# RAPORT AUDITIMI

## Mbi

## "Auditimin e Përputhshmërisë"

**Tiranë, tetor 2026**

| Nr. | Përmbajtja | Faqe |
|---|---|---|
| **I.** | **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE** | **4 – 12** |
| 1. | Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.... | |
| 2. | Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve..... | |
| 3. | Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit..... | |
| **II.** | **HYRJA** | **12 – 15** |
| 1. | Objektivat dhe qëllimi ..... | |
| 2. | Identifikimi i çështjes..... | |
| 3. | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese ..... | |
| 4. | Përgjegjësitë e audituesve..... | |
| 5. | Kriteret e vlerësimit..... | |
| 5. | Standardet e auditimit..... | |
| 7. | Metodat e auditimit..... | |
| 8. | Dokumentimi i auditimit..... | |
| **III** | **PËRSHKRIMI AUDITIMIT** | **15 -** |
| 1. | Informacion i përgjithshëm mbi subjektin ..... | 15 – 16 |
| 2. | Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.... | 16 – |
| *2.2.6* | *Mbi administrimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore.....* | *16 - 45* |
| *2.4* | *Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik....* | *45 – 142* |
| *2.4.4* | *Mbi zbatimin e kontratave të punëve publike (investime).....* | *142 – 165* |
| *2.5* | *Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikim zhvillim territorit.....* | *165 – 203* |
| *2.6.* | *Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV....* | *203 – 235* |
| *2.7* | *Të ndryshme dajë gjatë auditimit....* | *235 – 240* |
| **IV.** | **GJETJE DHE REKOMANDIME** | **204 – 263** |

**Lista e shkurtimeve.**

| | |
|---|---|
| KLSH | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| MFE | Ministria e FI.ncave dhe Ekonomisë |
| NA | Nëpunës Autorizues |
| NZ | Nëpunës Zbatues |
| UMF | Udhëzim i Ministrisë së FI.ncave |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| VKB | Vendim i Këshillit Bashkiak |
| ASHK | Agjencia Shtetërore e Kadastrës |
| NJA | Njësi Administrative |
| sh.a | Shoqëri Anonime |
| NJP | Njësia e Prokurimit |
| BOE | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë |
| OE | Operator Ekonomik |
| KVO | Komisioni i Vlerësimit të Ofertave |
| ISSAI | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit |
| INTOSAI | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit |
| IFAC | Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve |
| IPSAS | Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik |
| TAK | Titullari i Autoritetit Kontraktor |
| DT | Dokumentet e Tenderit |
| KVK | Kriteret e veçanta të kualifikimit |
| UKD | Ujësjellës Kanalizime Durrës |

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve të vitit 2025, kreu auditimin e përputhshmërisë me objektiv vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-fI.nciare të Bashkisë Durrës, për prokurimet publike, zbatimin e kontratave të punëve publike (investime), planifikimi dhe zhvillimi i territorit, veprimtaria e IMT dhe menaxhimin e të ardhurave.

Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2024.

Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive kryesore nga Bashkia Durrës si realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve fI.nciare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Konstatohet se deri më datë 31.12.2023, për mos pagesën e detyrimeve tatimore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë, debitorë janë në vlerën 1,718,399,005 lekë. Përgjatë vitit 2024 detyrimet janë rritur me vlerën 140,927,992 lekë. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2024, për abonentët privatë janë në vlerën 1,859,326,997 lekë.
- Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2023 – 31.12.2024 me fond limit 2,850,065 mijë lekë, u konstatua mangësi në hartimin e fondit limit, të specifikimeve teknike dhe kritereve kualifikuese, si dhe në vlerësimin e ofertave të OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, në kundërshtim me dispozitat e LPP.
- Në auditimin e zbatimit të 11 kontratave të shërbimit me vlerë 2,209,892 mijë lekë me TVSH, rezultoi se gjatë fazës së zbatimit të punimeve, të jenë konstatuar diferenca në volume të cilat konvertohen në efekt fI.nciar me dëm në buxhetin e Bashkisë Durrës për vlerën 30,353,166 lekë pa TVSH.
- Nga auditimi i lejeve të ndërtimit, u konstatua se në 5 praktika, taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në raport me sipërfaqen e objektit dhe paketën fiskale, duke evidentuar një të ardhur të munguar për vlerën 18,737,359 lekë;
- Nuk ishte mundësuar llogaritja dhe kalimi në favor të bashkisë fondi i banesave sociale (3%), referuar rregullores dhe legjislacionit në fuqi, duke evidentuar mungesë të ardhurash në vlerën 1,317,600 lekë ose 19.5 $m^2$ sipërfaqe banimi;
- Në 9 praktika nuk respektoheshin të gjitha kondicionet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe në lejen e zhvillimit, të tilla si: mosparaqitjen e saktë të planvendosjes së miratuar, mos pasqyrimi i të dhënave të sakta të treguesve të zhvillimit, mosrespektimi i të gjitha distancave të përcaktuara, lartësia e ndërtimit, intensiteti, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi;
- Në 3 praktika dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e-leje nuk paraqitet i plotë dhe ka mangësi lidhur me projektin "as build", me realizimin e objektit në përputhje me lejen e ndërtimit, si dhe me kryerjen e të gjitha verifikimeve të nevojshme përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, nëse ka pasur ndryshime/ devijime në zbatimin e punimeve të ndërtimit dhe nëse është respektuar destI.cioni i objektit sipas lejes së ndërtimit të miratuar;
- Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e IMTV-së, rezultoi se *për vitin 2023* në 26 raste nga 169 raste që ka mbajtur IMTV, dhe *për vitin 2024*, në 27 raste nga 194 raste që ka mbajtur IMTV, kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me fotografi ose video dhe nuk është bërë pjesë e dosjes individuale për secilën praktikë;

- *Për vitin 2023*, në 5 raste dhe në 17 raste *për vitin 2024*, nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve, kur do të duhej t'i ishte dhënë kohë subjektit të konstatuar për plotësimin e dokumentacionit ose përmirësimin e masave të sigurimit teknik në objekt dhe shtimin e mjeteve mbrojtëse të jetës së punëtorëve;
- Për periudhën e auditimit 01.01.2023 - 31.12.2024, vlera totale e gjobave të pa ekzekutuara (arkëtuara), në mënyrë vullnetare apo të detyrueshme, rezultojnë në një vlerë të lartë, konkretisht 69,491,000 lekë;
- Në 65 raste, vlera e masës administrative dënim me gjobë është vendosur e pabazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore (në shumën 500,000 lekë), ndërkohë që procedurat kanë të bëjnë me punime të kryera pa leje ndërtimi, për të cilat, vlera e gjobës llogaritet sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e);
- Në 22 raste, nga ana e Kryeinspektorit, nuk është respektuar afati 10- ditor për nxjerrjen e vendimeve vijuese sipas rastit, në funksion të kundërvajtjes së evidentuar në procesverbalin e konstatimit, dhe për 23 raste të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Durrës, të cilat përbëjnë vepër penale, sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal dhe IMTV, do të duhej t'u ishte drejtuar organeve ligj-zbatuese, për dërgimin pranë tyre të indicies për vepër penale dhe ka vepruar ndryshe për raste të ngjashme, duke përdorur dy standarte;
- Në 277 masa administrative "*Vendim me gjobë*", me vlerë totale 79,491,000 lekë, janë arkëtuar nga shlyerja vullnetare e detyrimit vlera 9,600,000 lekë, kurse 69,891,000 lekë rezulton pa arkëtuar. Ndërsa në 252 raste nuk rezulton që të ketë konfirmim njoftimi nga kundërvajtësit.

**b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.**

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të nenit 50 "*Auditi i jashtëm*" pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për fI.ncat e qeverisjes vendore". Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Durrës si një nga institucionet kryesore lokale në Shqipëri, menaxhon një pjesë të konsiderueshme të fondeve publike. Çdo vit, qytetarët i besojnë bashkisë taksat e tyre, në pritje që këto para të shpenzohen për investime, shërbime dhe infrastrukturë që përmirësojnë jetën e komunitetit. Por, si çdo institucion që administron burime të mëdha, ekziston gjithmonë rreziku që fondet të përdoren në mënyrë joefikase, të shpërdorohen, ose të mos përputhen me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
Auditimi nga KLSH nuk është thjesht një formalitet është një mekanizëm i pavarur që siguron se çdo vendim financiar i bashkisë është transparent dhe i përgjegjshëm. Përmes auditimit, KLSH-ja verifikon që buxheti i Bashkisë Durrës të përdoret sipas ligjit, se prokurimet janë bërë në mënyrë të drejtë dhe konkurruese, dhe se investimet e realizuara japin vlerë reale për qytetarët, dhe se lejet e ndërtimit janë dhënë në përputhje me kuadrin ligjore e rregullatorë.
Auditimi gjithashtu ndihmon në identifikimin e dobësive në menaxhimin financiar, duke dhënë rekomandime konkrete për përmirësim. Në këtë mënyrë, bashkia mëson të punojë më efikas, ndërsa qytetarët fitojnë siguri se paratë e tyre përdoren në mënyrë të drejtë.

**c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave.**

Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar, nëpërmjet analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit fI.nciar dhe kontrollit, duke vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.
Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2023 deri më datën 31.12.2024.
Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 31.12.2024, janë si vijon:
- *Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve;*
- *Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;*
- *Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (këtu e vijim IMTV);*
- *Auditimi mbi administrimin dhe përdorimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore;*

- *Të ndryshme të dala gjatë auditimit.*

**d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**
Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit fI.nciar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0.7% për paga/sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe 0.7% për shpenzimet *(mallra/shërbime dhe investime).*
Për periudhën e viti 2023, niveli i materialitetit pranohet në vlerën 78,904 mijë lekë dhe gabimi i lejuar *(10% - 20%)* në vlerën 7,890 mijë lekë ndërsa për vitin 2024 niveli i materialitetit pranohet në vlerën 90,282 mijë lekë dhe gabimi i lejuar *(10% - 20%)* në vlerën 9,028 mijë lekë, ku për t'u konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm.
Grupi i auditimit ka audituar mbi 70% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve/shërbimeve dhe investimeve. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe tekN.t e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

**e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:** Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka evidentuar gjithsej **44** gjetje dhe ka dhënë **45** rekomandime, *nga të cilat:* masa organizative janë 24 gjetje dhe 25 rekomandime, masa shpërblim dëmi janë 11 gjetje dhe dhënë 11 rekomandime me vlerë 30,353 mijë lekë, masa mungesë të ardhurash janë 9 gjetje dhe 9 rekomandime, dhe masa për 3-E janë 2 gjetje dhe 2 rekomandime.

**f. Paraqitja e gjetjeve kryesore**:
Nga auditimi rezultoi se, deri më datë 31.12.2023, detyrimet tatimore të papaguara nga subjektet fizikë dhe juridikë, si dhe abonentët familjarë, debitorë ndaj Bashkisë Durrës, arrinin në vlerën **1,718,399,005 lekë**. Gjatë vitit 2024, këto detyrime u rritën me **140,927,992 lekë**, duke arritur në total, në mënyrë progresive deri më datë 31.12.2024, në vlerën **1,859,326,997 lekë**.
Nga auditimi i **27 procedurave të prokurimit publik**, të zhvilluara gjatë periudhës 01.01.2023–31.12.2024, me fond limit në shumën **2,850,065 mijë lekë**, u konstatuan mangësi në hartimin e fondit limit, përcaktimin e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kritereve të kualifikimit. Gjithashtu, në disa raste, vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues është kryer ndonëse këta të fundit nuk përmbushnin kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.
Nga auditimi i fazës së zbatimit të kontratave të shërbimit, të realizuar në **11 kontrata** me vlerë totale **2,209,892 mijë lekë me TVSH**, u konstatuan diferenca në volume gjatë zbatimit të punimeve. Këto diferenca kanë sjellë efekt fI.nciar negativ në buxhetin e Bashkisë Durrës, në shumën **30,353,166 lekë pa TVSH**.
Nga auditimi i procedurave për dhënien e lejeve të ndërtimit rezultoi se: në **5 raste**, taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk ishte llogaritur në përputhje me sipërfaqen e objektit dhe përcaktimet e paketës fiskale, duke sjellë të ardhura të munguara në shumën **18,737,359 lekë**;
nuk ishte siguruar llogaritja dhe kalimi në favor të Bashkisë i fondit për banesat sociale, në masën **3%**, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, duke evidentuar të ardhura të munguara në shumën **1,317,600 lekë**, ose ekuivalentin e **19.5 m² sipërfaqe banimi**; në **9 raste**, zhvillimi i ndërtimit

nuk ishte në përputhje të plotë me kushtet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe lejen e zhvillimit, përfshirë pasqyrimin e saktë të planvendosjes së miratuar, treguesve të zhvillimit, distancave, lartësisë së ndërtimit, intensitetit të ndërtimit dhe koeficientit të shfrytëzimit të territorit; në **5 raste**, dokumentacioni i pronësisë i ngarkuar në sistemin "e-Leje" nuk ishte i përditësuar dhe mungonte konfirmimi i përputhshmërisë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës përpara miratimit të lejes së ndërtimit; në **2 raste**, dokumentacioni i administruar në sistemin "e-Leje" nuk ishte i plotë, pasi dokumente që disponoheshin nga autoriteti vendor gjatë shqyrtimit të aplikimit nuk ishin përfshirë në dosjen elektronike; Në **3 raste**, dokumentacioni i administruar në sistemin "e-Leje" kishte mangësi lidhur me projektin "as built", verifikimin e përputhshmërisë së objektit të ndërtuar me lejen e ndërtimit, si dhe kryerjen e verifikimeve të nevojshme përpara miratimit të certifikatës së përdorimit; në **2 raste**, gjendja faktike e zhvillimit të ndërtimit rezultoi në mospërputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.
Nga auditimi i dokumentacionit dhe veprimtarisë së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) rezultoi se: në **26 raste gjatë vitit 2023** dhe **27 raste gjatë vitit 2024**, kundërvajtjet e konstatuara nuk ishin dokumentuar me fotografi ose video dhe kjo evidencë nuk ishte administruar në dosjen individuale të praktikës, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit për inspektimin; në **5 raste gjatë vitit 2023** dhe **17 raste gjatë vitit 2024**, nuk ishte nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve, megjithëse, në kushtet e konstatuara, duhej t'i jepej subjektit koha e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit ose për marrjen e masave për përmirësimin e kushteve të sigurisë teknike dhe mbrojtjen e jetës së punëtorëve; detyrimet e papaguara nga masat administrative me gjobë arrinin në **69,491,000 lekë**. Gjithashtu, në rastet e arkëtimit të detyrimeve, nuk ishte llogaritur dhe arkëtuar kamata e vonesës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; në **65 raste**, masa administrative e dënimit me gjobë ishte përcaktuar në shumën **500,000 lekë**, ndonëse, për punimet e kryera pa leje ndërtimi, masa e gjobës duhej të përcaktohej në përputhje me kriteret dhe mënyrën e llogaritjes të parashikuara nga legjislacioni për planifikimin dhe zhvillimin e territorit; në **200 raste**, Kryeinspektori i IMTV-së nuk kishte vijuar procedurën për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, në **22 raste**, nuk ishte respektuar afati 10-ditor për nxjerrjen e vendimeve vijuese, sipas rastit, në funksion të kundërvajtjes së evidentuar; në **23 procedura**, për të cilat, sipas konstatimeve të auditimit, ekzistonin elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, IMTV-ja nuk kishte referuar indiciet përkatëse pranë organeve kompetente të zbatimit të ligjit. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se, për raste të ngjashme, ishte ndjekur praktikë e ndryshme, duke evidentuar zbatim jo të njëtrajtshëm të procedurave; nga **277 masa administrative "Vendim me gjobë"**, me vlerë totale **79,491,000 lekë**, ishin arkëtuar në mënyrë vullnetare vetëm **9,600,000 lekë**, ndërsa **69,891,000 lekë** rezultonin të paarkëtuara. Në **252 raste**, nuk rezultonte dokumentacion që të provonte konfirmimin e njoftimit të kundërvajtësve.
**g.1-** Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për:

- moslidhjen e kontratave për zbatimin e investimeve publike pa miratimin paraprak të lejes së ndërtimit/infrastrukturës dhe, në rastet kur kërkohet, pa kryerjen e oponencës teknike të objektit;
- hartimin e projekteve nga persona ose subjekte të licencuara, sipas kategorive përkatëse të punimeve, me qëllim garantimin e cilësisë së projekteve dhe pasqyrimin e gjendjes reale të objektit;
- hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, specifikimeve teknike dhe kritereve të vlerësimit të ofertave në mënyrë të qartë, objektive dhe proporcionale, duke garantuar transparencën, trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjen e konkurrencës dhe përdorimin me ekonomicitet të fondeve publike;
- analizimin, nëpërmjet një grupi pune të posaçëm, të rasteve të kualifikimit të operatorëve ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse. Gjatë fazës së vlerësimit të procedurave të prokurimit

të konsiderohet e vlefshme dhe të kualifikohet vetëm oferta që është plotësisht në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës, ftesën për ofertë ose dokumentet e tenderit.

**g.2-** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Durrës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për:

- dokumentimin e plotë të procesit të konstatimit të kundërvajtjeve administrative dhe të prishjes së ndërtimeve pa leje, si dhe respektimin e afatit ligjor 10-ditor për nxjerrjen e vendimeve vijuese nga Kryeinspektori i IMTV-së, pas mbajtjes së akteve të konstatimit;
- zbatimin e dispozitave ligjore dhe respektimin e afateve të përcaktuara për plotësimin e dokumentacionit nga subjektet e konstatuara;
- arkëtimin e gjobave që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të Ligjit nr. 127, datë 19.12.2024, si dhe kërkimin e kamatëvonesës, sipas legjislacionit në fuqi, për vendimet me gjobë të vendosura në vijim;
- përshkrimin e plotë dhe të detajuar të kundërvajtjes në akt-konstatim, duke përfshirë të dhënat mbi materialet e përdorura, përmasat dhe elemente të tjera të nevojshme për përllogaritjen e saktë të masës administrative;
- nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit për prishjen e objekteve të kundërligjshme për subjektet ndaj të cilave është marrë vendim për prishje, si dhe përllogaritjen e shpenzimeve për rikthimin e territorit në gjendjen e mëparshme në rastet e ndërtimeve të paligjshme në hapësira publike, duke njoftuar subjektet për likuidimin e dëmit në natyrë ose në vlerë monetare;
- referimin me kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës të rasteve të punimeve pa leje ndërtimi për banesa ose njësi shërbimi, sipas parashikimeve ligjore;
- ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve, duke dërguar fillimisht njoftimin për shlyerje vullnetare të detyrimit dhe, në rast mospagimi, vijimin e procedurave për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit dhe kalimin e çështjes për ekzekutim pranë Zyrës së Përmbarimit Shtetëror, në bashkëpunim me strukturat juridike të Bashkisë Durrës.

**g.3-** Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës të marrë masa për:

- verifikimin, përpara miratimit të lejeve të ndërtimit/zhvillimit, të plotësisë, përputhshmërisë dhe saktësisë së dokumentacionit teknik të ngarkuar në sistemin e-Leje, si dhe të përputhshmërisë së aplikimit me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor;
- përfshirjen në kushtet e lejes së ndërtimit edhe të lejes për prishjen e objekteve ekzistuese, në rastet kur në pasuritë që marrin pjesë në zhvillim ndodhen ndërtime ekzistuese;
- verifikimin e plotë të dokumentacionit që provon të drejtat pasurore mbi pronat që marrin pjesë në zhvillim, të gjendjes ligjore të përditësuar të tyre, të marrëveshjeve ndërmjet pronarëve, zhvilluesve dhe palëve të treta, si dhe të miratimeve dhe konfirmimeve të institucioneve përkatëse;
- administrimin në dosjen elektronike të sistemit "e-Leje" të të gjithë dokumentacionit të përdorur gjatë shqyrtimit të aplikimit, përfshirë kontratat, marrëveshjet dhe korrespondencën ndërinstitucionale;
- kryerjen e verifikimeve të nevojshme në sistemin "e-Leje" dhe në terren, përfshirë kontrollin e përputhshmërisë së punimeve me lejen e miratuar dhe dhënien e konformitetit për aktkontrollet e detyrueshme;
- zhvillimin, në bashkëpunim me IMTV-në, të kontrolleve të vazhdueshme në terren gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve dhe pas përfundimit të tyre, me qëllim parandalimin e devijimeve nga leja e ndërtimit dhe garantimin e ruajtjes së destI.cionit të miratuar;

- marrjen e masave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **18,737,359 lekë**, të ardhur si rezultat i mosllogaritjes së saktë të TNI-së;
- marrjen e masave për kalimin në favor të fondit publik të banesave sociale të sipërfaqes prej **19.5 m²** dhe, në pamundësi të kalimit të sipërfaqes ndërtimore, arkëtimin e vlerës përkatëse prej **1,317,600 lekë**, sipas përcaktimeve përkatëse.

**g.4-** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për menaxhimin e kontratave të punëve publike, të marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **30,353,166 lekë pa TVSH**, të konstatuar si pasojë e mangësive në zbatimin e kontratave të punëve publike.

**g.5-** Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me përfaqësues të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtorisë së Financës dhe specialistë të IT-së, me qëllim:

- rakordimin dhe saktësimin përfundimtar të detyrimeve tatimore të abonentëve biznes deri më datë 31.12.2024;
- verifikimin e funksionalitetit të sistemit informatik, në mënyrë që gjenerimi i detyrimeve të kryhet sipas datës faktike të kërkuar, pa përfshirë kamatëvonesa dhe rivlerësime të krijuara pas periudhës raportuese;
- dokumentimin zyrtar të çdo diference ndërmjet të dhënave të sistemit dhe evidencave kontabël, si dhe përcaktimin e përgjegjësive administrative dhe ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e pasaktësive;
- marrjen e të gjitha masave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët në vlerën **1,859,326,997 lekë**, deri në ndjekjen e procedurave përkatëse ligjore, përfshirë kallëzimin penal kur plotësohen kushtet ligjore, duke dokumentuar dhe administruar çdo veprim në dosjen individuale të debitorit;
- marrjen e masave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e plazhit, në vlerën **2,841,205 lekë**.

**g.6-** Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Durrës, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës, me qëllim evidentimin e shkaqeve dhe përcaktimin e personave përgjegjës për përdorimin joefektiv të fondeve buxhetore në vlerën **14,230,919 lekë**, si pasojë e hartimit të pasaktë të fondit limit dhe përfshirjes së TVSH-së së makinerive dhe pajisjeve.

## I.1. <u>Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit</u>

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale. Konkluzionet dhe opinioni ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Bashkia Durrës, e cila konsiderohet nga ana e jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinioni me siguri të arsyeshme. Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinioni të gabuar rreth objektivit të auditimit.

**Opinion mbi auditimin e përputhshmërisë:**
Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Durrës, me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, bazuar në mandatin e KLSH-së për auditimin e përputhshmërisë dhe kompetencën për të kryer auditimin sipas parashikimit të Ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë

të Shtetit". Evidencat e marra janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë të arsyeshme për opinionin tonë nga një vlerësim objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve dhe kushteve të përcaktuara, mbi të cilat është rënë dakord. Nga auditimi është konstatuar se gjatë veprimtarisë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "*Bazës për Opinionin*", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, situatë e cila justifikon dhënien e një ***opinioni të kualifikuar*[1]**.

**Bazat për opinionin e kualifikuar:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesit"*, pjesë e Raportit të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e përputhshmërisë. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 78,904 mijë lekë për *vitin 2023*, dhe për *vitin 2024* niveli i materialitetit pranohet në vlerën 90,282 mijë lekë. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë, (ISSAI 400 & ISSAI 4000). Mangësitë e konstatuara janë si më poshtë:

- Nuk janë marrë masa për uljen e nivelit të detyrimeve tatimore të subjekteve fizike, juridike dhe abonentëve familjarë, duke sjellë një efekt fI.nciar në vlerën **1,859,326,997 lekë**.
- Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit publik për periudhën objekt auditimi (01.01.2023–31.12.2024), u konstatuan veprime në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit për prokurimin publik, konkretisht në: përcaktimin e fondit limit; vendosjen e kritereve të kualifikimit të paargumentuara dhe të pambështetura në ligj, në raport me tipologjinë e procedurës; si dhe në kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë (OE), të cilët nuk plotësonin kriteret e kualifikimit dhe kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST).
- Nga auditimi i zbatimit të kontratave të punëve publike u konstatuan diferenca në volume, me pasojë efekt fI.nciar negativ në vlerën **30,353,166 lekë**, pa TVSH.
- Nga auditimi i lejeve të ndërtimit rezultoi se, në 5 praktika, taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në përputhje me sipërfaqen e objektit dhe përcaktimet e paketës fiskale, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në vlerën **18,737,359 lekë**.
- Nuk është kryer llogaritja dhe transferimi në favor të fondit të banesave sociale (3%) për një sipërfaqe banimi prej **19.5 m²**, duke sjellë mungesë të ardhurash në vlerën **1,317,600 lekë**.
- Në 9 praktika nuk janë respektuar të gjitha kushtet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) dhe në lejen e zhvillimit, konkretisht: nuk është paraqitur saktë planvendosja e miratuar; nuk janë pasqyruar saktë treguesit e zhvillimit; nuk janë respektuar distancat e përcaktuara, lartësia e ndërtimit, intensiteti dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit, në kundërshtim me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.
- Në 3 praktika, dokumentacioni i ngarkuar në sistemin "**e-Leje"** rezultoi i paplotë, me mangësi që lidhen me projektin **"as built"**, dokumentimin e realizimit të objektit në përputhje me lejen e ndërtimit, si dhe me kryerjen e të gjitha verifikimeve të nevojshme përpara miratimit të

[1] Opinioni i kualifikuar, jepet kur:
-audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura;
-audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

certifikatës së përdorimit, për të evidentuar nëse kanë ekzistuar ndryshime ose devijime gjatë zbatimit të punimeve dhe nëse është respektuar destI.cioni i objektit sipas lejes së miratuar.
- Në 2 praktika u konstatua se ndërtimi është realizuar në mospërputhje me lejen e ndërtimit.
- Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e IMT-së rezultoi se: për vitin 2023, në 26 nga 169 raste të trajtuara nga IMT-ja, dhe për vitin 2024, në 27 nga 194 raste, kundërvajtjet e konstatuara nuk janë dokumentuar me fotografi ose video dhe këto prova nuk janë administruar në dosjen individuale të praktikës; për periudhën 01.01.2023–31.12.2024, vlera totale e gjobave të paekzekutuara (të paarkëtuara), qoftë në mënyrë vullnetare apo të detyrueshme, rezulton **69,491,000 lekë**.
- Në 65 raste, masat administrative me gjobë janë vendosur në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore, duke u përcaktuar në mënyrë të njëtrajtshme në shumën **500,000 lekë**, megjithëse procedurat lidhen me punime të kryera pa leje ndërtimi, për të cilat masa administrative duhet të llogaritet sipas nenit 52, pika 1, shkronja "e", të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar.
- Nga 277 vendime administrative me gjobë për ndërtim pa leje, me vlerë totale **79,491,000 lekë**, janë arkëtuar në mënyrë vullnetare **9,600,000 lekë**, ndërsa **69,891,000 lekë** mbeten të paarkëtuara. Gjithashtu, në 252 raste nuk rezulton të ketë konfirmim të njoftimit të kundërvajtësve për vendosjen e masës administrative.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1347/ prot., datë 13.11.2024, i ndryshuar miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Durrës nga data 14.11.2024 deri në datën 27.01.2026, u krye auditimi i përputhshmërisë për periudhën nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2024 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:
1. Z. A. K, *përgjegjës grupi;*
2. Zj. O. F, *auditues*
3. Z. K. Gj, *auditues;*
4. Z. K. H, *auditues;*
5. Z. E. S, *auditues;*
6. Z. A. S, *auditues*.

### 1. Objektivat, Fushëveprimi dhe Metodologjia

**Objektivat dhe Qëllimi i auditimit.** Objektivi i *auditimit të përputhshmërisë* synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 31.12.2024.
Qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar, i cili do realizohet pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit fI.nciar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

**- Identifikimi i çështjes.** Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.
Ky Raport Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Durrës, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre. Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në

përputhje me kuadrin e raportimit fI.nciar në fuqi. Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditivit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i adituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditivi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditiv, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-fI.nciare të Bashkisë Durrës për përputhshmërisë**.**

- **<u>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</u>**. Në qytetin bregdetar të Durrësit, strukturat drejtuese të bashkisë nuk janë thjesht një radhë tituj, por janë motorët që mbajnë qytetin në funksion të mirë. Në krye të gjithë këtij sistemi është *Kryetari i Bashkisë*, personi që përfaqëson qytetarët dhe merr përgjegjësi të mëdha për të siguruar që vendimet e Këshillit Bashkiak të zbatohen në praktikë. Ai kujdeset që administrata të funksionojë pa ndërprerje, që shërbimet publike të jenë të rregullta nga ndriçimi i rrugëve, pastrimi i qytetit, deri te planifikimi i investimeve në infrastrukturë. Kryetari është gjithashtu ura lidhëse midis qytetit dhe institucioneve të tjera, duke përfaqësuar Durrësin në marrëdhënie kombëtare dhe ndërkombëtare.
Por Kryetari nuk vepron vetëm. *Këshilli Bashkiak*, i përbërë nga këshilltarë të zgjedhur, është organi vendimmarrës që merr vendimet kryesore për qytetin. Ata miratojnë buxhetin, rregulloret dhe politikat që do të përcaktojnë zhvillimin e Durrësit. Nëse Kryetari zbaton, Këshilli përcakton drejtimin: ai vendos se çfarë prioritetesh duhet të ketë qyteti, çfarë investimesh duhet të kryhen dhe si duhet menaxhuar buxheti i qytetit. Përgjegjësia e tyre është e thellë, sepse vendimet e tyre ndikojnë drejtpërdrejt tek jetët e banorëve.
Në sfond punon *administrata e bashkisë*, drejtori dhe sektorët e ndryshëm, që marrin vendimet dhe i kthejnë ato në veprim. Ata planifikojnë investimet, përgatisin dokumentacionin për lejet dhe shërbimet që qytetarët përdorin çdo ditë, dhe sigurojnë që hapësirat publike të jenë funksionale dhe të sigurte. Përgjegjësia e tyre është operative, nëse diçka nuk funksionon në qytet, një rrugë e prishur, një shërbim i vonuar, apo një projekt urbanistik që ngec, ata janë ata që duhet të japin zgjidhje.
Pra, struktura e Bashkisë Durrës është e ndërtuar në mënyrë që përgjegjësia të shpërndahet dhe të mbulojë çdo aspekt të jetës qytetare. Përgjegjësitë e tyre nuk janë vetëm detyra burokratike janë premisa për mirëqenien e komunitetit.

- **<u>Përgjegjësitë e audituesve</u>.** Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i njësisë dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-<u>së</u>) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:
- *Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore për prokurimet e fondeve publike, si dhe lidhja e zbatimi i kontratave;*
- *Nëse është zbatuar kuadri ligjorë në dhënien e lejeve të zhvillimit/ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit;*
- *Nëse është zbatuar kuadri ligjorë në mirëadmnistrimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, etj.*

- **<u>Kriteret e vlerësimit</u>.** Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit, si:
*<u>- Në fushën e prokurimeve publike dhe zbatimit të kontratave të punëve publike:</u>* Ligji nr. 162,

datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" , i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" , i ndryshuar; Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" , i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 57, datë 12,06.2014, "Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë"; Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", etj.
*- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:* Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" , i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për sistemin e taksave lokale" , i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare" , i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre" , i ndryshuar; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" , i ndryshuar; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, etj.
*- Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:* Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative" , i ndryshuar; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" , i ndryshuar; Ligji nr. 107-2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" , i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" , i ndryshuar; VKM nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve të ndërtimit" , i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i përditësuar); VKM nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore"; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.
Rregullore e brendshme "Mbi procedurat e auditimit në KLSH"; Rregullore e brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së"; Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë; Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut; Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit. Etj.

**Standardet e auditimit**. Për kryerjen e auditimit fI.nciar dhe të përputhshmërisë në Bashkinë Durrës grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si: ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik; ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

**- Metodat e auditimit**. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe tekN.t e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimet e auditimit;

d. *Të kombinuara,* sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme

të metodave dhe tekN.ve veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

- **Dokumentimi i auditimit**. Audituesit e KLSH, mbi bazën e dokumentacionit (evidencave) të kërkuar/a dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me përfaqësuesit e Bashkisë Durrës, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të fI.lizuar këto në akt konstatimet e mbajtura në subjekt të cilat u dorëzuan në datë 27.01.2026 në protokollin e Bashkisë Durrës, sipas afatit të përcaktuar në programin e auditimit, nr. 1347/1 prot, datë 13.11.2024, i ndryshuar dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, u hartua dhe dërgua, Projekt Raport Auditimi.
Në përfundim të afateve mbi Projekt Raport Auditimit, përcjellë me shkresën nr. 1347/68. Prot. datë 15.05.2026, nga subjekti audituar Bashkisë Durrës me shkresën nr. 668/88 Prot, datë 17.06.2026 (*administruar në KLSH nr. 1347/71, dt. 18.06.2026*), janë përcjellë observacionet mbi Projekt raportin e Auditimit, të cilat pasi u lexuan me kujdes dhe paanshmëri, hartohet ky Raport Përfundimtar të Auditimit, i cili i përcillet subjektit për njohje dhe zbatim.


## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

### 1. Informacion i përgjithshëm.

Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me Bashkinë Kurbin, në lindje me Bashkitë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me Bashkinë Kavajë. Bashkia Durrës përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz. Të gjitha njësitë e bashkisë bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra. Durrësi është qyteti me aktivitetin më të madh ekonomik pas Tiranës.
Sipas censusit të vitit 2023, kemi në situatë:

| | |
|---|---|
| **Numri i popullsisë më 18 Shtator 2023**<br>*Population number on September 18th 2023* | **226 863** |
| **Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë (%):**<br>*Gender population distribution:*<br>**Meshkuj**/*Male*<br>**Femra**/*Female* | <br>50,2<br>49,8 |
| **Popullsia me status martesor i/e martuar (%)**<br>*Population with marital status married* | 54,8 |
| **Popullsia 15 vjeç e lart që kanë përfunduar ose janë duke e ndjekur shkollën (%)**<br>*Population aged 15 and over have either completed any level of education or are currently attending school* | 96,7 |
| **Ndërtesa për qëllime banimi (Numër)**<br>*Buildings for residential purposes (Number)* | 59 723 |
| **Banesa të zakonshme të banuara (Numër)**<br>*Conventional inhabited dwellings (Number)* | 66 176 |
| **Njësi Ekonomike Familjare (Numër)**<br>*Households (Number)* | 68 645 |

www.instat.gov.al



| DURRËS | Numri i popullsisë më 18 Shtator 2023<br>*Population number on September 18th 2023* | Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë (%)<br>*Gender population distribution (%)* | | Ndërtesa për qëllime banimi (Numër)/<br>*Buildings for residential purposes (Number)* | Banesa të zakonshme të banuara (Numër)/<br>*Conventional inhabited dwellings (Number)* | Njësi Ekonomike Familjare (Numër)/<br>*Households (Number)* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj<br>*Male* | Femra<br>*Female* | | | |
| Durrës | 153 614 | 49,6 | 50,4 | 37 880 | 46 783 | 48 413 |
| Krujë | 51 191 | 51,6 | 48,4 | 14 029 | 13 297 | 13 882 |
| Shijak | 22 058 | 50,6 | 49,4 | 7 814 | 6 096 | 6 350 |

Misioni i Bashkisë Durrës është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.
Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:
*a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;*
*b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;*
*c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;*
*ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;*
*d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;*
*dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;*
*e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.*
Bashkia Durrës, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Ligji nr.68/2017 "Për fI.ncat e vetëqeverisjes vendore" , i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.
Rëndësia e auditimit të përputhshmërisë të Bashkisë Durrës për periudhën e aktivitetit 2023-2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

## 2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

### 2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave. nga taksat arifat, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**1- <u>Burimi i krijimit të të ardhurave:</u>**
Për vitin 2023 dhe 2024 burimet e fI.ncimit të Bashkisë Durrës, ndahen në 4 kategori (*Të ardhurat nga burimet e veta, Transferta nga Buxheti Qëndror, Huamarrja, Trashëgimi nga viti i shkuar, rindërtimi etj.*):
**A. Të ardhura nga burimet e veta:**
Sipas informacionit në evidencat për raportim të Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore (në vijim DATTV):
- *Planifikimi për vitin 2023 është 2,118,990 mijë lekë;*
- *Realizimi faktik për vitin 2023 është 1,851,570 mijë lekë;*
- *Planifikimi për vitin 2024 është 2,344,450 mijë lekë;*
- *Realizimi faktik për vitin 2024 është 2,303,707 mijë lekë;*

Realizimi faktik i vitit 2024 krahasuar me vitin 2023 është 24 **% më i lartë** dhe në vlerë absolute është **452 mijë** lekë.

- *<u>Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore</u>***<u>:</u>**

Organizimi i veprimtarisë së DTTV bëhet duke u mbështetur në sistemin që menaxhon bazën e të dhënave në Bashkinë Durrës. Sistemi i menaxhimit të të dhënave O.B.S. 11 (në vijim "Sistemi").
Objektivat e auditimit janë të sigurohet se njësia publike:
- *Pajtohet me legjislacionin, aktet e brendshme dhe kontratat,*
- *Siguron informacione operative dhe fI.nciare të besueshme dhe të plota,*
- *Mbron informacionin dhe aktivet e saj*.

Nga informacioni i marrë në intervistat me punonjësit e DTTV, pyetësorët e drejtuar institucionit dhe evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se:
Ndërthurja e veprimtarisë së DTTV Durrës me sistemin e menaxhimit të të dhënave nuk kryhet bazuar në komponentët e sistemit të menaxhimit fI.nciar dhe kontrollit.
"Përdoruesit" organizohen dhe funksionojnë vetëm sipas kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara në pozicionin e miratuar në strukturën organizative dhe si kuadër rregullator përdorin detyrat dhe kompetencat e miratuara në rregulloren e brendshme të institucionit.
DTTV nuk ka një rregullore të brendshme për funksionimin e sistemit apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem.
**a)** Ndërthurja e veprimtarisë së DTTV Durrës me sistemin e menaxhimit të të dhënave nuk kryhet bazuar në komponentët e sistemit të menaxhimit fI.nciar dhe kontrollit. Drejtoritë nuk angazhohen në procesin e monitorimit të sistemit, nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e procesit të popullimit të bazës së të dhënave, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga sistemi në evidencat format Excel dhe më pas shkresore për raportime midis drejtorive apo drejt titullarit.
**b)** Nuk ka informacion për administrimin e përdoruesve, bashkëveprimin me burimet njerëzore për procedurat e gjenerimit në sistem të përdoruesve të rinj, përdoruesve që ndërrojnë pozicion pune apo që largohen nga detyra. Nuk ka informacion për procedurën që ndiqet për përdorues të cilët janë larguar nga detyra apo kanë ndryshuar pozicion në strukturë.
**c)** Referuar të dhënave gjatë punës audituese dhe intervistave me stafin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, administrator i sistemit është kompania private e cila referuar kontratës së bashkëpunimit ka akses total në sistem e cila mund të sjelli risk të shtuar për institucionin dhe databazën me të dhëna të rëndësishme e cila disponohet.
**d)** Informacionit i Sistemit të Menaxhimit të të dhënave nuk përputhet me evidencat zyrtare mbi të cilat DTTV planifikon dhe raporton.
**e)** Raportet që prodhon ky sistem dhe që përpunohen më pas në formatin Excel nga sektorët për të ndërtuar evidenca nuk protokollohen.
**f)** Referuar të dhënave të kërkuar nga sektori i borxhit dhe apelimit nga sistemi nuk mund te gjenerohet një listë përmbledhëse për debitorët por kjo listë mund të gjenerohet për çdo vit më vete.
Drejtoritë të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk rakordojnë me DTTV lidhur me realizimet e të ardhurave që kanë përgjegjësi të menaxhojnë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar me VKB-në nr. 149, datë 22.12.2022 "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit, viti 2023*".
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin fI.nciar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni 5...., neni 11,...; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41.; Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 5, pika ç; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar.
Në Bashkinë Durrës struktura e taksave dhe tarifave vendore për periudhën e auditimit është e organizuar në nivel drejtorie, e cila është paraqitur **në aneksin nr. 2.2.6.1** në anekset e projekt raportit të auditimit. Sistemi ka të njëjtën strukturë organizative me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore. Komponentët klientë në vijim "Përdoruesit" janë pjesë (softuerë) e sistemit që përdor Bashkia për manaxhimin e të ardhurave. Përdoruesit janë instaluar në kompjuterat

personal në vijim "PC" që janë në përdorim të punonjësve të drejtorive dhe njësive të varësisë. Sistemi nëpërmjet raporteve që gjeneron i mundëson drejtimit, (*sipas pozicioneve të Strukturës Organizative të miratuar dhe funksioneve të drejtorisë*) organizimin dhe monitorimin e punës për popullimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të sistemit. Informacioni që grumbullohet dhe përpunohet nga përdoruesit sipas kategorive biznes dhe familjarë, ka të bëjë me regjistrimin e subjekteve të reja, modifikimin e përllogaritjen e detyrimeve për taksat e tarifa vendore të subjekteve ekzistuese, si dhe regjistrimin e të ardhura nga vjelja e tyre.
Për vitin 2023 struktura organizative është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 69, datë 05.08.2022, "*Për ndryshimin e strukturës dhe rregulloren e Bashkisë Durrës"*", ndryshuar me vendim nr. 73, datë 03.10.2023.

DTTV organizohet në nivel drejtorie struktura e saj sipas sektorëve është me 44 punonjës, si: Drejtor Drejtorie 1 punonjës; Specialist jurist 1 punonjës; Sektori i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore 10 punonjës: Përgjegjës sektori 1 punonjës; Specialist sektori 7 punonjës; Specialist statistike 1 punonjës; Specialist rakordimi 1 punonjës; Sektori i kontrollit të taksave dhe tarifave 16 punonjës: Përgjegjës sektori 1 punonjës; Inspektor sektori 15 punonjës; Sektori i menaxhimit të borxhit dhe apelimit 7 punonjës: Përgjegjës 1 punonjës; Specialist sektori 6 punonjës; Administrata e tregut Agro-Bujqësor me pakicë 9 punonjës: Administrator tregu 1 punonjës; Inspektor finance 1 punonjës; Inspektor i taksave 1 punonjës; Mirëmbajtës 1 punonjës; Pastrues 2 punonjës; Roje 3 punonjës.

Nga auditimi i dokumentacionit të përmendur më sipër ("*Vendimi i Këshillit Bashkiak Durrës për miratimin e Paketës Fiskale", "Struktura organizative dhe Rregullorja e Brendshme për funksionimin dhe organizimin e Bashkisë Durrës"*), dhe kontrolli në ndërfaqen zyrtare të Bashkisë Durrës, u konstatua se:
Nuk realizohet në kohë njoftimi i subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore pasi përllogaritja dhe azhurnimi i detyrimeve vjetore në sistem bëhet manualisht. Mungon një adresar i plotë dhe i qartë për kategoritë Familjarë dhe Biznes, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 23, 27, 28, 30, 32, 36, 38,... neni 64 pika 3; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, në nenin 7, Ligji nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*" (i ndryshuar).

- *Mbi përputhshmërinë e "Sistemit të Menaxhimit të të dhënave për të ardhurat" në Bashkinë Durrës me kuadrin ligjor në fuqi.*

Auditimin i "*Sistemit*" është vlerësuar i rëndësishëm, për shkak të shërbimit që ofron. Ky sistem administron "*Regjistrin Elektronik*" për tatimpaguesit në kategorinë Biznes dhe Familjar, në nivel lokal. Si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkëpërdorimi i burimeve të informacionit, siguria e informacionit ka rëndësi të lartë për institucionet e administratës shtetërore që administrojnë ose kanë në përdorim një sistem menaxhimi të dhënash.
Bazuar në informacionin dhe nenin 3, pika "a" të Ligjit nr. 10325, datë 23.09.2010, "*Për bazat e të dhënave shtetërore*" në të cilin citohet, "*Baza e të dhënave shtetërore" kuptohet grumbullimi i organizuar i informacionit, i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhen nëpërmjet një sistemi kompjuterik, si pjesë e plotësimit të detyrimeve ligjore të institucionit administrues*", rezulton se Bashkia Durrës ka krijuar dhe administron *" Bazë* të dhënash shtetërore". Kjo bazë të dhënash ndërvepron me sistemin e "U" sh.a për administrimin e taksapaguesve familjarë.
Bashkia Durrës krijimin dhe administrimin e bazave të të dhënave nuk e kryen bazuar në kuadrin rregullator në fuqi. Ky institucion nuk ka paraqitur kërkesë për regjistrimin në regjistrin kombëtar të bazave të të dhënave shtetërore pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së

Informacionit në vijim (AKSHI), i cili është autoriteti rregullator koordinues, përgjegjës i bazave të të dhënave shtetërore në vijim (ARK).
Struktura e teknologjisë së informacionit në vijim "TI" është e organizuar në nivel drejtorie me 5 punonjës (*Drejtor Drejtorie 1 punonjës, Sektori i Informacionit me 2 punonjës dhe Sektori i Dixhitalizimit të Shërbimeve me 2 punonjës*).
Për administrimin e sistemeve që përdor kjo bashki, specifikisht për sistemin e përmendur më sipër, *nuk ka një person përgjegjës të autorizuar (marrësi në dorëzim i kodit të burimit) për administrimin e bazës së të dhënave. Shërbime të ndryshme në këtë bazë të dhënash kryhen nga personel që nuk është pjesë e strukturës organizative të personelit të Bashkisë Durrës***.**
Nuk ka Auditues me profil të teknologjisë së informacionit për të zhvilluar burimet njerëzore të auditit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit. Nuk janë planifikuar, kryer misione auditimi mbi sistemet e TI-së duke mos përmbushur kriteret e Manualit të Auditit të Brendshëm të miratuara me urdhërin nr.4, datë 10.01.2020 pika 2.4.4**.**
Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, "*Për bazat e të dhënave shtetërore*" nenin 3, Kreun II "Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave; Ligji nr. 2/2017, datë 26.01.2017, "*Për sigurinë kibernetike*" neni 4; Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" të ndryshuar" nenet 2, 3,.5, 6....20...27,28..; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar nenet 25, 27, 28, 31.

- *Mbi kontrollin e cilësisë së të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve.*

Informacioni që popullon bazën e të dhënave organizohet sipas kategorive të bizneseve: Biznes i madh; Biznes i Vogël; Ambulant; Transport; Institucione shtetërore; Pa kategori (*Janë subjekte të cilat nuk kanë specifikim të kategorisë që i përkasin* ).
Taksat dhe tarifat vendore që administron ky sistem për kategorinë biznes paraqiten si më poshtë: *Taksa mbi Ndërtesën Biznes, Taksa e Truallit, Taksa e Tabelës, Taksa e Reklamës, Taksa e Fjetjes në Hotel, Taksa e Përkohshme e Infrastrukturës Arsimore, Tarifë e Pastrimit Biznes, Tarifë Ndriçimi, Tarifë Gj., Tarifë Parkimi, Tarifa Plazh Privat.*

1. Person

- Familje që kanë në pronësi/përdorim banesa private, toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.
- Pa kategori.

Lidhur me sa më sipër veprimtaria e DTTV bazohet në proceset që menaxhojnë :

- Kërkesa për regjistrim të subjekteve të reja.
- Ndryshime në të të dhënave rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përllogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet ekzistuese.
- Kërkesat për çregjistrim, pezullim të subjekteve ekzistuese.

Të dhënat e administruara nga sistemi i DTTV janë në funksion të identifikimit të subjektit tatimpagues dhe përcaktimit të detyrimit për tu paguar lidhur me taksat dhe tarifat vendore.
Bashkia Durrës nuk ka element kontrolli mbi vërtetësinë e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve, pasi ky kontroll nuk është pjesë vetëm e aktivitetit të këtij institucioni por një ndërthurje midis Degës Rajonale të Tatimeve në vijim (DRT), Qendrës Kombëtare të Biznesit në vijim (QKB) dhe sektorit të kontrollit në terren pranë DTTV. Sistemi nuk ka ndërveprim me QKB dhe DRT.
Komunikimi midis DTTV dhe QKB është vetëm në rrugë shkresore dhe e-mail. Sektori i terrenit është hallka e vetme për të përcaktuar përputhjen midis të dhënave të deklaruara vullnetarisht nga subjekti në QKB, të dhënat faktike në terren dhe të dhënave që administron DTTV në dosjen e subjektit. Nëpërmjet akt konstatimeve në terren ky sektor konfirmon saktësinë e të dhënave për të proceduar më tej me regjistrimin e subjekteve në sistemin e DTTV.
Nga auditimi lidhur me të dhënat elektronike të subjekteve, mënyrën e përllogaritjes së

detyrimeve dhe përgatitjen e evidencave mbi raportet e përfituara nga sistemi i menaxhimit të të dhënave është konstatuar se:
Popullimi i sistemit me kërkesa për regjistrim të subjekteve të reja, ndryshimet në të dhënat rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përllogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet ekzistuese nuk realizohet duke rakorduar informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT.
Regjistrimi i subjekteve të reja në sistem kryhet bazuar në akt konstatimet nga Sektori i kontrollit të taksave dhe tarifave. Akt konstatimet nuk përcaktojnë përputhjen midis informacionit të deklaruar vullnetarisht nga subjekti në QKB me informacionin faktik në terren. Kjo ndikon në përgatitjen e evidencave të qarta sa i përket identifikimit të subjektit dhe përcaktimit njoftim detyrimit për tu paguar lidhur me taksat dhe tarifat vendore.
DTTV për çdo aplikim nga subjektet ekzistuese lidhur me ndryshimin e të dhënave i kërkon sektorit të kontrollit në terren të kryej verifikimin për konfirmimin e të dhënave të deklaruara vullnetarisht në QKB apo në sportele. Në DTTV nuk konstatohen evidenca të ndjekjes së procedurës ligjore për mbledhjen e debisë së tyre, por procedohet me hapjen apo mbylljen e adresave dytësore të tjera.
DTTV për çdo aplikim nga subjektet ekzistuese lidhur ndryshimin e statusit të aktivitetit (*çregjistrim, pasiv apo pezullim*) i kërkon sektorit të kontrollit në terren informacion lidhur me kërkesën e paraqitur nga QKB (*nëse subjekti i cili ka paraqitur kërkesën për ndryshim statusi ushtron aktivitet ose jo*.)
Ky akt konstatim është shumë i rëndësishëm, ai duhet të realizohet konform kuadrit rregullator ligjor brenda afateve të përcaktuara në ligj sepse: Në rast të mos respektimit të afateve të përcaktuara në kuadrin ligjor, QKB procedon automatikisht me ndryshimin e statusit. DTTV Durrës për të gjitha rastet kur statusi ka ndryshuar ndërpret faturimin e mëtejshëm të subjektit edhe pse ky çregjistrim ka ardhur si pasojë e mos përgjigjes në kohë ndaj kërkesës për evidentimin e gjendjes debitorë nga QKB**.**
Në sistem janë konstatuar raste ku subjekti, ka gjendje debitorë, rezulton me statusin aktiv në QKB por në sistem pasqyrohet me statusin mbyllur pasiv apo pezulluar. Ky status në sistem ndërpret njoftim detyrimin. Termi i përdorur më shpesh në akt konstatime është "*Nuk u gjet në aktivitet*"", pa përcaktuar numrin e procesverbaleve të mbajtura për të vërtetuar shpeshtësinë e kontrolleve apo faktin nëse ky subjekt nuk ushtron aktivitet që normalisht për çdo subjekt duhej tre procesverbale në periudha në ndryshme kohore.
Nga evidencat e trajtuar në DTTV nuk u konstatua asnjë dokument i cili tregon rakordimin me degët rajonale të tatimeve lidhur me klasifikimin e biznesit dhe llojin e aktivitetit që kryen.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 1, neni 2 germat a), ç), neni 5 germat a), d), dh), f), g), gj), h), i), neni 6 pikat 1, 2, 3, neni 12 germat a, b, dh..., neni 13 germa b), neni 15, neni 23 pika 1, 4, neni 26, neni 27,neni 28 pika 1, neni 29, neni 31, neni 40, neni 41, neni42, neni 43 pika1, 2, 3, neni 44, neni 45, neni 47 , neni 48 pika 1, neni 57 pikat 4, 5, nenet 60, 61, 62, neni 65 pika 5, nenet 68, 69 , neni 70 pika 2, neni 71/1 pika 5 ; Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, "*Për regjistrimin e biznesit*" i ndryshuar, nenet 28-40, neni 42, neni 43 germa d, neni 59; VKB-në nr. 149, datë 22.12.2022, "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit*"; Rregulloren e brendshme të bashkisë.

- **<u>Planifikimi, vlerësimi i mbledhjes dhe realizimi i të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.</u>**

*<u>Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore</u>.*
*Për vitin 2023* paketa fiskale për taksat dhe tarifat vendore në Bashkisë Durrës është miratuar me VKB nr. 149, datë 22.12.2022 "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit*".

Parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, duke u përgatitur fillimisht në formë relacioni nga DTTV. Në tabelat në vijim paraqitet i detajuar parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2023, është paraqitur **në aneksin nr. 2.2.6.2** në anekset e projekt raportit të auditimit.
Për vitin 2024 paketa fiskale për taksat dhe tarifat vendore në Bashkisë Durrës është miratuar me VKB nr. 194, datë 22.12.2023 "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit*".
Parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, duke u përgatitur fillimisht në formë relacioni nga DTTV. Në tabelat në vijim paraqitet i detajuar parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2024, sipas **aneksit nr. 2.2.6.3** në anekset e projekt raportit të auditimit.

*Për vitin 2023* të ardhurat nga burimet e veta, ku futen: a) të ardhurat nga taksat vendore dhe b) të ardhura jo tatimore (*tarifat vendore etj*.), janë planifikuar në vlerën 2,118,990 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 1,851,570 mijë lekë, ose në masën 87% me një mosrealizim në vlerën 267,320 mijë lekë.
Në këtë planifikim të ardhurash, të ardhurat nga taksat duke përfshirë dhe taksat e ndara janë planifikuar në vlerën 1,255,050 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 1,127,316 mijë lekë, ose në masën 89%, ndërsa të ardhurat jo tatimore (*peshën kryesore e zënë tarifat vendore*), janë planifikuar në vlerën 785,248 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 594,721 mijë lekë, ose në masën 76%.
Peshën specifike më të ulët në mosrealizimin e të ardhurave gjatë vitit 2023 e zë: taksa e tokës bujqësore në masën 20%, *ku nga vlera e parashikuar 45,000 mijë lekë është realizuar në masën 9,030 mijë lekë,* taksa e ndërtesës për familjarët në masën 41%, *ku nga vlera e parashikuar prej 150,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 61,433 mijë lekë,* TNI për objektet e legalizuara në masën 0%, *ku nga vlera e parashikuar prej 30,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 22 mijë lekë*.
- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturI.ve ka realizim të ulët. Kështu nga vlera e planifikuar prej 350,000 mijë lekë dhe është realizuar në vlera 241,469 mijë lekë, ose në masën 69%. Në këtë mosrealizim ka ndikuar tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturI.ve nga popullata, e cila nga vlera e planifikuar prej 160,000 mijë lekë është realizuar në vlerën 71,920 mijë lekë, ose në masën 45%, edhe tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve, ku nga vlera e planifikuar prej 190,000 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 169,549 lekë, ose në masën 89%.
Planifikimi për tarifën e pastrimit dhe rritja me 11% e detyrimit për të është bërë në mbështetje të realizimit të programit të manaxhimit të mbetjeve dhe jo si rezultat i një analize mbi realizimin e mëparshëm, etj.
**Për vitin 2024** të ardhurat nga burimet e veta, ku futen: a) të ardhurat nga taksat vendore dhe b) të ardhura jo tatimore (*tarifat vendore etj*.), janë planifikuar në vlerën 2,344,450 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 2,303,707 mijë lekë, ose në masën 98% me një mosrealizim në vlerën 40,743 mijë lekë.
Në këtë planifikim të ardhurash, të ardhurat nga taksat duke përfshirë dhe taksat e ndara janë planifikuar në vlerën 1,448,050 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 1,300,404 mijë lekë, ose në masën 89%, ndërsa të ardhurat jo tatimore (*peshën kryesore e zënë tarifat vendore*), janë planifikuar në vlerën 802,400 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 825,614 mijë lekë, ose në masën 103%.
Peshën specifike më të ulët në mosrealizimin e të ardhurave gjatë vitit 2024 e zë: taksa e tokës bujqësore në masën 35%, *ku nga vlera e parashikuar 45,000 mijë lekë është realizuar në masën 15,638 mijë lekë,* taksa e ndërtesës për familjarët në masën 80%, *ku nga vlera e parashikuar prej 165,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 131,733 mijë lekë,* TNI nga ndërtimet e reja në masën 51%, *ku nga vlera e parashikuar prej 460,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 235,867 mijë lekë*.

**Tabela Nr.1:** Paraqiten në mënyrë të përmbledhur të ardhurat e realizuara dhe kuadruara me Degën e Thesarit Durrës:

| | Viti 2023 | Plani 2023 | Fakti 2023 | % e realizimit | Plani 2024 | Fakti 2024 | % e realizimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | Të Ardhura nga burimet e veta | **2,118,990** | **1,851,570** | **87** | **2,344,150** | **2,303,707** | **98** |
| A1 | Të ardhurat nga Taksat Vendore | 965,500 | 816,646 | **85** | 1,133,000 | 970,342 | 86 |
| A2 | Të ardhurat nga taksat e ndara | 289,550 | 310,670 | **107** | 315,050 | 330,062 | 105 |
| A3 | Të ardhura nga tarifa vendor | 785,248 | 594,721 | **76** | 802,400 | 825,614 | 103 |
| A4 | Të ardhura të tjera | 78,692 | 129,532 | **165** | 94,000 | 177,689 | 189 |

***Burimi:*** *Përpunoi Grupi i Auditimit*

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se si parashikimi dhe realizimi për vitin 2024 është në nivel më të lartë se viti 2023.
Kështu nga vlera e parashikuar prej 2,118,990 mijë lekë në vitin 2023, në vitin 2024 parashikimi është në nivelin 2,344,150 mijë lekë ose 225,160 mijë lekë më tepër. Po kështu dhe fakti nga vlera e arkëtuar prej 1,851,570 mijë lekë viti 2023, në vitin 2024 kemi në realizim në masën 2,303,707 mijë lekë ose 452,137 mijë lekë më shumë.
Në Taksat dhe Tarifat Vendore të Bashkisë Durrës taksa e ndërtesës zë 22.3 % të të ardhurave të realizuara, taksa e pastrimit zë 15.8% të të ardhurave të veta dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe e planifikimit të territorit zë 10.2% të të ardhurave të veta

- **Analiza me zgjedhje disa nga taksat e tarifat:**

- *Taksa mbi tokën bujqësore***.**

Në paketën fiskale të Bashkisë Durrës është parashikuar:
Baza e taksës: *Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit*. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumenteve të pronësisë, formularit nr. 6, aktit të pronësisë, certifikatës së regjistrimit të tokës. Është miratuar edhe niveli i taksës mbi tokën bujqësore, e cila në varësi të kategorisë së tokës varion nga vlerë 5,600 lekë/ha/vit deri në 1,260 lekë/ha/vit. Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, kjo referuar paketës fiskale që e ngarkon si sektori përgjegjës për menaxhimin e kësaj takse.
Nga auditimi konstatohet se :
Për të gjithë periudhën e audituar taksa mbi tokën bujqësore nuk është administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në kundërshtim me përcaktimet e bërë në paketën fiskale.
Për këtë taksë nuk ka regjistër të taksapaguesve. Për kategorinë familjar edhe pse është parashikuar në paketë fiskale të arkëtohet nga UKD, kjo nuk është realizuar as nga UKD dhe as nga vetë Bashkia, pasi vetë struktura e taksave të bashkisë për mungesë të dhënash si të familjarëve edhe të sipërfaqes për secilën familje, nuk ka bërë llogaritje të detyrimeve për këtë taksë dhe si rrjedhim ngarkesa në faturën e ujit nuk është kryer.
Planifikimet janë të pa mbështetura në të dhëna reale. Për vitin 2023 taksa mbi tokën bujqësore është planifikuar në vlerën 45,000 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 9,030 mijë lekë, ose në masën 20%, *nga cila:* taksa e tokës bujqësore për biznes nga 11,400 mijë lekë është arkëtuar 62 mijë lekë ose 1% dhe për familjarët nga 33,600 mijë lekë është arkëtuar vlera 8,968 mijë lekë ose 27% .
Për vitin 2024 taksa mbi tokën bujqësore është planifikuar në vlerën 45,000 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 15,638 mijë lekë, ose në masën 34%, *nga cila:* taksa e tokës bujqësore për biznes nga 11,400 mijë lekë është arkëtuar 0 mijë lekë ose 0 % dhe për familjarët nga 33,600 mijë lekë është arkëtuar vlera 15,638 mijë lekë ose 46% .
Në tabelën më poshtë paraqitet shpërndarja sipas njësive numri i familjeve që kanë përfituar tokë bujqësore.

**Tabela Nr.2:** Të dhëna mbi tokën bujqësore të ndarë sipas Njësive Administrative.

*000 lekë*

| Nr. | Bashkia Durrës | Nr. i familjeve të trajtuara me tokë bujqësore | Sipërfaqja e tokës bujqësore në ha | Nr. i familjeve që kanë likuiduar | Vlera e likuiduar gjatë vitit 2023 | Nr. i familjeve që kanë likuiduar | Vlera e likuiduar gjatë vitit 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Nj. Administrative 4 e 6 (ish NB Spitalle) | 1,820 | 2,129 | 144 | 1,535 | 153 | 2.743 |
| 2 | Nj. Administrative Manez | 2,230 | 2,148 | 83 | 460 | 120 | 1,391 |
| 3 | Nj. Administrative Sukth | 3,500 | 3,120 | 174 | 1,037 | 231 | 1,834 |
| 4 | Nj. Administrative Ishem | 1,919 | 2,139 | 149 | 762 | 174 | 1.880 |
| 5 | Nj. Administrative Katund i ri | 4,410 | 3,620 | 298 | 2,089 | 475 | 4,016 |
| 6 | Nj. Administrative Rashbull | 3,420 | 3,284 | 403 | 1,792 | 421 | 3,752 |
| | **Totali** | **17,299** | **16,442** | **1,251** | **7,678** | **1,574** | **15,618** |

***Burimi i të dhënave:*** *Bashkia Durrës*

Referuar tabelës së mësipërme, kjo taksa arkëtohet vetëm nga ato persona të cilët paraqiten në Bashki për marrjen e shërbimit për transaksionet e shitblerjes, ndërsa për pjesën tjetër nuk veprohet. Gjithashtu nuk ka bashkëpunim dhe me UK Durrës si agjent për aplikimin e taksës së tokës, pasi në faturën e UK Durrës tarifohet vetëm taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe pastrimit, kjo e bën të pamenaxhushme këtë taksë. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë. 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 4 , neni 23; Paketa fiskale e miratuar nga Këshilli Bashkiak Durrës; VKB- në nr. 149, datë 22.12.2022, "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit*", pika A.1.1.2 "Taksa e tokës bujqësore" dhe VKB- në nr. 194, datë 22.12.2023, "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit*", pika A.1.1.2 "Taksa e tokës bujqësore"

-Parashikimi i të ardhurave nga taksa bujqësore në vlerë 45,000 mijë lekë nuk është i argumentuar as me realizimin e të ardhurave për vitet 2023-2024 dhe as në përputhje me sipërfaqet e ndara në ha.

-Referuar të dhënave të mësipërme nga Sektori i Bujqësisë pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike nuk ka paraqitur informacion për vlerësimin e kategorive të tokës dhe sipërfaqen me ha sipas njësive administrative gjithashtu dhe informacion për tokat e mbjella me kultura drufrutor dhe vreshtari të përjashtuara nga taksa e tokës bujqësore me afat 5-vjeçar.

-Nga sektori i menaxhimit të gjeoinformacionit pjesë e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit nuk disponohet informacion i azhornuar për (AMTP) për të paraqitur ndryshimet e tyre gjatë periudhës 2023-2024.

**Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi si më poshtë:** z. *L.D., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 01.01.2023-21.01.2024, z. R. Sh., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 21.01.2024-31.12.2024, z.A.I., Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z. R.D., Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, z. M.L., inspektor i sektorit të kontrollit të taksave dhe tarifave vendore.*

- *Taksa dhe tarifa lokale (familjarët) me agjent tatimor*.

Për kategorinë e taksapaguesve familjar nga DTTV nuk është hartuar regjistër i taksapaguesve familjar, në kundërshtim me pikën 7, të nenit 4, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar,: *Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të FI.ncave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".*

Në VKB-në nr. 149, datë 22.12.2022, "*Mbi sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Qytetin e Durrësit*", dhe VKB-në nr. 194, datë 22.12.2023, "*Mbi sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Qytetin e Durrësit*", është përcaktuar se për kategorinë e taksapaguesve familjar, UK Durrës sh.a do të luaj rolin e agjentit tatimor për 6 lloj taksash (ndërsa faktikisht ka mbledhur 5 lloje taksash).

Në vijim paraqiten të dhëna për këto taksa si dhe për taksat e tjera për të cilat subjekte jashtë bashkisë luajnë rolin e agjentit tatimor.

**Tabela Nr. 3:** Taksat e abonentëve familjarë

| Nr. | Lloji i taksës për taksapaguesit familjar | Agjenti tatimor | Akt marrëveshja midis Bashkisë dhe Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a |
|---|---|---|---|
| I | - Taksa ndërtesës<br>- Taksa e truallit<br>- Tarifa e pastrimit<br>-Taksa e përkohshme e Gj.t<br>- Tarifa e ndriçimit | UKT Durrës sh.a | Kontrata nr. 641 prot., datë 03.02.2014<br>Aneks kontrate nr. 849 prot. date 12.04.2016 |
| II | Tatim i thjeshtuar mbi fitimin | Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës | Bazuar në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"*, i ndryshuar. |
| III | Taksa e mjeteve të përdorura | Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Bazuar në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 *"Për taksat kombëtare"* i ndryshuar |
| IV | Taksa e së drejtës së pronësisë | Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Durrës | Bazuar në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"*, i ndryshuar. |

Struktura që kryen aktet e rakordimit me agjentët tatimor është sektori i të ardhurave (i regjistrimit).
Bazuar në nenin 1 dhe të kontratës nr. 641 prot., datë 03.02.2014, Bashkia Durrës ka detyrimin (neni 1): të përcjellë periodikisht rekordet me detyrimet për taksat dhe tarifat e popullatës (TTP) pranë agjentit tatimor; (neni 2): Bashkia dërgon të dhëna të plota me rekordet për taksat dhe tarifat e popullatës (TTP), nëpërmjet sistemit informatik.
Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2023, nga lista prej 70,783 e abonentëve familjarë e regjistruar në UKD janë ngarkuar me taksa dhe tarifa vendore 60,783 abonentë, 10,000 abonentë janë abonentë të përjashtuar nga tarifat vendore.
Për vitin 2024, numri i abonentëve familjarë të identifikuar me kontratë me UKD është 83,355 abonentë përfshirë qytetin e Durrësit dhe Njësitë Administrative. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon informacion të azhornuar nga gjendja civile për numrin e familjeve të regjistruara në këtë Bashki.
Nga auditimi rezulton se, për periudhën 2023-2024 nuk është hartuar një plan apo strategji, vjetore apo afatshkurtër (më shumë se një vit), për të evidentuar familjet e pa regjistruara te agjenti tatimor UKD, në mënyrë që të ndiqej arkëtimi i tyre jashtë agjentit tatimor, pra nga vetë administrata e taksave dhe tarifave vendore Durrës. DTTV nuk ka hartuar regjistër të taksapaguesve familjar duke mos evidentuar taksapaguesit familjar të cilët nuk kanë marrëdhënie me UK Durrës. DTTV ka lënë jashtë mbikëqyrjes së saj këtë kontingjent taksapaguesish familjar. Nuk ka të dhëna për familjarët të cilët nuk kanë marrëdhënie me UKD, si bëhet menaxhimi i tyre, pasi referuar të dhënave të evidencës janë të deklaruara vetëm për abonentët familjarë. Edhe pse është rritur numri i taksapaguesve familjar në vitin 2024, kjo nuk është e plotë, pasi nuk ka evidentime konkrete për pjesën që nuk përfshihet në UK Durrës.
*Në paketën fiskale është parashikuar një gjë e tillë, por nuk janë marrë masa konkrete. Në paketë citohet: "Për ato familje që nuk janë regjistruar në faturat e ujësjellësit fatura do të llogaritet totale dhe do të paguhet në dy këste: kësti i parë deri më datë 20 prill të vitit korrent dhe kësti i dytë më datë 20 korrik të vitit korrent".*
Për këta taksapagues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, duhet të ndiqeshin procedurat ligjore për njoftimin dhe arkëtimin e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me paketën fiskale.
Rakordimet për të ardhurat nga taksat e familjarëve bëhen për të rakorduar shumën totale që UKD ka për detyrë të transferojë te Bashkia, por nuk ka rakordime mbi bazën e detyrimeve që duhet të paguajnë familjarët për llogari të muajit të caktuar të vitit buxhetor, pra sa ishte detyrimi i muajit sipas paketës fiskale, sa është paguar dhe sa ngelen debitor, në numër abonentësh dhe në vlerë. Nuk njihet situata e debitorëve familjar pasi për të gjithë periudhën e audituar nuk janë

hartuar evidenca për këtë qëllim dhe nuk i është kërkuar UKD të jap raporte të tilla, në cilësinë e agjentit tatimor.
Sa më sipër nuk është zbatuar kontrata nr. 641 prot. datë 03.02.2014, neni 5 pika 4,5,6...., ku cilësohet .....*"agjenti tatimor bën rakordimet përkatëse mbi të ardhurat e arkëtuara brenda datës 10 të çdo muaji duke derdhur në buxhetin e bashkisë shumën përkatëse të të ardhurave të realizuara për kategorinë familje",* dhe neni 7 pika 1, ku cilësohet *"përbën shkelje për agjentin, pika a. mos pasqyrimi në faturat mujore dhe mosmbajtja në burim e TTP dhe mostransferimi në Bashkinë Durrës, në mënyrë korrekte dhe në afatin e përcaktuar",* pika b. "*Mosmbajtja e regjistrimeve për të ardhurat e paguara nga tatimpaguesi duke saktësuar në mënyrë të rregullt çdo kategori dhe nivel takse me të ardhurat përkatëse",* pika c. "*Mosdhënia e informacionit Bashkisë së Durrësit për kontrollin e saktësisë së llogaritjeve për pagesat e tatimpaguesve".*
Sa më sipër nga Bashkia Durrës duhet të zbatoheshin penalitete bazuar në nenin 7, pika 2 të marrëveshjes, ku cilësohet: *"shkeljet e mësipërme përbëjnë kundërvajtje administrative ndaj të cilave vendosen gjoba në mbështetje të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar"*. Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 4, pika 7; Kontrata nr. 641 prot. datë 03.02.2014, neni 5 pika 4,5,6, neni 7 pika 1 dhe 2; Rregullore brendshme e institucionit.

- **<u>Problematika me funksionimin e sistemit:</u>**

Gjatë periudhës 2023-2024, ka pasur problematika me ndërfaqen e sistemit. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore sëbashku me sektorin e regjistrimit të të ardhurave kanë akses në sistem, për rakordimin e arkëtimeve nga abonentët familjarë pagesat të cilat kryhen nëpërmjet faturës së ujit nga abonentë familjarë.
Faturimi i taksës së popullatës nga UKD ka filluar në muajin Maj 2023 dhe ka përfunduar në muaj Prill 2024. Në muajin maj 2023 ndërfaqja ka funksionuar ndërsa për 2 (dy) muajt qershor dhe Korrik 2023 për shkak të mosfunksionimit të sistemit nuk është faturuar asnjë abonent.
Referuar informacionit të marrë nga z. R.I me pozicion specialist tek sektori i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ngarkesa për këto 2 muaj është kryer në muajt mars dhe prill 2024. Gjithashtu për shkak të mosfunksionimit të sistemit ka pasur problematikë në faturimin e muajt gusht 2023 për shkak sepse nuk është faturuar 1/12 e vlerës vjetore nga UKD por 1/12 e vlerës së mbetur nga pagesa e muajt maj 2023.
Për vitin 2024 sistemi nuk ka funksionuar dhe faturimi i taksave dhe tarifave vendore për abonentë familjarë ka filluar në muajin tetor 2024 deri në muaj prill 2025.
**Në aneksin nr. 2.2.6.3** në anekset e projekt raportit të auditimit janë paraqitur të ardhurat në sistem dhe pagesat e kryera nga UKD në drejtim të Bashkisë Durrës.
**Në aneksin nr. 2.2.6.4** dhe **nr. 2.2.6.5** në anekset e projekt raportit të auditimit janë paraqitur rakordimet midis UKD dhe Bashkisë Durrës për të ardhurat e vitit 2023-2024 sipas muajve dhe llojit të taksave/tarifave vendore.
**Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi personat si më poshtë:** *z. L.D., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 01.01.2023-21.01.2024, z. R.Sh., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 21.01.2024-31.12.2024, Përgjegjësi i Sektorit të të Ardhurave znj. N.S., Specialisti i Sektorit të Informatikës z. F.M., Specialist i të ardhurave z. R.I..*

Në paketën Fiskale të vitit 2023 dhe 2024 të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Durrës dhe Njësitë Administrative, ndahen në 2 kategori si më poshtë:
- Biznes
- Familjar

Kategoritë e mësipërme ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:
- Biznes i Madh; Biznes i Vogël; Tregtarët Ambulant.

- Familje që kanë në pronësi/përdorim banesa private, toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Nga auditimi i evidencave mbi planifikimin dhe realizimin vjetor të të ardhurave, paketës fiskale të miratuar dhe taksave e tarifave vendore që administron sistemi i DTTV u konstatua se:

Në sistemin e DTTV rezultojnë mungesa sipas kategorizimeve për nënkategoritë e taksave/ tarifave dhe përjashtimet nga detyrimi për tu krahasuar me paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Durrës.

Burimi i të dhënave sa i përket kategorisë biznes për llojin e aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj. në sistemin e DTTV nuk është i plotë dhe i shoqëruar me dokumentacion shoqërues (sipas kërkesave në formularët për aplikim të miratuar nga bashkia Durrës).

Planifikimi për Taksa dhe Tarifa vendore të cilat janë burimi kryesor në realizimin e të ardhurave të veta nuk është kryer bazuar në numrin e subjekteve sipas sistemit, analizën e rezultatit historik, pritshmërive të vitit korrent dhe koordinimit midis drejtorive që mbulojnë realizimin e tyre.

Në paketën e fiskale të Bashkisë Durrës nuk identifikohen taksa dhe tarifa vendore të përcaktuara për pajisjet automatike të cilat krijon aktivitet dhe gjenerojnë të ardhura si: ATM, pajisje elektronike, lojëra për fëmije, ekranet dixhital të reklamimit, karrikues për mjetet lëvizëse (që janë të vendosura në hapësira publike apo biznes privat, pranë institucioneve të ndryshme etj.) edhe pse janë të identifikueshme nuk janë të përfshira në taksat dhe tarifat vendore.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 "*Për regjistrimin e biznesit*", Neni 2 pika 13: *"Subjekt" është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, që ka cilësinë e tregtarit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, shoqëritë tregtare dhe degët e shoqërive të huaja*, Neni 2 pika 16. *"Veprimtari" është veprimtaria e pavarur ekonomike, profesionale apo tregtare, e ushtruar në mënyrë të vazhdueshme nga subjektet;* Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 4, pika 7; Udhëzimi nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3, pika 4.

- *<u>Për kategorinë e taksapaguesve Biznes</u>***.**

Për vitin 2023 *(sipas informacionit të marrë nga evidencat e vëna në dispocion të grupit të auditimit nga DTTV),* në Bashkinë Durrës kanë zhvilluar aktivitet 13,535 subjekte. Janë hapur biznese të reja 1,532 subjekte dhe kanë mbyllur aktivitetin 2,097 subjekte. Për vitin 2024 kanë zhvilluar aktivitet 13,535 subjekte. Janë hapur të reja 2,511 subjekte dhe kanë mbyllur aktivitetin 2,298 subjekte, sipas tabelës nr.7.

**<u>Tabela nr. 4:</u>** Të dhënat për numrin e subjekteve aktiv dhe mbyllur sipas kategorive

| Nr. | Lloji Biznesit | Viti | Gjendje ne fillim | Regjistrime te reja | Mbyllur aktivitet | Gjendja ne fund |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Biznesi Vogël | 2023 | 10,231 | 1,262 | 1,893 | 9,600 |
| | | 2024 | 9,600 | 2,043 | 1,111 | 10,532 |
| 2 | Biznesi Madh | 2023 | 3,869 | 270 | 204 | 3,935 |
| | | 2024 | 3,935 | 468 | 1,187 | 3,216 |
| **(1+2)** | **Gjithsej** | **2023** | **14,100** | **1,532** | **2,097** | **13,535** |
| | | **2024** | **13,535** | **2,511** | **2,298** | **13,748** |

***Burimi të dhënave:*** *Bashkia Durrës.*

DTTV raportimin në evidenca zyrtare dhe pasqyra fI.nciare e bën nëpërmjet informacionit të përpunuar nga specialistët e sektorit mbi raportet që ofron sistemi. Sistemi i DTTV jep informacion në raportet që gjeneron vetëm për subjektet që kanë të përcaktuar kategorinë në fushën përkatëse.

Procesi i përpunimit të informacionit nga raportet që gjeneron sistemi në formatin Excel nuk kalon në faza monitorimi. Për subjektet pa kategori planifikimi i taksave e tarifave vendore nuk është i saktë. Bazuar në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni "5" "*rregulla të përbashkëta për taksat vendore*" cilësohet *.....bashkia nëpërmjet këshillit bashkiak:*

*a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;*
*b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori e nënkategori të bazës së taksës.*
Në kushtet kur nuk është përcaktuar kategoria nuk ka gjurmë auditimi për të bërë vlerësimin e saktësisë së përllogaritjes së detyrimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", neni "5"; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "*Për Arkivat*", dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

- *Auditimit i ngarkesës me taksa dhe tarifa vjetore të subjekteve në sistemin e DTTV .*

Sipas informacionit identifikues në sistemin e DTTV rezulton se në Bashkinë Durrës për kategorinë biznes deri më datë 31.12.2024 janë 13,748 subjekte me statusin aktiv. Taksat dhe tarifat vendore që administron ky sistem paraqiten si më poshtë:
*Taksa mbi Ndërtesën Biznes, Taksa Truallit, Taksa Tabelës, Taksa e Reklamës, Taksa Fjetjes në Hotel, Taksa Përkohshme Infrastrukturës Arsimore, Tarifë Pastrimi Biznes, Tarifë Ndriçimi, Tarifë Gj., Tarifë Parkimi, Tarifa plazh privat*.
Gjatë vitit 2023 është kryer kalimi i të dhënave nga sistemi "O.E-B.S.11", në sistemin "O.E-B.R12". Referuar specifikimeve teknike në pikën 13.2 "*Migrimi i të dhënave"* është përcaktuar së OE do të duhet të realizojë migrimin e balancave e të gjithë të dhënave historike të sistemit informatik. *Sipas informacionit të mëposhtëm në tabelën nr.8 sipas të dhënave të nxjerra nga sistemi i taksave dhe tarifave vendore verifikohet së nuk janë migruar të dhënat për faturimin e bizneseve në Bashkinë Durrës. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nuk mund të arrihet në konkluzion sa biznese janë faturuar gjatë vitit 2023.*
Më poshtë paraqiten të dhënat e krahasuara lidhur me planifikimet dhe realizimin për taksat dhe tarifat vendore që administrohen nga Sistemi DTTV.
**Tabela nr. 5:** Të dhënat për numrin e subjekteve aktiv dhe mbyllur sipas kategorive

*000 lekë*

| Lloji i Taksës | Viti | Faturimi | | Nr. i Bizneseve aktiv në sistem | Diferenca regjistër me sistemin | Vlera e arkëtuar (sistem) | Vlera e zbritur (sistem) | Vlerë e mbetur (sistem) | Sipas rakordimit me thesarin |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr. | Vlerë | | | | | | |
| Taksë ndërtesë | 2023 | 3,213 | 96,175 | 13,535 | 10,322 | 43,739 | 7,941 | 44,494 | 232,953 |
| Tarifë Pastrimi | 2023 | 3,918 | 58,892 | 13,535 | 9,617 | 29,634 | 1,880 | 27,377 | 169,549 |
| Tarifë ndriçimi | 2023 | 3,856 | 10,600 | 13,535 | 9,679 | 5,534 | 242 | 4,821 | 33,454 |
| Tarifë Gj. | 2023 | 3,782 | 12,279 | 13,535 | 9,753 | 690 | 6,332 | 5,256 | 35,172 |
| Taksë Tabele | 2023 | 55 | 6,416 | - | | 4,118 | 808 | 1,489 | 18,469 |

***Burimi i të dhënave:*** *Përpunoi Grupi i Auditimit*

Më poshtë paraqiten të dhënat e krahasuara lidhur me planifikimet dhe realizimin për taksat dhe tarifat vendore që administrohen nga sistemi DTTV.
**Tabela nr. 6:** Të dhënat për numrin e subjekteve aktiv dhe mbyllur sipas kategorive

*000 lekë*

| Lloji i Taksës | Viti | Faturimi | | Nr. i Bizneseve aktiv në sistem | Diferenca regjistër me sistemin | Vlera e arkëtuar (sistem) | Vlera e zbritur (sistem) | Vlerë e mbetur (sistem) | Sipas rakordimit me thesarin |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr. | Vlerë | | | | | | |
| Taksë ndërtesë | 2024 | 9,385 | 286,680,731 | 13,748 | 4,363 | 221,429,992 | 13,000,265 | 52,378,474 | 312,730,000 |
| Tarifë Pastrimi | 2024 | 11,535 | 187,847,887 | 13,748 | 2,213 | 157,685,767 | 2,816,487 | 27,345,633 | 222,763,000 |
| Tarifë ndriçimi | 2024 | 11,470 | 36,151,421 | 13,748 | 2,278 | 30,838,086 | 442,720 | 4,870,615 | 41,692,000 |
| Tarifë Gj. | 2024 | 11,397 | 38,682,211 | 13,748 | 2,351 | 32,765,130 | 570,942 | 5,346,139 | 45,632,000 |
| Taksë Tabele | 2024 | 213 | 26,615,389 | - | | 22,788,868 | 1,787,150 | 2,039,371 | 27,232,000 |

***Burimi i të dhënave:*** *Përpunoi Grupi i Auditimit*

Sipas evidencave të vëna në dispozion DTTV numri total i subjekteve që zhvillojnë aktivitet për vitin 2024 është 13,748 subjekte.
DTTV në planifikimin taksave dhe tarifave vendore nuk i ngarkon detyrim secilit prej subjekteve për të gjitha taksat dhe tarifat e miratuara por vetëm për një pjese të tyre sipas tabelës së mësipërme.
Nga intervistat me stafin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore Durrës u pohua se

ngarkesave sipas taksave dhe tarifave vendore e përcaktuar me VKB çdo vit nuk ngarkohet automatikisht në sistem çdo fillim viti sipas të dhënave që ka të regjistruara çdo subjekt por ngarkesa bëhet manualisht.
-Referuar të dhënave të mësipërme për vitin 2024 për taksën e ndërtesës nga 13,748 subjekte të regjistruara vetëm për 9,385 subjekte është kryer ngarkesa për këtë taksë. Pa ngarkesë për taksë e ndërtesës janë 4,363 subjekte në kundërshtim me VKB nr.194, datë 22.12.2023 "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2024".*
-Për tarifën e pastrimit referuar të dhënave në tabelën e mësipërme nuk janë ngarkuar për këtë tarifë 2,213 subjekte në Bashkinë Durrës.
-Për tarifën e ndriçimit referuar të dhënave në tabelën ë mësipërme nuk janë ngarkuar për këtë tarifë 2,278 subjekte në Bashkinë Durrës.
-Për tarifën e Gj.t referuar të dhënave në tabelën ë mësipërme nuk janë ngarkuar për këtë tarifë 2,351 subjekte në Bashkinë Durrës.

Nga krahasimi i të dhënave sipas tabelës më sipër për taksën e ndërtesës për biznesin rezulton se:
Plani të ardhurave për vitin 2024 sipas evidencës është 285,000,000 lekë, ndërsa plani sipas sistemit të DTTV është 286,680,731 lekë (diferenca 1,680,731 lekë ).
Realizimi sipas evidencës për vitin 2024 është 312,730,000 lekë, ndërsa realizimi sipas sistemit të DTTV është 221,429,992 lekë (diferenca 91,300,008 lekë ).
Ka diferenca në llogaritjen, planifikimin dhe arkëtimin e taksave e tarifave vendore.
Nuk ndahen të ardhurat që paguhen për llogari të vitit buxhetor aktual, nga të ardhurat të cilat paguhen me vonesë, për llogari të viteve të mëparshëm. Sipas paketës fiskale vjetore, të ardhurat duhet të mbahen të ndara, veç ato të cilat realizohen si rezultat i zbatimit të paketës fiskale dhe veç pagesat për detyrimet e prapambetura. Mos ndarja bën që edhe realizimi faktik sipas paketës fiskale të jetë më i vogël nga sa paraqesin shifrat e realizimit për secilin vit buxhetor.
Edhe fakti që realizimi i disa të ardhurave kalon vlerën 100%, shpjegohet me mos ndarjen e pagesave për llogari të vitit buxhetor, nga ato për llogari të detyrimeve të prapambetura.

*Praktika për Përcaktimin e statusit mbyllur, pezulluar, pasiv në sistemin e DTTV bëhet si më poshtë:*

A. Me kërkesën vullnetare për çregjistrim pranë QKB;
B. Nga ndjekja rutinë e DTTV për statusin e subjekteve në Drejtorinë Rajonale Tatimore;
C. Nga ndjekja rutinë e DTTV për statusin e subjekteve në Regjistrin Elektronik Online të QKB;

**A**. **Me kërkesën vullnetare për çregjistrim pranë QKB**
Subjekti aplikon për çregjistrim në QKB dhe kjo e fundit njofton DTTV me shkrim për të evidentuar gjendjen debitor të subjektit para çregjistrimit brenda afatit ligjor. (*Në rast të mungesës së një konfirmimi nga DTTV, QKB proceson me çregjistrimin automatik*). DTTV regjistron në protokollin e brendshëm praktikën dhe drejtori i DTTV e nis praktikën për ndjekje nga Sektorët hapat janë si më poshtë:
1. Sektorit të Kontrollit në terren i cili mban akt konstatim me të cilin përcakton nëse ky subjekt ushtron aktivitet ose jo.
2. Sektori regjistrimit pas paraqitjes së akt konstatimit nga sektori terrenit përcakton vlerën debitorë.
3. DTTV njofton QKB nëse ky subjekt ka ose jo detyrime. (*Nëse rezulton debitor nga sektori regjistrimi dhe nëse nuk ushtron aktivitet bën kërkesë për bllokimin debie në vlerën e detyrimit të subjektit*)
4. Sektori i borxhit në rastet me detyrim përpunon në format Excel (regj. i borxhit) informacionin e përfituar në formatin PDF nga sistemi dhe përgatit:
a. Evidencën për kontabilizim që i paraqitet Drejtorisë Ekonomike, Sektorit të Financës.

b. Listat për njoftim Bllokimi në Bankat e nivelit të dytë.

**B. Nga ndjekja rutinë e DTTV për statusin e subjekteve në Drejtorinë Rajonale Tatimore**

Kur DTTV konstaton se subjekti ka kaluar me status pasiv në DRT, nis praktikën për ndjekje nga Sektorët, hapat janë si më poshtë:

1. Sektorit të kontrollit në terren i cili mban akt konstatim në të cilin përcakton nëse ky subjekt ushtron aktivitet ose jo,
2. Sektori regjistrimit pas paraqitjes se akt konstatimit nga sektori terrenit përcakton vlerën debitorë nëse ka,
3. DTTV nëse subjekti rezulton pasiv në DRT dhe nëse nuk ushtron aktivitet sipas akt konstatimit nga terreni bën ndryshimin e statusit në sistem nga aktiv në pasiv duke ndaluar faturimin për këtë subjekt,
4. Sektori i borxhit (ndjek të njëjtën praktikë si në rastin e paraqitur në pikën A).

*C. Nga ndjekja rutinë e DTTV për statusin e subjekteve në Regjistrin Elektronik Online të QKB dhe korrespodenca me institucionin***.**

**DTTV** kur konstaton se subjekti ka ndryshuar status në QKB**,** nis praktikën për ndjekje nga Sektorët, hapat janë si më poshtë**:**

DTTV sipas statusit që rezulton në Regjistrin elektronik online të QKB (Aktiv, pezulluar, çregjistruar) dhe nëse nuk/ ushtron aktivitet sipas akt konstatimit nga terreni bën ndryshimin e statusit në sistemin e DTTV.

**a.** Për rastet kur nga Akt Konstatimi rezulton se nuk ushtron aktivitet dhe në Regjistrin Elektronik Online të QKB është Aktiv, pavarësisht gjendjes debitorë, *DTTV vendos statusin mbyllur në sistem dhe ndërpret ngarkesën me detyrime për taksa dhe tarifa vendore për këtë subjekt në vazhdim. Vendosja e statusit mbyllur nuk e shfaq më këtë subjekt në raportin e detyrimeve vjetore që gjeneron sistemi*.

**b.** Për rastin kur nga akt konstatimi nga terreni rezulton me aktivitet DTTV bën përllogaritjen e detyrimit që nga momenti kur ka filluar të ushtrojë aktivitet dhe gjeneron faturën për njoftim në sistemin e DTTV.

Sektori i borxhit në rastet me detyrim përpunon në format Excel (regj i borxhit) informacionin e përfituar në formatin PDF nga sistemi dhe përgatit:

**a.** Evidencën për kontabilizim që i paraqitet Drejtorisë Ekonomike, Sektorit të Financës (*Vendosja e statusit mbyllur sipas hapit 3 nuk e shfaq më këtë subjekt në raportin e detyrimeve vjetore që jep sistemi)*

**b.** Listat për njoftim Bllokimi në Bankat e nivelit të dytë.

- *Korrespodenca me institucionet***.**

DTTV në kuadrin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacioneve me institucione të ndryshme jashtë bashkisë, ka kërkuar dhe njëkohësisht ka dhënë informacione në funksion të realizimit të detyrave dhe objektivave për të ardhurat vendore. DTTV ka mbajtur korrespodencë me institucione të ndryshme si QKB, ASHK, Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës, Banka të nivelit të dytë dhe institucione të tjera shtetërore.

- *Evidentimi i problematikave të procesit të çregjistrimit dhe pezullimit:*

Shkresat me objekt: "Kthim përgjigje" institucionit të QKB, e cila me shkresë zyrtare kërkon informacion periodik për subjektet të cilët aplikojnë për pezullim ose mbyllje, u konstatua se:

Nga verifikimi me zgjedhje i shkresave në ***9 (nëntë) raste*** shkresat kanë kaluar afatin kohor ligjor të dërgimit kthimit të përgjigjeve të cilat janë paraqitur në **aneksin nr.2/6/6** në anekset e projekt raportit të auditimit.

Për 10 (dhjetë) raste shkresat kanë kaluar afatin kohor ligjor të dërgimit kthimit të përgjigjeve dhe nga e QKB është vazhduar me pezullimin e aktivitetit të subjekteve me detyrim në vlerën 2,101,470 lekë.

**Tabela Nr.7:** Kërkesat nga subjektet për pezullim

| Nipti | Lloji Aktivitetit | Data e Mbylljes | Det. Pashlyer | Akt-verifikimi nr./date | Grupi I kontrollit | Statusi në QKB |
|---|---|---|---|---|---|---|
| "L1" | Import-Eksport | 04.05.2023 | 342,950 | | | Pezulluar |
| "L2" | Bar Kafe, Piceri | 06.02.2023 | 197,030 | Pv198/1dt 17.04.2023 | A.D.A.B.. | Pezulluar |
| "L3" | avokat | 24.04.2023 | 124,520 | pv 422/5 dt30.06.2023 | A.H.,E.Gj.,G.D. | Pezulluar |
| "K4" | Shërbime | 17.10.2023 | 49,500 | PV1802/1dt07.05.2024 | A.D., A.B. | Pezulluar |
| "K5" | tregti karburanti | 01.04.2023 | 28,823 | Pv376/3dt29.05.2023 | A.D., A.B. | Pezulluar |
| "L1" | Sek. Prodhimit | 04.05.2023 | 491,400 | Pv450/3dt31.05.2023 | A.D., A.B.. | Pezulluar |
| "L6" | Bar Kafe | 31.07.2023 | 452,732 | Pv650/2 Dt02.10.2023 | A.D., A.B., A.J. | Pezulluar |
| "L7" | Shërbime | 08.09.2023 | 261,420 | Pv737/2dt20.10.2023 | A.D., A.B., A.J. | Pezulluar |
| "M8" | Bar Bufe | 18.01.2023 | 76,020 | Pv304/1dt 30.03.2023 | J.H., A.L., | Pezulluar |
| "L9" | Transport | 28.08.2023 | 54,900 | Pv3678/1dt20.11.2023 | A.H, E. Gj., G.D. | Pezulluar |
| "M10" | Tregti indus | 04.03.2023 | 22,175 | Pv 638/1dt 17.03.2023 | J.H.,, A.L. | Pezulluar |

***Burimi:*** *Përpunoi Grupi i Auditimit*

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar*" neni 1, neni 2 germat a, ç, neni 5 germat a, d, dh, f, g, gj, h, i, neni 6 pikat 1, 2, 3, neni 12 germat a, b, dh..., neni 13 germa b, neni 15, neni 23 pika 1, 4, neni 26, neni 27,neni 28 pika 1, neni 29, neni 31, neni 40, neni 41, neni42, neni 43 pika1, 2, 3, neni 44, neni 45, neni 47 , neni 48 pika 1, neni 57 pikat 4, 5, nenet 60, 61, 62, neni 65 pika 5, nenet 68, 69 , neni 70 pika 2, neni 71/1 pika 5 ; Ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 "*Për regjistrimin e biznesit*" i ndryshuar, nenet 28 –40, neni 42, neni 43 germa d, neni 59.

- *Zbritja e Detyrimit tatimor referuar sistemit të tatim-taksave***:**

Referuar raportit përmbledhës gjeneruar nga sistemi i Tatim Taksave në Bashkinë Durrës grupi i auditimit ka përzgjedhur 13 raste me zbritje tatimore në sistem të cilat janë përzgjedhur në bazë të analizës së riskut. Rastet e përzgjedhura dhe analizimi i tyre sipas dokumentacionit është paraqitur në **aneksin nr.2/6/6** në anekset e projekt raportit të auditimit

- *Referuar analizës së rasteve mëposhtë do të paraqesim informacioni për rastet të cilat janë konstatuar problematika***.**

**1-** Shoqëria "R.", për ndërtesën e dhënë më qira për shoqërinë "T" nuk është ngarkuar me detyrim për taksë ndërtesë 500m$^2$ (141.75 lek/m$^2$ vit).

**2-**Shoqërisë "E", i është zbritur në sistem taksa e ndërtesë në vlerën 96,775 lekë dhe i është ngarkuar taksa në shumën 38,678 lekë më arsye sepse 860m$^2$ nga 1433m$^2$ do t'i ngarkohen shoqërisë "B" sh.p.k

Referuar veprimit të mësipër është kryer ngarkesa për subjektin e mësipërm në vlerën 58,097 lekë.

Nga auditimi i veprimit në sistem nuk disponohet me dokumentacion fizik veprimet e mësipërm nuk janë të justifikuara me kërkesë më shkrim nga vetë subjektet, nuk janë mbajtur akt konstatime nga inspektorët dhe nuk disponohet kontrata e qirasë.

**3-**Shoqëria "D" sh.p.k me nipt "L11" i është zbritur taksa e tabelës nga vlera 787,500 lekë në vlerën 225,000 lekë. Veprimi i mësipër nuk mbështetet më dokumentacion justifikues.

**4-** Shoqëria "A" me NIPT "L12" ka paraqitur kërkesë më datë 18.04.2024 për sistemimin e taksës së ndërtesë. Në sistem për vitin 2024 është ngarkuar vlera 483,773 lekë për taksë ndërtesë dhe kjo vlerë është korrigjuar më vlerën 158,625 lekë. Taksa e truallit është ngarkuar për vlerën 48,820 lekë kjo taksë është zëruar në sistem dhe nuk është ngarkuar më për vitin 2024.

Sipas dokumentacionit të pronësisë sipërfaqe e truallit është 4342 m$^2$ dhe sipërfaqe ndërtese 1901 m$^2$. Subjekti për taksën e truallit duhej të ngarkohej për vlerën (2441 m$^2$ *20 lek/m$^2$=48,820 lek) dhe për taksën e ndërtesë (1901m$^2$ * 67.2lek/m$^2$= 127,747 lekë).

- *Debitorët biznes dhe masat e marra për vjeljen e detyrimeve***:**

Sipas informacionit identifikues në sistemin e DTTV rezulton se, në Bashkinë Durrës për kategorinë biznes deri më datë 31.12.2024 janë 13,748 subjekte me statusin aktiv. Taksat dhe tarifat vendore që administron ky sistem paraqiten si më poshtë:

*Taksa mbi Ndërtesën Biznes, Taksa Truallit, Taksa Tabelës, Taksa e Reklamës, Taksa Fjetjes në Hotel, Taksa Përkohshme Infrastrukturës Arsimore, Tarifë Pastrimi Biznes, Tarifë Ndriçimi, Tarifë Gj., Tarifë Parkimi, Tarifa plazh privat*.
Gjatë vitit 2023 është kryer kalimi i të dhënave nga sistemi "O.E-B.S11" në sistemin "O.E-B.S.R12". Referuar specifikimeve teknike në pikën 13.2 *"Migrimi i të dhënave"* është përcaktuar së OE do të duhet të realizojë migrimin e balancave e të gjithë të dhënave historike të sistemit informatik.
Për debitorët abonentët biznes nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponohet shkresë përcjellëse në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e këtyre debitorëve. Nga sistemi nuk mund të gjenerohet një liste e debitorëve me datë detyrimi deri në datë 31.12.2024.
Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore detyrimi në datën 31.12.2024 është në vlerën 1,859,326,997 lekë. Në datën 11.04.2025 sipas informacionit të përcjell me email nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore detyrimi për abonentë biznes deri në datën 31.12.2024 është në vlerën 1,951,318,745 lekë, kjo diferencë kaq e lartë vjen për shkak sepse në sistem detyrimi nuk gjenerohet sipas datës që kërkohen të dhënat por në këtë detyrim përfshihen kamatëvonesat që i përkasin detyrimit të mëparshëm dhe rivlerësime detyrimesh.

*Grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion të saktë dhe të qenësishëm për situatën e menaxhimit, identifikimit, regjistrimit dhe vjeljes së të ardhurave në DTTV Durrës për debinë totale pasi ka pasaktësi në detyrimin total për sa më sipër.

- *Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa për periudhën 01/01/2023 – 31/12/2024***.**

Nga informacioni i përcjell nga Sektori i Borxhit, rezulton se gjendja e debitorëve në fund të periudhës 31/12/2024 paraqitet në vlerën 1,859,326,997 lekë, sipas të dhënave të pasqyrës si vijon:

**Tabela Nr. 8:** Informacion për debitorët nga Sektori i Borxhit

| Emërtimi | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|
| | Vlera | Vlera | Vlera |
| **Debitorë ne total** | **1,593,055,464** | **1,718,399,005** | **1,859,326,997** |
| Biznesi i madh | 790,800,930 | 870,081,475 | 964,575,373 |
| Biznesi i vogël | 802,254,534 | 848,317,530 | 894,751,624 |

***Burimi:*** *Përpunoi Grupi i Auditimit*

Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se niveli i borxhit nga një periudhë në tjetër vjen në rritje për detyrimet e taksave e tarifave vendore, kështu nga viti 2023 në vitin 2024 ky nivel është rritur për vlerën 140,927,992 lekë.

- *Historiku i lëvizjes së debitorëve*.

Sipas të dhënave të paraqitur nga sektori i borxhit dhe përpunimi i tyre, konstatohet se krahasuar me vitet e mëparshme gjendja në fund të çdo viti e vlerës së debisë, paraqitet si më poshtë:

**Tabela Nr.9:** Lëvizja e debitorëve gjatë viteve

| Debia sipas viteve | Nr. subjekteve | Vlera | % rritjes se vlerës se debisë | Rritja e vlerës se debisë ne lek |
|---|---|---|---|---|
| Debia deri 31.12.2019 | 8486 | 1,277,145,907 | 9.90% | 115,091,921 |
| Debia deri 31.12.2020 | 9303 | 1,407,880,645 | 10.23% | 130,734,738 |
| Debia deri 31.12.2021 | 9862 | 1,540,596,911 | 9.42% | 132,716,266 |
| Debia deri 31.12.2022 | 10449 | 1,679,002,015 | 8.98% | 138,405,104 |
| Debia deri 31.12.2023 | 11087 | 1,807,153,779 | 7.63% | 128,151,764 |
| Debia deri 31.12.2024 | 12036 | 1,951,318,745 | 7.97% | 144,164,966 |

***Burimi:*** *Bashkia Durrës*

- *Masat e marra nga DAV Bashkia Durrës për arkëtimin e debitorëve*.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga DAV Bashkia Durrës për vitet 2023-2024, rezulton se nga kjo administratë (Sektori i borxhit), janë ndërmarrë këto hapa për vjeljen e debitorëve, konkretisht pasqyra:

**Tabela Nr.10:** Masat e marra nga DAV për arkëtimin e debitorëve

| Debitor | Nr./Debi | Vl. Debie | Njoftim për pagesë | Bllok bankë | Ekz nr. Llog | Njoftim vendosje barre sigurie | Vendosje barre siguri QKB |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2023 | 11,087 | 1,807,153,779 | 11,087 | 2,852 | - | - | - |
| 2024 | 12,036 | 1,951,318,745 | 12,943 | 12,943 | - | - | - |

**Burimi:** Bashkia Durrës

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se nga Sektori i Borxhit nuk janë marrë masat referuar ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" kreu IX Mbledhja me forcë e detyrimeve, nenet 88-101* dhe Udhëzimin nr. 17 datë 20.06.2022 *"Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve proceduriale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore".*

Duke vlerësuar riskun e praktikave të menaxhimit të borxhit u përzgjodhën disa raste për auditimin e procedurave që janë kryer, për ndjekjen dhe procedurat e arkëtimit të borxhit në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për Procedurat Tatimore në RSH"*, me ndryshime, nga ku rezultoi se:

- Për Institucionet shtetërore, të identifikuar si debitorë është ndjekur vetëm procedura e nxjerrjes së Njoftimit për Pagesë të Detyrimeve Tatimore dhe nuk është vazhduar me asnjë procedurë tjetër.
- Nuk gjen zbatim ndryshimi ligjor i nenit 89 i ligjit të procedurave tatimore, ku thuhet se; "*Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume **jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar**, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit*".
- Nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181 "Mos pagimi i taksave dhe tatimeve", të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 9 pika1.3, neni 35, me ligjin nr. Ligj nr. 68/2017 "Për fI.ncat e vetëqeverisjes vendore" ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "Për sistemin e taksave vendore", për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: *z. L.D., Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore (periudha 01.01.2023- 24.01.2024), z. R.Sh. Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore (periudha 24.01.2024-31.12.2024), dhe z. L.B., Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit të taksave dhe tarifave vendore*.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga Bashkia Durrës është paraqitur observacioni me shkresën nr. 668/88 prot, datë 17.6.2026, administruar në KLSH me praktikën nr. 1347/71 prot., datë 18.06.2026, nga *Drejtoria e Tatim Taksave Vendore*, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

Në përgjigje të konstatimeve të evidentuara në projekt Raportin e KLSH-së, si dhe shkresën me rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Durrës, mbërritur me nr.1347/68 prot., datë 15.05.2026 dhe protokolluar në Bashkinë Durrës me nr.668/74 prot., datë 18.05.2026 , lidhur me nivelin e detyrimeve të papaguara të subjekteve tatimpaguese ndaj Bashkisë Durrës, (faqja 33-36) , ju bëjmë me dije se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka ndërmarrë dhe vijon të zbatojë masa të vazhdueshme administrative, ligjore dhe ekzekutive me qëllim arkëtimin e detyrimeve debitorë dhe uljen progresive të stokut të borxhit.
Masat e ndërmarra janë mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore në fuqi që rregullojnë

procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore nga njësitë e vetëqeverisjes. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nëpërmjet sektorit të borxhit, ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme procesin e evidentimit, monitorimit dhe ndjekjes administrative të debitorëve, duke realizuar:

- Evidentimin mujor dhe vjetor të stokut të borxhit;
- Dërgimin e njoftimeve për pagesë ndaj subjekteve debitore;
- Vendosjen e masave të bllokimit bankar;
- Procedurat e ekzekutimit të shumave në llogaritë bankare;
- Procedurat për vendosjen e barrës siguruese në ASHK dhe DPSHTRR;
- Ndjekjen e subjekteve që nuk kanë respektuar marrëveshjet me këste;
- Bashkëpunimin me administratën tatimore, bankat dhe strukturat e tjera administrative;
- Evidentimin dhe administrimin e rasteve që përfitojnë nga skemat e faljes së detyrimeve dhe kamatvonesave.

**Masat e ndërmarra gjatë vitit 2025:**

| Nr | Procedura / Veprimi | Nr. Prot / Data | Subjekte | Vlera |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Borxh për kontabilizim 2011–2023 dhe debitorët 2024 | Evidentim dhe regjistrim i stokut historik të borxhit tatimor për periudhat e mëparshme dhe vitin aktual për përfshirje në ndjekje administrative | Nr. 696 dhe 697, 16.01.2025 | Debitorë 2011–2024 |
| 2 | Urdhër bllokim bankar | Vendosje masash bllokuese në llogari bankare për subjekte debitore individuale | Nr. 6157, 22.05.2025 | 4 subjekte |
| 3 | Urdhër bllokim bankar masiv | Aplikim i bllokimeve bankare në shkallë të gjerë për debitorë të shumtë | Nr. 6375, 27.05.2025 | 11,365 subjekte |
| 4 | Urdhër individual Banka Raiffeisen | Njoftime dhe bllokime të drejtpërdrejta në bankën Raiffeisen për subjekte specifike | Nr. 15704, 11.06.2025 | 791 subjekte |
| 5 | Bllokim për mosrespektim kështesh (subjekte të cilët kanë lidhur marrëveshje me këste) | Masa ndaj subjekteve që nuk kanë respektuar marrëveshjet me këste | Nr. 10126, 25.08.2025 | 23 subjekte |
| 6 | Bllokim për debitorët viti fiskal 2025 | Ndjekje dhe bllokim për detyrimet e vitit aktual tatimor | Nr. 10921, 17.09.2025 | 2,384 subjekte |
| 7 | Urdhër nominal Raiffeisen | Bllokim i drejtpërdrejtë për subjekte të identifikuara individualisht | Nr. 11375/1, 02.10.2025 | 312 subjekte |
| 8 | Bllokim për mosrespektim kështesh (subjekte të cilët kanë lidhur marrëveshje me këste | Masa për subjektet që nuk kanë respektuar marrëveshjet e pagesës | Nr. 13186, 29.10.2025 | 12 subjekte |
| 9 | Ekzekutim përmes bankave | Urdhër për ekzekutim të detyrimeve direkt nga llogaritë bankare | Nr. 14355, 21.11.2025 | 11,996 subjekte |
| 10 | Masa sigurimi në QKB | Vendosje masash sigurie për pengimin e ndryshimeve në regjistrin tregtar | Nr. 14643, 02.12.2025 | 11,019 subjekte |
| 11 | Bashkëpunim me kontrollin | Koordinim me strukturat e kontrollit për verifikim dhe ndjekje debitorësh | 18.11.2025 | 3,912 subjekte |

**Masat e ndërmarra gjatë vitit 2026:**

| **Nr** | **Procedura / Veprimi** | **Nr. Prot / Data** | **Subjekte** | **Vlera** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Borxh për kontabilizim | Evidentim i stokut të ri të borxhit dhe rifreskim i të dhënave të debitorëve | Nr. 417, 12.01.2026 | 12,058 subjekte |
| 2 | Kërkesë për informacion | Ndjekje dhe verifikim i detyrimeve për masa të mëtejshme ekzekutive | Nr. 15805, 30.12.2025 | Debitorë të ndryshëm |
| 3 | Bllokim për mosrespektim kështesh | Masa ndëshkuese për moszbatim të marrëveshjeve të pagesës | Nr. 1908, 06.02.2026 | 23 subjekte |
| 4 | Njoftime për këste të papaguara | Evidentim dhe njoftim i subjekteve me detyrime të pashlyera | Nr. 1908 | 17 subjekte |
| 5 | Bllokim për marrëveshje të papaguara | Ndjekje administrative për moszbatim të detyrimeve të dakorduara | Nr. 2990, 27.02.2026 | 2 subjekte |
| 6 | Ekzekutim individual (Artur Mata) | Procedurë individuale ekzekutimi për subjekt specifik | Datë 2026 | 1 subjekt |
| 7 | Verifikim para shërbimeve | Kontroll paraprak i detyrimeve për ofrimin e shërbimeve administrative | 02.03.2026 | Të gjithë debitorët |
| 8 | Njoftime debitorët | Dërgim njoftimesh me email dhe postë për detyrime të papaguara | Janar–Mars 2026 | 9,047 subjekte |
| 9 | Bashkëpunim për debitorët e mëdhenj | Koordinim institucional për subjektet me borxh të lartë | 18.03.2026 | 375 subjekte |
| 10 | Bllokim bankar (Hysen Gashi) | Ekzekutim i drejtpërdrejtë ndaj subjektit individual | Nr. 4502, 02.04.2026 | 1 subjekt |
| 11 | Masa sigurimi ASHK/DPSHTRR | Vendosje barrash për pengimin e tjetërsimit të pasurive | Nr. 4574, 03.04.2026 | 209 subjekte |
| 12 | Qarkullim xhiroje debitore | Ndjekje për identifikim të qarkullimit financiar të subjekteve | 2026 | 18 subjekte |
| 13 | Shkresë juridike | Procedurë ligjore për detyrime të pashlyera | Nr. 4574/1, 21.04.2026 | 200 subjekte |
| 14 | Bllokim nga të tretët | Sekuestrim i detyrimeve përmes palëve të treta (bankat/institucionet) | Nr. 4968, 15.04.2026 | 18 subjekte |
| 15 | Bllokim bankar 2015–2025 | Ndjekje e stokut historik të borxhit për ekzekutim | Nr. 4969, 15.04.2026 | 8,656 subjekte |
| 16 | Bllokim individual (Hazir Gashi) | Ekzekutim i drejtpërdrejtë për subjekt specifik | Nr. 4973, 15.04.2026 | 1 subjekt |
| 17 | Bllokim individual (Dritan Kadiu) | Masa ekzekutive individuale bankare | Nr. 5232, 21.04.2026 | 1 subjekt |
| 18 | Bllokime Raiffeisen | Procedura të vazhdueshme në bankën Raiffeisen | 2026 | 550 raste |
| 19 | Bllokim marrëveshjesh | Masa ndaj marrëveshjeve të papërmbushura | Nr. 5995, 05.05.2026 | 2 subjekte |
| 20 | Bllokim individual (Petrit Baba) | Ekzekutim bankar për subjekt individual | Nr. 5724, 29.04.2026 | 1 subjekt |
| 21 | Bllokim individual (Erlinda Cyrbja) | Masa ekzekutive bankare individuale | Nr. 6551, 15.05.2026 | 1 subjekt |

Gjatë vitit 2026, Drejtoria ka vijuar në mënyrë intensive procedurat e ekzekutimit administrativ dhe bankar ndaj debitorëve, duke zgjeruar bashkëpunimin institucional me bankat e nivelit të dytë, administratën tatimore dhe strukturat e tjera shtetërore.

Gjithashtu, po evidentohen dhe administrohen rastet e subjekteve që aplikojnë për falje të kamatvonesave dhe detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi.
Në mbështetje të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Përbashkët nr. 17, Sektori i Borxhit në përbërje të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë të vazhdueshme, të organizuar dhe të koordinuar, në funksion të administrimit efektiv të detyrimeve tatimore të papaguara dhe të garantimit të zbatimit të plotë të legjislacionit fiskal në fuqi.
Në këtë kuadër, sektori ynë është i angazhuar në një proces të vazhdueshëm identifikimi, evidentimi, analizimi dhe ndjekjeje administrative të subjekteve tatimpaguese debitore, me qëllim evidentimin në kohë të detyrimeve të papaguara, vlerësimin e shkallës së riskut të mosshlyerjes dhe ndërmarrjen e masave përkatëse ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura.
Funksioni kryesor i Sektorit të Borxhit konsiston në menaxhimin dhe uljen progresive të stokut të detyrimeve të papaguara, përmes zbatimit të procedurave administrative të njoftimit, rikujtimit, negociimit të pagesave, si dhe ndjekjes së hapave ligjorë të parashikuar për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve tatimore, në rast mosrespektimi të afateve të pagesës.
Gjithashtu, sektori ushtron monitorim të vazhdueshëm të sjelljes paguese të tatimpaguesve, përditëson bazën e të dhënave të borxhit tatimor dhe bashkëpunon ngushtësisht me strukturat e tjera brenda administratës tatimore, me qëllim përmirësimin e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave dhe forcimin e disiplinës fiskale.
Qëllimi përfundimtar i punës së Sektorit të Borxhit mbetet garantimi i arkëtimit sa më të plotë dhe në kohë të detyrimeve të papaguara, rritja e nivelit të zbatimit vullnetar të detyrimeve tatimore, si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i performancës së mbledhjes së të ardhurave vendore, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.
Përfundimisht, Sektori i Borxhit siguron Auditin e Brendshëm se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Durrës, mbetet plotësisht e angazhuar në ndjekjen e procedurave ligjore dhe administrative për uljen progresive të stokut të borxhit, forcimin e kontrollit mbi detyrimet e papaguara dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së administrimit fiskal vendor."
**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacionit të mësipërm përcjell nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Durrës për periudhën e audituar 2023-2024 masat e marra janë pasqyruar në material si masat e bllokimit të llogarive bankare si në numër dhe në vlerë, njoftimet e detyrimit etj. Sa më sipër është sjell informacion dhe argument për masat e marra gjatë periudhës 2025 dhe 2026 e cil anuk është objekt auditimi. Në material janë cituar veprimet që duhet të merreshin nga Drejtoria përkatëse dhe nuk janë ndërmarrë dhe sa më sipër shprehet dhe në këtë observacion si në nenin 181 "*Mos pagimi i taksave dhe tatimeve",* të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar dhe ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", neni me ndryshime. Sa më sipër nuk janë sjell fakte dhe dokumentacion shtesë për masat e marra gjatë periudhës 2023-2024. Masat e marra nga Sektori i Borxhit janë pasqyruar në vijim të raportit të auditimit. ***Observacioni nuk merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit***.

- *Aktmarrëveshje e lidhura nga Bashkia Durrës gjatë periudhës 2023-2024***:**

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2023 në Bashkinë Durrës nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore janë lidhur 47 akt-marrëveshje me abonentë debitorë biznes. Aktmarrëveshjet janë paraqitur në **aneksin nr. 2.2.6.8** në anekset e projekt raportit të auditimit.
Marrëveshjet me subjektet debitorë janë të rregulluara sipas nenit 77 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar.
Nga auditimi u verifikua se janë lidhur 4 (katër) aktmarrëveshje duke mos u respektuar vlera fillestare prej 20% para lidhjes së aktmarrëveshjes në kundërshtim me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".*
Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2024 në Bashkinë Durrës nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore janë lidhur 47 akt-marrëveshje me abonentë debitorë biznes. Aktmarrëveshjet janë paraqitur në **aneksin nr. 2.2.6.9** në anekset e projekt raportit të auditimit.
**Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi personat si më poshtë:** *zv. Kryetarët e*

*Bashkisë z. G.K., z. L.D., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 01.01.2023-21.01.2024, z. L.B., Përgjegjësi i Sektorit të Manaxhimit të Borxhit dhe Apelimit*.

- *Tarifa për zënien e hapësirës publike***:**

Referuar VKB nr.149, datë 22.12.2022 *"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2023"* dhe VKB nr.194, datë 22.12.2023 *"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2024",* struktura përgjegjëse për dhënien e lejes për zënien e hapësirës publike, llogaritjen dhe arkëtimin e taksës është Drejtoria e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Durrës.
Referuar VKB-vë përkatëse tarifa për zënien e hapësirës publike llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit.

**Tabela Nr.11:** Tarifat për zënien e hapësirës publike

| Nr. | Kategoria dhe nënkategoria | Lekë/$m^2$/muaj |
|---|---|---|
| 1 | Zona A-Bregdetare, lagja nr.13 bregdeti, lagja 1, shëtitorja Taulantia, C.la, Shkëmbi i Kavajës, Gjiri i Lalëzit. | 2,000 |
| 1.1 | Zona B, (Lagja 2,3,4,5,6,11,17) | 1,500 |
| 1.2 | Zona C | 500 |

Referuar të dhënave nga regjistri përmbledhës konstatohet së për vitin 2024 në sistem janë regjistruar 210 kode biznesi me llojin e taksës (taksë tavolI.) me vlerë të faturuar 9,971,500 lekë, vlerë të arkëtuar 6,412,500 lekë dhe vlerë të mbetur 3,559,000 lekë.
Sipas informacionit zyrtar të përcjell nga Drejtoria e Shërbimeve Publike gjatë vitit 2023 janë pajisur me leje për zënie hapësirë publike 41 biznese dhe gjatë vitit 2024 janë pajisur me leje për zënie hapësire publike 87 biznese.
Nga informacioni i mësiprm nga Drejtoria e Shërbimeve Publike vlera e faturuar për vitin 2024 është 5,436,352 lekë.
Sipas bazës së të dhënave biznese aktive me fushën e veprimtarisë bar-restorant, bar bufe janë 1,440 biznese nga të cilat me leje për vitin 2024 janë pajisur vetëm 87.

- *Tarifa e Plazheve Private***:**

Për vitin 2023 me VKB nr. 149, datë 22.12.2022 *"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2023"* dhe për vitin 2024 me VKB nr. 194, datë 22.12.2023 *"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2024".* Në vendimet e Këshillit të Bashkisë Durrës, janë miratuar tarifat, struktura dhe procedura për ndjekjen e tarifës së plazheve private si më poshtë:

**Tabela Nr.12:** Tarifa për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi Plazh

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Durrës, Rrashbull, Ishëm, Hamallaj | 500 lekë/$m^2$/sezon |
| 2 | Katundi i Ri (Fshati Rinia) Sukth | 200 lekë/$m^2$/sezon |

Referuar vendimit nr.171, datë 27.03.2019 *"Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"* zonat e plazheve në Republikën e Shqipërisë janë përcaktuar në shtojcën 1 të vendimit të mësipërm.

Me VKB nr. 142, datë 24.11.2022 *"Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara ku do të ushtrohet veprimtaria si stacione plazhi, si dhe plazhet publike për vitin 2023"* është miratuar lista e përgjithshme e plazheve të lejuara.

Mbi të ardhurat e realizuara nga zbatimi i kontratave të lidhura për shfrytëzimin e hapësirave të plazhit dhe pagesa e detyrimeve të subjekteve.

Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, si drejtoria e ngarkuar për menaxhimin e kontratave të plazhit dhe drejtoria e FI.ncë Buxhet Bashkia Vlorë, rezulton se:

a- Përgjatë sezonit turistik të vitit 2023 janë lidhur kontrata plazhi me afat 1-vjecar si vijon:
Kontrata plazhi me afat 1-vjeçar janë lidhur 154; - *Gjiri i Lalëzit 22 kontrata me sipërfaqe 41,135 $m^{2.}$*
*-Sukth 1 kontratë me sipërfaqe 13,793$m^2$; -Katund i Ri 20 kontrata me sipërfaqe 23,617$m^2$; -Durrësi 82 kontratë me sipërfaqe 42,857$m^2$; -Shkëmbi 32 kontrata me sipërfaqe 26,615$m^2$;* Gjatë vitit 2023 ka pasur kontrata aktive me afat 3 dhe 5 vjeçar; *-Shkëmbi i Kavajës 6 kontrata me afat 3 vjeçare me sipërfaqe 5,086 $m^2$; -Shkëmbi i Kavajës 33 kontrata me afat 5 vjeçar me sipërfaqe 47,210 $m^2$; -Durrës kontrata me afat 3 vjeçare me sipërfaqe 2,660 $m^2$; -Durrës kontrata me afat 5 vjeçare me sipërfaqe 29,043 $m^2$.*
*Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Shkëmbit të Kavajës është 78,911 $m^2$ .*
*Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Durrësit është 74,560 $m^2$.*
*Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Gjirit të Lalëzit është 41,135$m^2$.*
*Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në Katundit të Ri është 23,617 $m^2$.*
*Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në Sukth është 13,793 $m^2$.*
*Shuma totale e faturuar për vitin 2023 është 108,972,900 lekë shuma e arkëtuar 106,006,195 lekë dhe debitor në shumën 2,916,705 lekë si mëposhtë:*

**Tabela Nr.13:** Debitorët nga tarifa për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi

| Subjekti | Nipti | Zona | Sipërfaqja | Çmimi | Shuma | Gjendja e pagesës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| "B". A.I. | "K13" | Shkembi | 2369 | 500 | 1,184,500 | Paguar në vitin 2024 |
| E.K. | "L14" | Durres | 761 | 500 | 380500 | Paguar në vitin.2024 |
| Z.Sh. | "L15" | Shkembi | 600 | 500 | 92,705 | Paguar në vitin 2025 |
| S.D. | "L16" | Shkembi | 892 | 500 | 446,000 | |
| M.K. | "M17" | Durres | 626 | 500 | 313,000 | |
| K.Gjy. | "L18" | Gjiri i Lalezit | 1000 | 500 | 500,000 | Paguar në vitin 2024 |
| **Totali** | | | | | **2,916,705** | |

***Burimi:*** *Përpunoi Grupi i Auditimit*

a- Përgjatë sezonit turistik të vitit 2024 janë lidhur kontrata plazhi me afat 1-vjecar si vijon:
Kontrata plazhi me afat 1-vjeçar janë lidhur 193; -*Gjiri i Lalëzit 20 kontrata me sipërfaqe 35,912 $m^{2.}$*
*-Sukth 1 kontratë me sipërfaqe 13,793$m^2$; -Katund i Ri 25 kontrata me sipërfaqe 27,217 $m^2$; -Durrësi 100 kontratë me sipërfaqe 51,270 $m^2$; -Shkëmbi 47 kontrata me sipërfaqe 39,927 $m^2$;* Gjatë vitit 2024 ka pasur kontrata aktive me afat 5 vjeçar; *-Shkëmbi i Kavajës 32 kontrata me afat 5 vjeçar me sipërfaqe 46,973 $m^2$; -Durrës 30 kontrata me afat 5 vjeçare me sipërfaqe 29,856 $m^2$; -Gjiri i Lalëzit 5 kontrata me afat 5 vjeçare me sipërfaqe 10,000 $m^2$.*
*Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Shkëmbit të Kavajës është 86,900 $m^2$ .*
*Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Durrësit është 81,126 $m^2$.*
*Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Gjirit të Lalëzit është 45,912 $m^2$.*
*Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në Katundit të Ri është 27,217 $m^2$.*
*Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në Sukth është 13,793 $m^2$.*
*Shuma totale e faturuar për vitin 2023 është 119,363,900 lekë shuma e arkëtuar 117,373,900 lekë dhe debitor në shumën 1,990,000 lekë si mëposhtë:*

**Tabela Nr.14:** Debitorët nga tarifa për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi

| Subjekti | Nipti | Zona | Sipërfaqja | Detyrimi | Afati i Kontratës |
|---|---|---|---|---|---|
| Z.Sh. | "L15" | Shkembi | 600 | 300,000 | 5 vjecare |
| "M 05".Z.E. | "L19" | Durres | 1000 | 500,000 | 5 vjecare |
| E.K. | "L14" | Durres | 761 | 380,500 | 5 vjecare |
| "S. M" | "L20" | Durres | 880 | 440,000 | 5 vjecare |
| "2D&2L".E.L. | "L21" | Durres | 738 | 369,000 | 5 vjecare |
| **Totali** | | | | **1,989,500** | |

***Burimi:*** *Përpunoi Grupi i Auditimit*

- *Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre***:**

Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se përgjatë periudhës 2023-2024 në territorin e Bashkisë Durrës dhe njësive administrative është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 130 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Konstatohet se në fund të vitit 2024, gjithsej rezultojnë 4 subjekte të pajisura me autorizim me afat 5 vjeçar, këto subjekte e kanë paguar të plotë vlerën e autorizimit sipas rastit. Ndërkohë që për 126 subjekte me aktivitet tregtimin e karburanteve që operojnë në territorin e Bashkisë Durrës të pa pajisur me autorizimin përkatës, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, kërkesë për bashkëpunim nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Transportit, Pronave dhe Shërbimeve. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, *"Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre",* VKM nr. 170, datë 25.04.2002, *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre"* i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj"* i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, germa "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, germa "b" dhe pika 9 dhe 15.

**Tabela Nr.15*:*** Subjektet e hidrokarbureve të pajisura me licencë**:**

| Nr. | Subjekti | Nipti | Adresa | Fillimi | Përfundimi | Detyrime për tu paguar | Detyrimi i paguar | Diferenca |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | "K.&P" Karburant (M.N.) | "K22" | Rrethrotullimi Plepa | 09.05.2023 | 09.05.2028 | 1,000,000 | 1,000,000 | - |
| 2 | "K.& P."(M.-N.) | "K22" | Shkozet | 09.05.2023 | 09.05.2028 | 1,000,000 | 1,000,000 | - |
| 3 | "A.P."Tregeti Karburanti (B. S.,T.Pas.Q. Xh.) | "L23" | - | 30.04.2024 | 30.04.2029 | 1,000,000 | 1,000,000 | - |
| 4 | Karburant bm" D." ( F.D.) | "K24" | - | 12.05.2023 | 12.05.2028 | 1,000,000 | 1,000,000 | |
| **Total** | | | | | | **4,000,000** | **4,000,000** | |

***Burimi:*** *Përpunoi Grupi i Auditimit*

**Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** *Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike z. A.I..*

**TREGU AGROBUJQËSOR** (Tregu fshatar/Markata)

Administrata e Tregut Agro - Bujqësor është në varësi të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Durrës.

Misioni i tij është të ofrojë kushtet optimale në zhvillimin e tregtisë së lirë, për një shërbim bashkëkohor ndaj popullatës duke zbatuar detyrimet që rrjedhin nga dispozitat ligjore dhe normat higjeno – sanitare dhe normat e peshëmatjes.

Administratori është përgjegjës dhe ka në varësi të drejtpërdrejtë njësinë në fjalë, të përcaktuar në strukturën e miratuar nga Këshilli Bashkiak.

**Administrata e tregut sipas funksioneve përkatëse:**

- Kryen mirëmbajtjen për problemet e defekteve elektrike, hidraulike, saldaturë, muratori etj. Në raste të veçanta sipas kërkesave që parashtrohen në mbështetje të tij vihen dhe sektorët e mirëmbajtjes të ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë.
- Inspektori i financës arkëton të ardhurat mujore nga të gjithë tregtaret mbi bazën e kontratës dhe arkëtimet ditore për postet që mund të jenë ditore. Çdo ditë këto arkëtime i derdh në llogarinë bankare të Bashkisë. Raporton tek administratori në lidhje me të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e nevojshme për mirëmbajtjen e tregut.
- Rojet e pastruesit e tregut në zbatim të detyrave të përcaktuara në kontratën e punës, kujdesen për higjienën dhe rregullin në ambientet ku tregtohet.

Ky treg ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës me anë të Vendimit nr. 536, datë 01.05.2008 *"Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës të Qarkut të Durrësit".* Për këtë pronë Bashkia Durrës nuk disponon certifikatë pronësie. Nëpërmjet vendimit të përmendur më sipër sipërfaqja e tregut që ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës është 2000 $m^2$ truall dhe 465 $m^2$ ndërtesë.

Në paketë Fiskale të miratuar për vitin 2023 dhe 2024, baza e taksës së përkohshme të tregut është në vlerën 50 lekë/$m^2$. (taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit). Tregtarët që zhvillojnë aktivitet në tregjet që administrohen nga Bashkia Durrës ngarkohen me tarifa vendore gjithsej 3,500 lekë (tarifë pastrimi, tarifë Gj., tarifë ndriçimi).

Kontratat parashikojnë detyrimin e Bashkisë për dhënien me qira të sipërfaqes 3 m² (duke përfshirë edhe banakun). Kontratat parashikojnë dhe llogaritjen e vlerës së qirasë sipas formulës: 26 ditë x 3 m² x 50 lekë/m² në ditë = 3900 lekë. Subjektet me kontratë në momentin e kryerjes së pagesës pajisen me mandat arkëtimi. Shuma e mbledhur derdhet në bankë sipas kodit të bashkisë dhe kalojnë në Thesar. Të gjitha pagesat e kryera regjistrohen në librin e arkës të cilit i bashkëngjiten kopjo e mandatit që i jepet subjekteve, dhe mandatet e derdhjes në bankë.

Në evidencat e drejtuar DTTV Durrës dhe të vëna në dispozicion të grupit të auditimit përllogaritja e detyrimit bëhet sipas njësisë matëse "Banak". *Nuk u konstatua asnjë rakordim midis administratorit të tregut dhe DTTV, lidhur me gjendjen debitorë të subjekteve për taksa dhe tarifa vendore në momentin e lidhjes së kontratave individuale*.

Gjatë vitit 2023 kanë zhvilluar aktivitetin e tyre rreth 263 subjekte në sektorin fruta-perime, 6 subjekte ne sektorin e peshkut si dhe 2 subjekte ne sektorin e bulmetit.

**Tabela Nr.16:** Të adhurat në lekë nga mbledhja e detyrimeve të subjekteve për 2023

| Muaji | Banakë të fruta/perime | | Banakë bulmeti | | Banake Peshku | | Gjithsej | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Shuma lekë | Nr. | Shuma lekë | Nr. | lekë | Nr. | Shuma lekë |
| Janar | 232 | 904.800 | 2 | 7.800 | 3 | 11.700 | 237 | 924.300 |
| Shkurt | 236 | 920.400 | 2 | 7.800 | 6 | 23.400 | 244 | 951.600 |
| Mars | 289 | 1.127.100 | 1 | 3.900 | 1 | 3.900 | 291 | 1.134.900 |
| Prill | 220 | 858.000 | 2 | 7.800 | | | 222 | 865.800 |
| Maj | 275 | 1.072.500 | 3 | 11.700 | 4 | 15.600 | 282 | 1.099.800 |
| Qershor | 253 | 986.700 | 2 | 7.800 | 2 | 7.800 | 257 | 1.002.300 |
| Korrik | 264 | 1.029.600 | 1 | 3.900 | 10 | 39.000 | 275 | 1.072.500 |
| Gusht | 262 | 1.021.800 | 3 | 11.700 | 3 | 11.700 | 268 | 1.045.200 |
| Shtator | 250 | 975.000 | 1 | 3.900 | 8 | 31.200 | 259 | 1.010.100 |
| Tetor | 295 | 1.150.500 | 3 | 11.700 | 8 | 31.200 | 306 | 1.193.400 |
| Nentor | 267 | 1.041.300 | 1 | 3.900 | 11 | 42.900 | 279 | 1.088.100 |
| Dhjetor | 289 | 1.127.100 | 3 | 11.700 | 13 | 50.700 | 305 | 1.189.500 |
| **Shuma** | **3132** | **12.214.800** | **24** | **93.600** | **69** | **269.100** | **3225** | **12.577.500** |

***Burimi:*** *Bashkia Durrës*

Gjatë vitit 2024 kanë zhvilluar aktivitetin e tyre rreth 270 subjekte në sektorin fruta-perime, 6 subjekte ne sektorin e peshkut si dhe 3 subjekte ne sektorin e bulmetit.

**Tabela Nr.17:** Të adhurat në lekë nga mbledhja e detyrimeve të subjekteve për 2024

| Muaji | Subjekte të fruta/perime | | Subjekte te bulmeti | | Subjekte te peshku | | Gjithsej | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Shuma lekë | Nr. | Shuma lekë | Nr. | Shuma lekë | Nr. Subjekteve | lekë |
| Janar | 249 | 971.100 | 2 | 7.800 | 2 | 7.800 | 253 | 986,700 |

| Muaji | Subjekte të fruta/perime | | Subjekte te bulmeti | | Subjekte te peshku | | Gjithsej | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Shuma lekë | Nr. | Shuma lekë | Nr. | Shuma lekë | Nr. Subjekteve | lekë |
| Shkurt | 263 | 1.025.700 | 2 | 7.800 | 2 | 7.800 | 267 | 1,041,300 |
| Mars | 253 | 986,700 | 2 | 7.800 | 3 | 11,700 | 258 | 1,006,200 |
| Prill | 266 | 1,037,400 | 2 | 7.800 | 2 | 7,800 | 270 | 1,053,000 |
| Maj | 262 | 1,021,800 | 2 | 7.800 | 3 | 11,700 | 267 | 1,041,300 |
| Qershor | 207 | 807,300 | 3 | 11,700 | 3 | 11,700 | 213 | 830,700 |
| Korrik | 327 | 1,275,300 | 3 | 11,700 | 1 | 3,900 | 331 | 1,290,900 |
| Gusht | 260 | 1.014.000 | 3 | 11.700 | 2 | 7.800 | 265 | 1.033.500 |
| Shtator | 252 | 982.800 | - | - | 15 | 58.500 | 267 | 1.041.300 |
| Tetor | 314 | 1.224.600 | 6 | 23.400 | 4 | 15.600 | 324 | 1.263.600 |
| Nëndor | 331 | 1.290.900 | 3 | 11.700 | 29 | 113.100 | 363 | 1.415.700 |
| Dhjetor | 287 | 1.119300 | 3 | 11.700 | 7 | 27.300 | 297 | 1.158.300 |
| **Gjithsej** | **3.271** | **12.756.900** | **31** | **120.900** | **73** | **284.700** | **3375** | **13.162.500** |

***Burimi:*** *Bashkia Durrës*

- *<u>Të ardhurat nga gjobat nga Policia Bashkiake</u>***:**

Policia Bashkiake funksionon në bazë të ligjit 89/2022 *"Për Policinë Bashkiake",* gjithashtu zbaton urdhërat e Kryetarit të Bashkisë, Vendimet e Këshillit Bashkiak si dhe çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor, si vijon: Ligji nr.139/2015 *"*Për Vetëqeverisjen Vendore"; VKB nr.37, datë 31.03.2021 "Për përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Durrës"; VKB nr.41, datë 09.05.2022 *"Për miratimin e rregullores së mbetjeve në Bashkinë Durrës";* Ligji nr.8378, datë 28.07.1998 *"Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë";* Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.03.2019 *"Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit".*
Efektivët e Policisë Bashkiake për të përmbushur detyrat e tyre operojnë me 3 (tre) blloqe gjobash si mëposhtë: *Bllok gjobash për tregtarët ambulant; Bllok gjobash për subjektet me nipt; Bllok gjobash për shkeljet në fushën e qarkullimit rrugor*.

**Për vitin 2023 janë vendosur gjobat si mëposhtë:**

| Emërtimi | Numri | Vlera |
|---|---|---|
| Gjoba me NIPT | 185 | 1,752,000 |
| Gjoba Ambulant | 198 | 463,500 |

***Burimi:*** *Bashkia Durrës*

| Emërtimi | Numri | Vlera gjobës referuar thesarit | Kamata referuar thesarit | Totali |
|---|---|---|---|---|
| Gjoba qarkullimi rrugor | 26,782 | 24,871,219 | 3,921,242 | 28,792,461 |

***Burimi:*** *Bashkia Durrës*

**Për vitin 2024 janë vendosur gjobat si mëposhtë:**

| Emërtimi | Numri | Vlera |
|---|---|---|
| Gjoba me NIPT | 226 | 2,195,000 |
| Gjoba Ambulant | 83 | 331,000 |

***Burimi:*** *Bashkia Durrës*

| Emërtimi | Numri | Vlera gjobës referuar thesarit | Kamata referuar thesarit | Totali |
|---|---|---|---|---|
| Gjoba qarkullimi rrugor | 43,184 | 32,664,980 | 6,255,51 | 38,920,490 |

***Burimi:*** *Bashkia Durrës*

- *<u>Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve</u>***:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për procedurat e ndjekura nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve Bashkia Durrës, në lidhje me procedurat e dhënies me qira mbi 200 $m^2$ sipërfaqe objekte të pasurisë shtetërore në zbatim të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore"* nga ku rezultoi se :
-Nga "Sektori i pronave dhe aseteve" në Bashkinë Durrës, janë të administruar vetëm 2 lista të pronave të miratuara me VKM dhe konkretisht ajo e Bashkisë Durrës e cila është e miratuar me

VKM nr. 536, datë 01.05.2008, *"Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës"* dhe e ish-Komunës Ishëm e miratuar me VKM, nr. 284, datë 12.3.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Ishëm, të Qarkut të Durrësit", ***ndërsa Njësitë e tjera Administrative që varen nga Bashkia Durrës janë me listë paraprake, jo përfundimtare të pa miratuar me VKM.***

**Tabela Nr.18:** Pasuritë me listë të miratuara me VKM dhe me listë paraprake të pa miratuara janë si më poshtë:

| Njesite Administrative | Pronesi | Perdorim | Totali për Njesi | Rregjistruar |
|---|---|---|---|---|
| Bashkia Durrës | 938 | 221 | 1159 | 94 |
| Njësia Administrative Ishëm | 115 | 29 | 144 | 5 |
| Njësia Administrative Katund I Ri | 81 | 197 | 278 | 2 |
| Njësia Administrative Rrashbull | 61 | 0 | 61 | - |
| Njësia Administrative Sukth | 423 | 7 | 430 | - |
| Njësia Administrative Manzë | 91 | 39 | 130 | - |
| **Totali** | **1709** | **493** | **2202** | **101** |

**Burimi:**Bashkia Durrës

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* VKM nr. 54, datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"* i ndryshuar, si dhe të VKM-së, nr. 536, datë 1.5.2008, "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës, të Qarkut të Durrësit"* për pronat që janë të regjistruara dhe që janë të pajisur me certifikatë pronësie.
Për vitin 2023, Bashkia Durrës ka lidhur 4 kontrata të reja "Për sipërfaqen nën 200 $m^{2"}$ aktivë ka qenë 1 kontratë e cila është lidhur gjatë vitit 2022. Kontrata aktive gjatë vitit 2023 për sipërfaqen nën 200 $m^2$ gjenden në tabelën më poshtë:

**Tabela Nr.19:** Kontratë-Qiraje për sipërfaqe nën 200 $m^2$.

| Nr. | Qiramarrësi | Objekti i dhënë me qira | Aktiviteti i subjektit | Data e lidhjes kontratës | Sip. $m^2$ | Afati i qirasë | Detyrimi mujor në lekë | Detyrimi i prapambe. në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A.K | URT | Shtëpi botuese | 14.09.2023 | 155 | 1 | 29,130 | - |
| 2 | "U" sh.p.k | URT | Fason | 13.01.2023 | 200 | 1 | 39,690 | - |
| 3 | S.Q | Bashkia | Bar-kafe | 26.05.2023 | 35 | 1 | 7,000 | - |
| 4 | X.K | URT | Agjensi Reklama | 14.09.2023 | 129.5 | 1 | 23,300 | - |
| 5 | D.Z | Tregu | Tregti produkte mishi | 17.10.2022 | 147 | 1 | 43,000 | - |
| **Totali** | | | | | | | | - |

**Burimi:**Bashkia Durrës

Nga shqyrtimi i procedurave të djegura nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Durrës në lidhje me monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratës së qirasë për sipërfaqe nën 200 $m^2$ me afat 1-vjeçar rezultoi se:
Nga ana e Bashkisë Durrës janë lidhur kontratë qiraje me afat 1-vjeçar për objektet me sipërfaqe nën 200 $m^2$ gjithsej 5 kontrata.
Këto kontratë qiraje të lidhura nga Bashkia Durrës me afat 1-vjeçar për objektet me sipërfaqe nën 200 $m^2$ janë bërë pa konkurrim në zbatim të pikës 5/a të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore*".*
Për të gjitha rastet nga subjektet janë paraqitur pranë Bashkisë Durrës dokumentacioni për marrjen me qira të objekteve, duke filluar nga kërkesa e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, plan biznesin, të detajuar për vënien me funksionim të objektit, ku është përshkruar qartë plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen, në zbatim të pikës 7 të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014.

Për vitin 2023, Bashkia Durrës nuk ka lidhur kontrata të reja "Për sipërfaqen mbi 200 $m^{2"}$ aktivë kanë qenë 4 kontratë të cilat janë lidhur gjatë periudhës 2019-2020. Kontrata aktive gjatë vitit 2023 për sipërfaqen mbi 200 $m^2$ gjenden në tabelën më poshtë:

**Tabela Nr.20:** Kontratë-Qiraje për sipërfaqe mbi 200 $m^2$.

| Nr. | Qiramarrësi | Objekti i dhënë me qira | Aktiviteti i subjektit | Data e lidhjes kontratës | Sip. $m^2$ | Afati i qirasë | Detyrimi mujor në lekë | Detyrimi i prapambe. në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | C.P | URT | Rrobaqepsi | 01.09.2020 | 602 | 10 | 117,000 | - |
| 2 | I.I.& P. | URT | Servis Mak. | 01.09.2020 | 251 | 5 | 45,000 | - |
| 3 | U. | URT | Fasoneri | 30.07.2019 | 930 | 8 | 1 Eur | - |
| 4 | T.P | Shkollë | Tenis | 09.11.2020 | 1420 | 5 | 25,810 | - |
| 5 | N.S | Truall | - | 07.06.2005 | 1,800 | 30 | 11,600 | - |
| **Totali** | | | | | | | | |

**Burimi:**Bashkia Durrës

Për vitin 2024, Bashkia Durrës ka lidhur 15 kontrata të reja "Për sipërfaqen nën 200 $m^{2}$". Kontrata aktive gjatë vitit 2024 për sipërfaqen nën 200 $m^2$ gjenden në tabelën më poshtë:

**Tabela Nr.21:** Kontratë-Qiraje për sipërfaqe nën 200 $m^2$.

| Nr. | Qiramarrësi | Objekti i dhënë me qira | Aktiviteti i subjektit | Data e lidhjes kontratës | Sip. $m^2$ | Afati i qirasë | Detyrimi mujor në lekë | Detyrimi i prapambe. në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | X.K | URT | Shtëpi botuese | 16.10.2024 | 155 | 1 | 29,130 | - |
| 2 | S.Q | Bashkia | Bar-kafe | 28.06.2024 | 35 | 1 | 7,000 | - |
| 3 | X.K | URT | Agjensi Reklama | 16.10.2024 | 129.5 | 1 | 23,300 | - |
| 4 | D.Z | Tregu | Tregti produkte mishi | 22.04.2024 | 167 | 1 | 65,448 | - |
| 5 | J.S | URT | Riparim qepenash | 01.07.2024 | 160 | 1 | 29,700 | - |
| 6 | L.H | URT | Mirëmbajtje mjete ujore | 23.10.2024 | 123 | 1 | 23,000 | - |
| 7 | J.M | Njësi Shërbimi | Parukeri | 05.11.2024 | 35 | 1 | 7,400 | - |
| 8 | A.P | Njësi Shërbimi | Marangoz | 24.06.2024 | 86 | 1 | 16,180 | - |
| 9 | E.G | Njësi Shërbimi | Bilardo | 02.07.2024 | 79 | 1 | 16,000 | -- |
| 10 | "A" sh.p.k | Tregu | Tregti peshku | 24.06.2024 | 61 | 1 | 22,480 | - |
| 11 | M.H | Tregu | Tregti peshku | 08.11.2024 | 61 | 1 | 22,480 | - |
| 12 | F.A | Tregu | Tregti me pakicë | 09.07.2024 | 74 | 1 | 28,240 | |
| 13 | E.X | Tregu | Tregti | 02.07.2024 | 15 | 1 | 5,700 | - |
| **Totali** | | | | | | | | |

**Burimi:**Bashkia Durrës

Për vitin 2024, Bashkia Durrës ka lidhur 2 (dy) kontrata të reja "Për sipërfaqen mbi 200 $m^{2"}$ aktivë kanë qënë 5 (pesë) kontratë të cilat janë lidhur gjatë periudhës 2019-2020. Kontrata aktive gjatë vitit 2024 për sipërfaqen mbi 200 $m^2$ gjenden në tabelën më poshtë:

**Tabela Nr.22:** Kontratë-Qiraje për sipërfaqe mbi 200 $m^2$.

| Nr. | Qiramarrësi | Objekti i dhënë me qira | Aktiviteti i subjektit | Data e lidhjes kontratës | Sip. $m^2$ | Afati i qirasë | Detyrimi mujor në lekë | Detyrimi i prapambe. në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Conorsium Penelopa | URT | Rrobaqepsi | 01.09.2020 | 602 | 10 | 117,000 | |
| 2 | I. I. & P. | URT | Servis Mak. | 01.09.2020 | 251 | 5 | 45,000 | |
| 3 | U. | URT | Fasoneri | 30.07.2019 | 930 | 8 | 1 Eur | |
| 4 | T. P. | Shkollë | Tenis | 09.11.2020 | 1420 | 5 | 25,810 | |
| 5 | N.S | Truall | - | 07.06.2005 | 1800 | 30 | 11,600 | |
| 6 | "A" | BGT | Prodhim | 02.09.2024 | 585 | 3 | 113,611 | |
| 7 | "U" | URT | Fason | 16.04.2024 | 414 | 3 | 79,600 | |
| **Totali** | | | | | | | **392,621** | |

**Burimi:**Bashkia Durrës

Nga shqyrtimi i dokumentacionit me zgjedhje i procedurave të ndjekura nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve Bashkia Durrës në lidhje me procedurat e dhënies me qira

mbi 200 $m^2$ sipërfaqe objekte të pasurisë shtetërore në zbatim të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore"* rezultoi se :

**-Subjekti "A" sh.p.k** (Qiramarrës):

Me VKB nr.119, datë 24.12.2020 *"Për miratimin e dhënies me qira të ambientit me vendndodhje në katin zero të ndërtesës me nr. pasurie 5/109, ZK 8516, me sipërfaqe të përgjithshme 585.2 $m^2$ (nga kjo sipërfaqeje ndërtimi 555 m2 dhe sipërfaqeje funksionale 30.2 $m^2$), në inventar të Ndërmarrjes së Tregtisë me Shumicë, pronë e Bashkisë Durrës për një afat 3 vjet nëpërmjet procedurës së konkurrimit".*

Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Durrës me nr.210, datë 19.07.2024 është hapur procedura e konkurrimit për dhënien me qera të pasurisë me nr. pasurie 5/109, ZK 8516, me sipërfaqe të përgjithshme 585.2 $m^2$.

Afati i dhënies me qira do të jetë për periudhë 3 vjeçare.

Në konkurrimin e zhvilluar në datën 19.07.2024 për dhënien me qira të një pjese të katit 0 të ndërtesës (magazinë) me adresë lagja nr.14, Rruga "Asti Nushi", pasuria 5/109, ZK 8516 me sipërfaqeje të përgjithshme 585.2 m2 në këtë procedurë ka marrë pjesë vetëm 1 subjekt "A" sh.p.k Me ofertë ekonomike në vlerën 113,611 lekë.

OE ka dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

**Subjekti i mësipërm rezulton se kontratën fillestare të qirasë e ka lidhur në datë 03.04.2017** me afat 3-vjeçar me sipërfaqe objekti 585.2 $m^2$ nëpërmjet procedurës së konkurrimit për ushtrimin e aktivitetit "Duralumin" me qiradhënësin Bashkia Durrës.

Nga Administrata e Ndërmarrjes së Tregtisë me Shumicë (BGT) që e ka në inventar pasurinë objekt qiraje që ka të drejtë të kontrollojnë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate, nuk është respektuar nenit 7.1 "Zgjidhja e Kontratës" ku citohet se "Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të kësaj kontrate", që do të thotë se ka 3 vjet që subjekti **"A" sh.p.k**, me përfaqësues z. A.Z. vazhdon aktivitetin pa pasur një kontratë qiraje për objektin me sipërfaqe 585.2 $m^2$.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga Bashkia Durrës është paraqitur observacioni me shkresën nr. 668/88 prot, datë 17.6.2026, administruar në KLSH me praktikën nr.1347/71 prot., datë 18.06.2026, nga *Sektori i Pronës Publike dhe Menaxhimit të Aseteve*, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**<u>Pretendimi i subjektit</u>:**

Në lidhje me konkluzionin e Kontrollit Lartë Shtetit, sqarojmë se pas përfundimit të afatit të kontratës së qirasë me datë 03/04/2017, Bashkia Durrës nuk procedoi me rinovimin e saj, pasi pasuria ishte parashikuar të përdorej për nevoja dhe interesa publike të institucionit. Gjithashtu, situata e krijuar pas tërmetit të vitit 2019 dhe pasojat e pandemisë "COVID-19", ndikuan në mosfI.lizimin në kohë të procedurave përkatëse administrative. Megjithëse Këshilli Bashkiak, me vendimin nr.119, datë 24.12.2020., *"Mbi miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike"*, kishte miratuar dhënien me qira të pasurisë nëpërmjet procedurës së konkurrimit për një afat 3-vjeçar, deri në zhvillimin e procedurës përkatëse marrëdhënia ndërmjet palëve vijoi faktikisht në kushtet e parashikuara nga neni 821 i Kodit Civil, me vazhdimin në heshtje të përdorimit të sendit nga qiramarrësi dhe pa kundërshtimin e qiradhënësit. Gjatë kësaj periudhe, vlera e qirasë u përditësua në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, konkretisht me ndryshimet e VKM nr. 54, datë 05.02.2014, ku çmimi dysheme për llogaritjen e qirasë u rrit nga 200 lekë/m² në 202.5 lekë/m², duke u reflektuar në detyrimet përkatëse të subjektit.

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së për rregullimin e situatës juridike të përdorimit të pasurisë, Bashkia Durrës zhvilloi procedurën e konkurrimit për dhënien me qira të pasurisë objekt auditimi. Në përfundim të procedurës, fitues u shpall sërish subjekti "A", me të cilin u lidh kontrata e qirasë nr. 10083, datë 02.09.2024, me afat 3 (tre) vjet. Më pas, për arsye të vetë subjektit, ky i fundit i është drejtuar Bashkisë Durrës me kërkesë nr.2784 datë 25.02.2026 për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së qirasë. Në zbatim të kushteve kontraktore, Bashkia Durrës ka miratuar kërkesën dhe kontrata është konsideruar e zgjidhur pas kalimit të afatit 30-ditor të parashikuar në kontratë. Për këtë është njoftuar

subjekti dhe ndërmarrja BGT që ka në administrim objektin me shkresat e më poshtme: Shkresa nr.2784/1 datë 02.03.2026, shkresa nr.2784/2 datë 19.03.2026 dhe shkresa nr.6009/1 datë 19.05.2026.
Nga verifikimet e kryera rezulton se:
- subjekti nuk ka asnjë detyrim fI.nciar të pashlyer ndaj Bashkisë Durrës;
- pasuria objekt kontrate është dorëzuar pranë Ndërmarrjes BGT me procesverbal dorëzimi-marrjeje;
- procesverbalit i janë bashkëlidhur fotografi që dokumentojnë lirimin e plotë të objektit;
- aktualisht pasuria është e lirë dhe në administrimin e Bashkisë Durrës., ndërmarrjes BGT.
Në këto kushte vlerësojmë se rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit lidhur me subjektin "A", si për arkëtimin e detyrimeve fI.nciare ashtu edhe për lirimin e pasurisë objekt qiraje dhe rregullimin e marrëdhënieve kontraktore, janë zbatuar plotësisht, duke mos ekzistuar aktualisht asnjë detyrim fI.nciar apo juridik i pambyllur në raport me këtë subjekt. Bashkëlidhur po ju përcillen kopje të dokumentacionit provues përkatës.
- Urdhri për zhvillimin e konkurrimit që mban nr. 210, datë 27.06.2024;
- Procedura e zhvillimit të konkurrit e ndjekur nga komisioni i ngritur me urdhrin e mesiperm;
- Informacion drejtuar titullarit të institucionit hartuar nga komisioni;
- Miratimin e titullarit të institucionit për lidhjen e kontratës;
- Njoftimet në faqen e APP-së për publikimin e njoftimit të bashkisë për dhënien me qira të pasurisë në administrim të Ndërmarrjes BGT, pronë e Bashkisë Durrës;
- Njoftim për shpalljen fitues;
- Kontrata e qirasë nr.10083, datë 02.09.2024;
- Kërkesa për zgjidhjen e kontratës;
- Njoftimi për miratimin e zgjidhjes së kontratës;
- Procesverbali i dorëzimit të pasurisë;
- Fotografi të objektit të liruar.
- Mandatet e pagesës së detyrimeve dhe kamatëvonesave;

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**
Referuar observacionit të mësipërm për periudhën 2020-2023 OE ka operuar pa kontratë qiraje. Referuar nenit 821 *"Përsëritja e kontratës së qirasë" Qiraja përtërihet në qoftë se, pasi të ketë mbaruar afati i saj, qiramarrësit i lihet në përdorim sendi i dhënë me qira pa kundërshtimin e qiradhënësit.*
***Sa më sipër observacioni merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.***

**-Subjekti "U" sh.p.k** (Qiramarrës) rezulton të ketë lidhur kontratë qiraje me datë 30.07.2019 me afat 8-vjeçar me sipërfaqe objekti 930 $m^2$ nëpërmjet procedurës së konkurrimit për ushtrimin e aktivitetit "Fasoneri" me qiradhënësin Bashkia Durrës.
Subjektit "U" sh.p.k referuar VKM nr.54, datë 05.02.2024 "*Për përcaktimin e kritereve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"* pika e ka kërkuar marrje me qira objekti me hapësirë të përgjithshme 414.6 $m^2$ ku sipërfaqja ndërtimore është 387.6 $m^2$ dhe sipërfaqeje funksionale 27 $m^2$.
Sipërfaqja e mësipërme është konfirmuar me VKB nr.18, datë 06.03.2024. Kontrata midis Bashkisë Durrës dhe Shoqërisë "U" sh.p.k është lidhur më nr.4909 prot, datë 16.04.2024.

**Kontrata Ndërmarrja Tregtare Shumica:**
Për vitin 2023, Ndërmarrja Tregtare Shumica ka lidhur 7 kontrata "Për sipërfaqen nën 200 $m^2$". Kontrata të mbartura nuk ka pasur. Në tabelën mëposhtë gjendet informacion për kontratat e lidhura gjatë vitit 2023.
**Tabela Nr.23:** Kontratë-Qiraje për sipërfaqe nën 200 $m^2$.

| Nr. | Qiramarrësi | Objekti i dhënë me qira | Aktiviteti i subjektit | Data e lidhjes kontratës | Sip. $m^2$ | Afati i qirasë | Detyrimi mujor në lekë | Detyrimi i prapambe. në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A.C. | Ndërmarrja | Tregëti | 01.06.2023 | 150 | 1 | 30,000 | - |
| 2 | "A" sh.p.k | Ndërmarrja | Tregëti | 01.12.2023 | 200 | 1 | 40,000 | - |
| 3 | E.M. PF | Ndërmarrja | Tregëti | 01.09.2023 | 200 | 1 | 40,000 | - |

| Nr. | Qiramarrësi | Objekti i dhënë me qira | Aktiviteti i subjektit | Data e lidhjes kontratës | Sip. $m^2$ | Afati i qirasë | Detyrimi mujor në lekë | Detyrimi i prapambe. në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | E.M. PF | Ndërmarrja | Tregëti | 01.09.2023 | 125 | 1 | 25,000 | - |
| 5 | J.S. | Ndërmarrja | Tregëti | 01.10.2022 | 100 | 1 | 20,000 | - |
| 6 | I.T. | Ndërmarrja | Tregëti | 01.04.2023 | 200 | 1 | 40,000 | - |
| 7 | J.Z. | Ndërmarrja | Tregëti | 01.04.2023 | 100 | 1 | 20,000 | - |
| 8 | E.D. Pf | Ndërmarrja | Tregëti | 01.11.2023 | 150 | 1 | 30,000 | - |
| **Total** | | | | | | | **245,000** | **-** |

**Burimi:**Bashkia Durrës

Për vitin 2024, Ndërmarrja Tregtare Shumica ka lidhur 7 kontrata "Për sipërfaqen nën 200 $m^2$ nuk ka pasur kontrata të mbartura. Në tabelën mëposhtë gjendet informacion për kontratat e lidhura gjatë vitit 2024.

**Kontratë-Qiraje për sipërfaqe nën 200 $m^2$.**

| Nr | Qiramarrësi | Objekti i dhënë me qira | Aktiviteti i subjektit | Data e lidhjes kontratës | Sip. $m^2$ | Afati i qirasë | Detyrimi mujor në lekë | Detyrimi i prapambe. në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A.C. | Ndërmarrja | Tregëti | 01.06.2024 | 150 | 1 | 30,000 | - |
| 2 | "A" sh.p.k | Ndërmarrja | Tregëti | 01.12.2024 | 200 | 1 | 40,000 | - |
| 3 | M. L. | Ndërmarrja | Tregëti | 01.04.2024 | 125 | 1 | 25,000 | - |
| 4 | R.Ç. | Ndërmarrja | Tregëti | 01.04.2024 | 100 | 1 | 20,000 | - |
| 5 | M.D. | Ndërmarrja | Tregëti | 01.07.2024 | 200 | 1 | 40,000 | - |
| 6 | I.T. | Ndërmarrja | Tregëti | 01.04.2024 | 200 | 1 | 40,000 | - |
| 7 | J.Z. | Ndërmarrja | Tregëti | 01.04.2024 | 100 | 1 | 20,000 | - |
| 8 | E.D. Pf | Ndërmarrja | Tregëti | 01.11.2024 | 150 | 1 | 30,000 | - |
| 9 | T.Ç. Pf | Ndërmarrja | Tregëti | 01.07.2024 | 50 | 1 | 10,000 | - |
| 10 | A. | Ndërmarrja | Prodhim | 02.09.2024 | 585 | 3 | 113,611 | - |
| **Total** | | | | | | | **245,000** | **-** |

**Burimi:**Bashkia Durrës

Kontratat aktive të lidhura nga Ndërmarrja Rruga Durrës janë paraqitur në **aneksin nr. 2/6/10** në anekset e projekt raportit të auditimit dhe kontratat aktive për dhënien me qira të fondit pyjor, kullosor janë paraqitur në **aneksin nr. 2/6/11** në anekset e projekt raportit të auditimit.

## 2.4. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 31.12.2024, u konstatua se përgjithësisht është zbatuar Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në funksion të tyre, në lidhje me përzgjedhjen e tipologjisë se procedurave të prokurimit, llogaritjen e fondit limit, argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim, kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik, si dhe lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

*Pavarësisht nga sa cituar më sipër, nga auditimi janë konstatuar dhe raste (procedura prokurimi), në shkeljeve dhe parregullsi ligjore ose rregullatore të LPP, të cilat në mënyrë të detajuar për çdo procedurë prokurimi paraqiten si më poshtë vijon:*

Dokumentacioni i shqyrtuar në auditim:

- *Regjistri i prokurimeve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2024;*
- *Dokumentacioni i OE të shpallur fitues dhe të paraqitur në sistemin e APP;*
- *Dosja e procedurës së auditimit të sipërcituar;*
- *Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP;*
- *Dokumentacioni mbi përllogaritjen e fondit limit.*

Regjistrat e planifikimit dhe të realizimit të prokurimeve, janë dërguar në APP nëpërmjet sistemit elektronik, si dhe për çdo ndryshim të kryer në to gjatë vitit fI.nciar, në zbatim me nenet 3 dhe

4, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
Nga grupi i auditimit nëpërmjet shkresave në zbatim të programit të auditimit (pika 4), është kërkuar informacion mbi regjistrin e planifikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2024, ku paraqitet kjo situatë:
Në total për periudhën objekt auditimi janë realizuar **81** propcedura prokurime me fond limit 3,434,827 mij lekë dhe vlerë kontrate të lidhur pa TVSH prej 2,940,501 mijë lekë me një diferencë në vlerësim për vlerën 494,326 mijë lekë ose 85.6% e fondit limit të prokuruar, *nga e cila:*
***Për vitin 2023,*** janë realizuar gjithsej 31 procedura prokurimi me fond limit 925,495 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 596,043 mijë lekë me një diferencë në vlerësim për vlerën 329,452 mijë lekë ose 64.4% e fondit të prokuruar.
***Për vitin 2024,*** janë realizuar gjithsej 50 procedura prokurimi me fond limit 2,509,332 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 2,344,458 mijë lekë me një diferencë në vlerësim për vlerën 164,873 mijë lekë ose 93.4% e fondit të prokuruari, të dhëna të cilat paraqiten në Aneksin 4.1 dhe 4.2 bashkëlidhur PRA.
Grupi i auditimit mbi bazën e analizës së riskut, ku janë vlerësuar për auditim procedura me vlërë më të lartë të fondit limit, procedura ku janë skualifikuar OE me ofertë më të leverdishme, etij, për periudhën objekti auditimi 01.01.2023 – 31.12.2024, ka vlerësuar gjithsej për auditim 26 procedura prokurimi me fond limit 2,849,269 mijë lekë ose 82.9% e fodnit të prokuruar, *nga e cila:*
***Për vitin 2023,*** janë vlerësuar 17 procedura me fond limit 861,818 mijë lekë ose 93.1% dhe ***për vitin 2024,*** janë vlerësuar 9 procedura prokurimi me fond limit 1,987,450 mijë lekë ose 79.2% e fodnit të prokuruar, të dhëna të cilat paraqiten në tabelën si vijon:

*Të dhëna mbi regjistrin e realizmit të procedurave të prokurmit dhe të vlerësuara për auditim.*

*në lekë*

| STATUSI | Nr. procedura | Fond limit | Vlere kontrate | Dif (FL - VK) | Ne % e fondit te prokuruar |
|---|---|---|---|---|---|
| **Procedura gjithsej** | **81** | **3,434,827,998** | **2,940,501,725** | **494,326,273** | **14.4** |
| *Nga e cila:* | | | | - | |
| Viti 2024 | 50 | 2,509,332,173 | 2,344,458,356 | **164,873,817** | **6.6** |
| Viti 2023 | 31 | 925,495,825 | 596,043,369 | **329,452,456** | **35.6** |
| **Vleresuar per auditim gjithsej** | **26** | **2,849,289,252** | **2,667,392,892** | **181,896,360** | **6.4** |
| *Nga e cila:* | | | | | |
| Viti 2024 | 9 | 1,987,470,381 | 1,921,475,172 | 65,995,209 | 3.3 |
| Viti 2023 | 17 | 861,818,871 | 745,917,720 | 115,901,151 | 13.4 |
| **Vleresuar ne %** | | **82.95289469** | | | |
| *Nga e cila:* | | | | | |
| Viti 2024 | | 79.2031602 | | | |
| Viti 2023 | | 93.119693 | | | |

*Burimi: Përpunuar nga grupi, sipas të dhënave të subjektit*

Auditimi rast pas rasti paraqitet si më poshtë vijon:

**1- Auditim i procedurës me objekt**: " *Rikonstruksion shkolla 9- vjeçare Demokracia",* viti 2023.

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"Rikonstruksion shkolla 9- vjeçare Demokracia".* | | | |
|---|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E hapur"<br>REF-91817—12-21-2023<br>Urdhri nr. 8541/1 *prot*., datë 13.10.2023 | **1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)**<br>Urdhri nr. 279 *prot*., datë 15.9.2023<br>1. J.K.<br>2. A.K.<br>3. M.J. | **2 Njësia e Prokurimit**<br>nr. 8541/, dt. 13.10.2023<br>1. A.Xh.<br>2. E.Gj.<br>3. A.T.<br>*Me urdhër nr. 329, dt. 23.10.2023 për ndryshimin e një anëtari, konkretisht* | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhri nr. 318 prot., datë 13.10.2023.<br>1. G.K.<br>2. L.S.<br>3. R.D. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | *A.T. është zëvendësuar me* K.S.Dh.. | |
| **4. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>47,500,000 lekë | **5. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>34,954,350 lekë<br>Fitues: OE "A" sh.p.k | | **6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>12,546 mijë lekë ose 26.4% |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 8.01.2024<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 105 ditë. | **8. Burimi FI.ncimit**<br>Të ardhurat e Bashkisë Durrës për vitin 2023, miratuar me VKB Nr. 150, datë 22.12.2022 *"Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Durrës për vitin 2023 (e ndryshuar)*". | | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **21 B/OE**<br>b) S'kualifikuar 8 B/OE,<br>c) Kualifikuar 13 B/OE |
| **10.Ankimime**<br>**AK**-s'ka/ka**; -Po**<br>**APP–**s'ka/ka**;-Jo**<br>**KPP**-s'ka/ka;-**Po** | **11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:**<br>Data: 13.3.2024 | | **12.Data e lidhjes së kontratës:**<br>Nr. 1649/9, datë 13.4.2024 |

**Mbi Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit datë 23.01.2023 "*Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në zbatim të VKM-së nr**.** 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", (i ndryshuar), neni 39, "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*", pika 4, ku është përcaktuar se: **"***Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve".* E konkretisht:

**Në pikën 2.3.4 të DT,** *është kërkuar që OE ekonomik duhet të ketë në stafin mbështetës një* ***ekspert zjarrfikës*** *dhe një* ***auditues energjetik i certifikuar për ndërtesat****.*

- Kërkesa për një zjarrfikës është e tejkaluar e LPP, pasi eksperti zjarrfikës është tejkaluar njëherë gjatë procesit të studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të projekt/preventivit, specifikimeve teknike, projektit dhe relacionit teknik të objektit. Kjo shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar Ligjit nr. 152/2015 "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*", roli i ekspertit zjarrfikës nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës.
- Gjithashtu dhe kërkesa për një auditues energjetikë të certifikuar, është në kundërshtim me nenin 16 pika 4 dhe 5 të Ligjit nr. 125/2015 "*Për efincencën e energjisë*" parashikohet se:. *4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për: a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie; b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të fI.ncuar nga Fondi për Efiçencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e efiçencës së energjisë. 5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen: a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij neni; b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm*."

AK nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit të efiçencës së energjisë në ndërtesa. AK në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjetik me një procedurë të veçantë.

Sa më sipër, kriteret e vendosura nga AK në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë AK.

**Personat përgjegjës për kritere të paargumentuara, janë:** *J.K., A.K., M.J***,** në cilësinë e anëtarëve të KVO.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Referuar të dhënave të Procesverbalit (PV) datë 9.01.224, datë në të cilën është bërë hapja e procedurës sipas afatit të përcaktuar dhe në DST, konstatohet se kanë marrë pjesë **21** B/OE, si më poshtë vijon:

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë pa TVSH | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | "L." C. | 39,006,861 | Kualifikuar |
| 2 | N.+ N. 2014 | 34,327,640 | Skualifikuar |
| 3 | N. | 36,443,433 | Kualifikuar |
| 45 | K. C. | 38,314,940 | Kualifikuar |
| 6 | S. | 39,424,485 | Kualifikuar |
| 7 | MF. + M./S | 36,535,525 | Skualifikuar |
| 8 | M.K. & R.Es. | 39,89,810 | Kualifikuar |
| 9 | "A" | 34,954,350 | Kualifikuar /fitues |
| 10 | S... | 43,001,625 | Kualifikuar |
| 11 | T & XH | 39,898,761 | Kualifikuar |
| 12 | K. | 31,938683 | Kualifikuar |
| 13 | L. k. + V.K. | 38,186,224 | Skualifikuar |
| 14 | C. | 34,284,415 | Skualifikuar |
| 15 | L. | 39,819,283 | Kualifikuar |
| 16 | I. | 37,488,230 | Kualifikuar |
| 17 | E. B&B + Rr.S.M. & H.C. + D. Com. | 37,857,530 | Skualifikuar |
| 18 | P.G. | 39,659,263 | Kualifikuar |
| 19 | N. 1934 + 2Z K. | 37,083,315 | Skualifikuar |
| 20 | A..3 | 43,360,440 | Skualifikuar |
| 21 | L. K. | 45,598,443 | Kualifikuar |

Sipas PV datë 15.01.2024 nga **21** OE pjesëmarrës në garë, gjatë fazës së vlerësimit nga KVO-ja janë skualifikuar **8** OE dhe kualifikuar **13** OE, sipas të dhënave të paraqitura në tabelën sipër. Nga OE të mbetur në garë është llogaritur çmimi anomalisht më i ulët, i cili është në vlerën 33,042,649 lekë, kjo në zbatim të nenit 39 të LPP[2].

- **Janë skualifikuar B/OE, si më poshtë vijon**:

**1- Bashkimi OE "N" + "N" sh.p.k**, për faktin se:

*Nuk përmbush kriterin sipas pikës 2.3.a, për punët e ngjashme. Nga shoqëria "N" sh.p.k e cila sipas marrëveshjes së bashkëpunimit mbulon 68.36% të vlerës së punimeve, si punë të ngjashme është paraqitur objekti "Rikonstruksion i bllokut te salla operatore në shërbimin e urgjencës", me vlerë kontrate 62,056,224 lekë në bashkëpunim me shoqërinë "U" sh.p.k Në këtë kontratë shoqëria "N" sh.p.k mbulon 30.84% të vlerës së kontratës, vlerë e cila nuk përmbush pikën 2.3.b të DST, në kundërshtim me nenin 88 pika 3 paragrafi 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar.*
*Shoqëria "N" sh.p.k, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër punime hodroizuluse, por që nga ana e sajë nuk është deklaruar në formularin e vetëdeklarimir asnjë punonjës me profil "hidroizules".*

**2- Shoqëria "C" sh.p.k,** për faktin se:

*Sipas shtojcës 1 është deklaruar vlera 34,284,415 lekë, ndërsa referuar preventivit të korrigjuar vlera e përllogaritur është 35,209,965 lekë, me një diferencë prej 925,550 lekë më e madhe se 2%.*

**3- B/OE "N" + "2" sh.p.k,** për faktin se:

*Nuk plotëson pikën 2.3.m të DST, ku asnjë nga shoqëritë nuk kanë vetëdeklaruar 1 punonjës gipsi nga 2 që kërkohen.*
*Shoqëria "N" sh.p.k, nuk përmbush pijen 2.3.p, ku certifikata ISO 9001/2015 dhe ISO 45001/2018 e paraqitur, pas verifikimit të sajë rezulton të jetë me status "pezulluar".*

**4- B/OE "M" + "M" sh.p.k,** për faktin se:

*Shoqëria "M" sh.p.k nuk plotësin pikën 2.2.b të DST, duke mos paraqitur asnjë nga bilancet e kërkuara.*
*Shoqëria "M" sh.p.k referuar marrëveshjes së bashkëpunimit mbulon 20% të vlerës së kontratës në përgjithësi, duke mos vetëdeklaruar asnjë punonjës të specializuar për realizimin e kontratës sipas DST. Nga asnjë nga 2 shoqëritë, nuk është disponon "nivelues për shtresa betoni dhe matrapik"(nga 2 që kërkohen është vetëdeklaruar 1).*

**5- B/OE "E" + "R" sh.p.k,** për faktin se:

[2] Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar)

*Shoqëria "E" sh.p.k, ku sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër punimet hidroizuluse dhe hidraulike", nuk vetëdeklaron asnjë punonjës me këto profile, kjo bazuar dhe në vendimin e KPP nr. 1129/2022, dhe nr. 2345/4, datë 22.11.2022.*

**6- Bashkimi i OE "L" + "V" sh.p.k,** për faktin se:

*Nuk përpmushur pikën 2.3.b, pasi nga shoqëria "V" referuar marrëveshjes së bashkëpunimit nuk ka paraqitur licencë profesionale të kërkuar në DST.*

**7- Shoqëria "E" sh.p.k,** për faktin se:

*Referuar ofertës ekonomike sipas shtojcës 1 ku paraqitet vlera 37,235,268 lekë, ndërsa referuar zërave të preventivit paraqitet oferta 38,607,268 lekë, me një diferencë prej 1,372,000 lekë, më e madhe se 2%.*

**8- Shoqëria "A" sh.p.k,** për faktin se:

*Referuar ofertës ekonomike sipas shtojcës 1 ku paraqitet vlera 43,360,440 lekë, ndërsa referuar zërave të preventivit paraqitet oferta 47,360,440 lekë, me një diferencë prej 3,821,660 lekë, më e madhe se 2%.*.

*Sipas grupit të auditimit, vlerësimi i KVO-së për OE e skualifikuar është i saktë dhe në përputhje me dispozitat e LPP, pasi OE nuk plotësonin kriteret e DST, të pasqyruara si më sipër.*

Nga të dhënat e PV të vlerësimit, KVO-ja ka konstatuar se oferta e paraqitur nga shoqëria "K" sh.p.k me vlerë 31,938,683 lekë është anomalisht të ulët.
Me shkresën nr. *S'ka*, datë 15.01.2024, KVO-ja i kërkon shoqërisë "K" sh.p.k argumentimin e ofertës anomalish të ulët. Me PV datë 18.01.2024, pas paraqitjes së dokumentacionit të shoqërisë "K" sh.p.k me shkresën nr. 14 *prot*, datë 16.01.2024 (*prot Bashkia Durrës nr. 513, dt. 18.01.2024),* KVO-ja vlerëson se argumenti i paraqitur është shoqëruar me dokumentacion jo të plotë dhe nuk argumenton çmimin e ofruar, **duke e skualifikuar shoqërinë "K" sh.p.k**
Nisur nga fakti se shoqëria "K" sh.p.k, nuk argumenton çmimin anomalish të ulët, KVO ka kualifikuar si të vlefshme ofertën e shoqërisë "A" sh.p.k me vlerë 34,954,350 lekë pa TVSH i radhitur i dyti në radhë.
Me shkresën datë 18.01.2024, KVO-ja i kërkon shoqërisë "A" sh.p.k që brenda 5 ditëve të paraqes dokumentacionin shoqërues sipas vetëdeklarimit, dokumentacion i cili është paraqitur datë 22.01.2024.
Me datë 25.01.2024 është bërë *njoftimi paraprak i fituesit*, shpallur në buletin e APP nr. 4, datë 29.01.2024.
Me shkresën nr. 1011, datë 31.01.2024 ( *prot bashkia Durrës nr. 1649, datë 01.2.2024*), nga shoqëria "K" sh.p.k është paraqitur ankesë në AK Durrës dhe KPP për skualifikim të padrejtë.
Me urdhër nr. 28, datë 2.2.2024, nga Titullari bashkia Durrës është ngritur KSHA me përbërje: *L.S.; I.H.; E.T.*.
Me shkresën nr. 1649/3 *prot*, datë 7.2.2024, KSHA-ja informon Titullarin e AK dhe Drejt/Shërbimeve Publike (*Sektorin e Prokurimeve),* se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë, të shprehur në vendimin nr. 1649/2 *prot*, datë 7.2.2024.
Me shkresën nr. 1649/4 *prot*, datë 8.2.2024, Titullari i AK bashkia Durrës, informon KPP mbi vendimin e KSHA.
Me vendim nr. 189/2024 *prot*, datë 16.2.2024, KPP informon AK Bashkia Durrës mbi ankesën e shoqërisë "K" sh.p.k, ku konkludon se pretendimet nuk qëndrojnë dhe KVO-ja duhet të vijojë me procedurën më tej.
Nga KVO-ja dhe me miratim të Titullarit të AK është hartuar dhe miratuar *Raporti Përmbledhës*.
Me shkresën nr. 1649/7 prot., datë 26.2.2024 është plotësuar *formulari i njoftim fituesit*, shpallur në buletin nr. 13, datë 4.3.2024.
Midis investitorit (Bashkia Durrës) përfaqësuar nga *z. E.J.* me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë (*sipas urdhrit nr. 66, datë 4.3.2024 për delegim kompetencash nga Kryetari i Bashkisë znj. E.S.*)

dhe investitorit shoqërisë "A" sh.p.k është lidhur kontrata nr. 1649/9 *prot*, datë 13.3.2024 për zbatimin e punimeve në afatin 105 ditë nga data e fillimit.

**Vlerësimi i procedurës:** *Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer veprime në zbatim të akteve te ligjore e nënligjore të LPP, pasi si skualifikimet dhe shpallja fitues i shoqërisë "A" sh.p.k është në përputhje me kriteret e DST të miratuara nga AK.*

**2- Auditim i procedurës me objekt:** ” *Rikonstruksion shkolla “Dom Nikoll Kaçorri”.*

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion shkolla “Dom Nikoll Kaçorri”</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>“E hapur”<br>REF-56583-01-23-2023<br>Urdhri nr. 58/1 prot., datë 9.01.2023</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)<br>Urdhri nr. 58 prot., datë 5.01.2023<br>4. A.T.<br>5. B.M.<br>6. J.K.<br>7. A.K.<br>8. M.J.</td><td>2 Njësia e Prokurimit nr. 58/1, dt. 9.01.2023<br>1. A.Xh.<br>2. V.S.<br>3. A.T.<br>Me urdhër nr. 45, dt. 17.01.2023 për ndryshimin e një anëtari, konkretisht V.S. është zëvendësuar me I. F.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhri nr. 58/2 prot., datë 9.01.2023.<br>1. G.K.<br>2. L.S.<br>3. V.S.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)<br>53,286,043 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)<br>38,025,220 lekë<br>Fitues: OE "N" sh.p.k</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)<br>15,261 mijë lekë ose 28.6%</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:<br>Data 8.2.2023<br>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 157 ditë.</td><td colspan="2">8. Burimi FI.ncimit<br>Të ardhurat e Bashkisë Durrës për vitin 2023, miratuar me VKB Nr. 150, datë 22.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Durrës për vitin 2023 (e ndryshuar)”.</td><td>9. Operatoret Ekonomike<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 25 B/OE<br>b) S’kualifikuar 15 B/OE,<br>c) Kualifikuar 10 B/OE</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime<br>AK-s’ka/ka; -Jo<br>APP–s’ka/ka;-Jo<br>KPP-s’ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:<br>Data: 13.3.2023</td><td>12.Data e lidhjes së kontratës:<br>Nr. 58/5, datë 24.3.2023</td></tr>
</table>

**Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit “*për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*” datë 5.7.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se njësia e prokurimit për hartimin dhe argumentimin e kritereve referuar dhe rekomandimit të APP, nga AK për kriteret janë bërë ndërhyrjet duke i përmisuar ato, dhe nga grupi janë vlerësuar si kritere të drejta në procedurën e zhvilluar.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Referuar të dhënave të Procesverbalit (PV) datë 08.02.2023, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë **25** OE, si më poshtë vijon:

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | A. | 34,697,721 | Skualifikuar |
| 2 | N. | 38,025,270 | Kualifikuar / fitues |
| 3 | C. | 38,088,705 | Skualifikuar |
| 4 | K.C. | 39,941,359 | Kualifikuar |
| 5 | E.-ALB + S. 2F | 41,656,405 | Skualifikuar |
| 6 | MF I. + I.C.C.G. | 41,875,167 | Skualifikuar |
| 7 | R...c. + D.C. | 42,371,299 | Skualifikuar |
| 8 | "A" | 42,628,385 | Kualifikuar |
| 9 | Z. | 42,668,668 | Kualifikuar |
| 10 | 2 N | 42,922,840 | Kualifikuar |
| 11 | C... + K.M.K | 43,261,265 | Kualifikuar |
| 12 | XH. | 43,521,662 | Skualifikuar |
| 13 | B.C. | 44,214,703 | Skualifikuar |
| 14 | K. | 44,215,774 | Kualifikuar |
| 15 | T & XH | 44,531,520 | Skualifikuar |
| 16 | K. | 45,227,498 | Skualifikuar |
| 17 | I. | 45,569,148 | Skualifikuar |
| 18 | K. | 45,605,397 | Kualifikuar |

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 19 | C. | 46,096,891 | Kualifikuar |
| 20 | L...VII | 46,751,425 | Skualifikuar |
| 21 | BE-SI | 47,474,487 | Skualifikuar |
| 22 | B. | 48,208,672 | Skualifikuar |
| 23 | E. 2000 | 49,029,734 | Skualifikuar |
| 24 | P.G. | 48,317,759 | Kualifikuar |
| 25 | E.-VL | 0 | Skualifikuar |

Sipas PV datë 20.02.2023 nga **25** OE pjesëmarrës në garë, nga KVO-ja janë skualifikuar **15** OE dhe janë kualifikuar **10** OE, sipas të dhënave të paraqitura në tabelën sipër.

- **Janë skualifikuar B/OE, si më poshtë vijon**:

**1- Shoqëria "A" sh.p.k,** nuk përmbush kriteret e pikave 2.3.c; 2.3.d; 2.3.e; 2.3.f, pasi një pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve janë të angazhuara në kontratën me objekt: *"LOTI II: Riforcim pallate me kod 19051; 19142; 21263 dhe riforcim banesash individuale në njësinë administrative Sukth"***.**

**2- Shoqëria "C" sh.p.k,** nuk përmbush kriteret e pikave 2.3.c; 2.3.d; 2.3.e; 2.3.f, pasi një pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve janë të angazhuara në kontratën me objekt: *"Riforcim godI. 37,39, lagje 13 pranë pistës Iliria me kod gis 5934; 5933"***.**

**3- B/OE "E" + "S" sh.p.k,** nuk përmbush kriteret e pikave 2.3.c; 2.3.d; 2.3.e; 2.3.f, pasi një pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve janë të angazhuara në kontratën me objekt: *"L.III; Riforcim godI. banime 12-13 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, Rruga Jahja Ballhysa nr. 6, gis 3092 (Jedasi)"*.

**4- B/OE "M" + "I" sh.p.k,** nuk plotëson pikën 2.3.e të DT, pasi referuar kontratës së bashkëpunimit, shoqëria "M" sh.p.k ka marrë përsipër punime murature dhe nuk ka vetëdeklaruar asnjë murator. Në të njëjtën kohë shoqëria "I" sh.p.k ka marrë përsipër të gjitha punimet e hidroizolimit dhe hidraulike dhe ka deklaruar 1 hodroizolues nga 2 që kërkohen dhe 1 hidraulik nga 2 që kërkohen (*kjo sipas vendimit të KPP nr. 1129/2022 me nr. 2345/4, datë 22.11.2022).*

**5- B/OE "R" + "D" sh.p.k,** nuk plotëson pikën 2.3.c; 2.3.d; 2.3.e të DT, pasi një pjesë e punonjësve të shoqërisë "R" sh.p.k janë të angazhuara në kontratën me objekt :*" Ndërtim kanali KUZ në rrugën Gjergj Balsha"*. Gjithashtu referuar marrëveshjes së bashkëpunimit shoqëria "R" sh.p.k, ka marrë përsipër punime hidraulike, por që nuk ka deklaruar asnjë punonjës me profil hidraulik.

**6- Shoqëria "X" sh.p.k,** sipas shtojcës 8 ka vetëdeklaruar punonjës të kualifikuar/specializuar dhe mjete/pajisje nga subjekti mbështetës "C" sh.p.k, në kundërshtim me pikën 2.16 të DST, në të cilën AK nuk lejon opsionin e mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera, duke e bërë ofertën e pavlefshme.

**7- Shoqëria "B" sh.p.k,** nuk përmbush pikën 2.3.f të DST, për deponimin e mjeteve dhe pajisjeve, pasi ato nuk kanë asnjë të dhënë në formularin e vetëdeklarimit. Në formularin e ofertës është paraqitur vlera 44,214,703 lekë, por referuar preventivit vlera e përllogaritur është 45,265,503 lekë, me një diferencë prej 1,050,800 lekë, në kundërshtim me nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.2.2021, pika (c).

**8- Shoqëria "T" sh.p.k,** për faktin se nuk përmbush kriteret e pikave 2.3.c; 2.3.d; 2.3.e; 2.3.f, pasi një pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve janë të angazhuara në kontratën me objekt: *"Riforcim i godinës banimi 8 kate+bodrum, lagj 13, rruga "Egnatia", kod gis 27258"*.

**9- Shoqëria "K" sh.p.k,** në formularin e ofertës është vlera 45,227,498 lekë, ndërsa referuar preventivit vlera e përllogaritur është 46,487,497 lekë, me një diferencë prej 1,259,999 lekë në kundërshtim me nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.2.2021, pika c.

**10- Shoqëria "I" sh.p.k,** për faktin se nuk përmbush kriteret e pikave 2.3.c; 2.3.d; 2.3.e; 2.3.f, pasi një pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve janë të angazhuara në kontratën me objekt: *"L.VI: Riforcim pallati me kod gis 1023;1025"*.

**11- Shoqëria "L" sh.p.k,** sipas shtojcës 8 ka vetëdeklaruar punonjës të kualifikuar/specializuar dhe mjete/pajisje nga subjekti mbështetës "C" + "S" sh.p.k, e cila bie në kundërshtim me pikën 2.16 të DST, në të cilën AK nuk lejon opsionin e mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera, duke e bërë ofertën e pavlefshme, etj.;
**12- Shoqëria "B" sh.p.k,** sipas shtojcës 8 ka vetëdeklaruar punonjës të kualifikuar/specializuar dhe mjete/pajisje nga subjekti mbështetës "2" sh.p.k, e cila bie në kundërshtim me pikën 2.16 të DST, në të cilën AK nuk lejon opsionin e mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera, duke e bërë ofertën e pavlefshme, etj.
**13- Shoqëria "B" sh.p.k,** për faktin se nuk përmbush kriteret e pikave 2.3.c; 2.3.d; 2.3.e; 2.3.f, pasi një pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve janë të angazhuara në kontratën me objekt: *"Rikonstruksion rruga C.la segmenti Hotel Ferra- Guest Haus"*.
**14- Shoqëria "E" sh.p.k,** nuk plotëson pikën 2.3.d, pasi për stafin mbështetës nuk ka deklaruar teknik ndërtimi.
**15- Shoqëria "E" sh.p.k,** nuk ka paraqitur ofertë.
Sipas KVO, oferta anomalish e ulët është në vlerën 37,032,449 lekë.
Në këto kushte KVO-ja ka klasifikuar në vend të parë shoqërinë "N" sh.p.k me ofertë 38,025,270 lekë.
Me shkresën nr. S'ka, datë 20.2.2023, KVO-ja i ka kërkuar shoqërisë "N" sh.p.k me Nip "J25", të paraqesë dokumentacioni origjI.l ose fotokopje të noteriale sipas formularit të vetëdeklarimit.
Me datë 2.3.2023, nga KVO-ja është bërë inventarizimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria "N" sh.p.k
Ma datë 2.3.2023 është plotësuar formulari i *njoftim fituesit (paraprak),* shpallur në buletin APP nr. 21, datë 6.3.2023. Me shkresën nr. 58/3prot, datë 13.3.2023 është hartuar *Raporti Përmbledhës* i nënshkruar titullari i AK zj. E.S.. Me shkresën nr. 58/4prot, datë 13.3.2023 është hartuar formulari i *njoftim fituesit*, shpallur në buletinin e APP nr. 26, datë 20.3.2023.
Kontrata midis investitorit (Bashkia Durrës) dhe sipërmarrësit të punimeve (shoqëria "N" sh.p.k) është nënshkruar me nr. 58/5 *prot*, datë 24.3.2023, me afat 157 ditë nga data e fillimit të punimeve.

**Vlerësimi i procedurës**. *Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer veprime në zbatim të akteve te ligjore e nënligjore të LPP, pasi si skualifikimet dhe shpallja fitues i shoqërisë "N" sh.p.k është në përputhje me kriteret e DST të miratuara nga AK.*

**3- Auditim i procedurës me objekt** " *Rehabilitim i zonës që preket nga zgjerimi territorit të varrezave të qytetit të Durrësit".*

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitim i zonës që preket nga zgjerimi territorit të varrezave të qytetit të Durrësit"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur"<br>REF-59060-02-14-2023<br>Urdhri nr. 68/1prot., datë 12.01.2023</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)<br>Urdhri nr. 13 prot., datë 5.01.2023<br>G.D.<br>M.Z<br>L.F.<br>A.K.</td><td>2 Njësia e Prokurimit<br>nr. 68/1prot., datë 12.01.2023<br>1. A.Xh.<br>2. E.Gj.<br>3. A.T.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhri nr. 35 prot., datë 12.01.2023.<br>1. G.K.<br>2. B.M.<br>3. M.B.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)<br>240,000,000 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)<br>231,059,829 lekë<br>Fitues: B/OE "B" + "A" sh.p.k</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)<br>8,941 mijë lekë ose 3.75%</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:<br>Data 2.3.2023</td><td colspan="2" rowspan="2">8. Burimi FI.ncimit<br>Të ardhurat e Bashkisë Durrës për vitin 2023, miratuar me VKB Nr. 150, datë 22.12.2022 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Durrës për vitin 2023 (e ndryshuar)".</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 5 B/OE<br>b) S'kualifikuar 4 B/OE,<br>c) Kualifikuar 1 B/OE</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 720 ditë.</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime AK-s'ka/ka; -Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:<br>Data: 26.4.2023 nr. 68/4 prot.</td><td>12.Data e lidhjes së kontratës:<br>Nr. 68/5 prot, datë 5.5.2023</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| **APP–**s'ka/ka**;-Jo**<br>**KPP**-s'ka/ka;-**Jo** | | |

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në referim të PV datë 9.3.2023 është bërë hapja procedurës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë **5 OE**, si më poshtë vijon::

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | B.-I. + C. | 203,812,665 | Skualifikuar |
| 2. | B.K. + A. C. | 231,059,829 | Kualifikuar /fitues |
| 3. | A.I.C. | 238,700,543 | Skualifikuar |
| 4. | A.L-A. + E. H. (dega në Shqipëri) | 238,700,543 | Skualifikuar |
| 5. | 2 T | 239,708,175 | Skualifikuar |

Sipas PV datë 24.3.2023 nga 5 OE pjesëmarrës në garë, nga KVO-ja janë skualifikuar 4 OE, duke kualifikuar 1 OE, respektivisht B/OE "B" + "A" sh.p.k, sipas të dhënave të paraqitura në tabelën sipër.

- **<u>Janë skualifikuar B/OE, si më poshtë vijon</u>:**

**1- JV "B" + "C" sh.p.k**, për faktin se:

*Nuk përmbush pikën 2.3.g.8 të KT për deponimin e mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara, duke mos deklaruar në formularin e vetëdeklarimit mjetin "Agregat hidraulik për pastrimin vegjetacionin e bimësisë d-10 cm (krah hidraulik decespugliato me peshë jo më pak se 150 kg). Sipas vetëdeklarimit është deklaruar aparat teknologjik për pastrime me targë TR....R për përmbushjen e kërkesës sipas pikës 2.3.g.8, ku nga 2 mjetë është deklaruar vetëm një. Nuk plotëson pikën 2.3.g.21 për automjet teknologjik për inspektimin e kolektorëve me diametër (250÷600) mm e pajisur me sistem kamerash;*
*Nuk plotëson pikën 2.3.g.23, pasi nuk ka deklaruar "Makineri për ndërtim mikrotunel d=110 mm me lazer, për kalim tubi poshtë rrugës, etj.* **Nga verifikimi bërë nga grupi i auditim, rezulton se skualifikimi është i saktë.**

**2- JV "A.L A." + "E" sh.p.k,** , për faktin se:

*1. Nuk përmbush Kapacitetin Teknik pika 2.3.g.(8,19,20,21,22,23)* ***OE "E"*** *sh.p.k Dega ne Shqipëri nuk ka deklaruar kapacitetet teknike te nevojshme për kryerjen e punimeve të mara përsipër ne aktmarrëveshjen e bashkëpunimit (A.L-"A" sh.p.k 60 %, "E" sh.p.k Dega ne Shqipëri 40 %, për çdo zë ne preventivin e punimeve), ku:*
*- Mungon kapaciteti teknik 2.3.G.8, "Agregat hidraulik për pastrim vegjetacioni e bimësie d~10 cm (krah hidraulik decespugliator me peshe jo me pak se 150 kg)" për realizimin e "Prerje bime te vogla ø-10cm me agregat hidraulik (decespugliator)";*
*- Mungon kapaciteti teknik 2.3.G.19, "Automjet teknologjik për pastrimin e kolektorëve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartës (9-12 ton), me ndarje membranë të lëvizshme (ndryshim volumi ujë/material i ngurtë), e pajisur me pompë pastrimi me presion pune jo më pak se 170 bar, prurje jo me pak se 330 litra/minut dhe dy sonda me gjatësi me te madhe se 80m, e pajisur me pompe vakumi për thithjen e materialeve te ngurta me kapacitet jo me te vogël se 1500 m3/ore." për realizimin e "Pastrim kolektori Ø (250 ÷ 600) me automjet teknologjik për pastrimin e kolektorëve" dhe "Transport i llumit me automjet teknologjik deri ne 5 km";*
*- Mungon kapaciteti teknik 2.3.G.20,* ***"****Automjet teknologjik për pastrimin e kolektorëve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartës (2-4 ton), me ndarje membranë të lëvizshme (ndryshim volumi ujë/material i ngurtë), e pajisur me pompë pastrimi me presion pune, jo më pak se 200 bar, prurje jo më pak se 60 litra/minut dhe dy sonda me gjatësi më të madhe se 70 m, e pajisur me pompë vakumi për thithjen e materialeve të ngurta" për realizimin e "Pastrim kolektori Ø (250 ÷ 600) me automjet teknologjik për pastrimin e kolektorëve" dhe "Transport i llumit me automjet teknologjik deri ne 5 km";*
*- Mungon kapaciteti teknik 2.3. G.21, " Automjet teknologjik për inspektimin e kolektorëve me diametër (250÷600) mm e pajisur me sisteme kamerash" për realizimin e inspektimit punimeve te kryera" Pastrim kolektori Ø (250 ÷ 600) me automjet teknologjik për pastrimin e kolektorëve";*
*- Mungon kapaciteti teknik 2.3.G.22, "Makine shpimi horizontale për instalim tubi me çarje për zëvendësim kolektorësh ekzistues Ø (250 ÷ 600), (Pipe bursting)" për realizimin e inspektimit punimeve te kryera "Instalim tubi me çarje për zëvendësim kolektorësh ekzistues Ø (250 ÷ 600), (Pipe bursting)";*
*- Kapaciteti teknik 2.3.G.23,* ***"****Makineri për ndërtim mikrotunel D=110mm me lazer, për kalim tubi poshtë rrugës." për realizimin e inspektimit punimeve te kryera "Mikrotunel D=110 mm, poshtë rrugës për kalimin e tubit te polietilenit PEHD+ rakorderi, për lidhjen e rrjetit te ri te ujësjellësit ne rrjetin ekzistues".*
*2. Nuk përmbush piken 2.3.j te Kapacitetit Teknik ku citohet se "OE në konkurrim duhet të jetë i pajisur me licencë nga Qendra Kombëtare e licencimit (QKL) Kodi III.2.B "Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte", pasi*

*subjekti "E" sh.p.k Dega ne Shqipëri ka marre përsipër 40% te te gjithë zërave te preventivit, dhe nuk ka paraqitur licencën përkatëse te sipërcituar***. Nga verifikimi bërë nga grupi i auditim, rezultoi se skualifikimi është i saktë.**

**3. Për ofertuesin** "2", për faktin se:

*1. Nuk përmbush piken 2.3.g.14 dhe 2.3.g.15 te Kapacitetit Teknik për deponimin e mjeteve dhe pajisjeve te kërkuara, ku citohet "Auto betoniere vetëngarkuese me peshe jo me te vogël se 5.5 ton - cope 2; Auto betoniere vetëngarkuese me peshe jo me te vogël se 5.5 ton – cope 2", pasi ne përmbushje te këtij kriteri, ka vetedeklaruar ne total 2 mjete nga 4 te kërkuara.*
*2. Nuk përmbush piken 2.3.g.19 te Kapacitetit Teknik për deponimin e mjeteve dhe pajisjeve te kërkuara, ku citohet "Automjet teknologjik për pastrimin e kolektorëve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartës (9-12 ton), me ndarje membranë të lëvizshme (ndryshim volumi ujë/material i ngurtë), e pajisur me pompë pastrimi me presion pune jo më pak se 170 bar, prurje jo me pak se 330 litra/minut dhe dy sonda me gjatësi me te madhe se 80m, e pajisur me pompe vakumi për thithjen e materialeve te ngurta me kapacitet jo me te vogël se 1500 m3/ore - cope 1", pasi nuk ka vetdeklaruar asnjë mjet ne përmbushje te këtij kriteri.*
*3. Nuk përmbush piken 2.3.g.20 te Kapacitetit Teknik për deponimin e mjeteve dhe pajisjeve te kërkuara, ku citohet "Automjet teknologjik për pastrimin e kolektorëve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartës (2-4 ton), me ndarje membranë të lëvizshme (ndryshim volumi ujë/material i ngurtë), e pajisur me pompë pastrimi me presion pune, jo më pak se 200 bar, prurje jo më pak se 60 litra/minut dhe dy sonda me gjatësi më të madhe se 70 m, e pajisur me pompë vakumi për thithjen e materialeve të ngurta - cope 1", pasi nuk ka vetdeklaruar asnjë mjet ne përmbushje te këtij kriteri.*
*4. Nuk përmbush piken 2.3.g.21 te Kapacitetit Teknik për deponimin e mjeteve dhe pajisjeve te kërkuara, ku citohet "Automjet teknologjik për inspektimin e kolektorëve me diametër (250÷600) mm e pajisur me sisteme kamerash - cope 1", pasi nuk ka vetdeklaruar asnjë mjet ne përmbushje te këtij kriteri.*
*5. Nuk përmbush piken 2.3.g.22 te Kapacitetit Teknik për deponimin e mjeteve dhe pajisjeve te kërkuara, ku citohet "Makine shpimi horizontale për instalim tubi me çarje për zëvendësim kolektorësh ekzistues Ø (250 ÷ 600), (Pipe bursting) - cope 1", pasi nuk ka vetdeklaruar asnjë mjet ne përmbushje te këtij kriteri.* **Nga verifikimi bërë nga grupi i auditim, rezultoi se skualifikimi është i saktë.**

**4**. **Për shoqërinë "A"**, për faktin:

*1. Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës se kërkuar.*
*2. Nuk përmbush piken 2.3.a te Kapacitetit Teknik, ku citohet se "OE duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 120'000'000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 480'000'000 lekë. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme", pasi pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur ne përmbushje te këtij kriteri, nuk plotësohet vlera minimale e kërkuar ne pikat a) dhe b).*
*3. Nuk përmbush piken 2.3.b te Kapacitetit Teknik për kategoritë e kërkuara ne licencën profesionale te shoqërisë për zbatimin e punimeve objekt kontrate, pasi nuk disponon kategorinë NS 8-A (Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri).*
*4. Nuk përmbush piken 2.3.c te Kapacitetit Teknik, pasi ne përmbushje te këtij kriteri nuk ka paraqitur Inxhinier Gjeoteknik 1(një); Inxhinier Gjeoded 1(një); Inxhinier Hidroteknik 1(një); Inxhinier Mjedisi 1(një).*
*5. Nuk përmbush piken 2.3.d te Kapacitetit Teknik, ku citohet se "OE, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: Inxhinier Ndërtimi 1 (një); Inxhinier Hidroteknik 1 (një); Inxhinier Mekanik 1 (një); Teknik Ndërtimi 2 (dy); Punonjës 1 (një), pajisur me certifikatë për "Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplomë/certifikatë si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të muajit të fundit; Punonjës 1 (një), pajisur me certifikatë për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetin në punë" në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplome/certifikate si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë; Mjek Epidemiolog 1 (një) për mbikëqyrjen e kryerjes së punimeve për përforcim e rikonstruksion varreza ekzistuese në zonat me rrëshqitje aktive (në mbështetje të VKM Nr. 711, datë 29.10.2014 dhe Udhëzimit Nr. 4, datë 9.12.2015), shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplomë mjeku /specializim, të figurojë në listëpagesat e shoqërisë; Punëtorë te thjeshte 15 (pesëmbëdhjetë)", pasi ne përmbushje te këtij kriteri ka paraqitur vetëm staf mbështetës inxhinier mekanik, teknik ndërtimi (1 nga 2 te kërkuar), dhe mjek.*
*6. Nuk përmbush piken 2.3.e te Kapacitetit Teknik, ku citohet se "OE duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Manovratorë për mjete ndërtimi 2 (dy); Drejtues Mjeti 2 (dy); Murator 2 (dy); Hekurkthyes 2 (dy); Saldator 1 (një); Hidraulik 1 (një)", pasi ne përmbushje te këtij kriteri ka deklaruar 1 hekurkthyes nga 2 te kërkuar.*

*7. Nuk përmbush piken 2.3.g te Kapacitetit Teknik për dispononim e mjeteve dhe pajisjeve, me konkretisht pikat 1, 3, 4, 5, 6, 8, 11, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, pasi nuk ka vetedeklaruar asnjë nga mjetet dhe pajisjet e kërkuara sipas pikave te mësipërme.* **Nga verifikimi bërë nga grupi i auditim, rezulton se skualifikimi është i saktë.**

Sa më sipër JV "B" + "A" sh.p.k me adresë Vlore Velçë + Fier Sheq i Madh, oferta e paraqitur me vlerë 231,059,829 lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme, pasi plotëson kriteret e DST, sipas KVO.
Ankesa pas **nuk ka.**
Me shkresën *nr. S'ka, datë 24.3.2023*, KVO-ja i ka kërkuar JV "B" + "A" sh.p.k, të paraqesë dokumentacioni origjI.l ose fotokopje noteriale sipas formularit të vetëdeklarimit. Me datë 7.4.2023, nga KVO-ja është bërë verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga JV "B" + "A" sh.p.k
Me datë 11.4.2023 është plotësuar formulari i *njoftim fituesit (paraprak),* shpallur në buletin APP nr. 34, datë 18.4.2023. Me shkresën nr. 68/3 *prot*, datë 25.4.2023 është hartuar *Raporti Përmbledhës* i nënshkruar titullari i AK zj. E.S..
Me shkresën nr. 68/4 *prot*, datë 26.4.2023 është hartuar formulari i *njoftim fituesit (përfundimtar),* shpallur në buletinin e APP nr. 39, datë 2.5.2023.
Kontrata midis investitorit (Bashkia Durrës) dhe sipërmarrësit të punimeve (JV "B" + "A" sh.p.k) është nënshkruar me nr. 68/5 *prot*, datë 5.5.2023, me afat 702 ditë nga data e fillimit të punimeve.

**Sipas këtij procesverbali (datë 24.3.2023), rezultoi se z. G.K. në cilësinë e anëtarit të KVO të mos ketë nënshkruar me pretendimin se vlerësimi nuk është i drejtë dhe është kundra kualifikimit të JV "B" + "A" sh.p.k,** duke argumentuar se:
**a- Nuk përmbush pikën 2.3.e të DST**, ku kërkohet që *"OE duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar si: manovrator për mjete ndërtimi dy; drejtues mjetesh dy; murator dy; hekurkthyes dy; saldator një; hidraulik një".* Referuar kushteve të kontratës së bashkëpunimit dhe zërave të preventivit të marrë përsipër nga secili prej shoqërive, rezulton se shoqëria "B" sh.p.k, ka marrë përsipër shërbim transporti dhe nuk deklaron asnjë drejtues mjeti. Gjithashtu, sipas zërave të preventivit i nevojitet manovrator, por që nuk ka deklaruar asnjë punonjës manovrator.
Mos plotësimi i këtyre kritereve është mangësi, kjo referuar dhe vendimit të KPP nr. 1129/2022 me nr. 2345/4 *prot*, datë 22.11.2022.
Nga JV "B" + *"A"* sh.p.k, nuk plotësohet **pika 2.3.g.15,** pasi nga 2 autobetonjere që kërkohen me peshë jo më te vogël se 20 ton është paraqitur vetëm një, kjo nga shoqëria "B" sh.p.k, konkretisht mjeti me targë LA9492A me kontratë qiraje nr. 964 kol/316 rep, datë 7.3.2023 me shoqërinë "A" sh.p.k Ndërsa mjetet e tjera të vetëdeklaruara nga shoqëria "A" sh.p.k, nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara me peshë jo më të vogël se 20 ton, konkretisht mjeti me targë AA7...YJ me tonazh 16.1 ton dhe mjeti me targë FR1...D me targë 8.9 ton.
**Si konkluzion**, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se nuk ka vlerësuar drejt shoqëritë pjesëmarrëse në garë, pasi KVO-ja duhet të kishte skualifikuar dhe *JV "B" + "A" sh.p.k*, për mos plotësim të kritereve, dhe në kushtet kur në garë nuk ka OE të tjerë, KVO-ja duhej t'i propozonte Titullarit të AK pezullimi i procedurës, duke evidentuar shkaqet dhe hedhur ne sistem të një procedure tjetër, veprimet në kundërshtim me LPP, dhe **ngarkohen me përgjegjësi:** *B.M., M.B.*, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik*"* i ndryshuar, neni 2, neni 3 pika 1, neni 92 pika 3, 4.

**4- Auditim i procedurës me objekt:** ” *Rikonstruksion rruge në NJA Katundi i Ri”.*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *“Rikonstruksion rruge në NJA Katundi i Ri”* | | | |
|---|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>“E hapur”<br>REF-64167-03-29-2023<br>Urdhri nr. 131/1prot., datë 27.3.2023 | **1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)**<br>Urdhri nr. 79prot., datë 14.2.2023<br>1. E.T.<br>2. B.M.<br>3. A.K. | **2 Njësia e Prokurimit** nr. 131/1prot., datë 27.3.2023<br>1. I.F.<br>2. E. Gj.<br>3. A. T. | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhri nr. 131 prot., datë 27.3.2023.<br>1. K.Dh.<br>2. A.I.<br>3. K.B. |
| **4. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>16,666,285 lekë | **5. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>11,512,400 lekë<br>Fitues: OE "C" sh.p.k | | **6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>5,154 mijë lekë ose 30.9% |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 14.4.2023 | **8. Burimi FI.ncimit**<br>Të ardhurat e Bashkisë Durrës për vitin 2023, miratuar me VKB Nr. 150, datë 22.12.2022 *“Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Durrës për vitin 2023 (e ndryshuar)*”. | | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **7 B/OE**<br>b) S’kualifikuar 0 B/OE,<br>c) Kualifikuar 7 B/OE |
| **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:**<br>35 ditë. | | | |
| **10.Ankimime**<br>**AK-**s’ka/ka**; -Jo**<br>**APP–**s’ka/ka**;-Jo**<br>**KPP-**s’ka/ka;-**Jo** | **11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:**<br>Data: 8.5.2023 nr. 1623/5 prot. | | **12.Data e lidhjes së kontratës:**<br>Nr. 1792/5 prot, datë 01.6.2023 me afat zbatimi 35 ditë |

**Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezultoi se në dosjen e procedurës nuk ishte i depozituar “*leje ndërtimi/infrastrukture*”, në kundërshtim të hapur me nenin 39 pika 3 të Ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, dhe **ngarkon me përgjegjësi:** *Titullari i Bashkisë (E.S.) dhe Sipërmarrësi punimeve*.

**AK (NjHST) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të dosjes fizike, procesverbalit datë 10.01.2023 “*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*” dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se nuk ka kritere të paargumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës, dhe në përputhje me kuadrin ligjorë të LPP**.**

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në referim të PV datë 14.4.2023 është bërë hapja procedurës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 7 OE, si më poshtë vijon:

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | C. M | 11,512,400 | Kualifikuar |
| 2. | S.M.O U. | 12,388,100 | Kualifikuar |
| 3. | E. 2000 | 13,826,100 | Kualifikuar |
| 4. | "A". | 14,496,960 | Kualifikuar |
| 5. | B. | 15,862,950 | Kualifikuar |
| 6. | V. + K.-D. | 12,945,240 | Kualifikuar |
| 7. | S. | 16,235,766 | Kualifikuar |

Sipas PV datë 18.4.2023 nga 7 OE pjesëmarrës në garë, nga KVO-ja janë skualifikuar 0 (zero) OE dhe janë kualifikuar 7 OE, pasi të gjithë OE pjesëmarrës plotësonin kriteret e DST.
Sipas këtij PV, nga KVO-ja është vlerësuar në vend të parë OE "C" sh.p.k me ofertë më të leverdishme se OE e tjerë të mbetur ne garë, duke vlerësuar ofertën 11,512,400 lekë, por që është anomalish e ulët, duke i kërkuar sqarim mbi ofertën deri datë 20.4.2023.
Me shkresën nr. 18, datë 20.4.2023 *(hyrë bashkia Durrës nr. 3371 prot, datë 20.4.2023),* nga shoqëria "C" sh.p.k është kthyer përgjigje mbi ofertën anomalish të ulët, duke dhënë dhe sqarimet e nevojshme.

Sipas PV datë 20.4.2023, KVO-ja pasi shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria "C" sh.p.k për ofertën anomalish të ulët, konkludon se pranon si të vlefshme shpjegimet e ofertës, duke e kualifikuar.
*Njoftim fituesi paraprak* mban datën 26.4.2023, shpallur në buletinin e APP nr. 39, datë 2.5.2023.
Në përfundim të afateve të ankimimit nga KVO-ja me datë 8.5.2023 dhe nr. 1792/3 *prot*, është hartuar *Raporti Përmbledhës*, i cili është miratuar nga Titullari i AK zj. E.S..
Me shkresën nr. 1792/4 *prot*, datë 9.5.2023 është hartuar *formulari i njoftim fituesit përfundimtar*, shpallur në buletin e APP nr. 43, datë 15.5.2023.
Në përfundim ndërmjet investitorit (Bashkia Durrës) përfaqësuar nga zj. E.S. dhe shoqërisë së ndërtimit "C" sh.p.k, është lidhur kontrata nr. 1792/5 *prot*, datë 01.6.2023 për zbatimin e punimeve në afatin e 35 ditë nga dita e nënshkrimit për vlerën 11,512,400 lekë pa TVSH.

**Vlerësimi i procedurës**. *Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer veprime në zbatim të akteve te ligjore e nënligjore të LPP, pasi si skualifikimet dhe shpallja fitues i shoqërisë "C" sh.p.k është në përputhje me kriteret e DST të miratuara nga AK.*

**5- Auditim i procedurës me objekt:** ” *Rikonstruksion rruge në NJA Ishëm”.*

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion rruge në NJA ISHËM”</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>“E hapur”<br>REF-64546-04-01-2023<br>Urdhri nr. 2628/2 prot., datë 31.3.2023</td><td colspan="2">1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)<br>Urdhri nr. 2628/2 prot., datë 31.3.2023<br>1. B.M.<br>2. O.G.<br>3. E.T.</td><td>2 Njësia e Prokurimit<br>nr. 2628/2 prot., datë 31.3.2023<br>1.A.Xh.<br>2.E. Gj.<br>3. A.T.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhri nr. 144 prot., datë 31.3.2023.<br>1. G.K.<br>2. R.D.<br>3. L.S.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)<br>16,666,597 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)<br>14,751,950 lekë<br>Fitues: OE "A" sh.p.k</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)<br>1,915 mijë lekë ose 88.5%</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:<br>Data 18.4.2023<br><br>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 21 ditë.</td><td colspan="2">8. Burimi FI.ncimit<br>Të ardhurat e Bashkisë Durrës për vitin 2023, miratuar me VKB Nr. 150, datë 22.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Durrës për vitin 2023 (e ndryshuar)”.</td><td>9. Operatoret Ekonomike<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 10 B/OE<br>b) S’kualifikuar 8 B/OE,<br>c) Kualifikuar 2 B/OE</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime<br>AK-s’ka/ka; -Jo<br>APP–s’ka/ka;-Jo<br>KPP-s’ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:<br>Data: 26.5.2023 nr. 2628/5 prot.</td><td>12.Data e lidhjes së kontratës:<br>Nr. 2628/6 prot, datë 19.6.2023 me afat zbatimi 21 ditë</td></tr>
</table>

**Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezultoi se në dosjen e procedurës nuk ishte e depozituar “*leje ndërtimi/infrastrukture*”, në kundërshtim të hapur me nenin 39 pika 3 të Ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, *ngarkohet me përgjegjësi: Titullari i Bashkisë, dhe Sipërmarrësin e punimeve***.**

**Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të dosjes fizike, procesverbalit datë 10.01.2023 “*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*” dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se nuk ka kritere të paargumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës, dhe në përputhje me kuadrin ligjorë të LPP.
**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në referim të PV datë 18.4.2023 është bërë hapja procedurës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 10 OE, si më poshtë vijon:

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | K.M.K/ L. | 11,073,400 | ***Skualifikohet:*** *Nuk argumenton ofertën anomalish të ulët* |
| 2 | C. M/ L. | 12,244,340 | ***Skualifikohet***: *Nuk plotësohet pika 2.3.c,d,e,g, pasi një pjesë e mjeteve dhe punonjësve janë të angazhuara në kontratën me objekt "FV ndriçim rruga "Bajram Tisha"* |
| 3 | S.M.O U./ J. | 12,424,300 | ***Skualifikohet***: *Nga verifikimi i dosjes fizike është konstatuar se disa nga dokumentet nuk bashkëshoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, konkretisht:*<br>*-Nuk paraqet vërtetim mbi pagesën e energjisë elektrike;*<br>*-Nuk paraqet vërtetim që nuk është i dënuar për asnjë nga veprat penale që parashikon pika 1 e nenit 76 të LPP;*<br>*-Nuk përmbush pikën 2.2.a, pasi nuk ka paraqitur vërtetim mbi pagesën e taksave lokale bashkia Mirditë; Durrës, si dhe nga verifikimi në sistem e DTTV bashkia Durrës rezulton debitorë;*<br>*-Nuk përmbush pikën 2.3.g, pasi mjeti me targë AA032RI nuk ka bashkëlidhur licencën/certifikatën e transportit sipas kërkesave të DST* |
| 4 | E.2000/ K. | 13,169,700 | ***Skualifikohet***: *Nuk plotësohet pika 2.3.c,d,e,g, pasi një pjesë e makinerive dhe punonjësve janë të agzhazguara në kontratën me objekt "Loti I: Rikonstruksion NJA nr. 1,2,3,4,5, Sukth, Manzë" dhe "Riforcim pallate me kod gid 5407; 25387; 26969; 1511; 25947; 26972; 27307; 26764" të cilat janë në proces zbatimi.* |
| 5 | V. / "J26" | 13,323,700 | ***Skualifikohet***: *Nuk plotësohet pika 2.3.c,d,e,g, pasi një pjesë e makinerive dhe punonjësve janë të angazhuara në kontratën me objekt: Rikonstruksion rruga Dervish Hima" dhe " Rikonstruksion i rrugëve të qytetit".* |
| 6 | B./ "K27" | 13,336,390 | ***Skualifikohet***: *Nuk plotëson pikën 2.3.h, pasi certifikata ISO 9001 me nr. 1710AL592Q rezulton e skaduar në muajin shkurt 2023.*<br>*Nuk plotësohet pika 2.3.h, pasi certifikata ISO 45001 me nr. 1710AL592OHS ka skaduar ne muajin shkurt 2023* |
| 7 | S./ "K28" | 13,808,277 | ***Skualifikohet***: *Nuk përmbush pikën 2.3.a, pasi referuar dokumentacionit për punët e ngjashme të paraqitura në SPE nuk plotësohet vlera minimale e kërkuar si dhe nuk janë të shoqëruara me formularin sipas shtojcës 9.* |
| **8** | **A.2A CO/ K.** | **14,751,950** | **Kualifikohet./ fitues** |
| 9 | B./ J. | 15,537,600 | Kualifikohet |
| 10 | D.-05/ K. | 19,052,750 | ***Skualifikohet***: *Oferta e paraqitur është më e lartë se fondi limit.* |

Sipas PV datë 28.4.2023 nga 10 OE pjesëmarrës në garë, nga KVO-ja janë skualifikuar 8 OE dhe janë kualifikuar 2 OE, sipas të dhënave në pasqyrën sipas.
Sipas PV datë 12.5.2023 në rivlerësimin e procedurës nga 2 OE të mbetur në garë KVO-ja ka vlerësuar në vend të parë shoqërinë "A" sh.p.k me ofertë 14,751,950 lekë pa TVSH.
Me shkresën (*kërkesë)* datë 12.5.2023, KVO-ja i është drejtuar shoqërisë "A" sh.p.k që brenda 5 ditëve të depozitojë dokumentacionin sipas formularit të vetëdeklarimit.
Me shkresën datë 18.5.2023 (*shtojca 12*), është plotësuar *formulari i njoftim fituesit paraprak.*
Me shkresën nr. 2628/5 prot, datë 26.5.2023 është plotësuar *formulari i njoftim fituesit përfundimtar* pas përfundimit të afateve të ankimimit, shpallur në buletinin e APP nr. 51, datë 5.6.2023.
Me shkresën nr. 2628/4, datë 26.5.2023 nga KVO është mbajtur *Raporti Përmbledhës* i cili është nënshkruar dhe miratuar nga titullari i AK zj. E.S.
Në përfundim midis investitorit Bashkia Durrës përfaqësuar nga zj. E.S. dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "A" sh.p.k është lidhur kontrata për zbatimin e punimeve nr. 2628/6 prot, datë 19.6.2023 me vlerë 14,751,950 lekë pa TVSH me afat zbatimi 21 ditë nga data e fillimit të punimeve.

*Për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezultoi se ka vlerësuar drejt ofertat e OE pjesëmarrës, pasi si skualifikimi i OE (në mos plotësim kriteresh) dhe shpallja fitues i shoqërisë "A" sh.p.k (në plotësim të kërkesave të DST), është në përputhje me dispozitat e LPP.*

**6- Auditim i procedurës me objekt**: ”*Rehabilitim i shëtitores Taulantia (Loti III)”.*

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitim i shëtitores Taulantia (Loti III)”</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>“E hapur”<br>REF-85173-10-24-2023<br>Urdhri nr. 8539/1 prot., datë 13.10.2023</td><td colspan="2">1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)<br>Urdhri nr. 8539 prot., datë 15.9.2023<br>1. R.D.<br>2. E.T.<br>3. B.M.</td><td>2 Njësia e Prokurimit nr. 8539/1 prot., datë 13.10.2023<br>1.A.Xh.<br>2.E.Gj.<br>3.. A.T.<br>zëvendësohet nga z. K.Dh. me shkresën nr. 9966, datë 23.10.2023</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhri nr. 8539/2 prot., datë 13.10.2023.<br>1. A.I.<br>2. K.B.<br>3. L.B.<br>Sipas dokumentacionit nga z. L.B. nuk është nënshkruar formulari i deklarimit të konfliktit të interesit, në zbatim të nenit 73 të VKM[3]</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)<br>16,953,401 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)<br>12,692,156 lekë<br>Fitues: OE "M" sh.p.k</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)<br>4,261 mijë lekë ose 74.8%</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:<br>Data 9.11.2023</td><td colspan="2" rowspan="2">8. Burimi FI.ncimit<br>Të ardhurat e Bashkisë Durrës për vitin 2023, miratuar me VKB Nr. 150, datë 22.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Durrës për vitin 2023 (e ndryshuar)”.</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 11 B/OE<br>b) S’kualifikuar 4 B/OE,<br>c) Kualifikuar 7 B/OE</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 42 ditë.</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime<br>AK-s’ka/ka; -Jo<br>APP–s’ka/ka;-Jo<br>KPP-s’ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:<br>Data: 4.12.2023 nr. 8539/4 prot.</td><td>12.Data e lidhjes së kontratës:<br>Nr. 8539/5 prot, datë 19.12.2023 me afat zbatimi 42 ditë</td></tr>
</table>

**Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të dosjes fizike, procesverbalit “*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*” dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se kritere janë në përputhje me dispozitat e LPP.


**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në referim të PV datë 9.11.2023 është bërë hapja procedurës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë **<u>11</u>** OE, si më poshtë vijon:

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | C. M/ | 11,913,814 | <u>*Sukualifikohet:*</u><br>*Nuk disponon kategorinë e licencës NP-8A* |
| 2 | MF.G. +M./S. | 12,692,156 | *Kualifikohet/ fitues* |
| 3 | T&XH | 12,776,530 | <u>*Sukualifikohet:*</u><br>*Nuk disponon kategorinë e licencës NP-8A* |
| 4 | S./ J. | 12,802,026 | *Kualifikohet* |
| 5 | "A" | 13,003,726 | *Kualifikohet* |
| 6 | AL- A. | 13,231,378 | *Kualifikohet* |
| 7 | B. | 13,654,251 | <u>*Sukualifikohet:*</u><br>*Nuk disponon kategorinë e licencës NP-8A* |
| 8 | Li.VII | 14,064,900 | *Kualifikohet* |
| 9 | E.B&B + B.-I. | 14,293,273 | *Kualifikohet* |
| 10 | K. | 14,681,023 | <u>*Sukualifikohet:*</u><br>*Nuk disponon kategorinë e licencës NP-8A* |
| 11 | E. 2000 | 15,137,914 | *Kualifikohet* |

[3] *VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për mniratimin e rregullave të PP”, i ndryshuar.*

Sipas PV datë 10.11.2023 kanë shprehur interes për pjesëmarrje **11** OE. Pas vlerësimit të bërë në sistemin SPE, nga KVO-ja janë skualifikuar 4 OE dhe janë kualifikuar 7 OE, sipas të dhënave në pasqyrën sipas.
Me shkresën (*kërkesë)* datë 10.11.2023, KVO-ja i është drejtuar JV "M" + "M" sh.p.k që brenda 5 ditëve të depozitojë dokumentacionin sipas formularit të vetëdeklarimit.
Me PV datë 15.11.2023 pas paraqitjes së dokumentacionit nga JV "M" + "M" sh.p.k, nga KVO-ja është bërë verifikimi i dokumentacionit të depozituar i cili është në përputhje me LPP.
Me shkresën datë 15.11.2023 (*shtojca 12*), është plotësuar formulari i *njoftim fituesit paraprak* dhe me shkresën nr. 8539/4 *prot*, datë 4.12.2023 është plotësuar formulari i *njoftim fituesit përfundimtar* pas përfundimit të afateve të ankimimit, shpallur në buletinin e APP nr. 103, datë 26.12.2023.
Me shkresën nr. 8539/3, datë 4.12.2023 nga KVO-ja është hartuar *Raporti Përmbledhës* i cili është nënshkruar dhe miratuar nga titullari i AK *zj. E.*.
Në përfundim midis investitorit Bashkia Durrës përfaqësuar nga *zj. E.S.* dhe sipërmarrësit të punimeve JV "M" + "M" sh.p.k është lidhur kontrata për zbatimin e punimeve nr. 8539/5 prot, datë 19.12.2023 me vlerë 12,692,156 lekë pa TVSH me datë zbatimi 42 ditë nga data e fillimit të punimeve.

**Vlerësimi i procedurës**. Në lidhje me shpalljen fitues të JV "M" + "M" sh.p.k, u konstatua se vlerësimi nuk është i saktë nga KVO-ja dhe në zbatim të dispozitave të LPP dhe kërkesave të DST, pasi:
**a-** Shoqëria "M" + "M" sh.p.k, **nuk përmbush pikën 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.g te Kapacitetit Teknik** për disponimin punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi një pjese e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve te vetedeklaruara për këtë procedure prokurimi janë te angazhuar në kontratën me objekt "*Rikonstruksion shkolla MB "B.H.", Shenvlash*". Sipas informacionit të marrë nga *Sektori i Menaxhimit të Kontrata*, afati i mbylljes nga data 7.11.2023, si dhe është shtyrë me amendament deri datë 28.12.2023, ku në procedura të tjera ky fakt është përdorur si kriter skualifikues pavarësisht ofertës më të leverdishme.
**b-** Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy OE, rezulton se shoqëria "M" sh.p.k, e cila mbulon pjesën më të madhe të punimeve prej 92.56%, nuk paraqet kategorinë e licencës NP-8A-*Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.*
Gjithashtu, referuar zërave të preventivit, kjo kategori përputhet me zërin e punimeve *"Mbushje me gurë 1.5 ÷ 2.5 ton sipas projektit platforma me gurë që shërbejnë për zgjerimin e shëtitores".*
Sipas preventivit të ndarjes së punimeve, këtë zë punime e ka marrë përsipër shoqëria "M" sh.p.k, foto:



| Nr | Nr. AN | ZERAT E PUNIMEVE | NJESIA | SASIA | ÇMIMI | VLERA | VLERA E PUNIMEVE MF INVEST | MANE /5 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | | PUNIME PRI SHUEJE | | | | | | |
| 1 | 2.424/3 | Prisnje shtrese betoni | m3 | 20.00 | 1,200.0 | 24,000.00 | 24,000.00 | |
| 2 | 3.25/b | Prisnje trotuareve + germim | m3 | 20.00 | 1,200.0 | 24,000.00 | 24,000.00 | |
| 3 | 3.3 | Heqje pema ekzistuese | cope | 200.00 | 1,500.0 | 300,000.00 | | 300,000.00 |
| 4 | An | Heqje bordura betoni | ml | 80.00 | 1,500.0 | 120,000.00 | | 120,000.00 |
| | | SHUMA A | | | | 468,000.00 | 48,000.00 | 420,000.00 |
| B | | Punime ndertimi | | | | | | |
| 1 | An 164/1b | Mbushje me cakull e gur gjuror dhe ngjeshur me makinari | m³ | 347.11 | 1,200.0 | 380,332.00 | | 380,332.00 |
| 2 | An | Mbushje me gure 1.5÷2.5 ton sipas projektit platforma me gure qe sherbejne per zgjerimin e shetitores | m³ | 1,130.00 | 1,800.0 | 2,034,000.00 | 2,034,000.00 | |



| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | 3.89/b+3.15 5/5a | Gerrmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeres > 2 m, toke ark, kategoria II, me aft ne mjet ne zonen e afert me kubik gur deri ke mur mbi mbi ekskavatorit +transport deri 5km | m3 | 58.00 | 2,000.0 | 116,000.00 | | 116,000.00 |
| 4 | 3.211 | Shtese gjaku trashesi minimale mbas ngjeshjes 20 cm perhapur e ngjeshur me makinari | m² | 580.00 | 250.0 | 145,000.00 | 145,000.00 | |
| 5 | 3.212/b | Shtese stabilizant, trashesi minimale mbas ngjeshjes 10 cm | m² | 580.00 | 250.0 | 145,000.00 | 145,000.00 | |
| 6 | 2.262/4 | Shtese beton C16/20 e armuar me rgjare hekuri Ø 8 (20x20), trashesi betoni 50 - 15 cm nen shtresen e zones se shtruar me kubik gur | m² | 58.00 | 10,000.0 | 580,000.00 | 580,000.00 | |
| 7 | 2.166 | P.V hekur ne shtresat me beton nen shtresen e zones se shtruar me kubik gur (gjere 20x20) Ø8 | ton | 1.35 | 100,000.0 | 135,000.00 | 135,000.00 | |
| 8 | An | P.v shtrim me kubik gur grilandhe te vendit permasa 15x15 cm trashesi 8-10 cm, fuge max 1 cm | m² | 580.00 | 3,500.0 | 3,080,000.00 | 3,080,000.00 | |
| 9 | An | P.v bordure prej guri i bardhe me qoshe te latuar, permasa 15x25 dhe 15x35 cm | ml | 180.00 | 2,500.0 | 400,000.00 | 400,000.00 | |
| 10 | 2.262/3 | Shtese beton: C12/15 per rrasim bordure | m³ | 4.00 | 8,500.0 | 34,000.00 | 34,000.00 | |
| 11 | An | Beton C 30/25 i hatuar me aditiv kunder ngrirave te ujit te deti per bram 60x30 te themelit | m3 | 25.00 | 10,000.0 | 230,000.00 | 230,000.00 | |
| 12 | An | Beton C 30/25 i hatuar me aditiv kunder ngrirave te ujit te deti per themelin | m3 | 150.00 | 10,000.0 | 1,500,000.00 | 1,500,000.00 | |
| 13 | 2.167 | PV hekur per bram e themeli | ton | 4.65 | 85,000.0 | 395,250.00 | 395,250.00 | |
| | | SHUMA B | | | | 9,194,782.00 | 8,698,250.00 | 496,532.00 |
| C | | Punime gjelberimi dhe vaditje | | | | | | |
| 1 | 3.89/b+3.15 5/5a | Gerrmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeres > 2 m, toke ark, kategoria II, me aft ne mjet ne zonen e gelberimit deri ne 30cm +transport deri 5km | m3 | 150.00 | 250.0 | 37,500.00 | 37,500.00 | |
| 2 | An | Mbushje me dhe vegetal | m³ | 320.00 | 250.0 | 80,000.00 | 80,000.00 | |
| 3 | 3.643 | Mbjelje me lari | m² | 3,200.00 | 150.0 | 480,000.00 | 480,000.00 | |
| 4 | An | P.v pema LIGUSTRUM JAPONICUM diametri. 14/16 cm (figurine) | cope | 58.00 | 3,500.0 | 302,500.00 | 302,500.00 | |
| 5 | An | P.v kasha mbeturinash | cope | 5.00 | 12,000.0 | 60,000.00 | 60,000.00 | |
| 6 | 4.3 | Konstruksione metalike dekorative per kangjellat e pemeve tek rruga hotel Arvi | ton | 0.40 | 200,000.0 | 80,000.00 | 80,000.00 | |
| 7 | An | P.V pomp vaditje 18.5 kw | cope | 1.00 | 100,000.0 | 100,000.00 | 100,000.00 | |
| | | SHUMA C | | | | 1,140,000.00 | 1,140,000.00 | - |
| D | | PUNIME ELEKTRIKE (ana e portit) | | | | | | |

Nga sa parashtruam më sipër, KVO-ja nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e LPP, pasi JV "M" + "M" sh.p.k e shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve të DST, siç paraqitet më sipër. Në këtë rast KVO duhet të vijonte me OE tjetër në radhë për vlerësim dhe shpallje fitues, për të cilën **ngarkohen me përgjegjësi *A.I., L.B. dhe K.B.*** në cilësinë e anëtarit të KVO, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2, neni 3 pika 1, neni 76 pika 3/ë dhe 5, neni 92.

**7- Auditim i procedurës me objekt** "*Rikualifikim i hapësirave publike lagjja 13 dhe 6, bashkia Durrës"*.

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikualifikim i hapësirave publike lagjja 13 dhe 6, bashkia Durrës"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur"<br>REF-57364-01-30-2023<br>Urdhri nr. 64/4 prot., datë 17.01.2023</td><td colspan="2">1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)<br>Urdhri nr. 11 prot., datë 5.01.2023.<br>1-A.K.<br>2-E.T.<br>3-M.J.<br>4-J.K.<br>5-B.M.</td><td>2 Njësia e Prokurimit nr. 64/4 prot., datë 17.01.2023<br>1.A.T. (PP)<br>2.E.Gj.<br>3.I.F.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhri nr. 41 prot., datë 17.01.2023.<br>1. G.K.<br>2. L.S.<br>3. A.T.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)<br>21,144,868 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)<br>15,633,895 lekë<br>Fitues: B/OE "'"K" + "C" " sh.p.k</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)<br>5,511 mijë lekë ose 73.9%</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:<br>Data 15.2.2023<br>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 56 ditë.</td><td colspan="2">8. Burimi FI.ncimit<br>Të ardhurat e Bashkisë Durrës për vitin 2023, miratuar me VKB Nr. 150, datë 22.12.2022 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Durrës për vitin 2023 (e ndryshuar)".</td><td>9. Operatoret Ekonomike<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 19 B/OE<br>b) S'kualifikuar 9 B/OE,<br>c) Kualifikuar 10 B/OE</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime<br>AK-s'ka/ka; -Po (trajtuar më poshtë)<br>KPP-s'ka/ka;- Po (trajtuar më poshtë)</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:<br>Data: 15.11.2023 nr. 64/31 prot.</td><td>12.Data e lidhjes së kontratës:<br>Nr. 64/32prot, datë 4.12.2023 me afat zbatimi 56 ditë</td></tr>
</table>

**Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të procedurës (dosjes fizike), procesverbalit datë 30.01.2023 "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se kriteret e aplikuara janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në zbatim të VKM nr**.** 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 39, pika 4.

**<u>Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO</u>.** Në referim të PV datë 15.2.2023 është bërë hapja procedurës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë **<u>19</u>** OE, si më poshtë vijon:

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1. | N. | 14,167,315 | ***<u>Skualifikuar:</u>***<br>*Nuk plotëson pikën 2.3.c,d,e,f të KT, pasi punonjësit dhe mjetet janë të angazhuara në kontratën me objekt "Rikonstruksion shkolla Dom Nikoll Kacori"* |
| 2. | M. + E.-ALB | 15,436,232 | ***<u>Skualifikuar:</u>***<br>*Nuk plotëson pikën 2.3.c,d,e,f të KT, pasi punonjësit dhe mjetet e shoqërisë "E" janë të angazhuara në kontratën me objekt "Loti III. Riforcim godI. banimi 12-13 kat mbi tokë dhe një kat nëntokë";*<br>*BOE, nuk plotëson pikën 2.3.f të KT, pasi nuk kanë deklaruar mjet vetëshkarkues me kapacitet 7.5-18 ton* |
| 3. | T&XH | 15,463,476 | ***<u>Skualifikohet:</u>*** |

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| | | | *Nuk plotëson pikën 2.3.c,d,e,f të KT, pasi punonjësit dhe mjetet janë të angazhuara në kontratën me objekt "Riforcim i godinës së baimit 8 kate + podrum, lagja nr. 3, rruga Egnatia, kog.gis 27258"* |
| 4. | "K" + "C" | 15,633,895 | ***Kualifikohet/fitues*** |
| 5. | I.C.C G. + MF I. | 16,276,777 | *Kualifikohet* |
| 6. | N. 2000 | 16,166,368 | *Kualifikohet* |
| 7. | E. 2000 | 16,294,277 | ***Skualifikohet:*** *Nuk plotëson pikën 2.3.h të KT, pasi nuk paraqet certifikatën ISO 45001/2018* |
| 8. | "A" | 16,443,469 | *Kualifikohet* |
| 9. | 2 N | 16,579,659 | *Kualifikohet* |
| 10. | "L" | 17,146,605 | ***Skualifikuar:*** *Nuk plotëson pikën 2.3.c,d,e,f të KT, pasi punonjësit dhe mjetet janë të angazhuara në kontratën me objekt "Riforcim i pallateve me kod.gis 25759; 25583; 22842; 22248; 22248; 22866; 24812; 22707; 25248; 22721; 247821; 22245; 22299"***:** |
| 11. | RSM C. | 17,148,562 | ***Skualifikuar:*** *Nuk plotëson pikën 2.3.c,d,e,f të KT, pasi punonjësit dhe mjetet janë të angazhuara në kontratën me objekt "Ndërtim kanalizim KUZ në rrugën Gjergj Blasha"* |
| 12. | B. | 17,685,709 | ***Skualifikuar:*** *Nuk plotëson pikën 2.3.c,d,e,f të KT, pasi punonjësit dhe mjetet janë të angazhuara në kontratën me objekt "Rikonstruksion rruga C.la segmenti Hotel Ferra – Guest Hoause"* |
| 13. | S. 2F | 17,777,777 | *Kualifikohet* |
| 14. | K. | 17,872,285 | *Kualifikohet* |
| 15. | G. | 17,977,330 | *Kualifikohet* |
| 16. | Z. | 18,265,742 | ***Skualifikuar:*** *Nuk plotëson pikën 2.3d të KT, pasi nuk deklaron të formulari i vetëdeklarimit ing.elektrik dhe hidroteknik.* *Nuk plotëson pikën n2.3.e të KT, pasi në formularin e vetëdeklarimit ka 1 punonjës nga 2 që kërkohen* |
| 17. | X. | 18,740,576 | *Kualifikohet* |
| 18. | K.K. | 19,024,013 | *Kualifikohet* |
| 19. | S. | 19,549,352 | ***Skualifikuar:*** *Nuk plotëson pikën 2.3.a të KT, pasi përmbush pikën e punimeve të ngjashme. Objekti që paraqet "Asfaltim i parkimit midis pallateve, Divjakë nuk merret në konsideratë pasi është jashtë afatit 5 vjeçar të kërkuar të DST.\ndërsa punët e tjera nuk plotësojnë vlerën minimale të kërkuar në pikën (a) dhe (b).* |

Me PV datë 13.3.2023 është bërë vlerësimi i procedurës ku sipas KVO-së, nga 19 OE pjesëmarrës janë skualifikuar 9 OE dhe janë kualifikuar 10 OE. Nga verifikimi i dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se **KVO-ja ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave**. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të ofertave është hapur në datën 15.2.2023, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor që vlerësimi i tyre të kryhej brenda datës 3.3.2023 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit dhe të dhënave në SPE, rezultoi se vlerësimi përfundimtar i ofertave është kryer në datën 13.3.2023. Pavarësisht faktit të rivlerësimit të kryer në lidhje me këtë procedurë, nga dita e hapjes së ofertave datë 15.2.2023 deri në vlerësimin përfundimtar të datës 13.3.2023 ka kaluar një afat prej 10 ditësh, **afat për të cilin nuk ka një justifikim objektiv nga ana e KVO-së,** veprime/dhe mosveprime në kundërshtim me LPP, duke **ngarkuar me përgjegjësi:** *G.K., L.S. dhe A.T.*, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2, dhe VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenin 82 pika 1 "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla...".*

Nga KVO është bërë korrigjimi i gabimeve aritmetike, ku oferta anomalisht e ulët për OE të kualifikuar është 14,661,833 lekë. Pra asnjë nga OE nuk është në këtë vlerë. Në këto kushte KVO-ja ka vlerësuar në vend të parë JV "K" + "C" sh.p.k me ofertë 15,633,895 lekë pa TVSH.

Me shkresën (*kërkesë)* datë 13.3.2023, KVO-ja i është drejtuar JV "K" + "C" sh.p.k që brenda 5 ditëve të depozitojë dokumentacionin sipas formularit të vetëdeklarimit.
Me PV datë 24.3.2023 pas paraqitjes së dokumentacionit nga JV "K" + "C" sh.p.k, nga KVO-ja është bërë verifikimi i dokumentacionit të depozituar i cili është në përputhje me LPP.

**ANKESA**

Me shkresën (shtojca 21), datë 3.4.2024 nga shoqëria "T" sh.p.k, është bërë ankesë për vlerësim të padrejtë të dokumentacionit teknik/ligjorë, duke argumentuar dhe shkaqet.
Me urdhër nr. 149 *prot*, datë 5.4.2023 të titullarit të AK është ngritur KSHA nga: *R. D., K. B. dhe A.H.*, dhe anulimin e procedurës deri në shqyrtimin e ankesës.
Me shkresën nr. 64/8 *prot*, datë 6.4.2023, AK Bashkia Durrës i përcjell shoqërisë "T" sh.p.k, për dijeni dhe KPP vendimi marrë nga KSHA, ku është vendosur refuzimi i ankesës, pasi shoqëria ka pasur mjete dhe specialistë në kontrata të tjera (qëndron konstatimi i KVO), dhe se në datën 3.4.2023 ora 11:[57] kur ka përfunduar afati i ankimit nuk ka pasur asnjë ankesë në AK.
Me shkresën nr. 64/25 *prot*, datë 17.7.2023, AK Bashkia Durrës i ka kërkuar KPP sqarim mbi vendimin nr. 529/2023 *prot*, datë 17.7.2023, ku kërkohet:
*AK Bashkia Durrës është njoftuar me vendimin nr. 529/2023; nr. 688/14 prot, datë 27.6.2023, si dhe vendimin nr. 582/2023, datë 10.7.2023 me objekt "Mbi zbatimin e vendimit të KPP me nr. 391/2023, datë 18.5.2023", ku kërkohet që:*

- *Të mos lejojë AK për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës;*
- *AK të rivlerësojë procedurën, duke skualifikuar OE "N", "L... VII", "RSM C...", "B", dhe duke kualifikuar shoqërinë "T" sh.p.k;*
- *AK Bashkia Durrës në respektimin të vendimit të KPP nr. 391/2023, datë 18.5.2023 ka kualifikuar ofertën e shoqërisë "T" sh.p.k;*
- *Në respektimin të pikës 2 të LPP, dhe për të mbajtur të njëjtin standart, KVO ka vendosura të rivlerësojë të gjithë OE e skualifikuar për të njëjtën mangësi.*

*Me PV datë 26.5.2023 është bërë rivlerësimi i dokumentacionit të OE të skualifikuar, duke kualifikuar në vend të parë shoqërinë " N.." sh.p.k me ofertë 14,167,315 lekë (anomalisht të ulët).*
*Me PV rivlerësim klasifikimi datë 30.5.2023, KVO-ja ka klasifikuar në vend të parë shoqërinë "N" sh.p.k me ofertë 14,167,315 lekë pa TVSH, pasi nga shoqëria është paraqitur argumentimi i ofertës anomalisht të ulët.*
*Me venim nr. 460/2023 (prot 688/12), datë 2.6.2023, KPP-ja ka njoftuar AK Bashkia Durrës se në zbatim të kërkesës për rishikim të vendimit nr. 391/2023, datë 18.5.2023 për procedurën me REF-57364-01.30.2023 me objekt "Rikualifikim i hapësirave publike në lagje 13 dhe 6" me fond limit 21,144,868 lekë pa TVSH, ka vendosur që:*

*II.3- KPP në lidhje me vendimmarrjen gjykon se ligjvënësi ka parashikuar rregulla strikte mbi procedurën e shqyrtimit të ankesave si nga AK ashtu dhe nga KPP, si organi më i lartë të shqyrtimit të ankesave, në zbatim të nenit 24/3 të LPP;*

*Lidhur me ankesën e AK, KPP-ja nuk mund të komentojë apo shpjegojë vendimmarrjen e tij përtej shpjegimeve të bazuara në ligj e argumenteve faktik, referuar nenit 30 pika 2 e LPP*

*II.4- Instituti i rishikimit nga një organ administrativ të një vendimi të nxjerrë nga vetë organi në fjalë, nuk gjen mbështetje ligjore të parashikuar në nenin 144 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave Administrative në RSH", pasi nuk jemi në rastin e parashikuar në këtë dispozitë ligjore. KPP vlerëson se AK duhet ti drejtohet me analogji Kodit të Procedurës Civile, ku parashikon" Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë";*

*II.5- ë kërkesën e AK, KPP gjykon se argumentet e AK kanë të bëjnë me argumentet e AK, por nuk ofrohet apo nga AK mbi ndonjë fakt apo rrethanë të re.*
*Në zbatim të neneve 30 dhe 118, të LPP është vendosur mos pranim i kërkesë së AK Bashkia Durrës.*

*Me PV datë 3.8.2023, KVO-ja në zbatim të vendimeve të KPP, ka kualifikuar në vend të parë shoqërinë "T" sh.p.k për ofertën 15,463,476 lekë pa TVSH.*
*Me shkresën nr. S'ka, datë 3.8.2023, KVO-ja i kërkon shoqërisë "T" sh.p.k paraqitjen e dokumentacionit sipas formularit të vetëdeklarimit, brenda 5 ditëve.*
*Me PV datë 9.8.2023 ka bërë inventarizimin e dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria "T" sh.p.k, ku sipas KVO këto dokumente janë të parregullta dhe kanë devijimi me të dhënat e formularit 8, si më poshtë:*
*a- Nuk përmbush pikën 2.2.a të KEF, pasi nuk paraqet vërtetim mbi pagesën e taksave vendore Bashkia Kavajë referuar QKB me çështjes CN-909675-05-22 e cila është mbyllur datë 15.11.2022;*
*b- Nuk plotëson pikën 2.3.e të KT, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur datë 7.8.2023 për një hekurkthyes (XH.S) si dhe 2 karpentier (K.ZH, S.M), nuk paraqet dokumentacion që vërteton profesionin (dëshmi profesionale ose ekuivalent të tij), por vetëm IQT dhe kontratë pune. Gjithashtu punonjësit e vetëdeklaruar si drejtues mjeti (L.C, F.T), janë paraqitur dëshmitë e aftësisë profesionale për kategorinë ekskavator (manovrator) dhe jo dokumenti (leje drejtimi) për kategorinë e mjeteve të kërkuara;*
*c- Nuk përmbush pikën 2.3.f të KT. Mjeti me targë AA664VY i vetëdeklauar si mjet vetëshkarkues me masë maksimale 7.5-18 ton është paraqitur certifikatë transporti nr. 18, datë 5.7.2018 për mjetin me targë SR4591B, e cila nuk është e vlefshme, pasi afati i vlefshmërisë përfundon 4.7.2023. Gjithashtu dhe certifikata e vlefshmërisë së kontrollit teknik me targë AA664VY ka afat vlefshmëria 4.7.2023;*
*d- Nuk plotëson pikën 2.3.g të KT, pasi certifikata ISO 9001 ka afat skadence datë 5.8.2023 dhe certifikata ISO 45001:2018 ka afat skadence 5.8.2023;*
*Si përfundim KVO e ka skualifikuar si të parregullt dhe në mos plotësim të kritereve të DST, duke e skualifikuar shoqërinë T&XH" sh.p.k*
*Me PV datë 9.8.2023, nga KVO është bërë rivlerësimi i procedurës, duke kualifikuar JV "K" + "C" sh.p.k me ofertë 15,633,895 lekë pa TVSH.*

Me shkresën nr. 64/27 *prot*, datë 6.10.2023, AK Bashkia Durrës informon KPP për zhvillimin e procedurës në zbatim të vendimeve të KPP nr. 460/2023, nr. 529/2023, nr. 582/2023, 599/2023 dhe vendimin nr. 391/2023, datë 18.5.2023, duke kualifikuar në vend të parë shoqërinë "T" sh.p.k (sipas PV datë 3.8.2023).
Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria "T" sh.p.k, KVO-ja konstatoj se dokumentacioni i paraqitur ka parregullsi, devijime dhe mospërputhje referuar formularit të vetëdeklarimit.
Me vendim nr. 1040/2023 (*prot* 2506), datë 16.10.2023, KPP-ja ka vendosur të lejojë AK Bashkia Durrës vijimin e hapjes së mëtejshëm të procedurës.
Me shkresën nr. 64/29 *prot*, datë 01.11.2023, nga KVO-ja është mbajtur *Raporti Përmbledhës*, i cili është miratuar dhe nga titullari i AK *zj. E.S.*.
Me shkresën nr. 64/30 *prot*, datë 01.11.2023 është plotësuar *formulari i njoftim fituesit paraprak.*
Me shkesën nr. 64/31 *prot*, datë 15.11.2023 *njoftim fetusi përfundimtar*.
Ndërmjet investitorit Bashkia Durrës dhe sipërmarrësit të punimeve JV "K" + "C" sh.p.k pas sigurimit të kontratës datë 7.11.2023 është lidhur kontrata për zbatimin e punimeve nr. 64/32 *prot*, datë 4.12.2023 për vlerën 15,633,895 lekë pa TVSH me afat 56 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

**Vlerësimi i procedurës**. Në lidhje me shpalljen fitues të JV "K" + "C" sh.p.k, konstatohet se vlerësimi nuk është i saktë nga KVO, pasi:
Shoqëria "K" sh.p.k, nuk plotëson pikën 2.3.4 të DST, për *ing. Hidroteknik*, pasi referuar zërave të punimeve të preventivit, kjo shoqëria ka punime për të cilat kërkohet prezenca e *ing. Hidroteknik.*

Nga verifikimi i regjistrit të zbatimit të kontratave ardhur nga Sektori i Investimeve pranë Bashkisë Durrës, rezultoi se JV "K" + "C" sh.p.k, nuk plotëson pikën *2.3.c,d,e,f të KT***,** pasi një pjesë e stafit, punonjësve dhe mjeteve janë të deklaruara në zbatimin e kontratës nr. 1214/5 *prot*, datë 3.6.2021 me objekt: "*Rikonstruksion rruga paralel me hekurudhën-Plazh (Apulia)*" për vlerën 23,649,180 lekë me TVSH, ku sipas amendamentit shtesë përfundojnë me datë 10.01.2024.
Në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezultoi se nuk ka vlerësuar drejt B/OE "K" + "C" sh.p.k të shpallur fitues, pasi sipas grupit të auditimit të KLSH-së nuk plotëson disa nga kriteret e DST, të cilat janë evidentuar si mësipërm. në këto kushte KVO-ja duhet të vijonte me OE e tjerë të radhës për vlerësim dhe lidhje kontrate, veprimet në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi: *G.K., L.S. dhe A.T.***, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, në kundërshtim me **nenet 2, 3 pika 1, dhe 92** të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar Bashkia Durrës janë paraqitur observacioni me shkresë nr. 668/88 prot, datë 17.06.2026 (*administruar në KLSH nr. 1347/71, dt. 18.06.2026)* "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga G.K., L.S. dhe A.T., në cilësinë e anëtait të KVO, , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
**Pretendim i subjektit:** - *Ju citoni se shoqëria K.M.K nuk plotëson piken 2.3.4 te DST, për ing. Hidroteknik, pasi referuar zërave te punimeve te preventivit, kjo shoqëri ka punime për te cilat kërkohet prezenca e ing. Hidroteknik. Në lidhje me këtë konstatim, KVO-ja sqaron se ne marrëveshjen e bashkëpunimit për bashkimin e përkohshëm te operatoreve ekonomik (BOE) te paraqitur ne SPE nga ofertuesi, ne nenin 2 te saj, citohet shprehimisht se "...Palët mes tyre bien dakort qe, stafi teknik-drejtues, makineritë dhe pajisjet qe disponojnë do ti vene ne dispozicion për kryerjen e punimeve sipas zërave te preventivit, pavarësisht ndarjes se punimeve qe ka marre përsipër secila pale për te kryer".*
*- Ju citoni se nga verifikimi i regjistrit te zbatimit te kontratave ardhur nga Sektori i Investimeve pranë Bashkisë Durrës, rezultoi se JV "K" + "C" sh.p.k, nuk plotëson piken 2.3.c, d, e, f, te KT, pasi një pjese e stafit, punonjësve dhe mjeteve janë te deklaruara ne zbatimin e kontratës nr. 1214/5 prot., date 3.6.2021 me objekt "Rikonstruksion rruga parallel me hekurudhën-Plazh (Apulia)" për vlerën 23,649,180 leke me TVSH, ku sipas amendamentit shtese përfundojnë me date 10.01.2024.*
*Në lidhje me këtë konstatim, KVO-ja, referuar kontratës me objekt "Rikonstruksion rruga paralel me hekurudhën-Plazh (Apulia)", sqaron si me poshtë:*
*Procesverbal për rifillimin e punimeve i datës 12.02.2023, me afat përfundimi 25 dite kalendarike (data 10.03.2023)*
*Procesverbal mbi përfundimin e punimeve te ndërtimit i datës 08.03.2023.*
*Pas këtij momenti, kontraktori ka përfunduar punimet, te cilat kane rifilluar ne datën 25.10.2023 (sipas procesverbalit për rifillimin e punimeve), pas daljes se VKM nr. 587, date 18.10.2023 "Për shpronësimin, për interes publik, te pronareve te pasurive te paluajtshme, prone private, qe preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion rruga "Apulia" (parallel me linjën hekurudhore-Plazh), Bashkia Durrës". Persa me lart argumentuar, për periudhën 08.03.2023 – 25.10.2023, zbatimi ka qene i pezulluar për arsye shpronësimesh.*
**Qëndrim i grupit të auditimit**: Për sa keni observuar, sqarojmë se pretendimet nuk qëndrojnë, pasi nga ana juaj nuk është paraqitur asnjë element shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilat grupi i auditimit është shprehur në me qëndrimin e tij në projektraportin e paraqitur. Kështu, në lidhje ing. Hidroteknik nga shoqëria duhej deklarohet për faktin se ka marrë përsipër punime që i përkasin këtij profili, dhe në zbatim të dispozitave të LPP, duhet ta plasonte. Nnëdras në lidhje me faktin se një pjesë e makinerive janë të deklaruar në një kontratë tjetër dokumentacioni nuk është i plotë për faktin se nga shoqëria fituese nuk është deklaruar asnjë pjesë e stafit dhe makineri janë në kontrata të tjera, por që për arsye të ndryshme nuk është mbyllur, por është deklaruar e kundërta (nuk janë të angazhuara). Nga ana juaj pretendohet se

nuk është mbyllur procesi i shpronësimit, ndërkohë VKM e shpronësimit ka datë 18.10.2023 me nr. 587, shumë kohë më përpara, dhe për më tepër nuk vijohet me zbatimin e kontratës pa mbyllur procesin e shpronësimeve. Procedura mbetet me shkelje në vlerësim.

**8- Auditim i procedurës me objekt** ” *Rehabilitim i ndriçimit të akseve rrugore”*.

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitim i ndriçimit të akseve rrugore”</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>“E hapur”<br>REF-63767-03-27-2023<br>Urdhri nr. 2857/1 prot., datë 21.3.2023</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</td><td>2 Njësia e Prokurimit<br>Urdhri nr. 2857/1 prot., datë 21.3.2023<br>1. A.X. P/P<br>2. A.T.<br>3. E.Gj.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhri nr. 2857/2 prot., datë 21.3.2023.<br>1. R.M.<br>2. L.B.<br>3. N.Z.<br>Sipas dokumentacionit në dosje, deklarata e konfliktit të interesit është e panënshkruar nga anëtarët,</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)<br>41,611,645 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)<br>34,282,500 lekë<br>Fitues: B/OE "B" + "B" + "B" sh.p.k</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)<br>7,329 mijë lekë ose 17.6% e fondit</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:<br>Data 12.4.2023</td><td colspan="2" rowspan="2">8. Burimi FI.ncimit<br>Buxheti i Autoritetit Kontraktor</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 7 B/OE<br>b) S’kualifikuar 5 B/OE,<br>c) Kualifikuar 2 B/OE</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:<br>56 ditë</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime<br>AK-s’ka/ka; -Jo<br>APP–s’ka/ka;-Jo<br>KPP-s’ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit (sipas SPE):<br>Data: 30.5.2023 (Paraprak)<br>Data: 16.6.2023, nr. 2857/5 (Përfundimtar)</td><td>12.Data e lidhjes së kontratës:<br>Data: 7.7.2023, nr. 2857/6</td></tr>
</table>

**Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit “*për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*” datë 5.7.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se kriteret janë në përputhje me dispozitat e LPP dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 7 OE, kjo sipas PV datë 12.4.2023, si më poshtë:

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1. | S/ A. Sh./ | 32,674,550 | ***Skualifikohet:***<br>*-Nuk plotëson pikën2.3.c.d të KT, pasi referuar akt marrëveshjes së bashkëpunimit për B/OE, shoqëria S. ka marrë përsipër punime elektrike, konkretisht preventivin e plotë për 4 akse dhe nuk ka vetëdeklaruar personel në përmbushjen e këtij kriteri;*<br>*Gjithashtu nuk deklaron dhe personel ing. Ndërtimi;*<br>*- Nuk plotëson pikën 2.3.e të KT, për personel teknik ndërtimi 3 veta, elektricist 17 veta, teknik elektronik për 2 veta, manovrator për një person dhe drejtues mjeti për 3 veta, ku referuar formularit të vetëdeklarimit dhe marrëveshjes së bashkëpunimit shoqëria S. ka marrë përsipër punimeve për të cilat kërkohen specialistët e mësipërm dhe nuk paraqiten në formularin e vetëdeklarimit.;*<br>*Konstatimet e mësipërme janë bazuar dhe në vendimin e KPP nr. 1129/2022, datë 22.11.2022;*<br>*- Shoqëria S. në të njëjtën periudhë ka kontratë të lidhur me Bashkinë Durrës për objektin “Riforcim pallate me kod gis 25759, 255833..., etj.* |
| 2. | Ra. C. | 32,674,550 | ***Skualifikohet:***<br>*Shoqëria "N" dhe "U" sh.p.k, si subjekt mbështetës i shoqërisë "R", për punonjësit z. B.K. si teknik ndërtimi, z. A.Ll. dhe z. E. Nd. si elektricist, janë të angazhuar në kontratën në vijim me objekt “Riforcim i pallateve me kod gis 26311, 26028, si dhe riforcim i banesave individuale, sipas kontratës datë 18.10.2022 me datë 224 ditë* |
| 3. | Co. + B. | 33,294,380 | ***Sukualifikohet:*** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | *Nga shqyrtimi i dokumentacionit paraqitur me shkresën datë 3.5.2023, KVO konstaton se:*<br>*1. Mjeti me targë AA479FO, i vetëdeklaruar me masë 7.5-18 ton rezulton të jetë me masë 26 ton. Gjithashtu këtij mjeti i ka kaluar dhe afati i vlefshmëruisë së sigurimit;*<br>*2. Mjeti me targë AA983SK, i vetëdeklaruar me masë 11 ton, rezulton me masë 24 ton, duke mos plotësuar kriterin 7.5-18 ton;*<br>*Nga sa sipër JV "C" + " B...", nuk disponojnë mjetet me kapacitet 7.5-18 ton.* |
| 4. | B. + B93 II/ + B-93 | 34,282,500 | **Kualifikohet / fitues** |
| 5. | HTM + AL-/ | 37,492,450 | Kualifikohet |
| 6. | E.COM/ + M. | 38,085,050 | ***Skualifikohet:***<br>*Nuk përmbush pikën 2.2.b të KT, pasi shoqëria E.COM nuk ka paraqitur PF viti 2022.* |
| 7. | "A"/ + 2Z K./ | 39,710,850 | ***Skualifikohet:***<br>*Shoqëria "2" mbështet në kapacitet e 4 subjekteve të tjera, të cilat nuk kanë depozituar në SPE formularin e vetëdeklarimit.;*<br>*- Nuk përmbush pikën 2.3.b të KT, pasi shoqëria "A" sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër punime elektrike me vlerë 20,000,000 lekë, por nuk ka kategorinë e licencës NP-11B* |

Sipas PV datë 26.4.2023, nga 7 OE pjesëmarrës janë skualifikuar 5 OE dhe janë kualifikuar 2 OE, sipas të dhënave në pasqyrën sipër:
Me shkresën datë 30.5.2023 (*shtojca 12*), është plotësuar formulari i *njoftim fituesit paraprak* dhe me shkresën nr. 2857/5 *prot*, datë 16.6.2023 është plotësuar *formulari i njoftim fituesit përfundimtar* pas përfundimit të afateve të ankimimit, shpallur në buletinin e APP nr. 51, datë 5.6.2023.
Me shkresën nr. 2857/4 *prot*, datë 14.6.2023, nga KVO-ja është mbajtur *Raporti Përmbledhës* i cili është nënshkruar dhe miratuar nga titullari i AK.
Në përfundim midis investitorit Bashkia Durrës përfaqësuar nga *zj. E.S.* dhe sipërmarrësit të punimeve JV "B" + "B" + "B" sh.p.k është lidhur kontrata për zbatimin e punimeve nr. 2857/6 *prot*, datë 7.7.2023 me vlerë 34,282,500 lekë pa TVSH me datë zbatimi 56 ditë nga data e fillimit të punimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) dhe në dosjen fizike, konstatohet se **KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer veprime dhe mosveprime në kundërshtim me dispozitat e LPP,** në lidhje me shpalljen fitues të JV "B" + "B" + "B" sh.p.k, konkretisht si vijon:
***a)-*** Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit datë 11.4.2023 të lidhur midis shoqërive, shoqëria "B" sh.p.k do të realizojë 34% të punimeve, ndërsa shoqëria "B" sh.p.k do të realizojë 35% të punimeve dhe shoqëria "B" sh.p.k do të realizojë 31% të punimeve.
Sipas dokumentacionit në dosje dhe SPE, shoqëria "B" sh.p.k, nuk plotëson **pikën e licencës NP-11/B,** pasi kategoria e saj është (A), dhe referuar ndarjes së punimeve kjo shoqëri ka punime që kërkohet kjo kategori licence (B). Sipas dokumentacionit në dosje dhe sistem, shoqëria "B" sh.p.k, nuk ka depozituar **pasqyrat fI.nciare viti 2022**
**b-** Shoqëria "B" sh.p.k, nuk ka paraqitur ***teknik elektronik***, ku referuar marrëveshjes së bashkëpunimit kjo shoqëria ka punime marrë punime që kërkohet teknik elektronik.
**c-** Nga B/OE "B" sh.p.k + *"B"* sh.p.k, nuk janë depozituar vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike në sistemin SPE, në kundërshtim me nenin 82 pika 5 e Ligjit nr. 162, date 21.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rrëgallave te prokurimit publik", i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 26, pika 6 "*Mbi paraqitjen e dokumentacionit administrativo ligjor për procedurat e prokurimit",* për të cilën **ngarkohen me përgjegjësi**: *R.M., L.B. dhe N.Z.***,** në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, në kundërshtim me nenet 2, 3 pika 1, 76 pika 3/ë dhe 5, neni 92 pika 3 të "Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar Bashkia Durrës janë paraqitur observacioni me shkresë nr. 668/88 prot, datë 17.06.2026 (*administruar në KLSH nr. 1347/71 Prot, dt. 18.06.2026)* "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga z. R.M., në cilësinë e anëtait të KVO, , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:** *Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit datë 11.4.2023 të lidhur midis shoqërive, shoqëria "B" sh.p.k do të realizojë 34% të punimeve, ndërsa shoqëria "B" sh.p.k do të realizojë 35% të punimeve dhe shoqëria "B" sh.p.k do të realizojë 31% të punimeve, sqarohet se kërkesa për specifikime për pikën e licencës NP-11/B, është vlerësuar në kuadër të preventivit të punimeve, nga e cila përcaktohet qartazi vlera që i përkasin këto punime. Bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 , shoqëria "B" sh.p.k, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër 34% të punimeve me vlerë 11.6 milionë lekë, vlerë e cila i përket kategorisë A (0-20).*
*Në lidhje me pasqyrat fI.nciare të vitit 2022, janë dorëzuar rregullisht, si në SPE dhe fizikisht.*
*Në lidhje me konstatimin se shoqëria "B" sh.p.k, nuk paraqet teknik elektronik, sqarohet se kërkesa për 2 teknik sipas DT. B/OE ka deklaruar 2 teknik, konkretisht: z. S.Z. me profil teknik elektronik i deklaruar nga shoqëria "B" sh.p.k dhe z. M.D., teknik elektronik deklaruar nga shoqëria B.sh.p.k*
*Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit (pika 1 dhe 2), thuhet se: "1. Bashkëpunim i përkohshëm pa shpërblim, i kapitalit, stafit teknik, dokumenteve ligjorë, si dhe makinerive dhe i të gjithë kapaciteteve të deklaruara nga përfaqësuesit ligjore. 2. Palët subjekt në këtë deklaratë bashkëpunimi prezentë marrin përsipër që të përgjigjen solidarisht ndaj çdo detyrimi që buron nga kontrata, dhe në atë të realizimit të objektit, në përputhje me nenin 423 të KC".*
*Referuar pikës 1 dhe 2 të marrëveshjes së bashkëpunimit, pavarësisht ndarjes së punimeve në pjesë takuese të secilës shoqëri, parashikohet përgjegjësi **solidare** e operatorëve për vënien në dispozicion të stafit teknik gjatë realizimit të kontratës.*
*Referuar pikës 1 dhe 2 të marrëveshjes së bashkëpunimit, pavarësisht ndarjes së punimeve në pjesë takuese të secilës shoqëri, parashikohet përgjegjësi **solidare** e operatorëve për vënien në dispozicion të stafit teknik gjatë realizimit të kontratës.*
*Në lidhje me konstatimin se nga B/OE nuk janë depozituar vërtetimi mbi pagesën e FSHU, sqarohet se Referuar nenit 82 , pika 1 të LPP, dhe nenit 26, pika 2, shkronja "e" të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar, operatorët ekonomikë mund të vërtetojnë shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike përmes Formularit të Vetëdeklarimit.*
*Të tre operatorët e BOE-së kanë dorëzuar Formularin e Vetëdeklarimit (Shtojca 8) në sistemin elektronik. Për më tepër, Procesverbali i KVO-së, mbi vlerësimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet si dhe dokumenteve të paraqitura në rrugë elektronike, pikat 11 dhe 12, vërteton se shoqëritë "B" sh.p.k dhe "B" sh.p.k kanë dorëzuar gjithashtu edhe **vërtetime zyrtare nga FSHU**, që konfirmojnë shlyerjen e detyrimeve.*
**Qëndrimi i grupit të auditimit**: Për sa keni observuar, sqarojmë se pretendimet nuk qëndrojnë, pasi nga ana juaj nuk është paraqitur asnjë element shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilat grupi i auditimit është shprehur në me qëndrimin e tij në projektraportin e paraqitur. **Në këto kushte procedura mbetet me shkelje në vlerësim.**

**9**-Auditim i procedurës me objekt " *Blerje dru zjarri e pellet për QEA, Durrës",* viti 2023.

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"Blerje dru zjarri e pellet për QEA, Durrës"* | | | |
|---|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E hapur-blerje malli"<br>REF-61664-03-07-2023<br>Urdhri nr. 1859/1 prot., datë 24.2.2023 | **1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)**<br>Urdhri nr. 80 prot., datë 16.2.2023<br>1. E.Xh.<br>2. E.Ç.<br>3. E.P. | **2 Njësia e Prokurimit**<br>nr. 1859/1 prot., datë 24.2.2023<br>1. A Xh.<br>2. I.F.<br>3. E. Gj. | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhri nr. 95 prot., datë 24.2.2023.<br>1. L.M.<br>2. R.Xh.<br>3. A.K. |
| **4. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>39,996,000 lekë | **5. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>39,889,800 lekë<br>Fitues: OE GJ.B. (pf) | | **6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>107 mijë lekë ose 0.26% |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 23.3.2023 | **8. Burimi FI.ncimit**<br>Të ardhurat e Bashkisë Durrës për vitin 2023, miratuar me VKB Nr. 150, datë 22.12.2022 | | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **4 B/OE**<br>b) S'kualifikuar **3 B/OE,** |

| | | |
|---|---|---|
| **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 150 ditë. | *"Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Durrës për vitin 2023 (e ndryshuar)*". | c) Kualifikuar **1 B/OE** |
| **10.Ankimime**<br>**AK**-s'ka/ka**; -Jo**<br>**APP**–s'ka/ka**;-Jo**<br>**KPP**-s'ka/ka;-**Jo** | **11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:** Data: 26.4.2023 nr. 1859/4 prot. | **12.Data e lidhjes së kontratës:** Nr. 1859/55 prot, datë 8.5.2023 |

**Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.** Me shkresën *nr. S'ka, datë s'ka*, grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe të fondit limit i përcjellë njësisë së prokurimit dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës, i cili përmban: urdhrin nr. 80, datë 16.2023; formularin e deklarimit; preventivin dhe grafikun e lëvrimit të mallit; procesverbal dhe specifikimet teknike (*nënshkruar nga gjithë anëtarët e grupit të punës)*.

**Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nëpërmjet postës subjekti "N" (PF), ka kërkuar rishikimin e kriterit e pikës 2.2/c për xhiron, e cila është në vlerën 39,000,000 lekë, ku është sugjeruar përgjysmimi i sajë.
AK Bashkia Durrës me shtojcën datë 15.3.2023 ka bërë ndryshimin e këtij kriteri, duke përcaktuar se për të provuar të ardhurat duhet që për njërin nga vitet 2019/2020/2021 të ketë një xhiro jo më të vogël se 20 milionë lekë. Afati i hapjes së procedurës nuk ka ndryshuar.
Ky ndryshim kriteri, bie ndesh me përcaktimet e nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të PP*" ( i ndryshuar), ku thuhet se:

*Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet fI.nciare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga OE, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit fI.nciare[1].*
*2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*
*a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit[1], në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*
*b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*
*c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".*
*3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve fI.nciare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor*.

Gjithashtu auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit datë 23.01.2023 "*Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të VKM nr**.** 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 39, "Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike", pika 4. E konkretisht:
**Pika 2.3.1/b e DT,** *është kërkuar **2 (dy) punonjës të kualifikuar përpunues druri**, të vërtetuar me certifikatë nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik( ose ekuivalent të tij/saj).*
Nisur nga tipologjia e objektit të kontratës që prokurohet (mallra), ky kriter nuk është mirëargumentuar, pasi nuk kemi të bëjmë me prodhim mobileje për institucionin por është procedurë blerje dru zjarri dhe pallet, ku për specifikimet e vendosura duhet që nga AK bashkia Durrës në komisionin e marrjes në dorëzim të jetë specialist i fushës, pasi qëllimi është cilësia e mallit që furnizohet AK, dhe jo kualifikimet profesionale të OE. Vendosja e një kriteri të tillë bëhet shkak për mungesë pjesëmarrje në procedurë ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme, të cilët disponojnë kapacitet teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin e kontratës, në kundërshtim kjo dhe me nenin 3 të LPP[4].
**Për sa sipër ngarkohen me përgjegjësi:** *E.Xh., E.Ç. dhe E.P.*, në cilësinë e anëtarit të NJP.
**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në referim të PV datë 23.3.2023 është bërë hapja procedurës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 4 B/OE, si më poshtë vijon:

[4] *Ligjin nr. 162/2020, "Për prokurimin publik",*

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | Gj.B. | 39,889,800 | Kualifikuar |
| 2. | P. | 39,942,900 | *1. Nuk disponon Lejen mjedisore të tipit B "Veprimtaritë e lëndës së drurit" sipas pikës 2.3 b të shtojcës 7 pika 2.3 "Kapaciteti teknik"*<br>*2. Nuk disponon "Formularin e sigurimit të ofertës" sipas shtojcës 3.*<br>*3. Nuk disponon Certifikatën ISO 9001 sipas pikës 2.3.4 të shtojcës 7 pika 2.3 "Kapaciteti teknik".*<br>*4. Nuk disponon dokumentacionin për punonjësit e kualifikuar sipas pikës 2.3.1 a dhe b të shtojcës 7 pika 2.3 "Kapaciteti teknik".*<br>*5. . Nuk disponon dokumentacionin për mjetet dhe pajisjet sipas pikës 2.3.3 të shtojcës 7 pika 2.3 "Kapaciteti teknik".* |
| 3. | Ẅoo. | 39,945,024 | *1. Në shtojcën 7 pika 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3 "Kapaciteti teknik" ku kërkohet dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të kryera gjatë 3 viteve të fundit, Ofertuesi nuk disponon fare xhiro për vitet 2019 dhe 2020 ndërsa për vitin 2021 disponon një xhiro simbolike.*<br>*2. Nuk disponon "Formularin e sigurimit të ofertës" sipas shtojcës 3.*<br>*3. Nuk disponon Certifikatën ISO 9001 sipas pikës 2.3.4 të shtojcës 7 pika 2.3 "Kapaciteti teknik".* |
| 4. | R.P. | 18,709,000 | *1. Në "Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit" pjesa e II-të, pika b "Deklarata e dorëzimit të ofertave të pavarura" pika 6 (a) dhe (b) nuk është çekuar as pika (a) as pika (b).*<br>*2. Certifikata ISO 9001 me nr. AL979649 nuk përfshin aktivitetin e druve të zjarrit si edhe në mungesë të QR ose barcode-it nuk mund të verifikohej vlefshmëria e saj.*<br>*3. Në "Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit" pjesa e III-të pika b "Deklarata për deponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme", mungojnë të dhënat konkrete të kërkuara nga formulari, si edhe nga dokumentacion i shoqërues, punonjësit e specializuar janë mobilierë dhe jo punonjës druri sipas kërkesës së specifikimeve teknike. Gjithashtu në mungesë të listëpagesës bashkëngjitur nuk mund të vërtetohej se punonjësit e lartpërmendur janë të Ofertuesit apo jo.*<br>*4. Në shtojcën 7 pika 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3 "Kapaciteti teknik" ku kërkohet dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të kryera gjatë 3 viteve të fundit, Ofertuesi ka bashkëngjitur kontratën me "El.E.Mon Ike" si edhe faturat përkatëse. Komisioni kontrolloi faturat dhe konstatoi se në asnjërën prej tyre nuk kishte tregtim drush zjarri sipas kërkesës së DT.*<br>*5. Në shtojcën 7 pika 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.2 "Kapaciteti ekonomik dhe fI.nciar" pika b, kërkohet paraqitja e bilanceve të viteve 2019, 2020, 2021. Komisioni pasi shqyrtoi dokumentacionin bashkëngjitur për këtë pikë, konstatoi se Ofertuesi ndodhet në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 10091 dt. 05.03.2008 neni 41, pra duhet të kishte paraqitur edhe akt ekspertizat nga Eksperti Kontabël i Autorizuar, të cilat mungojnë, në shkelje të "Kritereve të veçanta të kualifikimit" pika 2.2, pika b* |

Sipas PV datë 3.4.2023 nga 4 OE pjesëmarrës në garë, nga KVO-ja janë skualifikuar 3 OE dhe është kualifikuar 1 OE, konkretisht subjekti "G" (PF), sipas të dhënave të paraqitura në tabelën sipër.

Sa më sipër subjekti "G" (PF), me ofertë me vlerë 39,889,800 lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme, pasi plotëson kriteret e DST sipas KVO.

Ankesa pas **nuk ka.**

Me PV datë 5.4.2023, nga KVO-ja është bërë verifikimi i dokumentacionit sipas formularit të vetëdeklarimit. Raporti përmbledhës është me datën 25.4.2023 nr. 1859/3 prot, i cili është nënshkruar nga anëtarët e KVO dhe miratuar nga zj. E.S. me funksion Titullar i AK.

Formulari i *njoftim fituesit* është me datë 26.4.2023 nr. 1859/4, shpallur në buletin e APP nr. 32, datë 11.4.2023.

Në përfundim të procedurës midis AK Bashkia Durrës përfaqësuar nga zj. E.S. dhe subjektit "G" (PF), është lidhur kontrata nr. 1859/5, datë 8.5.2023 me afat 150 ditë nga lidhja.

**Vlerësimi i procedurës.** *Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE), dosjen fizike, konstatohet se KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer në zbatim të dispozitave të LPP.*

**Zbatimi i kontratës.** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e kontratës, konstatohet se malli nuk është lëvruar në afatin kohorë të 150 ditëve ose nga data 01.11.2023 deri me datë 31.3.2024, kjo në zbatim të kontratës nr. 1859/5, datë 8.5.2023 (kushtet e veçanta të kontratës), pika 7.5, ku thuhet se: *"Afati i zbatimit të kontratës është 150 ditë duke filluar nga data 01.11.2023 deri më datë 31.3.2024".*

Referuar të dhënave të likuidimeve marrë nga fI.nca e QEA Bashkia Durrës kemi këtë situatë:

| **Urdhër shpenzim** | | **Faturë likuidimi** | | **Fletë hyrje** | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr./datë** | **Vlerë** | **Nr./datë** | **vlerë** | **Nr./datë** | **Vlerë** |
| 625/7.12.2023 | 12,337,200 | 22/4.12.2023 | 12,337,200 | 52/4.12.2023 | 12,337,200 |
| 677/26.12.2023 | 10,451,160 | 24/22.12.2023 | 10,451,160 | 57/22.12.2023 | 10,451,160 |
| 166/7.5.2024 | 12,079,400 | 1/2.5.2024 | 25,079,400 | 18/2.5.2024 | 25,079,400 |
| 167/7.5.2024 | 8,000,000 | | | | |
| 168/7.5.2024 | 5,000,000 | | | | |
| **Shuma likuiduar** | **47,867,760** | **-** | **47,867,760** | **-** | **47,867,760** |

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se kontrata nr. 1859/5, datë 8.5.2023 me vlerë 47,867,760 lekë me TVSH dhe afat zbatimi 150 ditë është zbatuar deri me datë 2.5.2024.

Nga sa sipër, kjo kontratë nuk është zbatuar në pikës 7- *Kushtet e veçanta të kontratës*, pika 7.5, ku thuhet se: *"Afati i zbatimit të kontratës është 150 ditë duke filluar nga data 01.11.2023 deri më datë 31.3.2024".,* pasi një pjesë e mallit është dorëzuar jashtë këtij afati, konkretisht fatura nr. 1, datë 2.5.2024 dhe bërë hyrje me FH nr. 18, datë 2.5.2024 për vlerën 25,079,400 lekë **ose me 32 ditë vonesë**.

Nga AK Bashkia Durrës (peronat përgjegjës), nuk është bërë i mundur llogaritja e kamatëvonesave në zbatim të nenit 10 pika 10.1/a, në masën 4/1000 e vlerës së mbetur, por jo më pak se 25%, *vlerë e cila duhet të ishte***: 25,079,400 x 0.25% x 0.004 x 32 ditë/vonesë = 802,540.8 lekë, me efekt me dem në buxhetin e Bashkisë Durrës,** duke ngarkuar me përgjegjësi komisionin e marrjes në dorëzim sipas urdhrit të titullarit nr. 267, datë 01.9.2023 (prot 1859/1), i përbërë nga **M.G., N.H. dhe M.A..**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar Bashkia Durrës janë paraqitur observacioni me shkresë nr. 668/88 prot, datë 17.06.2026 *(administruar në KLSH nr. 1347/71 Prot, dt. 18.06.2026)* "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga M.G., N.H. dhe M.A., në cilësinë e komisionit të marrjes në dorzim, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:** *Komisioni i marrjes në dorëzim ngritur me urdhërin nr. 267 prot 1859/7 datë01.09. 2023, duke qenë se nga specifika dhe lloji i mallit që nuk mund të depozitohet fizikisht në magazinën e QEA-së, si edhe bazuar në DST dhe konkretisht te "Specifikimet Teknike " për "Blerje dru zjarri dhe pellet për QEA" , ku përcaktohet se:*

*Furnizimi me pelet do të bëhet nga ana e subjektit kontraktues nga ora 08:00 deri në orën 16:00, nga dita e hënë në të premte, në institucionet të cilat janë me kaldajë dhe ndodhen brenda territorit të Njësive Administrative të Bashkisë Durrës, sipas grafikut.*

*Është bërë lëvrimi i mallit brenda afateve të përcaktuar në DST dhe kontratë, gjë që vërtetohet me flete daljet përkatëse me date 13.12.2023- 23.03.2024, të cilat janë lëshuar nga operatori dhe janë firmosur nga përfaqësuesit e institucioneve arsimore , të cilët disponojnë kaldaje me pellet dhe soba me dru. Kjo tregon se firma është treguar korrekte në zbatimin e kontratës në afatin 150 ditë ( duke filluar 1 Nëntor 2023- 31 Mars 2024 ). Pra nga ana e firmës nuk ka asnjë devijim në afatin e zbatimit të kontratës ( ngrohja bëhet për periudhën e dimrit , si rrjedhoje dhe furnizimi bëhet po në këtë periudhë).*

*Fatura elektronike e lëshuar nga OE dhe fletë hyrja e bërë nga magazine janë dokumentacion justifikues për të bërë likuidimin e mallit , të cilin për mungese fondesh të disponueshme në buxhet jemi detyruar që pagesën ta bëjmë në datën 02.05.2024 duke bërë të disponueshme dhe fondet e muajit Maj 2024, pasi gjatë kësaj periudhe duhet të likuidonim dhe zërat e tjerë të shpenzimeve operative shumë të domosdoshme për funksionimin Institucionit tonë.( energji elektrike, ujë, ushqime etj ).*

*Zbatimi i kontratës vërtetohet nga dorëzimi i mallit në institucionet arsimore sipas (planit të shpërndarjes ), i cili është bërë brënda 150 ditëve, kjo e vërtetuar nga fletë daljet e firmosura nga drejtuesit e institucioneve arsimore Brenda dates 31.03.2024. Me vonesën prej 32 ditësh i është shkaktuar një dem kontraktuesit për likuidim me vonese ,për mungese fondesh., kjo e kërkuar nga ana jonë për të lëshuar faturën në momentin që fondet I kishim në dispozicion, në një kohë që dorëzimi I mallit ka përfunduar Brenda afatit 150 ditë ( periudha 31.03.2024).*
*Edhe një here theksojmë se për specifikën që ka kjo procedure, malli merret në dorëzim në periudhen e dimrit duke filluar nga 01.11.2023-31.03.2024.*
**Qëndrimi i grupit të auditimit**: Për sa keni observuar, sqarojmë se pretendimet nuk qëndrojnë, pasi nga ana juaj nuk është paraqitur asnjë element shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilat grupi i auditimit është shprehur në me qëndrimin e tij në projektraportin e paraqitur. Referuar dokumentacionit (faturave), malli është bërë hyrje jo referuar pikës 7- Kushtet e veçanta të kontratës, pika 7.5, ku thuhet se: *"Afati i zbatimit të kontratës është 150 ditë duke filluar nga data 01.11.2023 deri më datë 31.3.2024"., pasi një pjesë e mallit është dorëzuar jashtë këtij afati, konkretisht fatura nr. 1, datë 2.5.2024 dhe bërë hyrje me FH nr. 18, datë 2.5.2024 për vlerën 25,079,400 lekë* ***ose me 32 ditë vonesë.***

**10- Auditim i procedurës me objekt** "*Riaftësim strukturore i pallatit Big Kristi, Durrës, rruga Neki Libohova nr. 62, Kod Gis 5058"*, viti 2024.

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Riaftësim strukturore i pallatit Big Kristi, Durrës, rruga Neki Libohova nr. 62, Kod Gis 5058"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>"E kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit për kontrata punë publike, në zbatim të Vendimit të Komisionit Shtetërorë të Rindërtimit nr. 114, datë 16.4.2024, sipas Kreut VI , të nenit 40 të aktit normativ nr. 9, datë "<br>REF-12310-07-05-2024<br>Urdhri nr. 7927/1 prot., datë 3.7.2024</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)<br>Urdhri nr. 206 prot., datë 26.6.2024<br>1. E.T.<br>2. J.K.<br>3. A.K.<br>Fuknsionet:<br>a-Hartimi i specifikimeve teknike;<br>b-Përllogaritja e fondit limit;<br>c-Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitet teknike;<br>d-Përcaktim i çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit;<br>e-Hartimi i kërkesave për shpalljen e ofertës fitues.</td><td>2 Njësia e Prokurimit nr. 7927/1 prot., datë 3.7.2024<br>1-E.Gj., me detyrë Spec. Prokurimesh<br>2-K.Dh., me detyrë Spec Sek. Prokurimeve<br>3-O.Sh., me detyrë Drejt. Shërbimeve Publike Bashkia Durrës</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhri nr. 213 prot., datë 3.7.2024.<br>1. A.I., tek Drejt e Shërbimeve<br>2. K.B., Jurist Drejt. Shërbimeve<br>3. L.B., specialist DTTV</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)<br>156,383,025 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)<br>156,015,648 lekë<br>Fitues: BOE "R" + "G" sh.p.k</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)<br>365 mijë lekë ose 99.7%</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:<br>Data 18.7.2024<br><br>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 224 ditë.</td><td colspan="2">8. Burimi FI.ncimit<br>Buxheti shtetit.</td><td>9. Operatoret Ekonomike<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 8 B/OE<br>b) S'kualifikuar 7 B/OE,<br>c) Kualifikuar 1 B/OE</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime AK-s'ka/ka; -Jo APP–s'ka/ka;-Jo KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:<br>Data: 7.8.2024 nr. 7927/4 prot. (njoftim fituesi)</td><td>12.Data e lidhjes së kontratës:<br>Draft marrëveshje kuadër nr. 7927/9 prot, dt. 28.8.2024.<br>Kontrata për zbatim nr. 7927/10 prot, dt. 28.8.2024</td></tr>
</table>

**Në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit:** Me urdhrin nr. 206 *prot*., datë 26.6.2024 titullari i AK ka urdhëruar *E.T., J.K. dhe A.K.,* për hartimin e specifikimeve teknike, relacionit teknik, leje infrastrukturë, grafik punimesh dhe fondin limit, në lidhje me objektin: "*Riaftësim strukturore i pallatit Big Kristi, Durrës, rruga Neki Libohova nr. 62, Kod Gis 5058*".

Në zbatim të urdhrit të titullarit është përgatitur materiali përkatës, ku sipas PV është përllogaritur fondi limit në vlerën 156,383,025 lekë pa TVSH, i cili është hartuar nga studio projektuese B/OE "A" + *"A"* sh.p.k

**Konstatimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezultoi se AK bashkia Durrës **nuk ndodhet e depozituar në dosje** "*leje ndërtimi/infrastrukture*", veprime në kundërshtim me nenin 39[5] pika 3[6] të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar.

Gjithashtu, **nuk** rezulton të jetë kryer dhe "*oponenca teknike"*, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, si dhe pikës 4 të VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 "*Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit"*, **ngarkohet me përgjegjësi Titullari i AK z. E.J.** *(person i autorizuar për mbarëvajtjen e procedurës)* dhe sipërmarrësin e punimeve **BOE "R" + "G" sh.p.k**

**Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*" datë 5.7.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se kriteret e aplikuara janë të argumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës, në përputhje me pikën 2 germa (c) e nenit 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), nenit 78 pika 4, në përputhje me nenet 55 e 56 të LPP-së i ndryshuar.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në referim të PV datë 18.7.2024 është bërë hapja procedurës, ku evidentohet se kanë shprehur interes për pjesëmarrje 8 OE, si më poshtë vijon:

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|
| 1 | B. | ***Skualifikuar:***<br>*-Kontratat e mjeteve me qira janë pa noter, në kundërshtim me nenin 801 të KC;*<br>*-Kamioni me targë AA511LU është 32 ton, ku pesha është kërkuar 3.5-7.5 dhe 7.5-18 ton;*<br>*-Nuk paraqet mjete me tonazh 3.5-7.5 ton, 2 copë;*<br>*-Mjeti me targë AA295 DS dhe AB928BT me kontratë bashkëpunimi (pa noter) me shoqërinë "D" datë 24.6.2024, janë të njëjtat mjete të vëna në dispozicion nga OE "I" sh.p.k me kontratë qiraje datë 6.9.2021 me afat 3 vjeçar* |
| 2 | I. | ***Skualifikuar:***<br>*-Kontrata e qirasë për mjetet me targë AA603IR dhe AA817SJ janë pa noter në kundërshtim me nenin 801 të KC;*<br>*-Mjetet me targë AA295DS dhe AB928BT me KQ datë 6.9.2021, figurojnë të njëjtat mjete të cilat kamë vënë në dispozicion nga shoqëria "B" me kontratë bashkëpunimi datë 24.6.2024 lidhur me shoqërinë "D" sh.p.k* |
| 3 | I. | **Kualifikohet** |
| 4 | L.VII + S. | ***Skualifikihet:***<br>*-Në formularin e vlerësimit (shtojca 12) për objektin "Riforcim pallate me kod gis 25759/25583/etj., është cilësuar si OE i vetëm me 100% të punimeve, por sipas dokumentacionit bashkëlidhur është me bashkim operatorësh si: L. VII 26%; U. 51%, Sh.-2AB 14%, S. 9%;* |

[5] përcakton se: "Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji".

[6] përcakton se: "Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit".

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|
| | | *-Ka mospërputhje në paga për stafin inxhinjerik midis vlerës së kontratës dhe pagës në listpagesë.* |
| 5 | L.K. | ***Skualifikohet*:**<br>*-Kamioni me targë AB244OK me KQ nr. 27777, datë 18.3.2023 nuk i përket targës që është paraqitur tek shtojca 13, por i përket targës AB608CV e cila nuk figuron në shtojcën e mjeteve, pra mungon një kamion 7.5-18 ton.* |
| 6 | N. | ***Skualifikohet:***<br>*-Nuk plotëson kriterin e pikave 2.3/m dhe 2.3.6 të stafit të kualifikuar, pasi për 8 murator dhe 8 bojaxhi ka paraqitur të njëjtit persona;*<br>*Stafi teknik 4 hidroizolues dhe 6 hekurkthyes janë të njëjtit persona;*<br>*-Në pikën 2.3/6 është sqaruar që në llogaritjen e numrit të punonjësve janë marrë parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar ku është hartuar dhe grafiku i punimeve;*<br>*-Punëtorët e thjeshtë D.GJ dhe TH.N kanë kontratë pune datë 18.6.2023, por nuk janë në listpoagesat e muajt maj 2024.* |
| 7 | U. | ***Skualifikuhet*:**<br>*-KQ datë 14.9.2023 me shoqërinë "N" dhe "B" sh.p.k për mjetin "Autobetonjere" me targë AA691GJ; AA077HM; AB306JB, nuk është KQ e rregullt noteriale, pasi në fund të saj qiramarrësi dhe qiradhënësi është nënshkruar nga shoqëria :"N" sh.p.k, gjë e cila e bën kontratën të pavlefshme;*<br>*-Nuk plotëson shtojcën 4 dhe 7 sipas formatit të DST* |
| 8 | R.N. + "G". | **Kualifikohet/Fitues** |

Sipas PV datë 22.7.2024 nga 8 OE pjesëmarrës në garë, nga KVO-ja janë skualifikuar nga faza e parë 6 OE, duke kualifikuar 2 OE për në fazën e dytë, sipas të dhëna në tabelën sipër.
Me tej procedura vijon në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" dhe nenit 90 të LPP[7].
Me shkresën (*ftesë për ofertë*) nr. 7927/3 *prot*, datë 29.7.2024 janë ftuar për fazën e dytë 2 OE e kualifikuara në fazën e parë, konkretisht B/OE "R" + *"G"* sh.p.k dhe OE "I" sh.p.k, për paraqitjen e ofertave.
Sipas PV datë 01.8.2024 është bërë hapja e fazës së dytë mbi ofertat e paraqitura nga OE e kualifikuara në fazën e parë, ku: B/OE "R" + *"G"* sh.p.k paraqet ofertën prej 156,015,648 lekë pa TVSH dhe OE "I" sh.p.k me ofertë 156,385,085 lekë pa TVSH.
Kriteret e vlerësimit të fazës së dytë janë: *Koha e zbatimit të projektit 30 pikë; çmimi më i ulët 60 pikë dhe cilësia 10 pikë.*
Me PV datë 01.8.2024, nga KVO-ja është bërë vlerësimi i fazë së 2-të ku është vendosur që OE "I" sh.p.k të vlerësohet me 40 pikë dhe të skualifikohet pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës. Ndërsa B/OE "R" + *"G"* sh.p.k është vlerësuar me 100 pikë, duke u shpallur fitues..
Me shkresën datë 5.8.2024 është bërë klasifikimi përfundimtar, duke shpallur fitues B/OE "R" + *"G"* sh.p.k me ofertë 156,015,648 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 7927/*prot*, datë 7.8.2024 është hartuar *Raporti Përmbledhës* i cili është miratuar dhe nga titullari i AK *z. E.J.* (person i autorizuar).
Me shkresën nr. 7927/6 *prot*, datë 7.8.224 është bërë *njoftim fituesi*, shpallur në buletinin e APP nr. 46, datë 8.8.2024.
Me datë 28.8.2024 nga KVO-ja është mbajtur PV për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar në formë shkresore me atë të ngarkuar në SPE nga B/OE "R" + *"G"* sh.p.k për fazën e parë dhe të dytë, ku rezultojë se është i njëjti dokumentacion.

**Vlerësimi i fazës së parë të procedurës***:* Nga auditimi i dokumentacionit mbi OE të skualifikuar në fazën e parë, sipas grupit të auditimit rezultoi se vlerësimi i KVO nuk është në zbatim të dispozitave të LPP, për faktin se:
***I- Skualifikimi i shoqërive "B" sh.p.k***, nuk qëndron, kjo sipas grupit të auditimit, *për faktin se*:

[7] Ligji nr. 162, datë 13.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

a- Shoqëria "B" sh.p.k është skualifikuar pasi nuk paraqet mjete me masë maksimale 3.5-7.5 ton copë dy. Sipas DT nuk janë kërkuar 2 mjete me tonazh 3.5-7.5 ton **por vetëm një mjet**, për të cilën shoqëria ka vetëdeklaruar dhe paraqitur dokumentacionin e mjetit me targë AA859LG.

b- Për plotësimin e kriterit automjet vetëshkarkues me kapacitet 7.5-18 ton (një copë), nga shoqëria është deklaruar dhe paraqitur dokumentacion mjeti me targë AA592MN me masa maksimale 16.8 ton, pavarësisht faktit se nga shoqëria mund të jenë paraqitur dhe dokumente për mjete të tjera, kjo referuar formularit të vetëdeklarimit (shtojca 8);

c- Në lidhje me kërkesën për mjetin tip "*Autobetonjer"*, rezultoi se nga shoqëria është vetëdeklaruar mjeti me targë AB928BT me kontratë qiraje nr. 196, datë 24.6.2024 me shoqërinë "D" sh.p.k për të cilën janë depozituar dhe dokumentacioni ligjorë. **Në këto kushte skualifikimi është i padrejtë.**

***II- Në lidhje me skualifikimin e shoqërisë "I" sh.p.k***, sqarojmë se:

Në lidhje me mangësi se për mjetin tip "*Autobetonjer",* me kontratë qiraje nr. 7217rep/1453kol, datë 6.9.2021 për mjetet me targë AA296DS dhe AB928BT janë të njëjtat mjete që ka deklaruar dhe shoqëria "B", sqarojmë se:

a- Sipas DT është kërkuar vetëm një *autobitumatrice* për të cilin shoqëria "B"" sh.p.k ka deklaruar mjetin me targë AB928BT me kontratë qiraje me shoqërinë "D" sh.p.k;

b- Nga shoqëria "I" sh.p.k janë paraqitur dy mjete *Autobitumatrice* me kontratë qiraje nga një që kërkohet, por sipas dokumenteve në sistem nuk dihet se me kë e ka kontratën e qirasë. Sipas KVO shkruhet se e ka me po të njëjtën shoqëri "D" sh.p.k, por dhe nëse është e njëjta shoqëria ajo ka të deklaruara dy nga një që kërkohet dhe njëri nga mjetet kanë targa të ndryshme në kontrata të ndryshme, respektivisht AA295/DT (I.)/ AA296DT (B.). Ndërkohë KVO i ka marrë si targa të njëjta.

***III- Në lidhje me skualifikimin e shoqërisë "U" sh.p.k***, sipas KVO është skualifikuar, pasi nuk ka plotësuar formularin sipas shtojcës 4 dhe 7, si dhe kontrata e qirasë datë 14.9.2023 me shoqërinë "N" sh.p.k dhe "B" sh.p.k për mjetin "*Autobetonjere*" me targë AA691GJ; AA077HM; AB306JB, nuk është kontratë qiraje e rregullt noteriale, pasi në fund të sajë qiramarrësi dhe qiradhënësi është nënshkruar nga shoqëria "N" sh.p.k, gjë e cila e bën kontratën të pavlefshme, nga verifikimi rezultoi se skualifikimi është i padrejtë**,** pasi asnjë nga pretendimet e KVO nuk qëndrojnë, duke sqaruar se nga shoqëria janë paraqitur formularët sipas shtojcës 4 dhe 7, foto:
*Nga subjekti bashkia Durrës (anëtarët e KVO), gjatë fazës së akteve nuk janë paraqitur kundërshtim, duke mos i kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit.*

**IV-** Në lidhje me vlerësimin e KVO-së, për shpalljen fitues të JV "R" + "G" sh.p.k, nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, sipas grupit të auditimit, ky B/OE **nuk është në kushtet e plotësimit të kërkesave të DST të miratuara nga AK,** *si më poshtë vijon*:

**a-** Nga shoqëria "G" sh.p.k, për punonjësin *K.L* me profil "*murator*", konstatohet se nuk përputhet paga sipas kontratës me pagën sipas listpagesës, **kriter i cili është përdorur si kriter skualifikuar në OE e skualifikuar në të njëjtën procedurë.**

**b-** Nisur nga fakti se JV "R" + "G" sh.p.k është shpallur fitues dhe në procedurën me objekt: "*Riaftësim strukturor i pallatit nr. 8 dhe nr. 10, rruga Pelikan me kod gis 5709-5711* me fond limit 291,310,068 lekë pa TVSH, për të cilat janë deklaruar të njëjtat mjete, staf dhe drejtues teknik, **KVO-ja duhej të skualifikonte në njërën nga procedurat**.

**Si përfundim**, në lidhje me vlerësimin e dokumentacionit ligjorë për fazën e parë të kryer nga KVO-ja, vlerësimi nuk është i drejt dhe në përputhje me dispozitat e LPP, pasi nga KVO-ja janë skualifikuar shoqëri me kritere të plotësuara dhe skualifikuar shoqëri me kritere të plotësuara, të cilat nëse do ishin vlerësuar në plotësim të kritereve të DT, do ndikonin për në fazën e dytë atë të ofertave, në rritjen e konkurrencës dhe përdorim më efektiv të fondeve nga rritja e numërit të pjesëmarrësve në procedurë, veprime në kundërshtim me 3E, duke **ngarkuar me përgjegjësi:**

*A.I., K.B. dhe L.B.***,** në cilësinë e anëtarit të KVO, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" ( i ndryshuar), neni 2, neni 3 pika 1, neni 92 pika 3 dhe 4.

**11- Auditim i procedurës me objekt** " *Riaftësim strukturor i pallatit nr. 8 dhe nr. 10, rruga Pelikan me kod gis 5709-5711", viti 2024.*

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Riaftësim strukturor i pallatit nr. 8 dhe nr. 10, rruga Pelikan me kod gis 5709-5711"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>"E kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit për kontrata punë publike, në zbatim të Vendimit të Komisionit Shtetërorë të Rindërtimit nr. 114, datë 16.4.2024, sipas Kreut VI , të nenit 40 të aktit normativ nr. 9, datë "<br>REF-12226-07-05-2024<br>Urdhri nr. 7922/1 prot., datë 3.7.2024</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)<br>Urdhri nr. 202 prot., datë 26.6.2024<br>1. E.T.<br>2. J.K.<br>3. A.K.<br>Fuknsionet:<br>a-Hartimi i specifikimeve teknike;<br>b-Përllogaritja e fondit limit;<br>c-Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitet teknike;<br>d-Përcaktim i çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit;<br>e-Hartimi i kërkesave për shpalljen e ofertës fitues.</td><td>2 Njësia e Prokurimit nr. 7922/1 prot., datë 3.7.2024<br>1-E.Gj., me detyrë Spec. Prokurimesh<br>2-K.Dh., , me detyrë Spec Sek.Prokurimeve<br>3-S.X</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhri nr. 214 prot., datë 3.7.2024.<br>1. A.I., tek Drejt e Shërbimeve<br>2.K.B., Jurist Drejt. Shërbimeve<br>3. L.B., specialist DTTV (sipas dokumentacionit në dosje nuk rezulton i nënshkruar formulari i deklarimit të konfliktit të interesit)</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)<br>291,310,068 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)<br>290,577,196 lekë<br>Fitues: BOE "R" + "G" sh.p.k</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)<br>733 mijë lekë ose 0.25%</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:<br>Data 18.7.2024<br>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 224 ditë.</td><td colspan="2">8. Burimi FI.ncimit<br>Buxheti Bashkia Durrës.</td><td>9. Operatoret Ekonomike<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 6 B/OE<br>b) S'kualifikuar 5 B/OE,<br>c) Kualifikuar 1 B/OE</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime<br>AK-s'ka/ka; -Jo<br>APP–s'ka/ka;-Jo<br>KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:<br>Data: 7.8.2024 nr. 7922/6 prot. (njoftim fituesi)</td><td>12.Data e lidhjes së kontratës:<br>Draft marrëveshje kuadër nr. 7922/13 prot, dt. 28.8.2024.<br>Kontrata për zbatim nr. 7922/14 prot, dt. 28.8.2024</td></tr>
</table>

**Në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit:** Me urdhrin nr. 202 *prot*., datë 26.6.2024 titullari i AK ka urdhëruar *E.T., J.K. dhe A.K.* për përgatitjen e specifikimeve teknike, relacionit teknik, leje infrastrukturë, grafik punimesh dhe fondin limit, në lidhje me objektin: "*Riaftësim strukturor i pallatit nr. 8 dhe nr. 10, rruga Pelikan me kod gis 5709-5711*". Në zbatim të urdhrit të titullarit është përgatitur materiali përkatës, ku sipas PV është përllogaritur fondi limit në vlerën 291,310,068 lekë pa TVSH nga studio private B/OE "A" + *"A"* sh.p.k

**Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*" datë 5.7.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se kriteret e aplikuara janë të argumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës, në përputhje me dispozitat e LPP.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në referim të PV datë 18.7.2024 është bërë hapja procedurës, ku evidentohet se kanë shprehur interes pjesëmarrje gjithsej 6 OE, si më poshtë vijon:

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|
| 1 | B | **Skualifikuar***:*<br>*-Kontratat e mjeteve me qira janë pa noter, në kundërshtim me nenin 801 të KC;* |

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|
| | | *-Kamioni me targë AA511LU është 32 ton, ku pesha është kërkuar 3.5-7.5 dhe 7.5-18 ton;*<br>*-Nuk paraqet mjete me tonazh 3.5-7.5 ton, 2 copë;*<br>*-Mjeti me targë AA295 DS dhe AB928BT me kontratë bashkëpunimi (pa noter) me shoqërinë "D" datë 24.6.2024, janë të njëjtat mjete të vëna në dispozicion nga OE "I" sh.p.k me kontratë qiraje datë 6.9.2021 me afat 3 vjeçar* |
| 2 | I | **Kualifikohet** |
| 3 | L. VII + S. | **Skualifikihet*:***<br>*-Në formularin e vlerësimit (shtojca 12) për objektin "Riforcim pallate me kod gis 25759/25583/etj., është cilësuar si OE i vetëm me 100% të punimeve, por sipas dokumentacionit bashkëlidhur është me bashkim operatorësh si: L.VII 26%; U. 51%, Sh.-2AB 14%, S. 9%;*<br>*-Ka mospërputhje në paga për stafin inxhinjerik midis vlerës së kontratës dhe pagës në listpagesë.* |
| 4 | L.K. | **Skualifikohet:**<br>*-Kamioni me targë AB244OK me KQ nr. 27777, datë 18.3.2023 nuk i përket targës që është paraqitur tek shtojca 13, por i përket targës AB608CV e cila nuk figuron në shtojcën e mjeteve, pra mungon një kamion 7.5-18 ton.* |
| 5 | U. | ***Skualifikuhet*:**<br>*-KQ datë 14.9.2023 me shoqërinë "N" dhe "B" sh.p.k për mjetin "Autobetonjere" me targë AA691GJ; AA077HM; AB306JB, nuk është KQ e rregullt noteriale, pasi në fund të sajë qiramarrësi dhe qiradhënësi është nënshkruar nga shoqëria :"N" sh.p.k, gjë e cila e bën kontratën të pavlefshme;*<br>*-Nuk plotëson shtojcën 4 dhe 7 sipas formatit të DST* |
| 6 | R.N. + "G" | **Kualifikohet/Fitues** |

Sipas PV datë 22.7.2024 nga 6 OE pjesëmarrës në garë, nga KVO-ja janë skualifikuar nga faza e parë 4 OE dhe janë kualifikuar 2 OE, sipas të dhëna në tabelën sipër, kjo për fazën e parë të vlerësimit të dokumentacionit ligjor/teknik.
Me tej procedura vijon në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" dhe nenit 90 të LPP.
Me shkresën (*ftesë për ofertë*) nr. 7922/6 *prot*, datë 29.7.2024, janë ftuar për fazën e dytë 2 shoqëritë e kualifikuara në fazën e parë, konkretisht B/OE "R" + *"G"* sh.p.k dhe shoqëria "I" sh.p.k, për paraqitjen e ofertave për zbatimin e punimeve deri datë 01.8.2024.
Sipas PV datë 01.8.2024 është bërë hapja e fazës së 2 mbi ofertat e paraqitura nga shoqëritë e ftuara, ku: B/OE "R" + *"G"* sh.p.k paraqet ofertën prej 290,577,196 lekë dhe OE "I" sh.p.k me ofertë 291,314,072 lekë.
Vlerësimi do të bëhet për kriteret: *Koha e zbatimit të projektit 30 pikë; çmimi më i ulët 60 pikë dhe cilësia 10 pikë.*
Me PV datë 01.8.2024, nga KVO-ja është bërë vlerësimi i fazë së 2-të ku është vendosur që OE "I" sh.p.k të vlerësohet me 40 pikë, duke e skualifikuar pasi nuk ka paraqitur sigurimin dhe të kualifikohet B/OE "R" + *"G"* sh.p.k me 100 pikë.
Me shkresë datë 5.8.2024 është bërë klasifikimi përfundimtar duke shpallur fitues B/OE "R" + *"G"* sh.p.k me ofertë 290,577,196 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 7922/7 *prot*, datë 7.8.2024 është hartuar *Raporti Përmbledhës* i cili është miratuar dhe nga titullari i AK *z. E.J.*.
Me shkresën nr. 7922/6 *prot*, datë 7.8.224 është bërë *njoftim fituesi*, shpallur në buletinin e APP nr. 46, datë 8.8.2024.
Me datë 28.8.2024 nga KVO është mbajtur PV për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar në formë shkresore me atë të ngarkuar në SPE për fazën e parë dhe të dytë, ku rezultojë se është i njëjti dokumentacion.

**Vlerësimi i fazës së parë të procedurës**: Nga auditimi i dokumentacionit mbi OE të skualifikuar në fazën e parë, sipas grupit të auditimit rezultoi se vlerësimi i KVO **nuk është në zbatim të**

**dispozitave të LPP,** duke argumentuar se disa nga OE e skualifikuar, nuk duhet të ishin skualifikuar, pasi sipas grupit të auditimit plotësonin kriteret e DT. E konkretisht:

a- Shoqëria "B" sh.p.k është skualifikuar pasi nuk paraqet mjete me tonazh 3.5-7.5 ton copë dy. Sipas DST nuk janë kërkuar 2 mjete me tonazh 3.5-7.5 ton por vetëm një mjet, për të cilën shoqëria ka vetëdeklaruar dhe paraqitur dokumentacionin e mjetit me targë AA859LG. Për plotësimin e kriterit automjet vetëshkarkues me kapacitet 7.5-18 ton ku kërkohet një copë, nga shoqëria është deklaruar dhe paraqitur dokumentacion mjeti me targë AA592MN me kapacitet 16.8 ton, pavarësisht faktit se nga shoqëria mund të jenë paraqitur dhe dokumente për mjete të tjera;

Në lidhje me kërkesën për mjetin tip "*Autobetonjer"*, rezultoi se nga shoqëria është vetëdeklaruar mjeti me targë AB928BT me KQ nr. 196, datë 24.6.2024 me shoqërinë "D" sh.p.k për të cilën janë depozituar dhe dokumentacioni ligjorë.

**b-** Për mangësitë e konstatuara mbi skualifikimin e shoqërisë "I" sh.p.k, në lidhje me mangësi se për mjetin tip "*Autobetonjer",* me kontratë qiraje nr. 7217*rep.*/1453*kol*, datë 6.9.2021 për mjetet me targë AA296DS dhe AB928BT janë të njëjtat mjete që ka deklaruar dhe shoqëria "B", sqarojmë se:

Sipas DST është kërkuar vetëm një *autobitumatrice* për të cilin shoqëria "B" sh.p.k ka deklaruar mjetin me targë AB928BT me kontratë qiraje me shoqërinë "D" sh.p.k;

Nga shoqëria "I" sh.p.k janë paraqitur dy mjete *Autobitumatrice* me kontratë qiraje nga një që kërkohet, por sipas dokumenteve në sistem nuk dihet se me kë e ka kontratën e qirasë. Sipas KVO shkruhet se e ka me po të njëjtën shoqëri "D" sh.p.k, por dhe nëse është e njëjta shoqëria ajo ka të deklaruara dy nga një që kërkohet dhe njëri nga mjetet kanë targa të ndryshme në kontrata të ndryshme, respektivisht AA295/DT (I...)/ AA296DT (B..). Ndërkohë KVO i ka marrë si targa të njëjta.

**c-** Në lidhje me skualifikimin e shoqërisë "U" sh.p.k, ku sipas KVO është skualifikuar, pasi nuk ka plotësuar formularin sipas shtojcës 4 dhe 7, si dhe kontrata e qirasë datë 14.9.2023 me shoqërinë "N" sh.p.k dhe "B" sh.p.k për mjetin "*Autobetonjere*" me targë AA691GJ; AA077HM; AB306JB, nuk është kontratë qiraje e rregullt noteriale, pasi në fund të sajë qiramarrësi dhe qiradhënësi është nënshkruar nga shoqëria "N" sh.p.k, gjë e cila e bën kontratën të pavlefshme, nga verifikimi rezultoi se skualifikimi është i padrejtë**,** pasi asnjë nga pretendimet e KVO nuk qëndrojnë.

**II-** Në lidhje me vlerësimin e KVO-së, për shpalljen fitues të JV "*R.Ndërtim*" + "G" sh.p.k, nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, sipas grupit të auditimit, ky B/OE **nuk është në kushtet e plotësimit të kërkesave të DT të miratuara nga AK,** duke e kualifikuar në kundërshtim me dispozitat e LPP, *si më poshtë vijon*:

a- Referuar aktmarrëveshje nr. 1759/967, datë 13.7.2024 (kontratë bashkëpunimi), të dyja shoqëritë duhet të deklarojnë mjetet sipas pikës 23.3.7 të DST. Nga shoqëria "R" sh.p.k Nuk janë deklaruar mjeti fadrom, autobetonjere dhe skeleri 1000 m2, *fragmenti nga kontrata e bashkëpunimit*:


Te dyja shoqerite do te vene ne dispozicion mjetet e meposhtme:

Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 3.5-7.5 ton (cope 1)
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 7.5-18 ton (cope 1)
Autobetoniere (cope 1)
Skela 1000m2
Fadrome (cope 1)

Palet deklarojne se kane aftesi financiare per te perballuar garancine e perhershme te objektit sic specifikohet ne dokumentat e tenderit si dhe cdo detyrim tjeter financiar qe mund te rrjedh gjate zbatimit te punimeve.

a- Nga shoqëria "G" sh.p.k është paraqitur mjeti *fadromë* në pronësia, por që bashkëlidhur nuk ka foton e mjetit siç kërkohet në DST, fragment:

*Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të paraqese: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, **Foto e mjetit** (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe libreza/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj)*

**b-** Nisur nga fakti se JV "*R.Ndërtim*" + "G" sh.p.k është shpallur fitues dhe në procedurën me objekt: "*Riaftësim strukturore i pallatit Big Kristi, Durrës, rruga Neki Libohova nr. 62, Kod Gis 5058"* me fond limit 156,383,025 lekë pa TVSH, për të cilat janë deklaruar të njëjtat mjete, staf dhe drejtues teknik, KVO-ja duhej të skualifikonte në njërën nga procedurat.

**Si përfundim**, në lidhje me vlerësimin e dokumentacionit ligjorë për fazën e parë të kryer nga KVO-ja, vlerësimi nuk është i drejt dhe në përputhje me dispozitat e LPP, pasi nga KVO-ja janë skualifikuar shoqëri me kritere të plotësuara dhe skualifikuar shoqëri me kritere të plotësuara, të cilat nëse do ishin vlerësuar në plotësim të kritereve të DT, do ndikonin për në fazën e dytë atë të ofertave, në rritjen e konkurrencës dhe përdorim më efektiv të fondeve nga rritja e numërit të pjesëmarrësve në procedurë, veprime në kundërshtim me 3E, duke **ngarkuar me përgjegjësi: *A.I., K.B., dhe L.B.,*** në cilësinë e anëtarit të KVO, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" ( i ndryshuar), neni 2, neni 3 pika 1, neni 92 pika 3 dhe 4.

**12- Auditim i procedurës me objekt:** "*Ndërtim i shkollës 9-vjecare Vadardh Sukth".*

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim i shkollës 9-vjecare Vadardh Sukth"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>"E kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit për kontrata punë publike, në zbatim të Vendimit të Komisionit Shtetërorë të Rindërtimit nr. 114, datë 16.4.2024, sipas Kreut VI , të nenit 40 të aktit normativ nr. 9, datë "<br>REF-27178-10-30-2024<br>Urdhri nr. 7925/2 prot., datë 11</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)<br>Urdhri nr. 205 (7925prot), dt. 26.6.2024-<br>1.L.F.<br>2.R.D.<br>3.B.M.</td><td>2 Njësia e Prokurimit nr. 7925/2 prot., datë 11.10.2024<br>E.Gj.,<br>O.S.<br>K.Dh.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhri nr. 392 (7925/3prot) prot., datë 11.10.202.<br>1. G.K.<br>2.L.S.<br>3. M.J.<br>Sipas dokumentacionit dy nga tre anëtarët nuk kanë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit, konkretisht: G.K. dhe L.S.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)<br>268,788,521 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)<br>260,524,684 lekë<br>Fitues: BOE "P" + "U"</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)<br>8,264 mijë lekë ose 3%</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:<br>Data 11.11.2024<br><br>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 16 muaj.</td><td colspan="2">8. Burimi FI.ncimit<br>Buxheti Bashkia Durrës.</td><td>9. OE<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 6 B/OE<br>b) S'kualifikuar 5 B/OE,<br>c) Kualifikuar 1 B/OE</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime<br>AK-s'ka/ka; -Jo<br>APP–s'ka/ka;-Jo<br>KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:<br>Data: 27.12.2024 nr. 7925/12 prot.<br>(njoftim fituesi)</td><td>12.Data e lidhjes së kontratës:<br>Draft marrëveshje kuadër nr. 7925/13 prot, dt. 31.12.2024.<br>Kontrata për zbatim nr. 7925/14 prot, dt. 31.12.2024</td></tr>
</table>

**Në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit:** Me urdhrin nr. 205 (7925 *prot*), datë 26.6.2024 titullari i AK ka urdhëruar komisionin me përbërje: *L.F., R.D. dhe B.M.* për përgatitjen e specifikimeve teknike, relacionit teknik, leje infrastrukturë, grafik punimesh dhe fondin limit, në lidhje me objektin: "*Ndërtim i shkollës 9-vjecare Vadardh Sukth*". Në zbatim të urdhrit nga ana e komisionit është përgatitur materiali përkatës, ku sipas PV është përllogaritur fondi limit në vlerën 268,788,521 lekë pa TVSH, nga studio private "N" sh.p.k

**Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit nr. ----- *prot*., datë 27.3.2023 "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se disa nga kriteret janë të paargumentuara dhe të lidhura me procedurën e prokuruar, në kundërshtim me nenin 39, "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*", pika 4 të VKM nr**.** 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar,. E konkretisht:

**Pik 2.3.3 e DST.** *OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht: Inxhinier* ***Arkitekt 1 (një****;*
Kërkesa 2 teknik ndërtimi, kur është kërkuar dhe inxhinierë është një kërkesë e paargumentuar, pasi vetëm një do ishte më i mjaftueshëm. Gjithashtu dhe kërkesa për *1 (një) Arkitekt, 1 (një) ing. Mjedisi,* janë të paargumentuar, pasi puna e tyre është ezauruar gjatë fazë së hartimit të projekt/ preventivit.
**Pika 2.3.4 e DST.** *OE, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe <u>stafin mbështetës</u> (jo domosdoshmërish drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:*

- *a- OE duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre* ***1 (një) "Auditues energjie", i cili duhet të jetë i pajisur me "Certifikatë për Auditim Energjie në ndërtesa",*** *lëshuar nga institucione te njohura nga Republika e Shqipërisë, te cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.*

Në nenin 16 pika 4 dhe 5 të Ligjit nr.125/2015 "*Për efincencën e energjisë*" parashikohet se:" 4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për: a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie; b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të fI.ncuar nga Fondi për Efiçencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e efiçencës së energjisë. 5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen: a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij neni; b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm."
Në dokumentet e procedurës së prokurimit, AK ka publikuar njëherazi "Preventivin e punimeve", "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe "Projektin e Zbatimit". Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi, konstatohet se në asnjë rast AK nuk ka parashikuar në "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike" kryerjen e shërbimit të auditimit të eficencës së energjisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga auditues energjetik të licencuar. Gjithashtu AK nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit të efiçencës së energjisë. Sa më sipër, kriteri i mësipërm i vendosur nga AK në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë AK. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.124/2015 "Për efincencën e energjisë", AK në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjetik me një procedurë të veçantë.

*b. OE duhet të ketë në stafin e tij 1(një) punonjës i cili të jetë i pajisur me* ***certifikatë "Ekspert zjarrfikës"*** *ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate , te cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.*

Kërkesa e autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e **një ekspert zjarrfikës**, shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", roli i ekspertit zjarrfikës nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës.

***c.*** *OE ofertues duhet të vërtetojë se ka të punësuar* ***1 (një) inxhinier të pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.***

*Për këtë duhet të paraqesë diplomë dhe certifikatën për vlerësimin e ndikimit në Mjedis të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë.*

Ky kriter është i panevojshëm, pasi procesi i vlerësimit të mjedisit është mbyllur gjatë procesit të hartimit të projekt/preventivit dhe nuk është i nevojshëm gjatë fazës së zbatimit, pasi nuk ka punimeve të cilat kërkojnë këtë lloj inxhinieri.

**Për sa sipër ngarkohen me përgjegjësi:** *L.F., R.D. dhe B.M.***,** në cilësinë e anëtarëve të hartimit të specifikimeve teknike (HST).

**<u>Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO</u>.** Në referim të PV datë 11.11.2024 është bërë hapja procedurës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 6 OE, si më poshtë vijon:

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|
| 1 | A.G. + N. C | ***<u>Skualifikuar</u>*** *:*<br>*Nuk përmbush piken 2.3.5 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, pasi subjekti "A", pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve:*<br>*- Ka marre përsipër te gjitha punimet hidraulike, dhe ka paraqitur një hidraulik (nga 2 te kërkuar) për realizimin e këtyre punimeve;*<br>*- Ka marre përsipër te gjitha punimet elektrike, dhe ka paraqitur një elektricist (nga 2 te kërkuar) për realizimin e këtyre punimeve;*<br>*- Ka marre përsipër te gjitha punimet mekanike, dhe ka paraqitur një mekanik (nga 2 te kërkuar) për realizimin e këtyre punimeve;*<br>*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.5 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional. Ky arsyetim bazohet edhe ne vendimin e KPP Nr. 1129/2022, me nr. 2345/4 prot., date 22.11.2022*. |
| 2 | I. | ***<u>Skualifikuar</u>****:*<br>*Nuk përmbush piken 2.3.7 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, pasi:*<br>*- Për mjetin me targe AA553ZA (Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton), marre me qira nga A.H. PF, mungon certifikata e transportit. Certifikata e transportit e paraqitur është lëshuar për D.C.. Ne këto kushte, ofertuesi ka paraqitur 2 Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton (nga 3 te kërkuar);*<br>*- Për mjetin me targe TR4121F (Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 6 ton - 2 copë), marre me qira nga shoqëria "M" sh.p.k, mungon certifikata e pronësisë. Ne këto kushte, ofertuesi ka paraqitur 1 Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 6 ton (nga 2 te kërkuar);*<br>*Nuk përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim, pasi:*<br>*- Për pajisjet hidrosanitare dhe ngrohje-ventilim, përveç autorizimit te distributorit dhe prodhuesit, nuk është paraqitur asnjë dokumentacioni ne përmbushje te këtij kriteri;*<br>*- Për pajisjet e ashensorit, autorizimi i prodhuesit është ne gjuhe te huaj dhe jo në gjuhën shqipe sipas pikës 4.6 te DST.*<br>*Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.* |
| 3 | L.K. + M. + V.K. | ***<u>Skualifikuar</u>****:*<br>*Referuar kontratës se bashkëpunimit për krijimin e BOE, konstatohet përqindja e ndarjes se punimeve (65% + 5% + 20%) për një total prej 90%, dhe jo 100%, duke e lënë te pa përmbushur vlerën prej 10% te punimeve.*<br>*Nuk përmbush piken 2.1.gj te Kritereve te Veçanta te Kualifikimit, pasi subjekti "M", pjese e BOE, nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike.*<br>*Nuk përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim, pasi për pajisjet hidrosanitare, elektrike, ngrohje-ventilim, përveç autorizimit te distributorit dhe prodhuesit, dokumentacioni i paraqitur është ne gjuhe te huaj.* |
| **4** | **P.G + U.** | ***Kualifikuar/ Fitues*** |
| 5 | S. 2F + A.-I. G. C. | ***<u>Skualifikuar</u>****:*<br>*Nuk përmbush pikën 2.4.3 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim, pasi për pajisjet hidrosanitare, përveç autorizimit te distributorit dhe prodhuesit, dokumentacioni i paraqitur është ne gjuhe te huaj dhe jo i përkthyer. Ne piken 4.6 te DST deklarohet se "Gjuha(-ët) për hartimin e propozimit dhe shprehjes së interesit: Shqip X".*<br>*Ne te njëjtën kohe, ne Shtojcën 15 te DST "Kriteret e përgjithshme të pranimit / kualifikimit", citohet se "...Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.".*<br>*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim* |
| 6 | SH. + "A" | ***<u>Skualifikuar</u>:***<br>*Nuk përmbush piken 2.3.5 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, pasi punonjësi i specializuar teknik/specialist i inxhinierisë elektronike dhe/ose i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, i paraqitur ne përmbushje te këtij kriteri, nuk është i pajisur me certifikatën e sigurimit teknik.*<br>*Nuk përmbush piken 2.3.7 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, pasi:*<br>*- Për mjetin me targe AB177AX (Kamion me kosh për punime ne lartësi), te paraqitur nga subjekti "A", marre me qira nga subjekti M.E., nuk është paraqitur certifikata e pronësisë se mjetit;*<br>*- Për mjetin me targe AB295FS (Auto betoniere me kapacitet mbi 6m3), te paraqitur nga subjekti "S", marre me qira nga subjekti "E", nuk është paraqitur certifikata e pronësisë se mjetit.*<br>*Nuk përmbush piken 2.4.1 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim, pasi subjekti "S", pjese e bashkimit të OE, nuk ka paraqitur certifikatën ISO 50001:2018 te vlefshme. Certifikata e paraqitur rezulton e skaduar ne datën 28.10.2024.* |

Sipas PV datë 26.1.2024 nga 6 OE pjesëmarrës në garë, nga KVO-ja janë skualifikuar nga faza e parë 5 OE dhe është kualifikuar 1 (një) OE, sipas të dhëna në tabelën sipër, kjo për fazën e parë të vlerësimit të dokumentacionit ligjor/teknik.
Me tej procedura vijon në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" dhe nenit 90 të LPP.
Me shkresën (ftesë për ofertë) nr. 7925/7 *prot*, datë 3.12.20244 është ftuar për fazën e dytë shoqëria e kualifikuara në fazën e parë, B/OE "P" + *"U"* sh.p.k, për paraqitjen e ofertave për zbatimin e punimeve deri datë 11.12.2024.
Sipas PV datë 17.12.2024 është bërë hapja e fazës mbi ofertën e paraqitura nga *JV "P.G.+"U"sh.p.k*, me ofertë prej 260,524,684 lekë pa TVSH.
Me PV datë 20.12.2024 nga KVO-ja është bërë vlerësimi i procedurës mbi dokumentacionin e paraqitur nga JV "P" + "U" sh.p.k
Me shkresën nr. 7925/12 *prot*, datë 27.12.2024 është plotësuar *formulari i njoftim fituesit* (shtojca 20).
Me shkresën nr. 7925/11 *prot*, datë 27.12.2024 është hartuar *Raporti Përmbledhës* i cili është miratuar dhe nga titullari i AK *z. E.J.*.
Me datë 26.12.2024, nga KVO-ja është mbajtur PV për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar në formë shkresore me atë të ngarkuar në SPE për fazën e parë dhe të dytë, ku rezultojë se është i njëjti dokumentacion.

**Vlerësimi i fazës së parë të procedurës**: Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin SPE, mbi skualifikimet/kualifikimet e bërë gjatë vlerësimit të fazës së parë nga KVO-ja, rezultoi se vlerësimi në lidhje me skualifikimin e 5 OE nga 6 OE pjesëmarrës **është në përputhje me dispozitat e LPP,** pasi OE nuk plotësonin kërkesat e DT, siç tregohet në tabelën sipër.

a- Nga shoqëria "P" sh.p.k, nuk plotësohet **pika 2.3.1** e DST për punë të ngjashme. Kështu, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 10726/4393 *prot*, dt. 8.11.2024, shoqëria ka marrë përsipër 93% të volumit të punimeve. Referuar pikë 2.3.1 të DST, shoqëria duhet të deklarojë vlerën 124,620,000 lekë (*134,000,000 lekë x 93%).*
Nga shoqëria janë paraqitur si punë të ngjashme kontrata nr. 36418/4 *prot*, dt. 28.10.2020 me objekt "*Hartim projekti dhe zbatim i punimeve për ndërtimin e godinës 12 (seksioni A0, në zonën zhvillimore 5/587",* ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe JV "*C.R.* (48.5% të punimeve) + *P. G.* (26.8% të punimeve) + *N.* (24.7% të punimeve), për vlerën pa TVSH prej 430,893,394 lekë. Referuar përqindjes që shoqëria ka marrë përsipër për zbatim sipas marrëveshjes së bashkëpunimit (26.8%), vlera e punimeve të ngjashme që deklaron është 115,479,429 lekë *(430,893,394 lekë x 26.8%)*, ose më pak se sa duhet të deklaronte për vlerën 9,140,570 lekë pa TVSH *(124,620,000 – 115,479,429).*

b- Nga të dyja shoqëritë nuk plotësohet **pika 2.3.4 e DST**, ku kërkohet *ing. Gjeoteknik dhe ing. Elektronik.* Nisur nga kontrata e bashkëpunimit (preventivi i ndarjes së punimeve) secila prej shoqërive ka marrë përsipër punime që kërkon specialistët e kërkuar. Kështu nga shoqëria "P" sh.p.k, është paraqitur vetëm ing. Elektronik (*M.S.*), por jo ing. Gjeoteknik**.** Ndërsa nga shoqëria "U" sh.p.k, është paraqitur ing. Gjeoteknik (*Dh.L.*), por nuk është paraqitur ing. Elektronik**.**

c- Nga JV "P" + "U" sh.p.k, nuk plotësohet pika 1.3.7, pasi mjeti tip *"Autopompë betoni"* i deklaruar nga shoqëria "P" sh.p.k, me targë AB183GE, nuk ka bashkëlidhur lejen e bashkie.

**Si konkluzion**, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e dokumentacionit ligjorë për fazën e parë të kryer nga KVO-ja, rezultoi se vlerësimi nuk është i njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit, pasi sipas grupit të auditimit JV "P" + "U" sh.p.k, **nuk është në kushtet e plotësimit** të të gjitha kritereve të DST, elementë të cilat janë evidentuar sa sipër, por dhe ky B/OE duhej të skualifikohej që në fazën e parë, veprime të cilat do duhet të çonin KVO në anulimin e procedurës dhe zhvillimin e një procedurë tjetër, duke **ngarkuar me përgjegjësi: *G.K., L.S. dhe M.J.***, në cilësinë e anëtarit të KVO, në cilësinë e anëtarit të KVO, në kundërshtim me nenet 2, 3 pika 1, dhe neni 92 pika 3 dhe 4 të Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar Bashkia Durrës janë paraqitur observacioni me shkresë nr. 668/88 prot, datë 17.06.2026 (*administruar në KLSH nr. 1347/71 Prot, dt. 18.06.2026)* "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga G.K., L.S. , M.J., në cilësinë e anëtait të KVO, , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:** - *Referuar sa më lart, lidhur me vlerësimin e ofertave, ju citoni se nga shoqëria "P" sh.p.k, nuk plotësohet pika 2.3.1 e DST për pune te ngjashme.*
*Në lidhje me këtë konstatim, KVO-ja sqaron si me poshtë:*
*Shoqëria P.G, ne përmbushje te këtij kriteri, ka paraqitur dokumentacionin:*
*Kontrata 36418/4 prot, dt. 28.10.2020 me objekt "Hartim projekti dhe zbatim i punimeve për ndërtimin e godinës 12 (seksioni A0, ne zonën zhvillimore 5/587", ndërmjet Bashkisë Tirane dhe JV "C.R. (48.5% te punimeve) + P.G (26.8% te punimeve) + N. (24.7% te punimeve), për vlerën pa TVSH prej 430,893,944 leke. Referuar përqindjes qe shoqëria ka marre përsipër për zbatim sipas marrëveshjes se bashkëpunimit (26.8%), vlera e punimeve te ngjashme qe deklaron është* ***115,479,249 leke*** *(430,893,394 leke x 26.8%), ashtu si edhe cituar nga ana juaj;*
*Kontrata e bashkëpunimit nr. rep 19828, nr. kol 7110, date 07.12.2021, lidhur me shoqërinë N., për nenkontraktimin e punimeve me vlere* ***44,029,410 leke****, nenkontraktim i miratuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Tirane nëpërmjet shkresës nr. 48535/2 prot., date 07.12.2021 (bashkëlidhur dokumentacioni përkatës i ngarkuar ne SPE dhe i paraqitur edhe fizikisht).*
*Persa me lart, ne kundërshtim me konstatimin tuaj, vërtetohet qe shoqëria P.G ka paraqitur punime te ngjashme ne vlerën* ***159,508,659 leke****, duke e përmbushur kriterin për pune te ngjashme.*
Ne rastin konkret, OE P.G ka paraqitur me dokumentacion te plote per pune te ngjashme me ente publike ne vleren 115,479,249 leke, sipas pikes 1, dhe ne permbushje te pikes 2.3.1.a) te DST, dhe pune te ngjashme me sektorin privat ne vleren 44,029,410 leke, sipas pikes 2, dhe ne permbushje te pikes 2.3.1.b) te DST, per nje total prej 159,508,659 leke.
*- Ju citoni se nga te dyja shoqëritë nuk plotësohet pika 2.3.4 e DST, ku kërkohet ing. Gjeoteknik dhe ing. Elektronik. Nisur nga kontrata e bashkëpunimit (preventivi i ndarjes se punimeve) secila prej shoqërive ka marre përsipër punime qe kërkon specialistet e kërkuar. Kështu nga shoqëria "P" sh.p.k, është paraqitur vetëm ing. Elektronik (M.S.), por jo ing. Gjeoteknik. Ndërsa nga shoqëria "U" sh.p.k, është paraqitur ing. Gjeoteknik (Dh.L.), por nuk është paraqitur ing. Elektronik. Gjithashtu nga shoqëria "U" sh.p.k, nuk është deklaruar dhe inxhinier audites për energjinë me certifikate për auditimin e energjisë ne ndërtesa. Për mos deklarimin e inxhinierit elektronik nga shoqëria U., bazuar ne marrëveshjen e bashkëpunimit dhe preventivin e ndarjes se punimeve, është shume e qarte qe shoqëria U. nuk ka marre përsipër asnjë punim te kategorisë elektronike, prandaj edhe nuk është i nevojshëm disponimi i inxhinierit elektronik nga shoqëria U.*
*Për mos deklarimin e inxhinierit audites për energjinë nga shoqëria U., nisur nga përqindja e punimeve qe kjo shoqëri merr përsipër (7%), nuk i nevojitet audites për energjinë për pjesën e punimeve te cilat ka marre përsipër, pasi bazuar ne ligjin nr. 125/2015 "Për eficencen e energjisë", ne këtë BOE, konsumatori i madh i energjisë është P.G, me 93% te punimeve.*
*Gjithashtu, bazuar ne preventivin e ndarjes se punimeve, punimet kryesore qe kane lidhje me eficencen e energjisë (punimet ne sistemin kapot, punimet e fasadës, punime termoizoluese, elektrike, hidrosanitare, etj) kryhen te gjitha nga shoqëria P.G.*
*- Ju citoni se nga JV "P" + "U" sh.p.k, nuk plotësohet pika 1.3.7, pasi mjeti tip "Autopompe betoni" i deklaruar nga shoqëria "P" sh.p.k, me targe AB183GE, nuk ka bashkëlidhur lejen e bashkisë. Leja e bashkisë dhe certifikata e transportit lëshohen për mjete qe transportojnë materiale kur janë ne lëvizje. Pompat e betonit nuk transportojnë material beton, por janë APV (Automjete për Përdorim te Veçantë). Ato shërbejnë për hedhjen e betonit ne vepër, pasi te jene stacionuar ne një lokacion te caktuar. Nëse shihet ne lejen e qarkullimit, kodi i karrocerisë është KB – mjet i pajisur me pompe.*
*Ne rast se pompa e betonit do te ishte edhe auto betoniere, duhet te pajisej me lejen dhe certifikatën përkatëse te transportit.*
**Qëndrim i grupit të auditimit**: Për sa keni observuar, sqarojmë se pretendimet nuk qëndrojnë, pasi nga ana juaj nuk është paraqitur asnjë element shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilat grupi i auditimit është shprehur në me qëndrimin e tij në projektraportin e paraqitur.

Në lidhje me mos pajisjen me leje bashkie argumenti nuk qëndron, kjo në referencë pikës 3.18 të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar dhe Udhëzimin i MIE nr. 8, datë 31.12.2000, pika 11.2. Leja e bashkisë kërkohet kur ushtrohet aktivitet ekonomik brenda territorit të bashkisë, ka shërbim për të tretë dhe aktivitet ndërtimor/tregtarë. **Procedura mbetet me shkelje në vlerësim**.

**13- Auditim i procedurës me objekt**: "*Riaftësim i strukturorë i pallatit R.sh.p.k, rruga Iljaz Reka, Kod Gis 26380"*, viti 2024

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Riaftësim i strukturorë i pallatit R.sh.p.k, rruga Iljaz Reka, kod gis 26380"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>"E kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit për kontrata punë publike, në zbatim të Vendimit të Komisionit Shtetërorë të Rindërtimit nr. 114, datë 16.4.2024, sipas Kreut VI , të nenit 40 të aktit normativ nr. 9, datë "<br>REF-12311-07-05-2024<br>Urdhri nr. 7928/1 prot., datë 3.7.2024</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)<br>Urdhri nr. 207 (7928prot), dt. 26.6.2024-<br>1.I.H.<br>2.E.T.<br>3.J.K.</td><td>2 Njësia e Prokurimit nr. 7928/1 prot., datë 3.7.2024<br>E.Gj.,<br>O.S.<br>K.Dh.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhri nr. 215 (7928/2prot) prot., datë 3.7.2024.<br>1. A.I.<br>2.L.B.,<br>Sipas dokumentacionit në dosje nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit<br>3. K.B.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)<br>118,997,888 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)<br>118,983,262 lekë<br>Fitues: OE "I" sh.p.k</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)<br>14 mijë lekë ose 0.01%</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:<br>Data 18.7.2024<br>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 336 ditë.</td><td colspan="2">8. Burimi FI.ncimit<br>Buxheti Bashkia Durrës.</td><td>9. OE<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 7 B/OE<br>b) S'kualifikuar 6 B/OE,<br>c) Kualifikuar 1 B/OE</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime<br>AK-s'ka/ka; -Jo<br>APP–s'ka/ka;-Jo<br>KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:<br>Data: 7.8.2024 nr. 7928/4 prot. (njoftim fituesi)</td><td>12.Data e lidhjes së kontratës:<br>Draft marrëveshje kuadër nr. 7928/11 prot, dt. 17.9.2024.<br>Kontrata për zbatim nr. 7928/12 prot, dt. 17.9.2024</td></tr>
</table>

**Në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit:** Me urdhrin nr. 207 (7928 prot), datë 26.6.2024, titullari i AK ka urdhëruar *I.H., E.T. dhe J.K.* për përgatitjen e specifikimeve teknike, relacionit teknik, leje infrastrukturë, grafik punimesh dhe fondin limit, në lidhje me objektin: "*Riaftësim i strukturorë i pallatit R.sh.p.k, rruga Iljaz Reka, Kod Gis 26380*". Në zbatim të urdhrit të titullarit është përgatitur materiali përkatës, ku sipas PV është përllogaritur fondi limit në vlerën 118,997,888 lekë pa TVSH, nga studio private BOE "A" + "A.L.T.E.A & G. 2000", "E" sh.p.k

**Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit nr. ----- *prot*., datë 5.7.2024 "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se kriteret e aplikuara janë të argumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës, në përputhje me dispozitat e LPP-së i ndryshuar.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në referim të PV datë 18.7.2024 është bërë hapja procedurës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 7 OE, si më poshtë vijon:

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|
| 1 | B. | ***Skualifikuar***<br>*Kontratat e qirave të mjeteve nuk janë të noterizuara, kjo në kundërshtim me nenin 801 të KC.*<br>*Nuk plotëson pikën 2.3.7, pasi:*<br>*Mjeti me targë AA511LU dhe targë AA592MN është 32 ton, ndërsa pesha maksimale e autorizuar është 3.5-7.5 dhe 7.5-18 ton. Pra mungojnë të dy mjetet.*<br>*Për mjetet me targë AA295DS dhe AA928DT, me KQ pa noter me shoqërinë "D" sh.p.k datë 24.6.2024, janë të deklaruara dhe nga shoqëria "I" sh.p.k me KQ datë 6.9.2021* |
| 2 | I. | ***Skualifikuar*** |

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|
| | | *Konstatohet se kontratate qirave për mjetet me targë AA603IR dhe AA817SJ, është kontrata e panoterizuar, në kundërshtim me nenin 801 të KC.*<br>*Për mjetet me targë AA295DS dhe AA928DT, me KQ pa noter me shoqërinë "D" sh.p.k datë 6.9.2021, janë të deklaruara dhe nga shoqëria "B" sh.p.k me KQ datë 24.6.2024* |
| **3** | **I.** | ***Kualifikuar/ fitues*** |
| 4 | "L" + S. | ***Skualifikuar***<br>*Shoqëria "L" sh.a, sipas shtojcës 12 ka deklaruar objektin "Riforcim i pallateve me Kod, Gis 25759;25583;22842.... etj., duke cilësuar se është 100% pjesëmarrëse në zbatimin e kontratës. Ndërkoha sipas dokumentacionit bashkëlidhur ajo është bashkim OE midis "L. me 26%", "U. me 51%", "Sh.-2AB me 14%" dhe " S. me 9%".*<br>*Në lidhje me kontratat me stafin inxhinierik midis H.S, L.M, K.Z ka mospërputhje me pagat midis kontratës dhe pagës në listpagesë* |
| 5 | L.K. | ***Skualifikuar***<br>*Nga verifikimi i shtojcës 13 të mjeteve, komini me targë AB244OK me kontratë qiraje nr. 2777, datë 18.3.2023, nuk i përket targës që është paraqitur tek shtojca, por i përket targës AB608CV e cila nuk figuron në shtojcën e mjeteve, pra mungon mjeti me kapacitet 7.5-18 ton* |
| 6 | N. | ***Skualifikuar***<br>*-Nuk plotësohet pika 2.3.7, pasi mjeti me qargë AB419TL i mungon certifikata e transportit;*<br>*-Mjeti me targë AB433MK, me masë max 7.5-18 ton, referuar dokumentacionit është kamionë vinç* |
| 7. | U. | *Skualifikuar* |

Sipas PV datë 22.7.2024 nga 7 OE pjesëmarrës në garë, nga KVO janë skualifikuar 6 OE dhe është kualifikuar 1 (një), sipas të dhëna në tabelën sipër.
Me tej procedura vijon në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" dhe nenit 90 të LPP.
Me shkresën (ftesë për ofertë) nr. 7928/4 *prot*, datë 29.7.2024 është ftuar për fazën e dytë shoqëria e kualifikuara në fazën e parë, konkretisht shoqëria "I" sh.p.k, për paraqitjen e ofertave për zbatimin e punimeve deri datë 01.8.2024.
Sipas PV datë 01.8.2024 është bërë hapja e fazës së 2 mbi ofertën e paraqitura nga shoqëria fituese "I" sh.p.k me ofertë prej 118,983,262 lekë pa TVSH.
Me PV datë 01.8.2024 nga KVO-ja është bërë vlerësimi i procedurës mbi dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria "I" sh.p.k
Me shkresën nr. 7928/4 *prot*, datë 7.8.2024 është plotësuar *formulari i njoftim fituesit përfundimtar* (shtojca 20).
Me shkresën nr. 7928/5 prot, datë 7.8.2024 është hartuar *Raporti Përmbledhës* i cili është miratuar dhe nga titullari i AK *z. E.J.*.

**Vlerësimi i fazës së parë të procedurës**: Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin SPE, mbi skualifikimet/ kualifikimet e bërë gjatë vlerësimit të fazës së parë nga KVO-ja, rezulton se vlerësimi në lidhje me skualifikimin e 6 OE nga 7 OE pjesëmarrës nuk është në përputhje me dispozitat e LPP dhe të kritereve të DST, pasi sipas grupit të auditimit disa nga OE e skualifikuar janë në plotësim të kritereve të DST. Gjithashtu dhe OE i klasifikuar për në fazën e dytë, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST dhe duhej skualifikuar nga gara. E konkretisht:
**a-** Në lidhje me shoqërinë e shpallur fitues **"I" sh.p.k**, për në fazën e dytë, konstatohet se nga KVO-ja nuk janë mbajtur të njëjtat standrate në fazën e parë kur është bërë skualifikimi i 6 OE pjesëmarrës për mos plotësim të kritereve (*mangësi të cilat qëndrojnë*), por janë anashkaluar, si:
Nga shoqëria "I" *sh.p.k,* nuk plotësohet kërkesa sipas **pikës 2.3.7 të DST**, pasi mjetet tip "*Autobetonjerë* "dhe "*Fadrome"* të cilat janë me kontratë qiraje, konstatohet se kontratat janë të panoterizuara, konkretisht: kontrata datë 16.7.2024 ndërmjet qiradhënësit shoqëria "R" sh.p.k dhe qiramarrësit shoqëria "I" sh.p.k për dy mjete: "*Autobetonjere"* me targë AA243U dhe me targë AA244AU, si dhe kontrata nr. 44, datë 16.7.2024 për mjetin tip "*Fadrome"* lidhur midis qiradhënësit "*I.D.*" (PF) dhe qiramarrësit shoqërisë "I" sh.p.k për mjetin tip "*Fadromë"***.**
**b-** Nga auditimi i dokumentacionit mbi skualifikimin e shoqërive "B" sh.p.k dhe "I" sh.p.k pretendimet e KVO-së nuk qëndrojnë, pasi:

*E para*, në lidhje me tonazhet, qëndron si fakt por tonazhi i kërkuar është më i lartë dhe mund të klasifikohet si devijim i vogël;
*E dyta*, në lidhje me faktin se mjetet me targë AA295DS dhe AA928DT, me kontratë qiraje pa noter me shoqërinë "D" sh.p.k, datë 6.9.2021 me shoqërinë "I" sh.p.k dhe 24.6.2024 me shoqërinë "B" sh.p.k, sqarojmë se kontratat e qirave që këto shoqëri kanë për mjetet tip "*Autobetonjere"* me targa të ndryshme. Sipas DT kërkohet vetëm një mjet tip *"Autobetonjerë"*, kusht i cili plotësohet nga secila prej shoqërive pjesëmarrëse, konkretisht nga shoqëria "I" sh.p.k, mjeti me targë *AB376II* dhe nga shoqëria "B" sh.p.k mjeti me targë *AN928BT*. Pra nga shoqëritë janë deklaruar më shumë mjete se sa kërkohet në DST të cilat plotësojnë kriterin.
- Nga verifikimi në sistem SPE të dokumentacionit të shoqërisë "L" sh.p.k, mbi vlerësimin e KVO, rezulton se referuar shtojcës 13 nga shoqëria janë deklaruar disa mjete të rregullta dhe në plotësim të pikës 2.3.7 të DT. Kërkohet një mjet me kapacitet 3.5-7.5 ton, një mjet me kapacitet 7.5-18 ton dhe një "*Autobetonjere"*, pra nga shoqëria janë paraqitur disa mjete, foto:

**Shtojca 13**

**MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE**

Operatori ekonomik: **"LIS KONSTRUKSION" sh.p.k**

**Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: Riaftësim strukturor i Pallatit "Rajfi" shpk, Rruga " Iljaz Reka", Kod GIS 26380**

| Në pronësi | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa** | **Nr. Lejes qarkullimit** | **Nr. Shasisë** | **Të tjera** |
| 1. Automjete vetshkarkuese me masë maksimale te autorizuar 3.5-7.5 ton | AA 314 XA | DRD0039119 | ZCFC35D10056736l5 | LIS KONSTRUKSION |
| 2. Fadrome me goma | ANMT 61 | TRD000623024 | 2CR20475 | LIS KONSTRUKSION |
| 3. Automjete vetshkarkuese | AB614AY | TRDA3116820 | WJMJ4CTS40C193132 | LIS KONSTRUKSION |
| 4. Automjete vetshkarkuese | AA027TX | PED0101118 | ZCFA1VMK004180281 | LIS KONSTRUKSION |
| 5. Autobetoniere kantieri | Fat R 96477 dt, 17.09.2018 | | | LIS KONSTRUKSION |
| 6. Autobetoniere kantieri | Fat R 40962 dt, 11.05.2019 | | | LIS KONSTRUKSION |
| 7. Skela | Fat nr. 47 dt, 20.08.2008 (580 m²) | Fat nr. 06 dt, 01.04.2015 (3200 m²) | Fat nr. 17 dt, 20.07.2015 (2500 m²) | LIS KONSTRUKSION |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| autorizuar 3.5-7.5 ton | | | | | |
| 2. Automjete vetshkarkuese me masë maksimale te autorizuar 3.5-7.5 ton | AB 475 FE | TRD03754421 | WDB9062331N300994 | NR 8996 REP NR 5933 KOL | 16.09.2022 16.09.2027 |
| 3. Automjete vetshkarkuese me masë maksimale te autorizuar mbi 7.5-18 ton | AA590YI | DRD12225119 | WDB9700581L089032 | NR 12870 REP NR 8631 KOL | 18.11.2023 17.11.2028 |
| 4. Automjete vetshkarkuese me masë maksimale te autorizuar mbi 7.5-18 ton | AB 244 OK | TRD000740221 | WDB9505331K479693 | NR 2777 REP NR 1880 KOL | 18.03.2023 17.03.2028 |
| 5. Autobetoniere | AA 065 AE | DR0033416 | WJMJ4CSS00C110299 | NR 2981 REP NR 2349 KOL | 24.05.2023 24.05.2025 |
| 6. Autobetoniere | AA 829 SR | DRD1766717 | ZCNH834447P514295 | NR 2981 REP NR 2349 KOL | 24.05.2023 24.05.2025 |
| 7. Autobetoniere | AA 513NR | DRD0661516 | WJMJ4CP800C0664479 | NR 2981 REP NR 2349 KOL | 24.05.2023 24.05.2025 |
| 8. Fadrome me goma | ABMT71 | TRF3199614 | CAT0432DJBLD 01282 | NR 2382 REP NR 1628 KOL | 08.03.2023 08.03.2028 |

- shto/fshi rreshta të tjerë, nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin përkatës të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë

**Në përfundim skualifikimi i padrejtë.**
- Nga verifikimi në sistem SPE, të mangësive të konstatuara nga KVO, rezulton se asnjë nga mangësitë e konstatuara nga KVO për shoqërinë "N" sh.p.k nuk qëndron dhe se skualifikimi është i padrejtë, *konkretisht*:
Subjekti ka kontratë qiraje me shoqërinë "B" sh.p.k, nr. 504rep/134 kol, datë 10.01.2023, për tre mjete si vijon:

**Neni 1**
**Objekti**

1.1 Mjetet objekt te kesaj kontrate jane te tipit:

- **Autobetoniere me targa AA257FY me shasi WDB9521431K484180**
- **Autobetoniere me targa AA691GJ me shasi ZCNH76438AG421754**
- **Autopompe betoni me targa AA450FG me shasi WDB9521411K565079**

**Neni 2**

Sipas DST është kërkuar vetëm një mjet tip "*Autobetonjere"*, pavarësisht se shoqëria ka deklaruar disa të tillë dhe me kontrata të ndryshme. Referuar shtojcës 13 shoqëria ka deklaruar si të rregullt mjetin me targë AA257FY, sipas dokumentacionit që kërkohet në DST.
Gjithashtu në lidhje me faktin se deklarata sipas shtojcës 4 dhe 7, nuk janë sipas formatit të DST, sqarojmë se nuk qëndron, pasi:
*E para*, shtojca 4, është deklaratë që paraqitet për në fazën e dytë, kjo sipas DST;
*E dyta*, të dyja deklaratat (shtojca 4 dhe 7), janë sipas formalit të DST, foto:
*Në këto kushte kjo shoqëri është skualifikuar padrejtësisht*.

**Si konkluzion**, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e dokumentacionit ligjorë për fazën e parë të kryer nga KVO-ja, rezulton të jenë mbajtur qëndrime të ndryshme në vlerësim, pasi dhe OE i kualifikuar është në mosplotësim të kërkesave të DST mangësi për të cilat janë skualifikuar OE me kritere të plotësuara (trajtuar si mësipërm), veprime të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve pa efektivitet, duke **ngarkuar me përgjegjësi:** *A.I., L.B. dhe K.B.*, në cilësinë e anëtarit të KVO, në cilësinë e anëtarit të KVO, në kundërshtim me nenet 2, 3 pika 1, dhe neni 92 pika 3 dhe 4 të Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

**14-- Auditim i procedurës me objekt** "*Riaftësim strukturore i pallatit nr. 15, rruga Abaz Elkupa 15, Rajoni 3, Kod Gis 24795"*, viti 2024

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Riaftësim strukturore i pallatit nr. 15, rruga Abaz Elkupa 15, Rajoni 3, Kod Gis 24795"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>"E kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit për kontrata punë publike, në zbatim të Vendimit të Komisionit Shtetërorë të Rindërtimit nr. 114, datë 16.4.2024, sipas Kreut VI , të nenit 40 të aktit normativ nr. 9, datë "<br>REF-15970-08-12-2024<br>Urdhri nr. 8346/2, dt. 15.7.2024</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)<br>Urdhri nr. 220 (prot 8346), datë 5.7.2024<br>1 I.H.,<br>2. L.F.,<br>3. K.B</td><td>2 Njësia e Prokurimit<br>nr. 8346/2, dt. 15.7.2024<br>E.Gj.,<br>O.S.<br>K.Dh.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhri nr. 244 (8346/3prot), dt. 15.7.2024<br>1. A.I.<br>2.L.B.,<br>3. M.J.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)<br>81,831,881 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)<br>81,820,638 lekë<br>Fitues: OE "E" + "E" + "S" sh.p.k</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)<br>11,243 lekë ose 0.013%</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:<br>Data 23.8.2024<br>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 224 ditë.</td><td colspan="2">8. Burimi FI.ncimit<br>Buxheti Bashkia Durrës.</td><td>9. OE<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 7 B/OE<br>b) S'kualifikuar 6 B/OE,<br>c) Kualifikuar 1 B/OE</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime<br>AK-s'ka/ka; -Jo<br>APP–s'ka/ka;-Jo<br>KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:<br>Data: 17.9.2024 nr. 8346/3 prot. (njoftim fituesi)</td><td>12.Data e lidhjes së kontratës:<br>Draft marrëveshje kuadër nr. 8346/16 prot, dt. 25.11.2024.<br>Kontrata për zbatim nr. 8346/17 prot, dt. 25.11.2024</td></tr>
</table>

**Në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit:** Me urdhrin nr. 220 (*prot* 8346), datë 5.7.2024, titullari i AK ka urdhëruar *I.H., L.F., K.B.* për përgatitjen e specifikimeve teknike, relacionit teknik, leje infrastrukturë, grafik punimesh dhe fondin limit, në lidhje me objektin: "*Riaftësim strukturore i pallatit nr. 15, rruga Abaz Elkupa 15, Rajoni 3, Kod Gis 24795*". Në zbatim të urdhrit të titullarit është përgatitur materiali përkatës, ku sipas PV është përllogaritur fondi limit në vlerën 81,831,881 lekë pa TVSH, hartuar nga studio private bashkim OE "A"*, "A.L.T.E.A & G. 2000", "E"* sh.p.k

**Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit nr. ----- *prot*., datë 12.8.2024 "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se kriteret e aplikuara janë të argumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës, në përputhje me dispozitat e LPP-së i ndryshuar.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në referim të PV datë 23.8.2024 është bërë hapja procedurës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 7 OE, si më poshtë vijon:

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|
| 1 | B. | ***Skualifikuar***<br>*- Mungon vërtetimi mbi pagesën e muajt qershor të OSHEE;* |

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|
| | | *- Nuk plotësohet pika 2.3.7 e DST, pasi mjeti me targë AB859LG dhe AB845ND (me qira), mungon certifikata e transportit nga organet përkatës* |
| 2 | I. | ***Skualifikuar***<br>*- Nuk plotëson pikën 3.3.7 e DST, pasi mjeti me targë AA513YT dhe AA526RJ, mungon certifikata e transportit nga organet përgjegjëse* |
| 3 | C. | ***Skualifikuar***<br>*-Nuk plotësohet pika 2.3.7, pasi mjeti me targë AA940TP, me masë max 3.5-7.5 ton, sipas dokumentacionit është 25 ton;*<br>*Mjeti me targë AA937TP i deklaruar si mjet vetëshkarkues me masë 7.5-18 ton, sipas dokumentacionit rezulton 40 ton;*<br>*Mjeti me targë AA936TP, i vetëdeklaruar si mjet vetëshkarkues me masë 3.5-7.5 ton, sipas dokumentacionit rezulton 2.8 ton* |
| 4 | L. | ***Skualifikuar***<br>*- Nuk plotëson pikat 2.3.4/2.3.5/2.3.6 të DST, pasi A.B, J.F, P.K., I.B, i listuar si bojaxhi, referuar certifikatës është sp. Ndërtimi. F.R, M.N. i listuar si murator, referuar certifikatës është sp. Ndërtimi.*<br>*A.K, i listuar si karpentier, referuar certifikatës është sp. Ndërtimi* |
| 5 | E. 2000 + E. + SH. 2AB K. | ***Kualifikuar/ fitues*** |
| 6 | N. | ***Skualifikuar***<br>*-Nuk plotësohet pika 2.3.7, pasi mjeti me gargë AB419TL i mungon certifikata e transportit;*<br>*-Mjeti me targë AB433MK, me masë max 7.5-18 ton, referuar dokumentacionit është kamionë vinç* |
| 7. | K. | ***Skualifikuar***<br>*Nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST, për punë të ngjashme, pasi kontrata e paraqitur "Ndërtim pikë grumbullimi produkte bujqësore" me vlerë 25,160,000 lekë, nuk plotëson vlerën minimale* |

Sipas PV datë 2.9.2024 nga 7 OE pjesëmarrës në garë, nga KVO-ja janë skualifikuar nga faza e parë 6 OE dhe është kualifikuar 1 (një) OE, sipas të dhëna në tabelën sipër, kjo për fazën e parë të vlerësimit të dokumentacionit ligjor/teknik.
Me tej procedura vijon në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "*Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"* dhe nenit 90 të LPP.
Me shkresën (ftesë për ofertë) nr. 8346/7 *prot*, datë 9.9.2024 është ftuar për fazën e dytë shoqëria e kualifikuara në fazën e parë, konkretisht JV "E" + "E" + "S" sh.p.k, për paraqitjen e ofertave për zbatimin e punimeve deri datë 11.9.2024.
Sipas PV datë 11.9.2024 është bërë hapja e fazës së 2 mbi ofertat e paraqitura nga shoqëria fituese "E" + "E" + "S" sh.p.k me ofertë prej 81,820,638 lekë pa TVSH.
Me PV datë 13.9.2024 nga KVO-ja është bërë vlerësimi i procedurës mbi dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria "E" + "E" + "S" sh.p.k
Me shkresën datë 16.9.2024 nga KVO është bërë klasifikimi përfundimtar.
Me shkresën nr. 8346/3 *prot*, datë 17.9.2024 është plotësuar formulari i *njoftim fituesit përfundimtar* (shtojca 20).
Me shkresën nr. 8346/8 *prot*, datë 24.9.2024 është hartuar *Raporti Përmbledhës* i cili është miratuar dhe nga titullari i AK *z. E.J.*.

**Vlerësimi i fazës së parë të procedurës**: Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin SPE, mbi skualifikimet/ kualifikimet e bërë gjatë vlerësimit të fazës së parë nga KVO-ja, rezulton se vlerësimi në lidhje me skualifikimin e 6 OE nga 7 OE pjesëmarrës nuk është në përputhje me dispozitat e LPP dhe të kritereve të DST, si më poshtë vijon:
**a-** Në lidhje me skualifikimet e 6 OE, rezulton se jo në të gjitha rastet KVO-ja ka vlerësuar drejtë shoqëritë pjesëmarrëse, si vijon:
**1**- Për ofertuesin **"I"** sh.p.k, është skualifikuar për arsye se "*Nuk plotëson pikën 3.3.7 e DST, pasi mjeti me targë AA513YT dhe AA526RJ, mungon certifikata e transportit nga organet përgjegjëse".* Nga verifikimi, konstatohet se mangësi nuk qëndron, pasi referuar DST për pikën 2.3.7 është kërkuar që:

*Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të paraqesë: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentet si: Leja e qarkullimit,* ***Certifikata e Kontrollit Teknik, Foto e mjetit*** *(Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në regjistra publike duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe libreza/te dhëna teknike, ose ekuivalenti i tij/saj).*

**b**- Në lidhje me B/OE "E" + "E" + "S" sh.p.k të shpallur fitues, për në fazën e dytë, nuk janë përdorur të njëjtat standarte, ku nga KVO-ja janë mbajtur qëndrime të ndryshme, duke sukualifikuar në fazën e parë shoqëri me mangësi të njëjta me shoqërinë e kualifikuar dhe ose sukualifikuar padrejtësisht shoqëri me kritere të plotësuara (sipas grupit të auditimit), ku nëse do ishin kualifikuar për në fazën e dytë oferta fituese nuk do ishte gati 100% e fondit limit. *E konkretisht*:
- Nga JV "E" + "S" sh.p.k, nuk është plotësuar formulari i deklaratës sipas shtojcës 13- *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive*, ku referuar marrëveshjes së bashkëpunimit, këto shoqëria kanë marrë përsipër punime që kërkohet disponimi i makinerive.
- Nga shoqëria "E" sh.p.k, nuk plotësohet **pika 2.2.3 e DT**, për pagesën e taksave vendore 2024, pasi referuar ekstraktit të QKB shoqëria ka aktivitet dhe në Bashkinë Mat, për të cilën nuk është depozituar vërtetimi mbi pagesën e taksave lokale;
- Nga shoqëria "S" sh.p.k, nuk plotësohet pika e licencës NP-2B- *Ndërtime civile dhe industriale* dhe NS-4B- *Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami*, pasi referuar dokumentacionit në dosje (ndarjen e punimeve në preventiv) dhe marrëveshjes së bashkëpunimit, kjo shoqëria ka marrë përsipër realizimin e këtyre punimeve;
- Referuar të dhënave të sistemit SPE, nga shoqëria "S" sh.p.k, nuk plotësohet **pika 2.4.1** për paraqitjen e certifikatave **ISO 9001** - *Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akreditуar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akredites, të njohur nga Republika e Shqipërisë* dhe **ISO 45001:2018** - *Sistemi i manaxhimit te sigurisë dhe shëndetit ne vendet e punës, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akreditуar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akredites, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
**Në këto kushte për sa trajtuam më sipër KVO nuk duhej të kualifikonte** B/OE "E" + "E" + "S" sh.p.k, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve të DST.
**Si konkluzion**, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e dokumentacionit ligjorë për fazën e parë të kryer nga KVO-ja, rezulton të jenë mbajtur qëndrime të ndryshme në vlerësim, pasi dhe OE i kualifikuar është në mosplotësim të kërkesave të DST mangësi për të cilat janë skualifikuar OE me kritere të plotësuara (trajtuar si mësipërm), veprime të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve pa efektivitet, duke **ngarkuar me përgjegjësi:** *A.I., L.B. dhe M.J.*, në cilësinë e anëtarit të KVO, në cilësinë e anëtarit të KVO, në kundërshtim me nenet 2, 3 pika 1, dhe neni 92 pika 3 dhe 4 të Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
*Nga subjekti nuk është paraqitur observacion mbi konstatimet e grupit të auditimit në vlerësim.*

**15- Auditim i procedurës me objekt:** "*Rehabilitim rruga e dëshmorëve, segmenti nga kryqëzimi me rrugën Mujo UlqI.ku tek Stacioni i Trenit"*, viti 2023.

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"Rehabilitim rruga e dëshmorëve, segmenti nga kryqëzimi me rrugën Mujo UlqI.ku tek Stacioni i Trenit"* | | | |
|---|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E hapur mbi kufirin"<br>REF-61338-03-03-2023<br>Urdhri nr. 1019/2 prot., datë 20.2.2023 | **1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)**<br>Urdhri nr. 54 prot., datë 26.01.2023<br>1. O.G.<br>2. M.J.<br>3. A.K. | **2 Njësia e Prokurimit** nr. 1019/2, dt. 20.2.2023<br>1. E.Gj.<br>2. A.T.<br>3. I. F. | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhri nr. 1019/3 prot., datë 20.2.2023.<br>1. A.I.<br>2. K.B.<br>3. K.Dh. |

| | | |
|---|---|---|
| **4. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>50,401,601 lekë | **5. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>40,034,812 lekë<br>Fitues: OE "E" sh.p.k | **6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>10,367 mijë lekë ose 20.5% |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 21.3.2023<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 63 ditë. | **8. Burimi FI.ncimit**<br>Të ardhurat e Bashkisë Durrës për vitin 2023, miratuar me VKB Nr. 150, datë 22.12.2022 *"Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Durrës për vitin 2023 (e ndryshuar)*". | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **20 BASHKIM OE**<br>b) S'kualifikuar 10 BASHKIM OE,<br>c) Kualifikuar 10 BASHKIM OE |
| **10.Ankimime**<br>**AK**-s'ka/ka**; -Jo**<br>**APP**–s'ka/ka**;-Jo**<br>**KPP**-s'ka/ka;-**Jo** | **11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:**<br>Data: 8.11.2023 | **12.Data e lidhjes së kontratës:**<br>Nr. 1019/6, datë 22.5.2023 |

**Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*" datë 5.7.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se kriteret e aplikuara janë të argumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës, në përputhje me pikën 2 germa (c) e nenit 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe me nenet 55 e 56 të LPP-së i ndryshuar.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **20** OE, për të cilët, fillimisht, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në datën 21.3.2023, vlerësimin paraprak dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | L.T.E C. | 32,041,961 | Skualifikuar<br>*- Nuk përmbush pikën: **2.3 Kapaciteti teknik:** ndër të tjera kërkohet, për punëtori të thjeshtë, të disponojë një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë.* |
| 2 | RSM C. | 37,894,627 | Skualifikuar<br>*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, OE **n**uk përmbush kriteret 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f te Kapacitetit Teknik për disponimin punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve të vetëdeklaruara për këtë procedurë prokurimi janë të angazhuar në kontratën me objekt: "Rikonstruksione të ambienteve të institucioneve arsimore".* |
| 3 | NG S. | 38,539,408 | Skualifikuar<br>*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, OE **n**uk përmbush kriterin **2.3 Kapaciteti teknik,** pikën a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 25'000'000 lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*<br>*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100'000'000 lekë.*<br>*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.* |
| 4 | "I" + "M" | 39,131,451 | Skualifikuar<br>*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, OE BOE I.C.C "G" sh.p.k + "M" sh.p.k:*<br>*- Nuk përmbush kriteret 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f të Kapacitetit Teknik për dispononim punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve të vetëdeklaruara për këtë procedurë prokurimi nga **"M" sh.p.k,** janë të angazhuar në kontratën me objekt: "Rikonstruksion shkolla MB "Besnik Hidri" Shenvlash".* |
| 5 | D.C. | 39,499,044 | Skualifikuar |

| Nr. | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH | Skualifikuar/ Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| | | | *Nuk përmbush kriterin **2.3. Kapaciteti teknik,** pikën a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 25'000'000 lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*<br>*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100'000'000 lekë.*<br>*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.* |
| 6 | A.-SA CO | 39,913,118 | Skualifikuar<br>*-Nuk përmbush kriterin **2.3 Kapaciteti teknik,** pikën a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 25'000'000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*<br>*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100'000'000 lekë.*<br>*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.* |
| 7 | E. K. | **40,034,813** | **Kualifikuar/Fitues** |
| 8 | L.K. | 40,199,484 | Skualifikuar<br>*-Nuk përmbush piken 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f te Kapacitetit Teknik për dispononim punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjese e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve te vetedeklaruara për këtë procedure prokurimi janë te angazhuar ne kontratën me objekt "Loti III Riforcim godine banimi 12-13 kat mbi toke dhe një kat nëntokë, Rr.Jahja Ballhysa nr.6, gis 3092 (Jedasi)".* |
| 9 | K . | **42,819,347** | **Kualifikuar** |
| 10 | 2N | 42,895,923 | Skualifikuar<br>*- **Për** ofertuesin **2N sh.p.k me nipt "L29"**, me vlerë të ofertës **42'895'923**, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit te dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, OE **2N sh.p.k:***<br>*- Nuk ka arritur të marrë Formular Vlerësimi nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Durrës për procedurën me objekt :"Rikonstruksion i Godinës së Bashkisë Durrës".* |
| 11 | A. | 44,042,069 | Kualifikuar |
| 12 | B. | 44,354,015 | Kualifikuar |
| 13 | T@XH | 44,356,260 | Skualifikuar<br>*- Nuk përmbush kriteret 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f të Kapacitetit Teknik për dispononim punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve të vetëdeklaruara për këtë procedurë prokurimi janë të angazhuar në kontratën me objekt: "Riforcim i godinës së banimit 8 kate + bodrum, lagja nr.3, rruga Egnatia, kod gis 27258".* |
| 14 | S. | 44,372,423 | Kualifikuar |
| 15 | Z. | 44,787,900 | Kualifikuar |
| 16 | L. + Nd. | 45,306,301 | Kualifikuar |
| 17 | C. | 47,146,133 | Kualifikuar |
| 18 | AL-A. | 47,848,702 | Kualifikuar |
| 19 | V. E | 48,856,145 | Kualifikuar |
| | | | |
| 20 | K.T. +I. | 49,383,095 | Skualifikuar<br>*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, OE **BOE K.T.sh.p.k + I.sh.p.k:***<br>*-Shtojca 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është i plotësuar sipas pikave të përcaktuara në këtë formular.* |

Referuar procesverbalit datë 4.4.2023 si dhe *njoftimit të fituesit*, KVO-ja ka kualifikuar si të vlefshme **10** OE nga **20** pjesëmarrës në garë.

Formulari i *njoftim fetusit (paraprak),* mban datën 11.4.2023, shpallur në buletinin e APP nr. 34, datë 18.4.2023, ku fitues është shpallur shoqëria "E" sh.p.k me ofertë 40,034,813 lekë pa TVSH.
Formulari i *njoftim fetusit përfundimtar* (*pas përfundimit të afatit të ankimimit*) është me shkresën nr. 1019/5 *prot*, datë 20.4.2023, shpallur në buletinin e APP nr. 39, datë 2.5.2023.
Në vijim, KVO-ja, ka shpallur përfundimisht fitues, me "*njoftimin e fituesit*" nr. 1019/5 *prot*, datë 20.4.2023, shoqëria "E" sh.p.k me ofertë 40,034,813 lekë pa TVSH, duke skualifikuar 10 bashkim OE me arsyetimin, siç paraqitet në tabelën sipër.
Referuar procedurës së lartpërmendur, sipas KVO-së shoqëria "E" sh.p.k me NIPT "K30", me adresë: Tirane Rruga "Abdi Toptani", Qendra "Torre Drin", oferta e paraqitur me vlerë totale prej 40,034,813 lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.
Me shkresën nr. 1019/4 *prot*, datë 20.4.2023 nga KVO-ja është hartuar *Raporti Përmbledhës* i cili është miratuar nga titullari i AK *zj. E.S.*.
Pas njoftimit të OE fitues si dhe pasi ky i fundit ka paraqitur sigurimin e kontratës *( me shoqërinë "A" datë 25.4.2023 në shumën 4,804,117.5 lekë*), midis palëve është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes me nr. 1019/6 *prot*., datë 22.5.2023 me vlerë 40,034,812 lekë me afat 63 ditë nga momenti i fillimit.

**Vlerësimi i procedurës.** Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer veprime dhe mosveprime të pajustifikuara të cilat bien ndesh me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, pasi OE "E" sh.p.k nuk plotëson të gjitha kriteret e DT. E konkretisht:
- Mjeti kamion cisternë me targë AB126AL në pronësi të shoqërisë, sipas dokumentacionit (*leje qarkullimi TRDA2308820 dhe fotos së mjetit*), nuk është kamion cisternë, pasi referuar lejes së qarkullimit, tek rubrika e lejes (*të dhëna mbi mjetin*), pika 6 është F1 (*kodeve të karrocerive*) F1 **është kamion vetëshkarkues** kjo dhe sipas fotos dhe **jo kamion cisternë** që duhet të kishte kod C1, foto mjeti:



- Mjeti me targë AA216R me kontratë qiraje nr. 1202rep/381kol, datë 8.4.2022 me qiradhënësin *H.Ç.*, **certifikata e kontrollit teknik është jashtë afatit** (24.12.2022), ndërkohë që procedura zhvillohet me datë 21.3.2023.
- Mjeti me targë TR5944N me kontratë qiraje nr. 1353 *rep*/443 *kol*, datë 28.4.2022 me qiradhënësin *A.P*, polisa e sigurimit mban datën 29.12.2022 dhe certifikata e kontrollit teknik datë 24.12.2021, **pra janë jashtë afatit të zhvillimit të procedurës datë 21.3.2023.**
- Në lidhje me punët e ngjashme, shoqëria ka paraqitur kontratën nr. 6759/1 *prot*, datë 18.6.2020 me objekt "*Rikonceprim i Kopshtit Zologjik*" me vlerë kontrate prej 738,908,795 lekë dhe fitues OE "G" sh.p.k (31.65% të punimeve), "A" sh.p.k (30.13%) dhe shoqëria "E" sh.p.k (37.24% të volumit të punimeve).

Nga analizimi i zërave të situacionit, konstatohet se nga shoqëria nuk janë kryer punime të ngjashme me objektin e prokuruar dhe disa nga zërat që mund të jenë nuk plotësojnë kriterin sipas pikës a-*jo më të vogël se 25,000 mijë lekë.*
Gjithashtu sqarojmë se në fazën e verifikimit të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se nga shoqëria "E" sh.p.k, nuk plotësohet kriteri "*Për punëtori të thjeshtë, të disponoje një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë"*.
**Si konkluzion**, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezultoi se shpallja fitues e shoqërisë "E" sh.p.k është bërë në kundërshtim me dispozitat e LPP, pasi nuk plotëson disa nga kriteret e DST të reflektuara si mësipërm.
*Veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, ngarkohen me përgjegjësi: A.I., K.B., K.Dh., në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2, neni 3 pika 1, neni 92 pika 3 dhe 4.*

**16- Auditim i procedurës me objekt:** *" Blerje kazanë për mbetjet urbane", Bashkia Durrës.*

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje kazanë për mbetjet urbane", Bashkia Durrës</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 76/1 prot., datë 26.01.2023</td><td rowspan="2">3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Urdhër nr. 17, datë 05.01.2023<br>1. L.S. Kryetar,<br>2. S.D.<br>3. E.Ç.<br>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. Nr. 76/1 prot., datë 26.01.2023<br>Njësia e Prokurimit<br>A.Xh., Jurist<br>A.T., Personi përgjegjës<br>E.Gj., Inxhiniere</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhër nr. 76/2, datë 26.01.2023,<br>1. G.K., Kryetar<br>2. K.K.<br>3. M.Rr.</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –<br>"E hapur, mall"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)<br>29,869,700 lekë,</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSH)<br>OE "P" sh.p.k<br>me ofertë 28,980,000 lekë pa TVSH,<br>sipas kontratës nr. 76/5 prot, dt. 22.08.2023 me afat 90 ditë nga data e lidhjes së kontratës.</td><td>7. Diferenca me fondin limit<br>889,700 lekë, ose 3 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit<br>Datë 01.03.2023</td><td>9. Burimi FI.ncimit<br>Buxheti i Bashkisë, sipas VKB-së nr. 150, datë 22.12.2022</td><td>10. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 2 BOE,<br>c) Kualifikuar 2 OE/BOE.<br>Pas vendimit të KPP-së, është kualifikuar vetëm 1 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime;<br>Nr. 28/3 Prot., datë 24.03.2023, nga OE "P"<br>Nr. 28/5 Prot., datë 28.03.2023, nga OE "Z"</td><td>12. Përgjigje Ankesës nga AK<br>Vendimi i KSHA datë 31.03.2023;<br>Vendimi i KSHA nr. 28/15 prot., datë 01.06.2023</td><td>13. Përgjigje Ankesës KPP<br>Vendimi nr. 294/2023<br>Vendimin nr. 552/2023, datë 04.07.2023</td></tr>
</table>

**Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike e kritereve kualifikuese:**
Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK është nxjerrë urdhër prokurimi nr. 17 (*prot 76*), datë 24.3.2023 për realizimin e procedurës, duke emëruar komisionin e hartimit të specifikimeve teknike dhe të fondit limit, me përbërje: *L.S., S.D. dhe E.C.*.
Për hartimin e preventivit komisioni ka studiuar ofertat e tregut, të marra në datën *s'ka* nga 3 OE të ndryshëm, konkretisht nga shoqëria "L" sh.p.k me ofertë 42,200 lekë/copa, shoqëria "P." sh.p.k me ofertë 45,500 lekë/copa dhe shoqëria "Ẅ" sh.p.k me ofertë 40,314 lekë/copa. Mesatarja e ofertave të ardhura nga shoqëritë që ju është kërkuar është në vlerën 42,671 lekë/copa x 700 copë kazanë = 29,869,700 lekë, kjo sipas procesverbalit datë 18.01.2023 mbajtur nga komisioni.
Nga të dhënat konstatohet se ofertat e paraqitura nuk kanë datë si dhe nuk janë të evidentuara specifikimet teknike siç kërkohen në DST, por është vendosur vetëm vlera e ofruar, pa asnjë lloje specifikimi, në kundërshtim me nenin 34, pika 2 (paragrafi i fundit) i Ligjit nr. 162, datë

23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 258, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 76, pika 2. Këto veprime përbëjnë një risk të shtuar për një përllogaritje të gabuar të fondit limit dhe për pasojë mosrealizimin e procedurës së prokurimit apo duke ndikuar negativisht në mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe nuk përcakton kohën e ofertave me zhvillim e tij, duke **ngarkuar me përgjegjësi**: *L.S., S.D. dhe E.C.***,** në cilësinë e anëtarëve të komisionit të përllogaritjes së fondit limit si dhe specifikimeve teknike.

**Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*" datë 5.7.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se kriteret e aplikuara janë të argumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës, në përputhje me pikën 2 germa (c) e nenit 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe me nenet 55 e 56 të LPP-së i ndryshuar.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO:** Në dosje administrohet procesverbali për hapjen e ofertave (datë 01.03.2023) dhe procesverbali për vlerësimin e ofertave (datë 13.03.2023). Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë në procedurë 4 OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës | Skualifikohet/ Kualifikohet |
|---|---|---|---|
| 1 | OE "L" | 22,750,000 | **Skualifikuar**:<br>*- Nuk përmbush piken 2.3.a te KT, pasi kontrata me objekt "Përmirësimi dhe rinovimi i sistemit te muzeve te qytetit te Gjirokastrës", me AK Fondi Shqiptar i Zhvillimit, pas analizimit te zërave te preventivit, nuk konsiderohet pune e ngjashme me objektin e prokurimit. OE ka lidhur edhe Marrëveshjen Kuadër me objekt "Loti 4 – Blerje materiale mobilimi urban sipas kërkesave te Bashkive", date 15.08.2022, me AK Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me afat 24 muaj. Referuar kontratave te lidhura ne respektim te marrëveshjes kuadër se sipërcituar, si edhe faturave përkatëse te paraqitura, totali i zërave te konsideruara pune e ngjashme, nuk e arrin vlerën minimale te kërkuar.*<br>*- Nuk përmbush piken 2.3.gj KT, pasi referuar katalogut te paraqitur, konstatohet qe te dhënat e mallit te ofruar nuk janë konform specifikimeve teknike te mallit te kërkuar nga AK* |
| 2 | OE "Z" | 26,397,000 | Kualifikohet |
| **7** | **OE "P"** | **28,980,000** | **Kualifikohet/fitues** |
| 8 | OE "V" | 29,620,500 | ***Skualifikohet*** :<br>*- Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës se kërkuar ne DST; - Nuk ka paraqitur certifikatën ISO 9001 te prodhuesit, siç është kërkuar ne specifikimet teknike; - Nuk përmbush piken 2.2.b te Kapacitetit Ekonomik dhe FI.nciar, ku citohet se "Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet fI.nciare 2019, 2020, 2021, ...., pasi nuk ka paraqitur asnjë nga bilancet e kërkuara; - Nuk përmbush piken 2.3.d te KT, ku citohet se: "OE ofertues duhet te paraqesë Certifikatë standarti EN 840-2-5-6 te mallit objekt prokurimi", pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ne përmbushje te këtij kriteri; - Nuk përmbush piken 2.3.e te KT, ku citohet se: "OE ofertues duhet te paraqesë Certifikatë standarti RAL GZ951/1 te mallit objekt prokurimi", pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ne përmbushje te këtij kriteri; - Nuk përmbush piken 2.3.f te KT, ku citohet se: "OE ofertues duhet te paraqesë dokumentacion i cili vërteton qe malli objekt prokurimi është ne përputhje me standartin CE", pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ne përmbushje te këtij kriteri; - Nuk përmbush piken 2.3.g te KT, ku citohet se: "OE ofertues duhet te paraqesë autorizim te prodhuesit/distributorit te autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet te përmbajë te dhëna te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, Ẅebsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast se do te paraqitet autorizim distributori OE duhet ta vërtetoj këtë duke paraqitur akt-marrëveshje/autorizim/kontrate lidhur mes kompanisë prodhuese dhe distributorit të autorizuar", pasi fragmenti i katalogut te paraqitur është ne gjuhen angleze; - Nuk përmbush piken 2.3.h te KT, ku citohet se: "Ne mënyrë qe te krahasohet pajtueshmëria me standartet e kërkuara OE duhet te paraqesë dokumentacion justifikues (certifikata/deklarata prodhuesi)* |

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës | Skualifikohet/ Kualifikohet |
|---|---|---|---|
| | | | *për standartet dhe kërkesat qe duhet te përmbushin zërat e kërkuara ne formularin e specifikimeve teknike", pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ne përmbushje te këtij kriteri; - Nuk përmbush piken 2.3.h te KT, ku citohet se "Ofertuesi duhet të dorëzoje dokumentin e titulluar "Ofertë Teknike" i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një tabele, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga ofertuesi për të gjithë zërat objekt prokurimi...", pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ne përmbushje te këtij kriteri; - Nuk përmbush piken 2.3.j te KT, ku citohet se "OE pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore", pasi nuk ka paraqitur asnjë deklarate ne përmbushje te këtij kriteri* |

*Burimi i të dhënave: SPE, përpunuar nga grupi auditimit.*

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, nga KVO nga 4 OE pjesëmarrës janë skualifikuar 2 OE dhe janë kualifikuar 2 OE, sipas të dhënave të tabelë.

*Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE dhe dosjen e procedurës, konstatohet se KVO-ja ka vepruar në përputhje me dispozitat e LPP, për skualifikimin e OE "L" sh.p.k, dhe "V" sh.p.k, pasi mangësitë e konstatuara qëndrojnë dhe këto OE nuk plotësonin disa nga kriteret e DT, të paraqitura si mësipërm.*

Pas shpalljes te fituesit paraprak datë 23.03.2023, me shkresën e protokolluar në Bashkinë Durrës me nr. 28/3 Prot., datë 24.03.2023, nga OE "P" sh.p.k, është bërë ankesë pranë AK dhe KPP me objekt "*Kundërshtim i vendimit të KVO-së, lidhur me kualifikimin e OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit*" dhe konkretisht OE "Z" sh.p.k, të shpallur fitues paraprak nga KVO-ja, me formularin e njoftimit të fituesit paraprak, datë 17.03.2023.

Në këtë ankesë është deklaruar që OE i shpallur fitues, nuk përmbush kriteret e vendosura në DT, në lidhje me pagesën e energjisë, me certifikatën EN-8402-5-6, ose SSH/EN 840-2, SSH/EN 840-5 dhe SSH/EN 840-6 dhe me përmbushjen e specifikimeve teknike të mallit që prokurohet.

Pas kësaj ankese, titullari i AK me urdhrin nr. 134 *prot*, datë 27.03.2023 ka ngritur KSHA me përbërje *V.M., R.T. dhe A.K.*, ku me vendimin e datës 31.03.2023 ka bërë pranimin e pjesshëm të ankesës dhe pikërisht për mosparaqitjen e katalogëve të mallit konform specifikimeve teknike të kërkuara. Ky vendim i është dërguar KPP-së me shkresën e Bashkisë Durrës me nr. 28/8 *prot*., datë 03.04.2023.

Në këtë vendim, është rishqyrtuar gjithashtu, pa kërkesën e ankimuesit OE "Z" sh.p.k, edhe oferta e OE "P" sh.p.k, e cila, sipas KSHA, nuk plotëson kriteret e kërkuara në DT, pa u shprehur për skualifikimin e këtij OE. Në vendim është shprehur vetëm pranimi i pjesshëm i ankesës së OE "P" sh.p.k

Në datën 27.03.2023, me shkresën e protokolluar në Bashkinë Durrës me nr. 28/5 *Prot*., datë 28.03.2023, nga OE "Z" sh.p.k, është bërë ankesë pranë AK dhe KPP me objekt "*Kundërshtim i pretendimeve të OE "H" sh.p.k në ankesën e datës 23.03.2023"*.

Me shkresën nr. 619/6 *prot*., datë 07.04.2023, KPP i kërkon AK bashkia Durrës në lidhje me njoftimin e OE "Z" *sh.p.k* dhe argumentet e shtruara nga ky OE. Pas kësaj shkrese, bashkia Durrës ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 28/10 *prot*, datë 13.04.2023, në të cilën ka bashkëlidhur ankesën me argumentet e OE "Z" sh.p.k

Me vendimin nr. 294/2023, KPP ka vendosur të mbyllë çështjen, sipas të cilit pranon vendimin e KSHA-së, për skualifikimin e shoqërisë "Z" sh.p.k

Me shkresën nr. 76/3 *prot*, datë 03.05.2023, nga KVO-ja është hartuar *Raporti Përmbledhës*, sipas të cilit i është propozuar titullarit të AK anulimi i procedurës së prokurimit, pasi *nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme*, duke marrë kështu në konsideratë vlerësimin padrejtësisht të ofertës së OE "P" sh.p.k nga KSHA.

Pranë AK është paraqitur ankesa e shoqërisë "P" sh.p.k (e cila nuk gjendet në dosje) me nr. 28/12 *prot*, datë 19.05.2023, pas të cilës është hartuar Urdhri nr. 188 prot, datë 31.05.2023 për shqyrtimin e ankesës, duke ngritur komisionin me përbërje *R.M., A.P. dhe E.H.*.

Ky komision, me Vendimin me nr. 28/15 *prot*., datë 01.06.2023 ka vendosur refuzimin e ankesës së OE "P" sh.p.k, i cili i është përcjellë KPP-së me shkresën nr. 28/17 prot, datë 02.06.2023.
Me vendimin nr. 552/2023 *prot*, datë 04.07.2023, KPP ka vendosur të pranojë kërkesën e OE "P" sh.p.k, duke kërkuar anulimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e këtij OE dhe anulimin e vendimit për anulimin e procedurës.
Pas këtij Vendimi dhe pas procesverbalit të KVO-së për rivlerësimin e procedurës, AK Bashkia Durrës, me shkresën nr. 28/19 *prot*, datë 17.07.2023, ka vënë në dijeni KPP-në që ka rikthyer procedurën nga anulim, në rivlerësim. Në këtë procesverbal është bërë kualifikimi i OE "P" sh.p.k
Nga KVO-ja është hartuar *Raporti Përmbledhës* me shkresën me nr. 76/4 *prot*, datë 28.07.2023, i cili është miratuar nga Titullari i AK znj. E.S..
Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit dhe dërguar për publikim, me shkresën nr. 28/21 *prot*, datë 07.08.2023.
**Si konkluzion**, KVO-ja, ka vlerësuar drejt OE të shpallur fitues, referuar kjo dhe vendimit të KPP me nr. 552/2023 *prot*, datë 04.07.2023, pasi plotëson kërkesat e DT për shpalljen fitues.

**17- Auditim i procedurës me objekt:** *" Blerje ushqime për QEA", Bashkia Durrës.*

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje ushqime për QEA", Bashkia Durrës, Nr. REF-80002, datë 09-14-2023.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 6145/1 prot., datë 01.09.2023</td><td rowspan="2">3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Urdhër nr. 223, datë 27.06.2023<br>1. E.Ç. Kryetar,<br>2. A.K.<br>3. F.F.<br>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 6145/1 prot., datë 01.09.2023<br>Njësia e Prokurimit<br>A.Xh., Jurist, Personi përgjegjës<br>A.T.,<br>E.Gj., Inxhiniere</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhër nr. 266, datë 01.09.2023,<br>1. G.K., Kryetar<br>2. K. N.<br>3. L.P.</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –<br>"E hapur, mall"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)<br>39,999,841 lekë,</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSH)<br>OE "4" sh.p.k<br>me ofertë 32,221,450 lekë pa TVSH,<br>sipas kontratës nr. 6145/6 prot, dt. 07.11.2023 me afat të kontratës që fillon ditën e nënshkrimit dhe përfundon me kalimin e pagesës totale në llogarinë e dhënë nga kontraktori.</td><td>7. Diferenca me fondin limit<br>7,778,391 lekë, ose 19.4 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit<br>Datë 02.10.2023</td><td>9. Burimi FI.ncimit<br>Buxheti i Bashkisë, sipas VKB-së nr. 150, datë 22.12.2022</td><td>10. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 1 BOE,<br>c) Kualifikuar 2 OE/BOE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; nuk ka ankesë.</td><td>12. Përgjigje Ankesës nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës<br>nuk ka</td></tr>
</table>

**Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:** Kjo procedurë është "E Hapur, mall", me vlerë 39,999,841 lekë pa TVSH, i cili do të fI.ncohet nga Buxheti i Bashkisë sipas VKB-së nr. 150, datë 22.12.2022. Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga grupi i punës të ngritur për këtë qëllim.
Grupi i punës ka bërë studimin e tregut, duke marrë mesataren aritmetike të tre ofertave + çmimet e sjella nga INSTAT me shkresën nr.1073/1, datë 16.06.2023, konkretisht: *1. "S. Co."; 2. "SI.ni T." dhe 3. "D.P. 2007".*

**Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":** Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*" datë 5.7.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se kriteret e aplikuara janë të argumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës, në përputhje me pikën 2 germa (c) e nenit 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe me nenet 55 e 56 të LPP-së i ndryshuar.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO**: Në dosje administrohet procesverbali për hapjen e ofertave (datë 02.10.2023) dhe procesverbali për vlerësimin e ofertave (datë 12.10.2023), ku evidentohet se kanë marrë pjesë 3 OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës | Skualifikuar/kualifikuar |
|---|---|---|---|
| **1** | **OE "4" sh.p.k** | **32,221,450** | **Kualifikuar/fitues** |
| 2 | OE "K" sh.p.k | 34,988,530 | Kualifikuar |
| 3 | OE "M" sh.p.k | Pa ofertë | skualifikuar |

*Burimi i të dhënave: SPE* *Punoi: KLSH*

Nga auditimi rezultoi se nga KVO-ja është hartuar *Raporti Përmbledhës* me shkresën me nr. 6145/4 *prot*, datë 27.10.2023, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor *znj. E.S.* dhe me shkresën nr. 6145/5, datë 01.11.2023, është hartuar *Formulari i Njoftimit të Fituesit.*
Sipas KVO është skualifikuar OE "M" sh.p.k, pasi ka paraqitur vetëm licencën II.1.A.1 dhe asnjë dokumentacion tjetër ne përmbushje te kritereve te përcaktuara ne dokumentet e tenderit, i cili është skualifikuar me të drejtë nga KVO-ja, për mungesë të dokumenteve të kërkuara në DT.
Ndërsa janë kualifikuar OE "4" sh.p.k me ofertë 32,221,450 lekë dhe "K" sh.p.k me ofertë 34,988,530 lekë. Nga KVO-ja është vlerësuar në vend të parë shoqëria "4" sh.p.k me ofertë 32,221,450 lekë pa TVSH më të leverdishme se OE tjetër në garë.
**Vlerësimi i dokumentacionit të OE të shpallur fitues:** *Nga verifikimi në dosjen e procedurës dhe të dhënat e sistemit SPE, rezultoi se vlerësimi i KVO është në zbatim të dispozitave të LPP, si në vlerësimin e OE të skualifikuar po ashtu dhe OE të shpallur fitues.*

**18- Auditim i procedurës me objekt:** *" Rikonstruksion i Qendrës së Fëmijëve", viti 2023.*

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i Qendrës së Fëmijëve", Nr. REF-56510, datë 01-20-2023.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 52/1 prot., datë 09.01.2023</td><td rowspan="2">3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Urdhër nr. 05, datë 05.01.2023<br>1. R.D. Kryetar,<br>2. A.K.<br>3. J.K.<br>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 52/1 prot., datë 09.0.1.2023, i ndryshuar<br>Njësia e Prokurimit<br>A.Xh., Jurist<br>I. F., Personi përgjegjës<br>E.Gj., Inxhiniere</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhër nr. 33, datë 09.01.2023,<br>1. G.K., Kryetar<br>2. L.S.<br>3. A.T.</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –<br>"E hapur"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)<br>106,262,235 lekë,</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSH)<br>OE "G" sh.p.k<br>me ofertë 103,989,214 lekë pa TVSH,<br>sipas kontratës nr. 52/5 prot, dt. 24.03.2023 me afat 120 ditë nga data e lidhjes së kontratës.</td><td>7. Diferenca me fondin limit<br>2,273,021 lekë, ose 2.1 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit<br>Datë 14.02.2023</td><td>9. Burimi FI.ncimit<br>Buxheti i Bashkisë, sipas VKB-së nr. 150, datë 22.12.2022</td><td>10. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 8 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 7 BOE,<br>c) Kualifikuar 1 OE/BOE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; nuk ka ankesë.</td><td>12. Përgjigje Ankesës nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës<br>nuk ka</td></tr>
</table>

**Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike:** Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga studio e projektimit "D" sh.p.k, me porosi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Në dosje administrohet edhe *Oponenca Teknike* e dërguar në bashkinë Durrës nga Instituti i Ndërtimit me shkresën nr. 119/2, datë 03.02.2022.
Sipas procesverbalit 14387/1 prot, datë 09.10.2023 të mbajtur nga grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit të kontratës, ky grup është bazuar ne projekt preventivin e hartuar nga studio projektimi private. Nga verifikimi i disa prej zërave të punës që figurojnë në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manuali.

Afati i përfundimit të punimeve 240 ditë nga projektuesi dhe 120 ditë nga komisioni i hartimit të DT.
Kapitullit "*Makineri pajisje (Sistemi i ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit*", me vlerë totale 11,122,901 lekë, gjatë hartimit të preventivit nga projektuesi "D" sh.p.k, i është ngarkuar edhe TVSH-ja, në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 1, datë 16.6.2011, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar", në të cilin jepet struktura e preventivave.
Ky veprim, ka rritur fiktivisht fondin limit në vlerën **2,224,580 lekë**, e cila bie ndesh me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficensës së fondeve publike të Bashkisë Durrës.
Gjithashtu, nga ana e komisionit të hartimit të fondit limit, rezultoi se pavarësisht vlerave të zërave të pasqyruara në preventiv nga studio projektues, nuk është dokumentuar mënyra e identifikimit apo përllogaritjes së tyre, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore, si dhe nuk është mbajtur një procesverbalit për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, mosveprim ky i fundit, në mospërputhje me nenin 2 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 sipas të cilit "*Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera*".
*Për sa sipër ngarkohen me përgjegjësi studio e projektimit "D" sh.p.k, si dhe komisionin i hartimit të fondit limit dhe specifikimeve teknike, sipas urdhrit nr. 66, datë 4.3.2024 (R.D., A.K. dhe J.K.).*

**Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":** Nga auditimi i dokumenteve të dosjes fizike, procesverbalit nr. xxx *prot*, datë 01.7.2024 "*Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të pikës 6 të nenit 39 dhe nenin 78, pika 2, të VKM nr**.** 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", (i ndryshuar), E konkretisht:
***1- Në pikën 6 të KVK** është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 6 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier ndërtimi, **Arkitekt**, **Ndërtimi Profili Strukturist**, **inxhinier Elektrik**, inxhinier Elektronik dhe inxhinier mekanik, të jenë në licencë, si dhe staf mbështetës 5 inxhinierë (Inxhinier Mekanik, Elektrik, Hidroteknik, Topograf/Gjeodet dhe Ndërtimi Profili Gjeoteknik) dhe 1 teknik ndërtimi*.
Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet (*dy inxhinierë strukturist, inxhinier ndërtimi dega gjeoteknik, 2 inxhinierë elektronikë, dy inxhinierë elektrikë dhe tekniku i ndërtimit).*
Kërkesa për një **ing. Arkitekt**, është kërkesë jo mirëargumentuara, pasi nuk kemi të bëjmë me ndërtim të ri, por me rikonstruksion objekti. Nëse do kishim ndërtim të ri përsëri pozicioni i arkitekti ezaurohet në fazën e hartimit të projektit.
**2- Është kërkuar që Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me Licence nga QKB Kodi III.2. B** *"Transportim i ujerave të ndotura urbane, llumrave septike dhe ujerave të zeza".*
Kjo kërkesë është ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis**.** Nga sa më sipër rezultoi se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, në mospërputhje me pikën (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 "*Për vlerësimin në mjedis*", me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit.

Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2/B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit rezultoi se nuk është aktivitet që plotësoni këto kushte. Nga NJP është përcaktuar baza ligjore ku është mbështetur një kriter i tillë.
Personat përgjegjës për kriteret e paargumentuara janë anëtarët e NJP: *R.D., A.K. dhe J.K.*.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO:** AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen e ofertave (datë 14.02.2023) dhe procesverbali për vlerësimin e ofertave (datë 20.02.2023). Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 8 OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës | Skualifikuar/ kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | "A.2A" &"S" & "J.C." | 86,046,103 | Skualifikuar |
| 2 | "T" & "E" | 87,878,225 | Skualifikuar |
| 3 | "I" | 91,653,952 | Skualifikuar |
| 4 | "C" | 93,501,976 | Skualifikuar |
| 5 | "D" &"RSM &H.C." | 94,412,880 | Skualifikuar |
| 6 | "L" &"E" sh.p.k& "U" | 94,615,898 | Skualifikuar |
| **7** | **"G"** | **103,989,213** | **Kualifikuar/fitues** |
| 8 | "E.VL" | Pa ofertë | Skualifikuar |

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Në përfundim të vlerësimit të dokumentacionit të OE pjesëmarrës, KVO-ja nga 8 OE pjesëmarrës ka skualifikuar 7 OE, duke mos kualifikuar shoqërinë "G" sh.p.k me ofertë 103,989,213 lekë pa TVSH, më të lartë se 6 prej OE të skualifikuar.
*Raporti Përmbledhës* është hartuar me shkresën me nr. 52/3 prot, datë 09.03.2023, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor *znj. E.S.* dhe me shkresën nr. 52/4, datë 10.03.2023, është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit dhe dërguar për publikim.

***Janë skualifikuar sipas KVO, për mos plotësim kriteresh 7 OE si më poshtë vijon:***:

**1. Për B/OE** "A" me NIPT "K31" + "S" me NIPT "K32" + "J" me NIPT "J33", me argumentin se:

*- Nuk përmbush piken 2.3.a te Kapacitetit Teknik për pune te ngjashme, pasi subjekti "A" sh.p.k, pjese e BOE, referuar VKM nr. 285, date 19.05.2021, e ndryshuar, përkatësisht neni 88, pika 3, paragrafi 2, duke qene anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim, vlerën monetare te përcaktuar ne piken 2.3.a te Kapacitetit Teknik duhet ta përmbushë të plotë, dhe jo sipas përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim.*
*Referuar dokumentacionit te paraqitur, punët e ngjashme me objekt "Rikonstruksion pjesor i shkollës 9-vjecare Himare", "Rikonstruksion i Farmacisë dhe i Dispanserisë për nevoja te Spitalit Rajonal Vlore", dhe "Stalle për rritje viçash" (edhe pse jo objekt i ngjashëm me procedurën e prokurimit), nuk e arrijnë vlerën minimale te punës se ngjashme për një objekt të vetëm te përcaktuar ne piken 2.3.a. a) te Kapacitetit Teknik, ku citohet "punë të ngjashme <u>për një objekt të vetëm</u> në një vlerë jo më të vogël se 50'000'000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës".*
*Komisioni i Vlerësimit te Ofertave mori ne shqyrtim edhe punën e ngjashme te paraqitur nga subjekti "A" me objekt "Objekt Thertore 1 Kat & Impiant Fotovoltaik 150 kW & Pajisje", e cila nuk konsiderohet objekt i ngjashëm me procedurën e prokurimit duke mos arritur vlerën minimale për një objekt të vetëm te përcaktuar ne piken 2.3.a. a) te Kapacitetit Teknik, ku citohet "punë të ngjashme <u>për një objekt të vetëm</u> në një vlerë jo më të vogël se 50'000'000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës".*
*Ne te njëjtën mënyrë, n.q.s. konsiderojmë shumen totale te punëve te ngjashme te paraqitura si me lart, nuk plotësohet as vlera minimale e përcaktuar ne piken 2.3.a. b) te Kapacitetit Teknik, ku citohet "punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, <u>e marrë së bashku</u> gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 200'000'000 lekë", pasi shuma e tyre është më e vogël se vlera minimale e kërkuar.*
*- Nuk përmbush piken 2.3.e te Kapacitetit Teknik për disponimin e punonjësve të specializuar/të kualifikuar, pasi subjekti "J" sh.p.k pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre përsipër punime hidraulike, dhe nuk ka vetedeklaruar punonjës hidraulik për realizimin e këtyre punimeve, kjo bazuar dhe në vendimin e KPP nr. 1129/2022, me nr. 2345/4 prot., date 22.11.2022.*

**2. Për OE** "T" me NIPT "L34" + "E" me NIPT "K35", me argumentin se:

*- Nuk përmbush piken 2.3.d te Kapacitetit Teknik për disponimin e stafit mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), pasi ne përmbushje te këtij kriteri nuk është vetedeklaruar si staf mbështetës* ***inxhinier elektronik.***

*- Nuk përmbush piken 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.g te Kapacitetit Teknik për disponimin punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjese e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve te vetedeklaruara për këtë procedure prokurimi janë te angazhuar ne kontratën me objekt "Riforcim i godinës se banimit 8 kate + bodrum, lagja nr.3, rruga Egnatia, Kod Gis 27258".*

**3. Për OE** "I" me NIPT "J36", me argumentin se:

*- Sipas Shtojcës 8 ka deklaruar staf dhe fuqi punëtore nga subjektet mbështetës "E. SHPKNJ" dhe "A.", e cila bie ne kundërshtim me piken 2.16 te DST, ne te cilën AK nuk lejon opsionin e mbështetjes ne kapacitetet e subjekteve te tjera, duke e bere ofertën te pavlefshme.*

*Ne këto kushte, OE I. nuk përmbush piken 2.3.d te Kapacitetit Teknik për inxhinierin elektrik, inxhinierin e ndërtimit profili gjeoteknik, inxhinierin elektronik, dhe punëtore ndërtimi te thjeshte, dhe as piken 2.3.g te Kapacitetit Teknik për disponimin e kamionit vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton, te cilat janë marre përsipër nga subjektet mbështetëse.*

*2. Nuk përmbush piken 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.g te Kapacitetit Teknik për disponimin punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjese e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve te vetedeklaruara për këtë procedure prokurimi janë te angazhuar ne kontratën me objekt "LOTI VI: Riforcim pallatit me kode gis 1023,1025".*

**4. Për OE** "C" me NIPT "J37" + "E" me NIPT "K30", me argumentin se:

*- Shoqëritë "C" sh.p.k dhe "E" sh.p.k, në formularin e vetedeklarimin (Shtojca 8), kane deklaruar subjekt mbështetës për piken 2.3.j te Kapacitetit Teknik me shoqërinë "E" sh.p.k, e cila bie ne kundërshtim me piken 2.16 te DST, ne te cilën AK nuk lejon opsionin e mbështetjes ne kapacitetet e subjekteve te tjera, duke e bere ofertën te pavlefshme.*

*Nder te tjera, subjekti mbështetës "E.-S.", ne Formularin Përmbledhës se vetedeklarimit sipas Shtojcës 8, ka vetedeklaruar se "OE është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Ekstrakt i regjistrit tregtar dhe Ekstrakt historik për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të Kufizuar" dokument i nënshkruar elektronikisht".*

*Ndërkohë, referuar ekstraktit te regjistrit tregtar dhe ekstraktit historik, statusi i aktivitetit te subjektit mbështetës "E.-S." me NIPT "L38" rezultoi "pezulluar", pezullim i cili referuar ekstraktit historik, ka ndodhur ne datën 28.10.2022, me numër çështje CN-022050-10-22.*

**5. Për B/OE "D"** me NIPT "K39" + **"Rruge Sinjalistike Mirëmbajtje" & "H. C."** me NIPT "L40", me subjekte mbështetës "E" me NIPT "J41" dhe "F" me NIPT "K42", me argumentin se:

*- Bashkimi i OE, referuar formularit të vetedeklarimin (Shtojca 8), kane deklaruar subjekte mbështetës për piken 2.3.d te Kapacitetit Teknik shoqëritë "E" sh.p.k dhe "F" sh.p.k, e cila bie ne kundërshtim me piken 2.16 te DST, ne te cilën AK nuk lejon opsionin e mbështetjes ne kapacitetet e subjekteve te tjera, duke e bere ofertën te pavlefshme.*

*Ne këto kushte, bashkimi i OE nuk përmbush piken 2.3.d te Kapacitetit Teknik, për inxhinier elektronik, dhe punëtore ndërtimi te thjeshte, te cilat janë marre përsipër nga subjektet mbështetëse.*

*- Subjekti mbështetës "E" sh.p.k për te njëjtën procedure ka ofertuar si pjese Bashkimit te Operatoreve "L" + "E" + "U" sh.p.k, ne kundërshtim me VKM nr. 285, date 19.05.2021, e ndryshuar, neni 90, pika 7, ku citohet se "Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit".*

*- Shoqëria "R" sh.p.k, nuk përmbush piken 2.3.a te Kapacitetit Teknik, pasi dokumentacioni i paraqitur nuk konsiderohet pune e ngjashme me objektin e prokurimit.*

*- Shoqëria "D" sh.p.k, nuk përmbush piken 2.3.f te Kapacitetit Teknik për disponimin e fuqisë punëtore prej minimalisht 118 persona, pasi sipas vetedeklarimit ne Shtojcën 8, referuar përqindjes se pjesëmarrjes ne bashkim, nuk arrin numrin minimal te fuqisë punëtore te kërkuar nga AK.*

*5. Bashkimi i OE nuk përmbush piken 2.3.j te Kapacitetit Teknik, ku citohet se "Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me Licence nga QKB Kodi III.2.B "Transportim i ujerave të ndotura urbane, llumrave septike dhe ujerave të zeza".*

**6. Për B/OE "L" + "E" + "U"**, me subjekte mbështetës "**ONI**" dhe "**SH**" – "**2AB K.**", me argumentin se:

*- Shoqëria "L" sh.p.k referuar formularit të vetedeklarimin (Shtojca 8), ka deklaruar subjekte mbështetës për piken 2.3.d, 2.3.e te Kapacitetit Teknik shoqëritë "O." dhe ""S" K.", e cila bie ne kundërshtim me piken 2.16 te DST, ne te cilën AK nuk lejon opsionin e mbështetjes ne kapacitetet e subjekteve te tjera, duke e bere ofertën te pavlefshme,*

*duke mos përmbushur piken 2.3.d te Kapacitetit Teknik, për inxhinier elektronik dhe punëtore ndërtimi te thjeshte, dhe as piken 2.3.e te Kapacitetit Teknik për murator dhe pllakashtrues, te cilat janë marre përsipër nga subjektet mbështetëse.*
*- Shoqëria "E" sh.p.k për te njëjtën procedure ka marre pjese si subjekt mbështetës i bashkimit te OE "D" + "R", ne kundërshtim me VKM nr. 285, date 19.05.2021, e ndryshuar, neni 90, pika 7, ku citohet se "Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit".*
*- Shoqëria "E" sh.p.k, nuk përmbush piken 2.3.e te Kapacitetit Teknik, pasi ka marre përsipër punime murature dhe suvatimi, dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë murator dhe asnjë suvaxhi. Gjithashtu, nuk përmbush piken 2.3.i te Kapacitetit Teknik, ku citohet "Certifikate: ISO 45001:2018 - Sistemi i manaxhimit te sigurisë dhe shëndetit ne vendet e punës, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", pasi nuk ka paraqitur certifikate ISO 45001:2018.*
*- Shoqëria "U" sh.p.k, nuk përmbush piken 2.3.e te Kapacitetit Teknik, pasi ka marre përsipër punime elektrike, dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë elektricist.*
*- Shoqëria "L" nuk përmbush 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.g te Kapacitetit Teknik për disponimin punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjese e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve te vetedeklaruara për këtë procedure prokurimi janë te angazhuar ne kontratën me objekt "Rikonstruksioni i hapësirave publike ne bllokun e banimit ne Lagjen Nr.17 dhe tek Muzeu i Dëshmorëve". Gjithashtu, nuk përmbush piken 2.3.f te Kapacitetit Teknik për disponimin e fuqisë punëtore prej minimalisht 118 persona, pasi sipas vetedeklarimit ne Shtojcën 8, referuar përqindjes se pjesëmarrjes ne bashkim, nuk arrin numrin minimal te fuqisë punëtore te kërkuar nga AK.*

**7. Për OE "E"** me NIPT K.....Ẅ, **pa ofertë ekonomike**, Komisioni i Vlerësimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vlerësimit te dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, OE **E.-V.:**

*Nuk ka paraqitur asnjë dokument te kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.*

*Nga auditimi i dokumentacionit në të dhënat e sistemit elektronik SPE, u konstatua se skualifikimi dhe kualifikimi i OE si më sipër bërë nga KVO është në përputhje me dispozitat e LPP, pasi mangësitë e konstatuara në mos plotësimin e disa prej kritereve qëndronin (trajtuar si më lartë).*

**19- Auditim i procedurës me objekt:** *" Rikonstruksion i rrugëve në qytet", Bashkia Durrës, viti 2023.*

| | | |
|---|---|---|
| **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "Rikonstruksion i rrugëve në qytet", Bashkia Durrës, Nr. REF-63036, datë 03-20-2023. | | |
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 2624/2 *prot*., datë 20.03.2023 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>**Urdhër nr. 109, datë 10.03.2023**<br>*1. B.M. Kryetar,*<br>*2. O.G.*<br>*3. E.T.*<br>*4. A.K.*<br>*5. J.K.*<br>*6. M.J.*<br>**1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 2624/2 *prot*., datë 20.03.2023<br>Njësia e Prokurimit<br>*A.T., Personi përgjegjës*<br>*A.Xh., Jurist*<br>*E.Gj., Inxhiniere,* | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 122, datë 20.03.2023,<br>1. *A.I., Kryetar*<br>*2. K.B.*<br>*3. K.Dh.* |
| **2. Lloji i Procedurës** –<br>"E hapur" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>41,567,027 lekë, | **6. Oferta fituese (pa TVSH**)<br>OE "V" sh.p.k<br>me ofertë 30,557,390 lekë pa TVSH, *sipas kontratës nr. 2624/6 prot, dt. 25.04.2023 me afat 42 ditë nga data e fillimit të punimeve.* | 7. Diferenca me fondin limit<br>11,009,637 lekë, ose 26.5 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 05.04.2023 | **9. Burimi FI.ncimit**<br>Buxheti i Bashkisë sipas VKB-së nr. 150, datë 22.12.2022 | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender 5 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 0 BOE,<br>c) Kualifikuar 5 OE/BOE |
| **11. Ankimime**; nuk ka ankesë. | **12. Përgjigje Ankesës** nuk ka | 13. Përgjigje Ankesës<br>nuk ka |

**Mbi projekt preventivin e zbatimit:** Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga Nj.P dhe Infrastrukturës në Bashkinë Durrës në Mars 2023 me afat përfundimi 42 ditë. Projekti i administruar në dosjen fizike nuk ka miratim (nënshkrim, vulë) nga Kryetari i Bashkisë Durrës *E. S.*
Në cilësinë e personit/ave që ka hartuar projekt/preventivin në dosje evidentohet fakti se personi përgjegjës për hartimin e këtij projekt/preventivi, të jetë i pajisur me licencë profesionale për hartimin e projektet/preventivi, pasi nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Grupi i projektimit duhet jetë i përberë minimumi nga: inxhinieri gjeodet për plan rilevimin dhe azhurnimin topografik, projektuesi arkitekt, projektuesi konstruktor, projektuesi i instalimeve e elektrike, projektuesi i instalimeve hidrosanitare, projektuesi i instalimeve ngrohje ftohje ventilim, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri, inxhinieri sizmolog, inxhinieri gjeolog, eksperti mjedisor, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*"(i ndryshuar), **neni 5**; VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "P*ër licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*" (i ndryshuar), e cila ka miratuar Rregulloren "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektim në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", neni 16*.

Për këtë objekt, administrohet në dosje Deklaratë paraprake për kryerje punimesh me nr. 878-24, datë 12.07.2024 dhe jo leje *ndërtimi/infrastrukturore*, në kundërshtim me nenin 39, pika 3 e Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "*Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit*".
Gjithashtu, në dosjen e prokurimit **nuk administrohet** *Oponenca Teknike*, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar dhe pikës 4 të VKM nr. 1055, datë 22.12.2010, kërkesa për oponencë teknike bëhet nga investitori, çka nënkupton edhe përgjegjësinë e këtij të fundit në rast mosveprimi.
Miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një **leje infrastrukturës dhe të oponencës teknike,** vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar), Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar si dhe VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit", **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi:** *Titullarin e AK, dhe Sipërmarrësin e punimeve, si dhe z. A.T.***,** në cilësinë e personit përgjegjës të dosjes së procedurës**.**
**AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin, dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*" nr. xxx, datë 5.01.2023, ndryshimeve të kryera me shtojcën përkatëse si dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se kriteret e aplikuara janë të argumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës, në përputhje me pikën 2 germa (c) e nenit 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe nenit 78 pika 4 e VKM[8], në përputhje me nenet 55 e 56 të LPP[9]-së i ndryshuar.
**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO**: Në dosje administrohet procesverbali për hapjen e ofertave (dt. 05.04.2023) dhe procesverbali për vlerësimin e ofertave

[8] VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar),
[9] Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" ( i ndryshuar)

(dt. 05.04.2023), ku evidentohet se kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 5 OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës |
|---|---|---|
| **1** | **OE "V" sh.p.k** | **30,557,390** |
| 2 | OE "K" sh.p.k | 35,024,600 |
| 3 | OE "A" sh.p.k | 39,431,100 |
| 4 | OE "B" sh.p.k | 40,548,700 |
| 5 | OE "D" sh.p.k | 41,323,948 |

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

*Raporti Përmbledhës* është hartuar me shkresën me nr. 2624/4 *prot*, datë 20.04.2023, i cili është miratuar nga Titullari i AK znj. E.S. dhe me shkresën nr. 2624/5, datë 20.04.2023 është hartuar *Formulari i Njoftimit të Fituesit* dhe dërguar për publikim.
Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se nga KVO-ja janë kualifikuar të gjithë OE pjesëmarrës, duke vlerësuar në vend të parë shoqërinë "V" sh.p.k, me ofertë 30,557,390 lekë, më të leverdishme se OE e tjerë në garë. Vlerësimi i drejtë nga KVO-ja.

**20- Auditim i procedurës me objekt**:*"Rikonstruksion Shkolla "Besnik Hidri",* Bashkia Durrës, viti 2023.

| | | |
|---|---|---|
| **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "*Rikonstruksion Shkolla "Besnik Hidri*", Bashkia Durrës, Nr. REF-60600, datë 02-27-2023. | | |
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 1405/2 *prot*., datë 20.02.2023 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>**Urdhër nr. 70, datë 03.02.2023**<br>*1. O.G. Kryetar,*<br>*2. B.M.*<br>*3. M.J.*<br>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 1405/2 *prot*., datë 20.02.2023<br>Njësia e Prokurimit<br>*A.T., Jurist*<br>*I. F., Personi përgjegjës*<br>*E.Gj., Inxhiniere, përgjegjëse prokurimit* | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>**Urdhër nr. 89, datë 20.02.2023,**<br>*1. A.I., Kryetar*<br>*2. K.B.*<br>*3. K.Dh.* |
| **2. Lloji i Procedurës** –<br>"E hapur" | | |
| 5**. Fondi Limit (pa TVSH**)<br>46,629,688 lekë, | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "M" sh.p.k<br>me ofertë 36,702,304 lekë pa TVSH, sipas kontratës nr. 1405/6 *prot*, dt. 18.04.2023 me afat 112 ditë nga data e fillimit të punimeve. | **7. Diferenca me fondin limit**<br>9,927,384 lekë, ose 21.3 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 15.03.2023 | **9. Burimi FI.ncimit**<br>Buxheti i Bashkisë, sipas VKB-së nr. 150, datë 22.12.2022 | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender 15 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 9 BOE,<br>c) Kualifikuar 6 OE/BOE |
| **11. Ankimime**; nuk ka ankesë. | **12. Përgjigje Ankesës** nuk ka | 13. Përgjigje Ankesës<br>nuk ka |

**Mbi projekt preventivin e zbatimit:** Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga Nj. P dhe Infrastrukturës në Bashkinë Durrës në Mars 2023. Projekti i administruar në dosjen fizike nuk ka miratim (nënshkrim, vulë) nga Kryetari i Bashkisë Durrës *E. S.*
Në cilësinë e personit/ave që ka hartuar projekt/preventivin në dosje evidentohet fakti personi përgjegjës për hartimin e këtij projekt/preventivi, të jetë i pajisur me licencë profesionale për hartimin e projektet/preventivi, pasi nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Grupi i projektimit duhet jetë i përberë minimumi nga: inxhinieri gjeodet për plan rilevimin dhe azhurnimin topografik, projektuesi arkitekt, projektuesi konstruktor, projektuesi i instalimeve e elektrike, projektuesi i instalimeve hidrosanitare, projektuesi i instalimeve ngrohje ftohje

ventilim, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri, inxhinieri sizmolog, inxhinieri gjeolog, eksperti mjedisor, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"(i ndryshuar), **neni 5**; VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "P*ër licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*" (i ndryshuar), e cila ka miratuar Rregulloren "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektim në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", neni 16* pika

Për këtë objekt, administrohet në dosje Deklaratë paraprake për kryerje punimesh me nr. 235-23/1, datë 09.05.2023 dhe jo *leje ndërtimi/infrastrukture*, veprim në kundërshtim me nenin 39, pika 3 e Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "*Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit*".
Gjithashtu, në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, dhe pikën 4 të VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 .
Miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një leje ndërtimi/infrastrukture dhe të oponencës teknike**,** vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar), Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar si dhe VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit", **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi:** *Titullarin e AK, Sipërmarrësi i punimeve, dhe z. I. F.***,** në cilësinë e personit përgjegjës të dosjes së procedurës**.**

**AK (Nj. P) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":** Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin, dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*" nr. xxx, datë 5.01.2023, ndryshimeve të kryera me shtojcën përkatëse si dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se kriteret e aplikuara janë të argumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës, në përputhje me pikën 2 germa (c) e nenit 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe me nenet 55 e 56 të LPP-së i ndryshuar.

**Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike:** Nga verifikimi i preventivit të administruar në dosje u konstatua se për zërin e punës "FV Dritare plastike me dopio xham (me mek antiribalt hapje), i cili është marrë me nr. analize "An" dhe çmim 16,716 lekë /$m^2$, në dosjen e prokurimit nuk administrohet analizë e veçantë. Ky zë pune në manualin e çmimeve rezultoi me nr. an 2.375/1 dhe me çmim 14,993 lekë/$m^2$, ose 1723 lekë/$m^2$ më pak se në preventivin e fondit limit. Sa sipër, për volumin e parashikuar prej 375 $m^2$, është shtuar fiktivisht vlera prej **646,125 lekë**.
Konstatohet që për të gjitha zërat e punës që janë etiketuar me nr. "Analizë", në dosjen teknike nuk ka analiza çmimi të bëra nga projektuesi.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO:** Në dosje administrohet procesverbali për hapjen e ofertave (dt. 15.03.2023) dhe procesverbali për vlerësimin e ofertave (dt. 17.03.2023). Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 15 OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës | Skualifikohet/kualifikohet |
|---|---|---|---|
| 1 | "2N" | 33,218,029 | ***Skualifikohet:*** *Nuk ka arritur të marrë Formular Vlerësimi nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Durrës për procedurën me objekt :"Rikonstruksion i Godinës se Bashkisë Durrës".* |
| 2 | "N" & "N" | 34,009,070 | ***Skualifikohet:*** |

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës | Skualifikohet/kualifikohet |
|---|---|---|---|
| | | | *Nuk përmbush piken 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f te Kapacitetit Teknik për disponimin punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve të vetëdeklaruara për këtë procedurë prokurimi janë të angazhuar në kontratën me objekt: "Rikonstruksion Shkolla Dom Nikoll Kaçorri"* |
| 3 | "L. Con." | 34,474,104 | ***Skualifikohet:*** *Nuk përmbush pikën 1. e ), te Kriteret e Përgjithshme te Kualifikimit mungon vërtetimi i cili verifikon se subjekti ka paguar energjinë elektrike.* |
| 4 | "E" | 35,703,540 | ***Skualifikohet:*** *Nuk përmbush pikën 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f te Kapacitetit Teknik për disponimin punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve të vetedeklaruara për këtë procedurë prokurimi janë të angazhuar në kontratën me objekt: "Riforcimi pallateve me kod Gis: 5407, 25387, 26969, 1511, 25947, 26972, 27307, 26764* |
| **5** | **"M"** | **36,702,304** | **Kualifikohet/fitues** |
| 6 | "B" sh.p.k | 38,233,507 | Kualifikohet |
| 7 | "S" sh.p.k& "Al. 2014" | 38,395,884 | ***Skualifikohet:*** *Nuk përmbush piken 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f te Kapacitetit Teknik për disponimin punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjese e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve te vetedeklaruara për këtë procedure prokurimi janë te angazhuar ne kontratat me objekt: "Riforcimi pallateve me kod gis: 25759, 25583, 22842, 22243, 22248, 22866, 24812, 22707, 25248, 22721, 24821, 22245, 22299". "Riforcim i godI.ve pallat me kod gis 1569, 27348, 27501* |
| 8 | "H" & "B" | 39,476,500 | Kualifikohet |
| 9 | "K.K." | 39,519,246 | Kualifikohet |
| 10 | "E.-Alb" | 40,110,657 | ***Skualifikohet:*** *Nuk përmbush pikën 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f te Kapacitetit Teknik për disponimin punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjese e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve te vetedeklaruara për këtë procedure prokurimi janë te angazhuar ne kontratën me objekt "Loti III Riforcim godine banimi 12-13 kat mbi toke dhe një kat nëntokë, Rr.Jahja Ballhysa nr.6, gis 3092 (Jedasi)"* |
| 11 | "T" | 41,828,697 | ***Skualifikohet:*** *Nuk përmbush piken 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f të Kapacitetit Teknik për disponimin punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve të vetëdeklaruara për këtë procedurë prokurimi janë të angazhuar në kontratën me objekt: "Riforcim i godinës së banimit 8 kate + bodrum, lagja nr.3, rruga Egnatia, kod gis 27258".* |
| 12 | "C" | 41,882,470 | Kualifikohet |
| 13 | "A" | 41,915,273 | ***Skualifikohet:*** *Nuk përmbush piken 1. e ), te Kriteret e Përgjithshme te Kualifikimit mungon vërtetim i cili verifikon se subjekti ka paguar energjinë elektrike.* |
| 14 | "Ed-Ko..." | 44,084,437 | Kualifikohet |
| 15 | "El.VL" | 0 | ***Skualifikohet:*** pa ofertë ekonomike |

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

*Nga auditimi i dokumentacionit në të dhënat e sistemit elektronik SPE, u konstatua se vlerësimi i KVO (skualifikimi/vlerësimi), i procedurës është në përputhje me dispozitat e LPP (trajtuar si më lartë).*

Raporti Përmbledhës është hartuar me shkresën me nr. 1405/4 prot, datë 31.03.2023, i cili është miratuar nga Titullari i AK E.S dhe me shkresën nr. 1405/5 prot, datë 03.04.2023 është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit dhe dërguar për publikim.

**21- Auditim i procedurës me objekt** *" FV Gj. qytet", Bashkia Durrës.*

**Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: *"V Gj. qytet", Bashkia Durrës, Nr. REF-62964, datë 03-20-2023.*

| | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 70/3 *prot*., datë 01.03.2023<br>2. Lloji i Procedurës –<br>"E hapur, mallra" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>**Urdhër nr. 70, datë 05.01.2023**<br>*1. L.S. Kryetar,*<br>*2. S.D.*<br>*3. M.V.*<br>1**. Urdhër Prokurimi, Nr. 70/3 *prot.*, datë 01.03.2023**<br>Njësia e Prokurimit<br>*I. F., Personi përgjegjës*<br>*A.T.,*<br>*E.Gj., Inxhiniere* | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>**Urdhër nr. 99, datë 01.03.2023**,<br>*1. G.K., Kryetar*<br>*2. R.D.*<br>*3. S.M.* |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>29,160,620 lekë, | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "A" sh.p.k<br>me ofertë 28,137,500 lekë pa TVSH,<br>sipas kontratës nr. 70/7 *prot*, dt. 22.05.2023 me afat të kontratës 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës. | **7. Diferenca me fondin limit**<br>1,023,120 lekë, ose 3.5 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 05.04.2023 | **9. Burimi FI.ncimit**<br>Buxheti i Bashkisë sipas VKB-së nr. 150, datë 22.12.2022 | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 3 BOE,<br>c) Kualifikuar 1 OE/BOE |
| **11. Ankimime; nuk ka ankesë**. | **12. Përgjigje Ankesës** nuk ka | **13. Përgjigje Ankesës**<br>nuk ka |

**Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të kritereve kualifikuese:** Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga grupi i punës të ngritur për këtë qëllim, duke bërë studimin e tregut nga ofertat e shoqërive: "F" sh.p.k, "G" sh.p.k dhe "A" sh.p.k Për hartimin e preventivit komisioni ka studiuar ofertat e tregut, të marra në datën s'ka nga 3 OE të ndryshëm, konkretisht nga shoqëria "L" sh.p.k me ofertë 42,200 lekë/copa, shoqëria "P" sh.p.k me ofertë 45,500 lekë/copa dhe shoqëria "Ẅ" sh.p.k me ofertë 40,314 lekë/copa. Mesatarja e ofertave të ardhura nga shoqëritë që ju është kërkuar është në vlerën 42,671 lekë/copa x 700 copë kazanë = 29,869,700 lekë, kjo sipas procesverbalit datë 18.01.2023 mbajtur nga komisioni.

Nga auditimi i dokumenteve të dosjes fizike, procesverbalit nr. S'ka *prot*, datë 20.3.2023 "*Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se kriteret janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të pikës 6 të nenit 39 dhe nenin 78, pika 2, të VKM nr**.** 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO**: Në dosje administrohet procesverbali për hapjen e ofertave (datë 05.04.2023) dhe procesverbali për vlerësimin e ofertave (datë 14.04.2023). Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 4 OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës | Skualifikuar/kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | BOE "A" & C." sh.p.k | 21,875,000 | Skualifikuar |
| **2** | **OE "A" sh.p.k** | **28,137,500** | **Kualifikuar/fitues** |
| 3 | OE "U" sh.p.k | 28,787,500 | Skualifikuar |
| 4 | OE "M" sh.p.k | Pa ofertë | Skualifikuar |

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Sipas procesverbali të vlerësimit datë 14.4.2023, KVO-ja nga 4 OE pjesëmarrës ka skualifikuar 3 OE dhe kualifikuar 1 OE. Nga auditimi rezulton se nga KVO-ja është hartuar *Raporti Përmbledhës* me shkresën me nr. 70/5 prot, datë 02.05.2023, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. E.S..

Është hartuar *Formulari i Njoftimit të Fituesit* me shkresën nr. 70/6, datë 02.05.2023.

***Janë skualifikuar OE si më poshtë vijon:***

**1. Bashkia i OE "A"** sh.p.k + **"C"**, me pretendimin se:

*1. Nuk përmbush piken 2.3.f te Kapacitetit Teknik, pasi referuar dokumentacionit te paraqitur, konstatohet se dokumentet e paraqitura nga shoqëria "A" sh.p.k ne përmbushje te këtij kriteri, janë ne gjuhe te huaj të pa*

*përkthyera, ne kundërshtim me DST, ku ne Njoftimin e kontratës, pika 4.7, specifikohet se "Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat është gjuha shqipe", dhe ne vazhdim, ne Kriteret e Përgjithshme te Përzgjedhjes/Kualifikimit specifikohet se "Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip".*
*Ne te njëjtën kohe, ky kriter nuk përmbushet as nga subjekti "C" sh.p.k, i cili nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ne përmbushje te këtij kriteri, pasi referuar ndarjes se punimeve, ka marre përsipër zërin e preventivit F.V Blir (20 copë).*
*2. Nuk përmbush piken 2.3.f te Kapacitetit Teknik, pasi subjekti "A" sh.p.k, nuk ka paraqitur certifikatën e regjistrimit për torfen. Ky konstatim bazohet ne nenin 4 "Përkufizime", pika 55 e ligjit nr. 17/2020 "Për produktet plehëruese", ku jepet përkufizimi: 55. "Substrakte kultivimi", janë materialet, përveç tokës ku rriten bimët*. **Vlerësimi bërë nga KVO-ja mbi mos plotësim kriteresh qëndron.**

**2. Shoqëria "U"** sh.p.k me NIPT "J43", me pretendimin se:

*1. Nuk përmbush piken 2.3.a te Kapacitetit Teknik, pasi referuar dokumentacionit te paraqitur, nuk përmbushet vlera minimale e kërkuar.*
*2. Nuk përmbush piken 2.3.d te Kapacitetit Teknik, pasi ne përmbushje te këtij kriteri, referuar formularit përmbledhës te vetedeklarimit, nuk është deklaruar si pjese e stafit teknik* ***asnjë agronom****.*
*3. Nuk përmbush piken 2.3.f te Kapacitetit Teknik, pasi nuk është paraqitur asnjë dokumentacion ne përmbushje te këtij kriteri.*
*4. Nuk përmbush piken 2.3.e te Kapacitetit Teknik, pasi nuk është paraqitur asnjë dokumentacion ne përmbushje te këtij kriteri.* **Vlerësimi bërë nga KVO-ja mbi mos plotësim kriteresh qëndron.**

**3. B. me NIPT "J44", pa ofertë ekonomike,** KVO-ja, gjate shqyrtimit dhe vlerësimit te dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, OE nuk ka paraqitur asnjë dokument te kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. *Nga shqyrtimit të kundërshtive të subjektit, rezulton se vlerësimi është bërë në zbatim të akteve ligjore të LPP, dhe në përmbushje të kërkesave kualifikuse të DST.*

**22- Auditim i procedurës me objekt** *" Ndërtim i ri Gjimnazi Manëz, NjA Manëz", Bashkia Durrës.*

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim i ri Gjimnazi Manëz, NjA Manëz", Bashkia Durrës, Nr. REF-15433-08-06-2024.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 7924/2 prot., datë 01.08.2024</td><td rowspan="2">3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Urdhër nr. 203, datë 26.06.2024<br>1. L.F. Kryetar,<br>2. R.D.<br>3. J.K.<br>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 7924/2 prot., datë 01.08.2024<br>Njësia e Prokurimit<br>E.Gj., Personi përgjegjës, Inxhiniere,<br>O.S., anëtar<br>K.Dh., Anëtar</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhër nr. 274, datë 01.08.2024,<br>1. G.K., Kryetar<br>2. L.S.<br>3. M.J.</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –<br>"Tender i kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, Punë"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)<br>315,848,761.8 lekë,</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSH)<br>BOE "D" sh.p.k & "E" sh.p.k me ofertë 315,162,521.52 lekë pa TVSH,<br>sipas kontratës nr. 7924/13 prot, dt. 04.11.2024 me afat të kontratës 16 muaj nga data e lidhjes së kontratës.</td><td>7. Diferenca me fondin limit<br>686,240.3 lekë, ose 0.22 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit<br>Datë 19.08.2024</td><td>9. Burimi FI.ncimit<br>Buxheti i Bashkisë Durrës 2024-2026, sipas VKB-së nr. 195, datë 22.12.2023</td><td>10. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 6 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 5 BOE,<br>c) Kualifikuar 1 OE/BOE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; Nuk ka</td><td>12. Përgjigje Ankesës Nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës Nuk ka</td></tr>
</table>

**<u>Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike</u>.** Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga studio e projektimit "N" sh.p.k në Janar 2023. Në dosje administrohet edhe Oponenca Teknike e dërguar në bashkinë Durrës nga Instituti i Ndërtimit me shkresën nr. 126/2, datë 14.02.2024.
Sipas procesverbalit të mbajtur nga grupi i punës në datën 06.06.2024, për përllogaritjen e fondit limit të kontratës, ky grup është bazuar ne projekt preventivin e paraqitur nga njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht në manualin nr. 216, datë

13.04.2023, për "*Miratimi i çmimeve*", si dhe për disa zëra në çmimet e tregut me analizat përkatëse.
Nga verifikimi i disa prej zërave të preventivit të administruar në dosje (*ato me peshë më të madhe në vlerën e përgjithshme*), u konstatua se përgjithësisht çmimet janë vendosur sipas manualit të çmimeve të marrë nga e-albania.

**AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":** Nga auditimi i dokumenteve të dosjes fizike, procesverbalit nr. 12271/4 *prot*, datë 6.8.2024 "*Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të pikës 6 të nenit 39 dhe nenin 78, pika 2, të VKM nr**.** 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", (i ndryshuar), E konkretisht:
**1- Në pikën 2.4.1.** *të KVK është vendosur kriteri për disponimin e Licencës së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit "Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane",* ***Kodi III.2.B dhe "Për grumbullim, dhe transportim i ujerave te ndotura urbane, llumrave septike dhe ujërave të zeza", Kodi III.2.B,*** *së bashku me aktin e miratimit te tyre.*
Kjo kërkesë është ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis**.** Nga sa më sipër rezulton se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, në mospërputhje me pikën (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 "*Për vlerësimin në mjedis*", me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit.
Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2/B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit rezulton se nuk është aktivitet që plotësoni këto kushte. Nga NJP është përcaktuar baza ligjore ku është mbështetur një kriter i tillë.
**2- Janë kërkuar**, *1 (një) inxhinier të pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, një "Auditues energjie", i cili duhet të jetë i pajisur me "Certifikatë për Auditim Energjie në ndërtesa", një "Ekspert zjarrfikës" ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe dy teknikë ndërtimi si staf mbështetës.*
Kërkesa për një **ing. Arkitekt**, është kërkesë jo mirëargumentuara, pasi nuk kemi të bëjmë me ndërtim të ri, por me rikonstruksion objekti. Nëse do kishim ndërtim të ri përsëri pozicioni i arkitekti ezaurohet në fazën e hartimit të projektit.
Kërkesa për **auditues energjetik** është e paargumentuar, pasi në nenin 16 pika 4 dhe 5 të ligjit nr.125/2015 "*Për efincencën e energjisë*" parashikohet se: "*4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për: a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie; b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të fI.ncuar nga Fondi për Efiçencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e efiçencës së energjisë. 5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen: a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij neni; b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm*"
Në dokumentet e procedurës së prokurimit, AK ka publikuar njëherazi "Preventivin e punimeve", "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe "Projektin e Zbatimit". Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi, konstatohet se në asnjë rast AK nuk ka parashikuar në "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike" kryerjen e shërbimit të auditimit të eficencës së energjisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga auditues energjetik të licencuar. Gjithashtu AK nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit

të efiçencës së energjisë. Sa më sipër, kriteri i mësipërm i vendosur nga AK në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë AK. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.124/2015 "Për efincencën e energjisë", AK në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjetik me një procedurë të veçantë.
Kërkesa për **një zjarrfikës** është e tejkaluar e LPP, pasi eksperti zjarrfikës është tejkaluar njëherë gjatë procesit të studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit dhe relacionit teknik të objektit. Kjo shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar ligjit nr. 152/2015 "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*", roli i ekspertit zjarrfikës nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës.
Kërkesa për *1 (një) inxhinier të pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis* është ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis**.** Nga sa më sipër rezulton se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, në mospërputhje me pikën (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 "*Për vlerësimin në mjedis*", me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit.
Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2/B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit rezulton se nuk është aktivitet që plotësoni këto kushte. Nga NJP është përcaktuar baza ligjore ku është mbështetur një kriter i tillë.
*Përsa sipër, ngarkohen me përgjegjësi hartuesit e dokumenteve të tenderit: L.F., R.D. dhe J.K.***.**

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në dosje administrohet procesverbali për hapjen e ofertave (datë 19.08.2024) dhe procesverbali për vlerësimin e ofertave Faza 1 (datë 02.09.2024). Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në fazën e parë të kësaj procedure 6 OE, si më poshtë:

| Nr. | OE pjesëmarrës |
|---|---|
| 1 | BOE "A" &"N.C.G." & "F" sh.p.k |
| 2 | BOE "A" & "A.I." & "E" sh.p.k |
| 3 | BOE "A" & "U" sh.p.k |
| 4 | BOE "D" & "E" sh.p.k |
| 5 | BOE "H" & "2T" & "B" sh.p.k |
| 6 | BOE "L" & "M" sh.p.k & "V" sh.p.k |

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga këta pjesëmarrës, në fazën e parë KVO-ja ka skualifikuar 5 OE nga 6 OE pjesëmarrës, duke kualifikuar për në fazën e dytë vetëm bashkimin e OE "D" sh.p.k & "E" sh.p.k
Nga auditimi i proces verbalit të vlerësimit të ofertave datë 02.09.2024 dhe vlerësimit të ngarkuar në sistem, rezultoi se arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë, janë si më poshtë:
1. **B/OE "A" & "N.C.G." & "F" sh.p.k**, është skualifikuar pasi:

*1. Nuk përmbush pikën 2.3.2 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, , pasi:*
*- Subjekti "F", pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre përsipër punime për te cilat kërkohet kategoria e licencës "NS–9 D "Punime strukturore speciale", dhe nuk e zotëron këtë kategori licence;*
*- subjekti "F" & "C. CO", pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre përsipër punime për te cilat kërkohet kategoria e licencës "NS–20B Shpime gjeologo-inxhinierike", dhe nuk e zotëron këtë kategori licence, dhe ne te njëjtën kohe nuk ka as inxhinierin gjeolog.*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.2 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional.*
*2. Nuk përmbush piken 2.3.5 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, pasi subjekti "F" & "C. CO", pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve:*

*- Ka marre përsipër punime hidraulike, dhe nuk ka paraqitur asnjë hidraulik për realizimin e këtyre punimeve;*
*- Ka marre përsipër punime ndërtimi, dhe nuk ka paraqitur asnjë punonjës murator / specialist ndërtimi për realizimin e këtyre punimeve;*
*- Ka marre përsipër punime hidroizolimi, dhe nuk ka paraqitur asnjë punonjës hidroizolues për realizimin e këtyre punimeve.*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.5 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional.*
*Ky arsyetim bazohet edhe ne vendimin e KPP Nr. 1129/2022, me nr. 2345/4 prot., date 22.11.2022.*
*3. Nuk përmbush piken 2.4.2 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim, pasi:*
*- Licenca e paraqitur nga subjekti N.C.G., pjese e BOE, nuk është e shoqëruar me aktin e miratimit, siç është kërkuar ne DT;*
*- Subjekti "F" & "C. CO.", pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre përsipër transportin e ujërave te zeza për te cilat kërkohet pajisja*
*me licencën "Kodi III.2.B"; "Për grumbullim, dhe transportim i ujerave te ndotura urbane, llumrave septike dhe ujerave te zeza", dhe nuk e zotëron këtë licence.*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.4.2 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim.*
*KVO vendos qe ofertuesi A.G + N.C.G. + F.B. & C. CO të mos kualifikohet.*

## 2. B/OE "A" & "A.I." & "E" sh.p.k, *për arsyet e mëposhtme:*

*1. Nuk përmbush piken 2.1.gj. te Kritereve te Veçanta te Kualifikimit, pasi subjektet A. dhe Ed K., pjese e BOE, nuk kane paraqitur vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë.*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.1.gj. te Kritereve te Veçanta te Kualifikimit.*
*2. Nuk përmbush 2.2.3 te Kapacitetit Ekonomik dhe FI.nciar, pasi subjektet A. dhe Ed K., pjese e BOE, nuk kane paraqitur vërtetimin e shlyerjes se taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024 ne adresat e ushtrimit te aktivitetit (për A. është paraqitur vetëm vërtetimi i Bashkisë Tirane).*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.2.3 te Kapacitetit Ekonomik dhe FI.nciar.*
*3. Nuk përmbush piken 2.3.1 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, pasi referuar dokumentacionit te paraqitur, kriteri për përvojën e mëparshme te ngjashme, nuk plotësohet nga subjekti A.I. C., pjese e BOE, pasi vlera e tyre nuk përmbush asnjë nga 2 kushtet e lartpërmendura.*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.1 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional.*
*4. Nuk përmbush piken 2.3.5 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, pasi referuar dokumentacionit te paraqitur, bashkimi i operatoreve nuk përmbush asnjë nga kërkesat për numrin e punonjësve te kërkuar.*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.5 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional.*
*5. Nuk përmbush piken 2.3.6 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, pasi subjekti ED K., pjese e BOE, nuk ka paraqitur listepagesat e punonjësve.*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.6 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional.*
*6. Nuk përmbush piken 2.3.7 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, pasi referuar dokumentacionit te paraqitur dhe te deklaruar me Shtojcën 13, bashkimi i operatoreve nuk përmbush kërkesat për mjetet dhe pajisjet e kërkuara.*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.7 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional.*
*7. Nuk përmbush piken 2.4.2 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim, pasi asnjë nga anëtarët e BOE nuk ka paraqitur licencën III.2.B "Për grumbullim, dhe transportim i ujerave te ndotura urbane, llumrave septike dhe ujerave te zeza".*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.4.2 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim.*
*8. Nuk përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim, pasi përveç autorizimit te distributorit, dokumentacioni i paraqitur është ne gjuhe te huaj.*
*Ne piken 4.6 te Dokumenteve Standarde te Tenderit deklarohet se "Gjuha(-ët) për hartimin e propozimit dhe shprehjes së interesit: Shqip X".*
*Ne te njëjtën kohe, ne Shtojcën 15 te DST "Kriteret e përgjithshme të pranimit / kualifikimit", citohet se "...Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe....".*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim.*
*KVO vendos qe ofertuesi A. + A.I. C. + ED K. të mos kualifikohet.*

## 3. B/OE "A" sh.p.k & "U" sh.p.k , *për arsyet e mëposhtme:*

*- 1. Nuk përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim, pasi për pajisjet e ashensorit, përveç autorizimit te prodhuesit/distributorit, dokumentacioni i paraqitur është ne gjuhe te huaj.*
*Ne piken 4.6 te Dokumenteve Standarde te Tenderit deklarohet se "Gjuha(-ët) për hartimin e propozimit dhe shprehjes së interesit: Shqip X".*
*Ne te njëjtën kohe, ne Shtojcën 15 te DST "Kriteret e përgjithshme të pranimit / kualifikimit", citohet se "...Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe....".*

*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim.*
*KVO vendos qe ofertuesi "A" + U. të mos kualifikohet..*

## 4. B/OE "H" & "2T" & "B" sh.p.k, *për arsyet e mëposhtme:*

- Për ofertuesin HTM me NIPT "K45" (30.06%) + 2 T me NIPT "K46" *(31.09%) + BE – IS me NIPT "K47" (38.85%), Komisioni i Vlerësimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vlerësimit te dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, OE HTM + 2 T + BE – IS:*

*1. Nuk përmbush piken 2.2.3 te Kapacitetit Ekonomik dhe FI.nciar, ku citohet se "Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë ketë dokument)", pasi subjekti 2T nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore ne Bashkinë Vore për vitin 2024. Vërtetimi i paraqitur nga Bashkia Vore i përket detyrimeve për vitin 2023.*

*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.2.3 te Kapacitetit Ekonomik dhe FI.nciar.*

*2. Nuk përmbush piken 2.3.2 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, ku citohet se "OE duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: Punime të Përgjithshme Ndërtimi: NP–1C Punime gërmimi në tokë; NP–2C Ndërtime civile e industriale; NP–7A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi dhe vaditje; NP–12A Punime të inxhinierisë së mjedisit. Punime Speciale Ndërtimi: NS–1A Punime për prishjen e ndërtimeve; NS–2A Impiante hidrosanitare, kuzhI., lavanteri, mirëmbajtja e tyre; NS–3A Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkalle lëvizëse, transportues); NS–4C Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknikendërtues; NS–9D Punime strukturore speciale; NS–12A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit; NS–14A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV; NS–18A Punime topogjeodezike; NS–20B Shpime gjeologo-inxhinierike", pasi subjekti HTM, pjese e BOE, referuar zërave te preventivit për ndarjen e punimeve, ka marre përsipër punime për te cilat nevojitet kategoria NS-9 e licencës profesionale, dhe zotëron kategorinë për nivelin A (0 – 20 milion lekë), ndërkohë qe vlera e punimeve te marra përsipër nga e tejkalon vlerën maksimale prej 20 milion lekë për te cilën është i licencuar.*

*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.2 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional.*

*3. Nuk përmbush piken 2.3.5 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, ku citohet se "OE duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Punonjës Staf Teknik: Teknik Ndërtimi 2 (dy); Hidraulikë 3 (tre); Elektricistë 3 (tre); Karpentier 3 (tre); Hekurkthyes 3 (tre); Mekanik 2 (dy); Saldator dhe prerës të metaleve 2 (dy); Murator 3 (tre); Pllakashtrues 3 (tre); Hidroizolues 3 (tre); Bojaxhi 3 (tre); Specialist ndërtimi 3 (tre); Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse 2 (dy); Punëtorë ndërtimi te thjeshte 30 (tridhjetë). Punonjës Manovrator: Ekskavatorist 3 (tre); Automakinist 3 (tre). Për këta punonjës, OE ofertues duhet të paraqesë: kontratën individuale të punës; një dokument (diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente; certifikate te sigurimit teknik e lëshuar nga shoqëri te akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë", pasi subjekti 2T, pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre përsipër punime gërmimi, dhe nuk plotëson punonjësit e nevojshëm për kryerjen e këtyre punimeve.*

*Ky arsyetim bazohet edhe ne vendimin e KPP Nr. 1129/2022, me nr. 2345/4 prot., date 22.11.2022.*

*Ne përmbushje persa me lart, subjekti 2 T ka paraqitur dokumentacionin e punonjësve për kryerjen e këtyre punimeve (3 ekskavatoristë dhe 2 automakinist/manovrator), te cilët nuk janë paraqitur dhe vetedeklaruar ne forme tabelare ne deklaratën mbi punonjësit e specializuar te paraqitur nga subjekti 2 T.*

*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.5 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional.*

*4. Nuk përmbush piken 2.3.7 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, ku citohet se "OE pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, 3 copë; Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton, 3 copë; Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton, 3 copë; Kamion me vinxh me kapacitet mbajtës 5-7 ton, 1 copë; Vinç kulle me kapacitet mbajtës jo me pak se 3 ton, 1 copë; Vinç karel portativ i lëvizshëm me kapacitet mbajtës se 0.3-0.5 ton, 1 copë; Kamion me kosh për punime ne lartësi, 1 copë; Trajler për transport mjetesh, 1 copë; Fadromë me goma, 1 copë; Ekskavator 0.25 m3 me gome, 1 copë; Ekskavator me zinxhirë, 2 copë; Mini ekskavator me zinxhirë deri 3 ton, 2 copë; Mini Fadromë, 1 copë; Autobot uji, 2 copë; Betoniere kantieri, 1 copë; Auto betoniere, 4 copë; Autopompë betoni, 1 copë; Vibrator betoni, 1 copë; Pompe Suvatimi, 2 copë; Tranxhe për përpunimin e hekurit të ndërtimit, 1 copë; Elektrosaldatriçe, 1 copë; Depozitë uji (kapaciteti minimal 2000 litra), 1 copë; Vibrator betoni, 2 copë; Moto pompe uji, 2 copë; Motogjenerator, 2 copë; Matrapik, 2 copë; Rul vibrimi min 5 ton, 1 copë; Tokmak /pajisje për nivelim shtresash, 2 copë; Armatur druri (Betoforma), 500 m2; Skeleri + Rrjet plastike për mbrojte ne pune, 1000 m2; Sonde shpimi me diameter ÷1000mm, 1 copë; Makineri për vendosje palankolash, 1 copë; Autobot për largimin e ujërave te zeza, 1 copë; Kontenier Stacionar, 1 copë; GPS/Teodoliti kërkohet për dhënien dhe kontrollin*

*sa me te shpeshte te kuotave gjate procesit te punës ne kantier, 1 copë. Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; lejen e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; certifikatë transporti lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore dhe fotot përkatëse. Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve", pasi janë paraqitur 2 mjete nga 3 te kërkuar. Për mjetin me targe DR9549E i paraqitur ne përmbushje te këtij kriteri, nuk është paraqitur dokumentacioni i mjetit.*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.7 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional.*
*5. Nuk përmbush piken 2.4.2 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim, ku citohet se "Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licencë lëshuar nga QKL: "Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane", "Kodi III.2.B"; "Për grumbullim, dhe transportim i ujerave te ndotura urbane, llumrave septike dhe ujerave te zeza", "Kodi III.2.B", së bashku me aktin e miratimit te tyre", pasi subjekti HTM, pjese e BOE, referuar preventivit te ndarjes se punimeve te paraqitur, ka marre përsipër transportin, por nuk ka paraqitur licence III.2.B "Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane" (është paraqitur vetëm akti i miratimit).*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.4.2 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim.*
*KVO vendos qe ofertuesi HTM + 2 T + BE – IS të mos kualifikohet.*

**5. B/OE "L" & "M" & "V" sh.p.k,** *për arsyet e mëposhtme:*

*- Për ofertuesin L.K. me NIPT "K48" (75%) + "M" me NIPT "J49" (5%) + V.K. me NIPT "K50" (20%), Komisioni i Vlerësimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vlerësimit te dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se ky operator ekonomik:*
*1. Nuk përmbush piken 2.3.2 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, pasi subjekti M., pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre përsipër punime për te cilat nevojitet kategoria NS-9 e licencës profesionale, dhe nuk e zotëron këtë kategori ne licencën e shoqërisë. Ne te njëjtën kohe, subjekti L.K., pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre përsipër punimet për te cilat nevojitet kategoria NS-9D e licencës profesionale, dhe zotëron kategorinë për nivelin B ne licencën e shoqërisë.*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.2 te Kapacitetit Teknik dhe Profesional.*
*2. Nuk përmbush piken 2.4.1 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim, pasi subjekti M., pjese e BOE, nuk ka paraqitur certifikatën ISO 50001:2011 - "Standard për Sistemin e Menaxhimit te Energjisë", e vlefshme, ose Ekuivalente.*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.4.1 te Kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim.*
*3. Nuk përmbush piken 2.4.2 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim, pasi asnjë nga anëtarët e BOE nuk ka paraqitur licencën III.2.B "Për grumbullim, dhe transportim i ujerave te ndotura urbane, llumrave septike dhe ujerave te zeza".*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.4.2 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim.*
*4. Nuk përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave te tjera te Veçanta për Kualifikim, pasi:*
*- për pajisjet hidrosanitare, përveç autorizimit te distributorit dhe prodhuesit, dokumentacioni i paraqitur është ne gjuhe te huaj;*
*- për pajisjet elektrike, përveç autorizimit te distributorit dhe prodhuesit (pjesërisht), dokumentacioni i paraqitur është ne gjuhe te huaj;*
*- për pajisjet ngrohje-ventilim, përveç autorizimit te distributorit dhe prodhuesit, dokumentacioni i paraqitur është ne gjuhe te huaj, si edhe mungon katalogu ose skeda teknike e prodhuesit;*
*- për pajisjet elektrike, përveç autorizimit te distributorit dhe prodhuesit (pjesërisht), nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar (katalogu i paraqitur i përket distributorit dhe jo prodhuesit).*
*Ne piken 4.6 te Dokumenteve Standarde te Tenderit deklarohet se "Gjuha(-ët) për hartimin e propozimit dhe shprehjes së interesit: Shqip X".*
*Ne te njëjtën kohe, ne Shtojcën 15 te DST "Kriteret e përgjithshme të pranimit / kualifikimit", citohet se "...Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe....".*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim.*
*KVO vendos qe ofertuesi L.K. + "M" + V.K. të mos kualifikohet.*

Me shkresën me nr. 7924/6 prot., datë 11.09.2024, në zbatim të dispozitave të LPP, është njoftuar dhe i është kërkuar dorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në DT për fazën e dytë bashkimit të OE "D" & "E" sh.p.k
Me procesverbalin e datës 04.10.2024, KVO-ja ka administruar dokumentacionin e dorëzuar nga bashkimi OE "D" & "E" sh.p.k, ku konstaton se dokumentet provuese të paraqitura nga BOE, janë të njëjta me ato të paraqitura në SPE.

Me procesverbalin e datës 20.09.2024, KVO-ja ka hapur ofertën e BOE "D" sh.p.k & "E" sh.p.k, i kualifikuar në fazën 1 të procedurës. Është konstatuar se oferta ekonomike e këtij operatori është 315,162,521.52 lekë.
Me procesverbalin e datës 24.09.2024, KVO-ja ka bërë vlerësimin e ofertës, sipas kritereve të vendosura në DT, duke bërë klasifikimin përfundimtar dhe shpallur fitues këtë BOE.
Nga KVO-ja është hartuar *Raporti Përmbledhës* me shkresën me nr. 7924/10 prot, datë 07.10.2024, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.J., dhe me shkresën nr. 7924/7, datë 25.09.2024, është hartuar *Formulari i Njoftimit të Fituesit.*
*Nga auditimi i procesit të vlerësimit të procedurës, u konstatua se KVO-ja ka vepruar në përputhje me dispzitat e LPP, si për OE e skualifikuar po ashtu dhe OE e kualifikuar, si atë të shpallur fitues.*

**23- Auditim i procedurës me objekt:** *" Rikonstruksion i Pallatit të Kulturës", Bashkia Durrës.*

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i Pallatit të Kulturës", Bashkia Durrës, Nr. REF-13423-07-17-2024.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 3327/2 prot., datë 01.08.2024</td><td rowspan="2">3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Urdhër nr. 78, datë 11.03.2024<br>1. L.F. Kryetar,<br>2. B.M.<br>3. J.K.<br>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 3327/2 prot., datë 01.08.2024<br>Njësia e Prokurimit<br>E.Gj., Personi përgjegjës, Inxhiniere, O.S., anëtar<br>K.Dh., Anëtar</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhër nr. 243 datë 15.07.2024,<br>1. G.K., Kryetar<br>2. L.S.<br>3. R.D.</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –<br>"E hapur, Punë"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)<br>496,274,322 lekë</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSH)<br>BOE "G" sh.p.k & "G" sh.p.k & "S" sh.p.k me ofertë 488,709,669 lekë pa TVSH, sipas kontratës nr. 3327/11 prot, dt. 08.11.2024 me afat të kontratës 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.</td><td>7. Diferenca me fondin limit<br>7,564,653 lekë, ose 1.5 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit<br>Datë 02.08.2024</td><td>9. Burimi FI.ncimit<br>Buxheti i Bashkisë Durrës 2024-2026, sipas VKB-së nr. 195, datë 22.12.2023</td><td>10. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 6 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 5 BOE,<br>c) Kualifikuar 1 OE/BOE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; Nuk ka</td><td>12. Përgjigje Ankesës Nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës Nuk ka</td></tr>
</table>

**<u>Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike</u>:** Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga studio e projektimit "AS Arch..." në Dhjetor 2021. Në dosje administrohet edhe Oponenca Teknike e dërguar në bashkinë Durrës nga Instituti i Ndërtimit me shkresën nr. 233/2, datë 07.05.2024.
Sipas procesverbalit të mbajtur nga grupi i punës në datën 01.07.2024, për përllogaritjen e fondit limit të kontratës, ky grup është bazuar ne projekt preventivin e hartuar nga studio projektimi private.
Nga auditimi i oponencës konstatohet se vlera e dhënë nga projektuesi nuk është e saktë artimetikisht, ndërkohë nga grupi i punës sugjerimi për rregullimin e vlerës së objektit nuk është marrë në konsideratë.

Nga verifikimi i disa prej zërave të preventivit të administruar në dosje (*ato me peshë më të madhe në vlerën e përgjithshme*), u konstatua se disa nga çmimet janë vendosur sipas manualit të çmimeve të manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Nuk administrohen analizat e çmimeve apo testim tregu për zërat me An, të cilat zënë pjesën kryesore të zërave të preventivit.
Konstatohet se në strukturën e preventivit të fondit limit (*del që është e njëjtë edhe në ofertën fituese*), pajisjet janë ngarkuar me TVSH, duke rritur fiktivisht fondin limit në vlerën **12,006,339 lekë** *{(30,702,386 pajisjet HVAC + 10,157,730 ngrohja me radiatore + 6,771,580 pajisjet MKZ*

*+ 12,400,000 pajisjet e sistemit mekanik të skenës) x 20%}*, vlerë që përbën përdorim pa ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Durrës.
Gjithashtu, nga ana e komisionit të hartimit të fondit limit, rezultoi se pavarësisht vlerave të zërave të pasqyruara në preventiv nga studio projektues, nuk është dokumentuar mënyra e identifikimit apo përllogaritjes së tyre, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore, si dhe nuk është mbajtur një procesverbalit për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, mosveprim ky i fundit, në mospërputhje me nenin 2 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi studio e projektimit "AS Arch.", si dhe komisionin i hartimit të fondit limit dhe specifikimeve teknike, sipas urdhrit nr. 78, datë 11.3.2024, me përbërje L.F. Kryetar, 2. B.M. dhe 3. J.K.*.

**Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga auditimi i dokumenteve të dosjes fizike, procesverbalit nr. xxx *prot*, datë 01.7.2024 "*Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të pikës 6 të nenit 39 dhe nenin 78, pika 2, të VKM nr**.** 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", (i ndryshuar), E konkretisht:
**1- Në pikën 2.4.2.** *të KVK është vendosur kriteri për disponimin e Licencës së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit "**Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane", "Kodi III.2.B",** së bashku me aktin e miratimit te tyre*.
Kjo kërkesë është ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis**.** Nga sa më sipër **rezultoi** se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, në mospërputhje me pikën (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 "*Për vlerësimin në mjedis*", me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit.
Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2/B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit **rezultoi** se nuk është aktivitet që plotësoni këto kushte. Nga NJP është përcaktuar baza ligjore ku është mbështetur një kriter i tillë.
***2- Janë kërkuar,* 1 (një) *Arkitekt*, *1 (një) inxhinier të pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, një "Audituesenergjie", i cili duhet të jetë i pajisur me "Certifikatë për Auditim Energjie në ndërtesa", një "Ekspert zjarrfikës"** *ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe tre teknikë ndërtimi si staf mbështetës*.
Kërkesa për një **ing. Arkitekt**, është kërkesë jo mirëargumentuara, pasi nuk kemi të bëjmë me ndërtim të ri, por me rikonstruksion objekti. Nëse do kishim ndërtim të ri përsëri pozicioni i arkitekti ezaurohet në fazën e hartimit të projektit.
Kërkesa për **auditues energjetik** është e paargumentuar, pasi në nenin 16 pika 4 dhe 5 të ligjit nr.125/2015 "*Për efincencën e energjisë*" parashikohet se*:" 4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për: a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie; b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të fI.ncuar nga Fondi për Efiçencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e efiçencës së energjisë. 5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen: a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij neni; b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.*"
Në dokumentet e procedurës së prokurimit, AK ka publikuar njëherazi "Preventivin e punimeve", "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe

"Projektin e Zbatimit". Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi, konstatohet se në asnjë rast AK nuk ka parashikuar në "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike" kryerjen e shërbimit të auditimit të eficencës së energjisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga audituesi energjetik të licencuar. Gjithashtu AK nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit të efiçencës së energjisë. Sa më sipër, kriteri i mësipërm i vendosur nga AK në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë AK. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.124/2015 "Për efincencën e energjisë", AK në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjetik me një procedurë të veçantë.
Kërkesa për **një zjarrfikës** është e tejkaluar e LPP, pasi eksperti zjarrfikës është tejkaluar njëherë gjatë procesit të studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit dhe relacionit teknik të objektit. Kjo shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar ligjit nr. 152/2015 "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*", roli i ekspertit zjarrfikës nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës.
Kërkesa për *1 (një) inxhinier të pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis* është ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis**.** Nga sa më sipër **rezultoi** se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, në mospërputhje me pikën (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 "*Për vlerësimin në mjedis*", me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit.
Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2/B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit **rezultoi** se nuk është aktivitet që plotësoni këto kushte. Nga NJP është përcaktuar baza ligjore ku është mbështetur një kriter i tillë.
*Përsa sipër, ngarkohen me përgjegjësi hartuesit e dokumenteve të tenderit: L.F., R.D. dhe J.K.***.**

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Nga auditimi konstatohet se formularët e deklarimit të konfliktit të interesit të anëtarëve të KVO-së të administruara në dosje, **janë të paplotësuara**, në kundërshtim me nenin 80 të VKM nr**.** 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
Në dosje administrohet procesverbali për hapjen e ofertave (datë 02.08.2024) dhe procesverbali për vlerësimin e ofertave Faza 1 (datë 08.08.2024). Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në këtë procedurë 6 OE, me ofertat si më poshtë:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Oferta ekonomike | Skualifikuar/kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | "D" | 313,171,632 | Kualifikuar |
| 2 | "B" &"NG St." | 437,697,139 | Skualifikuar |
| 3 | "L" & "V" & "L" | 441,754,980 | Skualifikuar |
| **4** | **"G" & "G" & "S"** | **488,709,669** | **Kualifikuar/fitues** |
| 5 | "4 AM" | 496,262,091 | Skualifikuar |
| 6 | "R.Co.." | Pa ofertë | Skualifikuar |

*Burimi i të dhënave: SPE*
*Punoi: KLSH*

KVO-ja pas vlerësimit të dokumentacionit në SPE, nga 6 OE pjesëmarrës janë skualifikuar 4 OE, duke kualifikuar 2 OE, konkretisht: OE "D" sh.p.k dhe Bashkimin e OE "G" & "G" sh.p.k & "S" sh.p.k, kjo sipas proces verbalit të vlerësimit të ofertave datë 02.09.2024.

***Janë skualifikuar këto shoqëri, me argumentin se:***

**1- Bashkimi I OE "B" +" NG S." sh.p.k**, *me subjekt mbështetës R.E. me NIPT "L51", për arsyet e mëposhtme:*

*- Nuk përmbush piken 2.3.1 te KT për përvojën e mëparshme te ngjashme, pasi subjekti B., pjese e BOE, ne kundërshtim me VKM nr. 285, date 19.05.2021, e ndryshuar, përkatësisht neni 88, pika 3, paragrafi 2, duke qene anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim, vlerën monetare te përcaktuar ne piken 2.3.a të KT duhet ta përmbushë te plote, dhe jo sipas përqindjes se pjesëmarrjes ne bashkim.*
*- Nuk përmbush piken 2.3.3 te KT, pasi nuk është vetedeklaruar/paraqitur asnjë Inxhinier Ndërtimi profili strukturist drejtues teknik ne licencat e shoqërisë te paraqitura nga BOE, duke mos e përmbushur këtë kriter.*
*- Nuk përmbush piken 2.3.5 te KT, pasi subjekti "N" pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre përsipër 35% te totalit te preventivit, dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës hidraulik, karpentier, hekurkthyes, specialist ndërtimi, instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse, pllakashtrues, murator, hidroizolues, termoizolues, bojaxhi, për realizimin e këtyre punimeve. Ky arsyetim bazohet edhe ne vendimin e KPP nr. 1129/2022, me nr. 2345/4 prot., date 22.11.2022.*
*- Nuk përmbush piken 2.3.7 te KT, pasi nuk është vetedeklaruar/paraqitur asnjë Minieskavator me zinxhirë deri 3 ton, nga 2 te kërkuar, duke mos e përmbushur këtë kriter.*

**2- Bashkimi i OE "L" + "V" + "L"** sh.p.k, *për arsyet e mëposhtme:*

*1- Nuk përmbush piken 2.3.2 te KT, pasi subjekti "L" sh.p.k pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre përsipër punimet për te cilat kërkohet kategoria NS-19 A, dhe nuk e zotëron këtë kategori ne licencën e paraqitur.*
*- Nuk përmbush piken 2.3.3 te KT, pasi nuk është vetedeklaruar/paraqitur asnjë Inxhinier Ndërtimi profili strukturist drejtues teknik ne licencat e shoqërisë te paraqitura nga BOE, duke mos e përmbushur këtë kriter.*
*- Nuk përmbush piken 2.3.4 te KT, pasi nuk është vetedeklaruar/paraqitur asnjë Inxhinier Ndërtimi profili strukturist drejtues teknik, duke mos e përmbushur këtë kriter.*
*- Nuk përmbush piken 2.3.5 te KT, pasi subjekti "V" sh.p.k, pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve ka marre përsipër punime elektrike dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës elektricist, për realizimin e këtyre punimeve; ka marre përsipër punime hidraulike dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës hidraulik, për realizimin e këtyre punimeve; ka marre përsipër punime mekanike dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës mekanik, për realizimin e këtyre punimeve; ka marre përsipër punime ndërtimi dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës specialist ndërtimi, për realizimin e këtyre punimeve.*
*Ne te njëjtën mënyrë, subjekti LL. pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve ka marre përsipër punime murature dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës murator, për realizimin e këtyre punimeve;*
*- ka marre përsipër punime suvatimi dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës suvatues, për realizimin e këtyre punimeve; ka marre përsipër zëra transporti me auto dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës shofer, për realizimin e këtyre punimeve; ka marre përsipër punime hekuri dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës hekurkthyes, për realizimin e këtyre punimeve; ka marre përsipër punime hidroizolimi dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës hidroizolues, për realizimin e këtyre punimeve; ka marre përsipër punime termoizolimi dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës termoizolues, për realizimin e këtyre punimeve; ka marre përsipër punime ndërtimi dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë specialist ndërtimi, për realizimin e këtyre punimeve; ka marre përsipër punime bojatisje dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës bojaxhi, për realizimin e këtyre punimeve; ka marre përsipër punime shtrimi pllakash dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës pllakashtrues, për realizimin e këtyre punimeve.*
*Ky arsyetim bazohet edhe ne vendimin e KPP Nr. 1129/2022, me nr. 2345/4 prot., date 22.11.2022.*
*Ne te njëjtën kohe, BOE ofertues nuk plotëson numrin minimal te punëtoreve te ndërtimit te thjeshte.*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.5 te Kapacitetit Teknik.*

3. **Shoqëria "4" sh.p.k**, *për arsyet e mëposhtme:*

*Nuk përmbush piken 2.3.5 te KT, pasi: nuk është vetedeklaruar asnjë punonjës specialist ndërtimi nga 4 (katër) te kërkuar; është vetedeklaruar 1 (një) përgatitës i konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm nga (dy) 2 te kërkuar.*
*- Nuk përmbush piken 2.4.3 te KT, pasi i gjithë dokumentacioni i paraqitur ne përmbushje te këtij kriteri është ne gjuhe te huaj,* ***pa përkthimin e noterizuar ne shqip****.*
*Ne piken 4.7 te DST deklarohet se "4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X". Ne te njëjtën kohe, ne Shtojcën 7 te DST Formulari i kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit; 1. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit, citohet se "...Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip...". Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.4.3 te Kapacitetit Teknik.*

4. **Shoqëria "D" sh.p.k**, *për arsyet e mëposhtme:*

***KVO****, konstatoi se oferta rezultoi anomalisht e ulet. Ne këto kushte, ne respektim te nenit 27 të ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.*

**5. Shoqëria "R" sh.p.k**, *për arsyet e mëposhtme:*

*- Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ne përmbushje te kritereve te përcaktuara ne dokumentet e tenderit.*

Është kualifikuar OE "D" sh.p.k, i cili pas shqyrtimit të ofertës ekonomike, rezultoi të jetë me ofertë anomalisht të ulët, duke u skualifikuar me të drejtë nga KVO-ja, duke e kualifikuar bashkimi i OE "G" & "G" & "S" sh.p.k me vlerë të ofertës 488,709,669 lekë pa TVSH.
Me shkresën pa nr. prot., datë 08.08.2024, është njoftuar dhe i është kërkuar dorëzimi i dokumentacionit fizik të BOE.
Nga KVO-ja është hartuar *Raporti Përmbledhës* me shkresën me nr. 3327/6 prot, datë 11.09.2024, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.J., dhe me shkresën nr. 3327/8, datë 11.09.2024 **ë**shtë hartuar *Formulari i Njoftimit të Fituesit*.
Nga BOE i shpallur fitues është paraqitur dokumentacioni fizik origjI.l, ose kopje të njehsuara me origjI.lin, ku sipas procesverbalin e datës 30.08.2024 (me 93 dokumente dhe 3657 fletë), KVO-ja konstaton se dokumentet provuese të paraqitura janë të njëjta me ato të paraqitura në SPE.
*Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe të dhënave nga sistemi elektronik SPE, rezultoi se si skualifikimi i OE pjesëmarrës dhe shpallja fitues e B/OE "G" & "G" & "S" sh.p.k", janë në përputhje me dispozitat e LPP*.

**24- Auditim i procedurës me objekt:** *"Ndërtim shkolla 9 vjeçare "Met Hasa", Bashkia Durrës.*

| | | |
|---|---|---|
| **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "Ndërtim shkolla 9 vjeçare "Met Hasa"", Bashkia Durrës, Nr. REF-12832-07-11-2024. | | |
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 5812/1 *prot*., datë 08.07.2024<br>2. Lloji i Procedurës – "E hapur" | 3**. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>**Urdhër** nr. 155, datë 09.05.2024<br>*1. L.F. Kryetar,*<br>*2. B.M.*<br>*3. D.E.*<br>1. Urdhër Prokurimi<br>**Nr. 5812/1 *prot*., datë 08.07.2024**<br>Njësia e Prokurimit<br>*A.Xh., Jurist,*<br>*O.S.,*<br>*E.Gj., Inxhiniere, Personi përgjegjës* | 4**. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>**Urdhër** nr. 229, datë 08.07.2024**,**<br>*1. G.K., Kryetar*<br>*2. L.S.*<br>*3. M.J.* |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>241,896,945 lekë, | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "A" sh.p.k<br>me ofertë 193,847,553 lekë pa TVSH (i korrigjuar),<br>sipas kontratës nr. 5812/22 *prot*, dt. 23.12.2024 me afat të kontratës 365 ditë nga data e lidhjes së kontratës. | 7. Diferenca me fondin limit 50,548,812 lekë, ose 20.9 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 05.08.2024 | 9**. Burimi FI.ncimit**<br>Buxheti i Bashkisë, sipas VKB-së nr. 195, datë 22.12.2023 | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender 11 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 10 BOE,<br>c) Kualifikuar 1 OE/BOE |
| **11. Ankimime**; A/2024/4610 | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK 5812/13, datë 08.10.2024 | **13. Përgjigje Ankesës**<br>nuk KPP Vendimi 1491/2024, datë 23.10.2024 dhe Vendimi 1553/2024, datë 04.11.2024 |

**Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve:** Nga *auditimi i dokumenteve* të dosjes fizike, procesverbalit nr. xxx *prot*, datë 11.7.2024 "*Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të pikës 6 të nenit 39 dhe nenin 78, pika 2, të VKM nr**.** 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", (i ndryshuar), E konkretisht:
**1- Në pikën 2.4.2. të KVK** *është vendosur kriteri për disponimin e Licencës së lëshuar nga* ***Qendra Kombëtare e Licencimit për grumbullimin dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme (kodi III.2.B).***

Kjo kërkesë është ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis**.** Nga sa më sipër **rezultoi** se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, në mospërputhje me pikën (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 "*Për vlerësimin në mjedis*", me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit.

Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2/B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit **rezultoi** se nuk është aktivitet që plotësoni këto kushte. Nga NJP është përcaktuar baza ligjore ku është mbështetur një kriter i tillë.

**2- Është kërkuar një arkitekt** *të jetë në licencën profesionale të shoqërisë dhe një inxhinier gjeolog dhe një teknik ndërtimi në stafin mbështetës. Këto kritere nuk janë në përpjesëtim me natyrën e objektit që prokurohet.*

Kërkesa për një **ing. Arkitekt**, është kërkesë jo mirëargumentuara, pasi nuk kemi të bëjmë me ndërtim të ri, por me rikonstruksion objekti. Nëse do kishim ndërtim të ri përsëri pozicioni i arkitekti ezaurohet në fazën e hartimit të projektit.

**3- Është kërkuar (një) "Auditues energjie",** *i cili duhet të jetë i pajisur me "Certifikatë për Auditim Energjie në ndërtesa" dhe 1 (një) inxhinier të pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.*

Kërkesa për *auditues energjetik* është e paargumentuar, pasi në nenin 16 pika 4 dhe 5 të ligjit nr.125/2015 "*Për efincencën e energjisë*".

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, AK ka publikuar njëherazi "Preventivin e punimeve", "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe "Projektin e Zbatimit". Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi, konstatohet se në asnjë rast AK nuk ka parashikuar në "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike" kryerjen e shërbimit të auditimit të eficencës së energjisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga auditues energjetik të licencuar. Gjithashtu AK nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit të efiçencës së energjisë. Sa më sipër, kriteri i mësipërm i vendosur nga AK në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë AK. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.124/2015 "*Për efincencën e energjisë*", AK në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjetik me një procedurë të veçantë.

Kërkesa për *1 (një) inxhinier të pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis* është ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis**.** Nga sa më sipër **rezultoi** se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, në mospërputhje me pikën (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 "*Për vlerësimin në mjedis*", me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit.

Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2/B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit **rezultoi** se nuk është aktivitet që plotësoni këto kushte. Nga NJP është përcaktuar baza ligjore ku është mbështetur një kriter i tillë Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën e objektit që prokurohet dhe janë ta paqarta, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kane krijuar mundësinë për të favorizuar

operatorë ekonomikë të caktuar, duke *ngarkuar me përgjegjësi hartuesit e dokumenteve të tenderit L.F., B.M. dhe D.E.***.**

**Mbi përllogaritjen e fondit limit.** Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga studio e projektimit "I" sh.p.k në vitin 2023.
Sipas procesverbalit të mbajtur nga grupi i punës në datën 06.06.2024, për përllogaritjen e fondit limit të kontratës, ky grup është bazuar ne projekt preventivin e paraqitur nga njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht në manualin nr. 216, datë 13.04.2023, për "*Miratimi i çmimeve*", si dhe për disa zëra në çmimet e tregut me analizat përkatëse.
Nga verifikimi i disa prej zërave të preventivit të administruar në dosje (ato me peshë më të madhe në vlerën e përgjithshme), u konstatua se përgjithësisht çmimet janë vendosur sipas manualit të çmimeve të vitit 2015. Në dosje nuk administrohet studimi i tregut për analizat e hartuara nga projektuesi.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në dosje administrohet procesverbali për hapjen e ofertave (dt. 05.08.2024) dhe procesverbali për vlerësimin e ofertave (dt. 26.08.2024), ose 21 ditë nga data e hapjes së ofertave, veprim në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", nenin 82, pika 1 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", sipas të cilit "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla*", **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO.**
Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, kanë marrë pjesë në procedurë 11 OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës | Skualifikuar/kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | "S" sh.p.k | 177,777,777 | Skualifikuar |
| 2 | "B93 II & "G" sh.p.k & "N" sh.p.k & "B" sh.p.k | 182,502,514 | Skualifikuar |
| **3** | **"D" sh.p.k** | **186,201,751.32** | **Kualifikuar** |
| 4 | "H" sh.p.k & "B" sh.p.k | 189,591,693 | Skualifikuar |
| 5 | "C" sh.p.k & "B" sh.p.k | 196,244,277 | Skualifikuar |
| **6** | **"A" sh.p.k & "S" sh.p.k** | **193,847,553.25** | **Kualifikuar** |
| 7 | "N" sh.p.k & "N" sh.p.k | 198,259,677.54 | Skualifikuar |
| 8 | "O" sh.p.k & "E" sh.p.k | 199,115,352.85 | Skualifikuar |
| 9 | "L" sh.p.k | 211,722,794 | Skualifikuar |
| 10 | "S" sh.p.k | 228,547,387.88 | Skualifikuar |
| 11 | "B" sh.p.k & "K" sh.p.k | 236,817,110 | Skualifikuar |

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Në fazën e parë nga 11 OE pjesëmarrës në procedurë, KVO-ja ka skualifikuar 9 OE dhe kualifikuar 2 OE, siç paraqitet në pasqyrën sipër.
Në fazën e dytë është skualifikuar OE "D" sh.p.k me ofertë 186,201,751 lekë, pas paraqitjes së dokumentacionit fizik i cili nuk është në plotësim të kërkesave të DST dhe formularit të vetëdeklarimit.

- ***<u>OE të skualifikuar në fazën e parë, paraqitet si vijon</u>***:

**1. OE "S" sh.p.k me NIPT "K52",** për arsye se:

*Nuk përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim, pasi i gjithë dokumentacioni i paraqitur ne përmbushje te këtij kriteri për pajisjet hidrosanitare, pajisjet ngrohje-ventilim, pajisjet e ashensorit (përveç autorizimit te distributorit), është ne gjuhe te huaj, pa përkthimin e noterizuar ne shqip.*

**2. B/OE "B" me NIPT "L53" + "G" me NIPT "J54" + "N" me NIPT "J55" + "B" me NIPT "J56",** *për arsyet e mëposhtme:*

*BOE ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit te OE, për te cilën referuar përqindjes se ndarjes se punimeve, konstatohet mungesa e përqindjes se punimeve për subjektin "G". Referuar DST, citohet se "Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të <u>pasakta</u>, konsiderohen kushte për skualifikim".*

*Nuk përmbush piken 2.3.1 te Aftësive Teknike dhe Profesionale, pasi subjekti G. pjese e BOE, referuar vlerës se përqindjes sipas preventivit, me dokumentacionin e paraqitur nuk përmbush asnjë nga 2 kushtet e lartpërmendura.*
*Nuk përmbush piken 2.3.5 te Aftësive Teknike dhe Profesionale, pasi referuar preventivit te ndarjes se zërave te punimeve:*
*- subjekti G., pjese e BOE, ka marre përsipër punime shtrimi pllakash, punime hidroizolimi, punime ndërtimi, punime murature, punime suvatimi, punime bojatisje, dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës pllakashtrues, hidroizolues, specialist ndërtimi, murator, suvatues, bojaxhi për kryerjen e këtyre punimeve;*
*- subjekti N. 1934, pjese e BOE, ka marre përsipër punime shtrimi pllakash, punime hidoizolimi, punime bojatisje, dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës pllakashtrues, hidroizolues, bojaxhi për kryerjen e këtyre punimeve;*
*- subjekti B-93, pjese e BOE, ka marre përsipër punime shtrimi pllakash, punime hidroizolimi, dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës pllakashtrues dhe hidroizolues për kryerjen e këtyre punimeve.*
*Ky arsyetim bazohet edhe ne vendimin e KPP Nr. 1129/2022, me nr. 2345/4 prot., date 22.11.2022.*
*Nuk përmbush piken 2.4.1 te Kërkesave te tjera te veçanta për kualifikim, pasi subjekti G. nuk ka paraqitur certifikate ISO 50001:2011 - "Standard për Sistemin e Menaxhimit te Energjisë", e vlefshme, ose ekuivalente.*
*Nuk përmbush piken 2.4.1 te Kërkesave te tjera te veçanta për kualifikim, pasi referuar preventivit te ndarjes se zërave te punimeve, subjektet G. dhe B-93 kane marre përsipër transportin e materialeve te ndërtimit, dhe nuk kane paraqitur licencën III.2.B për përmbushjen e këtij kriteri.*
*Nuk përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim, pasi dokumentacioni i paraqitur ne përmbushje te këtij kriteri për pajisjet hidrosanitare, pajisjet ngrohje-ventilim, pajisjet e ashensorit (përveç autorizimit te distributorit dhe prodhuesit), është ne gjuhe te huaj, pa përkthimin e noterizuar ne shqip.*

## 6. B/OE "H" me NIPT "K45" + "BE – IS" me NIPT "K47", për arsyet e mëposhtme:

*Për ofertuesin HTM me NIPT "K45" (48,08%) + BE – IS me NIPT "K47" (51,92%), me vlerë të ofertës 189'537'643.31 lekë, dhe ofertë ekonomike të korrigjuar 189'591'693.31 lekë, me subjekte mbeshtetes "A" me NIPT 81511508A, Geci me NIPT "K57", C. me NIPT "J58", Komisioni i Vlerësimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vlerësimit te dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe ne respektim te vendimit nr. 1491/2024, me nr. 2795/8 prot., date 23.10.2024 te Komisionit te Prokurimit Publik konstatoi se, OE HTM + BE – IS:*
*<u>Në respektim te vendimit nr. 1491/2024, me nr. 2795/8 prot., date 23.10.2024 te Komisionit te Prokurimit Publik</u>, ku ne konkluzionet ne piken III.1 te trajtimit te ankesës. Komisioni i Vlerësimit te Ofertave rishikoi arsyen e skualifikimit për pasqyrimin e sakte ne SPE, te riformuluar si me poshtë:*
*Në formularin e ofertës ekonomike sipas Shtojcës 1 është ofertuar vlera 189'537'643.31 lekë, ndërsa referuar preventivit te korrigjuar nga Komisioni i Vlerësimit te Ofertave, vlera e sakte e preventivit është 189'591'693.31 lekë, me një diferencë prej 54'050 lekë.*
*Kjo diference vjen pas ofertimit te sasisë për disa zëra te preventivit, ne kundërshtim me kërkesat e sasive te kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, si p.sh.:*
*Për zërin "veshje korrnize llamarine", është ofertuar sasia 133.36 m2, ndërkohë referuar preventivit te publikuar ne SPE, sasia e kërkuar është 113.36 m2;*
*Për zërin "Konstruksione metalike te përbëra" (punime armature çeliku), është ofertuar sasia 5.31 ton, ndërkohë referuar preventivit te publikuar ne SPE, sasia e kërkuar është 5.61 ton.*
*Persa me lart, oferta e paraqitur nga OE HTM (perfaqesues i BOE HTM &"B"), nuk i përgjigjet kërkesave te Dokumenteve te Tenderit, dhe si e tille refuzohet, duke mos qenë në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si edhe ne kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3.*
*Ky arsyetim bazohet edhe ne vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr. 550/2020.*
*Nuk përmbush piken 2.1.c te Kritereve te Veçanta te Kualifikimit, pasi ofertuesi është mbështetur ne kapacitete te subjekteve mbështetës, dhe nuk ka vetedeklaruar ne Shtojcën 8 - Formulari Përmbledhës i Vetedeklarimit ne seksionin "B: DEKLARATË: Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet OE (nëse është e zbatueshme)", subjektet mbështetëse ne te cilët do mbështetet, duke e lenë te pa plotësuar seksionin "Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet OE".*

## 7. B/OE "C" me NIPT "J37" + "B" me NIPT "K59", për arsyet e mëposhtme:

*-Për ofertuesin C. me NIPT "J37" (45%) + B. N. Me NIPT "K59" (55%), me vlerë të ofertës 190'799'772 lekë, dhe ofertë ekonomike të korrigjuar 196'244'277.23 lek, Komisioni i Vlerësimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vlerësimit te dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, OE C. + B. N.:*
*Në formularin e ofertës ekonomike sipas Shtojcës 1 është deklaruar vlera 190'799'772 lekë, ndërsa referuar preventivit te korrigjuar vlera e përllogaritur është 196'244'277.23 lekë, me një diferencë prej 5'444'505.23 lekë.*

*Bazuar në nenin 82, të VKM nr. 285, date 19.02.2021, Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, "ofertat me gabime refuzohen kur: - Shuma absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar".*
*Për sa më sipër KVO konstaton se ofertuesi ka dorëzuar ofertë ekonomike ku vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës.*
*Nuk përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim, pasi dokumentacioni i paraqitur ne përmbushje te këtij kriteri si me poshtë:*
*- pajisjet hidrosanitare, paraqitur vetëm autorizimi i distributorit dhe prodhuesit ne gjuhen shqipe;*
*- pajisjet elektrike, katallogu i paraqitur është ne gjuhe te huaj;*
*- pajisjet e ashensorit, katallogu i paraqitur është i distributorit, nuk i përket prodhuesit.*
*Ne piken 4.7 te Dokumenteve Standarde te Tenderit deklarohet se "4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X". Ne te njëjtën kohe, ne Shtojcën 7 te DST Formulari i kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit; 1. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit, citohet se "...Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip...".*

**8. B/OE "N" me NIPT "J60"** + "N" **me NIPT "J61",** për arsyet e mëposhtme*:*

*Për ofertuesin N. me NIPT "J60" (69,26%) + N. 2000 me NIPT "J61" (30,74%), me vlerë të ofertës 198'259'677.54 lek, Komisioni i Vlerësimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vlerësimit te dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, OE N. + N. 2000:*
*Nuk përmbush piken 2.2.1 te Kapacitetit Ekonomik dhe FI.nciar, pasi subjekti N. 2000, pjese e BOE, duke iu referuar përqindjes se pjesëmarrjes ne bashkim, nuk plotëson ne asnjë nga vitet vlerën minimale te kërkuar prej 74'083'400 leke (241'000'000 * 30,74%), duke mos përmbushur këtë kriter.*
*Nuk është paraqitur ndarja e punimeve sipas zërave te preventivit qe secili nga anëtarët e BOE kane marre përsipër te realizojnë, por vetëm pasqyra përmbledhëse e preventivit, duke e bere te pamundur verifikimin e aftësive teknike dhe profesionale te vetedeklaruara.*
*Nuk përmbush piken 2.3.5 te Aftësive Teknike dhe Profesionale, pasi referuar pasqyrës përmbledhës te preventivit te paraqitur, subjekti N. 2000, pjese e BOE:*
*- ka marre përsipër 100% te punimeve kondicionim-ventilim dhe ngrohje-ventilim, dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës mekanik nga 2 te kërkuar;*
*- ka marre përsipër 60% te punimeve elektrike, dhe ka vetedeklaruar vetëm 1 elektricist;*
*- ka marre përsipër 60% te punimeve hidrosanitare, dhe ka vetedeklaruar vetëm 1 hidraulik.*
*Persa me lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.5 te Aftësive Teknike dhe Profesionale.*
*Ky arsyetim bazohet edhe ne vendimin e KPP Nr. 1129/2022, me nr. 2345/4 prot., date 22.11.2022.*
*Nuk përmbush piken 2.4.1 te Kërkesave te tjera te veçanta për kualifikim, pasi subjekti N. 2000, nuk ka paraqitur certifikatat ISO 45001:2018 - "Sistemi i manaxhimit te sigurisë dhe shëndetit ne vendet e punës", e vlefshme, ose ekuivalente, dhe ISO 50001:2011 - "Standard për Sistemin e Menaxhimit te Energjisë", e vlefshme, ose ekuivalente.*
*Nuk përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim, pasi i gjithë dokumentacioni i paraqitur ne përmbushje te këtij kriteri për pajisjet hidrosanitare, pajisjet ngrohje-ventilim, pajisjet e ashensorit (përveç autorizimit te distributorit), është ne gjuhe te huaj, pa përkthimin e noterizuar ne shqip.*
*Ne piken 4.7 te Dokumenteve Standarde te Tenderit deklarohet se "4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X". Ne te njëjtën kohe, ne Shtojcën 7 te DST Formulari i kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit; 1. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit, citohet se "...Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip...".*

**9. B/OE "O" me NIPT "K62"** + "E" **me NIPT "K30",** për arsyet e mëposhtme*:*

*Për ofertuesin O.B.K. me NIPT "K62" (32,28%) + ED K. me NIPT "K30" (67,72%), me vlerë të ofertës 199'115'352.85 lek, me subjekte mbështetës Glavenica me NIPT "K63", A. me NIPT "L64", P. me NIPT "K65", E. me NIPT "J66", Komisioni i Vlerësimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vlerësimit te dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, OE O.B.K. + Ed K.:*
*Nuk përmbush piken 2.3.2 te Aftësive Teknike dhe Profesionale, pasi subjekti O.B.K., pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre përsipër punime për te cilat kërkohet kategoria NS-9A, dhe nuk e zotëron këtë kategori ne licencën e paraqitur.*
*Nuk përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim, pasi për pajisjet hidrosanitare, pajisjet ngrohje-ventilim, pajisjet e ashensorit nuk është paraqitur asnjë dokument i kërkuar.*

**10. OE "L" me NIPT "K67",** për arsyet e mëposhtme*:*

*Nuk përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim, pasi i gjithë dokumentacioni i paraqitur ne përmbushje te këtij kriteri për pajisjet hidrosanitare, pajisjet elektrike, pajisjet ngrohje-ventilim, pajisjet e ashensorit (përveç autorizimit te distributorit), është ne gjuhe te huaj, pa përkthimin e noterizuar ne shqip.*

*Ne piken 4.7 te Dokumenteve Standarde te Tenderit deklarohet se "4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X". Ne te njëjtën kohe, ne Shtojcën 7 te DST Formulari i kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit; 1. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit, citohet se "...Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip...".*

**11. OE "S" me NIPT "J68",** për arsyet e mëposhtme*:*

*Nuk përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim, pasi dokumentacioni i paraqitur ne përmbushje te këtij kriteri si me poshtë:*
*- pajisjet hidrosanitare, paraqitur vetëm autorizimi i distributorit ne gjuhen shqipe;*
*- pajisjet elektrike, paraqitur vetëm autorizimi i distributorit ne gjuhen shqipe;*
*- pajisjet ngrohje-ventilim, paraqitur vetëm autorizimi i distributorit ne gjuhen shqipe, si dhe skedat teknike te paraqitura ne gjuhen shqipe nuk i përkasin prodhuesit;*
*- pajisjet e ashensorit, paraqitur vetëm autorizimi i distributorit dhe prodhuesit ne gjuhen shqipe, si dhe skedat teknike te paraqitura ne gjuhen shqipe nuk i përkasin prodhuesit;*
*janë ne gjuhe te huaj, pa përkthimin e noterizuar ne shqip.*
*Ne piken 4.7 te Dokumenteve Standarde te Tenderit deklarohet se "4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X". Ne te njëjtën kohe, ne Shtojcën 7 te DST Formulari i kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit; 1. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit, citohet se "...Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip...".*

**12. B/OE "B" me NIPT "K69"** + "K" **me NIPT "L70",** për arsyet e mëposhtme*:*

*Nuk përmbush piken 2.3.5 te Aftësive Teknike dhe Profesionale, pasi referuar ndarjes se punimeve, subjekti B.-X ka marre përsipër 100% te punimeve hidrosanitare, dhe ka vetedeklaruar 2 (dy) punonjës hidraulik nga 4 (katër) te kërkuar. Ne te njëjtën mënyrë, subjekti K.M.K ka marre përsipër 100% te punimeve elektrike, dhe ka vetedeklaruar 2 (dy) punonjës elektricist nga 4 (katër) te kërkuar.*
*Ky arsyetim bazohet edhe ne vendimin e KPP Nr. 1129/2022, me nr. 2345/4 prot., date 22.11.2022.*
*Nga ana tjetër, për punonjësit e vetedeklaruar nga subjekti mbështetës B. nuk është paraqitur informacioni ne forme tabele me te dhënat e kërkuara ne DT.*
*Nuk përmbush piken 2.3.7 te Aftësive Teknike dhe Profesionale, pasi ofertuesi ka paraqitur 1 (një) tranxhe për përpunimin e hekurit të ndërtimit (nga 2 te kërkuar), duke mos e përmbushur këtë kriter.*
*Nuk përmbush piken 2.4.2 te Kritereve te tjera te veçanta për kualifikim, pasi ne përmbushje te këtij kriteri, BOE ka paraqitur licencën III.2.B te subjektit K.M.K, për te cilën mungon akti i miratimit.*
*Nuk përmbush piken 2.4.3 te Kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim, pasi i gjithë dokumentacioni i paraqitur ne përmbushje te këtij kriteri për pajisjet hidrosanitare, pajisjet elektrike, pajisjet ngrohje-ventilim (përveç autorizimit te distributorit), është ne gjuhe te huaj, pa përkthimin e noterizuar ne shqip.*
*Ne piken 4.7 te Dokumenteve Standarde te Tenderit deklarohet se "4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X". Ne te njëjtën kohe, ne Shtojcën 7 te DST Formulari i kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit; 1. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit, citohet se "...Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip...".*
*Ne te njëjtën kohe, persa i përket pajisjeve te ashensorit, është paraqitur vetëm autorizimi i distributorit, dhe asnjë dokumentacion tjetër ne përmbushje te këtij kriteri.*

**13. OE "D" me NIPT "K71",** për arsyet e mëposhtme*:*

*Operatori D.-AL, i cili është kualifikuar në fazën e parë, pasi paraqiti dokumentacionin me shkresën përcjellëse nr. 247 prot., date 02.09.2024, me objekt "Dorëzim dokumentacioni për procedure me objekt "Ndërtim shkolla 9 vjeçare Met Hasa", marre ne dorëzim në Bashkinë Durrës me nr. regjistri 7298, date 02.09.2024, dokumentacion i cili, sipas procesverbalit te inventarizimit te datës 09.09.2024, ka parregullsi, si edhe devijime dhe mospërputhje në vetëdeklarimet e tij (shtojca nr. 8), me konkretisht:*
*1. Nuk përmbush piken 2.3.5 te Aftësive Teknike dhe Profesionale, pasi për asnjë nga punonjësit e stafit teknik nuk është paraqitur certifikate e sigurimit teknik.*
*Ne te njëjtën kohe, për punonjësit shofer (Z.K dhe Z.Ç), nuk është paraqitur leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR (është paraqitur vetëm kontrata e punës, për te cilën konstatohet se ne kontratën e paraqitur për punonjësin shofer Z.Ç, pozicioni i punës rezulton te jete mekanik dhe jo shofer).*
*Gjithashtu, për punonjësit I.LL dhe A.H, te vetedeklaruar ne formularin përmbledhës te vetedeklarimit si punëtorë ndërtimi te thjeshte, nuk është paraqitur kontrata e punës, sipas kërkesës se DT.*
*Nuk përmbush piken 2.3.7 te Aftësive Teknike dhe Profesionale, pasi referuar dokumentacionit te paraqitur ne dosjen fizike, KVO konstatoi se nuk është paraqitur asnjë dokumentacion për mjetin ekskavator 0.25 m3 me gome, me targe AMMT53, i vetedeklaruar ne formularin përmbledhës te vetedeklarimit ne përmbushje te këtij kriteri.*

*Nga auditimi i dokumentacionit në SPE, mbi arsyet e skualifikimit të OE pjesëmarrës, rezultoi se KVO-ja ka vepruar në përputhje me dispozitat e LPP, pasi OE pjesëmarrës të skualifikuar nuk plotësonin kërkesat e DST.*

Me procesverbalin e rivlerësimit të datës 09.09.2024 është kualifikuar i pari B/OE "A" & "S" sh.p.k me ofertë të korrigjuar 193,847,553.25 lekë.
Me procesverbalin e datës 19.09.2024, KVO-ja ka administruar dokumentacionin e dorëzuar me 16 dokumente dhe 3195 fletë. Sipas këtij procesverbali, KVO-ja konstaton se dokumentet provuese të paraqitura nga B/OE "A" & "S" sh.p.k, janë të rregullta, duke e shpallur fitues.

**ANKESA**
Me Urdhrin nr. 376, datë 04.10.204, të titullarit të AK *z. E.J.* është urdhëruar pezullimin e procedurës, për shqyrtimin e ankesës së B/OE "H" & "B" sh.p.k, si dhe është ngritur nga KSHA me përbërje *R.D., J.K. dhe K.B.*
Me shkresën nr. 5812/11 prot., datë 07.10.2024, KSHA nuk e ka pranuar ankesën e këtij ofertuesi, duke i kërkuar Nj.P dhe KVO-së vijimin e procedurave të mëtejshme.
Gjithashtu, është marrë edhe vendimi i KPP-së, me nr. 1491/2024, datë 23.10.2024, sipas të cilit është pranuar pjesërisht ankesa e B/OE "H" & "B" sh.p.k dhe është kërkuar që AK të rishikojë arsyet e skualifikimit të këtij ofertuesi.
Nga KVO-ja është mbajtur procesverbali i rivlerësimit me datë 29.10.2024, i cili i është dërguar KPP-së me shkresën nr. 5812/15 *prot*., datë 30.10.2024. Sipas këtij procesverbali, ofertuesi ankues është skualifikuar sepse në dy zëra pune ka ndryshuar sasinë e përcaktuar në preventivin e shpallur në SPE dhe pasi ka lënë të paplotësuar në Formularin e Vetëdeklarimit seksionin "*Informacion mbi subjektet mbi kapacitetet e të cilit do të mbështetet OE*".
Me vendimin nr. 1553/2024, datë 04.11.2024, KPP-ja ka vendosur që të lejojë AK për vijimin e hapave të mëtejshëm të kësaj procedure prokurimi.
Nga KVO-ja është hartuar *Raporti Përmbledhës* me shkresën me nr. 5812/17 *prot*, datë 08.11.2024, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor E.J. dhe me shkresën nr. 5812/18, datë 08.11.2024 është hartuar *Formulari i Njoftimit të Fituesit*.

**Në lidhje me *B/OE "A" & "S" sh.p.k***, të shpallur fitues me vlerë të ofertës 193,847,553.25 lekë, rezultoi se sipas grupit të auditimit, ky B/OE duhej të ishte skualifikuar, pasi nuk plotëson disa nga kriteret e DST. E konkretisht:
- Nuk kuptohet nëse katalogu i paraqitur në SPE për ashensorët (prodhuesi AHMET) është i dhënë nga prodhuesi në shqip apo është i përkthyer, pasi janë të dyja gjuhët të alternuara në mënyrë të pakuptimtë. Mungon nënshkrimi i një noteri apo përkthyesi të certifikuar, nga gjuha turqisht në shqip.
Katër nga Certifikatat ISO, të paraqitura në sistem për prodhuesit e materialeve elektrike, **janë të skaduara**.
- Katalogu i prodhuesit të sistemeve të ngrohjes "Emtas", si furnizues i distributorit A.D PF, nuk është në gjuhën shqipe, mangësi për të cilën janë skualifikuar dhe OE të tjerë në të njëjtën procedurë.
**Për sa më sipër**, në lidhje me vlerësimin e dokumentacionit ligjorë për fazën e parë të kryer nga KVO-ja, rezultoi të jenë mbajtur qëndrime të ndryshme në vlerësim, pasi dhe B/OE i kualifikuar është në mosplotësim të kërkesave të DT, mangësi për të cilat janë skualifikuar OE të tjerë, veprime të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve pa efektivitet, pasi mungesa e konkurrencës për fazën e dytë ka çuar në lidhje kontrate 80% të fondit të prokuruar, duke **ngarkuar me përgjegjësi:** *G.K., Kryetar, L.S. dhe M.J.*, në cilësinë e anëtarit të KVO, në cilësinë e anëtarit të KVO, në kundërshtim me nenet 2, 3 pika 1, dhe neni 92 pika 3 dhe 4 të Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar Bashkia Durrës janë paraqitur observacioni me shkresë nr. 668/88 prot, datë 17.06.2026 (*administruar në KLSH nr. 1347/71 Prot, dt. 18.06.2026)* "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga G.K., L.S. , M.J, në cilësinë e anëtait të KVO, , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:** *- Ju citoni se nuk kuptohet nëse katalogu i paraqitur ne SPE për ashensorët (prodhuesi A.) është i dhënë nga prodhuesi ne shqip apo është i përkthyer, pasi janë te dyja gjuhet te alternuara ne mënyrë te pakuptimte. Mungon nënshkrimi i një noteri apo përkthyesi te certifikuar, nga gjuha turqisht ne shqip.*

*Në lidhje me këtë konstatim, KVO sqaron se referuar pikës së mësipërme, duke qenë se dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, KVO ka marre informacionin e nevojshëm, dhe është konsideruar i plotësuar kriteri i kërkuar ne DST duke iu referuar dhe pikave 2 dhe 3 të nenit 92 të LPP.*

*- Ju citoni se katër nga certifikatat ISO, te paraqitura ne sistem për prodhuesit e materialeve elektrike, janë te skaduara.*

*Në lidhje me këtë konstatim, KVO sqaron se ne DT, ne piken 2.4.3 te Kërkesave te Tjera te Veçanta për Kualifikim, citohet se "Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë: Pajisje hidrosanitare; Pajisje elektrike; Pajisje ngrohje-ventilim; Pajisje ashensori. OE ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore te kërkuara. Për materialet e kërkuara OE duhet te paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimet CE, certifikatat e cilësisë ose raportet e testimit nga laboratorë të akreditуar, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara ne Specifikimet teknike".*

*Ne asnjë rast nuk është shprehur qe te paraqiten certifikatat ISO te prodhuesit te vlefshme, dhe për këtë arsye KVO mendon se ky konstatim nuk është i drejte.*

*- Ju citoni se katalogu i prodhuesit te sistemeve te ngrohjes "E.", si furnizues i distributorit A.D PF, nuk është ne gjuhen shqipe, mangësi për te cilën janë skualifikuar dhe OE te tjerë ne te njëjtën procedure.*

*Në lidhje me këtë konstatim, KVO sqaron se referuar pikës së mësipërme BOE përveç sistemit te ngrohjes nga E. ka paraqitur dhe sistemet ngrohje – ftohje nga prodhuesi Argo, dokumentacion i cili, e përmbush i vetëm kriterin për sistemet e ngrohjes. Gjithashtu katalogu i paraqitur nga E., një pjesë është paraqitur ne gjuhën shqipe duke bërë që KVO ti referohet pikës 4 të këtij nenit 92, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit**: Për sa keni observuar, sqarojmë se pretendimet nuk qëndrojnë, pasi nga ana juaj nuk është paraqitur asnjë element shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilat grupi i auditimit është shprehur në me qëndrimin e tij në projektraportin e paraqitur. Në lidhje me mangësitë e tjera pretendimet nuk qëndrojnë, pasi nuk janë të mirëargumentuara. Kështu, në lidhje me certifikatat ISO, nga grupi është konstatuar se janë të skaduara dhe në DST janë kërkuar certifikatat, dhe jo ashtu siç ju shpreheni në observacion. Ndërsa në lidhje me mos përkthimin e dokumentacionit, është kriter skualifikuar ku në procedura të ndryshme nga ana e KVO-ve të AK bashkia Durrës është përdorur si kritere skualifikues, si në procedurën me objekt *"Ndërtim i shkollës 9-vjecare Vadardh Sukth".*

**25- Auditim i procedurës me objekt** *"Gj. në qytet",* Bashkia Durrës.

| **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "Gj. në qytet", Bashkia Durrës, Nr. REF-96978, datë 02-29-2024. | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave |

| | | |
|---|---|---|
| Nr. 1685/3 *prot*., datë 28.02.2024<br><br>2. Lloji i Procedurës –<br>"E hapur, mallra" | **Urdhër** nr. 1685, datë 01.02.2024<br>*1. L.S. Kryetar,*<br>*2. S.D.*<br>*3. M.V*<br>**1. Urdhër Prokurimi** Nr. 1685/3 *prot*., datë 28.02.2024<br>Nj.P<br>*A.Xh., Jurist, Personi përgjegjës*<br>*K.Dh.,*<br>*E.Gj., Inxhiniere* | **Urdhër** nr. 58, datë 28.02.20224,<br>1. *G.K., Kryetar*<br>*2. E.K*<br>*3. S.M* |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>16,138,970 lekë, | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "A" sh.p.k<br>me ofertë 15,834,000 lekë pa TVSH,<br>sipas kontratës nr. 1685/17 prot, dt. 20.05.2023 me afat të kontratës 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës. | **7. Diferenca me fondin limit**<br>304,970 lekë, ose 1.9 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 24.04.2024 | **9. Burimi FI.ncimit**<br>Buxheti i Bashkisë, sipas VKB-së nr. 195, datë 22.12.2023 | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 1 BOE,<br>c) Kualifikuar 1 OE/BOE |
| **11. Ankimime**; nuk ka ankesë. | **12. Përgjigje Ankesës** nuk ka | **13. Përgjigje Ankesës**<br>nuk ka |

**<u>Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve</u>:** Në datën 07.03.2024 OE i interesuar "A" sh.p.k, ka kërkuar, nëpërmjet sistemit, sqarime dhe ndryshime në lidhje me kërkesat për kualifikim. AK, referuar urdhrit të titullarit të AK z. E.J. (*me delegimin me shkresën nr. 2965 prot., dt. 04.03.2024*), rezulton t'i ketë kthyer përgjigje për paqartësitë dhe ndryshimet me shkresën nr. 579/8 *prot*, datë 25.03.2024.

Nëpërmjet shkresës nr. 979/1 *prot*, datë 07.03.2024 të OE "A" sh.p.k, është kërkuar sqarim mbi certifikatat profesionale të punëtorëve të Gj.t dhe AK i ka kthyer përgjigje nëpërmjet emailit të datës 09.03.2024. Gjithashtu, nga OE "F" sh.p.k është kërkuar nëpërmjet shkresës *pa nr. prot*, datë 12.03.2024, sqarim mbi kapacitetet e tre mjeteve të kërkuara, ku me shkresën e datës 12.03.2024, AK i ka kthyer përgjigje nëpërmjet emailit.

Nj.P, pas vendimit të KPP-së 292/2024, datë 25.03.2024, ka hartuar shtojcën për ndryshimet e disa nga kriteret e vendosura në Procesverbalin e grupit të punës, pa nr. *prot*, datë 29.03.2024.

Nga auditimi i dokumenteve të dosjes fizike, procesverbalit nr. xxx *prot*, datë 22.2.2024 "*Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se kriteret janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të pikës 6 të nenit 39 dhe nenin 78, pika 2, të VKM nr**.** 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.** Në dosje administrohet procesverbali për hapjen e ofertave (dt. 24.04.2024) dhe procesverbali për vlerësimin e ofertave (dt. 26.04.2024). Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 2 OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës | Kualifikuar/skualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | OE "L" | 11,297,500 | ***<u>Skualifikuar:</u>***<br>*- Nuk përmbush piken 2.3.a te Kapacitetit Teknik, pasi, përveç kontratave te lidhura me Fondin Shqiptar te Zhvillimit, nuk ka paraqitur asnjë vërtetim të lëshuar për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara, duke mos e përmbushur këtë kriter.*<br>*- Nuk përmbush piken 2.3.f te Kapacitetit Teknik, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ne përmbushje te këtij kriteri.*<br>*- Nuk përmbush piken 2.3.e) te Kapacitetit Teknik, ku citohet se "OE duhet paraqesë Certifikatën e Regjistrimit për torfen dhe plehun te lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural", pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ne përmbushje te këtij kriteri.* |

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës | Kualifikuar/skualifikuar |
|---|---|---|---|
| 2 | **OE "A" sh.p.k** | **15,834,000** | **Kualifikuar/fitues** |

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës, të dhënave të sistemit SPE dhe kundërshtive tyë subjektit paraqitur me shkresën nr. 668/17 prot, datë 6.2.2026, në lidhje me skualifikimin/ dhe kuaklifikimin e OE, rezultoi se KVO-ja ka vepruar në përputhje me dispozitat e LPP, pasi si OE skualifikuar dhe ai i shpallur fitues janë vlerësuar drejt në zbatim të kërksave kualifikuse të DT.

**26. Proçedura e prokurimit me objekt:** *"Blerje karburanti për, Bashkinë Durrës dhe Institucionet në varësi të saj":*

| **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"Blerje karburanti për, Bashkinë Durrës dhe Institucionet në varësi të saj":* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** Nr.45/5 prot., datë 12.01.2023<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "E Hapur ",e tipit Marrëveshje Kuadër | **3. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 45/5, datë 12.01.2023<br>1. K.K –(Jurist)<br>2. I.Q - (Specialist Dispeçer)<br>3. L.X –(Specialist) | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër Nr. 45/6 prot, datë 13.01.2023<br>1. S.D. (Kryetar)<br>2. F.A (Anëtar)<br>3. I.K (Anëtar) |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)** 199,856,000 lekë | **6. Oferta fituese**: OE "K" sh.p.k me marzh fitimi 20 lekë/litër marrëveshje kuadër me datë kontrate 06.02.2023 me afat 12 mujor. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** - |
| **8. Data e hapjes së tenderit**: Data e zhvillimit: 13.01.2023 | **9.Burimi FI.ncimit**: Të ardhurat e Bashkisë Durrës. | **10. Operatorët Ekonomike:** a) Pjesëmarrës në tender: 1 OE<br>- OE "K" sh.p.k |
| **11.Ankimime në AK** Nuk ka | **12. Përgjigje ankesës nga AK** Nuk ka | **13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP** Nuk ka |

**<u>Hartimi i fondit limit.</u>** Me shkresën Nr.173 prot, datë 09.01.2023 të Titullarit të Institucionit është përcaktuar Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës si organi qëndror blerës për blerjen e karburantit.

Me shkresën Nr.341/1 prot, datë 10.01.2023, Drejtoria MZSH Durrës ka sjell kërkesën për karburant referuar VKB për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023.

- *Naftë 16,000 litra x 200 lekë/litër 3,200,000 lekë me TVSH.*
- *Benzinë 500 litra x 200 lekë/litër 100,000 lekë me TVSH.*

Me shkresën Nr.7 prot, datë 10.01.2023, Klubi i Futbollit Teuta ka sjell kërkesën për karburant referuar VKB për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023.

- *Naftë 3,000 litra me vlerë 540,000 lekë me TVSH.*
- *Benzinë 700 litra me vlerë 102,000 lekë me TVSH.*

Me shkresën Nr.3 prot, datë 10.01.2023, Klubi Shumë Sportësh "Teuta" ka sjell kërkesën për karburant referuar VKB për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023.

- *Naftë me vlerë të parashikuar 1,000,000 lekë me TVSH.*

Me shkresën Nr.12/1 prot, datë 12.01.2023, Ndërmarrja Rruga Durrës ka sjell kërkesën për karburant referuar VKB për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023.

- *Naftë me sasi të pritshme 145,455 litra dhe vlerë të parashikuar 32,000,000 lekë me TVSH.*

Me shkresën Nr.10 prot, datë 10.01.2023, Qendra Kulturore ka sjell kërkesën për karburant referuar VKB për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023.

- *Naftë vlerë të parashikuar 50,000 lekë me TVSH.*

Me shkresën Nr.9 prot, datë 09.01.2023, Qendra Ditore e të Moshuarëve ka sjell kërkesën për karburant referuar VKB për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023.

*- Naftë me sasi të pritshme 1,050 litra dhe vlerë të parashikuar 159,092 lekë me TVSH për vitin 2023.*

*- Naftë me sasi të pritshme 600 litra dhe vlerë të parashikuar 90,908 lekë me TVSH për vitin 2024.*

Me shkresën Nr.18 prot, datë 10.01.2023, Ndërmarrja Komunale Plazh ka sjell kërkesën për karburant referuar VKB për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023.

- Naftë me vlerë të parashikuar 52,370,000 lekë me TVSH.
- Benzinë me vlerë të parashikuar 300,000 lekë me TVSH.

Me shkresën Nr.6 prot, datë 10.01.2023, Qendra Ekonomike e Arsimit Durrës ka sjell kërkesën për karburant referuar VKB për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023.

- *Naftë me vlerë të parashikuar 10,791,000 lekë me TVSH.*

Me shkresën Nr.173/2 prot, datë 13.01.2023, Bashkia Durrës, Drejtoria e Shërbimeve Publike ka sjell kërkesën për karburant referuar VKB për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023.

*- Naftë me sasi të pritshme 12,240 litra për automjetet e aparatit të Bashkisë Durrës, (6,000 litra për automjetin e administratës,240 litra për motogjeneratorin,6,000 litra për kaldajën e ngrohjes) dhe me vlerë të parashikuar 2,900,000 lekë.*

*- Naftë me sasi të pritshme 7,200 litra për automjetet e IMTV-së dhe me vlerë të parashikuar 1,700,000 lekë.*

*- Naftë me sasi të pritshme 17,400 litra dhe benzinë me sasi të parashikuar 3,600 litra për automjetet e Policisë Bashkiake dhe me vlerë të parashikuar 4,000,000lekë.*

Me shkresën nr.45/1 prot, datë 12.01.2023 me urdhrin nr.19, datë 12.01.2023 nga Titullari i Organit Blerës z. L.H është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondin limit të marrëveshjes kuadër si mëposhtë.

1. z. E.K përfaqësues i Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës.
2. znj. B.G. përfaqësuese e Ndërmarrjes Komunale Plazh.
3. z. A.I. përfaqësues i Bashkisë Durrës.
4. z. O.P përfaqësues i Klubit Shumë Sporteve Teuta.
5. z. M.B përfaqësues i Ndërmarrjes Rruga.
6. z. S.C përfaqësues i Qendrës Kulturore.
7. znj. M.H përfaqësuese e Qendrës Ditore e të Moshuarëve.
8. z. G.X përfaqësues i Klubit Futbolli Teuta.
9. z. D.K përfaqësues i Sektorit MZSH.
10. z. A.K. përfaqësues i Qendrës Ekonomike të Arsimit.

Me shkresën nr. 45/2, datë 12.01.2023 është firmosur marrëveshja mes autoriteteve kontraktore për kryerjen e procedurave të përbashkëta të prokurimit për mallra, punë apo shërbime.

Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe llogaritjen e fondit limit ka mbajtur procesverbalin nr.1 prot, datë 12.01.2023 ku ka përcaktuar specifikimet teknike për karburantet dhe sasinë e karburanteve të cilat do të përdorën nga çdo institucion.

| Nr | Emërtimi i Institucionit | Vlera totale | Vlera për naftën me TVSH) | Vlera për benzinë (me TVSH) | Sasia e naftës | Sasia e benzinës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bashkia Durrës | 8,600,000 | 7,962,800 | 637,200 | 39,878 | 3,585 |
| 2 | MZSH | 3,300,000 | 3,200,000 | 100,000 | 16,025 | 562 |
| 3 | Klubi i futbollit Teuta | 642,200 | 540,000 | 102,200 | 2,704 | 575 |
| 4 | Klubi i Shumë Sporteve Teuta | 1,000,000 | 1,000,000 | - | 5,008 | - |
| 5 | Ndërmarrja Rruga | 32,000,000 | 32,000,000 | - | 160,258 | - |
| 6 | Qendra Kulturore | 50,000 | 50,000 | - | 250 | - |
| 7 | Qendra ditore e të moshuarëve | 300,000 | 300,000 | - | 1,502 | - |
| 8 | Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale | 120,000,000 | 118,800,000 | 1,200,000 | 594,960 | 6,751 |
| 9 | Ndërmarrja Komunale Plazh | 63,144,000 | 62,844,000 | 300,000 | 314,728 | 1,687 |
| 10 | Qendra Ekonomike e Arsimit | 10,791,000 | 10,791,000 | - | 54,042 | - |
| **Totali me TVSH** | | **239,827,200** | **237,487,800** | **2,339,400** | **1,189,355** | **13,160** |
| **Totali pa TVSH** | | **199,856,000** | **197,906,500** | **1,949,500** | | |

**Burimi:** Përpunoi Grupi i Auditimit

Për përllogaritjen e fondit limit komisioni i është referuar vendimit të Bordit të Karburanteve të datës 14.12.2022 referuar Aktit Normativ Nr.5 datë 12.03.2022 si dhe Akti Normativ Nr.8, datë 25.03.2022 *"Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre".*
Vendimi i bordit i datës 14.12.2022, çmimi i naftës me pakicë jo më shumë së 202 lekë dhe çmimi i nënproduktit benzinë jo më shumë se 178 lekë/litri.
Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe llogaritjen e fondit limit ka vepruar në kundërshtim me aktin normativ nr.8, datë 25.03.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 *"Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës gazit dhe nënprodukteve të tyrë"*, neni 21/5 metodologjia e llogaritjes së çmimit.
*Bordi cakton çdo javë ose, kur e vlerëson të nevojshëm, në diskrecion të tij, çmimin tavan për shitjen për gazoilin, benzinën dhe gazin e lëngshëm të naftës, sipas metodologjisë së mëposhtme: a) Çmimi i tregjeve ndërkombëtare të një dite pune më parë nga mbledhja e Bordit, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare "S&P Global Platts" në USD, në kushtet e lëvrimit FOB Med, për gazoilin e standardit SSH EN 590 2018 dhe benzinën e standardit SSH EN 228 2018. Për rastin e GLN-së (gaz i lëngshëm i naftës) çmimi përcaktohet sipas faturës së importimit të siguruar nga shoqëritë e tregtimit me shumicë;*
Referuar vendimeve të bordit të transparencën vendimi i fundit rezulton në datën 20.12.2022 i cili përcakton si çmim tavan për naftën 199 lekë dhe çmim tavan për benzinën 177 lekë.
-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nga komisioni i përllogaritjes së fondit limit sasia e cila do te përdoret për nevojat e Bashkisë Durrës dhe Njësitë e Varësisë nuk argumentohet. Veprime të cilat bien në kundërshtim me nenin 76, pika 2, në VKM nr.285 datë 19.05.2021, ku citohet se; "*Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet".*
*Veprim për të cilin mban përgjegjësi komisioni i përllogaritjes së fondit limit:*

1. z. E.K përfaqësues i Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës.
2. znj. B. G. përfaqësuese e Ndërmarrjes Komunale Plazh.
3. z. A.I. përfaqësues i Bashkisë Durrës.
4. z. O.P përfaqësues i Klubit Shumë Sporteve Teuta.
5. z. M.B përfaqësues i Ndërmarrjes Rruga.
6. z. S.C përfaqësues i Qendrës Kulturore.
7. znj. M.H përfaqësuese e Qendrës Ditore e të Moshuarëve.
8. z. G.X përfaqësues i Klubit Futbolli Teuta.
9. z. D.K përfaqësues i Sektorit MZSH.
10. z. A.K. përfaqësues i Qendrës Ekonomike të Arsimit.

**Hartimi i kritereve.** Me shkresën nr.45/1 prot, datë 12.01.2023 me urdhrin nr.19, datë 12.01.2023 nga Titullari i Organit Blerës z. L.H është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondin limit të marrëveshjes kuadër për procedurën *"Blerje Karburanti", me fond limit 199,856,000 lekë pa TVSH.*
Me urdhër prokurimi të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr.45/5 prot, datë 12.01.2023, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. K.K, z. I.Q dhe zj. L.X në procedurën *"Blerje Karburanti", me fondin limit 199,856,000 lekë pa TVSH.*
-Në datë 12.01.2024 është administruar procesverbali për hartimin e dokumenteve të tenderit.
Dokumentat e tenderit janë hartuar në kundërshtim me Vendimin Nr.710, datë 24.11.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.285, datë 19.05.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Neni 45 "Kriteret për shpalljen e ofertës fituese" shtohet pika 2.1 me përmbajtje.

2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:
a)Çmimin e bursës, lëvrur sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike
b)Elementët fiskalë
c)Normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

**Vlerësimi i Ofertave.** Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 45/6 datë 13.01.2023 është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Ofertave për procedurën e prokurimit me objekt "*Blerje karburanti"* i cili përbëhet nga z. S.D. (kryetar), z. F.A. dhe zj. I.K
Në datë 01.02.2023 nga KVO-ja është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit *"Blerje Karburanti", me fondin limit 199,856,000 lekë pa TVSH e ndarë në 2 lote si mëposhtë:*
*Loti I, Diesel 10 ppm ULSD me vlerë 197,906,500 lekë.*
*Loti II, Benzinë Premium Unl 10 ppm me vlerë 1,949,500 lek.*
Mëposhtë paraqiten ofertat e operatorëve për procedurën blerje karburanti.
1-OE "K" sh.p.k me marzh fitimi 20 lekë/litër (nafta).
2-OE "K" sh.p.k me marzh fitimi 20 lekë/litër (benzI.).

Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar procesverbalit të datës 01.02.2023, KVO-ja i nevojiten më shumë se 1 ditë për shqyrtim dhe deklaron se ofertuesit do të njoftohen brenda 5 ditëve.

Referuar procesverbalit të datës 02.02.2023 KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

| Nr | Operatori ekonomi | Oferta lekë pa TVSH | Kualifikuar/S'kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | OE "K" sh.p.k | Marzh fitimi 20/lekë/litër | Kualifikuar |

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me nr.45/10 prot, datë 02.02.2023 në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, 1 OE kanë ofertuar "K" sh.p.k dhe është kualifikuar dhe shpallur fituese me ofertë ekonomike me marzh fitimi 20 lekë/litër.
Me shkresën nr. 45/12 prot, datë 02.02.2023, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka shpallur fitues për procedurën *"Blerje Karburanti", me fondin limit 199,856,000 lekë pa TVSH, Loti I, Diesel 10ppm ULSD* operatorin ekonomik "K" sh.p.k me nipt "J72" me ofertë me marzh fitimi 20 lekë/litër.
Me shkresën nr. 45/13 prot, datë 02.02.2023, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka shpallur fitues për procedurën *"Blerje Karburanti", me fondin limit 199,856,000 lekë pa TVSH, Loti II, Benzinë Premium Unl 10 ppm* operatorin ekonomik "K" sh.p.k me nipt "J72" me ofertë me marzh fitimi 20 lekë/litër.

**Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se:**

| Nr | Operatori ekonomi | Oferta lekë pa TVSH | Dokumentacioni |
|---|---|---|---|
| 1 | OE: "K" sh.p.k | Marzh fitimi 20 lekë/litër | OE "K" sh.p.k kanë dorëzuar dokumentacionin sipas DST |

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80, Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika 1, neni 92 pika 3, "

**Lidhja e Kontratës:**
Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 02.02.2023 ka shpallur fituese ofertën e operatorit "K" sh.p.k për të cilën është lidhur marrëveshja kuadër nr. 45/15, datë 06.02.2023 me afat 12 mujor.
Në datën 06.02.2023 është lidhur kontrata e furnizimit me objekt "Blerje karburante për NSHK Durrës, Loti I, Diesel 10 ppm ULSD midis Ndërmarrjes Shërbimeve Komunale Durrës dhe Shoqëria "K" sh.p.k Durrës.
Me urdhër nr.50, datë 06.02.2023 është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim për mallrat e Lotit të I, naftë 10 ppm dhe Loti 2, benzinë Premium Unl 10 ppm më përbërje si mëposhtë.
1-I.Q
2-V.B
3-E.K
Me shkresën Nr.45/20, datë 06.02.2023 është publikuar formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar për Lotin 1(Blerje nafte) për Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale Durrës.
Me shkresën Nr.16, prot datë 09.02.2023 është publikuar formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar për Lotin 1(Blerje nafte) për Klubin e Shumësporteve Teuta.
Me shkresën Nr.26/1, prot datë 09.02.2023 është publikuar formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar për Lotin 1(Blerje nafte) për Qendrën Ekonomike të Arsimit.
Me shkresën Nr.31, prot datë 09.02.2023 është publikuar formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar për Lotin 1(Blerje nafte) për Qendrën Kulturore.
Me shkresën Nr.78, prot datë 10.02.2023 është publikuar formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar për Lotin 1(Blerje nafte) për Ndërmarrjen Komunale Plazh.
Me shkresën Nr.12/5, prot datë 10.02.2023 është publikuar formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar për Lotin 1(Blerje nafte) për Ndërmarrjen Rruga.
Me shkresën Nr.12/5, prot datë 10.02.2023 është publikuar formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar për Lotin 1(Blerje nafte) për Ndërmarrjen Rruga.
Me shkresën Nr.27, prot datë 09.02.2023 është publikuar formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar për Lotin 1(Blerje nafte) për Klubin e Futbollit Teuta.
Me shkresën Nr.45/22, datë 06.02.2023 është publikuar formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar për Lotin 2(Blerje benzinë) për Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale Durrës.

Për sa është trajtuar në akt konstatim nr. 4, nga Bashkia Durrës është paraqitur observacioni me shkresën nr. 668/31 prot., datë 03.02.2026, administruar në KLSH me praktikën nr.1347/28 prot., datë 04.02.2026, nga grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit për procedurën *"Blerje Karburanti për Bashkinë Durrës dhe Institucionet e Varësisë"*, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
**Pretendimi i subjektit:** *1. Në lidhje me pretendimin se Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të levrimit dhe përllogaritjen e fondit limit ka vepruar në kundërshtim me aktin normativ nr.8 datë 25.03.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 8450, datë 24.02.1999 , Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre neni 21/5 metodologjia e llogaritjes së çmimit, ju sqarojme si më poshtë:*
*Për përllogaritjen e vlerës limit të Marrëveshjes Kuadër për vitin 2023 deri në 30.03.2024, grupi i punes ka ndjekur proceduren si me poshte:*

*Mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",si dhe të udhëzimit nr.06 datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" sipas të cilëve :*
*"Në Përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet të ketë parasysh; çmimet e botuara nga INSTAT- i ose/dhe çmime të tjera zyrtare të njohura nga institucionet përkatëse si psh., Organet Tatimore apo Doganore, Dhoma e Tregtisë, në Manuale etj, ose /dhe çmimet e Tregut; ose/ dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga Autoritete të Tjera Kontraktore dhe /ose çmime ndërkombëtare të publikuara.*
*1. Në zbatim te VKM Nr. 285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", u përcaktuan specifikimet teknike sipas Institutit Shteteror Teknik dhe Industrial (ISHTI) dhe Drejtoria e Laboratorit Qëndror të Kontrollit ( DLQK).*
*2. Çmimi i referuar bursës së datës 05.01.2023, sipas PLATTS, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri i cili është marrë nga Buletini i Njoftimeve Publike i A.P.P. nr.2 datë 09.01.2023 sipas Drejtorisë Pergjithshme te Doganes u përcaktua densiteti mesatar dhe po për datë 09.01.2023 nga Banka e Shqipërisë u mor kursi i dollarit.*
*b) Mbi çmimin e bursës u shtua premio dhe elementët fiskal ( akcizat), taksë karboni, taksë qarkullimi dhe taksa e markimit të karburantit.*
*c) Marzhi i fitimit është shprehur në vlerë për gazoilin dhe për benzinën, i percaktuar nga Akti Normativ nr. 8 date 25.03.2022 si dhe nga Bordi i Transparences i mbledhur për herë të fundit me datë 14.12.2022.*
*Në përfundim të kërkimeve dhe printimeve rezultoi*
*a. Buletini prokurimit publik nr. 2 date 09.01.2023 (data e fundit e publikimit të çmimeve në bursë është data 05.01.2023)*
*b. Kursi i këmbimit të dollarit është i datës 09.01.2023 i Bankës të Shqipërisë.*
*c. Premio mbi çmimin e cila është konstante për naftën dhe benzinën.*
*d. Taksa e karbonit është kostante 3.0 lekë për naftën dhe 1.5 lekë për benzinën.*
*e. Taksa e qarkullimit është konstante.*
*f. Taksë Markimi karburanti është e njëjtë konstante.*
*g. Densiteti është marrë si mesatare e standartit të karburantit për naftën 10 ppm ULSD dhe për Benzinën premium Unl 10 ppm*
*Mënyra e përllogaritjes së çmimit të naftës sipas aktit normativ nr.8, datë 25.03.2022, neni 25/1.*
*a. Çmimin i referuar bursës në dollar/ konvertuar në lekë/litër (sipas kursit të këmbimit valutor 09.01.2023) 95.59 lekë*
*b. Premio 3.3 lekë*
*Densiteti 0.8349*
*c.( a+b) x densitet 82.56 lekë*
*Ç.Marzhi fitimit për shoqëritë e tregetimit me shumicë 3.00 lekë*
*d. Detyrimet doganore 68.83 lekë*
*-Akciza*
*-Taksë karboni*
*-Taksë Qarkullimi*
*-Taksë Markimi Karburanti*
*Dh.= C+ç+d 154.39 lekë*
*e. Marzhi fitimit për shoqëritë e tregtimit me pakicë 12.00 lekë*
*Çmimi total pa TVSH 166.39 lekë*
*TVSH 33.27 lekë*
*Çmimi total me TVSH* ***199.67 lekë***
*Vlera e përllogaritur e çmimit të naftës nga Komisioni i për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe përllogaritjen e fondit limit nuk është rnë e lartë se çmimi tavan i përcaktuar nga Bordi i Transparencës me datë 20.12.2022, sipas të cilit çmimi tavan për naftën është 199 lekë/litër. (<u>Sqarim:</u> Pavarësisht se në materialin e grupit për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe përllogaritjen e fondit limit është shënuar vendimi i Bordit të*

*Transparencës i datës data 14.12. 2022, vlera e përllogaritur nuk rezulton të jetë 202 lekë për litër*
*por 199-lekë/litër që përputhet me çmimin/litër sipas vendimit te Bordit të Transparencës së datës 20.12.2022).*
*Pavarësisht sa me lartë citohet, theksohet se ky çmim është përdorur në fazën e përllogaritjes ka karakter orientues dhe shërben vetëm për përcaktimin e sasisë së pritshme në litra të karburantit për çdo institucion.*
*Mënyra e përllogaritjes së çmimit të benzinës sipas aktit normativ nr.8, datë 25.03.2022, neni 25/1.*
*a. Çmimin i referuar bursës në dollar/ konvertuar në lekë/litër (sipas kursit të këmbimit valutor 09.01.2023) 85.14 lekë*
*b. Premio 3.3 lekë*
*Densiteti 0.7437*
*c.( a+b) x densitet 65.77 lekë*
*Ç.Marzhi fitimit për shoqëritë e tregetimit me shumicë 3.00 lekë*
*d. Detyrimet doganore 67.33 lekë*
*-Akciza*
*-Taksë karboni*
*-Taksë Qarkullimi*
*-Taksë Markimi Karburanti*
*Dh.= C+ç+d 136.10 lekë*
*e. Marzhi fitimit për shoqëritë e tregtimit me pakicë 12.00 lekë*
*Çmimi total pa TVSH 148.10 lekë*
*TVSH 29.62 lekë*
*Çmimi total me TVSH* ***177.72 lekë***
*Vlera e përllogaritur e çmimit të benzinës nga komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të levrimit dhe përllogaritjen e fondit limit nuk është më e lartë se çmimi tavan i përcaktuar nga Bordi i Transparencës me datë 20.12.2022, sipas të cilit çmimi tavan për benzinën është 17 lekë/litër. (<u>Sqarim:</u> Pavarsisht se në materialin e grupit për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të levrimit dhe përllogaritjen e fondit limit është shënuar vendimi i Bordit të Transparencës i dates data 14.12.2022, vlera e perllogaritur nuk rezulton të jetë 178 lekë për litër por 177 lekë/ litër që përputhet me cmimin/ litër sipas vendimit të Bordit të Transparencës së datës 20.12.2022).*
*Gjithashtu theksojmë se në zbatim të Aktit Normativ Nr.8 datë 25.03.2022 neni 21/5 metodologjia e llogaritjes së cmimit,* ***pika*** *ç citojmë- Vlerës së llogaritur në përputhje me shkronjën "c", të këtij*
*neni, i shtohet marzhi bruto 3 lekë/litri për shoqëritë e tregtimit me shumicë, si dhe pika e citojmë-Mbi çminmn, që rezulton sipas shkronjës "dh", të këtij neni, shtohet marzhi bruto pakicë 12 lekë/litri; referuar dhe studimit të tregut, në përcaktimin e marzhit të fitimit është marrë për bazë mbledhja e marzhit të pakicës dhe shumices, rezultati i te cilave del 15 leke/liter pa TVSH. Bashkimi apo mbledhja e cmimit te pakices dhe shumices ka ardhur si pasoje e funksionimit te tregetimit të karburantit sepse shoqëria e shumices nuk mund të shesë sasi të vogla Autoriteteve Kontraktore si dhe pakica duhet të deklaroje çmimin e blerjes nga shumica. Bashkia Durrës dhe institucionet në varësi marin/furnizohen me karta furnizimi elektronike bëhet nga shoqëritë e karburantit me pakicë, dhe në të giitha rastet Shoqeria e Pakicës furnizohet nga Shoqeria e Shumicës, prandaj dhe duhet të mblidhen të dy vlerat. Prandaj është detyrim ligjor të meren të dyja marzhet e fitimit. Si jemi informuar garantimi në rast mungese i karburantit në furnizimet me pakicë është detyrim ligjor të sigurohet nga rezervat e Shoqërive së Shumicës.*
*Për shkak të sasive si dhe faktit që karburanti është produkt me kërkese joelastike në periudha afatshkurtër, ndryshimi i cmimit nuk luan rol të rëndësishëm në përcaktimin e sasive sepse në momentin e blerjes së karburantit/lëshimit të fatures ato ndryshojnë. Dhe ndryshimi i cmimit ka*

*ardhur duke respektuar cmimin tavan të percaktuar nga bordi si dhe afishuar ne faqen zyrtare te API).*
*2. Në lidhje me pretendimin se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezuluton se nga komisioni i perllogaritjes së fondit limit sasia e cila do të përdoret për nevoja të Bashkisë Durrës dhe Njësite e Varësisë nuk argumentohet dhe dokumentohet sasia e kërkuar, ju sqarojmë si më poshtë:*
*Bazuar në shkresen me nr.45 Prot. datë 12.01.2023, me Objekt "Kërkesë informacioni për karburant për procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në vitin 2023, drejtuar Bashkisë Durrës dhe Institucioneve në varësi të saj". Më pas të gjithë institucionet në rrugë shkresore kanë sjellë të gjithë informacionin në lidhje me sasinë dhe fondin limit.*
*Grupi i punës për specifikimet teknike dhe fondi i marrevëshjes kuader, i ngritur me urdherin me nr.19 datë 12.01.2023, ka për detyrë të bëje llogaritjen e fondit limit ne bazë të pasqyrës që do të hartojë, të përgatisi materialin si dhe specifikimet teknike për proçedurën Marrveshje Kuadër "Blerje Karburanti për Bashkinë Durrës dhe institucioneve në varësi të saj". Fondi i përgjithshëm i marrëveshjes kuadër që do të përgatitet nga ky grup pune, duhet t'i referohet Buxhetit te Bashkisë Durrës për vitin 2023 dhe Projektbuxhetit Afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2022-2024 të Autoritetit Kontraktor.*
*Për sa më sipër çdo insitucion ka sjell kërkesat për karburant sipas nevojave të veta. Në bazë të kërkesave të sjella nga secili institucion është përllogaritur fondi limit total i marrëveshjes kuader dhe sasia e pritshme e karburanit.*
*Komisioni i përllogaritjes së fondit limit ka përcaktuar sasinë e karburantit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke u mbështetur në analizën e konsumit nder vite dhe në vlerësimin e nevojave reale të Autoritetit Kontraktor.*
*Në përllogaritje janë marrë në konsideratë:*
- *Kontratat e mëparshme për furnizim me karburant dhe të dhënat e realizimit të tyre; konsumi faktik i mjeteve në përdorim gjatë periudhave të mëparshme;*
- *Ndryshimet në përbërjen dhe kapacitetin e flotës së mjeteve të Autoriteteve Kontraktore.*

*Theksohet se, në vijim të ushtrimit normal të veprimtarisë së institucioneve, Autoritetet Kontraktore kane realizuar blerje të mjeteve të reja, me qëllim përmbushjen e nevojave operacionale. Këto ndryshime kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kërkesës për karburant, duke u reflektuar në përllogaritjen e sasisë së kërkuar.*
*Sasia e parashikuar e karburantit synon:*
- *Garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve publike; shmangien e riskut të ndërprerjes së aktivitetit institucional;*
- *Mbulimin e nevojave reale të përdorimit të mjeteve gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.*

*Në këtë kontekst, përllogaritja e fondit limit dhe e sasisë së karburantit, të bazuar në të dhëna e meparshme dhe në zhvillimet faktike të aktivitetit të Autoritetit Kontraktor*.
**<u>Qëndrimi i Grupit të Auditimit</u>: 1.**Referuar çmimit tavan të vendosur nga Bordi i Cmimeve nuk është përdorur saktë çmimi i fundit i vendosur nga bordi sepse komisoni ka përdorur vendimin e datës 14.12.2022 dhe jo vendimin e datës 20.12.2022 në të cilat ka ndryshim të ulët të çmimit tavan.
Përcaktimi i mësipërmë është përmendur si pikë e rregullshmërisë së dosjes së audituar sepse likuimi i sasisë së karburantit të përdorur do të likuidohet sipas vendimit të fundit në momentin e faturuar dhe vendimet e bordit kanë qënë të ndryshueshme çdo jave deri në mos vendosjen më të çmimeve nga bordi.
**2.** Në lidhje me mazhin e fitimit të përcaktuar 15lekë/ litër argumentat e sjella nga subjekti janë në përputhje me aktin normativ dhe do të merren në konsideratë në hartimin e projekt raportit të auditimit.
**3.** Në lidhje me argumentin e sasië së karburantit të prokuruar çdo drejtori ose shoqëri në varësi të Bashksisë Durrës përvec listës së mjeteve dhe kërkesës për karburant duhet të bashkëngjiti për mjetet e reja librin e mjetit i cili përcakton normativën e konsumit të karburantit. Për mjetet e

përdorura dhe teknologjik të ngrihet një grup i cili të kryej një test në një distanëcë të konsiderueshme për të kuptuar konsumin e mjetit ne orë për mjetet teknologjike dhe për mjetet e tjera sasinë e konsumuar për 100 km. Dokumentimi të jetë i mbajtur në një procesverbal nga komisioni.

***Sa më sipër observacioni merret pjesërisht në konsideratë në hartimin e projekt raportit të auditimit.***

| **Konkluzion i përgjithshëm:**<br>Nga auditimi me zgjedhje i 27 procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2023 – 31.12.2024 me fond limit 2,850,065 mijë lekë, u konstatuan shkelje akteve ligjore e nënligjore të LPP[10]. E konkretisht: |
|---|
| - Në **5 (pesë)** nga 27 procedura prokurimi të audituara me destI.cion investime publike (*objekte/rruge, etj*.), në momentin e lidhjes së kontratës objektet **nuk** ishin të pajisura me "*leje ndërtimi/infrastrukture*", në kundërshtim me nenin 39 pika 3, të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar);<br>- Në **2 (dy)** nga 27 procedura prokurimi të audituara, projekt/preventivat hartoheshin nga punonjësit e Bashkisë Durrës, në mungesë të licencave profesionale të projektuesve me kategoritë përkatëse, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 5, të VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", i ndryshuar;<br>- Në **7 (shtatë)** nga 27 procedurat e prokurimit të audituara, janë konstatuar mangësi në aplikimin e kriteret e vendosura, si kritere paargumentuara dhe jo të lidhura me tipologjinë e procedurës, veprime të cilat janë bërë shkak për skualifikim të OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës;<br>- Në **11 (njëmbëdhjetë)** nga 27 procedura prokurimi të audituara, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave kanë kualifikuar dhe shpallur fitues OE në kushtet kur këta të fundit nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit në plotësimit të kritereve kualifikues;<br>- Në **1 (një)** nga 27 procedurë prokurimi të audituara, rezultoj se fondi limit nuk është llogaritur në zbatim të VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", i ndryshuar, veprime të cilat kanë cuar në rritjen e tij me vlerë **646,125 lekë**;<br>- Në **2 (dy)** nga 27 procedura prokurimi të audituara, rezultoi se në hartimin e fondit limit për makineritë dhe pajisjet është ngarkuar edhe TVSH-ja, në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 1, datë 16.6.2011, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar", duke rënduar fondin limit për vlerën 14,230,919 lekë;<br>- Në **2** (dy) nga 27 **procedura** prokurimi të audituara, punimet nuk kanë përfunduar sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke evidentuar një efekt fI.nciar negativ me dëm në buxhetin e bashkisë për vlerën **802,540 lekë.** |

- **Mbi Prokurimet Publike, blerjet me vlerë të vogël**

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. *Regjistrat e planifikimit dhe realizimit të prokurimeve për vitin 2023.*

[10] *Ligj nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar*

2. *Urdhrat për ngritjen e komisioneve të prokurimeve me vlera të vogla për vitin 2023.*
3. *Dosjet e procedurave e prokurimeve me vlera të vogla me zgjedhje për vitin 2023.*
4. *Dokumentacion plotësues/justifikues si: fatura, transaksione bankare, fletë-hyrje në magazinë.*

Nga dokumentacioni dhe të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, si dhe nga verifikimi i procedurave me zgjedhje në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) u konstatua si më poshtë vijon:

Bashkia Durrës, bazuar edhe në regjistrin e realizimit të prokurimit publik ka realizuar për vitin 2023, në total 27 procedura me "vlerë të vogël", me një vlerë të fondit limit 11,902,293 lekë pa TVSH. Nga auditimi i procedurave të prokurimit "blerje me vlerë të vogël", grupi i auditimit zgjodhi që të auditojë 6 procedura, me vlerë totale 2,073,435,95 lekë pa TVSH.

- U konstatua se të gjitha dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në mospërputhje me nenin 21 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për arkivat*".

**1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt *"Riparime printera, fotokopje"***

Me Urdhrin e Prokurimi nr. 28 datë 03.10.2023, titullari i autoritetit kontraktor Znj. E.S. ka miratuar procedurën me objekt sipas kërkesës: "Riparime printera, fotokopje". Me shkresën me nr. 644 prot., dt.17.01.2023 është ngritur njësia e prokurimit e përberë nga: A.Xh., E.Gj. dhe A.T..

Me shkresën me nr. 9075 prot., datë 29.09.2023 është nxjerrë urdhri me nr. 292, për ngritjen e grupit të punës për hartimin dhe rishikimin e specifikimeve teknike, si dhe përllogaritjen e fondit limit. Ky grup përbëhej nga F.P, F.M dhe E.I.

Në datën 02.10.2023 është mbajtur procesverbali nr.1 mbi përllogaritjen e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e vlerës limit të kontratës së prokurimit.

Grupi i punës që ka vendosur specifikimet teknike ka përllogaritur fondin limit në vlerën 748,000 lekë pa TVSH, duke u bazuar në analizat e hartuara nga vetë grupi. Përcaktimi i fondit limit në këtë formë është bërë në mospërputhje me nenin 76, të VKM, nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar*.

Në datën 04.10.2023 është mbajtur procesverbali Tip i kontratës, shërbime, për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

***b)Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.***

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, i ngritur me shkresën nr. 644 datë 17.01.2023, ka mbajtur procesverbalin në datën 06.10.2023, për të dokumentuar hapjen e ofertave.

Në këtë procedurë janë kualifikuar pesë operatorë ekonomik si me poshtë:

1. O.E. "B" oferta ekonomike **639,300** lekë pa TVSH;
2. O.E. "J.&SH." oferta ekonomike **649,500** lekë pa TVSH;
3. O.E. "C" oferta ekonomike **678,000** lekë pa TVSH;
4. O.E. "K.E.B" oferta ekonomike **720,000** lekë pa TVSH;
5. O.E. "I.S.T." oferta ekonomike **732,140** lekë pa TVSH;

Janë skualifikuar operatorët ekonomik të mëposhtëm:

"J.O.T.", "HB-G. C.", "X.S.", "S.-2022", "A.D", pasi në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël të zhvilluar, nuk janë paraqitur brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë, për të realizuar objektin e prokurimit. "O.E. I.", me vlerë të ofertës 768,800 lekë është skualifikuar, pasi vlera është mbi fondin limit të përllogaritur.

Pasi përfundoi vlerësimi i ofertave të paraqitura dhe pasi të gjithë anëtarët e KBV përfunduan procesin e vlerësimit të ofertave, sistemi i prokurimit elektronik tregoi renditjen përfundimtare si me poshtë:

Vendi i parë: OE "B" oferta ekonomike **639,300** lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 7518 prot., datë 09.10.2023 është mbajtur procesverbali për dorëzimin e dokumentacionit në mënyrë shkresore të ofertës së renditur në vend të parë lidhur me procedurën, me objekt "Riparime printera, fotokopje".
Për këtë procedurë nuk ka pasur ankesa pas njoftimit të fituesit paraprak
Në datën 23.10.2023 është lidhur "Kontratë Furnizimi" me nr. 9075/2 prot., Bashkia Durrës me O.E. "B" sh.p.k. Me shkresën nr. 9075/3 prot., datë 30.10.2023 është caktuar komisioni për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimeve, i përbërë nga: F.P, F.M dhe E.I.
Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me Fletë-hyrjen Nr. 1, datë 10.11.2023.

**2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt: *"Mbikëqyrje, Rikualifikim Hapësira Publike në Lagjen nr. 6 dhe Lagjen nr. 13"***
Me Urdhrin nr. 44 datë 17.01.2023, titullarja e AK, znj. E.S. ka ngritur Njësinë e Prokurimit, me përbërje: Z. A.Xh., Znj. E.Gj. dhe Z. A.T.. Me Urdhrin nr. 37, datë 18.12.2023, të Kryetarit të Bashkisë Durrës, Znj. E.S., në cilësinë e Titullarit të AK, ka konfirmuar zhvillimin e procedurës së prokurimit sipas kërkesës me objekt "Mbikëqyrje, Rikualifikim Hapësira Publike në Lagjen nr. 6 dhe Lagjen nr. 13", me njësi prokurimi me përbërje si më sipër, me fondin limit në vlerën 477,953.5 lekë pa TVSH.
**Përllogaritja e fondit limit**
- Me urdhrin Nr. 477, datë 07.12.2023 "Për Argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim", është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, me përbërje si vijon: A.K. (Kryetar), E.T. (anëtar), J.K. (anëtar), B.M. (Anëtare). Bashkëngjitur këtij procesverbali ka bërë përllogaritjen e vlerës së fondit limit për lidhjen e kontratës. Kjo përllogaritje është e bazuar sipas VKM-së me Nr. 354, datë 11.05.2016, seksioni 2, "Strukturat e ambienteve të jashtme", mbështetur në tabelën 8, Neni 32 "Tabela shoqëruese e tarifave-struktura në ambientet e jashtme, grupi tarifor III".
-Sa më sipër, komisioni ka nxjerrë vlerën maksimale të të gjithë shërbimit nga faza e I-rë, në vlerën e fondit limit, në shumën 477,953.5 lekë të reja pa TVSH.
**Hartimi i kritereve dhe specifikimeve teknike**
Grupi i punës për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në procesverbalin bashkëngjitur Urdhrit të Titullarit për ngritjen e grupit të punës, ka argumentuar ligjërisht dhe teknikisht kriteret e vendosura, në përputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021, neni 78, pika 2.
**Vlerësimi i ofertave**
Me procesverbalin e datës 21.12.2023, Njësia e Prokurimi ka hartuar Procesverbalin e hapjes së ofertave. Në këtë procesverbal, Njësia e Prokurimit ka refuzuar ofertat si më poshtë:
- OE "P", me vlerën e ofertës 238.976,70 lekë, me argumentin se oferta është me vlerën nën 50% të fondit limit të përcaktuar.
- OE "H", me vlerën e ofertës 85,000.00 lekë, me argumentin se oferta është me vlerë nën 50% të fondit limit të përcaktuar.
- OE "N", me vlerë të ofertës 539.777.00, me argumentimin se oferta e paraqitur është mbi vlerën e fondit limit të përllogaritur.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se vendimmarrja e Njësisë së prokurimit ishte në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimet.
Klasifikimi përfundimtar i ofertave të kualifikuara rezulton si më poshtë:
- "G", me vlerë të ofertës 238,976.75 lekë.
- "V.E.", me vlerë të ofertës 249.268,31 lekë.
- "2 D&P H.S.", me vlerë të ofertës 250.000 lekë.
- "B.Y", me vlerë të ofertës 309.064 lekë.
- "A. 2E", me vlerë të ofertës 311.955,94 lekë.
- "M", me vlerë të ofertës 350,000 lekë.

- “A.SH.E.”, me vlerë të ofertës 444,953 lekë.
- “D.&S.”, me vlerë të ofertës 477.953,50 lekë.

Për sa më sipër, Njësia e Prokurimit vendosi që të shpallë fitues, OE "G", me vlerën e ofertës 238,976.75 lekë pa TVSH.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, OE fitues ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

**3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt: *“Blerje materiale për MZSH”***

Drejtori i MSZH S.T, ka nënshkruar shkresën pa nr. prot. dhe datë, duke informuar dhe kërkuar blerje materiale për MSZH (tuba uji+hedhëse). Me Urdhër Prokurimi me Nr. 32, datë 30.10.2023, titullari i autoritetit kontraktor Znj. E.S, për kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje materiale për MZSH”, tuba ujë+hedhëse, etj”, është ngritur njësia e prokurimit, i cili ka në përbërje Z. A.Xh., Znj. E.Gj., Z. K.Dh..

**Përllogaritja e fondit limit**

Me urdhrin me Nr.287, datë 29.09.2023 është ngritur grupi i punës, për hartimin e specifikimeve teknike si dhe për përllogaritjen e fondit limit, për këtë procedurë prokurimi me përbërje si vijon: A.G (Kryetar), M.M (Anëtar), E.K (Anëtar).

Grupi i punës ka përgatitur preventivin me objekt: “blerje tuba dhe hedhëse uji për zjarrëfikse”, me anë të së cilit është përllogaritur fondi limit me vlerën 330,000 lekë të reja pa TVSH dhe ka dalë në këtë konkluzion për vlerën, duke kërkuar dhe grumbulluar informacione bazuar mbi çmimet orientuese të mallit, të vëna në dispozicion nga subjektet me niptet si vijon: "L73", "K74", "K75".

**Hartimi i specifikimeve teknike**

Nga verifikimi i procesverbalit për argumentimin e specifikimeve teknike si dhe DST, u konstatua se grupi i punës ka argumentuar ligjërisht specifikimet teknike të përcaktuar në dokumentet e mësipërme, *por nuk ka bërë argumentimin teknik të kritereve për kualifikim. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me VKM-në Nr. 285, datë 19.5.2021, neni 78, pika 2.*

*-Për sa më sipër mban përgjegjësi grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike si dhe për përllogaritjen e fondit limit, për këtë procedurë prokurimi, me përbërje si vijon: A.G (Kryetar), M.M (Anëtar), E.K (Anëtar).*

**Vlerësimi i ofertave**

Me procesverbalin e datës 02.11.2023, Njësia e Prokurimi ka hartuar Procesverbalin e hapjes së ofertave. Në këtë procesverbal, Njësia e Prokurimit ka refuzuar ofertat si më poshtë:

- OE "E", me ofertën në vlerën 345,678 pa TVSH, me argumentin se kjo ofertë është në një vlerë më të lartë nga fondi limit i përcaktuar në grupi i punës për përcaktimin e fondit limit dhe argumentimin e specifikimeve teknike.
- OE "V", me ofertën në vlerën 590,000 lekë me argumentin se kjo ofertë ka një vlerë më të lartë nga fondi limit i përcaktuar nga grupi i punës, për përcaktimin e fondit limit dhe argumentimin e specifikimeve teknike
- OE "O" me ofertën në vlerën 140,000 lekë, me argumentimin se kjo ofertë është me e ulët se 50 % e fondit limit.
- OE "E", me vlerë të ofertës 132,000 lekë, me argumentimin se kjo ofertë është më e ulët se 50% e fundit limit.
- OE "E", me vlerë të ofertës 296,000 lekë, me argumentimin se operatori nuk ka në objektin e veprimtarisë së tij objektin e prokurimit.
- OE "S", me vlerë të ofertës 300,000 lekë, me argumentin se operatori nuk ka në objekt të veprimtarisë së tij objektin e prokurimit.
- OE "S", me vlerë të ofertës 315,000 lekë, me argumentin se operatori nuk ka objekt të veprimtarisë së tij objektin e prokurimit.
- OE "O", me vlerë të ofertës 330,000 lekë, me argumentin se operatori nuk ka në objekt të veprimtarisë së tij objektin e prokurimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se vendimmarrja e Njësisë së prokurimit ishte në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimet.
Klasifikimi përfundimtar i ofertave të kualifikuara rezulton si më poshtë:
- "M", me vlerë të ofertës 249,9000 lekë.
- "Q", me vlerë të ofertës 260,000 lekë.
- "A.", me vlerë të ofertës 307,700 lekë.
- "HB-G.", me vlerë të ofertës 310,000 lekë.
- "V.-al", me vlerë të ofertës 310,000 lekë.
- "J.", me vlerë të ofertës 313,000 lekë.
- "3V.A.1", me vlerë të ofertës 314,000 lekë.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit, vendosi që të shpallë fitues OE "M", me vlerën e ofertës 249,900 lekë pa TVSH.
Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me Fletë-hyrjen Nr. 12, datë 16.11.2023.

**4.Procedura e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt: *Krijimi dhe Dizenjimi i Aplikacionit "Visit Durrës".***
Me Urdhrin nr. 44, datë 17.01.2023, titullarja e AK, znj. E.S ka ngritur Njësinë e Prokurimit, me përbërje: Z. A.Xh., Znj. E.Gj. dhe Z. A.T.. Titullari i AK, Znj. E.S, me Urdhrin e prokurimit Nr. 19, datë 30.05.2023 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.
**Përllogaritja e fondit limit**
Me Urdhrin me nr. 157, datë 25.04.2023 është ngritur grupi i punës për miratimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, për procedurën e prokurimit me objekt: "Krijimi dhe Dizenjimi i aplikacionit "Visit Durrës", me përbërje si vijon: F.K (kryetar), S.T (anëtar), O.D (anëtar), E.I (anëtar), A.Z (anëtar).
Grupi i punës ka përllogaritur fondin limit, në shumën 412,667 lekë pa TVSH.
KBV ka shpallur fitues operatorin ekonomik "I.al", me vlerë të ofertës 320,500 lekë.
Komisioni për marrjen në dorëzim ka mbajtur procesverbal më datë 03.07.2023. *Konstatohet se procesverbali i marrjes në dorëzim është pa numër protokolli, ndërsa anëtarë janë i njëjti grup i cili ka marrë pjesë edhe në hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit. Në komision nuk ka specialistë të fushës, në kundërshtim me pikën 43 të UMF-së me Nr. 30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.*
OE është likuiduar nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr. 1034, datë 20.12.2023, në vlerën prej 384,600 lekë, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr.31/2023 datë 03.07.2023.

**5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt: Shpenzimet e sigurimit, të mjeteve të transportit të MZSH-Bashkia Durrës**
U audit ua procedura e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt: "Shpenzimet e sigurimit, të mjeteve të transportit të MZSH-Bashkia Durrës", (për 10 automjete), me nr.ref-60161022320 23, me fond limit 419,961 lekë, në zbatim të Urdhrit të Prokurimit Nr.2, datë 23.02.2023, me nr. prot. 1710/1.
Fitues u shpall ofertuesi "A", me NIPT "L76", me vlerë të ofertës 418,307 lekë, i cili ka depozituar faturën elektronike me nr.161951/2023, së bashku edhe me "10 policë" për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike respektive.
*Nga procedura e audituar dhe verifikimi në sistem, konstatohet se nuk ka parregullsi.*

**6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt: Blerje materiale për MZSH (radio dore+bateri)**
U audit ua procedura e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt: Blerje materiale për MZSH (radio dore+bateri), me nr. ref-83024-10-10-2023, me fond limit 492,000 lekë, për blerjen e 21 radio dore dhe 1 radio stacionare.

Me urdhrin, me nr. 207, datë 15.06.2023, i administruar me nr. 5815 prot., datë 15.06.2023 "Për ngritjen e grupit të punës, për hartimin dhe specifikimet teknike, si dhe për llogaritjen e fondit limit", për procedurën e prokurimit me objekt si më sipër, nga titullari i AK-së, është caktuar z. F.P kryetar dhe Z. D.K anëtar (MZSH) dhe F.M anëtar.

**Konstatim:** ***Grupi i punës i mësipërm, me procesverbalin nr. 1, datë 23.06.2023, nuk ka të argumentuar përllogaritjen e vlerës për fondin limit, në kundërshtim me Nenin 76-të, të VKM-së me nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar". Në këtë procesverbal citohet se: "Grupi i punës u bazua në analizat e hartuara nga vetë anëtarët, por duke studiuar tregun vendas dhe referencat në internet, duke përcaktuar fondin limit prej 492,000 lekë".***

Me urdhrin e prokurimit me nr. 29, datë 10.10.2023, nr.5815/1 prot., KBV ka refuzuar 3 oferta nga O.E, pasi vlerat e tyre janë mbi fondin limit të përllogaritur.

Gjithashtu ka skualifikuar 8 operatorë ekonomikë, pasi nuk kanë pasur në objektin e veprimtarisë së tyre, objektin e prokurimit.

Në klasifikimin përfundimtar, rezultojnë 2 operatorë ekonomikë, "A" sh.p.k me vlerë të ofertës 460,000 lekë dhe "E. C.", me vlerë të ofertës 490,000 lekë.

KBV ka shpallur fitues, duke njoftuar edhe në sistem "A" sh.p.k me vlerë të ofertës 460,000 lekë.

OE fitues ka paraqitur listën e dokumenteve, për procedurën e mësipërme, me nr. 7684 prot., datë 13.10.2023.

### 2.4.4. Mbi zbatimin e kontratave të punëve publike (investime).

Nga Bashkia Durrës për periudhën 2023-2024 janë nënshkruar gjithsej **44** kontrata të puneve publike me vlerë totale kontratash 3,273,509 mijë lekë. Nga grupi i auditimit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 mbi bazën e materialitetit nga kontratat e mbetura për auditim me vlerë kontrate 1,332,393 mijë lekë, janë vlerësuar për auditim **7** kontrata me vlerë **843,175** mijë lekë ose 63 % e vlerës së kontratave të zhvilluara, tabela 1. Ndërsa për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024 nga kontratat e mbetura për auditim me vlerë kontrate 1,941,116 mijë lekë, janë vlerësuar për auditim **3** kontrata me vlerë **1,340,316** mijë lekë ose 69 % e vlerës së kontratave të zhvilluara, siç tregohet në tabelat nr.1 dhe nr.2.

**Tabela 1:** Lista e kontratave të realizuara periudha 01.01.2023 – 31.12.2023

| Nr. | Objekti I Prokurimit | Vlera e kontratës | OE I Shpallur Fitues | Vlerësuar për auditim | Viti |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Loti Iii Riforcim Godine Banimi 12-13 Kat Mbi Toke Dhe Nje Kat Nentoke, Rr.Jahja Ballhysa Nr.6, Gis 3092 (Jedasi) | 247,158,153 | BOE "E" +LL.+ED K. | Po | 2023 |
| 2 | Loti 2 Me Objekt: Rikonstruksioni Dhe Riparimi Mjediseve Ne Bashkepronesi Ose Te Perbashketa Ne Ndertesa (Pallat) Ne Bashkine Durres, Njesite Administrative Nr.5 Dhe Rrashbull | 206,840,256 | BOE "R" sh.p.k + "G" | Po | 2023 |
| 3 | Loti 1 Me Objekt : Rikonstruksioni Dhe Riparimi Mjediseve Ne Bashkepronesi Ose Te Perbashketa Ne Ndertesa (Pallat) Ne Bashkine Durres, Njesite Adm.Nr.1,2,3,4,5, Sukth, Manez | 176,327,975 | "E" sh.p.k | Po | 2023 |
| 4 | Rikonstruksioni I Qendres Kulturore Te Femijeve | 124,787,056 | "G" sh.p.k | Po | 2023 |
| 5 | LOTI VI:Riforcim Pallatit Me Kode Gis 1023,1025 | 94,700,423 | "I" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 6 | Loti Iii: Riforcimi I Pallateve Me Kod Gis: 7339,23247 Dhe Riforcimi Banesave Individuale Ne Nj.Adm.Ishem Te Banoreve: A.B, A.K, S.K | 78,610,873 | "V" sh.p.k | Jo | 2023 |

| Nr. | Objekti I Prokurimit | Vlera e kontratës | OE I Shpallur Fitues | Vlerësuar për auditim | Viti |
|---|---|---|---|---|---|
| 7 | Rikonstruksioni I Hapesirave Publike Ne Bllokun E Banimit Ne Lagjen Nr.17 Dhe Tek Muzeu I Deshmoreve | 66,276,473 | BOE "L" sh.p.k + "N" sh.p.k | Po | 2023 |
| 8 | Rikonstruksion Shkolla MB Besnik Hidri, Shenvlash | 43,771,564 | "M" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 9 | Rehabilitimi I Ndricimit Te Akseve Rrugore | 41,139,000 | BOE "B" sh.p.k+"B" sh.p.k + "B" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 10 | Rikonstruksion Rrugeve Ne Qytet | 36,668,868 | "V" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 11 | FV Ndrcimi Rruges Mars 91, Paralel Me Murin E Portit | 23,799,180 | "A" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 12 | Riforcim I Godines Se Banimit 8 Kate + Bodrum, Lagja Nr.3, Rruga Egnatia, Kod Gis 27258 | 23,183,046 | "T" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 13 | Rikonstruksion Rruge Ne Njesine Administrative Ishem | 17,702,340 | "A" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 14 | Rikonstruksion Rruge Njesie Administrative Sukth | 14,991,480 | "K" sh.p.k | Po | 2023 |
| 15 | Rikonstruksion Te Ambienteve Te Institucioneve Arsimore | 14,957,522 | "R" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 16 | Pastrim Kanaleve Te Ujrave Te Bardha Ne Zonen E Plazhit | 14,352,570 | "O" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 17 | Pastrim I Kanaleve Te Ujerave Te Bardha Ne Zonen E Plazhit | 14,352,570 | "O" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 18 | Rikonstruksion Rruge Ne Njesine Administrative Katund I Ri | 13,814,880 | "C" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 19 | Rikonstruksion Rruga Papa Klementi 11 | 12,594,420 | BOE "V" sh.p.k + "E" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 20 | Rikonstruksion Rruga "Dervish Hima" | 11,332,200 | "V" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 21 | Ndertim Kanali Kuz Ne Rrugen Gjergj Balsha | 10,490,796 | "R" | Jo | 2023 |
| 22 | Fv Ndricim Rruga "Bajram Tusha" | 7,910,160 | "C" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 23 | Rikonstruksioni I Terrenit Sportiv Ne Shkollen 9-Vjecare "Fshat Rinia" Njesia Administrative Katund I Ri, Durres Si Nje Kontribut I Perbashket Midis Bashkise Durres Dhe world Vision Albania | 7,723,709 | "N" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 24 | Rikonstruksion Ne Rruge Ne Nj.Adm.Rrashbull | 6,793,200 | "K" sh.p.k | Po | 2023 |
| 25 | Rikonstruksion Rruga Lekë Dukagjini Rrashbull | 6,453,120 | "K" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 26 | FV Ndricim Rruga "Asti Gogoli", Lagja 14, Shkozet | 4,953,240 | "T" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 27 | Mbyllje Kanali Te Hapur Ne Rrugen Papa Klemendi II (550 Ml) | 4,369,440 | "S" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 28 | FV Ndricim Rruga "H.S", L.14, Shkozet | 3,125,280 | "T" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 29 | FV Ndricim Rruga "Rrota E Kuqe", L.13 | 2,371,440 | "T" sh.p.k | Jo | 2023 |
| 30 | Rikonstruksioni I Shkolles Vat Bushi Lalez Durres | 841,356 | "T" sh.p.k | Jo | 2023 |
| | **Totali** | **1,332,392,590** | | | |
| | **Vlera për objektet e zgjedhur për auditim** | **843,174,593** | | | |
| | **%** | **63%** | | | |

**Tabela 2:** Lista e kontratave të realizuara periudha 01.01.2024 – 31.12.2024

| Nr. | Objekti I Prokurimit | Vlera e kontratës | OE I Shpallur Fitues | Vlerësuar për auditim | Viti |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | “Përforcim Terreni Nga Rrëshqitja Në Zonën Nj.A Nr.2, Nr.4, Ishëm | 541,742.9 | "N" sh.p.k | Jo | 2024 |
| 2 | Rehabilitimi Shetitores Taulantia (Loti Iii) | 15,230,587.75 | BOE "M" + "M" sh.p.k | Jo | 2024 |
| 3 | Rikonstruksion I Pishines Taq Dafa | 10,863,900 | "R" sh.p.k | Jo | 2024 |
| 4 | Rikonstruksion Rruge Ne Njesine Administrative Katund I Ri | 12,507,120 | "L" sh.p.k | Jo | 2024 |
| 5 | Rikonstruksion Rruge Ne Njesine Administrative Sukth | 13,028,520 | "L" sh.p.k | Jo | 2024 |

| Nr. | Objekti I Prokurimit | Vlera e kontratës | OE I Shpallur Fitues | Vlerësuar për auditim | Viti |
|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Rikonstruksion Rruge Ne Njesine Administrative Manez | 13,306,320 | "K" sh.p.k | Jo | 2024 |
| 7 | Rikonstruksion Rruge Nje Njesine Administrative Rrashbull | 12,518,064 | "V" sh.p.k | Jo | 2024 |
| 8 | Ndertime Kabine Elektrike Dhe Pajisje Per Shkollen Naim Frasheri Dhe BernadI. Qeranxhija | 8,307,609 | BOE HTM + "A" sh.p.k | Jo | 2024 |
| 9 | Rikonstruksion Dhe Shtese Qendra Shendetesore Spitalle | 15,656,918 | "K" sh.p.k | Jo | 2024 |
| 10 | Loti Iv: Riforcimi Pallatit Me Kod Gis: 24844; Riforcimi Banesës Individuale Në Rajonin Nr.1 Të Banorit D.J, Riforcimi Banesave Individuale Në Rajonin Nr.4 Të Banorëve: K.E, M.V, M.H, N.S, G.K, A.D, Z.P Dhe Riforcimi Banesave Individuale Në Rajonin Nr.5 Të Banorëve: H.L, M.G, A.K | 81,977,789 | "I" sh.p.k | Jo | 2024 |
| 11 | Riforcimi Pallateve Me Kod Gis: 20590,22363,20402,19065,19659, 21258,21167,47053,38766,19068, 21281,22369 Riforcimi I Baneses Individuale Në Njësinë Administrative Manez Të X.S. | 409,898,699 | "G" sh.p.k | Po | 2024 |
| 12 | Riforcimi Pallateve Me Kod Gis: 25759,25583,22842,22243,22248, 22866,24812,22707,25248,22721, 24821,22245,22299 | 428,529,309 | BOE L. + S. + U. + "S" sh.p.k | Po | 2024 |
| 13 | Riforcimi Pallateve Me Kod Gis: 5407,25387,26969,1511,25947, 26972,27307,26764 | 416,861,893 | BOE E.I 2000 + K.A.E.XH +"A" + "E" sh.p.k | Jo | 2024 |
| 14 | Riforcimi Pallateve Me Kod Gis: 24, 5703, 5414, 6169, 94, 80, 99 | 501,887,927 | "I" sh.p.k | Po | 2024 |
| | **Totali** | **1,941,116,398.65** | | | |
| | **Vlera për objektet e zgjedhur për auditim** | **1,340,315,935** | | | |
| | **%** | **69%** | | | |

Në mënyrë të detajuara situata për çdo kontratë paraqitet si më poshtë:

**12.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore të Fëmijëve", Bashkia Durrës*** rezultoi se:
- Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 52/5 prot., datë 24.03.2023, lidhur midis AK Bashkisë Durrës dhe Kontraktorit OE "G" sh.p.k Vlera e kontratës është 124,787,056.4 lekë me TVSH. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr. 54/7 prot., datë 25.04.2023, midis AK Bashkia Durrës dhe Mbikëqyrësit OE "T" sh.p.k, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0919/11 dhe me vlerë të kontratës 1,337,493 lekë me TVSH. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 406 prot., datë 10.01.2024, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "A" sh.p.k, me licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3573.
-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se njoftimi i fillimit të punimeve nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi mban datën 25.04.2023. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 120 ditë nga data e njoftimit zyrtar të fillimit të punimeve dhe punimet janë kryer për 247 ditë sipas Amendamentit nr. 54/18, datë 02.08.2023 (zgjatje afati me 80 ditë). Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe mbikëqyrësi më datë 29.12.2023 ose brenda afateve kontraktuale të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve.
-Sipas kontrollit të dosjes tekniko-ligjore të situacionit përfundimtar, projektit bazë dhe projekt-preventivit të rishikuar, lidhur me volumet e punes të situacionuara; rezultuan diferenca në

volume të llogaritura jo në mënyrë korrekte. Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:
1. Zëri 7.70. Rrjetë metalike Ø 10 mm. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 4 ton. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 4 ton. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune figuron në sasinë 4.05 ton. Ky zë pune është i detajuar për shtresat e betonit në sipërfaqet në aksin 7-8, G-l dhe 5-6, K-l, sipas sipërfaqeve respektive 309 m2 ( 27.1 x 11.4) dhe 32 m2 (6.25 x 5.15), ose 341 m2 gjithsej. Nisur nga sasia e hekurit çdo 15 cm, kemi 14 fije për 1m2 ndërsa për 341m2 llogaritet që të jenë 4,774 ml fije hekur me d= 8 mm, që përbëjnë 1.981 ton hekur (4,774ml x 0.415 kg/ml). Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 2.01 ton më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.
2. Zëri 4.2+4.4. FV dektor tymi + Fv bazë detektori për alarm zjarri. Në preventivin bazë sasia e këtyre zërave pune është 114 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, këta zëra pune figurojnë në sasinë 114 copë. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, konstatohet se janë vendosur 63 copë, ose 51 copë më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.
**Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punes të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën 497,280 lekë pa TVSH.** Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve OE "T" sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

**13.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***“Riforcim i pallateve me kod gis 24, 5703,5414, 6169, 94, 80, 99”, Bashkia Durrës*** rezultoi se: - - Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 4992/16 prot, datë 13.09.2022, lidhur midis AK Bashkisë Durrës dhe Kontraktorit OE "I" sh.p.k Vlera e kontratës është 501,887,927 lekë me TVSH. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 224 ditë nga data e njoftimit zyrtar të fillimit të punimeve. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr. 4992/21 prot., datë 29.06.2022, midis AK Bashkisë Durrës dhe Mbikëqyrësit të punimeve BOE "M" PF & OE "D" sh.p.k, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh respektivisht MK. 1200/4 dhe MK 1676/4. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 418/1 prot., datë 16.01.2024, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria OE "6" sh.p.k, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2837/6. -Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se njoftimi i fillimit të punimeve, procesverbali i fillimit të punimeve, akt dorëzimi i sheshit si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 29.09.2022 . Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 18.12.2023. -Sipas kontrollit të dosjes tekniko-ligjore të situacionit përfundimtar, projektit bazë dhe projekt-preventivit të rishikuar, lidhur me volumet e punës të situacionuara; rezultuan diferenca në volume të llogaritura jo në mënyrë korrekte. Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

| Nr | Zëri i punes | Njesia | Çmimi | Gis 24 | Gis 80 | Gis 94 | Gis 99 | Gis 5414 | Gis 5703 | Gis 6196 | Sasia | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Transport material ndërtimi deri në 10 km | $m^3$ | 350 | 446 | 294 | 777 | 917 | 1526 | 780 | 1610 | 6350 | 2,222,500 |
| 2 | FV plintuse pllakë grez, h=10 cm, çmimi | $m^2$ | 300 | 1199 | 666 | 2008 | 923 | 3667 | 2482 | 3644 | 14,889 | 580,671 |
| | **Totali** | | | | | | | | | | | **2,803,171** |

**1. Zëri "Transport material ndërtimi deri në 10 km"**. Për këtë zë pune, në librin e masave është llogaritur edhe volumi i prishjes së shtresave të betonit dhe murit të tullës, përkatësisht me nr analize 2.426/3 dhe 2.426, të cilat transportin e kanë të përfshirë në analizën e çmimit. Vlera e sasisë totale prej 6350 $m^3$ është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori.
**2. Zëri "Plintuse pllake grez, h=10 cm".** Nga verifikimi i librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimi në terren, rezulton se është situacionuar 14889 ml plintus pllaka grez me h=10 cm, me çmim 300 lekë/ml, e cila nga verifikimi në terren rezulton të jetë h= 8 cm. Nga verifikimi i analizës së çmimit të këtij zëri pune, sipas manualit (2.324/a), rezulton se çmimi i nënzërit material në këtë zë pune, është 65 % e të gjithë zërit të punes. Nga rillogaritja, çmimi i këtij zëri pune është 261 lekë/ml (65% x 300 lekë/ml x 8cm/10cm + 35 % x 300 lekë/ml), ose 39 lekë/ml më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 39 lekë/ml (për sasinë e plintuseve prej 14,889 ml), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve. Përveç sa më sipër, nga auditimi i objekteve të veçanta u konstatuan diferenca në volume si më poshtë:

**1. Pallati GIS 24**

Lartësia e katit përdhe, në librin e masave është marrë 3.7 m nga 3.55 m që është në projektin e azhurnuar. Për pasojë ka patur diferenca në volume në zërat e mëposhtëm:
- Zëri "Ndërtim muri me t=20 cm" në sasinë 11.7 $m^3$ x 10050 lekë/$m^3$ = **122,850** lekë;
- Zëri "Suva muri tulle brenda + lyerje" në sasinë 60 $m^2$ x 1500 lekë/m3 = **90,000** lekë;
- Zëri "Shtresë më pllaka gres importi", në ambientet shkalla dhe sheshpushimi, është marrë dy herë për katër kate, 38.2 x 4 = 152.8 $m^2$ x 2500 lekë/$m^2$= **382,000** lekë;
- Zëri "Shtresë lustër çimento 50 mm", në ambientet shkalla dhe sheshpushimi, është marrë dy herë për tre kate, 38.2 x 3 = 114.6 $m^2$ x 300 lekë/$m^2$= **34,380** lekë;
- Zëri "Suva solete me drejtues", në ambientet shkalla dhe sheshpushimi, është marrë dy herë për tre kate, 38.2 x 3 = 114.6 $m^2$ x 1000 lekë/$m^2$= **114,600** lekë;

**2. Pallati GIS 99**

- Përmasat e koloncI.ve në librin e masave është marrë 20.25 x 0.25 m, nga 0.2 m x 0.2 m që është në projektin ë azhurnuar. Për pasojë ka patur diferenca në volumin e zërit "kolona b/a lidhëse 0.2 m x 0.2 m", në sasinë 3.2 $m^3$,x 11000 lekë/$m^3$= **35,200** lekë;

**3. Pallati GIS 5703**

- Zëri B-5.4. Shtrim dhe veshje shkallë të brendshme me pllakë mermeri t=3 cm**.** Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 216 $m^2$. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 216 $m^2$. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 216 $m^2$, i detajuar sipas dy shkallëve të pallatit. Nga verifikimi i objektit në terren, rezulton se volumi i këtij zëri pune nuk është kryer. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **1,360,800** lekë (216 $m^2$ x 6300 lekë/$m^2$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punes të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën 4,943,001 lekë pa TVSH.** Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve BOE "M" PF & "D" sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

**14.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Rikonstruksioni godine 12-13 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, rruga "Jahja Ballhysa" nr. 6, GIS 3092", Bashkia Durrës*** rezultoi se: - Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 3638/63 prot., datë 09.06.2021, lidhur midis AK Bashkia Durrës dhe Kontraktorit BOE "E" sh.p.k & "L" sh.p.k & "E" sh.p.k Vlera e kontratës është 247,158,153 lekë me TVSH. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 168 ditë nga data e njoftimit zyrtar të fillimit të punimeve në Bashkinë Durrës. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr.3638/76 prot., datë 15.06.2021, midis AK Bashkia Durrës dhe

Mbikëqyrësit OE "N" sh.p.k, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1846/7. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 708/7 prot., datë 08.05.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria OE "F" sh.p.k, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3429/3.
-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 20.06.2021, dhe punimet kanë përfunduar me datë 04.04.2023.
-Për këtë objekt kanë ndodhur disa zgjatje afatesh të punimeve referuar amendamenteve përkatëse, pasi ka patur disa pezullime punimesh konkretisht: -Me shkresën nr. 9604/8, datë 08.10.2021 të Bashkisë Durrës *"Kthim përgjigje mbi kërkesën për pezullim punimesh-zbatimi"* drejtuar Kontraktorit dhe mbikëqyrësit të punimeve, citohet që puna duhet të vazhdojë, pasi kërkesat e paraqitura për rishikimin e projektit, nuk ndikojnë në vazhdimin e mëtejshëm të punimeve. -Me shkresën nr. 69 prot., datë 21.10.2021, Kontraktori ka rikërkuar pezullim punimesh deri në dhënien e zgjidhjes për detajet e riforcimit të objektit, në vendet e paparashikuara në projektin bazë. -Me shkresën nr. 10650/4, datë 08.11.2021, Bashkia Durrës ka riadresuar sërish tek projektuesi "A" sh.p.k problematikat teknike të hasura gjatë zbatimit, në lidhje me plasaritjet dhe çarjet në strukturat mbajtëse. Në këtë shkresë është bërë edhe pezullimi i punimeve deri në zgjidhjen e problemeve teknike nga projektuesi. -Me shkresën nr. 74/12, datë 24.03.2022 Bashkia Durrës ka rikërkuar nga projektuesi zgjidhje urgjente për problematikat teknike të bëra prezente në shkresat e mëparshme. Me shkresën nr. 22/12, datë 18.09.2022, projektuesi ka përcjellë në Bashkinë Durrës relacionin teknik me ndryshimet e bëra në projektin e zbatimit
- Nga auditimi i dosjes teknike, rezulton se është mbajtur një proceverbal për ndryshimin e volumeve ndërmjet Mbikëqyrësit dhe Kontraktorit të punimeve me datë 26.09.2022, që është pasuar me tabelën e volumeve faktike. Ky procesverbal është i shoqëruar nga tabela e ndryshimeve "Punimet që hiqen dhe shtohen", ku janë shtuar 8,789,561 lekë dhe pakësuar 8,917,455 lekë.
-Me shkresën nr. 93, datë 29.09.2022, protokolluar në Bashkinë Durrës me nr. 74/48 prot., datë 03.10.2022, mbikëqyrësi i punimeve ka njoftuar rifillimin e punimeve. Është bërë edhe një rishikim tjetër i projekt preventivit, sipas te cilit cilës janë shtuar nga preventivi i rishikuar 41,324,118 lekë dhe janë pakësuar 41,324,215 lekë. Me procesverbalin e datës 26.09.2022 ndërmjet Mbikëqyrësit dhe Kontraktorit të punimeve, miratuar nga përfaqësuesi i investitorit znj. E.S., është bërë negocimi i zërave të rinj. -Me shkresën me nr.74/50, datë 14.10.2022 është bërë amendamenti i parë për zgjatje afati të punimeve me 60 ditë, kjo pas kërkesave të njëpasnjëshme të mbikëqyrësit të punimeve për zgjidhjen e problematikave të dala në objekt, kërkesave për pezullim punimesh.-Me shkresën nr. 678/3, datë 09.12.2022 është bërë amendamenti i dytë për zgjatje afati të punimeve me 30 ditë, për arsye të vështirësive në ndërtimin e mureve të kafazeve në ashensorë, mungesës së personelit për riparimin e ashensorëve, motit të keq që pengojnë punimet në fasadë dhe mungesës së likuiditeteve për situacionet e paraqitura nga Kontraktori. -Me shkresën nr. 678/7, datë 30.12.2022 është bërë amendamenti i tretë për zgjatje afati të punimeve me 90 ditë, për arsye se të vështirësive në ndërtimin e mureve të kafazeve të ashensorë, mungesës së personelit për çmontimin e ashensorëve, motit të keq që pengojnë punimet në fasadë dhe mungesës së likuiditeteve për situacionet e paraqitura nga Kontraktori. -Në lidhje me "Akt Ekspertizën e Thelluar", është kryer oponenca teknike e sajë e përcjellë nga Instituti i ndërtimit me shkresën nr. 222/3, datë 10.03.2021; ku sipas të cilës ky objekt duhet ti nënshtrohet përforcimit dhe rikonstruksionit. Me shkresën e protokolluar me nr. 74/46, datë 21.09.2022 është përcjellë projektpreventivi i rishikuar nga projektuesi për miratim tek Autoriteti Kontraktor.- Pas ndryshimeve në projekt, nuk është kërkuar dhe nuk ka oponencë për projektin e rishikuar, i cili ka ndryshime thelbësore nga projekti bazë në strukturat mbajtëse të objektit.
-Sipas kontrollit të dosjes tekniko-ligjore të situacionit përfundimtar, projektit bazë dhe projekt-preventivit të rishikuar, lidhur me volumet e punes të situacionuara; rezultuan diferenca në

volume të llogaritura jo në mënyrë korrekte. Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

**1. Zëri B-1.4. Prishje suva ekzistuese muri.** Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 30 $m^2$. Në preventivin e rishikuar 1 është 2,849 $m^2$, ndërsa në preventivin e rishikuar 2 dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 27,282 $m^2$. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 27,282 $m^2$, i detajuar sipas apartamenteve. Nga verifikimi i librit të masave konstatohet se prishja e suvasë është në të gjithë muret e prishura, të cilat janë situacinuar si "Prishje mur tulle pa pastrim". Sa sipër volumi prej 27,282 $m^2$, nuk duhej librezuar dhe situacionuar për të gjitha muret që do të prishen, por do të duhet të ishte raportuar duke marrë parasysh edhe sondazhet përreth 20% të sasive; ndërsa pjesa tjetër nuk do të duhet të ishte raportuar. Rrjedhimihst 27,282.24m3*146 lekë/m3 = 3,983,206 lekë. 3,983,206 lekë * 20%= 796,641.2 lekë. Për pasojë, diferenca midis vlerës së raportuar 3,983,206 lekë me vlerën reale të punimeve të kryera për këtë zë (3,983,206 lekë -796,641.2 lekë) = **3,186,564.8 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si vlerë e përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.**

**2. Zëri B-1.7. Transport materiale ndërtimi deri në 10 km.** Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 2844 $m^3$. Në preventivin e rishikuar 1 është 3510 $m^3$, ndërsa në preventivin e rishikuar 2 dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 4402 $m^3$. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 4402 $m^3$, i detajuar sipas zërave të prishjeve. Nga verifikimi i librit të masave, dhe i analizës së çmimit të zërave të prishjeve për shtresa betoni, soleta betoni dhe tullë, përkatësisht analizat 2.246/36, 2.246/4 dhe 2.246, rezulton se volumi i transportit nuk duhet të ishte llogaritur për transportin e prishjeve të mësipërme. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1168 $m^3$, ose 3234 $m^3$, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi **1,510,278 lekë pa TVSH** është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve. **Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punes të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën 4,696,842.8 lekë pa TVSH pa TVSH.** Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve OE "N" sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Mbikqyrësi i punimeve OE "N" sh.p.k, më datë 28.05.2026 të protokolluara në KLSH me nr. 1347/70 prot. datë 01.06.2026; shprehen pretendimet e tyre për projekt raportin e auditimit për objektin e mësipërm.

**Pretendimi i subjektit përmbledhurazi:**

*Zëri B-1.7 Transport materiale ndërtimi deri në 10 km.*

*Volumet e prishjeve pavarësisht se e përfshijnë transportin nga mjeti i ngarkuar deri në vendgrumbullimin e caktuar nga autoriteti kontraktor brenda distancë 10 km, nuk parashikon transportin vertikal dhe horizontal nga prishjet e godinës të kryera me punëtori. Nisur nga Manuali 2 Viti 2015, i cili ka qenë në fuqi gjatë kohës së zbatimit të projektit dhe tenderimit do të kemi një analizë kostoje për këtë lloj punimi i cili do të konsistojë si më poshtë:*

*Emërtimi:"Transport mbeturI.sh, nga prishje të brendshme të godinës, me krahë"*

| Nr. Kodi | EMËRTIMI | Njësia | PUNËTORI | | TRANSPORT | | MAKINERI | | | SHUMA | Shpi 8% | Fitim 10% |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Op | Çmimi | Op | Çmimi | Op | Çmimi | vlefta | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 7 | 8 | 9 | 6 | 10 | 11 | 12 | |
| An | Transport mbeturinash, nga prishje të brendshme të godinës, me krahë | m3 | | | | | | | | | | |
| | Sp + p | Op | 6 | 125 | 750 | | | | | | | |
| | lekë | 750 | 0.167 | 125.3 | | | | | **875.3** | **875.3** | 70 | 87.5 |
| | | | | | | | | | | | | **1032.8** |

*Po të shikohet nga analiza e kostos do të vëreni se çmimi është disa herë më i lartë sesa ai i preventivit për zërin B-1.7. Me këtë arsyetim janë pranuar si volume për transport materialesh deri në 10 km i volumeve të prishjeve. Në manualin e ri hyrë në fuqi për vitin 2025 do të gjeni se transporti vertikal dhe horizontal i sasive të prishjeve parashikohet nëpërmjet zërave 2.2 dhe 2.40.*

*Zëri B-1.4 Prishje suva ekzistuese muri*
*Për sa i takon këtij zëri punimesh në praktikën inxhinierike të punimeve të prishjeve është praktikë heqja e suvasë së mureve për të kontrolluar gjendjen e muraturës kur ajo nuk paraqet dëmtime të mëdha ose paraqet dëmtime lokale. Në objektin tonë pjesa më e madhe e muraturës kanë shfaqur dëmtime lokale të cilat kanë qenë të riparueshme, por duke qenë e nevojshme prishja e gjithë muraturës, por duke zbatuar praktikën inxhinierike të kontrollit paraprak të muraturës pas heqjes së suvasë është parë se dëmtimet ishin të patjetërsueshme për tërësinë e muraturës dhe jo vetëm për atë zonë lokale ku paraqitej dëmtimi. Kjo ndërhyrje ka qenë dhe pikë kyçe në rishikimin e projektit ku në projekt preventivin e ri nuk kemi kërkuar që të gjitha muret e parashikuara të prishen plotësisht pas kontrollit në vend që volumet e mureve pas observimit mund të shkonin në ndërhyrje të tjera. Duke ju falënderuar për bashkëpunimin kërkojmë rishikimin e akt konstatimit tuaj duke marrë parasysh arsyetimet e më sipërme. Me respekt "N" sh.p.k*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Referuar argumentimeve dhe komenteve të bëra nga Mbikëqyrësi OE "N" sh.p.k, në observacionin e projekt raportit të auditimit të kryer në Bashkinë Durrës, risqarojmë se: Në lidhje me pretendimet rreth zërit "Transport materiale ndërtimi deri në 10 km" çështja e kostove shtesë duhet të ishte marrë parasysh nga ana e Kontraktorit në ofertën e tij gjatë procesit të tenderimit si dhe gjatë procesit të rishikimit të preventivit të punimeve; pra pretendimet e Kontraktorit nuk kanë mbështetje ligjore, rrjedhimisht nuk do të merren në konsideratë. Në lidhje me pretendimet rreth zërit "B1.4 Prishje suva ekzistuese muri" Kontraktorit gjatë zbatimit të punimeve kryen sondazhe të muraturës së tullës dhe shikon nëse kjo muraturë është e degraduar ose jo, dhe këto sondazhe nuk e kalojnë 20% të sasisë së prishjeve suvatimeve, rrjedhimisht observacionet nuk do të merren në kosideratë.

**15.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Rikonstruksioni dhe riparimi i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Durrës, Njësitë administrative nr. 1,2,3,4,5, Sukth, Manëz"***, ku rezultoi se: - Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 588/17 prot., datë 05.04.2022, lidhur midis AK Bashkisë Durrës dhe Kontraktorit OE "E" sh.p.k Vlera e kontratës është 176,327,975 me TVSH. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 168 ditë nga data e njoftimit zyrtar të fillimit të punimeve në Bashkinë Durrës. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr. 588/55 prot., datë 15.07.2022, midis AK Bashkisë Durrës dhe Mbikëqyrësit të punimeve OE "G" sh.p.k, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2812/4. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 164/10 prot., datë 11.04.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi Ing.V.Z PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2061/1.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 15.07.2022 dhe kanë përfunduar me datë 06.03.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve (shkresa me nr. 588/82, datë 16.11.2022).

-Bashkëlidhur kontratës, administrohet një relacion teknik, në të cilën ndodhet "Ndarja e objekteve sipas kodit GIS", me 109 objekte, me numrat GIS përkatës. Në këtë relacion nuk është përcaktuar se në cilat nga 109 objektet, është menduar të bëhet ndërhyrje. Në përfudim të objektit konstatohet se është caktuar për të ndërhyrë në 65 pallate. Nga analiza e relacionit teknik hartuar nga Kontraktori dhe përcjellë nga Mbikëqyrësi i punimeve tek Bashkia Durrës, me shkresën nr. 588/72, datë 30.09.2022; konstatohet se janë përcaktuar për të ndërhyrë 65 objekte, nga të cilat 34 objekte me DS1, 23 objekte me DS2 dhe 8 objekte me DS3. Bashkëlidhur këtij relacioni është preventivi i ripunuar, me 65 objekte dhe me zërat e punes për secilin prej tyre, si dhe tabela e ndryshimit të volumeve, e nënshkruar nga Kontraktori dhe mbikëqyrësi i punimeve dhe i përcjellë nga titullari i Bashkisë, Drejtorisë ekonomike Bashkia Durrës, bashkëlidhur relacionit të punimeve për situacionin progresiv përfundimtar, me shkresën nr. 164/16, datë 06.06.2024 (dmth, miratuar pa shkresë të veçantë për miratim). Nga auditimi i aktkolaudimit, rezulton se

është ndërhyrë në 60 objekte, me të njëjtën vlerë dhe pa bërë një miratim sërish nga investitori, Bashkia Durrës. Nga krahasimi i dokumentacionit, konstatohet se nuk është punuar në objektet me GIS 26026, 25969, 26162 (për këtë objekt ka 2 situacione, që përkojnë me librezën e masave të objekteve me GIS 27427 dhe 27424), 27054 dhe 26141. Këto 5 objekte kanë të preventivuar zërat "Lyerje me bojë plastike" 2701 $m^2$, "Lyerje me bojë plastike me bazë akrelik, i jashtëm" 6927 $m^2$ dhe "Skeleri" 6026.4 $m^2$. Nga llogaritja me çmimet përkatëse për njësi (përkatësisht 120 lekë, 596 lekë dhe 320 lekë), vlera e objekteve të miratuara në të cilat nuk është punuar është 6,381,060 lekë.

-Sipas kontrollit të dosjes tekniko-ligjore të situacionit përfundimtar, projektit bazë dhe projekt-preventivit të rishikuar, lidhur me volumet e punes të situacionuara; rezultuan diferenca në volume të llogaritura jo në mënyrë korrekte. Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Tabela nr. 1

| Nr | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Vol. | Vlera |
| **A** | **Punime prishje** | | | | | | | |
| 7 | Transport materiale ndërtimi deri në 10 km | $m^3$ | 150 | 2,278 | 2,278 | 1,413 | 865 | 129,750 |
| **E** | **Punime shtresash** | | | | | | | |
| 24 | Lyerje me bojë plastike jashtë | $m^2$ | 596 | 144,745 | 147,745 | 146,712 | 593 | 353,428 |
| | | | | | | | **Total** | **483,178** |

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

**1. Zëri A.7. Transport materiale ndërtimi deri në 10 km.** Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 3620 $m^3$. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 2278 $m^3$. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 2278 $m^3$, i detajuar sipas zërave të prishjeve. Nga verifikimi i librit të masave, dhe i analizës së çmimit të zërave të prishjeve për tullat, me nr. analize 2.246, rezulton se volumi i transportit nuk duhet të ishte llogaritur për transportin e prishjes së mësipërme (865 $m^3$). Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1413$m^3$, ose 865$m^3$, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**2. Zëri E.24. Lyerje me bojë plastike jashtë.** Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 148,367 $m^2$. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 147745 $m^2$. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 147,745 $m^2$, i detajuar sipas 62 pallateve. Nga verifikimi i librit të masave, projektit të azhurnuar dhe verifikimi në terren rezulton se: Në pallatin me kod GIS 25407 janë situacionuar 553 $m^2$ sipërfaqe tepër, pasi janë marrë përmasat jo sipas projektit të azhurnuar në fasadën jugore, lindore dhe perëndimore. Në pallatin me kod GIS 23428 nuk është bërë zbritja e pjesës me alukobond në fasadën lindore me sasi 40 $m^2$.

Sa sipër është librezuar dhe situacionuar më shumë sasia prej 593 $m^2$, vlera e të cilës është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve. **Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punes të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën 483,178 lekë pa TVSH pa TVSH.** Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve OE "G" sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

**16.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Rikonstruksioni dhe riparimi i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Durrës, Njësitë administrative nr. 5 dhe Sukth, Rrashbull", Bashkia Durrës*** ku rezultoi se: - Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me n nr. 588/19 prot.,

datë 01.04.2022, lidhur midis AK Bashkisë Durrës dhe Kontraktorit BOE "R" sh.p.k & "G" sh.p.k Vlera e kontratës është 206,840,255.6 lekë me TVSH. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 168 ditë nga data e njoftimit zyrtar të fillimit të punimeve në Bashkinë Durrës. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr. 588/30 prot., datë 26.04.2022, midis AK Bashkisë Durrës dhe Mbikëqyrësit të punimeve OE "H" sh.p.k, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2720/5. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 588/81 prot., datë 14.11.2022, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria OE "X" sh.p.k, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1322/8. -Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se: Njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 08.04.2024. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 13.10.2022. - Preventivi është hartuar nga stafi inxhinierik i Bashkisë Durrës. Në dosje administrohet një projekt zbatimi jo i plotë, vetëm me detaje të përgjithshme të riparimit të mureve. Nuk ka planimetri, apo pamje të objekteve që do të rikonstruktohen, ku të jenë vendosur përmasat, me qëllim kontrollin e volumeve sipas situacionit.

**II.** Sipas kontrollit të dosjes tekniko-ligjore të situacionit përfundimtar, projektit bazë dhe projekt-preventivit të rishikuar, lidhur me volumet e punes të situacionuara; rezultuan diferenca në volume të llogaritura jo në mënyrë korrekte. Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

**1.** Në lidhje me zërin e punes *"Suvatim i jashtëm"* dhe zërin *"Rrjetë teli",* në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 48,000/52,000 $m^2$. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 79,360/ 87,790 $m^2$. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 79,360/ 87,790 $m^2$, i detajuar sipas pallateve. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se në pallatin me kod GIS 1182 është marrë gjatësia 166 ml nga 128 ml (ku 38 ml nuk është realizuar). Nga rillogaritja, volumi i këtyre dy zërave, janë respektivisht 78,810/87,280 $m^2$ ose 510 $m^2$ më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht Kontraktori i punimeve.

**2.** Sipas kontrollit të situacionit përfundimtar dhe librezave të masave vihet re se ka një mospërputhje midis sasive të zërave *"F.V rrjete plastike per suvatimet"* raportuar në sasinë 87,790 m2 me zërin *"Suvatim I jashtem i zakonshem mur tulle"* raportuar në sasinë 79,359.59 m2; diferenca prej 8,430.41m2 x 250 lekë/m2= 2,107,603 lekë pa TVSH do të konsiderohet si vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit të punimeve.

Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punes të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt ose punime të llogaritura jo sipas projektit të zbatimit, me pasojë **dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës** në vlerën **2,397,919 lekë pa TVSH.** Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve OE "H" sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

**17.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Riforcim i pallateve me kod gis 25759, 25583, 22842, 22243, 22248, 22866, 24812, 22707,25248, 22721, 24821, 22245, 22299", Bashkia Durrës*** rezultoi se: -Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 4990/16 prot, datë 15.08.2022, lidhur midis AK Bashkisë Durrës dhe Kontraktorit BOE "L" sh.p.k, & "U" sh.p.k & "S" sh.p.k dhe "S" sh.p.k Vlera e kontratës është 428,529,309 lekë me TVSH. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 224 ditë nga data e njoftimit zyrtar të fillimit të punimeve në Bashkinë Durrës. Për këtë objekt kanë ndodhur disa zgjatje të afateve sipas amendamenteve, Amendamenti i parë nr. 598/21, datë 08.05.2023, është kryer zgjatje afati të punimeve 90 ditë.

Amendamenti i dytë nr. 598/42, datë 26.07.2023, është kryer zgjatje afati të punimeve 80 ditë.

Amendamenti i tretë nr. 476/20, datë 29.04.2024, është kryer zgjatje të punimeve 80 ditë deri në Amendamenit i parë ka ndodhur për shkak të moslirimit të ambienteve nga familjarët dhe

bizneset, mospërputhjet e projektpreventivit me gjendjen faktike dhe vështirësive të hasura në shkëputjen e energjisë në objektet pallat. Amendamenit i dytë ka ndodhur për shkak të moslirimit të ambienteve nga familjarët dhe bizneset, rishikimit të projektit dhe mungesës së likuiditetit. Amendamenit i tretë ka ndodhur për shkak të moslirimit të ambienteve nga familjarët dhe bizneset dhe rishikimit të projektit konstruktiv në disa pallate.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr. 4990/26 prot., datë 29.09.2022, midis AK Bashkisë Durrës dhe Mbikëqyrësit të punimeve BOE "H" sh.p.k & "I" sh.p.k, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh respektivisht MK. 3730/1 dhe MK 2406/1. -Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 598/16 prot., datë 18.04.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi Ing. V.Z PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2061/1. -Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 30.09.2022 dhe kanë përfunduar me datë 28.06.2024, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentet e kontratës për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.
- Në dosjen e zbatimit administrohet Oponenca Teknike me shkresën nr. 1099/5, datë 21.07.2021 të Institutit të Ndërtimit, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6. Është bërë gjithashtu oponenca teknike për akt-ekspertizën e thelluar, e përcjellë nga Instituti i ndërtimit me shkresat nr. 1064/4 prot., datë 29.06.2021 dhe nr. 1099/5 prot., datë 21.07.2021, sipas të cilave objektet "Pallati i oficerëve në rrugën 17 Janari" dhe pallati nr. 1, Rruga "H.K", duhet ti nënshtrohen përforcimit dhe rikonstruksionit në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6.
- Nga auditimi i dosjes teknike, rezulton se me shkresat nr. 4990/29 prot., datë 12.10.2022 dhe 4990/32 prot., datë 07.11.2022, Bashkia Durrës ka kërkuar lirimin e sheshit të ndërtimit nga Policia Bashkiake dhe IMTV Durrës.
-Me shkresën nr. 306 Prot., datë 25.01.2023, Kontraktori i punimeve informon Mbikëqyrësin për pezullimin e punimeve në 5 pallate për shkak të mosshkëputjes së plotë të energjisë, kundërshtitë nga banorët për projektin e zbatimit, si dhe mospërputhje të projektit me faktin.
- Me shkresën e protokolluar me nr. 598 prot, datë 17.01.2023, mbikëqyrësi ka njoftuar investitorin për përfundimin e punimeve në pallatin me GIS 24812. Pas kësaj shkrese, Titullari i Bashkisë Durrës ka kërkuar heqjen e bonusit të qerasë.
- Me shkresën nr. 598/7, datë 24.02.2023, Bashkia Durrës, në vijim të kërkesave të mbikëqyrjes dhe banorëve, i ka kërkuar projektuesit "A" sh.p.k zgjidhjen e problematikave teknike për 8 pallate.
- Me shkresën e protokolluar me nr. 598/18 prot, datë 27.04.2023, mbikëqyrësi ka njoftuar investitorin për përfundimin e punimeve në pallatin me GIS 22299 dhe Gis 22721.
- Me shkresën nr. 598/31, datë 30.06.2023, Bashkia Durrës, në vijim të kërkesave të mbikëqyrjes dhe banorëve, i ka kërkuar projektuesit "A" sh.p.k zgjidhjen e problematikave teknike për pallatin me kod GIS 22245.
- Me shkresën nr. 598/26, datë 12.2023, Bashkia Durrës, është dorëzuar projekti i ripunuar nga projektuesi "A" sh.p.k zgjidhjen e problematikave teknike në pallatet me kod GIS 24812, 22721 dhe 22999.
- Me shkresën e protokolluar me nr. 598/38 prot, datë 21.07.2023, mbikëqyrësi ka njoftuar investitorin për përfundimin e punimeve në pallatet me GIS 25248 dhe Gis 22243.
- Pas kërkesës së mbikëqyrësit protokolluar me nr. 598/45, datë 03.08.2023 për pezullim të punimeve për shkak të problematikave teknike të pazgjidhura nga projektuesi dhe moslikuidimit të situacioneve, Bashkia Durrës, me shkresën nr. 598/53, datë 11.10.2023, ka miratuar pezullimin e pjesshëm të punimeve.
Me shkresën nr. 1715/2, datë 12.12.2023, Instituti i ndërtimit ka dërguar Oponencën teknike mbi projektin e ndryshuar të aktekspertizës së thelluar.

Pas kërkesave të njëpasnjëshme të mbikëqyrësit dhe Kontraktorit të punimeve, është hartuar procesverbali për punimet që shtohen dhe hiqen datë 27.12.2023, si dhe preventivi i ripunuar nga mbikëqyrësi dhe Kontraktori i punimeve. Ky procesverbal është i shoqëruar nga tabela e ndryshimeve "Punimet që hiqen dhe shtohen", ku janë shtuar/pakësuar 79,386,442.06 lekë, i miratuar nga titullari i Bashkisë Durrës dhe përfaqësuesi i projektueit ing. D.P.
- Me shkresën e protokolluar me nr. 3710/2 prot, datë 02.04.2024 të mbikëqyrësit të punimeve, është njoftuar për rifillim punimesh tek pallatet me Kod Gis 25759, 25583 dhe 22866.
Nga auditimi i dosjes teknike rezulton se nga Kontraktori i punimeve ka dorëzuar situacionin përfundimtar dhe librin e masave që i përket këtij situacioni, mbi të cilin është bërë edhe auditimi. Ky situacion nuk është i konfirmuar nga mbikëqyrësi i punimeve.

**II.** Sipas kontrollit të dosjes tekniko-ligjore të situacionit përfundimtar, projektit bazë dhe projekt-preventivit të rishikuar, lidhur me volumet e punes të situacionuara; rezultuan diferenca në volume të llogaritura jo në mënyrë korrekte. Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:
**1. Zëri Transport material ndërtimi deri në 10 km**. Për këtë zë pune, në librin e masave është llogaritur edhe volumi i prishjes së shtresave të betonit, soletave dhe murit të tullës, përkatësisht me nr analize 2.426/3 dhe 2.426, të cilat transportin e kanë të përfshirë në analizën e çmimit. Sa sipër, nga 8016 $m^3$ transport të situacionuar në total, sasia prej 6513 $m^3$, nuk duhej situacionuar e gjitha. Në këtë diferencë duhet të ishte marrë parasysh rreth 20% e sajë për transportin vertikal i cili nuk është përfshirë në analizën e çmimit. Për pasoj diferenca midis vlerës totalë dhe 20% të sajë duhet është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ose **3,764,560 lekë pa TVSH** .
**2. Zëri B-5.5. "Plintuse pllake grez, h=10 cm".** Nga verifikimi i librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimi në terren, rezulton se është situacionuar 9296 ml plintus pllaka grez me h=10 cm (nga të cilat 258 ml me çmim 200 lekë/ml, 2764 ml me çmim 250 lekë/ml dhe 6274 ml me çmim 350 lekë/ml), e cila nga verifikimi në terren rezulton të jetë h= 8 cm. Nga verifikimi i analizës së çmimit të këtij zëri pune, sipas manualit të çmimeve të ndërtimit për këtë zë rezulton se nënzëri *Plintuse pllaka grez h=10cm* përbën 40% të vlerës totale të zërit të punës. Konkretisht, sipas analizës 2.324/a, vlera totale e zërit të punës është 386.88 lekë, ndërsa vlera e materialit është 155 lekë, çka përfaqëson 40% të vlerës totale(155/386.88 = 40%).

| Nr. | Emërtimi | Tipi i kostos | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Transport auto mbi 10 km | Transport | t/km | 0.15 | 21.00 | 3.15 |
| 2 | Plintuse pllaka grez h=10cm | Material | ml | 1 | 150.00 | 150.00 |
| 3 | Kolle per pllaka | Material | kg | 0.2 | 25.00 | 5.00 |
| 4 | SP + P (paga bruto+kontributet) | Puntori | op | 0.35 | 484.90 | 169.71 |

Vlera përmbledhëse

| Puntori | Transport | Makineri | Materiale | Gjithsej | Shpenzime | Fitimi | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 169.71 | 3.15 | 0.00 | 155.00 | 327.86 | 26.23 | 32.79 | 386.88 |

Bazuar në këtë raport, për çdo pallat nxirret vlera reale e materialit për plintusin me h = 10 cm, në përputhje me çmimin e ofertuar. Për shembull, për pallatet me çmim të ofertuar 350 lek/ml, vlera e materialit llogaritet si më poshtë: 40% x 350 = 140 lekë. Kjo vlerë përfaqëson materialin për "Plintus pllakë grez, h = 10 cm" Ndërkohë, për "Plintus pllakë grez, h = 8 cm", vlera e materialit llogaritet proporcionalisht me trashësinë:
140 x 8/10 = 112 lekë. Si rrjedhojë, diferenca e çmimit të materialit ndërmjet plintusit me h = 10 cm dhe atij me h = 8 cm është : 140 – 112 = 28 lekë. Përfundimisht nëse aplkojmë këtë diferencë

për cdo pallatë do të kemi vlerën **234,730.08 lekë pa TVSH** të përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit.

**Sipas pallateve diferencat në volume janë si më poshtë: 1. Pallati GIS 24812**

**Zëri A-3.1. Prishje mur tulle pa pastrim.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se është marrë 160 ml gjatësia e murit MU 33, nga 6.8 ml që është në fakt. Ky mur është librezuar dhe situacionuar në sasinë 112.4 $m^3$ nga 4.8 $m^3$ (6.8 x 0.25 x 2.81), ose 107.6 $m^3$ më shumë. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **269,000 lekë** (107.6 $m^3$ x 2500 lekë/$m^3$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**Zëri B-5.1. Shtresë lustër çimento t=50 mm.** Nga verifikimi i librit të masave dhe situacionit përfundimtar, rezulton se janë librezuar 2598.72 $m^2$ dhe janë situacionuar 2765.52 $m^2$, ose 166.8 $m^2$ më shumë. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **91,740 lekë** (166.8 $m^2$ x 550 lekë/$m^2$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**Zëri B-5.4. Veshje shkallëve të brendshme me pllakë mermeri t=3 cm.** Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se është marrë gjatësia e pllakës 1.4 m, shkelja 0.35 m dhe lartësia (hapi) 0.20 m, ndërsa në fakt janë gjatësia e pllakës 1.3 m, shkelja 0.35 m dhe lartësia (hapi) 0.15 m. Nga rillogaritja volumi i këtij zëri është 14.88 $m^2$ më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **163,680 lekë** (14.88 $m^2$ x 11,000 lekë/$m^3$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**2. Pallati GIS 22245.**

**Zëri B-6.2. Suva brenda mur tulle.** Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se në katin bodrum -2.70 m, ky zë nuk është realizuar. Nga rillogaritja volumi i munguar i këtij zëri është 84 $m^2$. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **37,800 lekë** (84 $m^2$ x 450 lekë/$m^2$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**3. Pallati GIS 22707**

**Zëri B-6.1. Suva e zakonshme fasade.** Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se është marrë suvatim fasade edhe për kuotën -3.91, në sasinë 314 $m^2$, e cila në fakt nuk është kryer. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **314,000 lekë** (314 $m^2$ x 1000 lekë/$m^2$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**4. Pallati GIS 22842**

**Zëri B-1.5. Prishje suva tavani + Suva tavani + lyerje tavani.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se tavani i ballkoneve është marrë dy herë, një herë më sipërfaqe kati dhe një herë më vete. Nga rillogaritja volumi i munguar i këtij zëri është 420 $m^2$. Për pasojë, vlera e këtij volumi për të dy zërat prej **646,800 lekë** (420 $m^2$ x (450 + 740 + 350 lekë/$m^2$)) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**5. Pallati GIS 22243**

**Zëri B-5.4. Shtrim dhe veshje shkallë të brendshme me pllaka mermeri.** Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se shkallët janë shtruar me pllakë gres (11.5 $m^2$). Nga rillogaritja e volumit me çmimin e pllakës gres (2500 lekë/$m^2$) dhe jo të pllakës së mermerit (10500 lekë/$m^2$), rezulton që vlera prej **92,000 lekë** (11.5 $m^2$ x 8000 lekë/$m^2$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**6. Pallati GIS 22248**

**Zëri B-6.5. Suva strukturore me rrjet teli.** Nga verifikimi i librit të masave, projektit të azhurnuar dhe verifikimit në terren, rezulton se janë marrë sheshpushimet me perimetër 45 ml për tre katet, ndërkohë që është 23 ml për secilin kat. Nga rillogaritja volumi i munguar i këtij zëri është 200 $m^2$. Për pasojë, vlera e këtij volumi për të dy zërat prej **300,000 lekë** (200 $m^2$ x 1500 lekë/$m^2$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**7. Pallati GIS 22299**

**Zëri B-5.4. Shtrim dhe veshje shkallë të brendshme me pllaka mermeri.** Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se sheshpushimet dhe plintusat janë shtruar me pllakë gres (21.4 $m^2$). Nga rillogaritja e volumit me çmimin e pllakës gres (2000 lekë/$m^2$) dhe jo

të pllakës së mermerit (8500 lekë/$m^2$), rezulton që vlera prej **139,100 lekë** (21.4 $m^2$ x 6500 lekë/$m^2$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**9. Pallati GIS 22866**

**Zëri B-5.3. Shtresë me pllaka gres importi + suva solete + lyerje solete.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se në katin e parë dhe të dytë janë marrë përkatësisht 470 $m^2$ dhe 471 $m^2$, ndërkohë që e gjithë sipërfaqja e këtyre kateve është 409 $m^2$ (22.56 x 18.14 m). Sa sipër janë marrë më tepër 123 $m^2$ dhe vlera prej **295,200 lekë** (123 $m^2$ x (1700 +450 + 250 lekë/$m^2$)) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**11. Pallati GIS 25759**

**Zëri A-2.3 Mure b/a t=21-30 cm, C 25/30.** Nga verifikimi i librit të masave, rezulton se janë librezuar 123.82 $m^3$ volum pozitiv dhe 5.71 $m^3$ volum i zbritshëm (hapësirat), i cili nuk është zbritur.. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **85,500 lekë** (5 $m^3$ x 17,000 lekë/$m^3$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**Zëri B-11. Parapet shkalle e ballkone me tuba inoxi.** Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se volumi i këtij zëri nuk është kryer. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **237,600 lekë** është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**12. Pallati GIS 25583**

**Zëri A-2.3. Përforcim mure me torkret.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se në anën jugore është marrë dy herë volumi prej 5.9 $m^3$. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **165,200 lekë** (5.9 $m^2$ x 28000 lekë/$m^2$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punes të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt ose punime të llogaritura jo sipas projektit të zbatimit, me pasojë **dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës** në vlerën **6,945,267 lekë pa TVSH.** Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve BOE "H" sh.p.k & "I" sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

**18.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***“Rionstruksioni i hapësirave publike në bllokun e banimit në Lagjen nr. 17 dhe tek Muzeu i dëshmorëve”, Bashkia Durrës*** ku rezultoi se: - Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 4002/19 prot., datë 02.09.2022, lidhur midis AK Bashkisë Durrës dhe BOE "L" sh.p.k & "N" sh.p.k Vlera e kontratës është 66,276,473 lekë me TVSH. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 70 ditë nga data e njoftimit zyrtar të fillimit të punimeve në Bashkinë Durrës. Pas kërkesave të mbikëqyrësit të punimeve me shkresën nr. 4002/47, datë 29.12.2022, me shkresën nr. 4002/48, datë 30.12.2023 (e cila nuk administohet në dosjen teknike) është bërë amendamenti për shtyrje afati të punimeve me 20 ditë. -Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr. 4002/30 prot., datë 31.10.2022, midis AK Bashkisë Durrës dhe Mbikëqyrësit të punimeve OE "H" sh.p.k, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3730/2. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 850/2 prot., datë 24.02.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi Ing. "M" PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2061/1.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 27.01.2023. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 27.01.2023. Me shkresën nr. 150 prot., datë 12.11.2022, mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar rishikimin e projektin e ujitjes. Me procesverbalin datë 12.12.2022, i mbajtur nga Kontraktori i punimeve, Mbikëqyrësi dhe Drejtori i Projekteve dhe infrastrukturës publike, z. A.T dhe miratuar nga titullari i Bashkisë Durrës znj. E.S., është miratuar rikonceptimi i projekt preventivit, duke miratuar 9 zëra të rinj. Në dosje mungojnë certifikatat e tregut për materialet kryesore, si pllaka guri Trani, rezI., etj.

**II.** Sipas kontrollit të dosjes tekniko-ligjore të situacionit përfundimtar, projektit bazë dhe projekt-preventivit të rishikuar, lidhur me volumet e punes të situacionuara; rezultuan diferenca në volume të llogaritura jo në mënyrë korrekte. Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

- Në analizën e çmimit të zërit "Konstruksione metalike të përbëra" është marrë çmimi 111,741 lekë/ton më i lartë së ai i manualit me nr. 2.181 an. dhe nga rillogaritja rezulton një diferencë në vlerën **234,656 lekë pa TVSH,** vlerë e cila nuk duhej situacionuar dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Durrës.

Tabela nr. 1

| Nr | | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Vol. | Vlera |
| | **A** | **Punime prishje dhe gërmimi** | | | | | | | |
| 1 | 9 | Prerje bimë të vogla 10 cm | $m^2$ | 150 | 1500 | 1500 | 0 | 1500 | 225,000 |
| | **B** | **Punime shtresash** | | | | | | | |
| 2 | 4+5 | Shtrsë çakulli 15 cm + stabilizant 10 cm | $m^2$ | 450 (270+180) | 2600 | 2604 | 2370 | 230 | 103,500 |
| 3 | 8.1 | FV pllaka guri Trani, me t=5 cm | $m^2$ | 9957 | 1642 | 1642 | 1483 | 159 | 1,583,163 |
| 4 | 8.8 | F.V e rrethimit deri ne 2.5m me rrjete metalike | $m^2$ | 1700 | 400 | 400 | 376 | 24 | 40,800 |
| | | **Total** | | | | | | | **1,952,463** |

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

**A. Punime prishje dhe gërmimi**

**1. Zëri 9. Prerje bimë të vogla 10 cm.** Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 1500 $m^2$. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 1500 $m^2$. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1500 $m^2$, i detajuar sipas 5 zonave tek treni. Nga verifikimi i librit të masave rezulton se në sipërfaqet e këtyre 5 zonave është situacionuar zëri "Prishje strukture prej betoni", me trashësi t= 20 cm. Për këtë arsye, ky zë nuk duhej librezuar dhe situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori.

**B. Punime shtresash**

**2. Zëri 4+5. Shtresë çakulli t=15 cm + stabilizant t=10 cm.** Në preventivin bazë sasia e këtyre zërave pune është 2600 $m^2$. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, këta zëra pune figurojnë në sasinë 2600 $m^2$. Në librin e masave volumi i tyre është 2604 $m^2$, i detajuar sipas trotuareve tek Muzeu dhe zonave tek treni. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren rezulton se sipërfaqja "Rrugica para lokaleve ana e djathtë", me sipërfae 234 $m^2$, është marrë dy herë. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 2370 $m^2$, ose 230 $m^2$, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori**.**

**3. Zëri 8.1. FV pllaka guri Trani, me t=5 cm.** Në preventivin bazë sasia e këtyre zërave pune është 1750 $m^2$. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, këta zëra pune figurojnë në sasinë 1642 $m^2$. Në librin e masave volumi i tyre është 1642.9 $m^2$, i detajuar sipas trotuareve tek Muzeu. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren rezulton se gjerësitë e të gjithë trotuareve dhe rrugicave për këtë zë pune, janë marrë duke përfshirë edhe bordurat (32 cm më shumë për trotuaret që kanë bordura 20x22 cm + 12x20 cm dhe 24 cm më shumë për rrugicat që kanë nga të dyja anët bordura 12 x 20 cm), Hapësirat e pemëve janë marrë 0.7 x 0.7 m, në vend të 0.9 x 0.9 m që është në fakt. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1482.7 $m^2$, ose 159 $m^2$, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga nga Kontraktori i punimeve..

**4. Zëri 8.8. F.V e rrethimit deri ne 2.5m me rrjete metalike.** Në preventivin bazë sasia e këtyre zërave pune është 800 $m^2$. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, këta zëra

pune figurojnë në sasinë 400 $m^2$. Në librin e masave volumi i tyre është 400 $m^2$, i detajuar sipas përmasave të fushës së basketbollit. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren rezulton se lartësia e rrethimit është marrë 5 m, nga 4.7 që është në fakt.. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 376 $m^2$, ose 24 $m^2$, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.
Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 2,187,119 lekë pa TVSH** Kontraktorit të punimeve, (1,952,463 lekë pa TVSH për punime të pakryera dhe diferenca në volume, si dhe 234,656 lekë pa TVSH për rritjen artificiale të çmimeve të zërave të rinj), vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.
Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punes të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt ose punime të llogaritura jo sipas projektit të zbatimit, **me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën 2,187,119 lekë pa TVSH.**
Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve OE "H" sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

**19.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Riforcimi i pallateve me kod GIS 20590, 22363, 20402, 19065, 19659, 21258, 21167, 47053, 38776, 19068, 21281, 22369, riforcimi i banesës individuale në NjA Manëz të X.S", Bashkia Durrës*** ku rezultoi se: - Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 4981/14 prot., datë 15.08.2022, lidhur midis AK Bashkisë Durrës dhe Kontraktorit OE "G" sh.p.k Vlera e kontratës është 409,898,699 lekë me TVSH. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 224 ditë nga data e njoftimit zyrtar të fillimit të punimeve në Bashkinë Durrës. Me shkresën nr. 1023/9, datë 08.05.2023 është bërë amendamenti i parë për zgjatje afati të punimeve me 90 ditë, pas kërkesës së mbikëqyrësit të punimeve për zgjidhjen e problematikave të dala në objekt, me nr. 79 prot., datë 03.05.2023, argumentuar me pengesat nga banorët për zbatimin e punimeve, mospërputhje të projekt-preventivit me faktin, spostimit të matësve, mungesës së lejes së ndërtimit dhe mungesës së likuiditetit. Me shkresën nr. 1023/14, datë 31.07.2023 është bërë amendamenti i dytë për zgjatje afati të punimeve me 90 ditë, pas kërkesës së mbikëqyrësit të punimeve për zgjidhjen e problematikave të dala në objekt, e protokolluar me shkresën me nr. 1023/11, datë 21.07.2023, në argumentuar me pengesat nga banorët për zbatimin e punimeve, spostimit të depozitave të ujit nga tarracat dhe mungesës së likuiditetit. Me shkresën nr. 1023/22, datë 13.11.2023 është bërë amendamenti i tretë për zgjatje afati të punimeve me 90 ditë, pas kërkesës së mbikëqyrësit të punimeve për zgjidhjen e problematikave të dala në objekt, me shkresën nr. 156, datë 01.11.2023, në lidhje me pengesat nga banorët për zbatimin e punimeve, spostimit të linjave të OSHEE-së dhe mungesës së likuiditetit. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr. 4981/21 prot., datë 29.09.2022, midis AK Bashkisë Durrës dhe Mbikëqyrësit të punimeve BOE "H" sh.p.k & "I" sh.p.k, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3730/2. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 433/5 prot., datë 08.02.2024, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi ing. V.Z, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2061/1. - Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 05.10.2022 dhe kanë përfunduar me datë 01.02.2024, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentet e kontratës. - Pas kërkesës së mbikëqyrësit protokolluar me nr. 1023/23, datë 19.12.2023 për pezullim të punimeve për shkak të problematikave teknike të pazgjidhura në objektin me GIS 20590, Bashkia Durrës, me shkresën nr. 433/1, datë 17.01.2024.2023, ka miratuar pezullimin e pjesshëm të punimeve. Me shkresën e protokolluar me nr. 433/6 prot, datë 11.04.2024 të Kontraktorittë punimeve, është njoftuar për rifillim punimesh tek pallatet me Kod Gis 20590 dhe 21548. Me shkresën e protokolluar me nr. 433/8 prot, datë 08.05.2024, mbikëqyrësi ka njoftuar

investitorin për përfundimin e punimeve në pallatet me GIS 22363, 19065, 47053, 21281 dhe banesa individuale në NjA Manëz të X.S.

**II.** Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin "Ndërhyrje riparim në kopshte dhe shkolla, Bashkia Durrës " u konstatuan disa parregullsi dhe mangësi sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr | Zëri I punes | Njesia | Sasia | Vlera |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Transport material ndërtimi deri në 10 km | $m^3$ | 6215 | 4,240,500 |
| 2 | Plintuse pllake grez, h=10 cm, çmimi | ml | 7,332 | 146,640 |
| 3 | Dyer të blinduara | $m^2$ | 14 | 210,000 |
| 5 | Sipas pllateve në total | | | 2,573,480 |
| | **Dëmi ekonomik në total** | | | **7,170,620** |

**1. Zëri Transport material ndërtimi deri në 10 km**. Për këtë zë pune, në librin e masave është llogaritur edhe volumi i prishjes së shtresave të betonit, soletave dhe murit të tullës, përkatësisht me nr analize 2.426/3 dhe 2.426, të cilat transportin e kanë të përfshirë në analizën e çmimit. Vlera e sasisë totale prej 6215 $m^3$ është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori.

**2. Zëri B-5.5. Plintuse pllake grez, h=10 cm.** Nga verifikimi i librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimi në terren, rezulton se është situacionuar 7,332 ml plintues pllaka grez me h=10 cm me çmim 150 lekë/ml, e cila nga verifikimi në terren rezulton të jetë h= 8 cm. Nga verifikimi i analizës së çmimit të këtij zëri pune, sipas manualit (2.324/a), rezulton se çmimi i nënzërit material në këtë zë pune, është 65 % e të gjithë zërit të punes. Nga rillogaritja, çmimi i këtij zëri pune është përkatësisht 130 lekë/ml (65% x 150 lekë/ml x 8cm/10cm + 35 % x 150 lekë/ml), ose 20 lekë/ml më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 20 lekë/ml (për sasinë e plintuseve prej 7,332 ml), **146,640 lekë pa TVSH** është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**3. Zëri B-7.2. FV dyer të blinduara.**

Nga verifikimi i librit të masave, situacionit përfundimtar dhe procedurës së negociimit të çmimeve, rezulton se në pallatin me kod gis 20590 është situacionuar 14 m2 dyer të blinduara, me çmim 42,000 lekë/$m^2$, e cila nga shkresa me nr. 433/5, datë 27.03.2024, rezulton të jetë miratuar me çmimin 2, me çmim 27,000 lekë/$m^2$, ose 15,000 lekë/$m^2$ më pak se çmimi i situacionuar.

Pra sipas përllogaritjes sasia 14m2x15000=**210,000 lekë, është vlerë e përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve. Sipas pallatave diferencat në volume janë si më poshtë:**

**1. Pallati GIS 20590**

**Zëri A-3.2. FV hekur betoni me d>10 mm.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se është marrë janë marrë gabim peshat e hekurit me d=20 mm, përkatësisht nga 2.466 në 2.59 kg/ml, duke shtuar 0.42 ton (nga 14.66 ton në 15.08 ton). Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **43,680 lekë** (0.42 x 104,000 lekë/ton) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**2. Pallati GIS 19068**

**Zëri B-5.4. Veshje shkallëve të brendshme me pllakë mermeri t=3 cm.** Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se është marrë gjatësia e pllakës 1.5 m, shkelja 0.34 m dhe lartësia (hapi) 0.175 m, ndërsa në fakt janë gjatësia e pllakës 1.1 m, shkelja 0.32 m dhe lartësia (hapi) 0.15 m. Nga rillogaritja volumi i këtij zëri është 82.1 $m^2$, ose 12.9 $m^2$ më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **58,050 lekë** (12.9 $m^3$ x 4500 lekë/$m^2$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**Zëri A-2.5. Kolona b/a lidhëse 20 x 20 cm.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se në kuotat +2.88 dhe +5.76 është llogaritur lartësia e kolonës 5.16 m, nga 2.88 m. Nga rillogaritja, janë shtuar 8.4 $m^3$. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **100,800 lekë** (8.4 $m^3$ x 12,000 lekë/$m^3$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**3. Pallati GIS 21281**

**Zëri B-5.4. Veshje shkallëve të brendshme me pllakë mermeri t=3 cm.** Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se është marrë lartësia (hapi) 0.17 m, ndërsa në fakt është 0.145 m. Nga rillogaritja volumi i këtij zëri është 113 $m^2$, ose 5 $m^2$ më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **22,500 lekë** (5 $m^2$ x 4500 lekë/$m^3$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**4. Pallati GIS 19065**

**Zëri A-3.2. FV hekur betoni me d>10 mm.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se është marrë janë marrë gabim peshat e hekurit me d=20 mm, përkatësisht nga 2.466 në 2.59 kg/ml, duke shtuar 1.6 ton (nga 55.6 ton në 57.2 ton). Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **166,400 lekë** (1.6 x 104,000 lekë/ton) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**Zëri B-6.2. Suva brenda mur tulle.** Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se në katin bodrum -2.25 m, ky zë pune, në kolona dhe muret e ashensorit, nuk është realizuar. Nga rillogaritja volumi i munguar i këtij zëri është 84 $m^2$. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **155,000 lekë** (155 $m^2$ x 1000 lekë/$m^2$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**5. Pallati GIS 21167**

**Zëri A-3.2. FV hekur betoni me d>10 mm.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se për soletën është situacionuar 8.64 ton hekur me d=12 mm/ 10 cm. Konstatohet se janë 290 $m^2$ soletë x 20 ml hekur/$m^2$ x 0.888 kg/ml = 7150 kg, ose 1.49 ton më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **154,960 lekë** (1.49 x 104,000 lekë/ton) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**Zëri B-5.1. Suva e zakonshme fasade, mur tulle.** Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se gjatë llogaritjeve, nuk janë hequr sipërfaqet e dritareve. Nga rillogaritja volumi i munguar i këtij zëri është 37 $m^2$. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **40,700 lekë** (37 $m^2$ x 1100 lekë/$m^2$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**6. Pallati GIS 24402**

**Zëri B-5.4. Veshje shkallëve të brendshme me pllakë mermeri t=3 cm.** Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se është situacionuar volumi për të dy shkallët, ndërkohë që është realizuar vetëm në një shkallë. Nga rillogaritja volumi i këtij zëri është 53.85 $m^2$, ose 53.85 $m^2$ më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **242,325 lekë** (53.85 $m^3$ x 4500 lekë/$m^2$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**Zëri B-5.1. Suva e zakonshme fasade, mur tulle.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se në këtë zë pune është situacionuar edhe suva e brendshme, e cila është librezuar edhe si suva strukturore në të njëjtën sipërfaqe në këto akse:

Aksi 1-1 1x8.46x3.55=29.86m2

Aksi 2-2 1x16.99x3.53=59.97m2

Aksi 7-7 1x9.73x3.68 =35.8m2

Zbriten hapësira dritare 0.84m2+19.06=19.9m2

Total 125.63-19.9m2=105.73m2 e mbivendosur.

Nga rillogaritja volumi i këtij zëri është 1674.6 $m^2$, ose 345 $m^2$ më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e volumit të suvasë së zakonshme 105.73m2x1500l/m2 prej **158,595 lekë pa TVSH** është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**7. Pallati GIS 22369**

**Zëri A-3.1. FV hekur betoni me d= 5 mm për torkretim.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se sipërfaqja e torkretuar është 1278 $m^2$ (63.93 $m^3$/0.05 m trashësi). Në llogaritjen e peshës së rrjetës me d = 5 mm/çdo 15 cm, rezulton të jetë marrë sipërfaqja e mësipërme dy herë dhe volumi i hekurit 5.24 ton, ose 2.62 ton më shumë se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **296,470 lekë** (2.62 ton x 115,000 lekë/ton) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**8. Pallati GIS 22363**

**Zëri B-5.1. Suva e zakonshme fasade, mur tulle.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se lartësia e katit është marrë 20.43 m nga 19.43 m që është në fakt (3.59 kati përdhe + 15.84 katet e tjera + parapet). Nga rillogaritja volumi i këtij zëri është 1057 $m^2$, ose 41 $m^2$ më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e volumit të suvasë së zakonshme prej **61,500 lekë** (41 $m^2$ x 1500 lekë/$m^2$) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**9. Pallati GIS 21258**

**Zëri A-3.1. FV hekur betoni me d= 5 mm për torkretim.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se sipërfaqja e torkretuar është 1910 $m^2$ (95.5 $m^3$/0.05 m trashësi). Në llogaritjen e peshës së rrjetës me d = 5 mm/çdo 15 cm, rezulton të jetë marrë sipërfaqja e mësipërme dy herë dhe volumi i hekurit 8.335 ton, ose 4.167 ton më shumë se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **506,000 lekë** (4.167 ton x 115,000 lekë/ton) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**11. Pallati GIS 38766**

**Zëri A-3.1. FV hekur betoni me d= 5 mm për torkretim.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se sipërfaqja e torkretuar është 1319 $m^2$ (65.95 $m^3$/0.05 m trashësi). Në llogaritjen e peshës së rrjetës me d = 5 mm/çdo 15 cm, rezulton të jetë marrë sipërfaqja e mësipërme dy herë dhe volumi i hekurit 5.4 ton, ose 2.7 ton më shumë se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **310,500 lekë** (2.7 ton x 115,000 lekë/ton) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

**12. Pallati GIS 47053**

**Zëri A-3.1. FV hekur betoni me d= 5 mm për torkretim.** Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se sipërfaqja e torkretuar është 1120 $m^2$ (56 $m^3$/0.05 m trashësi). Në llogaritjen e peshës së rrjetës me d = 5 mm/çdo 15 cm. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1120 $m^2$ x 2.05 kg/$m^2$ = 2.3 ton, ose 3.2 ton më shumë se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi prej **256,000 lekë** (3.2 ton x 80,000 lekë/ton) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 7,170,620 lekë pa TVSH** Kontraktorittë punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.

Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve BOE "H" sh.p.k & "I" sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Mbikqyrësi i punimeve OE "H" sh.p.k, më datë 26.05.2026, të protokolluara në KLSH me nr. 1347/69 prot. datë 26.05.2026; shprehen pretendimet e tyre për projekt raportin e auditimi për objektin e mësipërm.

**Pretendimi i subjektit përmbledhurazi:**

*Bazuar në Projekt Raportin e Auditimit nr 1347/68 prot datë 15.05.2026, drejtuar Bashkisë Durrës mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Durrës në bazë të Programit të Auditimit nr 1347/1 datë 13.11.2024 i ndryshuar, pasi u njoftëm me materialin e mësipërm mbi disa diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga Autoriteti Kontraktor në objektin e mësipërm sqarojmë si më poshtë: 1- Transport materiale ndërtimi deri në 10 km.*

*Grupi i auditimit ka sqaruar se volumi i prishjes së shtresave të betonit, soletave, dhe të murit të tullës e kanë të përfshirë zërin transport të këtyre materialeve. Dhe si rrjedhojë sasia prej 6215 m3 në zërin transport të këtyre materialeve me vlerë 4.240.500 lekë është përcaktuar si vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana e kontraktorit shoqëria "G" sh.p.k Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve sqarojmë se kjo sasi 6215m3 është larguar nga objekti dhe është depozituar pranë shoqërisë "G" sh.p.k me NIPT "J77" e cila është pjesë e shoqërisë "G" sh.p.k Duke qenë se qyteti i Dr nuk ka landfill për grumbullimin e mbeturI.ve shoqëria ndërtuese i ka depozituar këto pranë pikës së vet ku sqaruam më sipër ku atje bëhet dhe riciklimi i tyre. Kjo largesi është 60km pra mbi 10 km.*

*Bashkangjitur këtij materiali janë dhe fotot që tregojnë vendin e depozitimit dhe shkarkimin e këtyre materialeve. Prandaj vlera prej 4.240.000 lekë nuk është vlerë e përfituar nga shoqëria kontraktuese "G" sh.p.k*

*2- Plintuse pllakë gres h=10cm sasia 14129 ml me vlerë 282.580 lekë.*

*Sipas kontrollit të situacionit përfundimtar dhe punimeve fakt grupi i auditimit ka konstatuar se lartësia e plintusit në objekt është 8cm dhe jo 10cm. Diferenca prej 20lekë/ml e nxjerrë nga llogaritja sipas përqindjes nga grupi i auditimit është e pranuar pjesërisht nga ana jonë pasi si të gjitha pallatet janë me h=8cm si e mëposhtme sqarojmë: pallati me kod gis 38766 ka 134 ml me h=10cm, pallati me kod gis 47053 ka 171ml me h=10cm, pallati me kod gis 22369 ka 1061ml me h=10cm, pallati me kod gis 22363 ka 734ml me h=10cm, pallati me kod gis 21258 ka 590ml me h=10cm, pallati me kod gis 21167 ka 505ml me h=10cm, pallati me kod gis 20402 ka 1002ml me h=10cm, pallati me kod gis 19659 ka 2600ml me h=10cm pra në total 6797ml me h=10cm. Diferenca prej 7332mlx20=146.640 lekë është e pranueshme nga mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve.*

*3- F.V dyer të blinduara. Sipas kontrollit të situacionit përfundimtar, librezës së masave dhe procedurës së negocimit të çmimeve për këtë zë, grupi i auditimit ka nxjerrë një diferencë 57m2x15.000 1/m2=855.000lekë/m2, vlerë kjo e përfituar nga kontraktori i punimeve. Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve e kundërshtoj diferencën e mësipërme si më poshtë sqaroj: Në pallatin me kod Gis 20590 nuk është e përfshirë zëri Dyer të blinduara. Duke qenë se ishte e domosdoshme vendosja e këtyre dyerve në këtë pallat u negociua me Bashkinë Durrës për çmimin e këtij zëri dhe u vendos 27.000lekë/m2. Sasia e vendosur në këtë pallat sipas librezës së masave dhe situacionit përfundimtar në këtë objekt është 14m2 dhe jo 57m2 siç është paraqitur nga grupi i auditimit. Më poshtë po paraqisim sasitë e zërit dyer blindato të ofertuara në preventiv sipas pallateve:*

- *Pallati me kod gis 38766, sasia 7.5 x15.000 lekë /m2e e ofertuar.*
- *Pallati me kod gis 19065, sasia 36.9m2x42.000 lekë/m2 e ofertuar.*
- *Pallati me kod gis 22369 sasia 2.1m2x42.000lekë/m2 e ofertuar.*
- *Pallati me kod gis 47053, sasia 2.1m2x27.000 lekë/m2 e ofertuar.*
- *Pallati me kod gis 21167, sasia 21m2x42.000lekë/m2 e ofertuar.*

*Pallatet e tjera 19068, 21258, 19659, 21281, X.S i kanë zero zërin Dyer blindato.*

*Pra siç shihet të gjitha pallatet kanë vlerat e tyre të ofertuara përveç pallatit me kod gis 20590. Duke qenë se çmimi i vendosur në negocim është 27.000lekë/m2 dhe jo 42.000 1/m2 siç është situacionuar është krijuar një diferencë prej 15.000lekë/m2 në çmim.*

*Pra sipas përllogaritjes sasia 14m2x15000=210.000 lekë, është vlerë e pranuar nga ana jonë.*

*4- Në pallatin me kod gis 20590 grupi i auditit ka nxjerrë një diferencë në zërin F.V hekur ndërtimi d>10mm për shkak të diferencës së peshës së hekurit d=20mm, përkatësisht 2.4666kg/ml në 2.59 kg/ml. Kjo diferencë është 0.42 ton x104.000lekë/ton =43.680 lekë. Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve nuk e pranojmë këtë diferencë pasi sipas manualit të ndërtimit që i është bashkangjitur dhe këtij materiali për zërin hekur d=20mm pesha specifike është 2.59kg/ml. Këtë fakt e tregon dhe fleta shoqëruese e hekurit që vjen nga importi Turqia, ku janë të përcaktuara edhe peshat specifike të hekurit sipas diametrave të tyre. Pra vlera prej 43.680 lekë nuk pranohet nga ana jonë.*

*5- Në pallatin me kod gis 19068 grupi i auditimit ka nxjerrë një dëm ekonomik prej 158.850 lekë dhe konkretisht në zërat e mëposhtme:*

*1- "Veshje shkalle të brendshme me pllakë mermeri t=3cm. Nga verifikimi i librezës së masave me gjendjen fakt në objekt grupi i auditimit ka rezultuar se diferenca në gjatësinë e pllakës nga 1.5 në 1.1 se diferencë në shkelje nga 0.34m në 0.32m dhe hapi nga 0.175m në 0.150m, ku diferenca e krijuar është 12.9m2x4500l/m2=58.050.lekë/m2. Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve pasi rikontrolluam librezën sipas këtyre ndryshimeve e pranojmë diferencën prej 58.050 lekë si vlerë e përfituar nga Kontraktori i punimeve.*

*6- Kolona b/a lidhëse 20x20cm. Nga verifikimi i librezës së masave dhe projektit të azhornuar grupi i auditimit ka vënë re diferenca në volumet e betonit për arsye të llogaritjes së lartësisë nga 5.16m në 2.88m fakt. Si pasojë sasia prej 8.4m3x12.000lekë/m3=100.800lekë, vlerë e përfituar nga kontraktori i punimeve. Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve pasi rikontrolluam librezën sipas këtyre ndryshimeve e pranojmë diferencën prej 100.800 lekë si vlerë e përfituar nga Kontraktori i punimeve.*

*7- Pallati me kod gis 21281 grupi i auditimit ka nxjerrë dëm ekonomik 178.900lekë dhe konkretisht si më poshtë:*

*- Zëri Përforcim kollone b/a. Nga kontrolli i librezës së masave me projektin e azhornuar grupi i auditimit ka rezultuar se në librezë janë paraqitur 55 kollona K2 kur në fakt janë 47 kollona, duke nxjerrë një diferencë 9.2m3 beton x17.000l/m3 si vlerë e përfituar padrejtësisht nga Kontraktori.*

*Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve pasi rikontrolluam librezën dhe projektin në azhornim konstatuam që sasia e kollonave të paraqitur në librezë janë 74 copë kurse në projekt të azhornuar janë 77 copë. Pra nga ana e kontraktorit nuk janë situacionuar dhe 3 kollona betoni në sasi prej 5.9 m3x17.000l/m3= 100.300lekë. Pra për sa sqaruam më sipër sasia 9.2x17.000 l/m3=156.400.lekë nuk është vlerë e përfituar nga ana jonë.*

*8- Veshje e shkalleve të brendshme me pllakë mermeri t=3cm*

*Nga verifikimi i librezës së masave me gjendjen fakt në objekt grupi i auditimit ka vënë re diferenca në lartësi hapi nga 0.17m në 0.145m, ku diferenca e krijuar është 5m2x4500l/m2=22.500.lekë/m2.*

*Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve pasi rikontrolluam librezën sipas këtyre ndryshimeve e pranojmë diferencën prej 22.500 lekë si vlerë e përfituar nga Kontraktori i punimeve.*

*9- Pallati me kod Gis 19065 grupi i auditimit ka nxjerrë një dëm ekonomik prej 321.400 lekë dhe konkretisht në zërat e mëposhtme:*

*- Në pallatin me kod gis 19065 grupi i auditit ka nxjerrë një diferencë në zërin F.V hekur ndërtimi d>10mm për shkak të diferencës së peshës së hekurit d=20mm, përkatësisht 2.4666kg/ml në 2.59 kg/ml. Kjo diferencë është 1.6 ton x104.000lekë/ton =104.000.lekë.*

*Unë mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori i punimeve nuk e pranojmë këtë diferencë pasi sipas manualit të ndërtimit që i është bashkangjitur dhe këtij materiali për zërin hekur d=20mm pesha specifike është 2.59kg/ml. Këtë fakt e tregon dhe fleta shoqëruese e hekurit që vjen nga importi Turqia, ku janë të përcaktuara edhe peshat specifike të hekurit sipas diametrave të tyre.*

*Pra vlera prej 104.000 lekë nuk pranohet nga ana jonë.*

*- Suva brenda mur tulle. Nga verifikimi i librezës së masave dhe verifikimi në terren rezulton se në kuoten -2.25 në katin bodrum nuk është realizuar ky zë në kolona dhe muret e ashensorit, duke përfituar kështu 155m2x1000l/m2=155.000.lekë/m2.*

*Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve pasi rikontrolluam dhe njëherë punimet në këtë objekt për këtë zë nuk e pranojmë diferencën prej 155.000 lekë pasi këto punime janë kryer nga kontraktori.*

*10- Pallati me kod Gis 21167 grupi i auditimit ka nxjerrë një dëm ekonomik prej 195.660 lekë dhe konkretisht në zërat e mëposhtme:*

*- F.V hekur betoni d>10mm. Nga verifikimi i librezës së masave dhe projektit të azhornuar grupi i auditit ka vërejtur se për soletën janë situacionuar 8.64ton hekur në d=12mm/10cm. Sipas llogaritjeve grupi i auditit konstaton se 290m2 solete x 20mlhekur/m3x0.888 pesha specifike kg/ml për hekurin 12 =7155kg ose 1.49ton hekur më pak se ai i situacionuar, dhe si pasojë vlera e këtij volumi është 1.49tonx104.000 lekë/ton =154.960lekë si vlerë e përfituar nga kontraktori.*

*Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve e kundërshtoj këtë vlerë si më poshtë sqaroj.*

*Sipas manualit të ndërtimit bashkangjitur këtij materiali sasia e hekurit për 1m2 beton solete shkon 25-40kg/m2 dhe jo 20 siç është paraqitur lart. Gjithashtu pesha e hekurit kg/ml për d=12 mm sipas manualit është 0.932 kg/ml dhe jo 0.888kg/ml. Duke bërë llogaritjet 290m2 solete x32kg/m2x0.932 kg pesha specifike =8649 kg /m2 ose 8.64 ton. Pra siç sqaruam nuk ka diferenca në zërin hekur ndërtimi d>10mm. Pra vlera 154.960 lekë nuk pranohet nga ana jonë.*

*- Suva e zakonshme fasade mur tulle. Nga ballafaqimi i librezës së masave me punimet fakt në objekt nga grupi i auditimit është rezultuar se nuk janë hequr në librezë hapësirat e dritareve. Nga rillogaritja volumi prej 37m2x1100lekë/m2 është vlerë e përfituar nga Kontraktori i punimeve.*

*Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve e pranoj pjesërisht këtë vlerë si më poshtë sqaroj:*

*Në librezën e masave nuk është paraqitur shpatullimi i dritareve 20copë(1.43x1.3). Pas rillogaritjes së shpatullimeve të dritareve kemi rezultatin 20x4.03x0.1=8.06m3. Nga përllogaritja sasia e përfituar nga kontraktori është 37-8.06=28.94m2. 28.94m2x1100=31.834lekë. Pra vlera e pranuar nga ana jonë është 31.834 lekë.*

*11- Pallati me kod gis 20402, grupi i auditimit ka nxjerrë një dëm ekonomik prej 759.825 lekë dhe konkretisht në zërat e mëposhtme:*

*- Veshje shkalleve të brendshme me pllakë mermeri t=3cm. Nga ballafaqimi i librezës së masave me punimet fakt në objekt është rezultuar se në këtë objekt është realizuar vetëm një shkallë. Nga rillogaritja volumi prej 53.85 m2 x4500l/m2=242.325lekë është vlerë e përfituar nga Kontraktori. Kjo vlerë prej 242.325 lekë është e pranuar nga ana jonë.*

*- Suva fasade e zakonshme mur tulle. Nga ballafaqimi i librezës së masave me projektin e azhornuar grupi i auditit ka konstatuar se në 345m2 është situacionuar edhe tek zëri suva fasade e jashtme dhe si suva e brendshme e cila është librezuar si suva strukturore duke shkaktuar një dëm prej 345m2x1500l/m2= 517.500l/m2.*

*Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve e pranoj pjesërisht këtë vlerë si më poshtë sqaroj:*

*Nga rikontrolli i librezës së masave në zërin "Suva fasade e zakonshme mur tulle" kemi mbivendosje vetëm në këto akse:*

*- Aksi 1-1 1x8.46x3.55=29.86m2*

*- Aksi 2-2 1x16.99x3.53=59.97m2*

*- Aksi 7-7 1x9.73x3.68 =35.8m2*

*- Zbriten hapësira dritare 0.84m2+19.06=19.9m2*

*- Total 125.63-19.9m2=105.73m2 e mbivendosur.*

*Pra sasia prej 105.73m2x1500l/m2=158.595 vlerë e pranuar nga ana jonë.*

*12- Pallati Gis 22369, grupi i auditimit ka nxjerrë një dëm ekonomik prej 297.470 lekë dhe konkretisht në zërat e mëposhtme:*

*- F.V hekur betoni d=5mm për tokëtim. Nga verifikimi i librezës së masave me projektin e azhornuar rezulton se sipërfaqja e tokëtuar është 1278m2(63.93m3/0.05m trashësi). Llogaritja e peshës së hekurit d=5mm/15cm për këtë sipërfaqe rezulton sipas librezës (2.62x2)=5.24 ton. Sipas grupit të auditit sasia prej 2.62 ton x115.000lekë/ton =296.470 lekë është e përfituar padrejtësisht nga Kontraktori.*

*Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve nuk e pranojmë këtë vlerë pasi po të shohim projektin e azhornuar sipërfaqja e tokëtimit është realizuar me dopjo zgare d=5mm, jo tek zgare. Prandaj dhe sasia e hekurit është dyfishuar nga 2.62 në 5.24 ton hekur.*

*Për sa sqaruam më sipër vlera prej 296.470 lekë nuk pranohet nga ana jonë.*

*13- Pallati me kod gis 21258 grupi i auditimit ka nxjerrë një dëm ekonomik prej 506.000 lekë dhe konkretisht në zërat e mëposhtme:*

*- F.V hekur betoni d=5mm për tokëtim. Nga verifikimi i librezës së masave me projektin e azhornuar rezulton se sipërfaqja e tokëtuar është 1910m2(95.5m3/0.05m trashësi). Llogaritja e peshës së hekurit së rrjetës d=5mm/15cm për këtë sipërfaqe rezulton sipas librezës (4.167x2)=8.335 ton. Sipas grupit të auditit sasia prej 4.167 ton x115.000lekë/ton =506.000 lekë është vlerë e përfituar padrejtësisht nga Kontraktori.*

*Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve nuk e pranojmë këtë vlerë pasi po të shohim projektin e azhornuar sipërfaqja e tokëtimit është realizuar me dopjo zgare d=5mm, jo tek zgare. Prandaj dhe sasia e hekurit është dyfishuar nga 4.167ton në 8.335 ton hekur.*

*Për sa sqaruam më sipër vlera prej 506.000 lekë nuk pranohet nga ana jonë.*

*- Suva brenda mur tulle. Nga verifikimi i librezës së masave me projektin e azhornuar grupi i auditit ka rezultuar se sasia e zbritshme e dyerve është bërë vetëm 1 herë në të dyja anët, vlera e volumit është 302.4m2 x1000 l/m2 =302.400.lekë është përfituar nga kontraktori padrejtësisht.*

*Unë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve nuk e pranojmë këtë vlerë pasi po të shohim librezën e masave për zërin "Suva brenda mur tulle" janë zbritur 604.8m2 dyer të brendshme dhe të jashtme.*

*Po të shohim librezën e masave dhe situacionin përfundimtar për zërin dyer të brendshme sasia është 144m2 x2 ane =288m2, dyer blindato janë 44m2 x2 ane =88m2 pra 288+44=376m2. Pra siç shihet kemi hequr më shumë hapësira dyer në librezën e masave rreth 228.8m2 të cilat nuk i kemi situacionuar nga ana jonë. Për sa sqaruam më sipër vlera prej 302.400 lekë nuk pranohet nga ana jonë.*

*Për sa mësipër vlera e pranuar nga ana jonë është:*

*146.640+210.000+58.050+100.800+22.500+31.834+242.325+158.595= 970.744.lekë.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Referuar argumentimeve dhe komenteve të bëra nga Mbikëqyrësi OE "H" sh.p.k, në observacionin e projekt raportit të auditimit të kryer në Bashkinë Durrës, sqarojmë se: Pasi pamë me kujdes

materialet dhe argumentet e sjella nga Mbikëqyrësi vihet re se ky obervacion është i njëjtë me observacioni ndaj akteve të konstatimit pra observacionet e sjella nuk shfaqin fakte dhe prova të reja ato nuk janë të shoqëruara me fakte dhe argumente bindëse, nuk kanë mbështetje teknike – ligjore, rrjedhimisht nuk do të merren në konsideratë.

**20.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Sukth", Bashkia Durrës,*** ku rezultoi se: -Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr.1865/54 prot., datë 01.06.2023, lidhur midis AK Bashkisë Durrës dhe Kontraktorit OE "K" sh.p.k Vlera e kontratës është 12,492,900 lekë me TVSH. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 21 ditë nga data e njoftimit në Bashkinë Durrës. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr. 1867/2 prot., datë 21.06.2023, midis AK Bashkisë Durrës dhe Mbikëqyrësit të punimeve OE "A" sh.p.k, me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2892/8. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit janë caktur nga AK inxhinierët E.K, dhe M.S. -Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 13.07.2023. Për këtë objekt kanë përfunduar brenda afateve kontraktuale, njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 03.08.2023.
Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin "Ndërhyrje riparim në kopshte dhe shkolla, Bashkia Durrës " u konstatuan disa parregullsi dhe mangësi sipas tabelës së mëposhtme:
-Në lidhje me zërin e punes *"Mbushje me çakëll, përhapur e ngjeshur me makineri (t=10cm) për banikI.t",* sipas rrugëve respektive u konstatua se ky ze pune ishte kryer pjesërisht dhe jo në të gjithë pjesën e bankinës. Rrjedhimisht vlera 127m3x1,000 lekë/m3= **127,000 lekë pa TVSH do të konsiderohet si dëm ekonomik. Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën 127,000 lekë pa TVSH.**
Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve OE "A" sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

**21.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Rrashbull", Bashkia Durrës*** ku rezultoi se: - Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 2626/9 prot., datë 28.01.2024, lidhur midis AK Bashkisë Durrës dhe Kontraktorit OE "K" sh.p.k Vlera e kontratës është 5,661,000 lekë me TVSH. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 18 ditë nga data e njoftimit në Bashkinë Durrës. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr.1867/2 prot., datë 21.06.2023, midis AK Bashkisë Durrës dhe Mbikëqyrësit të punimeve OE "P" sh.p.k, me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3492/1. -Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 522/4 prot., datë 21.02.2024, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria OE "B" sh.p.k, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2205/5. -Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 11.01.2024. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 28.01.2024.
**II.** Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren u konstatuan disa parregullsi dhe mangësi si më poshtë:
-Në lidhje me zërin e punes *"Shtresë asfaltobetoni me zall lavatrice, 4cm",* ky zë pune i librezuar në sasinë 2,954m2 nuk përputhet me sasinë e librezuar 2906m2 të zërit "*Shtresë binderi me zall*

*lavatrice 6 cm".* Diferenca prej 44m2 x 800lekë/m2 =35.200 lekë pa TVSH do të konsiderohet si vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit të punimeve.
-Gjithashtu u konstatua se në një pjesë të rrugës nuk ishte respektuar gjerësia e sajë referuar librezave të masave, me një diferencë prej 40 m2 e cila llogaritet në vlerën:
40 m2 x 1680 lekë/m2(880 binder+800 asfalt)=67,200 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik. **Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën 102,400 lekë pa TVSH.**
Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve OE "P" sh.p.k, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

## 2.5. Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikim zhvillim territorit.

Këshilli Kombëtar i Territorit në mbledhjen e datës 27.07.2022 ka miratuar Vendimin Nr. 4, "*Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Durrës*", në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Plan i Përgjithshëm Vendor ka hyrë në fuqi në momentin e botimit në Regjistrin e Integruar të Territorit më datë 15.02.2023.
Lejet e ndërtimit të cilat janë miratuar përpara hyrjes në fuqi të Planit të Përgjithshëm Vendor, bazohen në Planin e Përgjithshëm ekzistues të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendimin Nr. 27, datë 10.05.2013 "*Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës*", si dhe duke ju referuar VKM-së 502, datë 13.07.2011,"*Për miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*". Ndërsa zonat të cilat zhvillohen jashtë kufirit të planit ekzistues, janë bazuar në VKM-në 408, datë 13.05.2015, për "*Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar dhe Ligjit 107/ 2014, datë 31.07.2014, për "*Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar.

Auditimi konsiston në këto fusha:
*1.Dhënia e lejes së zhvillimit dhe përputhshmëria me kondicionet urbane të përcaktuar sipas Planit të Përgjithshme Vendore dhe Planeve të Detajuara Vendore*
*2.Dhënia e lejes së ndërtimit, plotësimi i të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e lejes, përputhshmëria me kondicionet urbane të përcaktuar dhe me lejen e zhvillimit*
*3.Saktësia e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë*
*4.Dhënia e çertifikatës së përdorimit*
*5.Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik*

- **Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit të miratuara për periudhën 2023 – 2024**

Duke ju referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Durrës, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 31.12.2023 janë miratuar **156 leje zhvillimi**, **35 leje** ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 $m^2$, **46 leje ndërtimi** me sipërfaqe deri në 250 $m^2$, **3 leje ndërtimi** për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 $m^2$, **12 leje ndërtimi** për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 $m^2$, **63 çertifikata përdorimi**, **401 deklarata paraprake** për kryerje punimesh dhe **6 leje infrastrukture**, të paraqitura në tabelën përmbledhëse nr.1, në Aneksin 5.1 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. Gjithashtu, të dhënat e detajuaja për secilën kategori të lejeve të miratuara për vitin 2023, gjendet në Aneksin 5.3, bashkëlidhur materialit.

Duke ju referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Durrës, gjatë periudhës 01.01.2024 deri më 31.12.2024 janë miratuar janë miratuar **88 leje zhvillimi**, **28 leje** ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250

$m^2$, **32 leje ndërtimi** me sipërfaqe deri në 250 $m^2$, **3 leje ndërtimi** për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 $m^2$, **8 leje ndërtimi** për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 $m^2$, **45 çertifikata përdorimi**, **295 deklarata paraprake** për kryerje punimesh dhe **6 leje infrastrukture**, të paraqitura në tabelën përmbledhëse nr. 2, në Aneksin 5.2 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. Gjithashtu, të dhënat e detajuaja për secilën kategori të lejeve të miratuara për vitin 2024, gjendet në Aneksin 5.3, bashkëlidhur materialit.

Në bazë të analizës së riskut, vlerës së preventivit dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit, janë përzgjedhur për tu audituar rastet e lejeve të ndërtimit dhe çertifikateve të përdorimit të paraqitura në tabelën nr.3, në Aneksin 5.4 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit..

**1.** Nga auditimi i procedurës së miratimit të "*Lejes së ndërtimit për ndërtim të ri , me sipërfaqe më të madhe se 250 m*$^2$", për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 1071/1, datë 31/08/2023**, i Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **"Godinë banimi dhe shërbimi 10 kat mbi tokë me 2 kat nëntokë"**, me zhvillues shoqëria "X" sh.p.k, në adresën rruga shëtitorja "Taulantia", Durrës, u konstatua si më poshtë:
Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr. 2067 Prot, datë 11.05.2022 dhe me Vendimin e KKT-së Nr. 39, datë 03.12.2020. Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **A.3.1,** në bazë të planit në fuqi, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:




| **Njësia strukturore** | **A.3.1** |
|---|---|
| **Kategoria e përdorimit të tokës:** | Zona Rezidenciale (përdorim i përzierë) |
| **Kategoria e zonimit:** | Zona të përdorimit të përzierë dhe rekreacionit me densitet të lartë |
| **Përdorimi i lejuar:** | Hotele, falsitete turistike dhje zyra<br>Rezidenca dhe falsitete përkatëse si garazhe, "D" dhe qilarë<br>Magazinë/dyqane shumice e pakice<br>Qendra komerciale<br>Zyra publike dhe private (banka, zyra postare etj.) |
| **Përdorime të ndaluara:** | Të gjitha tipete aktiviteteve prodhuese dhe përdorimeve përkatëse |
| **Statusi i zhvillimit:** | Leje Zhvillimi |
| **Parametrat e zhvillimit të përgjithshëm:** | 65% Zona Rezidenciale;<br>12% Biznes çdo lloj;<br>10% Rrugë;<br>10% Infrastrukturë Sekondare;<br>3% Tokë publike; |
| **Madhësia e parcelës:** | Min: 450 m² |
| **Sipërfaqja minimale për IZUV:** | 2500 m² |
| **Intensiteti i ndërtimit (i):** | 3 |
| **Ksht:** | 40 % |
| **Lartësia:** | 10 kate / 30 metra |
| **Fasada e parcelës:** | Min 20 m |
| **Kërkesa për parkime:** | 2 parkime (16.5 m²) për njësi banimi (100 m²) |

Në bazë të vendimit të KKT-së Nr.39, datë 03.12.2020 dhe dokumentit të rregullores së veçantë të miratuar nga KKT-ja, përcaktohen treguesit zhvillimorë si më poshtë:
Sipërfaqe  e përgjithshme e truallit: 1043.36 $m^2$
Sipërfaqe e zënë nga gjurma: 417 $m^2$
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit: 4683 $m^2$
Koefiçienti i shfrytëzimit të truallit: 40%
Intensiteti 4.49
Lartësia e ndërtimit : 34.3 metra (bashkë me daljen e nuklit të shkallëve dhe ambjetit teknik lartësia e katit është 36.7 metra )

Numri i kateve mbi tokë: 10 kate
Numri i kateve nën tokë: 2 kate

- Në planvendosjen e miratuar nga KKT-ja në lejen e zhvillimit pasqyrohen të gjithë të dhënat e zhvillimit, të tilla si: sipërfaqja e ndërtimit, intensiteti, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, numri i kateve, lartësia e ndërtimit dhe distancat. Nga verifikimi i projektit teknik në dëg të paraqitur në aplikimin për leje ndërtimi, konstatohet që sipërfaqet e përgjithshme të ndërtimit, nuk përkojnë me të dhënat e sipërfaqeve të pasqyruara në planvendosjen e miratuar, pasi nuk përfshihen të gjitha sipërfaqet e ndërtimit, përkatësisht sipërfaqet e ballkoneve në secilin kat. Mospërcaktimi i saktë i të dhënave të treguesve të zhvillimit të paraqitura në planvendosjen e miratuar, në mospërputhje me projektin teknik të miratuar (të ngarkuar në sistem në version pdf/ dëg), ndikon në përcaktimin e saktë të kondicioneve urbane, në mospërputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin 15, pika 1, gërma c, planvendosja e miratuar. Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës nuk është kërkuar saktësimi i informacionit në lidhje me të dhënave të treguesve të zhvillimit, që të jenë në përputhje me projektin teknik.
- Në dokumentin e rregullores së veçantë të miratuar nga KKT-ja sipas vendimit Nr.39, datë 03.12.2020 përcaktohet që distancat midis objekteve mund të përcaktohen sipas rregullores së të posaçme të miratuar prej tij. Distanca nga kufiri i pronës janë ruajtur si më poshtë:

-nga veriu 15.8 metra -10.5metra
-nga jugu 5.0 metra - 5.25 metra
-nga perëndimi 3.6 metra - 2.4 metra
-nga lindja 1.0 metra për faqen kallkan

Nga verifikimi i projektit të ndërtimit në dëg, minimumi i distancës së ruajtur midis ndërtimit dhe trupit të rrugës në orientimin perëndimor është 1.56 metra dhe jo 2.4 metra si është përcaktuar në planvendosjen e miratuar në lejen e zhvillimit nga KKT-ja. Në përcaktimin e distancave nuk janë marrë në konsideratë daljet konsol, në mospërputhje me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, neni 34, pika 7, në të cilën përcaktohet që: "*Për ndërtimet gjatë rrugëve, çdo dalje konsol do të quhet faqe ndërtimi dhe duhet të respektojë distancat nga trupi i rrugës*." dhe me nenin 36, pika 1/a, në të cilën përcaktohet që për distancën e lejuar ndërmjet ndërtimit dhe trupit të rrugës për gjerësi rruge, me ose pa trotuare, më të vogël se 7 (shtatë) metra, distanca minimale është 2.5 (dy pikë pesë) metra. Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Durrës nuk është kërkuar saktësimi i informacionit në lidhje me distancat faktike nga trupi i rrugës / kufiri i pronës / objektet kufitare.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, rezulton se, mbi pasurinë me nr. 26/177 ka një objekt me sipërfaqe 203 $m^2$ dhe mbi pasurinë me nr. 26/178 ka një objekt me sipërfaqe 44 $m^2$. Në pasuritë në cilat do të zhvillohet ndërtimi i ri, ka objekte ekzistuese të ndërtuara në to. Për prishjen e objekteve ekzistuese, pjesë e lejes së ndërtimit duhet ishte edhe leja për prishjen e objekteve sipas VKM nr.408, datë 13.05.2015 *"*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*"*, të ndryshuar, neni nr.11 pika "ç" ku citohet se "*Punimet për të cilat kërkohet pajisja me leje ndërtimi, sipas nenit 39 të Ligjit, janë ato që:..."ç" kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri. Nëse prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes*". Sa më sipër miratimi i kësaj leje është bërë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", të ndryshuar, neni 11.
- Në bazë të Ligjit Nr.22/2018, "Për strehimin social", datë 3.5.2018, Neni 19, pika 1, përcaktohet që: "Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi **për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë**, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një

sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme." Sipërfaqja e banimit të objektit që do të zhvillohet është **4352 metra katrorë,** prej të cilës referuar Ligjit Nr.22/2018, 3% e sipërfaqes së saj duhet t'i kalojë bashkisë pa shpërblim, **një sipërfaqe prej 130.5 m$^2$**.

Në sistem është ngarkuar aktmarrëveshja ndërmjet bashkisë dhe subjektit zhvillues, me Nr. rep 1245, Nr. Kol 586, me datë 10.05.2023, në të cilën zhvilluesi deklaron që do t'i japë bashkisë në favor të fondit publik të banesave sociale **122.81 m$^2$** sipërfaqe banimi, sipërfaqe e cila ndahet në dy pasuri, njëra me një sipërfaqe prej 65.31 m $^2$ dhe pasuria tjetër me sipërfaqe prej 57.5 m $^2$ . Nga verifikimi i sipërfaqeve të banimit nga projekti i ndërtimit në dëg, rezulton që sipërfaqja duhet t'i kalojë bashkisë është 130.5 m$^2$, nga të cilat marrëveshja është realizuar për kontributin prej 122.81 m$^2$ sipërfaqe banimi. Diferenca ndërmjet sipërfaqes që duhet të kontribuonte është 7.7 m$^2$, ose e shprehur në vlerë monetare për referencë **7.7 m $^2$ x 67,500 lekë/m2 (çmimi i shitjes për metër katror) = 519,750 lekë.**


- Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë, bazohet në Nenin 46 të Ligjit 107/2014 *"*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*"*, i ndryshuar dhe referuar Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, në pikën 1 përcaktohet që: *"Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.",* si dhe në pikën 2 përcaktohet që:*"Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri në 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror"*. Sipas Vendimit të **Këshillit Bashkiak Durrës** me nr.149, datë 22.12.2022,*"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës"*, në pikën 1.3, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregtimi e shërbimi është **8%**. Referuar këtyre të dhënave, më poshtë po bëjmë llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë objekt:

| **Emërtimi i katit teknik** | **Sipërfaqe ndërtimi** | **Çmimi shitje (lek/m²)/ zonë** | **Vlera (lekë )** | **Koeficient** | **Vlera Totale (lekë)** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Parkime** | | | | | |
| Kati -2 nëntokë | 933 | | | | |
| Kati -1 nëntokë | 928 | | | | |
| | **1861** | 67,500 | 125,617,500 | 0.7 | **87,932,250** |
| **Shërbime** | | | | | |
| Kati përdhe | 627 | | | | |
| Kati i pare | 595 | | | | |
| | **1222** | 67,500 | 82,486,222 | 1.5 | **123,727,500** |
| **Banim** | | | | | |
| Kati i dytë | 586 | | | | |
| Kati i tretë | 586 | | | | |
| Kati i katërt | 586 | | | | |
| Kati i pestë | 586 | | | | |
| Kati i gjashtë | 586 | | | | |
| Kati i shtatë | 586 | | | | |
| Kati i tetë | 586 | | | | |
| Kati i nëntë | 586 | | | | |
| Ambienti në tarracë | 81 | | | | |
| | **4769** | 67,500 | 321,907,500 | 1 | **321,907,500** |
| | | **VLERA TOTALE INVESTIMIT** | | | **533,567,250** |
| | | **VLERA E TAKSES TNI =8%** | | | **42,685,380** |

| **Llogaritja e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) për godinën e banimit** | |
|---|---|
| **Vlera që duhet likuiduar e taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **42,685,380** |
| **Vlera e llogaritur nga bashkia e taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **32,554,324** |
| **Diferenca e vlerës totale të taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **10,131,056** |

Fatura e përllogaritur nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës është **32,554,324 lekë**, ndërsa llogaritja e saktë ka vlerën **42,685,380 lekë**, e pasqyruar në tabelën e mësipërme. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit në dëg janë konstatuar diferenca në sipërfaqe në llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Diferenca ndërmjet dy vlerave të mësipërme prej **10,131,056 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetit e bashkisë.
*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar); 2.A.H, me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; 3.K.A, me pozicion Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të Lejeve , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (punonjëse e larguar); 4.E.L, me pozicion Përgjegjës i Sektori të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjëse i larguar); 5.E.K, me pozicion Përgjegjës sektori, Sektori i Kontrollit të Territorit dhe marrëdhënieve me Publikun Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjëse e larguar).*

**2. Nga auditimi i procedurës së miratimit të** "*Lejes së ndërtimit për ndërtim të ri , me sipërfaqe më të madhe se 250 m*$^2$", për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 930-22/5, datë 03/02/2023**, të Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **"Godinë banimi dhe shërbimi 1, 5 dhe 6 kate me 1 kat parkimi nëntokë"**, me zhvillues shoqëria "Ç" sh.p.k, në adresën rruga "H.M", lagjja 17, Durrës, u konstatua si më poshtë:
Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr. 2719, datë 12/01/2022. Duke u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 27, datë 10.05.2013 "*Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës*", parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **A.3.4,** sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:




| **Njësia strukturore** | **A.3.4** |
|---|---|
| **Kategoria e përdorimit të tokës:** | Zona Rezidenciale (përdorim i përzierë) |
| **Kategoria e zonimit:** | Zona të përdorimit të përzierë me densitet të lartë |
| **Përdorimi i lejuar:** | Hotele, falsitete turistike dhje zyra<br>Rezidenca dhe falsitete përkatëse si garazhe, "D" dhe qilarë<br>Magazinë/dyqane shumice e pakice<br>Qendra komerciale<br>Zyra publike dhe private (banka, zyra postare etj.) |
| **Përdorime të ndaluara:** | Të gjitha tipete aktiviteteve prodhuese dhe përdorimeve përkatëse |
| **Statusi i zhvillimit:** | Leje Zhvillimi<br>IZUV |
| **Parametrat e zhvillimit të përgjithshëm:** | 65% Zona Rezidenciale;<br>12% Biznes çdo lloj;<br>10% Rrugë;<br>10% Infrastrukturë Sekondare;<br>3% Tokë publike; |
| **Madhësia e parcelës:** | Min: 450 m² |
| **Sipërfaqja minimale për IZUV:** | 2500 m² |
| **Intensiteti i ndërtimit (i):** | 2.2 (IZUV = 2.4) |
| **Ksht:** | 60 % |
| **Lartësia:** | 20 m / 6 kate |
| **Fasada e parcelës:** | Min 17 m |
| **Kërkesa për parkime:** | 2 parkime (16.5 m²) për njësi banimi (100 m²) |

Në planvendosjen e miratuar në lejen e ndërtimit nuk pasqyrohen përmasat e objektit që do të zhvillohet dhe nuk pasqyrohen të gjitha distancat ndërmjet objekteve, në bazë të VKM-së 408, datë

13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin 15, pika 1, gërma c, planvendosja e miratuar.
Referuar të dhënave të treguesve të zhvillimit në lejen e ndërtimit të miratuar, paraqiten si më poshtë:

- Sipërfaqja e përgjithshme e pronës është 1285 m²
- Sipërfaqja e truallit e zënë nga struktura (gjurma) është 771 m²
- Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë është 2827 m² + 150 ,2 m² ballkone
- Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit nën tokë është 982.9 m²
- Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi dhe nën tokë është 3960.1 m²
- Intensiteti i ndërtimit është 2.2
- Koefiçenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim është 60%
- Koefiçenti i shfrytëzimit të truallit për rrugë dhe hapësira publike është 40%
- Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit është 20 m
- Numri i kateve mbi tokë është 1, 5 dhe 6 kate
- Numri i kateve nën tokë është 1 kat

Nga verifikimi i projektit teknik në dëg u konstatuan mospërputhje në sipërfaqet e ndërtimit të pasqyruara tek të dhënat e treguesve të zhvillimit, pasi janë paraqitur referuar Planit të Përgjithshëm ekzistues të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendimin Nr. 27, datë 10.05.2013 "*Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës*", si dhe duke ju referuar VKM-së 502, datë 13.07.2011,"*Për miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*", (në të cilin në llogaritjen e intensiteti të ndërtimit nuk përfshihen të gjitha sipërfaqet e kateve). Më poshtë pasqyrohen të dhënat e plota të sipërfaqeve të verifikuara sipas projektit teknik në dëg:

- Sipërfaqja e përgjithshme e pronës është 1285 m²
- Sipërfaqja e truallit e zënë nga struktura (gjurma) është 798 m²
- Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë është 3117 m²
- Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit nën tokë është 983 m²
- Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi dhe nën tokë është 4100 m²
- Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit është 20.7 m
- Numri i kateve mbi tokë është 1, 5 dhe 6 kate
- Numri i kateve nën tokë është 1 kat

➢ Në raport me respektimin e distancave, objekti ruan distancën nga kufiri i pronës në orientimin lindor prej 5.0 metra deri në 7.1 metra, në orientimin jugor prej 3.3 metra deri në 7.3 metra, në orientimin perëndimor prej 3.3 metra deri në 7.18, në respektim të distancave sipas legjislacionit në fuqi. Ndërsa në orientimin verior është ruajtur distanca prej 0.25 metra deri në 1.3 metra nga kufiri pronës dhe **jo distanca prej 3.3 metrash**, në kundërshtim me VKM-së 502, datë 13.07.2011,"*Për miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*", neni 40, pika 9, në të cilin përcaktohet që:" *Pa rënë ndesh me sa përcaktohet në pikat 7 dhe 8 të këtij neni, distanca minimale midis faqes së një strukture dhe kufirit të pronës parcelë, ku është vendosur kjo strukturë është 3.3 (tre pikë tre) metra.".*
Parcela në të cilën propozohet ndërtimi bën pjesë në zonën arkeologjike "B". Në bazë të Ligjit nr. 27/2018 "*Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*" dhe VKM-së nr.786, datë 26.12.2018, "Për miratimin e Zonave Arkeologjike B të Qytetit të Durrësit dhe planin e ruajtjes, mbrojtjes dhe administrimit të tyre", në nenin 4, pika 2, përcaktohet që projektet për ndërtimet e reja duhet të shqyrtohen dhe të miratohen nga KKTKM-ja. Subjekti është pajisur me Vendimin Nr. 495, datë 05.10.2022 të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, për Miratimin e Raportit të sondazheve arkeologjike, në kuadër të projektit "Godinë banimi 1, 5 dhe 6 kate me 1 kat nëntokë".

➢ Në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, kartelat e pasurive që marrin pjesë në zhvillim dhe hartat treguese nuk janë të përditësuara, në bazë të Ligjit 111/2018, për "*Kadastrën*", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: "*Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale.*

*Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar*". Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, neni 21 "*Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor*", pika 6, autoriteti vendor duhet të marrë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit, përcakton që: "*…informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën".*

- Gjithashtu, referuar pikës 6, të nenit 21, të VKM-së 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, të ndryshuar, në të cilën përcaktohet që: "*Përjashtimisht, në kuptim të këtij neni, informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e kërkesës aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën.".*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, rezulton se:
- Mbi pasurinë me nr. 5/1272, në zonë kadastrale 8513, në sipërfaqen e truallit prej 152 $m^2$ në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, ka edhe një objekt ekzistues me sipërfaqe 51 $m^2$.
- Mbi pasurinë me nr. 5/1242, në zonë kadastrale 8513, në sipërfaqen e truallit prej 766 $m^2$ në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, ka edhe një objekt ekzistues me sipërfaqe 249 $m^2$.
- Mbi pasurinë me nr. 5/1149, në zonë kadastrale 8513, në sipërfaqen e truallit prej 367 $m^2$ në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, ka edhe një objekt ekzistues me sipërfaqe 153 $m^2$.

- Për prishjen e objekteve ekzistuese, pjesë e lejes së ndërtimit **duhet ishte edhe leja për prishjen e objekteve** sipas VKM nr.408, datë 13.05.2015 *"*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*"*, të ndryshuar, neni nr.11 pika "ç" ku citohet se "*Punimet për të cilat kërkohet pajisja me leje ndërtimi, sipas nenit 39 të Ligjit, janë ato që: …"ç" kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri. Nëse prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes*". Sa më sipër miratimi i kësaj leje është bërë në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, të ndryshuar, neni 11.

- Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë, bazohet në Nenin 46 të Ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar dhe referuar Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, pika 1 dhe 2. Sipas Vendimit të **Këshillit Bashkiak Durrës** me nr. 149, datë 22.12.2022, *Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës"*, në pikën 1.3, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregtimi e shërbimi është **8%**. Referuar këtyre të dhënave, më poshtë po bëjmë llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë objekt:


| **Emërtimi i katit teknik** | **Sipërfaqe ndërtimi** | **Çmimi shitje (lek/$m^2$)/zonë** | **Vlera (lekë )** | **Koeficient** | **Vlera Totale (lekë)** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Parkime** | | | | | |
| Kati -1 nëntokë | **983** | 67,500 | 66,352,500 | 0.7 | **46,446,750** |
| **Shërbime** | | | | | |
| Kati përdhe | 754 | | | | |
| Kati i parë | 366 | | | | |
| | **1120** | 67,500 | 75,600,000 | 1.5 | **113,400,000** |
| **Banim** | | | | | |
| Kati i parë | 148 | | | | |
| kati i dytë | 515.2 | | | | |
| kati i tretë | 515.2 | | | | |
| Kati i katërt | 515.2 | | | | |
| kati i pestë | 283.4 | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Daljet në tarracë | 19.7 | | | | |
| | **1997.6** | 67,500 | 134,777,250 | 1 | **134,777,250** |
| | | **VLERA TOTALE INVESTIMIIT** | | | **294,624,000** |
| | | **VLERA E TAKSES TNI =8%** | | | **23,569,920** |

| **Llogaritja e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) për godinën e banimit** | |
|---|---|
| **Vlera që duhet likuiduar e taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **23,569,920** |
| **Vlera e llogaritur nga bashkia e taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **19,251,486** |
| **Diferenca e vlerës totale të taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **4,318,434** |

Fatura e përllogaritur nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës është **19,251,486 lekë**, ndërsa llogaritja e saktë ka vlerën **23,569,920 lekë**, e pasqyruar në tabelën e mësipërme. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit në dëg janë konstatuar diferenca në sipërfaqe në llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Diferenca ndërmjet dy vlerave të mësipërme prej **4,318,434 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetit e bashkisë.
*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar); 2.A.H, me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; 3.K.A, me pozicion Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të Lejeve , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (punonjëse e larguar);*

**3. Nga auditimi i procedurës së miratimit të** "*Lejes së ndërtimit për ndërtim të ri , me sipërfaqe më të madhe se 250 m*$^2$", për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 1036/6, datë 22/06/2023**, të Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **"Godinë banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë"**, me zhvillues ""A" " sh.p.k, në adresën rruga "Doktor Remzi Fico", Durrës, u konstatua si më poshtë:
Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr. 13115/3, datë 22.04.2022, në bazë të kushteve dhe përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor në fuqi dhe VKM-së 502, datë 13.07.2011,"*Për miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*".Aplikimi për lejen e ndërtimit është kryer në sistemin e-leje me datë 05.09.2022, me numër aplikimi AN050920220045 dhe kondicionet urbane bazohen në të dhënat e njësive strukturore sipas Planit ekzistues.
Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **A.3.4,** në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor në fuqi, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:




| **Njësia strukturore** | **A.3.4** |
|---|---|
| **Kategoria e përdorimit të tokës** | Zonë rezidenciale (përdorim të përzier) |
| **Kategoria e zonimit** | Zona të përdorimit të përzier me densitet të lartë |
| **Përdorimi i lejuar** | Hotele, falsitete turistike dhe zyra; Rezidenca dhe facilitetet përkatëse si garazhe, "D" dhe qilarë; Magazinë/dyqane shumice e pakice; Qendra komerciale; Zyra publike dhe private(banka, zyra postare etc.) |
| **Përdorime të ndaluara** | Të gjitha tipet e aktiviteteve prodhuese dhe përdorime përkatëse |
| **Statusi i zhvillimit** | Leje Zhvillimit IZUV |
| **Parametra të zhvillimit të përgjithshëm** | 65% Zona Rezidenciale – Tokë private<br>12% Biznes çdo lloj – Tokë private<br>10% Rrugë – Tokë publike<br>10% Infrastrukturë sekondare – Tokë publike 3% Kontribut Publike – Private |

| | |
|---|---|
| | /Publike |
| **Madhësia e parcelës** | Min: 450 m2 |
| **Koefiçienti maksimal i shfrytëzimit të tokës** | 60% |
| **Intensiteti i ndërtimit** | 2.2 |
| **Lartësia** | 20 m / 6 kate |
| **Fasada e parcelës** | Min. 17 metra |
| **Planimetria e sheshit të ndërtimit** | Fasadë e vazhduar të katit përdhes dhe katit të parë (Dp = 0 dhe Db = 0). |

Planvendosja e miratuar në lejen e ndërtimit nuk përputhet me projektin e ndërtimit, pasi në gjurmën e objektit **nuk pasqyrohen daljet konsol**, në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në nenin 15, pika 1, gërma c, planvendosja e miratuar. Referuar të dhënave të treguesve të zhvillimit në lejen e ndërtimit të miratuar, paraqiten si më poshtë:

-Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës është 1547.7 $m^2$
-Sipërfaqja e parcelës e zënë nga struktura është 567.5 $m^2$
-Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë është 3405 $m^2$
-Sipërfaqja e ndërtimit nën tokë është 678.1 $m^2$
-Koefiçienti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim është 36.6%
-Itensiteti i ndërtimit është 2.2
-Lartësia maksimale e strukturës është 19.9 metra
-Numri i kateve mbi tokë është 6
-Numri i kateve nën tokë është 1

- Nga verifikimi i projektit të ndërtimit në dëg ka mospërputhje në sipërfaqet e ndërtimit të pasqyruara tek të dhënat e treguesve të zhvillimit, pasi janë paraqitur referuar Planit të Përgjithshëm ekzistues i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendimin Nr. 27, datë 10.05.2013 "*Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës*", si dhe duke ju referuar VKM-së 502, datë 13.07.2011,"*Për miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*", (në të cilin në llogaritjen e intensiteti të ndërtimit nuk përfshihen të gjitha sipërfaqet e ndërtimit, të tilla si ballkonet). Më poshtë pasqyrohen sipërfaqet e plota të verifikuara nga projekti teknik:

-Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës është 1547.7 $m^2$
-Sipërfaqja e parcelës e zënë nga struktura është 612 $m^2$
-Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë është 3742 $m^2$
-Sipërfaqja e ndërtimit nën tokë është 678.1 $m^2$
-Numri i kateve mbi tokë është 6
-Numri i kateve nën tokë është 1

- Referuar pikës 8/a, të nenit 40, të VKM-së 502, datë 13.07.2011,"*Për miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*", në të cilën përcaktohet që: "*Në nënnjësitë strukturore me funksion banimi, distanca midis ndërtesave është 13.3 (trembëdhjetë pikë tre) m për objekte me 6 (gjashtë) kate, ku secila ndërtesë mbart detyrimin për respektimin e distancës 6.6 (gjashtë pikë gjashtë) m nga kufiri i pronës",* distanca që dy objekte në lartësinë e 6 kateve duhet të respektojnë është 13.3 metra, ose 6.6 metra nga kufiri i pronës. Nga planvedosja e miratuar konstatohet që distanca nga kufiri i pronës në orientimin verior, ku objekti përballet me një objekt tjetër në lartësinë e 6 kateve është 5.9 metra nga kufiri i pronës, në kundërshtim me pikës 8/a, të nenit 40, të VKM-së 502, datë 13.07.2011,"Për miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit". Ndërsa në orientimin perëndimor distanca që objekti ruan nga kufiri i pronës është 5.3 metra dhe jo 6 metra për objektin në lartësinë e 6 kateve, në kundërshtim me pikën 8/b, të nenit 40, të VKM-së 502, datë 13.07.2011,"*Për miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*", në të cilën përcaktohet që:"*Në rastet kur objektet kanë numër të ndryshëm katesh, secili objekt mbart detyrimin e respektimit të distancës nga kufiri respektiv i pronës në përputhje me numrin e kateve që projektohet.".*

Lidhur me lartësinë maksimale të ndërtimit, referuar VKM-së 502, datë 13.07.2011,"*Për miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*", neni 41, pika 4, gërma a, përcaktohet që: "*Nga kuota mesatare e sistemimit të trotuarit rrethues të strukturës, në përputhje me përcaktimet e shtojcës 3 të këtij vendimi, deri në tavanin e katit të fundit, për ndërtesa me mbulesë të sheshtë.",* lartësia e strukturës është 19.9 metra.

- Në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, nuk pasqyrohet kartela e pasurive që marrin pjesë në zhvillim dhe hartat treguese të përditësuara, në bazë të Ligjit 111/2018, për "*Kadastrën*", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: "*Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar*". Gjithashtu referuar pikës 6, të nenit 21, të VKM-së 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, të ndryshuar, në të cilën përcaktohet që: "*Përjashtimisht, në kuptim të këtij neni, informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e kërkesës aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën.".*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, rezulton se:

- Mbi pasurinë me nr. 5/1266, në zonë kadastrale 8513, në sipërfaqen e truallit prej 445 $m^2$ në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, ka edhe një objekt ekzistues me sipërfaqe 49 $m^2$.
- Mbi pasurinë me nr. 5/1264, në zonë kadastrale 8513, në sipërfaqen e truallit prej 500 $m^2$ në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, ka edhe një objekt ekzistues me sipërfaqe 214 $m^2$.
- Mbi pasurinë me nr. 5/1222, në zonë kadastrale 8513, në sipërfaqen e truallit prej 602.7 $m^2$ në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, ka edhe një objekt ekzistues me sipërfaqe 208.7 $m^2$.

- Për prishjen e objekteve ekzistuese, pjesë e lejes së ndërtimit **duhet ishte edhe leja për prishjen** e objekteve sipas VKM nr.408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, të ndryshuar, neni nr.11 pika "ç".

Parcela në të cilën propozohet ndërtimi bën pjesë në zonën arkeologjike "B". Në bazë të Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" dhe VKM-së nr.786, datë 26.12.2018, "Për miratimin e Zonave Arkeologjike B të Qytetit të Durrësit dhe planin e ruajtjes, mbrojtjes dhe administrimit të tyre", në nenin 4, pika 2, përcaktohet që projektet për ndërtimet e reja duhet të shqyrtohen dhe të miratohen nga KKTKM-ja. Në bazë të Vendimit nr.358, datë 01.07.2022, investitori duhet të lidhë paraprakisht aktmarrëveshja 3 palëshe me subjektin e licensuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike kryerjen e punimeve për objektin. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, pasqyrohet aktmarrëveshja me nr.1808 prot., datë 17.11.2023 e realizuar ndërmjet palëve.

- Në bazë të **Ligjit Nr.22/2018**, "*Për strehimin social*", datë 3.5.2018, Neni 19, pika 1, përcaktohet që: "Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi **për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë**, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme." Sipërfaqja e banimit mbi tokë e objektit që do të zhvillohet është **3628 metra katrorë,** prej të cilës referuar Ligjit Nr.22/2018, 3% e sipërfaqes së saj duhet t'i kalojë bashkisë pa shpërblim, **një sipërfaqe prej 108.8 $m^2$**. Në sistem është ngarkuar aktmarrëveshja ndërmjet bashkisë dhe subjektit zhvillues, me Nr. Repertori: 1626, Nr. Koleksioni:1036, me datë 12.05.2023, në të cilën zhvilluesi deklaron që do t'i japë bashkisë një sipërfaqe banimi prej 99 $m^2$ në një objekt tjetër, në favor të fondit publik të banesave sociale.

Nga verifikimi i sipërfaqeve të banimit nga projekti i ndërtimit në dëg, rezulton që sipërfaqja duhet t'i kalojë bashkisë është 108.8 $m^2$, nga të cilat marrëveshja është realizuar për kontributin prej 99 $m^2$ sipërfaqe banimi. Diferenca ndërmjet sipërfaqes që duhet të kontribuonte është 12.27 $m^2$, ose e shprehur në vlerë monetare për referencë **9.8 $m^2$ x 67,500 lekë/m2 (çmimi i shitjes për metër katror) = 664,200 lekë.**

- Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë, bazohet në Nenin 46 të Ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar dhe referuar Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, në pikën 1 dhe 2. Sipas Vendimit të **Këshillit Bashkiak Durrës** me nr.149, datë 22.12.2022, *Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës"*, në pikën 1.3, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregëtimi e shërbimi është **8%**.Referuar këtyre të dhënave, më poshtë po bëjmë llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë objekt:

| Emërtimi i katit teknik | Sipërfaqe ndërtimi | Çmimi shitje (lek/$m^2$)/ zonë | Vlera (lekë ) | Koeficient | Vlera Totale (lekë) |
|---|---|---|---|---|---|
| **Parkime** | | | | | |
| Kati -1 nëntokë | 678 | 67,500 | 45,765,000 | 0.7 | 32,035,500 |
| **Shërbime** | | | | | |
| Kati përdhe | 54 | 67,500 | 3,645,000 | 1.5 | 5,467,500 |
| **Banim** | | | | | |
| Kati përdhe | 558 | | | | |
| Kati i pare | 614 | | | | |
| kati i dyte | 614 | | | | |
| kati i trete | 614 | | | | |
| Kati i katërt | 614 | | | | |
| kati i pestë | 614 | | | | |
| Tarraca | 60 | | | | |
| | 3688 | 67,500 | 248,940,000 | 1 | 248,940,000 |
| | | | **Vlera totale investimit** | | **286,443,000** |
| | | | **Vlera e takses TNI =8%** | | **22,915,440** |

| **Llogaritja e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) për godinën e banimit** | |
|---|---|
| **Vlera që duhet likuiduar e taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **22,915,440** |
| **Vlera e llogaritur nga bashkia e taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **22,677,948** |
| **Diferenca e vlerës totale të taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **237,492** |

Fatura e përllogaritur nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës është **22,677,948 lekë**, ndërsa llogaritja e saktë ka vlerën **22,915,440 lekë**, e pasqyruar në tabelën e mësipërme. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit në dëg janë konstatuar diferenca në sipërfaqe në llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Diferenca ndërmjet dy vlerave të mësipërme prej **237,492 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetit e bashkisë.
*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar); 2.A.H, me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; 3.K.A, me pozicion Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të Lejeve , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (punonjëse e larguar); 4.V.S, me pozicion specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të lejeve, Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar).*

**4. Nga auditimi i procedurës së miratimit të** "*Lejes së ndërtimit për ndërtim të ri , me sipërfaqe më të madhe se 250 $m^2$*", për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 1444-22, datë 12.09.2023**, të Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **"GodI. banimi 1-2 kate dhe shërbimi me mur rrethues"**, me zhvillues "D" sh.p.k, në adresën C.la, Bashkia Durrës, u konstatua si më poshtë:

Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr. 42/2 Prot, datë 08.06.2022 dhe me **Vendimin e KKT-së** Nr.30, datë 03.12.2020. Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **DR_UB_A1_480/215,** në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:



Plani i Përgjithshëm Vendor.

Ndërmjet Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Bashkisë Durrës është lidhur marrëveshja për delegimin e kompetencave, për vijimin e procedurës për lejen e ndërtimit në bazë të lejes së zhvillimit të miratuar nga KKT-ja dhe hartës së planvendosjes së strukturave. Në bazë të vendimit të KKT-së Nr.30, datë 03.12.2020, kondicionet urbane ndryshojnë nga


| **Njësia strukturore** | **DR_UB_A1_480/215** |
|---|---|
| **Sistemi** | UB_Urban |
| **Kategori 1** | A.Banim 100 % |
| **Lartësia në kate** | 2 |
| **Lartësia në metra** | 9.2 |
| **PDV** | Jo |
| **Intensiteti** | K1=0.6 |
| **KSHT** | K1=30% |
| **KSHR** | 10% |
| **KSHP** | 30% |
| **Nënkategori 1** | A.1_Banim |
| **Përdorime të lejuara** | Të gjitha kategoritë e Sistemit Urban përveç IE-Industri dhe Ekonomi, V-Varrezë, ZU - Zona ushtarake. |
| **Përdorime të ndaluara** | Kategorite e Sistemit Urban IE-Industri Ekonomi,V- Varreza, ZU-Zona Ushtarake, dhe kategoritë e Sistemit Bujqësor |
| **Kushte të tjera** | KSHP plotësohet duke u Referuar nenit 19, i rregullores PPV/KSHR plotësohet duke u Referuar nenit 18, i rregullores PPV |


Referuar të dhënave të treguesve të zhvillimit në lejen e ndërtimit të miratuar, paraqiten si më poshtë:

-Sipërfaqja e përgjithshme e truallit është 3400 m²

- Sipërfaqja e truallit e zënë nga struktura është 1955.7 m²
- Sipërfaqja e ndërtimit totale është 3814 m²
- Koeficienti i shfrytëzimit të territorit është 57.5 %
- Intensiteti i ndërtimit është 1.12
- Lartësia e përgjithshme është 7.5 m
- Numri i kateve mbi tokë është1-2 kate
- Numri i kateve nën tokë është 1

➢ Në planvendosjen e miratuar nga KKT-ja në lejen e zhvillimit pasqyrohen të gjithë të dhënat e zhvillimit, të tilla si: sipërfaqja e ndërtimit, intensiteti, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, numri i kateve, lartësia e ndërtimit dhe distancat. Nga verifikimi i projektit teknik në dëg të paraqitur në aplikimin për leje ndërtimi, konstatohet që sipërfaqet e përgjithshme të ndërtimit, nuk përkojnë me të dhënat e sipërfaqeve të pasqyruara në planvendosjen e miratuar, pasi nuk përfshihen të gjitha sipërfaqet e ndërtimit. Mospërcaktimi i saktë i të dhënave të treguesve të zhvillimit të paraqitura në planvendosjen e miratuar, në mospërputhje me projektin teknik të miratuar (të ngarkuar në sistem në version pdf/ dëg), ndikon në përcaktimin e saktë të kondicioneve urbane, në mospërputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin 15, pika 1, gërma c, planvendosja e miratuar. Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës nuk është kërkuar saktësimi i informacionit në lidhje me të dhënave të treguesve të zhvillimit, që të jenë në përputhje me projektin teknik.





Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, për njësinë DR_UB_A1_480/215 dhe sipas përcaktimeve të rregullores së veçantë të KKT-së, *objektet duhet të jenë në lartësinë e dy kateve mbi tokë.* Nga verifikimi i prerjeve të pasqyruara në projektin teknik, evidentohet që objekti tejkalon lartësinë e 1-2 kate, në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin 37, pika 1, gërma c dhe pika 3, gërma b, përcaktohet që: "*Kati nëntokë, që sipas rastit mund të jetë emërtuar edhe "Bodrum", është vëllimi i ndërtimit të katit të objektit, i cili vendoset tërësisht ose kryesisht nëntokë, me kusht që kuota e sipërme e tij e matur në dyshemenë e përfunduar të katit mbi katin nëntokë, të mos jetë më shumë se 1 metër mbi nivelin e kuotës së sistemuar të trotuarit ose sheshit rrethues të jashtëm të strukturës*". Nga verifikim i projektit teknik konstatohet që kati i quajtur nëntokë zhvillohet 1 metër mbi nivelin e kuotës së sistemimit të sheshit rrethues. Lidhur me lartësinë e përgjithshme të ndërtimit, lartësia e miratuar në lejen e zhvillimit është 7.5 metra, ndërsa nga projekti teknik konstatohet që lartësia maksimale e ndërtimit tejkalon lartësinë e miratuar, referuar VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin 37, pika 1, gërma c, përcaktohet që: "*Në rastin e ndërtesave të vendosura në terrene me pjerrësi, lartësia në metra jepet në mënyrë të posaçme për të dyja faqet e strukturës në secilën anë të terrenit të pjerrët dhe në përputhje me shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike*." Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Durrës nuk është kërkuar saktësimi i projektit në lidhje me lartësinë dhe numrin e kateve të objektit, që të jetë në përputhje me përcaktimet ligjore.

- Për lejen e ndërtimit të sipërcituar është bërë aplikimi me nr.**AN150120250068** për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, për ndryshimin e sipërfaqeve të ndërtimit. Duke qenë që aplikimi është ende në proces shqyrtimi, projekti i ndërtimit ka ndryshuar dhe të dhënat e treguesve të zhvillimit kanë ndryshuar.
- Në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, nuk pasqyrohet dokumentacioni i përditësuar, në bazë të Ligjit 111/2018, për "*Kadastrën*", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: "*Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar*.". Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, neni 21 "*Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor*", pika 6, autoriteti vendor duhet të marrë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit, përcakton që: "*…informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën".*
- Në bazë të **Ligjit Nr.22/2018**, "*Për strehimin social*", datë 3.5.2018, Neni 19, pika 1, përcaktohet që: "Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi **për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë**, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të


Pasurive të Paluajtshme.” Sipërfaqja e banimit e objektit (*duke përfshirë vetëm sipërfaqen funksionale të banimit* dhe sipërfaqen neto të apartamenteve) që do të zhvillohet është **3125 metra katrorë,** prej të cilës referuar Ligjit Nr.22/2018, 3% e sipërfaqes së saj duhet t’i kalojë bashkisë pa shpërblim, **një sipërfaqe prej 93 m$^2$**. Në sistem është ngarkuar aktmarrëveshja ndërmjet bashkisë dhe subjektit zhvillues, me Nr. repertori 2929, Nr. Koleksioni:1881, me datë 24.08.2023, në të cilën zhvilluesi deklaron që do t’i japë bashkisë një sipërfaqe banimi prej 93 m$^2$ në një objekt tjetër, në favor të fondit publik të banesave sociale, sipërfaqe që përkon me sipërfaqen e përllogaritur nga sipërfaqja e banimit.

- Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë, bazohet në Nenin 46 të Ligjit 107/2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”*, i ndryshuar dhe referuar Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për*“ Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”*, i ndryshuar, në pikën 1 dhe 2. Sipas Vendimit të **Këshillit Bashkiak Durrës** me nr.149, datë 22.12.2022, *Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës”*, në pikën 1.3, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregtimi e shërbimi është **8%**. Përsa i përket llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, në observacionet e dërguara, subjekti ka aplikuar për ndryshim projekti gjatë ndërtimit. Leja e ndërtimit është miratuar me vendimin Nr.1444-22, datë 12.09.2023. Subjekti është pajisur me njoftim për fillimin e punimeve me datë 27.09.2023, me nr.1466/1 prot., pranë Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit. Me datë 15.01.2025 është bërë aplikimi për ndryshim projekti gjatë ndërtimit, për ndryshimin e sipërfaqeve të ndërtimit, me numër aplikimi **AN150120250068**. Duke qenë që aplikimi është ende në proces shqyrtimi dhe sipërfaqet e ndërtimit kanë ndryshuar, taksa e ndikimit në infrastrukturë duhet llogaritur e vlerësuar me sipërfaqet aktuale të ndërtimit, referuar VKM-së 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, të ndryshuar, neni 17, pika 2, ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit, përcaktohet që: “*Subjekti zhvillues detyrohet të paguajë shtesën përkatëse në vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në rast se ndryshimi i sipërfaqes ndërtimore apo/dhe aktiviteteve/funksioneve të objektit, sipas rasteve të parashikuara në këtë nen, shoqërohet me rritjen e shumës së kësaj takse, që subjekti ka paguar në momentin e miratimit të lejes së ndërtimit. Për rastet kur ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit apo/ dhe ndryshimi i aktiviteteve/ funksioneve sjell zvogëlimin e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, procedura e kthimit të diferencës së kësaj vlere miratohet nga autoriteti vendor, në përputhje me legjislacionin për vetëqeverisjen vendore.”.*
- Lidhur me verifikimin në terren të zbatimit të punimeve të ndërtimit, duke qenë që janë bërë ndryshime të projektit gjatë ndërtimit, duhet konstatuar në terren realizimi i punimeve në bazë të projektit të ndryshuar në lejen për ndryshimin e objektit gjatë ndërtimit.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar); 2.A.H, me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; 3.K.A, me pozicion Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të Lejeve , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (punonjëse e larguar);4.D.Gj., me pozicion specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të lejeve,Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;*

**5. Nga auditimi i procedurës së miratimit të** “*Lejes së ndërtimit për ndërtim të ri , me sipërfaqe më të madhe se 250 m$^2$*”, për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 1654-22/5, datë 31/01/2023**, të Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **“Hotel me 1 dhe 7 kate, me 1 kat nëntokë”**, me zhvillues E.K, në adresën rruga “Val Deti”, lagjja 13, Bashkia Durrës, u konstatua si më poshtë:

Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr.17, datë 24.11.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit me objekt “Hotel me 1 dhe 7 kate, me 1 kat nëntokë”. Në dokumentacionin e paraqitur në sistemin e-leje është ngarkuar dokumenti i rregullores së veçantë dhe planvendosja e miratuar për leje zhvillimi, me treguesit e zhvillimit si më poshtë:




- Sipërfaqja e truallit është 500 m²
- Sipërfaqja e katit përdhe është 280 m²
- Sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është 1943 m²
- Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi dhe nën tokë është 2223 m$^2$
- Koeficienti i shfrytëzimit të territorit 56 %
- Intensiteti i ndërtimit është 3.89
- Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit është 26.22 m
- Numri i kateve mbi tokë është 1 dhe 7 kate
- Numri i kateve nëntokë është 1 kat

Nga shqyrtimi i të gjithë dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, nuk paraqitet marrëveshja e delegimit të kompetencave lidhur me Bashkinë Durrës.

➢ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, rezulton se, mbi pasurinë me nr. 58/622, në zonë kadastrale 8518, në sipërfaqen e truallit prej 500 m$^2$ në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, ka edhe një objekt ekzistues me sipërfaqe 130 m$^2$. Për prishjen e objekteve ekzistuese, pjesë e lejes së ndërtimit duhet ishte edhe leja për prishjen e objekteve sipas VKM nr.408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, të ndryshuar, neni nr.11 pika "ç" ku citohet se "*Punimet për të cilat kërkohet pajisja me leje ndërtimi, sipas nenit 39 të Ligjit, janë ato që: ..."ç" kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri. Nëse prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes*". Sa më sipër miratimi i kësaj leje është bërë në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, të ndryshuar, neni 11.



➢ Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë, bazohet në Nenin 46 të Ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar dhe referuar Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, në pikën 1 dhe në pikën 3, gërma a, përcaktohet që :*"Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë individi apo me sipërmarrës; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 (një) deri në 3 (tre) për qind e vlerës së investimit"*. Sipas Vendimit të **Këshillit Bashkiak Durrës** me nr.149, datë 22.12.2022, *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës"*, në pikën 1.3, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtime të ndryshme është **3%**. Referuar këtyre të dhënave, më poshtë po bëjmë llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë objekt:

| **Emërtimi i katit teknik** | **Sipërfaqe ndërtimi/ m$^2$** | **Çmimi i sipërfaqes së ndërtimit sipas entit kombëtar të banesave** |
|---|---|---|
| Kati nëntokë | 280 | |
| Kati përdhe | 280 | |
| Kati i parë | 80 | |
| Kati i dytë | 280 | |
| Kati i tretë | 275 | |
| Kati i katërt | 275 | |
| Kati i pestë | 277 | |
| Kati i gjashtë | 280 | |
| Kati i shtatë | 276 | |
| Dalja e nuklit të shkallës/ ashensorit në tarracë | 23 | |
| Sipërfaqja totale e ndërtimit | 2326 | 32,105 |
| **Vlera totale e investimit** | | **74,676,230** |
| **Vlera e taksës TNI =3%** | | **2,240,287** |

Fatura e përcaktuar nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës është në vlerën **2,239,612 lekë**, përllogaritje e cila rezulton në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

➢ Nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe nga foto ajrore, u konstatuan ndryshime në realizimin e punimeve të ndërtimit nga projekti i ndërtimit i miratuar

në lejen e ndërtimit. Në planvendosjen e objektit të miratuar paraqiten dy volume 1 dhe 7 kate, ndërsa objekti është realizuar i gjithi në lartësinë e 7 kateve, duke rritur sipërfaqet e ndërtimit në secilin kat. Gjithashtu në pronën në të cilën zhvillohet objekti konstatohet edhe gjurma e objekteve të tjera. Më poshtë pasqyrohen foto në të cilat evidentohen ndryshimet nga projekti i miratuar.



Mungesa e Kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Durrës, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim 107/2014, datë 31.07.2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, Neni 51, Inspektimi, dhe Neni 52, Kundërvajtje administrative dhe ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007, "*Për inspektimin e ndërtimit",* Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, ka sjellë si pasojë devijimin nga leja e ndërtimit e miratuar dhe shtim të sipërfaqeve ndërtimore pa leje ndërtimi.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar); 2.A.H, me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; 3.K.A, me pozicion Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të Lejeve , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (punonjëse e larguar); 4.D.M, me pozicion Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (punonjës i larguar).*

**6. Nga auditimi i procedurës së miratimit të** "*Lejes së ndërtimit për ndërtim të ri , me sipërfaqe më të madhe se 250 m*$^2$", për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 1497-22/5, datë 06/02/2023**, të Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **"Objekte industriale 1 dhe 2 kat, vend-roje, kabinë elektrike dhe mur rrethues"**, me zhvillues shoqëria "I" sh.p.k, në adresën fshati Bisht Kamëz,Njësia Administrative Katund i Ri, Bashkia Durrës, u konstatua si më poshtë: Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr.1318-22/2 Prot, datë 08/11/2022. Në zbatim të Vendimit Nr. 5, datë 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit *"*Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban", **parcela e propozuar për zhvillim nuk ndodhet brenda zonës së shpallur të urbanizuar.** Parcela e propozuar për zhvillim **bën pjesë në rastet përjashtimore** sipas pikës 2, gërma d), të Vendimit Nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit *"*Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore", i ndryshuar.



Në bazë të lejes së zhvillimi të miratuar, kondicioneve urbane që duhet të respektojë janë si më poshtë:
- Sipërfaqja e pronës është 53,466 $m^2$
- Sipërfaqja e tokës e zënë nga strukturat është 26,441.1 $m^2$
- Koeficienti i shfrytëzimit të territorit është 49.45 %
- Sipërfaqja e ndërtimit totale mbi tokë është 31,010.1 $m^2$
- Intensiteti i ndërtimit është 0.58
- Lartësia e përgjithshme është 9.13 m
- Numri i kateve mbi tokë është 1 dhe 2 kate
- Numri i kateve nëntokë është 0 kat.

Ndërsa në raport me distancat nga kufiri i pronës janë miratuar si më poshtë:
- Distanca nga kufiri i pronës në orientimin verior është 21.70 metra.
- Distanca nga kufiri i pronës në orientimin jugor është 21.80 metra.
- Distanca nga kufiri i pronës në orientimin lindor është 24.00 metra.
- Distanca nga kufiri i pronës në orientimin perëndimor është 24.00 metra.

Nga verifikimi i planvendosjes dhe projektit të ndërtimit të miratuar në lejen e ndërtimit, u konstatua që treguesit e zhvillimit dhe kondicionet urbane të përcaktuara në lejen e zhvillimit të miratuar nuk janë në përputhje me lejen e ndërtimit, duke ju referuar VKM-së 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", të ndryshuar, neni 14, pika 1.

Më poshtë pasqyrohen të dhënat e verifikuara sipas lejes së ndërtimit të miratuar.
- Sipërfaqja e pronës është 53,466 $m^2$
- Sipërfaqja e tokës e zënë nga strukturat është 28,800 $m^2$
- Koeficienti i shfrytëzimit të territorit është 54 %
- Sipërfaqja e ndërtimit totale mbi tokë është 33,826 $m^2$
- Intensiteti i ndërtimit është 0.63
- Lartësia e përgjithshme është 9.23 m
- Numri i kateve mbi tokë është 1 dhe 2 kate
- Numri i kateve nëntokë është 0 kat.

➢ Në bazë të nenit 9, të VKM-së 408, datë datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", të ndryshuar, përcaktohet që dokumenti i lejes së zhvillimit paraprin lejen e ndërtimit dhe pikës 1, të nenit 14, në të cilën përcaktohet që :" *Leja e ndërtimit lëshohet në përputhje me <u>përcaktimet e lejes së zhvillimit</u>, dokumenteve të planifikimit, të rregulloreve të zhvillimit e ndërtimit, si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë ndërtimore në Republikën e Shqipërisë.*".

Sipërfaqja e zënë nga struktura nga 26,441.1 $m^2$ e përcaktuar në lejen e zhvillim është 28,800 $m^2$ në lejen e ndërtimit. Gjithashtu intensiteti i ndërtimit nga 31,010.1 $m^2$ që është përcaktuar në lejen e zhvillimi është 33,826 $m^2$ në lejen e ndërtimit. Me ndryshimin e sipërfaqeve të ndërtimit, ndryshojnë edhe kondicionet e përcaktuara në lejen e zhvillimit të tilla si koeficienti i shfrytëzimit të territorit nga 49.45 % në 54 % dhe intensiteti i ndërtimit nga 0.58 në 0.63.

Përsa i përket respektimit të distancave nga kufiri i pronës, distancat nuk janë në përputhje me ato të përcaktuara në lejen e zhvillimit, pasi nga verifikimi i planvendosjes së miratuar janë si më poshtë:
- Distanca nga kufiri i pronës në orientimin verior janë nga 6.00 metra deri në 10 metra
- Distanca nga kufiri i pronës në orientimin jugor është 17.6 metra deri në 21.6 metra.
- Distanca nga kufiri i pronës në orientimin lindor është 24.00 metra.
- Distanca nga kufiri i pronës në orientimin perëndimor është 24.00 metra.

Distanca nga kufiri i pronës në lejen e ndërtimit, përkatësisht distancat në orientimin verior dhe në orientimin jugor janë më të vogla se distancat e përcaktuara në lejen e zhvillimit, duke ju referuar VKM-së 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar, neni 14, pika 1.

- Në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohet infrastruktura dhe mënyra e aksesit në objektet e propozuara, në bazë të VKM-së 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", të ndryshuar, neni 14, pika 2, në të cilën përcaktohet që: *"Dhënia e lejes së ndërtimit kushtëzohet nga ekzistenca e infrastrukturës kryesore dhe dytësore në njësinë ku kërkohet ndërtimi."* dhe duke ju referuar VKM-së 408, datë 13.05.2015*, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",* të ndryshuar, neni 15, pika 1, gërma c.
- Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë, bazohet në Nenin 46 të Ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar dhe referuar Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, në pikën 1 dhe në pikën 3.Sipas Vendimit të **Këshillit Bashkiak Durrës** me nr.149, datë 22.12.2022, *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës"*, në pikën 1.3, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtime të ndryshme është **3%**. Referuar këtyre të dhënave, më poshtë po bëjmë llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë objekt:

Vlera e preventivit e pasqyruar është 535,767,158 lekë.
Në bazë të vlerës së preventivit, taksa e ndikimit në infrastrukturë është:
535,767,158 lekë x 3% (niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë) = 16,073,015 lekë.
Fatura e përcaktuar nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës është në vlerën **16,073,014 lekë**, përllogaritje e cila rezulton në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar); 2.A.H, me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; 3.K.A, me pozicion Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të Lejeve , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (punonjëse e larguar).*

**7. Nga auditimi i procedurës së miratimit të** "*Lejes së ndërtimit për ndërtim të ri , me sipërfaqe më të madhe se 250 m*$^2$", për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 55/1-23, datë 15/03/2023**, të Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **"2 kapanone industriale 1 kat dhe 2 kat+ mur rrethues + kabinë elektrike dhe vendroje "**, me zhvillues B.D, në Spitallë, Bashkia Durrës, u konstatua si më poshtë:
Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr.1061/1-22 Prot, datë 05.12.2022. Aplikimi për lejen e ndërtimit është kryer përpara zbardhjes së Planit të Përgjithshëm Vendor dhe kushtet e zhvillimit i referohen planit ekzistues. Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **I.1.0,** sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:



Nga verifikimi i planvendosjes dhe projektit të ndërtimit të miratuar në lejen e ndërtimit, të dhënat e zhvillimit plotësojnë kondicionet urbane të përcaktuara në planin rregullues ekzistues dhe janë si më poshtë:

- Sipërfaqja e pronës është 25,000 $m^2$
- Sipërfaqja e tokës e zënë nga strukturat është 10,992 $m^2$
- Koeficienti i shfrytëzimit të territorit është 44 %
- Sipërfaqja e ndërtimit totale mbi tokë është 12,142 $m^2$
- Intensiteti i ndërtimit është 0.49
- Lartësia e përgjithshme është 9 m
- Numri i kateve mbi tokë është 1 dhe 2 kate
- Numri i kateve nëntokë është 0
-Volumi total mbi sipërfaqen e ndërtimit është 3.95 $m^3/m^2$

Në tabelën e treguesve në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohen të dhënat në lidhje me distancat qe objektet ruajnë në raport me kufirin e pronës dhe me trupin e rrugës,në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.05.2015*, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",* të ndryshuar, neni 15, pika 1, gërma c.

Në lidhje me miratimin e lejes së ndërtimit, Agjencia Zhvillimit të Territorit shprehet se:" …. projekt-propozimi duhet të jetë në përputhje edhe me kriteret dhe standardet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Durrës miratuar me Vendimin Nr.4, datë 27.07.2022, legjislacionin sektorial në fuqi.". Në planin e ri që është zbardhur në datë 15.02.2023, parcela i përket njësisë strukturore **DR_UB_IE3_640/3,** sipas përcaktimeve të mëposhtme:

| **Njësia strukturore** | **I.1.0** |
|---|---|
| **Kategoria e përdorimit të tokës:** | Zona Industriale |
| **Kategoria e zonimit:** | Parku energjetik |
| **Përdorimi i lejuar:** | Aktivitete logjistike dhe industriale (me efekt të mesëm dhe të lartë), Zyrat, Kapanone (me qëllim prodhimi) |
| **Përdorime të ndaluara:** | Rezidenciale (me përjashtim të vendqëndrimit të rojes/portierit) MagazI., bare dhe restorante, mikro-ndërmarrjet |
| **Statusi i zhvillimit:** | Leje zhvillimi, plan nën-ndarjeje i detajuar (Zona ekonomike Spitallë) |
| **Parametrat e zhvillimit të përgjithshëm:** | 85% toka private, 15% rrugët e brendshme |
| **Madhësia e parcelës:** | Min. 5000 m2 |
| **Intensiteti i ndërtimit** | 1.2 |
| **KSHT** | 44% |
| **Lartësia (ndërtesat për zyra):** | 14m, 4 kate |
| **Volumi total i pranueshëm mbi sipërfaqen e plotit:** | 4m3/m2 (volume teknike si oxhakë, tubacione të jashtme, nuk do llogariten si volume) |
| **Distanca (Ndërtesat industriale)** | Kufiri i rrugës Dr = 18m, Kufiri i parcelës Dp = 10m |
| **Përcaktime të tjera** | Sipërfaqja e ndërtimit të zyrave nuk duhet të jetë më shumë se 10% e sipërfaqes së parcelës; volumi i zyrave dhe mbulimi i parcelës do të përfshihet në llogaritjet e përgjithshme të volumit total të pranueshëm dhe Mbulimit të Sipërfaqes së Parcelës. |
| **Planimetria e sheshit të ndërtimit:** | Metri i parë i tokës midis rrethimeve dhe vijës së rrugës do të shërbejë si shtrat për lule dhe pemë, që duhet të mirëmbahet nga secila njësi individuale industriale. Pjesa tjetër që mbetet(7m) do të pajiset dhe shërbejë si zonë parkimi e manovrimi. Ndërtimi i godI.ve në kufi të pronës nuk lejohet me përjashtim të dhomës së rojes në hyrje të njësisë (një për njësi) dhe ndërtesave speciale me pajisje për shpërndarjen e lëngjeve apo energjisë atëherë kur është e autorizuar dhe në përputhje me normat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë për aktivitetet e ngarkimit dhe shkarkimit të lëngjeve dhe materialeve të rrezikshme. |

| **Njësia strukturore** | **DR_UB_IE3_640/3** |
|---|---|
| **Sistemi** | UB_Urban |
| **Kategori 1** | IE.Industri Ekonomi 100% |
| **Kategori 2** | |
| **Lartësia në kate** | 3 |
| **Lartësia në metra** | Sipas funksionit dhe projektit |
| **PDV** | Jo |
| **Intensiteti** | K1=1.5 |
| **KSHT** | K1=50% |
| **KSHR** | 10% |
| **KSHP** | 30% |
| **Nënkategoria 1** | IE3_ Aktivitet Ekonomik Kompleks |
| **Përdorime të lejuara** | Kategoritë e Sistemit Urban: vetëm nënkategoria S2- Shërbime tregtare dhe |

| | |
|---|---|
| | biznesi. Të gjitha kategoritë e Sistemit Infrastrukturor, të shqyrtuara rast pas rasti, në varësi të shkallës së ndotjes dhe pajisjes me leje mjedisore përkatëse, si dhe respektimit të brezave mbrojtës nga monumentet e natyrës, sistemi ujor apo monumentet e kulturës. |
| **Përdorime të ndaluara** | Ndaluara Të gjitha kategoritë e tjera të sistemit urban. Kategoritë e sistemit bujqësor |
| **Kushte të tjera** | KSHP plotësohet duke u Referuar nenit 19, i rregullores PPV/ KSHR plotësohet duke u Referuar nenit 18, i rregullores PPV. Por ka nevoje për rrjet rrugor para lejes |

Nga verifikimi i projektit të ndërtimit dhe plavendosjes së miratuar, leja e ndërtimit i plotëson kondicionet urbane edhe me Planin e Përgjithshëm Vendor, të miratuar Vendimin Nr.4, datë 27.07.2022.

- Në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, nuk pasqyrohet kartela e pasurisë, në bazë të Ligjit 111/2018, për "*Kadastrën*", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: "*Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar*.". Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, neni 21 "*Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor*", pika 6, autoriteti vendor duhet të marrë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit, përcakton që: "*...informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën".* Në kërkesën për mendim drejtuar AShK-së Durrës, institucioni është shprehur se pasuria nuk ka kufizim, por është regjistruar një kontatë shitjeje me kusht në favor të shoqërisë "L". Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje nuk është ngarkuar marrëveshja ndërmjet zhvilluesit dhe shoqërisë "L".
- Në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, godI.t përbëhen në dy funksione, në funksion të prodhimit dhe në funksion të shërbimit dhe llogaritja e taksës nevojitet të bëhet në bazë të destI.cionit, referuar Nenit 46 të Ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar dhe referuar Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, në pikën 1 përcaktohet që: *"Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri."* dhe në pikën 2 përcaktohet *që: " Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo <u>për njësi tregtimi dhe shërbimi</u>, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) për qind deri 8 (tetë) për qind të çmimit të shitjes për metër katror.... <u>Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.".</u>* Sipas Vendimit të **Këshillit Bashkiak Durrës** me nr.149, datë 22.12.2022, *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës"*, në pikën 1.3, për njësitë e shërbimit dhe shoëroomet, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë është **8%**, ndërsa për prodhimin në funksion të industrisë, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë është **3%**.

Vlera totale e preventivit është 207,036,422 lekë.

Fatura e përcaktuar nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës është **6,211,092.66 lekë** dhe është llogaritur me të njëjtin nivel takse për të dyja funksionet e përfshira, në mospërputhje me përcaktimet ligjore të mësipërme. Referuar pikës 1, të nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për "*Sistemin e taksave dhe tarifave vendore*", i ndryshuar, <u>ndërtimi i destinuar për njësi shërbimi taksohet në vlerën 8% të çmimit të shitjes për metër katror, ndërsa</u>

ai i destinuar në funksion të industrisë dhe prodhimit, taksohet me 3% të vlerës së investimit në bazë të preventivit për sipërfaqet në funksion të prodhimit/industrisë.
*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar); 2.E.L, me pozicion Përgjegjës i Sektori të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjëse i larguar); 3.E.K, me pozicion Përgjegjës sektori, Sektori i Kontrollit të Territorit dhe marrëdhënieve me Publikun Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjëse e larguar).*

**8. Nga auditimi i procedurës së miratimit të** "*Lejes së ndërtimit për ndërtim të ri , me sipërfaqe më të madhe se 250 m*$^2$", për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 1623-23/4, datë 22/01/2024**, të Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **"Strukturë hotelerie 8 kate dhe 1 kat nëntokë"**, me zhvillues shoqëria "D" sh.p.k, në adresën rruga "Pavarësia", plazh, lagjja 13, Bashkia Durrës, u konstatua si më poshtë:
Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr. 41, datë 01.08.2023 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e Lejes së Zhvillimit". Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **DR_UB_S1_329/20,** në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:




| Njësia strukturore | DR_UB_S1_329/20 |
|---|---|
| Sistemi | UB_Urban |
| Kategori 1 | S.Shërbime_80 % |
| Kategori 2 | A.Banim_20 % |
| Lartësia në kate | LZH/LN |
| Lartësia në metra | LZH/LN |
| PDV | LZH/LN |
| Intensiteti | K1= LZH/LN \| K2= LZH/LN |
| KSHT | K1= LZH/LN \| K2= LZH/LN |
| KSHR | 10% |
| KSHP | 30% |
| Nënkategori 1 | S1_Sherbime Akomodimi dhe Argetimi |
| Nënkategori 2 | S2_ Shërbime Tregtare dhe Biznesi |
| Nënkategori 3 | A2_ Banim dhe Shërbime |
| Parcela minimale | LZH/LN |
| Përdorime të lejuara | Kategoritë e sistemit Urban: S- Shërbime, IS- Institucione (vetëm nënkategoria IS2), AS- Arsim, SH- Shëndetësi, sh.a – Aktivitete Shoqërore dhe Argëtimi |
| Përdorime të ndaluara | Të gjitha kategoritë e tjera të sistemit urban. Kategoritë e sistemit bujqësor. |
| Kushte të tjera | LZH/LN |

Referuar lejes së zhvillimit të miratuar me vendimin e KKT-së, treguesit e zhvillimit të miratuar janë si më poshtë:
- Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës është 740 m$^2$
- Sipërfaqja e tokës e zënë nga struktura është 321 m$^2$
- Koefiçienti i shfrytëzimit të territorit është miratuar 43.3%
- Sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është 2568 m$^2$
- Intensiteti i ndërtimit është miratuar 3.4

- Lartësia maksimale e strukturës është miratuar 30.45 metra
- Numri i kateve mbi tokë është 8
- Numri i kateve nën tokë është 1

➢ Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, nuk është ngarkuar Marrëveshja e Delegimit të Kompetencave drejtuar Bashkisë Durrës dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë për lejen e zhvillimit të miratuar nga KKT-ja.

➢ Në planvendosjen e miratuar nga KKT-ja në lejen e zhvillimit pasqyrohen të gjithë të dhënat e zhvillimit, të tilla si: sipërfaqja e ndërtimit, intensiteti, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, numri i kateve, lartësia e ndërtimit dhe distancat. Nga verifikimi i projektit teknik në dëg të paraqitur në aplikimin për leje ndërtimi, konstatohet që sipërfaqet e përgjithshme të ndërtimit, nuk përkojnë me të dhënat e sipërfaqeve të pasqyruara në planvendosjen e miratuar, pasi nuk përfshihen të gjitha sipërfaqet e ndërtimit. Mospërcaktimi i saktë i të dhënave të treguesve të zhvillimit të paraqitura në planvendosjen e miratuar, në mospërputhje me projektin teknik të miratuar (të ngarkuar në sistem në version pdf/ dëg), ndikon në përcaktimin e saktë të kondicioneve urbane, në mospërputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin 15, pika 1, gërma c, planvendosja e miratuar. Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës nuk është kërkuar saktësimi i informacionit në lidhje me të dhënave të treguesve të zhvillimit, që të jenë në përputhje me projektin teknik.

Në raport me lartësinë maksimale të ndërtimit, lartësia totale e ndërtimit e matur nga kuota e sistemimit deri në lartësinë e parapetit e ndërtimit është 31.12 metra, lartësi kjo e cila tejkalon lartësinë maksimale të miratuar në lejen e zhvillimit prej 30.45 metra, referuar VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin 37, pika 1, gërma a. Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës nuk është kërkuar saktësimi i projektit teknik në raport me lartësinë e ndërtimit, që të jetë në përputhje me përcaktimet ligjore.

➢ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, rezulton se, mbi pasurinë me nr.8/194, në zonë kadastrale 8518, në sipërfaqen e truallit prej 740 $m^2$ në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, ka edhe një objekt ekzistues me sipërfaqe 143 $m^2$. Për prishjen e objekteve ekzistuese, pjesë e lejes së ndërtimit duhet ishte edhe leja për prishjen e objekteve sipas VKM nr.408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, të ndryshuar, neni nr.11 pika "ç" ku citohet se "*Punimet për të cilat kërkohet pajisja me leje ndërtimi, sipas nenit 39 të Ligjit, janë ato që: ..."ç" kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri. <u>Nëse prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes</u>*". Sa më sipër miratimi i kësaj leje është bërë në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, të ndryshuar, neni 11.

➢ Objekti 8 katësh është një strukture shërbimi dhe akomodimi, <u>në funksion të publikut</u>. Nga verifikimi i sipërfaqeve të përgjithshme të ndërtimit në projektin dëg, u konstatuan që vlera totale e investimit referuar sipërfaqes totale të ndërtimit në bazë të çmimit mesatar sipas kostos së ndërtimit, tejkalon vlerën prej 100,000,000 lekë. Sipërfaqet për secilin kat janë të detajuara në tabelën bashkëngjitur. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, nuk rezulton të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një *oponencë teknike*, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 6, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, sipas të cilit: "*Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik*".

➢ Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë, bazohet në Nenin 46 të Ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar dhe referuar Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, në pikën 1 dhe në pikën 3, gërma a. Sipas Vendimit të **Këshillit Bashkiak Durrës** me nr.194, datë 22.12.2023, *Për*

*miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës"*, në pikën 1.3, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtime të ndryshme është **3%**. Referuar këtyre të dhënave, më poshtë po bëjmë llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë objekt:

| Emërtimi i katit teknik | Sipërfaqe ndërtimi/ $m^2$ | Çmimi i sipërfaqes së ndërtimit sipas entit kombëtar të banesave |
|---|---|---|
| Kati nëntokë | 522 | |
| Kati përdhe | 374 | |
| Kati i parë | 326 | |
| Kati i dytë | 326 | |
| Kati i tretë | 326 | |
| Kati i katërt | 327 | |
| Kati i pestë | 327 | |
| Kati i gjashtë | 327 | |
| Kati i shtatë | 327 | |
| Dalja e nuklit të shkallës/ ashensorit në tarracë | 26 | |
| Sipërfaqja totale | 3208 | 32,105 |
| **Vlera totale e investimit** | | **102,992,840** |
| **Vlera e taksës TNI =3%** | | **3,089,785** |


| **Llogaritja e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) për godinën e hotelerisë** | |
|---|---|
| **Vlera që duhet likuiduar e taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **3,089,785** |
| **Vlera e llogaritur nga bashkia e taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **2,989,563** |
| **Diferenca e vlerës totale të taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **100,222** |

Fatura e përllogaritur nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës është **2,989,563 lekë**, ndërsa llogaritja e saktë ka vlerën **3,089,785 lekë**, e pasqyruar në tabelën e mësipërme. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit në dëg janë konstatuar diferenca në sipërfaqen e ndërtimit, për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Diferenca ndërmjet dy vlerave të mësipërme prej **100,222 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetit e bashkisë.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar); 2.A.H, me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; 3.K.A, me pozicion Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të Lejeve , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (punonjëse e larguar).*

**9. Nga auditimi i procedurës së miratimit të** "*Lejes së ndërtimit për ndërtim të ri , me sipërfaqe më të madhe se 250 $m^2$*", për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 783/5, datë 11.11.2024**, të Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **"Godinë banimi dhe shërbimi 3, 5 dhe 7 kat me 1 kat parkim nëntokë"**, me zhvillues shoqëria "K" sh.p.k, në adresën rruga "ALeksandër Goga", lagjja 18, rajoni 4, Bashkia Durrës, u konstatua si më poshtë:

Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr. 1655-23/3, datë 20/03/2024. Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **DR_UB_A2_412/2,** në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:




Plani i vendosjes së miratuar nuk përkon me projektin teknik të ngarkuar në sistemin e-leje, pasi në gjurmën e ndërtimit pasqyrohet një thyerje në faqen kallkan, ndërsa në projektin teknik faqja është e gjitha e drejtë, pa ndërprerje. Gjithashtu në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohet gjurma e daljes së nuklit të shkallës dhe ashensorit, në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin 15, pika 1, gërma c, planvendosja e miratuar.

| **Njësia strukturore** | **DR_UB_A2_412/2** |
|---|---|
| **Sistemi** | UB_Urban |
| **Kategori 1** | A.Banim 100 % |
| **Lartësia në kate** | 8 |
| **Lartësia në metra** | 26 |
| **PDV** | Jo |
| **Intensiteti** | K1=3.5 |
| **KSHT** | K1=50% |
| **KSHR** | 10% |
| **KSHP** | 30% |
| **Nënkategori 1** | A.1_Banim |
| **Parcela minimale** | 1000 m$^2$ |
| **Përdorime të lejuara** | Të gjitha kategoritë e Sistemit Urban përveç IE-Industri dhe Ekonomi, V-Varrezë, ZU - Zona ushtarake. |
| **Përdorime të ndaluara** | Kategorite e Sistemit Urban IE-Industri Ekonomi,V- Varreza, ZU-Zona Ushtarake, dhe kategoritë e Sistemit Bujqësor |
| **Kushte të tjera** | KSHP plotësohet duke u Referuar nenit 19, i rregullores PPV/KSHR plotësohet duke u Referuar nenit 18, i rregullores PPV |

Bazuar në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Durrës, miratuar me Vendimin Nr. 4, datë 27.07.2022 të KKT-së, për rastet kur kërkohet zhvillimi i objekteve me lartësi katesh më të vogël se lartësia maksimale e përcaktuar në njësinë strukturore, madhësia e parcelës minimale mund të zvogëlohet në raport me numrin e kateve por duke mos ndryshuar tipologjinë hapësinore të ndërtimit në zonë. Duke qenë që sipërfaqja e truallit është 889 m$^2$, objekti zhvillohet në lartësinë e 7 kateve.

Nga verifikimi i planvendosjes dhe projektit të ndërtimit të miratuar në lejen e ndërtimit treguesit e zhvillimit janë si më poshtë:

Sipërfaqja e truallit që zhvillohet është 889 m$^2$
Sipërfaqja e tokës e zënë nga struktura: 445 m²
Koefiçienti i shfrytëzimit të territorit: 50 %
Sipërfaqe totale ndërtimi mbi tokë: 2804 m²
Intensiteti i ndërtimit: 3.15
Sipërfaqe totale ndërtimi nëntokë: 683 m²
Sipërfaqe totale ndërtimi: 3487 m²
Lartësia maksimale: 25.79 m
Numri i kateve mbi tokë: 3, 5 dhe 7 kat
Numri i kateve nën tokë: 1

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, rezulton se, mbi pasurinë me nr. 28/202, në zonë kadastrale 8511, vendoset ndërtesa me numër pasurie 28/202/ND dhe në pasurinë nr. 28/203, në zonë kadastrale 8511, vendoset ndërtesa me numër pasurie 28/202/ND.

Referuar deklaratës noteriale me Nr. Repertori: 17, Nr. Koleksioni: 8, datë 04.01.2024, shoqëria "K" sh.p.k, deklaron se objektet në pasuritë e saj nuk ekzistonin në momentin e blerjes së

pasurisë. Në dokumentacionin e pronësisë dhe në kartelat e pasurisë të rifreskuara, nuk pasqyrohet gjendja dhe statusi i pasurisë. Në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, nuk pasqyrohet ky ndryshim, në bazë të Ligjit 111/2018, për "*Kadastrën*", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: "*Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar.".*

- Në bazë të **Ligjit Nr.22/2018**, "*Për strehimin social*", datë 3.5.2018, Neni 19, pika 1, përcaktohet që: "Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi **për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë**, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme." Sipërfaqja e banimit mbi tokë e objektit që do të zhvillohet është **2402 metra katrorë,** prej të cilës referuar Ligjit Nr.22/2018, 3% e sipërfaqes së saj duhet t'i kalojë bashkisë pa shpërblim, **një sipërfaqe prej 72 m$^2$**. Në sistem është ngarkuar aktmarrëveshja ndërmjet bashkisë dhe subjektit zhvillues, me Nr.repertori 2751, Nr. Koleksioni:1814, me datë 07.11.2024, dhe vlera e përcaktuar për tu likuiduar është **4,730,400** lekë, në favor të fondit publik të banesave sociale. Nga verifikimi i sipërfaqeve të banimit nga projekti i ndërtimit në dëg, rezulton që sipërfaqja duhet t'i kalojë bashkisë është 72 m$^2$ x 67,500 lekë/m2 (çmimi i shitjes për metër katror) = **4,864,050 lekë**. Diferenca prej **133,650 lekë**, përbën të ardhura të munguara shkaktuar Bashkisë Durrës.
- Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë, bazohet në Nenin 46 të Ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar dhe referuar Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për*"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, në pikën 1 përcaktohet që: *"Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.",* si dhe në pikën 2 përcaktohet që :*"Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri në 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror"*. Sipas Vendimit të **Këshillit Bashkiak Durrës** me nr.194, datë 22.12.2023, *Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës"*, në pikën 1.3, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregëtimi e shërbimi është **8%**.Referuar këtyre të dhënave, më poshtë po bëjmë llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë objekt:


| **Emërtimi i katit teknik** | **Sipërfaqe ndërtimi** | **Çmimi shitje (lek/m²)/ zonë** | **Vlera (lekë )** | **Koeficient** | **Vlera Totale (lekë)** |
|---|---|---|---|---|---|
| Parkime | | | | | |
| Kati -1 nëntokë | 683 | 67,500 | 46,102,500 | 0.7 | 32,271,750 |
| Shërbime | | | | | |
| Kati përdhe | 402 | 67,500 | 27,135,000 | 1.5 | 40,702,500 |
| Banim | | | | | |
| Kati përdhe | 43 | | | | |
| Kati i parë | 460 | | | | |
| Kati i dytë | 460 | | | | |
| Kati i tretë | 395 | | | | |
| Kati i katërt | 395 | | | | |
| Kati i pestë | 309 | | | | |
| Kati i gjashtë | 309 | | | | |
| Dalja e nuklit të shkallës dhe ashensorit | 31 | | | | |
| | 2402 | 67,500 | 162,135,000 | 1 | 162,135,000 |
| | | | **Vlera totale investimit** | | **235,109,250** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | **Vlera e taksës TNI =8%** | **18,808,740** |

Fatura e përcaktuar nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës është në vlerën **18,791,406 lekë**, përllogaritje e cila rezulton në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar); 2.A.H, me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; 3.K.A, me pozicion Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të Lejeve , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (punonjëse e larguar).*

**10. Nga auditimi i procedurës së miratimit të** "*Lejes së ndërtimit për ndërtim të ri , me sipërfaqe më të madhe se 250 m*$^2$", për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 1562-23/4, datë 15/01/2024**, të Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **"Godinë industriale 1 kat, vendroje, kabinë elektrike dhe mur rrethues"**, me zhvillues shoqëria "T" sh.p.k, në adresën rruga "Kuvendi Françeskan", Spitallë, Bashkia Durrës, u konstatua si më poshtë:
Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr. 1326-23/2, datë 25/10/2023. Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **DR_UB_IE1_457/41,** në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:




| **Njësia strukturore** | **DR_UB_IE1_457/41** |
|---|---|
| **Sistemi** | UB_Urban |
| **Kategori 1** | IE.Industri Ekonomi 100% |
| **Lartësia në kate** | 3 |
| **Lartësia në metra** | Sipas funksionit dhe projektit |
| **PDV** | Jo |
| **Intensiteti** | K1=1.5 |
| **KSHT** | K1=50% |
| **KSHR** | 10% |
| **KSHP** | 30% |
| **Nënkategori 1** | IE1_ Industri e Lehtë |
| **Nënkategori 2** | IE3_ Aktivitet Ekonomik Kompleks |
| **Parcela minimale** | 5000 m2 |
| **Përdorime të lejuara** | Kategoritë e Sistemit Urban: vetëm nënkategoria S2- Shërbime tregtare dhe biznesi. Të gjitha kategoritë e Sistemit Infrastrukturor, të shqyrtuara rast pas rasti, në varësi të shkallës së ndotjes dhe pajisjes me leje mjedisore përkatëse, si dhe respektimit të brezave mbrojtës nga monumentet e natyrës, sistemi ujor apo monumentet e kulturës. |
| **Përdorime të ndaluara** | Të gjitha kategoritë e tjera të sistemit urban. Kategoritë e sistemit bujqësor. |

Të dhënat e treguesve të zhvillimit të pasqyruara në lejen e ndërtimit janë si më poshtë:
Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës është 18,700 m$^2$
Sipërfaqja e tokës e zënë nga struktura është 9,022 m$^2$
Sipërfaqja totale e tokës e zënë nga strukturat (objekt + vendroje + kabinë elektrike) është 9,045 m$^2$ (9,022 + 7 + 16)
Koefiçienti i shfrytëzimit të territorit është 48.37 %
Sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është 9,045 m$^2$
Intensiteti i ndërtimit është 0.48
Lartësia maksimale është 9.80 metra
Numri i kateve mbi tokë është 1
Numri i kateve nën tokë 0

- Përsa i përket respektimit të distancave nga kufiri i pronës, distancat janë në përputhje me ato të përcaktuara në lejen e zhvillimit, si më poshtë:

Distanca nga kufiri i pronës në orientimin verior është 3.4 m dhe 50.3 m për volumin 1 kat
Distanca nga kufiri i pronës në orientimin jugor është 4.6 m dhe 5.9 m për volumin 1 kat
Distanca nga kufiri i pronës në orientimin lindor është 5.3 m dhe 13.7 m për volumin 1 kat
Distanca nga kufiri i pronës në orientimin perëndimor është 5.0 m për volumin 1 kat
Distanca nga trupi i rrugës ekzistuese në orientimin verior është 6.54 m dhe 53.1 m

- Në lejen e zhvillimit të miratuar janë vendosur kërkesat që duhet të plotësohen në lejen e ndërtimit:


- Të merret mendimi nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
- Të merret dakortësia nga "I", për zhvillimin e pasurisë nr. 33/100, ZK 8517.

Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, neni 21 "*Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor*", pika 6, autoriteti vendor duhet të marrë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga kontrolli i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezulton se nuk është kërkuar mendimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar për marrjen e konformitetit për vijimin e procedurës së lejes së ndërtimit.

- Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë, bazohet në Nenin 46 të Ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar dhe referuar Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, në pikën 1 dhe në pikën 3, gërma a. Sipas Vendimit të **Këshillit Bashkiak Durrës** me nr.149, datë 22.12.2022, *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës"*, në pikën 1.3, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtime të ndryshme është **3%**. Referuar këtyre të dhënave, më poshtë po bëjmë llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë objekt:

Vlera e preventivit e pasqyruar është 269,742,311 lekë.
Në bazë të vlerës së preventivit, taksa e ndikimit në infrastrukturë është:
269,742,311 lekë x 3% (niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë) = 8,092,269 lekë.
Fatura e përcaktuar nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës është në vlerën **8,092,269 lekë**, përllogaritje e cila rezulton në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar); 2.A.H, me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; 3.K.A, me pozicion Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të Lejeve , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (punonjëse e larguar).*

**11. Nga auditimi i procedurës së miratimit të** "*Lejes së ndërtimit për ndërtim të ri , me sipërfaqe më të madhe se 250 m*$^2$", për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 1282-23/5, datë 28/03/2024**, të Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **"Godinë banimi 4 kat me 1 kat nëntokë"**, me zhvillues I.S dhe M.S, në adresën rruga "S.D", lagjja 8, njësia administrative nr. 4, Bashkia Durrës, u konstatua si më poshtë:




| | |
|---|---|
| **Njësia strukturore** | **DR_UB_A2_480/246** |
| **Sistemi** | UB_Urban |
| **Kategori 1** | A.Banim 100 % |
| **Lartësia në kate** | 5 |
| **Lartësia në metra** | 17.4 |
| **PDV** | Jo |
| **Intensiteti** | K1=2.25 |
| **KSHT** | K1=45% |
| **KSHR** | 10% |
| **KSHP** | 30% |
| **Nënkategori 1** | A.2_Banim dhe Shërbime |
| **Kufizime ligjore** | VKM Nr.786, datë 26.12.2018: Per miratimin e Zonave Arkeologjike B te Qytetit te Durrësit dhe planin e ruajtjes, mbrojtjes dhe administrimit te tyre, Ligji Nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" |
| **Parcela minimale** | 500 $m^2$ |
| **Përdorime të lejuara** | Të gjitha kategoritë e Sistemit Urban përveç IE-Industri dhe Ekonomi, V-Varrezë, ZU - Zona ushtarake. |
| **Përdorime të ndaluara** | Kategorite e Sistemit Urban IE-Industri Ekonomi,V- Varreza, ZU-Zona Ushtarake, dhe kategoritë e Sistemit Bujqësor |
| **Kushte të tjera** | KSHP plotësohet duke u Referuar nenit 19, i rregullores PPV/KSHR plotësohet duke u Referuar nenit 18, i rregullores PPV |

Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr. 510-23/3, datë 15.08.2023. Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **DR_UB_A2_480/246,** në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:
Bazuar në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Durrës, miratuar me Vendimin Nr. 4, datë 27.07.2022 të KKT-së, për rastet kur kërkohet zhvillimi i objekteve me lartësi katesh më të vogël se lartësia maksimale e përcaktuar në njësinë strukturore, madhësia e parcelës minimale mund të zvogëlohet në raport me numrin e kateve por duke mos ndryshuar tipologjinë hapësinore të ndërtimit në zonë. Në rastin konkret sipërfaqja e parcelës që do të zhvillohet ndërtimi është 437 $m^2$ dhe objekti zhvillohet në lartësinë e 4 kateve mbi tokë. Të dhënat e treguesve të zhvillimit të pasqyruara në lejen e ndërtimit janë si më poshtë:
Sipërfaqja e truallit që zhvillohet është 437 $m^2$.
Sipërfaqja e tokës e zënë nga struktura është 193 m²
Koefiçienti i shfrytëzimit të territorit është 44.16 %
Sipërfaqe totale ndërtimi mbi tokë është 969.1 m²
Intensiteti i ndërtimit është 2.21
Sipërfaqe totale ndërtimi nëntokë është 340.25 m²
Sipërfaqe totale ndërtimi është 1309.35 m²
Lartësia maksimale është 16.925 m
Numri i kateve mbi tokë është 4 kat
Numri i kateve nën tokë është 1 kat
Sipërfaqe e gjelbër është 49 m²
Numri i vend parkimeve është 8

- Planvendosja e miratuar nuk përkon me projektin e ndërtimit, pasi nuk pasqyrohet sipërfaqja e plotë e gjurmës së ndërtimit, në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin 15, pika 1, gërma c, planvendosja e miratuar.


Nga verifikimi i projektit të ndërtimit u konstatua që projekti arkitektonik dhe projekti konstruktiv kanë mospërputhje në raport me pasqyrimin e platformës hidraulike për aksesin e

automjeteve. Në projektin arkitektonik platforma pozicionohet në katin përdhe dhe zhvillohet në katin nëntokë, ndërsa në projektin konstruktiv, platforma ka soletë sipër dhe realizohet në lartësinë e 1 kati mbi tokë. Gjurma e sipërfaqes së platformës është 26 $m^2$.




Nga verifikimi i projektit në dëg, sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është 1029 $m^2$ (pa përfshirë gjurmën e plaformës), të dhënat të cilat nuk janë në përputhje me treguesit e zhvillimit të paraqitur në lejen e ndërtimit dhe me kondicionet e përcaktuara në njësinë strukturore. Intensiteti i ndërtimit nga 2.2 i lejuar për njësinë strukturore DR_UB_A2_480/246 është 2.35, ndërsa koeficienti i shfrytëzimit të territorit është 47 % nga 45 % i lejuar, në mospërputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin 39 dhe në bazë të Rregullores së Planit të miratuar me vendimin e KKT-së nr.4, datë 27.07.2022.

- Gjithashtu lartësia e ndërtimit e lejuar është 17.4 metra për objektin në lartësinë e 5 kateve, ndërsa objekti i propozuar është në lartësinë e 4 kateve (për arsye të sipërfaqes më të vogël të parcelës në të cilën do të zhvillohet ndërtimi) dhe duhet të ishte në lartësinë 15.3 metra (3.1 metër lartësia e banimit x 3 kate =9.3 metra + 5 metra shërbim + 1 metër parapeti). Në bazë të nenit 16, të Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr.4, datë 27.07.2022, në pikën 3 dhe 4, përcaktohet që lartësia maksimale e katit të banimit është 3.1 metër, ndërsa lartësia maksimale e katit të shërbimit është 5 metër. Nga shqyrtimi i projektit lartësia e katit të banimit është 3.85 metra. Lartësia totale e ndërtimit është 16.9 metra, lartësi e cila nuk është në përputhje me rregulloren e planit, si dhe me treguesit e zhvillimit të përcaktuara në njësinë strukturore.




- Përsa i përket respektimit të distancave nga kufiri i pronës, objekti kufizohet nga të tre anët me rrugë. Në bazë të VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", të ndryshuar, neni 36, pika 3, gërma a, përcaktohet që: "për gjerësi rruge, me ose pa trotuare, më të vogël se 7 (shtatë) metra, distanca minimale është 2.5 (dy pikë pesë) metra". Distanca që ka ruajtur objekti nga kufiri i rrugës është nga 3.3 metra deri në 8.6 metra.

Në lidhje me respektimin e distancave nga kufiri i pronës, në orientimin verior është faqe kallkan dhe ka deklaratë nga kufitari për të realizuar objektin bashkëngjitur.
Ndërsa distanca nga kufiri i pronës në orientimin jugor është 3.4 metra.
Distanca nga kufiri i pronës në orientimin lindor është 1.5 m dhe 1.6 m .
Distanca nga kufiri i pronës në orientimin perëndimor është 5.2 m dhe 5.4 m për objektin në lartësinë e 4 kateve. Në dokumentet e ngarkuar në sistemin e-leje, paraqitet deklarata noteriale nr. rep 873, nr. kol 306, datë 31.03.2023, në të cilën paraqitet miratimi i kufitarit për të realizuar ndërtimin bashkëngjitur pronës kufitare, me faqe kallkan.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, rezulton se, mbi pasurinë me nr. 4/327, në zonë kadastrale 8512, në sipërfaqen e truallit prej 437 $m^2$ në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, ka edhe një objekt ekzistues me sipërfaqe 109 $m^2$. Me anë të Deklaratës Noteriale Nr. repertori 740, Nr. koleksioni 259, datë 20.03.2023, pronarët deklarojnë me vullnet të lirë se janë dakort për prishjen e objektit ekzistues. Për prishjen e objekteve ekzistuese, pjesë e lejes së ndërtimit duhet ishte edhe leja për prishjen e objekteve sipas VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, të ndryshuar, neni nr.11 pika "ç" ku citohet se "*Punimet për të cilat kërkohet pajisja me leje ndërtimi, sipas nenit 39 të Ligjit, janë ato që: ..."ç" kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri. Nëse prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes*". Sa më sipër miratimi i kësaj leje është bërë në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, të ndryshuar, neni 11.
- Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë, bazohet në Nenin 46 të Ligjit 107/2014 *"Për planifikimin*
- *dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar dhe referuar Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, në pikën 1 dhe në pikën 2. Sipas Vendimit të **Këshillit Bashkiak Durrës** me nr.194, datë 22.12.2023, *Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës"*, në pikën 1.3, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregtimi e shërbimi është **8%**. Referuar këtyre të dhënave, më poshtë pasqyrohet llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë objekt:

| Emërtimi i katit teknik | Sipërfaqe ndërtimi/$m^2$ | Çmimi shitje (lek/$m^2$)/ zonë | Vlera (lekë ) | Koeficient | Vlera Totale (lekë) |
|---|---|---|---|---|---|
| Parkime | | | | | |
| Kati -1 nëntokë | 340 | 67,500 | 22,950,000 | 0.7 | 16,065,000 |
| Shërbime | | | | | |
| Kati përdhe | 208 | 67,500 | 14,040,000 | 1.5 | 21,060,000 |
| Banim | | | | | |
| Kati i parë | 267 | | | | |
| Kati i dytë | 267 | | | | |
| Kati i trete | 267 | | | | |
| Dalja e nuklit të shkallës dhe ashensorit në tarracë | 20 | | | | |
| Sipërfaqja totale e banimit | 821 | 67,500 | 55,417,500 | 1 | 55,417,500 |
| | | | **Vlera totale investimit** | | **92,542,500** |
| | | | **Vlera e taksës TNI =8%** | | **7,403,400** |


| **Llogaritja e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) për godinën e banimit** | |
|---|---|
| **Vlera që duhet likuiduar e taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **7,403,400** |
| **Vlera e llogaritur nga bashkia e taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **3,453,245** |
| **Diferenca e vlerës totale të taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **3,950,155** |

Fatura e përllogaritur nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës është **3,453,245 lekë**, ndërsa llogaritja e saktë ka vlerën **7,403,400 lekë**, e pasqyruar në tabelën e mësipërme. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit në dëg janë konstatuar diferenca në sipërfaqe

në llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Diferenca ndërmjet dy vlerave të mësipërme prej **3,950,155 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetit e bashkisë.


*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar); 2.A.H, me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; 3.K.A, me pozicion Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të Lejeve , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (punonjëse e larguar).*

**12. Nga auditimi i procedurës së miratimit të** "Certifikatës së përdorimit ", për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 1051/3, datë 19/09/2023**, të Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **"Godinë banimi dhe shërbimi 1-6-8 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë",** në pasurinë me nr. pasurie 46/474, ZK 8518, në pronësi të A.I ( H.) dhe adresën lagjja 13, Plazh Durrës, paraqitur nga zhvilluesi" "K"" sh.p.k, u konstatua si më poshtë:





Për miratimin e certifikatë së përdorimit është bazuar në Vendimin për leje ndërtimi nr.4, datë 25.04.2013 për objektin "Godinë banimi dhe shërbimi 1-6-8 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë", në pronësi të familjes A.I dhe subjekti ndërtues "M" sh.p.k dhe lejes për ndryshimin e subjektit zhvillues nr.1526, datë 26.02.2021, për objektin "Godinë banimi dhe shërbimi 1-6-8 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë", me zhvillues "K" sh.p.k

Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin Neni 27/2, në pikën 1, gërma g, përcaktohet që në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë është projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti "as build" (i zbatuar); Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet vetëm projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, **por nuk paraqitet projekti "as build" i zbatuar,** pasi në realizimin e punimeve të ndërtimit ka ndryshime.



Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin Neni 27/2, në pikën 1, gërma j, përcaktohet që në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë janë edhe fotografitë e objektit në të gjitha drejtimet. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet nuk paqiten fotot në të gjitha drejtimet e realizimit të objektit, por vetëm disa nga faqet e objektit në aktin e kolaudimit.



Nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe nga foto ajrore, u konstatuan ndryshime në realizimin e punimeve të ndërtimit nga projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, pasi janë shtuar volume ndërtimi në katin përdhe dhe në katin e fundit. Gjithashtu janë realizuar punimet në sistemimin e jashtëm të objektit jashtë kufirit të pronës. Më poshtë pasqyrohen foto në të cilat evidentohen ndryshimet nga projekti i miratuar.





Në bazë të ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, Neni 42, në pikën 3, përcaktohet se certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e Kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor. Ndërsa në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi.


Gjithashtu, bazuar në Neni 27/1, mbikëqyrja e punimeve, pika 3, të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, përcaktohet se: " Në çdo rast, verifikimi dhe konfirmimi i akteve të Kontrollit , sipas shkronjave "ç" dhe "dh", të këtij neni, janë të detyrueshme." *Në rast se konstatohet mospërputhje e faktit me aktkontrollet e mbajtura, ai merr masat e nevojshme kundrejt subjektit ndërtues, si dhe subjekteve të licencuara që janë shprehur në aktkontrolle.".* Autoriteti vendor nuk ka kryer verifikimet e nevojshme përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, duke sjellë si pasojë ndryshimin e projektit të ndërtimit dhe devijim nga leja e ndërtimit të miratuar.


Mungesa e Kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Durrës, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim 107/2014, datë 31.07.2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, Neni 51, Inspektimi, dhe Neni 52, *Kundërvajtje administrative dhe ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007,* "*Për inspektimin e ndërtimit", Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar,* ka sjellë si pasojë devijimin nga leja e ndërtimit e miratuar dhe zhvillimin e punimeve të ndërtimit të kryera jashtë kufirit të pronës.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar);2.K.A, me pozicion Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të Lejeve , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (punonjëse e larguar);*

*3.E.L, me pozicion Përgjegjës i Sektori të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar); 4.V.S, me pozicion specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të lejeve, Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar);5.D.Gj., me pozicion specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të lejeve , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit ; 6.D.M, me pozicion Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (punonjës i larguar).*

**13.** Nga auditimi i procedurës së miratimit të "Certifikatës së përdorimit ", për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 1682/4, datë 11.05.2023**, të Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **"Godinë Banimi dhe shërbimi 1-5-6 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë garazh",** në rrugën "R.J", në Durrës, paraqitur nga zhvilluesi shoqëria "D" sh.p.k, u konstatua si më poshtë:
Për miratimin e certifikatë së përdorimit është bazuar në Vendimin për leje ndërtimi Nr. 136 datë 27.02.2019, për objektin "Godinë Banimi dhe shërbimi 1-5-6 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë garazh", me zhvillues shoqërinë " "D" ", ndërtuar nga subjekti zbatues " "D" " sh.p.k, në adresën rruga " R.J", Durrës



➢ Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në nenin Neni 27/2, në pikën 1, gërma g, përcaktohet që në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë është projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti "as build" (i zbatuar); Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet vetëm projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, **por nuk paraqitet projekti "as build" i zbatuar,** pasi nga verifikimi i realizimit të punimeve të ndërtimit ka ndryshime.

➢ Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin Neni 27/2, në pikën 1, gërma j, përcaktohet që në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë janë edhe fotografitë e objektit në të gjitha drejtimet. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje **nuk paraqiten fotot në të gjitha drejtimet e realizimit të objektit**, por vetëm disa nga faqet e objektit në aktin e kolaudimit.

Nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe nga foto ajrore, u konstatuan ndryshime në realizimin e punimeve të ndërtimit nga projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, pasi janë shtuar volume ndërtimi në katin përdhe dhe në katin e fundit. Më poshtë pasqyrohen fasadat e objektit të parë në të cilat evidentohen ndryshimet nga projekti i miratuar.






Në bazë të ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Neni 42, në pikën 3, përcaktohet se certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e Kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor. Ndërsa në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë.
Gjithashtu, bazuar në Neni 27/1, mbikëqyrja e punimeve, pika 3, të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, përcaktohet se: " Në çdo rast, verifikimi dhe konfirmimi i akteve të Kontrollit , sipas shkronjave "ç" dhe "dh", të këtij neni, janë të detyrueshme." *Në rast se konstatohet mospërputhje e faktit me aktkontrollet e mbajtura, ai merr masat e nevojshme kundrejt subjektit ndërtues, si dhe subjekteve të licencuara që janë shprehur në aktkontrolle".* Autoriteti vendor nuk ka kryer verifikimet e nevojshme përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, duke sjellë si pasojë ndryshimin e projektit të ndërtimit dhe devijim nga leja e ndërtimit të miratuar.

- Mungesa e Kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Durrës, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim *107/2014, datë 31.07.2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Neni 51, Inspektimi e Neni 52, Kundërvajtje administrative dhe ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007,* "*Për inspektimin e ndërtimit", Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar,* ka sjellë si pasojë devijimin nga leja e ndërtimit e miratuar.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar);2.E.L, me pozicion Përgjegjës i Sektori të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjëse i larguar); 3.E.K, me pozicion Përgjegjës sektori, Sektori i Kontrollit të Territorit dhe marrëdhënieve me Publikun Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjëse e larguar); 4.D.M, me pozicion Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (punonjës i larguar).*


**14**. Nga auditimi i procedurës së miratimit të "Certifikatës së përdorimit ", për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 499/3 , datë 17/05/2024**, të Kryetarit të Bashkisë Durrës për objektin **" 3 godI. 1-6-7 kate mbi tokë (4 Kate Apartamente turistike dhe 3 kate Apart - Hotel) me 2 kat parkimi nëntokë",** në Lagjen Nr.l, C.la, në Durrës, paraqitur nga zhvilluesi "D" sh.p.k, u konstatua si më poshtë:
Për miratimin e çertifikatë së përdorimit është bazuar në :


-Lejen e ndërtimit nr. 735, me datë 18/06/2020
-Lejen e ndërtimit me nr.11065 prot. me datë 18/06/2020
-Zëvendësimin e Lejes së Ndërtimit nr. 707, datë 27/09/2018, me vendim me Nr. 1108-23/5 Prot. datë 07/12/2023, për "Rishikimin e kushteve të lejes dhe ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit"




Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, projekti "as build" i zbatuar dhe relacioni i bashkëngjitur pasqyron edhe një destI.cion tjetër nga ai i miratuar në lejen e ndërtimit dhe në çertifikatën e përdorimit. Leja e ndërtimit është miratuar për realizimin e 3 godI.ve të destinuara për turizëm, ndërsa në relacion përshkruhet që një pjesë e godI.ve me apartamente ka funksion banimi për qëllim shitjeje, në mospërputhje me gërmën b, të pikës 7, të nenit 27, të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", të ndryshuar, në të cilën citohet: "*lëshimi i çertifikatës së përdorimit të objektit, që vërteton përfundimin e punimeve, <u>në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit si dhe zbatimin e kritereve të dokumenteve të planifikimit e të Kontrollit të zhvillimit</u>*."

➢ Leja e ndërtimit dhe certifikata e përdorimit kanë destI.cion në funksion të turizmit, ndërsa në projektin e pasqyruar për çertifikatë përdorimi projekti i godI.ve në funksion të turizmit nuk pasqyrohet si një objekt i plotë, por fragmentohet në disa njësi të shkëputura me apartamente dhe parkime, si njësi më vete me destI.cion banimi e parkimi për qëllim shitjeje. Më poshtë pasqyrohen fragmente nga projekti "as build" i zbatuar në të cilin evidentohet fragmentimi i njësive të banimit dhe njësive të parkimit.




Referuar VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin Neni 27/2, në pikën 1, gërma j, përcaktohet që në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë janë edhe fotografitë e objektit në të gjitha drejtimet. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet nuk paraqiten fotot në të gjitha drejtimet e realizimit të objektit, por vetëm disa nga faqet e objektit në aktin e kolaudimit. Gjithashtu në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, në nenin Neni 27/2, në pikën 1, germa k, përcaktohet që në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë është edhe kontrata e nënshkruar

ndërmjet zhvilluesit dhe shoqërisë/shoqërive ndërtuese, shoqëruar me licencën përkatëse; Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet nuk evidentohet kontrata e lidhur ndërmjet zhvilluesit dhe shoqërive ndërtuese.
Certifikata e përdorimit nuk është lëshuar në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit dhe në zbatim të kritereve të dokumenteve të planifikimit e Kontrollit të zhvillimit, për shkak të ndryshimit të destI.cionit. Çertifikimi i tyre si objekte me dentI.cion në funksion të turizmit, si dhe ndryshimi i kushteve të lejes së ndërtimit të miratuar, ndikojnë në shmangien e likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas destI.cionit real të objektit, në mospërputhje me ligjin 107/2014, datë 31.7.2014, "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, Neni 42, në pikën 3, përcaktohet se **certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e Kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes** ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor. Gjithashtu, bazuar në Neni 27/1, mbikëqyrja e punimeve, pika 3, të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, përcaktohet se: " Në çdo rast, verifikimi dhe konfirmimi i akteve të Kontrollit , sipas shkronjave "ç" dhe "dh", të këtij neni, janë të detyrueshme." *Në rast se konstatohet mospërputhje e faktit me aktkontrollet e mbajtura, ai merr masat e nevojshme kundrejt subjektit ndërtues, si dhe subjekteve të licencuara që janë shprehur në aktkontrolle.".* Autoriteti vendor nuk ka kryer verifikimet e nevojshme përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, duke sjellë si pasojë ndryshimin e destI.cionit dhe kushteve të lejes së ndërtimit dhe shmangien e likuidimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas destI.cionit konkret.

Mungesa e Kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Durrës, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim *107/2014, datë 31.07.2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Neni 51, Inspektimi e Neni 52, Kundërvajtje administrative dhe ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007,* "*Për inspektimin e ndërtimit", Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar,* ka sjellë si pasojë ndryshimin e destI.cionit dhe kushtet e lejes së ndërtimit të miratuar.
*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1.R.D., me pozicion ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar);2.K.A, me pozicion Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të Lejeve , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (punonjëse e larguar); 3.E.Z, me pozicion Specialist në Sektorin e Gjeoinformacionit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (punonjës i larguar); 4.F. Z., me pozicion specialist në Sektorin e Gjeoinformacionit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; 5.D.M, me pozicion Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (punonjës i larguar).*

Në lidhje me gjetjet e kostatuara nga grupi i auditimit në fazën e Projekt Raportit të Auditimit, mbi auditimin e organizimit dhe funksionimin e planifikimit të zhvillimit të territorit, me shkresën e administruar në KLSH me Nr.668/88 Prot., datë 17.06.2026 dhe me shkresën nr. 1347/71 prot., datë 18.06.2026, është observuar nga Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës, si më poshtë:
**Pretendimet e subjektit:** Në lidhje me gjetjen e konstatuar nga grupi i auditimit për mosrespektimin e të gjitha kondicioneve urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe në lejen e zhvillimit, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se: "*Në disa nga lejet e sipërcituara, leja e zhvillimit është miratuar nga KKTU ku janë miratuar të gjitha parametrat e zhvillimit, të cilat nuk mund të ndryshohen nga ana jonë, në zbatim të legjislacionit ne fuqi.".*
**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, ndonëse leja e zhvillimit është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit, pas lidhjes së marrëveshjes për delegimin e kompetencave për kryerjen e procedurave administrative/ligjore, që në fazën e

paraqitjes së aplikimit fillestar, në miratimin e lejes së ndërtimit, deri në datën e lëshimit të çertifikatës së përdorimit, kompetencat ushtrohen nga Bashkia Durrës. Në një nga pikat e aktmarrëveshjes së lidhur, përkatësisht në pikën 3.2 ii, citohet që është në kompetencë të bashkisë *shqyrtimi, verifikimi dhe vlerësimi i dokumentacionit përkatës teknik, që të jetë në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.* Nëse gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të pasqyruar në aplikimin për leje ndërtimi konstatohen mospërputhje/paqartësi është në kompetencë të bashkisë për të verifikuar dhe vlerësuar dokumentacionin e miratuar. Përsa më sipër trajtuar, pretendimet tuaja merren pjesërisht në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit:** Në lidhje me gjetjen e konstatuar nga grupi i auditimit për mungesën e përcaktimit të të gjitha kushteve në dokumentin e lejes së ndërtimit, specifikisht mungesa e lejes për prishjen e objekteve ekzistuese, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se: "*Qëndrimi juaj eshtë pjesërisht i drejtë sepse në nje rast kemi Deklarate Noteriale që objektet që pasqyrohen në çertifikatën e pronësisë nuk ekzistojnë në terren pasi janë amortizuar dhe demoluar ndër vite, faktuar edhe në Planin e Rilevimit.".*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në kushtet kur observacioni i paraqitur nga subjekti nuk ka të bëjë me kundërshtime mbi gjetjen e lënë nga grupi i auditimit, por në thelb e konfirmon atë, të jetë në vëmendje që në përcaktimin e kushteve të lejes së ndërtimit, pjesë përbërëse e saj të jetë edhe leja për prishjen e objekteve që janë pjesë e pasurive që marrin pjesë në zhvillim. Përsa i përket rastit që paraqitet deklarata noteriale që objektet që pasqyrohen në çertifikatën e pronësisë nuk ekzistojnë në terren, pretendimet tuaja merren në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit:** Në lidhje me gjetjen e konstatuar nga grupi i auditimit për mangësitë e evidentuara në dokumentacionin e pronësisë, përkatësisht në përditësimin e kartelave të pasurive dhe hartave treguese, si dhe konformiteti i ASHK-së përpara miratimit të lejes, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se:"*Në asnjë rast nuk është miratruar leja pa konformitet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Bashkelidhur po ju dërgojmë edhe konformitetet.".*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përsa i përket observacionit të paraqitur nga ana Juaj mbi gjetjen e lënë nga grupi i auditimit, ndonëse kërkesës drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, neni 21 "*Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor*", pika 6, autoriteti vendor duhet të marrë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit, përcakton që: "*…informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën".* Në rastet e konstatuara nga grupi i auditimit, Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit i ka kërkuar mendim AShK-së Durrës dhe institucioni është kufizuar vetëm në dhënien e dakortësisë, por nuk është dërguar statusi i pronësisë/kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit. Përsa më sipër trajtuar, merren pjesërisht në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit**: Në lidhje me gjetjen e konstatuar nga grupi i auditimit për mangesitë e evidentuara në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, pasi disponohej vetëm në dosjen fizike nga autoriteti përgjegjës, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se: "*Në disa raste sistemi e-leje ka patur probleme me funksionimin e tij dhe materialet mund të gjenden të ngarkuara në folderin "Te Tjera" në sistemin e-leje."*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, lidhur pretendimet tuaja nuk janë të mbështetura mbi prova apo fakte mbi të cilat grupi i auditimit të vlerësojë pamundësinë objektive për zbatimin e afatave. Në këto kushte, observacioni jua nuk merret në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit**: Në lidhje me gjetjen e konstatuar për mungesën e kryerjes së oponencës teknike, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se: "*Qëndrimi juaj nuk është i*

*drejtë sepse vlera e preventivuar është më pak se 100,000,000 lekë. Ne këto raste nuk kërkohet Oponenca Teknike sipas legjislacionit në fuqi. Bashkëlidhur gjeni preventivin.".*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, objekti është një strukture shërbimi dhe akomodimi, *në funksion të publikut*. Nga verifikimi i sipërfaqeve të përgjithshme të ndërtimit në projektin dëg, u konstatuan që vlera totale e investimit referuar sipërfaqes totale të ndërtimit, referuar çmimit mesatar sipas kostos së ndërtimit tejkalon vlerën prej 100,000,000 lekë. Gjithashtu, referuar pikës 1, të nenit 6, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, përcaktohet që: "*Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha*: b) *ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik*". Në këto kushte, observacioni jua nuk merret në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit**: Në lidhje me gjetjen e konstatuar për mungesën e marrjes së të gjitha mendimeve dhe konformitetet nga autoritetet e tjera, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se: " *Qëndrimi juaj nuk është i saktë sepse në sistem janë të gjitha konformitetet dhe miratimet në heshtje nga institucionet kompetente. Bashkëlidhur po ju dërgojmë konformitetet.".*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, neni 21 "*Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor*", pika 6, autoriteti vendor duhet të marrë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Në lejen e konstatuar me objekt "*Godinë industriale 1 kat, vendroje, kabinë elektrike dhe mur rrethues*", miratuar me vendimin Nr. 1562-23/4, datë 15/01/2024, me zhvillues shoqëria "T" sh.p.k, në adresën rruga "*Kuvendi Françeskan*", Spitallë, Bashkia Durrës, nga kontrolli i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezulton se nuk është kërkuar mendimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar për marrjen e konformitetit për vijimin e procedurës së lejes së ndërtimit. Në këto kushte, observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit**: Në lidhje me gjetjen e konstatuar për vlerësimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës shprehen se:"*Të dyja rastet do të shqyrtohen në vijimesi sipas legjislacionit në fuqi ku do të kemi parasysh edhe rekomandimet tuaja.".*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në kushtet kur observacioni i paraqitur nga subjekti nuk ka të bëjë me kundërshtime mbi gjetjen e lënë nga grupi i auditimit, por në thelb e konfirmon atë, të jetë në vëmendje nga autoriteti përgjegjës për të rivleresuar taksën e ndikimit në infrastrukturë në bazë të destI.cionit të objektit dhe referuar sipërfaqeve të rishikuara në ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit.

## 2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV.

- *Mbi strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor .*

Për kryerjen e aktivitetit të tij, IMT Bashkia Durrës disponon vetëm 2 automjete për nevoja të inspektimit ditor, ndërsa përsa i përket rasteve të prishjes së ndërtimeve të kundërligjshme bashkëpunon me Ndërmarrjen e Shërbimeve pranë Bashkisë Durrës.

Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe IMTV, Bashkia Durrës, në lidhje me organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*",* i ndryshuar. Në strukturën e miratuar me Vendimin nr. 102, datë 20.04.2022, IMTV ka në përbërje ***14*** pozicione pune, nga të cilët ***1 (një)*** Kryeinspektor, ***9*** inspektorë, ***1 (një)*** jurist, ***1 (një)*** specialist fI.nce dhe ***2 (dy)*** shoferë, të paraqitura në formë tabele si vijon:

***Tabela nr. 1:*** *Struktura e IMTV-Bashkia Durrës, 01.01.2023 - 31.12.2023*

| Nr. | Emër Mbiemër | Funksioni | Lloji i arsimit/dega | Emërimi | Largimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | D.M | K/Inspektor | Dega Drejtësi | 19.03.2021 | |
| 2 | I.D | Inspektor | Ing. Markshajder/ Ing Miniere | 18.12.2007 | |
| 3 | M.M. | Jurist | Dega Drejtësi | 29.08.2019 | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4 | A.H | Inspektor | Dega M.Turizëm Arke, Shk.Politik-Juridk | 12.05.2021 | |
| 5 | S.M | Inspektor | Dega Drejtësi | 17.06.2019 | |
| 6 | M.D | Inspektor | Dega Ing.Mekanik | 27.11.2007 | |
| 7 | B.M | Inspektor | Dega Shkencat e lëvizjes | 01.01.2016 | |
| 8 | K.L | Inspektor | Dega Administrim Publik | 06.05.2014 | |
| 9 | G.H | Inspektor | Dega Gjeoinxhinieri | 26.12.2017 | |
| 10 | A.G | Inspektor | Dega Drejtësi | 25.06.2018 | |
| 11 | M.X | Specialist FI.nce | Dega FI.ncë-Kontabilitet | 24.01.2020 | |
| 12 | E.L | Inspektor | Dega Drejtësi | 17.12.2018 | 31.01.2024 |
| 13 | D.N | Shofer | | | |
| 14 | H.H | Shofer | | | |

***Burimi:*** *Sektori i Burimeve Njerëzore dhe IMTV, Bashkia Durrës*

***Tabela nr. 2:*** *Struktura e IMTV-Bashkia Durrës, 01.01.2024 - 31.12.2024*

| Nr. | Emër Mbiemër | Funksioni | Lloji i arsimit/dega | Emërimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | D.M | K/Inspektor | Dega Drejtësi | 19.03.2021 |
| 2 | I.D | Inspektor | Ing. Markshajder/ Ing Miniere | 18.12.2007 |
| 3 | M.M. | Jurist | Dega Drejtësi | 29.08.2019 |
| 4 | A.H | Inspektor | Dega M.Turizëm Arke, Shk.Politik-Juridk | 12.05.2021 |
| 5 | S.M | Inspektor | Dega Drejtësi | 17.06.2019 |
| 6 | M.D | Inspektor | Dega Ing.Mekanik | 27.11.2007 |
| 7 | B.M | Inspektor | Dega Shkencat e lëvizjes | 01.01.2016 |
| 8 | K.L | Inspektor | Dega Administrim Publik | 06.05.2014 |
| 9 | G.H | Inspektor | Dega Gjeoinxhinieri | 26.12.2017 |
| 10 | A.G | Inspektor | Dega Drejtësi | 25.06.2018 |
| 11 | M.X | Specialist FI.nce | Dega FI.ncë-Kontabilitet | 24.01.2020 |
| 12 | K.S | Inspektor | Dega Matematik-Informatik | 07.02.2024 |
| 13 | D.N | Shofer | | |
| 14 | H.H | Shofer | | |

***Burimi:*** *Sektori i Burimeve Njerëzore dhe IMTV, Bashkia Durrës*

Për periudhën objekt auditimi, IMTV është drejtuar nga Kryeinspektor, z. D.M, i cili rezulton me arsim të lartë në degën drejtësi. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se për periudhën e auditimit 01.01.2023 - 31.12.2024, arsimimi i 3 inspektorëve të IMTV Bashkia Durrës, konkretisht B. M., K. L., K. S., nuk është në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 *"*Për Inspektimin e Ndërtimit*"*, i ndryshuar me Ligjin nr. 183/2014 *"*Për inspektimin e ndërtimit*"*, neni 11.

Mungesa e stafit të kualifikuar, sidomos atij inxhinierik përbën mungesë cilësore për mbarëvajtjen e punës së inspektoratit, pasi nuk kanë kualifikimet e nevojshme për të kryer akte kontrolli, apo për të përcaktuar dhe përshkruar teknikisht situatat e konstatuara gjatë inspektimit.

**Konstatim*:*** Burimet në dispozicion të strukturës së IMTV-së nuk kanë arsimin e lartë të nevojshëm profesional. Kjo mbart riskun e pamjaftueshmërisë së burimeve për arritjen e objektivave në sasi, por mund të cenojë edhe cilësinë e punës së Inspektoratit.

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi*: *Znj. E.S*, me funksion Kryetar i Bashkisë Durrës, për rekrutimin e punonjësve të IMTV-së, pa plotësuar kushtin e arsimimit të përcaktuar dhe *Znj. D.G*, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Durrës, për rekrutimin e punonjësve të IMTV-së, pa plotësuar kushtin e arsimimit të përcaktuar.

Lidhur me objektet dhe gjetjet sa më sipër, me shkresën me nr. 668/88 Prot, datë 17.06.2026, administruar në KLSH nr. 1347/71, Prot dt 18.06.2026, ka paraqitur observacion IMTV Bashkia Durrës, për periudhën e audituar, si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me arsimimin e punonjësve të IMTV, shprehen se: *"Lidhur me arsimin e inspektorëve të IMTV Bashkia Durrës konkretisht: A.H. është paraqitur Diplomë "Master Profesional" në "E Drejtë e Pronës" me nr. Diplomë nr. 757 Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, të z. A.L.H, inspektor pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Bashkia Durrës, Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu".*

*Informacioni/dokumentacioni është paraqitur më parë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerzore, Bashkia Durrës. Inspektori K.L. me arsim dega "Administrim Publik", Master Menaxhim Marketing Universiteti "A. Moisiu".*

**Qëndrimi i grupit të auditimit**: Grupi i auditimit, referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti vendos që të marrë parasysh dokumentacionin sa i përket arsimimimit të inspektorit A. H., kurse për inspektorin K.L. arsimimi nuk është në përputhje me nenin 11 të Ligjit 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar. Si rrjedhojë *observacioni juaj do të merret në konsideratë pjesërisht* dhe do të reflektohet përgjatë materialit.

*- Mbi planifikimin e inspektimeve dhe raportimin periodik:*

2.1 Mbi planifikimin e inspektimeve:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet t'i ushtrojë detyrat e tij funksionale në bazë të planeve mujore, tri-mujore dhe/ose vjeçare të punës, sipas planifikimit, i cili hartohet nga kryeinspektori i IMTV-së, në zbatim të VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore",* nënpika b.ii. Nga grupi i auditimit është kërkuar dokumentacion dhe informacion mbi hartimin e tyre, në mënyrë periodike dhe përcjelljen tek strukturat e varësisë.

Nga sa është konstatuar për periudhën e auditimit 01.01.2023-31.12.2024, nga IMTV Bashkia Durrës nuk është vendosur në dispozicion asnjë plan pune, i miratuar nga kryeinspektori, referuar kuadrit ligjor sa më sipër.

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi*: *Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektori të IMTV për periudhën 01.01.2023-31.12.2024, për mos-hartimin e planeve të punës sipas përcaktimeve të procedurës ligjore.*

**2.2 Mbi raportimin periodik:**

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet të përgatisë dhe t'i japë të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj, për masat e marra, si p.sh.: vendimet e marra ndaj kundërvajtjeve të konstatuara (pezullim, gjobë, prishje të objektit të kundërligjshëm), kallëzimet penale, si dhe kërkesat për heqje të licensave profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, sipas përcaktimeve të nenit 5, të Ligjit nr. 9780, datë 16/07/2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika f). Nga ana e IMTV nuk është vendosur në dispozicion asnjë raportim për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023. Kurse për periudhën objekt auditimi, 01.01.2024-31.12.2024, ka vetëm një raportim në IKMT dhe DRIKMT Durrës, me shkresën me nr. 781 prot., datë 11.04.2024, por mungojnë raportimet për 3-mujoret në vijim të Vitit 2024. Si edhe konstatohet, nga dokumentacioni i kërkuar dhe vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk është kryer raportimi periodik, për periudhën nën auditim, sipas parashikimeve ligjore në fuqi të sipërcituara.

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, për mos-kryerjen e raportimit periodik ndaj IKMT;*

Lidhur me objektet dhe gjetjet sa më sipër, me shkresën me nr. 668/88 Prot, datë 17.06.2026, administruar në KLSH nr. 1347/71, Prot dt 18.06.2026, ka paraqitur observacion IMTV Bashkia Durrës, për periudhën e audituar, si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** Lidhur mbi planifikimin e inspektimeve shpehen: *Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Durrës, me shkresën nr. 60/1 prot., datë 17.01.2024 i jemi drejtuar Drejtorisë së Buxhetit Sektorit të Analizës Statistikës dhe Planifikimit Afatmesëm, ku është dërguar informacion mbi planin vjetor të IMT-së, për të gjitha procedurat e mbajtura si:*

*- "Akte konstatimi të mbajtur", "Vendim Prishje Objektit të Kundërligjshëm", "Vendime Pezullim Punimesh", Vendim për dënimin me gjobë, shkresa të ndryshme, në bashkëpunim*

*ndërinstitucional si: IKMT, ASHK, IKMT, por edhe Drejtoria Rajonale Durrës etj. Çka do të thotë se: IMT Bashkia Durrës ka bashkëpunim dhe korrespondencë të vazhdueshme me institucionet ligjzbatuese.*
*Gjithashtu nga Kryeinspektori i IMTV-së Bashkia Durrës bazuar është nxjerrë:*
*- Urdhër nr. 29 dt 17.05.2021 me nr. 1173 prot., "Për Organizimin e punës, ndarja në grupe e inspektoreve të terrenit si dhe ndarja në grupe të inspektorëve dhe punonjësve të IMT-së Durrës;*
*- Urdhër nr. 43 dt 14.11.2024 me nr. 2525 prot. "Për Organizimin e punës, ndarja në grupe e inspektoreve të terrenit si dhe ndarja në grupe të inspektorëve dhe punonjësve teë IMT-së Durrës;*
**Qëndrimi i grupit të auditimit**: Referuar observacionit dhe dokumentacionit të vendosur në dispozicion grupit të auditimit, pretendimi juaj nuk merret në konsideratë, pasi gjatë fazës së auditimit në terren nuk është vendosur në dispozicion dokumentacion provues, sa i përket analizës vjetore. Ka vetëm një informacion sipas përcaktimeve të nenit 5, të Ligjit nr. 9780, datë 16/07/2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika f). Për periudhën objekt auditimi, 01.01.2024 - 31.12.2024, ka vetëm një raportim në IKMT dhe DRIKMT Durrës, me shkresën me nr. 781 prot., datë 11.04.2024, por mungojnë raportimet për 3-mujoret në vijim të Vitit 2024.
*Sa më sipër, nuk përbën fakt të ri dhe nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.*

*- Mbi dokumentimin e kundërvajtjeve e proceseve të prishjeve me evidenca fotografike:*
*3.1 Mbi dokumentimin e kundërvajtjeve*:
Në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të kundërvajtjes së konstatuar me foto ose video, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë.
Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për periudhën objekt auditimi 01.01.2023-31.12.2024 është konstatuar se: për Vitin 2023, në 26 raste (nga 169 procedura që ka mbajtur IMTV), kurse për Vitin 2024, në 27 raste (nga 194 procedura që ka mbajtur IMTV) kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me fotografi ose video dhe nuk është bërë pjesë e dosjes individuale për secilën praktikë. Rastet e sipërcituara janë paraqitur në *Aneksin nr. 1 dhe Aneksin nr. 1.1*.
*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV për periudhën 01.01.2023 -31.12.2024*.

*3.2 Mbi dokumentimin e procesit të prishjes së objekteve të kundërligjshëm*:
Në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të proceseve të punës, në këtë rast të procesit të prishjes së objektit të kundërligjshëm, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë.
Referuar këtyre përcaktimeve dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se për vitin 2023, në 108 raste për të cilat kryeinspektori i IMTV-së ka nxjerrë vendimin e prishjes, në ***7 (shtatë) raste*** ky vendim nuk ka qenë i ekzekutueshëm, pasi bazuar në informacionin vënë në dispozicion grupit të auditimit, në formë tabele elektronike, mbi procedurat e IMTV Bashkia Durrës, se kundërvajtësi ka marrë masë sigurie nga gjykata ose gjykata ka shfuqizuar vendimet e IMT. Në ***26 raste*** janë ekzekutuar tërësisht, 4 raste janë ekzekutuar pjesërisht dhe ***78 raste*** janë të paekzekutuara. Për ***26 rastet*** në të cilat ky vendim është ekzekutuar, në ***4 raste*** ky proces nuk është dokumentuar me evidenca fotografike. Rastet e sipërcituara janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:
***Tabela nr. 3:*** *Rastet, për të cilat është ekzekutuar vendimi i prishjes, por nuk është dokumentuar,Viti 2023*

| Nr. | Kundërvajtësi<br>Shkelja e konstatuar | Nr.prot.<br>P – V. Konstatimi<br>Inspektorët | Vendim – Prishje |
|---|---|---|---|
| 1 | **I. K. K.**<br>(Objekt 1 katësh e mure/rrethues) | 1145 \ 13.07.23<br>S'- 0002832 | 60 \ 14.07.23<br>S'- 0000289 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Lagjja 4, pranë stacionit të trenit | G.H./A.Gj. | Ekzekutuar |
| 2 | **R. Q.P.**<br>(Objekt 1-katësh)<br>Lagjja 4, Rr.: "Egnatia" | 1146 \ 13.07.23<br>S'- 0002831<br>G.H./A.Gj. | 59 \ 14.07.23<br>S'- 0000288<br>Ekzekutuar |
| 3 | **M.B.**<br>(Vendosje e lodrave për fëmijë me struktura të çmontueshme, pa themele).<br>Lagjja 13, pranë hotel "B.", Plazh | 1193 \ 25.07.23<br>S'- 0002880<br>K.L./A.H. | 65 \ 26.07.23<br>S'- 0000294<br>Ekzekutuar |
| 4 | **L.P.D.**<br>[Objekti 1 katësh, me blloqe/b., me solet (I përjashtuar nga legalizimi)<br>Lagjia 15, Rr.: "Miqësia" | 1472 \ 28.09.23<br>S'- 0002776<br>K.L./A.Gj. | 88 \ 29.09.23<br>S'- 0001217<br>Ekzekutuar |

***Burimi:*** *Bashkia Durrës, përpunoi Grupi i Auditimit*

Për vitin 2024, në 140 raste për të cilat kryeinspektori i IMTV-së ka nxjerrë vendimin e prishjes, në shtatë (7) raste ky vendim nuk ka qenë i ekzekutueshëm, pasi bazuar në informacionin vënë në dispozicion grupit të auditimit, në formë tabele elektronike, mbi procedurat e IMT Bashkia Durrës, se kundërvajtësi ka marrë masë sigurie nga gjykata, ose gjykata ka shfuqizuar vendimet e IMT. 17 raste janë ekzekutuar tërësisht, 1 pjesërisht dhe 122 raste janë të paekzekutuara. Për 17 rastet e ekzekutura tërësisht dhe 1 pjesërisht nga IMTV Bashkia Durrës, nga materiali i audituar, rezulton se ky proces është dokumentuar me evidenca fotografike. Rastet e sipërcituara janë paraqitur në Aneksin 2.6.1, bashkëlidhur PRA:
*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e kryeinspektorit pranë IMTV, Bashkia Durrës për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.*

Lidhur me objektet dhe gjetjet sa më sipër, me shkresën me nr. 668/88 Prot, datë 17.06.2026, administruar në KLSH nr. 1347/71, Prot dt 18.06.2026, ka paraqitur observacion IMTV Bashkia Durrës, për periudhën e audituar, si më poshtë:
**Pretendimi i subjektit:** Lidhur mbi planifikimin e inspektimeve shpehen: *Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Durrës, me shkresën nr. 60/1prot dt 17.01.2024 jemi drejtuar Drejtorisë së Buxhetit Sektorit të Analizës Statistikës dhe Planifikimit Afatmesëm, ku është dërguar informacion mbi planin vjetor të IMT-së, për të gjitha procedurat e mbajtura si:*
*- "Akte konstatimi të mbajtur", "Vendim Prishje Objektit të Kundërligjshëm", "Vendime Pezullim Punimesh", Vendim për dënimin me gjobë, shkresa të ndryshme, në bashkëpunim ndërinstitucional si: IKMT, ASHK, IKMT, por edhe Drejtoria Rajonale Durrës etj. Çka do të thotë se: IMT Bashkia Durrës ka bashkëpunim dhe korrespondencë të vazhdueshme me institucionet ligjzbatuese.*
*Gjithashtu nga Kryeinspektori i IMTV-së Bashkia Durrës bazuar është nxjerrë:*
*- Urdhër nr. 29 dt 17.05.2021 me nr. 1173 prot., "Për Organizimin e punës, ndarja në grupe e inspektoreve të terrenit si dhe ndarja në grupe të inspektorëve dhe punonjësve të IMT-së Durrës;*
*- Urdhër nr. 43 dt 14.11.2024 me nr. 2525 prot. "Për Organizimin e punës, ndarja në grupe e inspektoreve të terrenit si dhe ndarja në grupe të inspektorëve dhe punonjësve teë IMT-së Durrës;*
**Qëndrimi i grupit të auditimit**: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion grupit të auditimit, pretendimi juaj nuk merret në konsideratë, pasi ashtu si edhe gjatë fazës së auditimit në terren, nuk është vendosur në dispozicion dokumentacion provues, sa i përket analizës vjetore. Ka vetëm një informacion sipas përcaktimeve të nenit 5, të Ligjit nr. 9780, datë 16/07/2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika f). Për periudhën objekt auditimi, 01.01.2024 - 31.12.2024, ka vetëm një raportim në IKMT dhe DRIKMT Durrës, me shkresën me nr. 781 prot., datë 11.04.2024, por mungojnë raportimet për 3-mujoret në vijim të Vitit 2024. *Sa më sipër, nuk përbën fakt të ri dhe nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.*

- *Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të pezullimit të punimeve:*

Vendimi për pezullimin e punimeve në ndërtim nxirret në rastin kur është i nevojshëm një afat kohor paraprak, për marrjen e vendimit, për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës, ose për marrjen e vendimit për prishjen e objektit. Pezullimi i punimeve në ndërtim ka afat deri në 60-ditë. Një vendim i tillë merret në rastet kur:

- subjekti i kontrolluar mungon në objekt ose nuk i paraqet grupit të inspektimit dokumentacionin teknik e/ose ligjor të punimit/ndërtimit;
- mungojnë masat e sigurimit teknik në objekt dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve;
- plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor kërkon proces miratimi nga autoriteti përgjegjës i planifikimit;
- vendimi i pezullimit të punimeve të ndërtimit për plotësimin e dokumentacionit teknik e/ose ligjor ka rezultuar i pamjaftueshëm dhe subjekti ndërtues kërkon zgjatjen e afatit, duke e argumentuar në mënyrë zyrtare.

Nga ana e kryeinspektorit, nga informacioni dhe dokumentacioni në formë shkresore vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezulton se janë nxjerrë në total pesë (5) vendime për pezullimin e punimeve, në lidhje me kundërvajtje si: *"Shkelja e lejes së ndërtimit, pa krijuar shtim volumi"; "Shkelje e deklaratës paraprake"; "Mungesë e dokumentacionit tekniko-ligjor".*

Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se për Vitin 2023, në 5 raste dhe në 17 raste për Vitin 2024 nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve, kur do të duhej t'i ishte dhënë kohë subjektit të konstatuar për plotësimin e dokumentacionit ose përmirësimin e masave të sigurimit teknik në objekt dhe shtimin e mjeteve mbrojtëse të jetës së punëtorëve, paraqitur në Aneksin 2.6.2 dhe 2.6.3, bashkëlidhur PRA:

Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar.

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024, për rastet, referuar tabelës së mësipërme*;

Lidhur me objektet dhe gjetjet sa më sipër, me shkresën me nr. 668/88 Prot, datë 17.06.2026, administruar në KLSH nr. 1347/71, Prot dt 18.06.2026, ka paraqitur observacion IMTV Bashkia Durrës, për periudhën e audituar, si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** *Lidhur me gjetjen tuaj ku cilësoni se... nuk është nxjerrë vendim për pezullimin e punimeve, në lidhje me shkeljet e lejes së ndërtimit, pa krijuar shtim volumi, apo shkelje të deklaratës,*

*Për sa me lart KLSH është në kundërshtim me: Neni 5)* ***Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës... a)*** *vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës dhe* ***ç)*** *vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;*

*Të gjitha vendimet e mbajtura nga IMT Bashkia Durrës për rastet konstatuar nga KLSH, si raste që nga Kryeinspektori ka mosveprim,* ***bazuar ne nenin 52 te ligjit 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, pika Nr. 5*** *Punimet e gjetura në tabelë janë "****Kundërvajtje administrative" dhe si të tilla dënohen me gjobë;***

*1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më posht*

*ç) mosrespektimi i afatit të dorëzimit të dokumentit të lejes, sipas nenit 47 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;*

*d) mosdeklarimi i punimeve që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje, sipas nenit 41 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 150 000 lekë;*

*dh) shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve, sipas nenit 40 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë;*

*ë) kryerja e ndryshimeve në projekt apo e punimeve në shkelje të kushteve të lejes, pa pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 300 000 (treqind mijë) lekë, pezullim të punimeve dhe me masën e përcaktuar në përfundim të procedurës, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni.".*
*i) pa pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 300 000 lekë, pezullim të punimeve dhe me masën e përcaktuar në përfundim të procedurës, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni;*
*ii) me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera pa leje.*
*f) përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;*
*g) vazhdimi i punimeve me gjithë vendimin administrativ për pezullimin ose ndërprerjen e tyre dënohet me prishje dhe me gjobë nga 10 000 lekë deri në 20 000 lekë;*
**Qëndrimi i grupit të auditimit**: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion grupit të auditimit, pretendimi juaj nuk merret në konsideratë, sepse është në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, Kreu 2, Neni 4 pika 1, ku citohet se: "*Inspektimi ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë dhe pika 2, pika d) dhënies së dënimeve dhe marrjes së masave të tjera administrative për shmangien e rreziqeve që mund t'u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë, të parashikuar nga ky ligj,* apo legjislacioni i posaçëm e nenin 13 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* i ndryshuar. Brenda 10 ditëve nga mbajtja e procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori. *Sa më sipër observacioni nuk përbën fakt të ri dhe nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.*

- *Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të dënimit me masë administrative gjobë.*

Vendimi për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë merret për të gjitha rastet kur konstatohen shkelje në veprimtarinë ndërtimore. Ky vendim bashkë-shoqëron gjithmonë vendimin për pezullimin e punimeve dhe vendimin për prishjen e objektit të kundërligjshëm. Vlera e masës administrative përcaktohet sipas dispozitave ligjore, ndërsa për objektet e ndërtuar pa marrë paraprakisht miratimin e autoriteteve vendore ose qëndrore, gjoba përcaktohet në raport të drejtë me vlerën e investimit.
Nga ana e kryeinspektorëve të IMTV-së, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezulton se Bashkia Durrës për Vitin 2023 ka nxjerrë në total 127 vendime për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë, me vlerë totale **38,350,000 lekë të reja, kurse për Vitin 2024 në 150 vendime për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë, me vlerën totale 41,141,000 lekë të reja.** Në formë tabelare paraqitet si më poshtë situata mbi gjobat e Vitit 2023 të IMTV-së, Bashkia Durrës:

***Tabela nr. 5:***

| **Totali i gjobave, viti 2023** | **127** |
|---|---|
| Paguar nga subjekti | 49 |
| Paguar nëpërmjet përmbarimit | 3 |
| Shfuqizuar nga gjykata | 1 |
| Ankimuar nga gjykata | 6 |
| Dërguar në gjykatë për titullin ekzekutiv | 63 |
| Pa dërguar në gjykatë | 2 |
| Anulluar nga K/Inspektori | 3 |

***Burimi:*** *Bashkia Durrës, përpunoi Grupi i Auditimit*

## Gjobat në shifra Viti 2023

| | |
|---|---|
| Totali për Vitin 2023 | 38,350,000 Lekë |
| Paguar Viti 2023 | 4,850,000 Lekë |
| **Pa paguar** | **33,500,000 Lekë** |

***Tabela nr. 5.1:***

| **Totali i Gjobave, Viti 2024** | **150** |
|---|---|
| Paguar nga subjekti | 47 |
| Paguar nëpërmjet përmbarimit | 0 |
| Shfuqizuar nga gjykata | 0 |
| Ankimuar në gjykatë | 2 |
| Dërguar në gjykatë për titull ekzekutiv | 16 |
| Pa dërguar në gjykatë | 84 |
| Anulluar nga K/Inspektori | 1 |

***Burimi:*** *Bashkia Durrës, përpunoi Grupi i Auditimit*

## Gjobat në shifra Viti 2024

| | |
|---|---|
| Totali për Vitin 2024 | 41,141,000 Lekë |
| Paguar Viti 2024 | 5,150,000 Lekë |
| **Pa paguar** | **35,991,000 Lekë** |

**Konstatimi*:*** Për sa më sipër, për periudhën e auditimit, 01.01.2023-31.12.2024, nga veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, nga IMTV Bashkia Durrës, vlera totale e gjobave të pa ekzekutuara (arkëtuara), në mënyrë vullnetare apo të detyrueshme, rezultojnë në një vlerë të lartë, konkretisht 68,891,000 lekë. Në të gjitha rastet nga IMTV-ja, arkëtimi i shumave të detyrimeve, nuk është shoqëruar me kamatë vonesë bazuar në masën e gjobës, në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 *"Për kundërvajtjet administrative"*, i ndryshuar.

Referuar Ligjit me nr. 127, datë 19.12.2024 *"Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 Janar 2015 deri më 30 Nëntor 2024, nga Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Shëndetsor, si dhe Policia e Shtetit e Policia Bashkiake"*, të gjitha gjobat e lëshuara nga IMTV Durrës, të cilat janë subjekt i këtij ligji shfuqizohen.
*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024.*

Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se:
**5.1.** Në 19 raste (të pasqyruara në ***Aneksin nr. 2***) dhe 46 raste (të pasqyruara në ***Aneksin 2.1)***, vlera e masës administrative dënim me gjobë është vendosur e pabazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Në të gjitha rastet e cituara në aneks vlera e gjobës është 500,000 lekë. Kjo vlerë fikse nuk është e parashikuar në asnjë nga pikat dhe nënpikat e nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar. Procedurat e cituara në aneks kanë të bëjmë me punime të kryera pa leje ndërtimi, për të cilat, vlera e gjobës llogaritet sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), ku citohet: *"kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi..."*. Duke qenë se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, në përshkrimin e kundërvajtjes në akt-konstatim nuk ka të dhëna të mjaftueshme, si materialet e përdorura, përmasat, etj., nuk është e mundur kryerja e përllogaritjes së saktë të vlerës së masës administrative.
*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024, për rastet referuar Aneksit nr.2 dhe Aneksit nr. 2.1;*

**5.2.** Për rastet kur vlera e masës administrative është llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), janë konstatuar edhe problematikat e mëposhtme:

- Në rastet e mëposhtme:

***Viti 2023 - Tabela nr. 6:***

| Nr. | Kundërvajtësi / Shkelja e konstatuar | Nr. prot. | Vendim gjobe<br>Nr. Serie<br>Nr. fature |
|---|---|---|---|
| **1** | **A.H**.<br>[Konstr.metalik kollona/me mbulesë/panel-sand.]<br>(E përfunduar) | 145<br>27/01/2023<br>0002852 | 07 dt:31/01/2023<br>0000241<br>ft-215004/1 |
| **2** | **M.B.**<br>[Vendosje e lodrave për fëmijë me struktura të çmontueshme, pa themele] | 11963<br>25/07/2023<br>0002880 | 80 dt:26/07/2023<br>0002146<br>ft-217423/1 |
| **3** | **V.R.Q.**<br>[Vendosje tub/plastik në rërë, për shkarkim ujërash në vijën bregdetare me gjatësi 60-m] | 1534<br>09/10/2023<br>0002783 | 111 dt:10/10/2023<br>0002177<br>ft-217733/1 |

***Burimi:*** *Bashkia Durrës, përpunoi Grupi i Auditimit*

***Viti 2024 - Tabela nr. 6.1:***

| Nr. | Dt .\ Seri.<br>P - V\ Konsta.<br>Inspektorët | Vendim – Gjobe.<br>Vlerë | Përshkrimi i objektit | Të dhëna mbi pronarin |
|---|---|---|---|---|
| **1** | **479 \ 22.02.24**<br>S'- 0001220<br>**S. M./ G.H.** | **V.gj.13** \ 26.02.24<br>S'- 0002210<br>F´- 572008/1<br>420´000 L –jo | Obj. me konstr/d, mbules ristela/d | **J.A.**<br>Rrotull, Lalëz.<br>Nj.Adm.Ishëm, Durrës |
| **2** | **1046 \ 13.05.24**<br>S'- 0001311<br>**K.L./G.H.** | **V.gj.39** \ 14.05.24<br>S'- 0002236<br>F´- 899020/1<br>500´000 L -jo | Konstr/metalik, mbules / llamarine, ngjitur me obj./ekz. 1 kat., kollona/metalikë, trarë / metalikë, mbulesë / llamarinë | **A.K.B.**<br>Shkafane. Nj.Adm.Ishem |
| **3** | **1964 \ 30.08.24**<br>S'- 0001253<br>**K.L./S.M.** | **V.gj.98** \ 30.08.24<br>S'- 0002298<br>F´- /1<br>700´000 L -jo | Punime me profile/hekuri, mbulesë me panelë/sanduiç në verandën e katit 3 | **A. U.**<br>Lgj.1 Rr. 'Taulantia", mbi restorant "Piaca", Durrës |
| **4** | **2267 \ 14.10.24**<br>S'- 0001367<br>**A.Gj./A.H.** | **V.gj.114** \ 15.10.24<br>S'- 0002315<br>F´- 1090819/1<br>500´000 L -jo | Obj. me konstr./d. me plate/b., zgare/h., mbuluar me panel/sand+llamarinë | **D.A.K.**<br>Lagjja 14, Rr. "Pranvera", Shkozet, Durrës |
| **5** | **2663 \ 10.12.24**<br>S'- 0001425<br>**G.H./K.L.** | **V.gj.149** \ 11.12.24<br>S'- 0002350<br>F´- 1178833/1<br>500´000 L -jo | Çati e shfrytëzueshme mbi katin 1, ristela/druri, me mbulesë tjegulle | **F.V.**<br>Katund Sukth, Nj.Adm.Katundi i Ri, Durrës |
| **6** | **2664 \ 10.12.24**<br>S'- 0001426<br>**G.H./K.L.** | **V.gj.150** \ 11.12.24<br>S'- 0002351<br>F´- 1178834/1<br>500´000 L -jo | Shtesë kati 2 me muraturë/tulle, trarë/druri, mbulesë me çati druri | **L.G. P.**<br>Fllakë, Nj.Adm.Katundi i Ri, Durrës |

***Burimi:*** *Bashkia Durrës, përpunoi Grupi i Auditimit*

Në këto raste nuk janë respektuar plotësisht këto dispozita, pasi vlera 35,000 lekë/$m^2$, e përdorur për llogaritjen e gjobave, nuk gjen zbatim në këtë rast, pasi asnjë prej këtyre kundërvajtjeve nuk janë objekte. Ndërtimi i tendave, strukturave metalike, mbylljet e verandave dhe ballkoneve, etj. nuk kanë të njëjtën kosto ndërtimi me ndërtesa. Shpesh herë, përllogaritja e masës administrative duke përdorur njësinë "për $m^2$" nuk është e saktë dhe nuk jep një vlerë të gjobës në proporcion të drejtë me kundërvajtjen e konstatuar. Në rastet e sipërcituara, vlera e gjobës do të duhej të ishte llogaritur si shumatorja e punimeve të kryera pa leje. Përllogaritja e vlerave të sakta të këtyre gjobave nga ana e grupit të auditimit, nuk mund të kryhet për shkak të mungesës së të dhënave (materiale, përmasa, sasi).

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024.*

- Në së paku tri raste për Vitin 2024, nga ana e kryesinpektorit të IMTV Bashkia Durrës, vlera e masës administrative dënime me gjobë nuk është llogaritur e saktë. Në zbatim të përcaktimeve të Nenit 52 të Ligjit nr.107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar,* pika 1, nënpika e V), kur objekti pa lejet përkatëse ndërtohet për qëllime përfitimi në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, vlerës së gjobës i shtohet edhe penaliteti prej 5,000,000 lekë. Rastet në të cilat nuk janë zbatuar këto dispozita janë si më poshtë:

| Nr. | **Dt .\ Seri. P - V\ Konsta. Inspektorët** | **Vendim – Gjobe Vlerë** | Përshkrimi i objektit | Të dhëna mbi pronarin |
|---|---|---|---|---|
| **1** | **1091 \ 15.05.24** S'- 0001314 **S.M./A.Gj.** | **V.gj.42** \ 20.05.24 S'- 0002239 F´- 912025/1 500´000 L -jo | "Beach-bar" me konstr./d., kollona/d., trarë/d. mbulesë/kashtë e pjesshme, banak/druri, pedanë/metalik, shtruar me dru | **Q.D.** Gjiri i Lalzit. Nj.Adm.Ishëm, Durrës |
| **2** | **1488 \ 24.06.24** S'- 0001325 **G.H./A.Gj.** | **V.gj.65** \ 28.06.24 S'- 0002265 F´- 956081/2 500´000 L -jo | Konstr./m. mbulesë/d., strehë/kashte, shtrim me pllaka dekor, vendosje kioske/metalike | **E.P.SH.** Lagjja 1, C.la, pranë "C", Durrës |
| **3** | **1867 \ 31.07.24** S'- 0001347 **G.H./A.Gj.** | **V.gj.94** \ 05.08.24 S'- 0002294 F´- 1037042/1 500´000 L -jo | Vendosje në rërë të plazhit,strukturë me konstruksion metalik dhe dru | **A.D.** Rëra e bardhë, Kepi i Rodonit, Nj.Adm.Ishëm, Durrës |

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024.*

Lidhur me objektet dhe gjetjet sa më sipër, me shkresën me nr. 668/88 Prot, datë 17.06.2026, administruar në KLSH nr. 1347/71, Prot dt 18.06.2026, ka paraqitur observacion IMTV Bashkia Durrës, për periudhën e audituar, si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** *Bazuar në gjetjen tuaj sipas tabelave.nr.5 dhe tab nr.5.1, nr.6, nr.6.1 faqe 257-259, për periudhën e vitit 2023-2024, sqarojmë se: Gjobat e vendosura nga IMT Bashkia Durrës janë konform ligjit në fushën e ndërtimeve pa leje, konkretisht: Vendim me Nr. 894, datë 4.11.2015, "Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit të Territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore"...*

*7. Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit, si dhe në të gjitha rastet kur nuk respektohet vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim, nuk plotësohet dokumentacioni, teknik e ligjor dhe kur ka parregullsi në zbatimin e punimeve në objekt, brenda afatit kohor të parashikuar në vendimin përkatës.*

***Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë dhe për kundërvajtësin përgatitet kallëzimi penal, në përputhje me legjislacionin në fuqi.***

*Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm mbahet sipas formës së parashikuar në aneksin shoqërues të vendimit.*

*"e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast, jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi dhe me:*

*i. prishje të menjëhershme të ndërtimit pa leje në kushtet e flagrancës;*

*ii. prishje të punimeve të kryera pa leje kur ndërtimi pa leje rezulton si shtesë kati dhe si shtesë volumi anësor nëse tejkalon masën 2% të sipërfaqes totale ndërtimore mbi tokë;*

*Objektet që janë cilësuara jo konform nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 të cituar me lart janë ato objekte si: konstruksion metalik, konstruksion druri, Vendosje e tubave plastike, apo profile hekuri me panele sanduiç të cilat duhen pajisur me leje ose deklarate paraprake për kryerje punimesh, të cilat në mungesë të kësaj të fundit janë kundërvajtje administrative jo për qëllime fitimi, dhe pa volum/vëllim dhe si të tilla dënohen me gjobë administrative për punime pa leje.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit**: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion grupit të auditimit, pretendimi juaj nuk merret në konsideratë, sepse është në kundërshtim me Ligjin nr.

10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, Kreu 2, Neni 4 pika 1, ku citohet se: "*Inspektimi ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë dhe pika 2, d) dhënies së dënimeve dhe marrjes së masave të tjera administrative për shmangien e rreziqeve që mund t'u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë, të parashikuar nga ky ligj,* apo legjislacioni i posaçëm, e nenin 13 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* i ndryshuar. Brenda 10-ditëve nga mbajtja e procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori.
*Sa më sipër observacioni nuk përbën fakt të ri dhe nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.*

Bazuar në informacionin e dhënë, Kryeinspektori i IMTV-së pranë Bashkisë Durrës ka anuluar tri masa administrative të llojit gjobë për Vitin 2023, të cilat detajohen si më poshtë:
Gjithashtu, në bazë të informacionit të vënë në dispozicion përmes "e-mailit" të datës 17.01.2025, IMTV-ja Durrës ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:
**N.S.V:** Vendim për dënimin me gjobë Nr. 17, datë 24.02.2023, S-0000252, ft-100129/1.
**S.K:** Vendim për dënimin me gjobë Nr. 46, datë 17.05.2023, S-0002112, ft-215901/1.
**S.B:** Vendim për dënimin me gjobë Nr. 75, datë 21.07.2023, S-0002141, ft-217127/1.
**Subjekti**
**N.S.V**
- Shkresë anulimi procedure Nr. 298/3, datë 17.03.2023.
- Procesverbal për konstatimin e kundërvajtjes Nr. 15, datë 20.02.2023.
- Vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm Nr. 13, datë 24.02.2023.
- Vendim për dënim me gjobë Nr. 17, datë 24.02.2023.
- Faturë arkëtimi Nr. 100129/1, datë 24.02.2023.
- Çertifikatë pronësie regjistrimi dhe hartë kadastrale e regjistrimit.

**Subjekti**
**S.K**
- Shkresë anulimi procedure Nr. 1278/3 prot., datë 25.08.2023.
- Procesverbal për konstatimin e kundërvajtjes Nr. 09, datë 17.07.2023.
- Vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm Nr. 62, datë 21.07.2023.
- Vendim për dënimin me gjobë Nr. 75, datë 21.07.2023.
- Faturë arkëtimi Nr. 217127/1, datë 31.07.2023.
- Kërkesë për aplikimin e legalizimit Nr. 1197, datë 25.01.2022.

**Subjekti**
**S.B**
Anulimi i vendimeve për këtë rast është bërë pasi, nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se kundërvajtësi është shtetasi B.A. dhe jo SH.K. Procedura ka vijuar për shtetasin B.A.
- Bazuar në informacionin e dhënë, Kryeinspektori i IMTV-ja pranë Bashkisë Durrës ka anuluar 1 masë administrative të llojit gjobë për Vitin 2024, e cila detajohet si më poshtë:

**Subjekti**
**K.B:** Vendim për dënimin me gjobë Nr. 125, datë 28.10.2024, S-0002326 ft-1098837/1.
Gjithashtu, në bazë të informacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet informacionit me nr. 269 prot. të datës 13.02.2025, IMTV-ja Durrës ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:
- Relacion kryeinspektorit të IMTV-së për vazhdimin e procedurës ligjore me nr. 2364 prot., datë 25.10.2024.
- Procesverbal për konstatimin e kundërvajtjes, Nr. 29, datë 24.12.2024.

- Vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm, Nr. 117, datë 28.10.2024.
- Vendim për dënim me gjobë, Nr.125, datë 28.10.2024.
- Dërgim "Vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm" Nr. 2364/1 prot., datë 29.10.2024 dhe Nr. 2364/2 prot., datë 29.10.2024.
- Faturë arkëtimi Nr. 1098837, datë 28.10.2024.
- Kërkesë e shtetasit K.B drejtuar Njësisë Administrative Katundi i Ri, e datës 28.08.2024, bashkëlidhur Licencë e teknikut Topograf-Hidrotenik, planvendosje, çertifikatë pronësie e shtetasit K.B, hartë treguese e pronës.
- Kërkesë e shtetasit K.B për lyerje punimesh, drejtuar Njësisë administrative.
- Anulim procedure me shkresën Nr. 2364/4 prot., datë 05.11.2024.

Bazë ligjore për vendimet e marra nga IMTV, Bashkia Durrës:
Vendimet e mësipërme janë marrë në përputhje me dispozitat e mëposhtme ligjore:
1. Ligji Nr. 9780, datë 16.07.2007: "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme."
2. Ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011: "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë," neni 8 mbi parimin e dispozitës më të favorshme ligjore.
3. Ligji Nr. 44/2015: Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë.

Këto veprime dhe vendime janë ndërmarrë në bazë të dokumentacionit përkatës, duke respektuar kornizën ligjore në fuqi.
Gjithashtu nuk janë dërguar në Gjykatë 2 masa administrative gjobë, si vijon:
1) D.Z, vendim për dënimin me gjobë me Nr. 15, datë 17.02.2023, S - 0000250, ft-215190/1;
2) I paidentifikuar, vendim për dënimin me gjobë, Nr. 62, dt. 09.06.2023, S - 0002128, ft-216182/1.

Për këto dy raste IMTV arsyeton me faktin se: për rastin e parë, D. Zh., procedura është ndjekur nga IKMT, në bazë edhe të "Njoftim vlerësimi" dërguar IMT-së Bashkisë Durrës me nr. 1306 prot., datë 24.02.2023, duke qenë se subjekti ndodhet në zonë bregdetare, bazuar edhe në pikën 14/1, të VKM-së me Nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe ai i Njësisë Vendore", ekzekutimi i këtij vendimi do të kryhet vetëm nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.
Rezulton se edhe rasti me subjekt "G.&A.H", është mbajtur akt-konstatimi nga IKMT, referuar shkresës me nr. 1632, datë 10.03.2023, pasi kundërvajtësi ndodhet në zonën bregdetare, me adresë: Hotel "A", Kryemedhenj Golem Shkëmbi i Kavajës, referuar pikës 8 të Vendimit nr. 894, datë 4.11.2015 *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore", IKMT-ja, në mbështetje të nenit 9, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", të ndryshuar, ushtron përgjegjësitë e veta në nivel njësie vendore drejtpërdrejt dhe pa asnjë kufizim për ndërtimet/punimet që lidhen me çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor.*

- Konstatimet e kryera nga inspektorët e IMTV, referuar masave të marra janë klasifikuar (nga ana e kryeinspektorit), si punime për të cilat nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi. Faktikisht, punimet e konstatuara dhe të evidentuara në tabelën e mëposhtme, janë punime për të cilat duhet pajisja me deklaratë paraprake punimesh dhe leje ndërtimi, referuar përcaktimeve të nenit 7 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 3, nënpika ii) dhe nenit 11, pika 1, nënpika a). Gjobat janë përllogaritur sipas përcaktimeve të nenit 52 Ligjit nr.107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika d), ndërkohë që do të duhej të llogariteshin sipas përcaktimeve të pikës 1, nënpika e). Përllogaritja e vlerave të sakta të këtyre gjobave nga ana e grupit të auditimit, nuk mund të kryhet për shkak të mungesës së të dhënave (materiale, përmasa, sasi). Konstatohet se nga **127** masa administrative, "Vendim me gjobë", për periudhën

01.01.2023 - 31.12.2023**, 95** prej tyre janë në shumat **50,000 (55) - 100,000 (40)** lekë të reja, të pasqyruara edhe në Aneksin 3.

**Për Vitin 2024**

Konstatimet e kryera nga inspektorët e IMTV, në së paku 20 raste, sipas tabelës së mëposhtme, referuar masave të marra janë klasifikuar (nga ana e kryeinspektorit), si punime për të cilat nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi. Faktikisht, punimet e konstatuara dhe të evidentuara në tabelën e mëposhtme, janë punime për të cilat duhet pajisja me deklaratë paraprake punimesh (rastet 1, 2, 4, 5, 6, 7, 9, 10, 12, 13, 14, 16, 17, 18) dhe leje ndërtimi (rastet 3, 8, 11, 15, 19, 20), referuar përcaktimeve të nenit 7 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 3, nënpika ii) dhe nenit 11, pika 1, nënpika a). Gjobat janë përllogaritur sipas përcaktimeve të nenit 52 Ligjit nr.107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika d), ndërkohë që do të duhej të llogariteshin sipas përcaktimeve të pikës 1, nënpika e). Përllogaritja e vlerave të sakta të këtyre gjobave nga ana e grupit të auditimit, nuk mund të kryhet për shkak të mungesës së të dhënave (materiale, përmasa, sasi), sipas Aneksit 2.6.4, bashkëlidhur PRA.

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024, për rastet referuar tabelës së mësipërme.*

- *Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të prishjes së objektit të kundërligjshëm dhe ekzekutimin e tyre:*

Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit, si dhe në të gjitha rastet kur nuk respektohet vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim, nuk plotësohet dokumentacioni, teknik e ligjor dhe kur ka parregullsi në zbatimin e punimeve në objekt, brenda afatit kohor të parashikuar në vendimin përkatës. Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë dhe për kundërvajtësin përgatitet kallëzimi penal, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Nga ana e kryeinspektorëve të IMTV, Bashkia Durrës për Vitin 2023 janë nxjerrë në total **108 vendime** për prishjen e objekteve të kundërligjshëm. Referuar informacionit të marrë nga IMTV, si dhe auditimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se:

- Janë ekzekutuar plotësisht **26 raste.**
- Janë ekzekutuar pjesërisht **4 raste.**
- Të paekzekutuara **78 raste.**

Nga ana e kryeinspektorëve të IMTV, Bashkia Durrës për Vitin 2024 janë nxjerrë në total **140 vendime** për prishjen e objekteve të kundërligjshëm. Referuar informacionit të marrë nga IMTV, si dhe auditimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se:

- *Janë ekzekutuar plotësisht **17 raste.***
- *Janë ekzekutuar pjesërisht **1 rast.***
- *Të paekzekutuara **122 raste.***

Nga informacioni i kërkuar IMTV - Bashkia Durrës lidhur me rastet që nuk janë ekzekutuar dhe janë në procese gjyqësore, për Vitin 2023, me "e-mailin" e datës 13.01.2025, Kryeinspektori i IMTV Bashkia Durrës sqaron se: Bazuar në informacionin që kërkoni lidhur me vendimet e prishjes nga IMTV Bashkia Durrës, "Kur nuk ekzekutohet vendimi i prishjes"...

*Ju bëjmë me dije se, për procedurat e vendimeve për prishje të objektit të kundërligjshëm, disa subjekte janë në proces gjyqësor, të cilët kanë paraqitur kërkesë-padi, ku gjykata ende nuk ka marrë një vendim për sigurim padie. Palët që janë në proces gjyqësor dhe po shqyrtohen në gjykatë janë: P.A.P, L.G, A.H, F.K, Z.R, R.K, K.M.I, I.S, B.R, A.L, A.G, A.F.A.*

Në "kthim përgjigjen" e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë drejtuar IMTV Bashkia Durrës, rezulton se nga rastet sa më sipër, në proces gjyqësor *janë vetëm: I.S, K.I, P.S, B.K, B.S "K" sh.p.k, Z.R, raste në shqyrtim nga gjykata dhe nuk ka një vendim.* Për rastet e tjera nuk ka një informacion, për fazën në të cilën ndodhet procesi.

Konstatohet se ka një mospërputhje informacioni referuar tabelës së vënë në dispozicion grupit të auditimit, pasi në kolonën me referencën "Në Gjykatë", rezultojnë 73 procese.

Nga materiali i vënë në dispozicion grupit të auditimit, në formë shkresore, me shkresën me Nr. 2716/1 prot., datë 23.12.2024, me lëndë: Dërgim dokumentacioni mbi periudhën objekt auditimi (01.01.2023 – 31.12.2023), rezulton se:
Nga 73 kërkesa të dërguara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me objekt "Lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit", nga informacioni i IMTV, rezulton se:

- Për 6 Vendime për Lëshim UE, kërkesa e IMTV është refuzuar nga Gjykata dhe është depozituar "Ankim" pranë Gjykatës së Apelit Administrativ.
- Për 1 Vendim për Lëshimin e UE-së është shfuqizuar dhe ka marrë formë të prerë.

Për 22 Vendime, i janë drejtuar me kërkesë për vënien në ekzekutim të UE-së, Zyrës së Përmbarimit Shtetëror Durrës, nga të cilat 3 rezultojnë të paguara, të tjerat në proces ekzekutimi.
Konstatohet se, për 19 raste të cilat ndodhen në ekzekutim pranë Zyrës së Përmbarimit Shtetëror Durrës nuk ka një informacion mbi ecurinë e procesit dhe respektimin e afateve ligjore, (fazat përmbariore), në kundërshtim me Nenin 515 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. *Në të gjitha rastet nga Zyra Përmbarimore Durrës, edhe pse ka kaluar afati 10-ditor i ekzekutimit vullnetar i ekzekutimit për shlyerjen e detyrimit nga debitori, nuk është vijuar me procedurësn sipas afateve ligjore, me nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit të detyrueshëm, që do të thotë se përformanca në arkëtimin e detyrimeve ndaj debitorëve të IMT-së nga Zyra Përmbarimore Durrës është shumë e ulët, duke ndikuar edhe në mosrealizimin e të ardhura nga subjekti i audituar.*
Nga materiali i vënë në dispozicion grupit të auditimit, në formë shkresore, me shkresën me Nr. 269 prot., datë 13.02.2025, me lëndë: Dërgim dokumentacioni mbi periudhën objekt auditimi (01.01.2024 – 31.12.2024), rezulton se:
Nga 16 kërkesa të dërguara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me objekt "Lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit", nga informacioni i IMTV, rezulton se:
- Vendimet (tituj ekzekutivë), të cilave nuk u është bërë kërkesë për lëshimin e urdhërit ë ekzekutimit, ju bëjmë me dije se periudha e Vitit 2024 është brenda afatit ligjor 2-vjeçar për dërgimin e kërkesës për tituj ekzekutivë.
- Gjithashtu, për të gjitha këto procedura të cilat ende nuk është bërë kërkesë për *"Lëshim Urdhër Ekzekutimi",* Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Durrës në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore po punon për aktet administrative, qartësimin e tyre, mbi adresat, gjeneralitetet e sakta të debitorëve, në mënyrë që të vërtetohet që debitori ka marrë dijeni ose jo për dënimin me gjobë dhe për të mos u bërë pengesë për vjeljen e gjobës. Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 nuk ka gjoba të parashkruara sepse janë brenda afatit ligjor dhe janë në proces pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
Konstatohet se për 16 rastet sa më sipër, për të cilat vijon procesi për nxjerrjen e Urdhërit të Ekzekutimit, nuk ka një informacion mbi ecurinë e procesit, për të vijuar më pas me nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit të detyrueshëm, çka ndikon edhe në përformancën në arkëtimin e detyrimeve, duke ndikuar edhe në mosrealizimin e të ardhura nga subjekti i audituar.
Bashkia Durrës ka nxjerrë vendimin e prishjes së objektit të kundërligjshëm, vendim që është ekzekutuar vetëm në **26 raste** (nga verifikimi dhe informacioni vënë në dispozicion në formë tabelare grupit të auditimit, rezulton se në ***22 rastet*** e ekzekutimit të prishjes janë faktuar me foto); *Katër subjekte rezultojnë se nuk janë të faktuar me foto, subjektet (I.K., R.P., M.B. dhe L.D.).* Janë ekzekutuar pjesërisht **4 raste (Të gjitha faktuar me foto).** Nuk provohet nga IMTV, që objekti është kthyer në gjendjen e mëparshme nga kundërvajtësi; në **78 raste** nuk është ekzekutuar vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm, të paraqitura në (***Aneksin nr. 3.1),*** bashkëlidhur këtij dokumenti. Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika d), si dhe në kundërshtim me neni 52 të Ligjit nr.107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, pika 6.

Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, rezulton se Bashkia Durrës ka nxjerrë vendimin e prishjes së objektit të kundërligjshëm, vendim që është ekzekutuar vetëm në **17 raste** (nga verifikimi dhe informacioni vënë në dispozicion në formë tabelare grupit të auditimit, rezulton se ***12 raste janë të faktuar me foto,*** në ***4 rastet*** e ekzekutimit tërësisht të prishjes dhe **1 rast ekzekutuar pjesërisht** nuk janë faktuar me foto), *subjektet (A.F., D.C., P.L., Q.Th., E.D.).* Nuk provohet nga IMTV, që objekti është kthyer në gjendjen e mëparshme nga kundërvajtësi; në **122 raste** nuk është ekzekutuar vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm, të paraqitura në (***Aneksin nr. 3.2),*** bashkëlidhur këtij dokumenti. Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika d), si dhe në kundërshtim me neni 52 të Ligjit nr.107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, pika 6.
*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024, për rastet referuar Aneksit nr. 3.1 dhe Aneksit nr.3.2;*

- *Mbi respektimin e afateve për nxjerrjen e vendimeve pas konstatimit të kundërvajtjes:*

Pas mbajtjes së procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, brenda një afati 10-ditor, kryeinspektori i IMTV-së, duhet të nxjerrë vendimet sipas rastit, në lidhje me shkeljen e konstatuar, si: vendim për pezullimin e punimeve, prishjen e objektit të kundërligjshëm, vendim për dënimin me masë administrative gjobë, ose kallëzim penal për kundërvajtësin.
Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se në 22 (njëzetë e dy raste), nga ana e kryeinspektorit, nuk është respektuar afati dhjetë ditor për nxjerrjen e vendimeve vijuese sipas rastit, në funksion të kundërvajtjes së evidentuar në procesverbalin e konstatimit. Më konkretisht, këto raste janë paraqitur në Aneksin 2.6.5 dhe 2.6.6, bashkëlidhur PRA:
Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar.
*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023-31.12.2024.*

- *Mbi nisjen e procedurave për të kallëzuar penalisht kundërvajtësit***:**

Në respektim të nenit 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika dh), si dhe nenit 52 i Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, pika 7, kryeinspektori i IMTV ka detyrimin e përgatitjes së kallëzimit penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe të paraqitjes së tij pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi. Duke marrë në konsideratë informacionin e vendosur në dispozicion nga ana e IMTV, Bashkia Durrës, si dhe nga auditimi i dokumentacionit, është konstatuar se:

**Për Vitin 2023**

- Nga 169 procedura të mbajtura, bazuar në informacionin e IMTV, Bashkia Durrës, 148 raste nuk përbëjnë vepër penale, sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal;
- Nga 21 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Durrës, të cilat përbëjnë vepër penale sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal, në 1 rast kundërvajtësi është i paidentifikuar;
- Nga 20 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Durrës, të cilat përbëjnë vepër penale sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal dhe kundërvajtësi është i identifikuar, në asnjë rast gjykata nuk ka shfuqizuar vendimet e IMTV, ose kundërvajtësi i pretenduar ka marrë masë sigurie;
- Për 148 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Durrës, nuk janë trajtuar rastet, të cilat përbëjnë vepër penale, sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal dhe IMTV do të duhej të ishte drejtuar organeve ligj-zbatuese, për dërgimin pranë tyre, të indicies për vepër penale.
- Pra, siç edhe konstatohet nga IMT-ja e Bashkisë Durrës është punuar me dy standarde në lidhje më kallëzimet penale të dërguara në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, në vend që të dërgohen për kallëzim penal subjekte që kanë realizuar kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi për

banesa, apo lokale shërbimi, janë referuar subjekte për kallëzim penale për ndërtime të mureve rrethues apo vendosje porte hyrëse në banese.

**Për Vitin 2024**

- Nga 194 procedura të mbajtura, nga ana e IMTV Bashkia Durrës, 162 raste nuk përbëjnë vepër penale, bazuar në përcaktimet e nenit 199/a të Kodit Penal;
- Nga 32 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Durrës, të cilat përbëjnë vepër penale sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal, nuk ka asnjë rast ku kundërvajtësi është i paidentifikuar;
- Nga 32 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Durrës, të cilat përbëjnë vepër penale sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal dhe kundërvajtësi është i identifikuar, vetëm në 2 raste, për kundërvajtësit Sh.B. dhe P.D., gjykata ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, kurse për 2 kundërvajtësi F.S. dhe Y.Z. ka masë sigurie nga gjykata.
- Për 162 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Durrës, nuk janë trajtuar rastet të cilat përbëjnë vepër penale sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal, IMTV do të duhej t'u ishte drejtuar organeve ligj-zbatuese për dërgimin pranë tyre të indicies për vepër penale.
- Pra, siç edhe konstatohet nga IMTV-ja e Bashkisë Durrës gjatë vitit 2024 është punuar me dy standarde në lidhje më kallëzimet penale të dërguara në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, në vend që të dërgohen për kallëzim penal subjekte që kanë realizuar kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi për banesa, apo lokale shërbimi, janë referuar subjekte për kallëzim penale për ndërtime të mureve rrethues apo vendosje porte hyrëse në banese.

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024.*

- Nga ana e kryeinspektorit, z. D.M, nuk është respektuar i njëjti standard në lidhje me përgatitjen e kallëzimeve penale, pasi për procedurat e mbajtura gjatë periudhës si kryeinspektor, është konstatuar se për procedurat, sipas Aneksit 2.6.7 dhe 2.6.8, bashkëlidhur PRA:

Është përgatitur kallëzim penal, ndërsa për të gjitha procedurat e tjera nuk është përgatitur, edhe pse kanë të bëjnë me shkelje të ngjashme ose më të rënda si: *"Mur rrethues me blloqe dhe themele beton arme", "konstruksion metalik në katin e fundit të objektit", "Mur rrethues me blloqe, portë metalike", "tendë konstruksion metalike, shtrim verande me beton, fasadë me mur tulle....." etj.*

- Nga ana e kryeinspektorit, z. D.M, nuk është respektuar i njëjti standard në lidhje me përgatitjen e kallëzimeve penale, pasi për procedurat e mbajtura gjatë periudhës së auditimit, si kryeinspektor, është konstatuar se për procedurat:

**Viti 2023**

| Nr. | PVKK | | Kundërvajtësi | Kundërvajtja |
|---|---|---|---|---|
| | Nr. serie | Datë | | |
| 1 | S'-0000209 | 30.12.22 | E.B. | [Shtrim me beton (plate/b.)] |
| 2 | S'- 000276 | 26.01.23 | Ç.S.B. | Mur/rrethues, blloqe/betoni, themele/b-arme] |
| 3 | S- 0002957 | 14.02.23 | N.M. | Punime jashtë lejes/mir-tërmet, bashkim e ndryshim vëllimi, shtesë/anës kati i 1-rë, obj./konstr-m., shtrim betoni e veshje gipsi |
| 4 | S'- 0002963 | 20.03.23 | B.RR. | [Tendë konstr./m., trarë/d, shtrim verande me beton, mbyllje e fasadës me mure/t-dekor, parapet/t përreth verandës] |
| 5 | S'- 0002931 | 30.03.23 | U.R.P. | Konstruksion metalik në katin e fundit të obj.] |
| 6 | S'- 0002964 | 03.04.23 | V.I.P. | [Punime ndërt. pa dekl./parap., duke bërë prishje muresh, shkalle, armature/d, puntela/h] |
| 7 | S'- 0002965 | 04.04.23 | R.A."A"sh.p.k | Vend parkimi kioske tregëtare, vend-roje, mur/rreth pronës] |
| 8 | S'- 0002765 | 05.04.23 | S.& D.H. | Mur/rreth me blloqe/b me portë metalike] |

**Viti 2024**

| Nr. | PVKK | | Kundërvajtësi | Kundërvajtja |
|---|---|---|---|---|
| | Nr. serie | Datë | | |
| 1 | S'-0001224 | 13.03.24 | sh.a.B | Rrethim me brez/b., kollona/b., bandjera/m. |
| 2 | S'- 0001313 | 14.05.2024 | A.M. | Objekt me mure gur, brez/b., fitila/h., zgarë/h., kollona/b., mur gur mbajtës |
| 3 | S- 0002889 | 07.06.2024 | G.C dhe I.Ç "Ç. K." | Mur rrethues/beton arme, beton i derdhur, rikonstruksion i plotë, rindërtim, 2 godI. banimi ekzistuese |
| 4 | S'- 0002891 | 12.06.2024 | SH.U. | Mur rrethues/bll-betoni, portë/m., kollona/b. |
| 5 | S'- 0002895 | 25.06.2024 | K.K. | Mur rrethues/bll-betoni, portë/m. |
| 6 | S'- 0001374 | 18.10.2024 | F.K. | Objekt 1-katësh me plate betoni/kollona betoni |
| 7 | S'- 0001378 | 23.10.2024 | A.M. | Shtesë kati i 3,mbi katin e 2, me kollona/b., armaturë/d.,puntela, fitila/h. |
| 8 | S'- 0001379 | 25.10.2024 | K.B. | Objekt me konstr./m., blloqe/b., mbuluar/llam. |
| 9 | S'- 0001383 | 29.10.2024 | E.SH.V. | Objekt me blloqe/b., konstr.m., mbuluar/llam. |
| 10 | S' - 0001441 | 06.11.2024 | L.A.T. | Mur/rreth me blloqe/b., kollona/b. |
| 11 | S' - 0001427 | 12.12.2024 | A.A. | Themele/b. e fitila/h. për rrethim prone |

Nuk është përgatitur kallëzim penal, ndërsa për kundërvajtje të tjera të ngjashme kryeinspektori ka përcjellë në institucionet ligj-zbatuese indicien e veprës penale. Rastet e ngjashme, për të cilat nuk është përgatitur kallëzim penal janë edhe si më poshtë:

| Nr. | PVKK | | Kundërvajtësi | Kundërvajtja |
|---|---|---|---|---|
| | Nr. serie | Datë | | |
| 1 | S'- 0002795 | 01.06.23 | F.A. | Tendë konstr./m., mbulesë/sand. në katin e fundit të pallatit |
| 2 | S'- 0002826 | 31.05.23 | F.C. "C" sh.p.k | Hedhje material/inert në vijën bregdetare (nga punimet në shëtitore e mbeturI.) |
| 3 | S'- 0002939 | 09.05.23 | A.J.M. | Kollona/b, armature/d për solet shtesë kati, puntela/h |
| 4 | S'-0002766 | 26.04.23 | SH.I. | Mur/rreth me blloqe/b, kollona/b |

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024;*

- *Mbi arkëtimin e masave administrative***:**

Inspektorati i Mbrotjes së Territorit Vendor, Bashkia Durrës, për Vitin 2023, ka vendosur në total **127** masa administrative dënim me gjobë me vlerën **38,350,000 lekë.** Nga këto, janë paguar vullnetarisht **45 gjoba**, me vlerë **4,450,000 lekë** të reja. Nga ana e kryeinspektorit, z. D. "M", për 127 vendime për dënim me masë administrative gjobë, vetëm në **23 raste** sipas Aneksit 2.6.9 bashkëlidhur PRA, është konfirmuar njoftimi i kundërvajtësit për vendimin e gjobës. Në 104 raste ky njoftim nuk është i konfirmuar.

IMTV Bashkia Durrës, gjatë Vitit 2024 ka vendosur në total **150** masa administrative **dënim me gjobë me vlerën 41,141,000 lekë** të reja. Nga këto rezulton se janë paguar vullnetarisht **47 gjoba**, me vlerën 5,150,000 lekë të reja. Nga ana e kryeinspektorit, z.D."M", për 150 vendime për dënim me masë administrative gjobë, vetëm në 2 raste është konfirmuar njoftimi i kundërvajtësit për vendimin e gjobës **(kundërvajtësit G.B. dhe J.P.)**. Në 148 raste ky njoftim rezulton i pakonfirmuar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010 *"Për kundërvajtjet administrative"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika c).

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV Bashkia Durrës për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024*;

- *Mbi auditimin e dosjeve individuale të procedurave të mbajtura nga IMTV*

- Për periudhën Janar - Dhjetor 2023 nga IMTV, Bashkia Durrës i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me "kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit" për 73 raste. Nga verifikimi i materilait të vënë në dispozicion, rezulton se mungon konfirmimi për vërtetimin e njoftimit të subjekteve, çka përbën shkak që Gjykata të mos ketë pranuar praktika për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit pasi në dosjet e konstatimit ka mangësi dokumentacioni provues.

- Në 1 rast, në praktikat e IMTV Bashkia Durrës në bazë të databazës elektronike që disponojnë, Vendimi i Gjobës është mbajtur për subjekte ende të pa identifikuar.
- Në 7 raste vendimet e dënimit me gjobë janë rrëzuar me vendim gjykate, të cilat janë ankimuar, kurse 1 rast është shfuqizuar nga Gjykata e Apelit, sipas Aneksit 2.6.10 bashkëlidhur PRA:
- Në 45 raste për Vitin 2023, pasqyruar në Aneksin nr. 4 gjobat janë paguar vullnetarisht;
- Në 6 raste, IMT Bashkia Durrës i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, për subjektet e mëposhtme:

| Nr. | Vendim gjobe | Subjekti | Kërkesë Lëshim UE | Vendim gjykate | Ankim i veçantë | Përshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Nr. vendimi 36, dt. 18.04.2023 Lajmerim-marrje | Gj.S. M. | Nr. 1204 prot., dt. 26.07.23 | Vendim nr. 3684 dt. 06.10.23 / nr. 1204/1 prot., dt 15.12.23 | Nr.1204/2, dt. 20,12.23 | *Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës pasi nuk vërtetohet se debitori ka marrë dijeni .* |
| 2 | Nr. vendimi 39, dt 25.04.23 Lajmërim marrje | F.A. | Nr. 1102 prot., dt. 06.07.23 | Vendim nr. 3694, dt. 27.12.23/ nr. 2112 prot., dt. 20.09.24 | Ankimi i veçantë nr. 2112/1., prot., dt. 29.09.24 | *Subjekti është njoftuar me lajmërim-marrje, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës.* |
| 3 | Nr. vendimi 41, dt. 05.05.23 Lajmrim marrje | F.B. | Nr.1152prot dt 17.07.24 | Vendim nr.3693 dt 19.09.23, nr.1537prot dt dt 09.10.23 | Ankim i veçantë Nr. 1537/1 prot. dt. 13.10.23 | *Subjekti është njoftuar me lajmërim-marrje, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës.* |
| 4 | Gjobe nr .43, dt 12.05.023 Lajmërim marrje | M. V. | Nr.1207prot dt26.07.23 | V.3696 dt 06.10.23 Nr.1207/1prot dt 15.12.23 | Ankim i vecantë/rikërkesë Nr. 1207/2 prot., dt. 20.12.23 | *Subjekti është njoftuar me lajmërim-marrje, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës.* |
| 5 | Gjobë nr. 80, dt. 26.07.23 Gjobë nr. 109 dt 06.10.23 | M.B. | Nr. 1099 prot., dt. 16.05.24 | Nr. 2947, dt. 30.07.24 Nr. 2017 prot., dt. 12.09.24 | Nr. 2017/1 prot., dt 16.09.24 | *Subjekti është njoftuar me lajmërim-marrje, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës.* |
| 6 | Gjobë nr. 109, dt. 06.10.23 | E.G. | Nr. 1347 prot., dt. 07.06.24 | Vendim nr. 3222, dt. 30.07.24/ Nr. 2016 prot., dt. 12.09.24 | Ankim i veçantë nr. 2016/1 prot. Dt. 16.09.24 | *Subjekti është njoftuar me lajmërim-marrje, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës.* |

***Burimi:*** *Bashkia Durrës, përpunoi Grupi i Auditimit*

➢ Rezulton se për vendimin e marrjes së masës administrative "Dënim me Gjobë", me nr. 73, datë 10.07.2023, për shtetasin X.S është bërë kërkesë për "Lëshim urdhër ekzekutimi", me Nr. 1101 prot., dt. 16.05.24. Me Vendimin me nr. 2949, dt. 11.06.24, **gjykata e ka refuzuar për shkak të mosmarrjes në dijeni të kundërvajtjes.** Vendimi nr. 2949 dt 11.06.24 ka marrë formë të prerë **dhe ndaj tij nuk është ushtruar ankim.**

Për periudhën Janar - Dhjetor 2024, IMTV Bashkia Durrës i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me "kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit" për 16 (kërkesa) raste. Nga verifikimi i materilait të vënë në dispozicion, rezulton se mungon konfirmimi për vërtetimin e njoftimit të subjekteve, çka përbën shkak që Gjykata të mos ketë pranuar praktika për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, pasi në dosjet e konstatimit ka mangësi dokumentacioni provues.
-Në **2 raste** vendimet e dënimit me gjobë janë rrëzuar me vendim gjykate, të cilat janë ankimuar;
- Për shtetasen F.R.S. : Vendim për dënimin me gjobë Nr.86, datë 27.06.2024, S-0002286, ft-1004016/1. (Është marrë masë sigurim padie nga gjykata me vendimin me nr.9672, datë 13.09.2024, nr.2110 prot., datë 20.09.2024. (Ankim i veçantë nr.2110/1 prot., datë 25.09.2024.
- Për shtetasin Y.Z. : vendim për dënimin me gjobë Nr. 143, datë 21.11.2024, S-0002344, ft-11418161/1. (Është marrë masë sigurimi padie nga gjykata me vendim s'ka, datë 18.12.2024, nr.2751 prot., datë 24.12.2024. (Ankim i veçantë nr.2751/1 prot., datë 27.12.2024).

- Në **47 raste** për Vitin 2024, gjobat janë paguar vullnetarisht sipas Aneksit 2.6.11, bashkëlidhur PRA

Për mos aplikimin e lëshimit të titullit ekzekutiv mbajnë përgjegjësi Kryeinspektori D."M" dhe Juristja e IMTV, Znj.M.M., për periudhën e audituar 01.01-2023-31.12.2024.

Lidhur me objektet dhe gjetjet sa më sipër, me shkresën me nr. 668/88 Prot, datë 17.06.2026, administruar në KLSH nr. 1347/71, Prot dt 18.06.2026, ka paraqitur observacion IMTV Bashkia Durrës, për periudhën e audituar, si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** Nga Gjykata Administrative Shkallës Parë Tiranë për çdo rast është rrezuar pjesa e kërkuar nga IMT për kamatëvonesat, si e pabazuar në ligj me pretendimin si më poshtë:

*III. Në lidhje me kërkimin për kamatëvonesat 7. Në lidhje me kërkimin e palës kërkuese për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për kamatëvonesat, gjykata vlerëson se, ky kërkim është i pabazuar në ligj, pasi titull ekzekutiv është vetëm gjoba dhe jo kamatëvonesat, të cilat janë penalitete për mosekzekutimin e titullit ekzekutiv vullnetarisht nga debitori, duke i shkaktuar një dëm kreditorit. Gjykata administrative nuk lëshon urdhër ekzekutimi edhe për kamatat e zbatueshme sipas ligjit mbi masën e dënimit me gjobë, në rastin eventual të vonesës së debitorit (kundërvajtësit) në shlyerjen e dënimit me gjobë. Urdhri i ekzekutimit kërkohet nga pala kreditore dhe lëshohet nga gjykata vetëm për vendimin e dënimit me gjobë. Pikërisht ky vendim bëhet titull ekzekutiv dhe për rrjedhojë edhe urdhri i ekzekutimit lëshohet në lidhje me atë masë gjobe të caktuar në vendimin e dënimit administrativ. Ndërsa kamatëvonesat, janë penalitete të tjera që lidhen me rastin e mundshëm të mosekzekutimit vullnetar të titullit ekzekutiv vullnetarisht nga debitori (kundërvajtësi), të cilat përcaktohen, kërkohen dhe ekzekutohen sipas procedurave të tjera përkatëse që parashikon ligji. Për kërkimin e këtyre të fundit, pala kërkuese mund të përdorë mjetin e duhur procedural, konkretisht me padi kundrejt subjektit debitor (kundërvajtësit). Pra, nuk bëhet në këtë gjykim. Në këto kushte, kjo pjesë e kërkesës duhet refuzuar (rrëzuar) si e pabazuar në ligj.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit**: Referuar sa më sipër, ashtu si kemi konstatuar edhe në fazën e projektraportit, arkëtimi i shumave të detyrimeve, nuk është shoqëruar me kamatë vonesë bazuar në masën e gjobës. Vendimet e gjykatave që ju citoni, nuk prevalojnë mbi ligjin dhe më konkretisht, me Nenin 30 të Ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative". IMTV Durrës, si palë kërkuesë, duhet që të ankimojë çështjen edhe përtej gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

*Sa më sipër, observacioni juaj nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.*

*-Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të konstatimit të kundërvajtjeve administrative u konstatua se për Vitin 2023:*

**I. Dosja e subjektit A.M.Ç**

Nga inspektimi i bërë në terren më datë 06.06.2023 nga inspektorët **K.L, A.G** në subjektin A.M.Ç, me adresë: Sukth, pranë Njësisë Administrative, Bashkia Durrës, janë konstatuar punime ndërtimi pa leje, duke bërë shtrim me beton në dysheme, vendosje profile metalike pa mbulesë, portë metalike, rrethim me rrjetë.

Nga inspektorët e terrenit të IMTV-së, më datën 06.06.2023, është mbajtur process-verbali i konstatimit të kundërvajtjes për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi. Proces-verbali datë 21.02.2022 i mbajtur nga inspektorët G. H. dhe A. Gj. për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi nuk është shoqëruar me vendim për dënimin me gjobë për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi edhe pse sipas fotove të administruara në dosje, objekti pothuajse është e ngritur plotësisht në strukturë, në kundërshtim me nenin 52 shkronja "e" të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.

Inspektorët kanë përgatitur për Kryeinspektorin relacionin me nr. 915 prot., datë 06.06.2023, për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, nga IMT Bashkia Durrës, rezulton se në praktikë mungon marrja e vendimit nga ana e Kryeinspektorit për vijimin e procedurës ligjore, dënimin me masën administrative gjobë ndaj subjektit, si dhe nuk është vijuar më tej me vendimin e prishjes së objektit të ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme nga ana e Kryeinspektorit të IMT Bashkia Durrës.

**Konkluzion:** Nga Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Durrës nuk është vijuar procedura brenda afatit 10-ditor për nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë", për subjektin A.Ç, në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
- Kryeinspektori nuk ka nxjerrë "Vendim për Prishje" në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
- Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat e ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:
a) kryetari i bashkisë;
b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;
- IMTV-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit B.Ç, për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 gërma (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit" i ndryshuar.

**II. Dosja e subjektit P.S.B**

Nga inspektimi i bërë në terren më datë 23.10.2023 nga inspektorët K.L, A.G në subjektin P.S.B, me adresë: Lagjja Nr.15, Rruga "A.Goga", Spitallë janë konstatuar punime në ndërtim pa leje, duke bërë mur rrethues me blloqe betoni dhe me portë metalike.
Inspektorët e terrenit të IMTV-së më datë 23.10.2023 kanë mbajtur procesverbal për konstatimin e kundërvajtjes, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi. Rezulton se procesverbali i datës 23.10.2023 i mbajtur nga inspktorët K.L dhe A.GJ, për konstatimin e kundërvajtjes për kryerjen e punimeve pa leje, nuk është shoqërar me vendimin për dënimin me gjobë, (fotot janë të paqarta dhe nuk e tregojnë objektin tërësisht), Nga inspektoret e terrenit të IMTV-së, për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, por nuk është vendosur dënimi me gjobë për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, në kundërshtim me nenin 52 të ligjit ligj nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar.
Inpektorët kanë përgatitur relacion për kryeinspektorin më datë 23.10.2023, për vazhdimin e procedurës ligjore. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, nga IMT Bashkia Durrës, rezulton se në praktikë mungon marrja e vendimit nga ana e Kryeinspektorit për vijimin e procedurës ligjore, dënimin me masën administrative gjobë ndaj subjektit, si dhe nuk është vijuar më tej me vendimin e prishjes së objektit të ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme nga ana e Kryeinspektorit të IMT Bashkia Durrës.

**Konkluzion:** Nga Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Durrës nuk është vijuar procedura brenda afatit 10-ditor për nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë", për subjektin P.B, në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
- Kryeinspektori nuk ka nxjerrë "Vendim për Prishje" në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
- Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat e ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:
a) kryetari i bashkisë;
b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

- IMTV-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetasin P.B., për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 gërma (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit" i ndryshuar.

**III. Dosja e subjektit R.E.H**

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 25.10.2023, nga inspektorët A.H, E.L, në subjketin R.E.H, me adresë "Shkëmbi i Kavajës", prapa Hotel "B." janë konstatuar punime pa leje: Hapja e një dere në fasadën e pallatit në katin e parë, byllja e derës në pjesën e brendshme të hyrjes në banesë në katin e parë, portë metalike në pjesën e përbashkët të oborrit, shkallë betoni, rrethim me kangjella tek depozitat në oborr pa lejen përatëse.

Nga inspektorët e terrenit të IMTV Bashkia Durrës, më datë 25.10.2023 është mbatur procesverbal për konstatimin e kundërvajtjes për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, (bashkëlidhur fotot).

Më datë 25.10.2023 nga inspektorët është mbajtur relacion drejtuar Kryeinspektorit të IMTV Bashkia Durrës për vijimin e procedurës ligjore, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Më datë 30.10.2023 nga kryeisnpektori i IMTV Bashkia Durrës, D."M" është marrë vendimi për prishje, duke njoftuar edhe subjektin për prishjen në mënyrë vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

**Konkluzion:** Nga Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Durrës nuk është vijuar procedura brenda afatit 10-ditor për nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë", për subjektin R.H, në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

- Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat e ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

- Nga ana e IMT-së Bashkia Durrës nuk është vijuar ndërhyrja për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

- Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit*** në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar.

- IMTV-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetasin R.H., për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 gërma (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit" i ndryshuar.

**IV. Dosja e subjektit L.K**

Nga inspektimi në terren më datë 17.05.2023 nga Inspektorët A.G dhe K.L, në subjektin L.K, me adresë Lagjja Nr.8, Rruga "Kastrioti", Durrës është konstatuar punime ndërtimi, duke bërë barrier mbrojtëse dhe shtrim me beton të verandës si dhe armaturë dërrase pa leje ndërtimi.

Nga inspektorët e terrenit të IMT-së, më datë 17.05.2023, është mbajtur process-verbal për konstatimin e kundervajtjes, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi (dokuemntuar me foto).

Më datë 17.05.2023 nga inspektorët e IMTV Bashkia Durrës është mbajtur relacion, dërguar Kryeinspektorit për vijimin e procedurave të mëtejshme ligjore ndaj kundërvajtësit.

**Konkluzion:** Nga Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Durrës nuk është vijuar procedura brenda afatit 10-ditor për nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë", për subjektin L.K, në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

- Kryeinspektori nuk ka nxjerrë “Vendim për Prishje” në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
- Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat e ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:
a) kryetari i bashkisë;
b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;
- IMTV-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetases L.K., për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 gërma (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

**V. Dosja e subjektit V.I.P**

Nga nspektimi në terren më datë 03.04.2023, nga inspektorët e IMTV Bashkia Durrës, G.H dhe A.G, në subjektin V.I.P, me adresë Lagjja 18, Rruga “Mbreti Pirro”, Durrës, janë konstatuar: Punime ndërtimi pa deklaratë paraprake për kryerje punimesh duke bërë prishje muresh, shkallë, armaturë dërrsaë, puntela hekuri (në ndërtim).
Nga inspektorët e IMT-së, më datë 03.04.2023, është mbajtur process-verbal për konstatimin e kundërvajtjes, për kryerjen e punimevepa leje, me foto bashkëlidhur, por **nuk është vendosur dënimi me gjobë për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi,** në kundërshtim me nenin 52 të ligjit ligj nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit“ i ndryshuar.
Më datë 03.04.2023, nga inspektorët e IMT Bashkia Durrës është mbajtur relacion, dërguar kryeinspektorit për vijimin e procedurave të mëtejshme.
Nga Kryeinspektori nuk është marrë vendim prishje të objektit. Mungon Urdhëri i Ekzekutimit nga Kryeinspektori për prishjen e objektit të kundërligjshëm, që do të thotë se objekti nuk është prishur.

**Konkluzion:**
-Nga inspektoret e terrenit nuk është vendosur dënimi me gjobë për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, në kundërshtim me nenin 5 pika “b“ të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhërit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika “d“ të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar..

**VI. Dosja e subjejtit A.P.T**

Nga inspektimi në terren më datë 12.04.2023 nga inspektorët G.H dhe A.G, në subjektin A.T, me adresë: Lagjja 15, rruga “Miqësia”, Spitallë-Durrës, janë konstatuar punime pa leje, në prishjen e një kati pa leje në objekt.
Inspektorët e IMTV Bashkia Durrës, më datë 12.04.2023 kanë mbajtur proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes, për kryerjen e punimeve pa leje (nuk ka foto bashkëlidhur).
Më datë 12.04.2023 nga inspektorët e IMT është përgatitur relacion për kryeinspektorin, për vijimin e procedurave të mëtejshme.
Më datën 14.04.2023 nga Kryinspektori është marrë vendimi, për dënimin me gjobë në masën 300,000 lekë ndaj subjektit kundërvajtës A.T, duke i dërguar edhe njoftim me shkresën me Nr. 599/1 prot., datë 18.04.2023, “Dërgim vendimi për dënimin me gjobë”, për shlyerje vullnetare, ku bazuar në faturën e datës 18.04.2023 gjoba është paguar nga shtetasja J. B. .
Në procesverbalin e gjobës, aplikimi i masës së gjobës me 300,000 lekë nuk ka një arsyetim për llogaritjen dhe bazën ligjore, kjo në kundërshtim me Nenin 52, të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.

**Konkluzion:**

-Kryeinspektori nuk ka nxjerrë "Vendim për Prishje" në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
-IMTV-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetasin A.T.., për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 gërma (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit" i ndryshuar.

**VII. Dosja e subjektit N.S.V**

Nga inspektimi i bërë në terren më datë 20.02.2023, nga Inspektorët A.H, E.L, në subjektin N.S.V me adresë: Lagjja Nr.15, Rruga: "Miqësia, Spitallë, Bashkia Durrës janë konstatuar punime pa leje që konsiston në vendosjen e konstruksionit metalik.
Inspektorët e terrenit të IMTV-së, më datë 20.02.2023 kanë mbajtur process-verbal për konstatimin e kundërvajtjes, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi (e dokumentuar me foto).
Më datë 20.02.2023, nga inspektorët është përgatitur Relacion drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore.
Më datë 24.02.2023 është venosur dënimi me gjobë nga Kryeinspektori, në shumën 50,000 lekë.
Më datë 24.02.2023 nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje të objektit të ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme.
Me shkresën me nr.298/1 prot., datë 24.02.2024 kundërvajtësit N.V. i është dërguar njoftim nga IMTV Bashkia Durrës, për prishjen në mënyrë vullnetare të objketit të ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme.
Me shkresën me nr. 298/2 prot., datë 24.02.2023 kundërvajtësit N.V i është dërguar shkresa për shlyerjen vullnetare të masës administrative, dënim me gjobë.
Nga IMT-ja janë ndjekur të gjitha procedura, deri në ekzekutimin e vendimit për prishje, që do të thotë për objekte provizore vijojnë dhe përfundojnë procedurat e ekzekutimit, ndërsa për ndërtimet pa leje të ndërtuar, me themele me kollana betoni dhe soltet monolite të ngritura në kate nuk vijojnë procedurat e Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, që do të thotë se punohet me dy standarde.

***Konkluzion:*** **-** Nga Kryeinspektori i IMTV-së punohet me dy standarde, ku për objekte provizore, të pa lidhura me sistemin e tokës (themelet), apo dhe me konstruksione metalike ose druri, vijojnë dhe përfundojnë procedurat e ekzekutimit për prishje, ndërsa për ndërtimet pa leje të ndërtuar më themele me kollan betoni dhe soletë monolite të ngritura në kate nuk vijohet procedura e Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

***Për sa më lart mbajnë përgjegjësi për Vitin 2023:***

**Z. D.M,** në cilësinë e kryeinspektorit, për:
***1 rast*** - Nga Kryeinspektori i IMTV-së gjoba është vendosur në masën minimale 50,000 l**,** në kundërshtim me nenin 52 shkronja "e" të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.
***5 Raste*** - Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës ***me kallëzim penal*** në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar;
**6 raste** - Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë", në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

**3 raste -** Nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e "Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektit të Kundërligjshëm", që do të thotë se objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishje vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Durrës, duke u bërë shakatarë i rritjes së numrit të ndërtimeve informale që kalojnë në procesin e legalizimit, ku subjektet kanë përfituar parcela ndërtimore në pronësi publike, në zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" dhe nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe në kundërshtim me nenin 52 pika 6 të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.
**3 raste** – Nga kryeinspektori i IMT-së Bashkia Durrës edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi të mbajtura nga Inspektorët e terrenit, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10-ditor për nxjerrjen e vendimit për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm", në kundërshtim me nenin 5 pika "d" dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
***6 raste -*** Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit*** në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar.

- *Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të konstatimit të kundërvajtjeve administrative u konstatua se për Vitin 2024:*

**I. Dosja e subjektit F.E**

Nga inspektimi i bërë në terren më datë 29.04.2024 nga inspektorët **K.L, A.H,** në subjektin "F.E", me adresë: Kullë, pranë Njësisë Administrative Sukth, janë konstatuar punime ndërtimi pa leje, objekt 1-katësh me mur tulle, me soletë betoni.
Nga inspektorët e terrenit të IMTV-së, më datën 29.04.2024, është mbajtur process-verbali i konstatimit të kundërvajtjes për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, shoqëriar me foto. Proces-verbali datë 29.04.2024 i mbajtur nga inspektorët K. L. dhe A. H. për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi është shoqëruar me vendim për dënimin me gjobë, në datën 02.05.024 dhe me vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm, datë 02.05.2024.
Inspektorët kanë përgatitur për Kryeinspektorin relacionin me nr. 957 prot., datë 30.04.2024 për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.
Me shkresën me nr. 957/1 prot., datë 03.05.2024 kundërvajtësit F.E. i është dërguar njoftim nga IMTV Bashkia Durrës, për prishjen në mënyrë vullnetare të objketit të ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme.
Me shkresën me nr. 957/2 prot., datë 03.05.2024 kundërvajtësit F.E. i është dërguar shkresa për shlyerjen vullnetare të masës administrative, dënim me gjobë.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, nga IMT Bashkia Durrës, rezulton se në praktikë mungon marrja e vendimit nga ana e Kryeinspektorit për vijimin më tej me prishjen e objektit të ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme.

**Konkluzion:** Nga ana e IMT-së Bashkia Durrës nuk është vijuar ndërhyrja për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
- Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit*** në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar.
- IMTV-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetasin R.H., për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 gërma (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit" i ndryshuar.

- Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat e ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:
a) kryetari i bashkisë;
b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

**II. Dosja e subjektit A.H**

Nga inspektimi i kryer në terren nga inspektorët K.S dhe K.L, në subjektin A.H, me adresë në Lagjja Nr.10, Rruga “E.D”, Durrës janë konstatuar punime pa leje ndërtimi, objekt me plate betoni, kollona betoni, murë tulle, armaturë dërrase.
Nga inspektorët e terrenit të IMTV më datë 29.10.2024 është mbajtur procesverbali për konstatimin e kundëravjtjes, për punime pa leje ndërtimi, shoqëruar edhe me foto.
Procesverbali i mbajtur më datë 29.10.2024 është shoqëruar nga ana e IMTv Bashkia Durrës edhe me vendimin për prishjen e objektit të kundërligjshëm me datë 01.11.2024 dhe masën administrative, vendim dënimi me gobë me procesverbalin e datës 01.11.2024.
Inspektorët kanë përgatitur për Kreyinspektorin relacion me nr.2395 prot., datë 29.10.2024, për vazhdimin e procesdurës ligjore.
Me shkresën me nr. 2395/1 prot., datë 31.10.2024 kundërvajtësit A.H.. i është dërguar konstatimi i kundërvajtjes.
Me shkresën me nr. 2395/2 prot., datë 01.11.2024 kundërvajtësit A.H. i është dërguar shkresa për prishjen në mënyrë vullnetare të objektit të kundërligjshëm.
Me shkresën me nr. 2395/3 prot., datë 01.11.2024, kundërvajtësit A.H. I është dërguar shkresa e vendimit të gjobës, për shlyerjen në mënyrë vullnetare të masës administrative të vendosur.
Nga ana e IMTV Bashkia Durrës, është përgatitur edhe kallëzim penal për subjektin, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.bazuar në shkresën me Nr.2609 prot., datë 27.11.2024

**Konkluzion: -** Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumës së detyrimit*** në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.
-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhërit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, në kundërshtim me nenin 5 pika “d“ të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar..

**III. Dosja e subjektit G.S.B**

Nga inspektimi i kryer në terren më datë 03.01.2024 nga inspektorët **G.H dhe A.G,** në subjektin G.S.B, me adresë: Lagjja nr.18, Rruga “Mbreti Pirro”, Durrës janë konstatuar punime ndërtimi pa leje, duke bërë kollona betony, profile hekuri-fitila, armaturë dërrasë jashtë projektit të miratuar (të deklaratës paraprake vendim me nr.1606-23/1, date 27.12.2023).
Nga inspektorët e terrenit të IMTV-së, më datën 03.01.2024, është mbajtur process-verbali i konstatimit të kundërvajtjes për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi. Proces-verbali datë 03.01.2024 i mbajtur nga inspektorët G. H. dhe A. Gj. për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi është shoqëruar me vendim për dënimin me gjobë, datë 11.01.2024 për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi si dhe me vendimin për prishjen e objektt të kundërligjshëm me nr.11.01.2024, bashkëlidhur edhe fotot, ku dallohen ngrija e kollonave të betonit.
Inspektorët kanë përgatitur për Kryeinspektorin relacionin me nr. 33 prot., datë 09.01.2024, për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.
Me shkresën me nr. 33/1 prot., datë 12.01.2024 kundërvajtësit G.B.. i është dërguar shkresa “Dërgim vendimi për prishjen në mënyrë vullnetare të objketit të kundërligjshëm”.

Me shkresën me nr. 33/2 prot., datë12.01.2024 kundërvajtësit G.B. i është dërguar shkresa "Vendim për dënimin me gjobë" dhe shlyerjen në mënyrë vullnetare.
Me shkresën me nr. 2395/3 prot., datë 01.11.2024, kundërvajtësit A.H. I është dërguar shkresa e vendimit të gjobës, për shlyerjen në mënyrë vullnetare të masës administrative të vendosur.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, nga IMT Bashkia Durrës, rezulton se gjoba në masën 50,000 l është shlyer nga kundërvajtësi. Por, në praktikë mungon marrja e vendimit nga ana e Kryeinspektorit për vijimin më tej, me prishjen e objektit të ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme.

**Konkluzion:**
- Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit, për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar. Nga informacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, nga ana e IMTV Bashkia Durrës, justifikohet me faktin se prishja e objektit nuk mund të kryhet për shkak të mungesës së mjeteve, pro që nga praktika konstatohet se ka një mungesë të bashkëpunimit me drejtorine e shërbimeve Bashkia Durrës, për të çuar procesin e ngarkuar me ligj deri në fund!
- Vendimi "Për Dënimin me Gjobë" prej 50,000 lekësh, i vendosur nga inspektorët e terrenit është minimal, në kundërshtim me nenin 52 shkronja "e" të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.

**IV. Dosja e subjektit F.M.H**
Nga inspektimi i kryer në terren nga inspektorët e IMTV Bashkia Durrës, **A.H** dhe **K.S** në subjektin F.M.H, me adresë "Xhafzotaj", Njësia administrative Rrashbull, janë konstatuar punime ndërtimi pa leje: Objekt 1-katësh me plate betoni, mur tulle, kollona betoni, armaturë dërrase, pa mbulesë, pa leje ndërtimi.
Nga inspektorët e terrenit të IMTV, më datë 07.11.2024 është mbajtur procesverbali i konstatimit të kundërvajtjes, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi. Procesverbali i datës 07.11.2024, I mbajtur nga inspektorët A.H dhe K.S. është shoqëruar me vendimin e dënimit me gjobë, datë 11.11.2024, si dhe vendim për prishjen e objketit të kundërligjshëm, dt.11.11.2024, bashkëlidhur edhe foto.
Inspektorët kanë përgatitur relacionin me nr. 2473 prot., datë 07.11.2024 për Kryinepsktorin për vijimin e mëtejshëm të procedurave ligjore.
Me shkresën me nr. 2473/1 prot., datë 12.11.2024 kundërvajtësit F.H. i është dërguar shkresa "Dërgim vendimi për prishjen në mënyrë vullnetare të objketit të kundërligjshëm".
Me shkresën me nr. 2473/2 prot., datë12.11.2024 kundërvajtësit F.H. i është dërguar shkresa "Vendim për dënimin me gjobë" dhe shlyerjen në mënyrë vullnetare.
Me shkresën me nr. 2629 prot., datë 02.12.2024, nga IMTV Bashkia Durrës është përgatutur kallëzim penal ndaj shtetasit F.H, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës.

**Konkluzion:**
- Vendimi "Për Dënimin me Gjobë" prej 500,000 lekësh, i vendosur nga inspektorët e terrenit është minimal, në kundërshtim me nenin 52 shkronja "e" të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.
- Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat e ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:
a) kryetari i bashkisë;
b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;
- Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit, për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të

ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

**V. Dosja e subjektit F.V**

Nga inspektimi i bërë në terren nga inspektorët e IMTV Bashkia Durrës, **G.H** dhe **K.L,** në subjektin F.V, me adresë Katund-Sukth, Njësia Administrative Katundi I Ri, Durrës, janë konstatuar punime ndërtimi pa leje: çati e shfrytëzueshme, ristela dërrase me mbulesë, me tjegulla.

Nga inspektorët e terrenit në IMTV, G.H dhe K.L, është mbajtur procesverbali I konstatimit të kundërvajtjes datë 06.12.2024, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi. Procesverbali I datës 06.12.2024, I mbajtur nga inspektorët e IMTV është shoqëruar me vendimin e dënimit me gjobë, datë 11.12.2024 dhe vendimin për prishjen e objektit të kundërligjshëm, datë 11.12.2024, bashkëlidhur edhe foto.

Inspektorët kanë përgatitur relacionin me nr. 2663 prot., datë 10.12.2024 drejtuar Kryeinspektorit, për vijimin e procedurës ligjore.

Me shkresën me nr. 2663/1 prot., datë 12.12.2024, kundërvajtësit F.V. i është dërguar njoftimi për prishjen në mënyrë vulnetare të objketit të ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme.

Me shkresën me nr. 2663/2 prot., datë 12.12.2024, kundërvajtësit F.V. I është dërguar vendimi për dënimin me gjobë dhe shlyerja në mënyrë vullnetare.

***Konkluzion:***

-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit, për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Vendimi "Për Dënimin me Gjobë" prej 500,000 lekë i vendosur nga inspektoret e terrenit është minimal, në kundërshtim me nenin 52 shkronja "e" të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.

-Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Durrës me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit F.V., për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal.

**VI. Dosja e subjektit G.G.B**

Nga inspektimi i bërë në terren nga inspektorët e IMTV Bashkia Durrës, A.H dhe K.L, në subjektin G.G.B, me adresë Lagjja Nr.4, rrethrrotullimi i Portit të Durrësit, janë konstatuar punime pa leje ndërtimi, duke vendosur konstruksione metalike si dhe veshje me panele sanduiç të mbulesës dhe veshjes anësore.

Nga inspektorët e terrenit të IMTV, A.H dhe K.L. është mbajtur procesverbali I konstatimit të kundërvajtjes, datë 24.01.2024, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi. Procesverbali I datës 24.01.2024 I mbajtur nga inspektorët e IMTV, është shoqëruar me vendim për prishjen e objektit të kundërligjhsnë,, datë 26.01.2024 dhe vendim për dënimin me gjobë, datë 26.01.2024.

Inspektorët knë përgatitur relacionin me nr. 198 prot., datë 25.01.2024 për Kryeisnepktorin e IMTV, duke kërkuar vijimin e procedurave ligjore.

Me shkresën me nr. 198/1 prot., datë 25.01.2024, kundërvajtësit G.B. i është dërguar procesverbal për konstatimin e kundërvajtjes.

Me shkresën me nr. 198/2 prot., datë 29.01.2024, kundërvajtësit G.B. i është dërguar njoftim për prishjen në mënyrë vullnetare të objektit të ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme.

Me shkresën me nr. 198/3 prot., datë 07.02.2024, kundërvajtësit G.B. i është dërguar vendimi për dënimin me gjobë dhe shlyerja në mënyrë vullnetare.

Me shkresën me nr.1439 prot., datë 19.06.2024, IMTV Bashkia Durrës I është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë për lëshimin e urdhërit të Ekzekutimit.
Me shkresën me nr.198/4 prot., datë 05.07.2024, IMTV Bashkia Durrës i është drejtuar me kërkesë për mbështetje IKMT-së.
Me shkresën me nr.2072/2 prot, datë 30.12.2024, IMTV Bashkia Durrës ka kërkuar pranë Zyrës Përmbarimore Durrës vënien në ekzekutim të Urdhërit të Ekzkeutimit, për vjeljen e detyrimit, të masës administrative gjobë ndaj subjektit G.B.
Nga praktika vënë në dispozicion grupit të auditimit, nga IMTV Bashkia Durrës, vihet re mungesë e theksuar e bashkëpunimit me Zyrën e Përmbarimit Shtetëror Durrës. Ndonëse ka kaluar afati 10-ditor e fazës përmbarimore "Lajmërim për ekzeuutim vullnetar", nga ana e Zyrës së Përmbarimit nuk ka vijim të procedurës me "Ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit", madje as shkresë ku IMTV të kërkojë informacion për ecurinë e procesit pranë ZP Shtetëror Durrës.

**Konkluzion:** - Vendimi "Për Dënimin me Gjobë" prej 300,000 lekë i vendosur nga inspektoret e terrenit është minimal, në kundërshtim me nenin 52 shkronja "e" të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.
-Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Durrës me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit G.B., për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal.
-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit, për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

**VII. Dosja e subjektit "I paidentifikuar".**
Nga inspektimi I bërë në terren nga inspektorët e IMTV Bashkia Durrës, K.S dhe A.H, në subjektin "I paidentifikuar", Lagjja nr.15, pranë "E", Durrës, janë konstatuar duy objekte me blloqe, me tjegulla, me mbulesë llamarine pa lejen përkatëse.
Nga inspektorët e terrenit të IMTV, K.S. dhe A.H. është mbajtur procesverbali i konstatimit të kundërvajtjes, datë 13.02.2024, për konstatimin e dy objekteve ekzistuese pa leje ndërtimi.
Procesverbali i konstatimit, i datës 13.02.2024, i mbajtur nga inspektorët e IMTV Bashkia Durrës, është shoqëruar me vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm, me datë 16.02.2024, por mungon vendimi i dënimit me gjobë, bashkëlidhur edhe foto nga objektet.
Inspektorët kanë përgatitur relacion për Kryeinspektorin, me nr.385 prot., datë 13.02.2024, për vijimin e procedurës ligjore.
Bashkëlidhur praktikës, me shkresën me nr.385/1 prot., datë 16.02.2024, IMTV ka afishuar shkresën në objektin e konstatuar, ku njofton dhe kërkon prishjen në mënyrë vullnetare.
Me shkresën me nr 385/2 prot., datë 16.02.2024, IMTV kërkon nga Sektori I Informacionit, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Nr.4, për afishimin e vendimt për prishjen e objektit.
Me shkresën me nr.385/3 prot., datë 16.02.2024 IMTV është drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, për mbështetjen në vendin dhe orarin e caktuar për prishjen e objektit.
Me shkresën me Nr.385/4 prot., datë 16.02.2024, IMTV i drejtohet Policisë Bashkiake me kërkesën për mbështetje, për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimit të prishjes.
Me shkresën me nr.423 prot., datë 16.02.2024 IMTV i është drejtuar Ndërmarrjes Komunale, Bashkia Durrës me kërkesë për mbështetje, për ekzekutimin e vendimit, prishjen e objektit.
Me shkresën me nr. 423/1 prot., datë 16.02.2024, nga IMTV Bashkia Durrës, është drejtuar me "kërkesë për mbështetje", Njësisë Administrative Nr.4, për pjesëmarrjen në ekzekutimin e vendimit të objektot të sipërcituar.
Bazuar në praktikën e vënë në dispozicion grupit të auditimit, nga IMTV Bashkia Durrës, konstatohet se nuk ka një bashkëpunim me Njësinë Administrative, Komisariatin e Policisë si dhe Zyrën e Gjendjes Civile, për të kërkuar informacion më të detajuar, se kujt i përkasin dy objektet ekzistuese,

***Konkluzion:*** - Nga inspektoret e terrenit nuk është vendosur dënimi me gjobë Brenda aftit 10-ditor, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, në kundërshtim me nenin 5 pika "b" dhe Neni 13 paragrafi I parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

- Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit, për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar. Mungon edhe procesverbali me foto për të konfirmuar nëse objektet janë prishur ose jo nga IMTV.
- Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Durrës me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit "I paidentifikuar", për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal.

**VIII. Dosja e subjektit "I paidentifikuar"**

Ng inspektimi I kryer në terren, nga inspektorët e terrenit Bashkia Durrës, K.S dhe A.H, në subjektin "I paidentifikuar", me adresë në lagjjen 15, rruga "Kuvendi Françeskan", pranë "E", Durrës është konstatuar ndërtim ekzistues pa leje, murr rrethues me blloqe betony, me portë me rrjetë teli.

Nga inspektorët e terrenit, K.S dhe A.H.është mbajtur procesverbali I konstatimit, më datë 13.02.2024, për krerjen e punimeve pa leje ndërtimi. Procesverbali I konstatimit është shoqëruar me vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm, me nr.16.02.2024 bashkëlidhur edhe fotot.

Inspektorët kanë përgatitur relacion me nr.386 prot., datë 13.02.2024 për Kryeinspektorin, për vijimin e procesudrës ligjore.

Bashkëlidhur praktikës, së vënë në dispozicn grupit të auditimit, nga IMTV Bashkia Durrës:

Shkresë me Nr.386/1 prot., datë 16.02.2024, afishim në object, I vendimit për prishjen e objektit, drejtuar subjektit "I paidentifikuar".

Me shkresën me nr 386/2 prot., datë 16.02.2024, IMTV kërkon nga Sektori I Informacionit, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Nr.4, për afishimin e vendimt për prishjen e objektit.

Me shkresën me nr.386/3 prot., datë 16.02.2024 IMTV është drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, për mbështetjen në vendin dhe orarin e caktuar për prishjen e objektit.

Me shkresën me Nr.386/4 prot., datë 16.02.2024, IMTV i drejtohet Policisë Bashkiake me kërkesën për mbështetje, për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimit të prishjes.

Me shkresën me nr.424 prot., datë 16.02.2024 IMTV i është drejtuar Ndërmarrjes Komunale, Bashkia Durrës me kërkesë për mbështetje, për ekzekutimin e vendimit, prishjen e objektit.

Me shkresën me nr. 424/1 prot., datë 16.02.2024, nga IMTV Bashkia Durrës, është drejtuar me "kërkesë për mbështetje", Njësisë Administrative Nr.4, për pjesëmarrjen në ekzekutimin e vendimit të objektot të sipërcituar.

Bazuar në praktikën e vënë në dispozicion grupit të auditimit, nga IMTV Bashkia Durrës, konstatohet se nuk ka një bashkëpunim me Njësinë Administrative, Komisariatin e Policisë si dhe Zyrën e Gjendjes Civile, për të kërkuar informacion më të detajuar, se kujt i përket objekti.

***Konkluzion:*** - Nga inspektoret e terrenit nuk është vendosur dënimi me gjobë Brenda aftit 10-ditor, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, në kundërshtim me nenin 5 pika "b" dhe Neni 13 paragrafi I parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

- Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit, për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar. Mungon edhe procesverbali me foto për të konfirmuar nëse objekti është prishur ose jo nga IMTV.

- Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Durrës me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit "I paidentifikuar", për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal.

**IX. Dosja e subjektit A.S.A**

Nga inspektorët e terrenit të IMTV Bashkia Durrës, K.L dhe G.H, suibjektin A.A, me adresë Lagja Nr. 15, rruga "Miqësia", Spitallë-Durrës janë konstatuar punime pa leje, ndërtim me konstruksion metalik, me profile llamarine me mbulesë sanduiç jshtë deklaratës paraprake për kryerjen punimesh. Punime pa leje duke shkelur projektin e miratuar dhe mbyllje anësore me profile llamarine.

Nga inspketorët e terrenit, K.l. dhe G.H. është mbajtur procesverbali i konstatimit i datës 26.03.2024, për kryerjen e punimeve pa leje. Procesverbali I konstatimit është shoqëruar me vendim për prishjen e objektt me nr,28.03.2024 dhe vendim për dënimin me gjobë datë 28.03.2024, si dhe vendim për pezullimin e punimeve datë 28.03.2024, bashkëlidhur edhe foto dhe miratim I deklaratës paraprake për kryerje punimesh, nga Kr.i Bashkisë Durrës, Znj.E.S. me nr258-24 prot., datë 28.02.2024.

Inspektorët kanë përgatitur informacion për lryeinspektrin me Nr.690 prot., datë 26.03.2024, për vijimin e procedurës, duke kërkuar vijimin e procedurës ligjore.

Me shkresën me nr.690/1 prot., datë 29.03.2024, subjektit kundërvajtës A.A. i është dërguar shkresë, dërgim vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm në mënyrë vullnetare.

Me shkresën me nr. 690/2 prot., datë 29.03.2024, subjektit kundërvajtës AAll I është dërguar shkresë vendim dënimi me gjobë, për shlyerjeen në mënyrë vullnetare, në shumën 500,000 lekë të reja.

Me shkresën me nr, 690/3 prot., datë 29.03.2024 subjektit i është dërguar shkresë vendim për pezullimin e punimeve, me një afat 45-ditë.

Me shkresën me nr.690/4, IMTV I është drejtuar Drejtorisë Vendore të Polcisë Durrës, për ,bështetje në pezullimin e punimve të kryera nga subjketi kundërvajtës.

Me shkresën me nr.708 prot., datë 29.03.2024 IMTV i është drejtuar policisë bashkiake, me kërkesë për mbështetje për bajtjen pezulluar të kryerjes së punimeve sipas afatit të përcaktuar n vendimin e pezullimit.

IMTV i është drejtuar me kërkesën, me nr. 1436 prot., datë 19.06.2024, për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe me shkresën me nr.66 prot., datë 16.01.2025 ka kërkuar vënien në dispoicion të Urdhërit të Ekzkeutimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

**Konkluzion:** Nga ana e IMT-së Bashkia Durrës nuk është vijuar ndërhyrja për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

- Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumës së detyrimit*** në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar.
- IMTV-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetasin R.H., për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 gërma (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit" i ndryshuar.

***Për sa më lart mbajnë përgjegjësi për Vitin 2024:***

**Z. D.M,** në cilësinë e kryeinspektorit, për:

***1 rast*** - Nga IMTV Bashkia Durrës justifikohet me faktin, se prishja e ndërtimit të kundërligjshëm **nuk mund të kryhet për shkak të mungesës së mjeteve, ndërkohë që në situata të tjera ka kërkuar bashkëpunimin e Ndërmarrjes Komunale në varësi të Bashkisë Durrës.**

***1 rast***-Nga IMTV Bashkia Durrës i është drejtuar IKMT, ndërsa nuk ka kërkuar bashkëpunim për rastet e tjera, në kundërshtim me Nenin 5, gërma "e" dhe "F" dhe Nenin 12, pika 1 dhe pika 8, gërma "a", "b", "c", të i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar;
***4 raste*** - Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për arkëtimin e shumave të detyrimit*** në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar;
***4 raste*** - Nga Kryeinspektori i IMTV-së gjoba është vendosur në masën minimale**,** në kundërshtim me nenin 52 shkronja "e" të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.
***6 Raste*** - Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës nuk i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës ***me kallëzim penal*** në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar;
**2 raste** - Nga IMT-ja e Bashkisë Durrës edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë", në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
**10 raste** - Nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e "Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektit të Kundërligjshëm", që do të thotë se objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishje vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Durrës, duke u bërë shkaktarë i rritjes së numrit të ndërtimeve informale që kalojnë në procesin e legalizimit, ku subjektet kanë përfituar parcela ndërtimore në pronësi publike, në zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" dhe nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe në kundërshtim me nenin 52 pika 6 të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.
***2 raste***- Nga kryeinspektori i IMTV Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat e ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:
a) kryetari i bashkisë dhe b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;
***2 raste*** –Nga IMTV për kundërvajtës të paidentifikuar, nga IMTV Bashkia Durrës, konstatohet se nuk ka një bashkëpunim me institucione si: ASHK, Njësinë Administrative, Komisariatin e Policisë si dhe Zyrën e Gjendjes Civile, për të kërkuar informacion më të detajuar, se kujt i përket objekti. Për rastet e konstatimit të kundërvajtës, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, për persona të pa identifikuar të kryer nga inspektorët, nuk rezulton që të ketë rikontrolle për të verifikuar ecurinë e punimeve të paligjshme dhe për të identifikuar personin përgjegjës, mungon korrespondenca me institucionet e tjera, për realizimin me sukses të misionit të ngarkuar me ligj, që do të thotë se akti administrativ nuk është i plotë, si rrjedhojë bëhet i pavlefshëm, mosveprime në kundërshtim me nenin 41 e vijues të ligjit 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në RSH".
***2 raste***- Nga IMTV Mungon edhe procesverbali me foto për të konfirmuar nëse objektet janë prishur ose jo nga IMTV, në kundërshtim me nenin 41, pika të ligjit 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në RSH".

Lidhur me objektet dhe gjetjet sa më sipër, me shkresën me nr. 668/88 Prot, datë 17.06.2026, administruar në KLSH nr. 1347/71, Prot dt 18.06.2026, ka paraqitur observacion IMTV Bashkia Durrës, për periudhën e audituar, si më poshtë:
**<u>Pretendimi i subjektit:</u>** *Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të konstatimit të kundërvajtjeve administrative, u konstatua se për periudhën e auditimit 2023-2024…"Për ato shtetas që janë konsumuar të gjithë elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit*

*Penal, bazuar në nenin 5 gërma (dh), të ligjit 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" i ndryshuar; V.K.M Nr.894 , datë 4.11.2015 "Për Unifikimin e Proçedurave të Kontrollit të Territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai Njësisë Vendore", si dhe bazuar në nenin 199/a të K. Penal, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Durrës, ku kjo e fundit paraqet material kallëzues pranë Prokurorisë Durrës dhe lajmëron IMT për ndjekjen ligjore të rastit. (Shembull dosja A.A IX fq285).*

**Qëndrimi i grupit të auditimit**: Referuar sa më sipër, ashtu siç ju kemi vënë në dukje edhe në fazën e projektraportit, lidhur me shpjegimet e dhëna nga subjekti vendos që të mos marrë parasysh observacionin, pasi rezulton i pabazuar dhe pa argumentim ligjor. Në rastet më sipër, IMT Bashkia Durrës është në kundërshtim me nenin 199/a të Kodit Penal me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"* i ndryshuar.

***Në përfundim të auditimit të dokumentacionit mbi aktivitetin e IMTV, Bashkia Durrës, për periudhën 01.01.2023-31.12.2024, arrihet në konkluzionin, se kjo strukturë nuk e ka përmbushur plotësisht qëllimin e saj, garantimin dhe mbrojtjen për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas kuadrit rregullator të fushës, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat ligjore përkatëse.***

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore të:
- Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar;
- Ligji nr. 183/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, Datë 16.7.2007, "Për Inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar;
- Ligji nr. 23/2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9780, Datë 16.7.2007 "Për Inspektimin në ndërtim", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative";
- Ligji nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar;
-Vendimi nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore".

## 2.7. Të ndryshme dajë gjatë auditimit (shqyrtim ankesash).

Në lidhje me ankesat e depozituara në KLSH, nga audtimi është konstatuar, si më poshtë:
**I - Ankesë me nr. 118 prot., datë 18.10.20024,** administruar në KLSH me nr. 1258 prot., datë 21.10.2024, nga studio ligjore "T.& H.", si përfaqësues të shtetasit J.M, ku parashtron shqetësimin për prishjen e ndërtimit të kundraligjishëm, për lirimin e hapësirës publike, si dhe moscënimin e pasurisë së paluajtshme të tij.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në Bashkinë Durrës, ka rezultuar se:
1- Kërkesë-padi, e protokolluar në IMTV Durrës, me nr. 1780/1 prot., dt 02.09.2024;
2- Relacion me nr.1780/2 prot., datë 02.09.2024;
Pasi u njoh me ankesën, grupi i auditimit ka kërkuar informacion në lidhje me ankesën e z. J.M, përfaqësuar nga studio ligjore "T. & H.", për lirimin e hapsirës publike.
Pranë Bashkisë Durrës në datën 17.07.2024 është depozituar ankesa me nr. 8728 prot., nga z. J.M banues në lagjen nr. 10, Rr. "17 Janari", i cili kërkon hapjen e rrugës, që në mënyrë të padrejtë është e mbyllur nga komshiu. Kjo ankesë është protokolluar me nr. 1780 prot., datë 23.07.2024 dhe i ka kaluar për trajtim IMT-së Durrës.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion grupit të audtimit, nga inspektorët e IMTV Bashkia Durrës (Z. A.G dhe Z. G.H), me shkresën nr. 1780/2 prot., datë 02.09.2024 i janë drejtuar me relacion Kryeinspektorit të IMTV-së, z. D.M.
Sipas këtij relacioni, inspektorët e IMTV Bashkia Durrës njoftojnë Kryeinspektorin se pas depozitimit të ankesës pranë Bashkisë Durrës dhe kalimit për trajtim nga ana e IMTV-së, kanë bërë verifikimin në terren dhe kanë konstatuar se objekti në fjalë ishte ekzitues dhe nuk po kryheshin punime.
Bashkëlidhur me këtë relacion, inspektorët kanë vendosur në dispozicion edhe Kërkesë-Padinë që znj. F.H, bërë në datën 23.07.2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, e cila ka paditur Bashkinë Durrës (Sektori i Financës), Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Dega Rajonale Durrës.
Me këtë kërkesë-padi Znj. F.H kërkon detyrimin e palëve të paditura të njohin pronare me parashkrim fitues për sipërfaqen e truallit + Apartament sip.trull = 300 $m^2$ dhe sip.Nd = 86.60 $m^2$, me numër pasurie 18/170/A Zona Kadastrale 8512, Durrës. Kjo kërkesë padi është protokolluar në Bashkinë Durrës me nr. 1780/1 prot., datë 02.09.2024.
Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion mungon akt-verifikimi dhe dokumentacioni justifikues nga inspektorët e IMTV, që janë marrë me trajtimin e rastit, duke verifikuar situatën në terren dhe kanë përgatitur relacionin për Kryeinspektorin, *në kundërshtim me pikën 5, të Nenit 12, i Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e Kundërligjshme", 5. Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës të konstatimit dhe nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar ose përfaqësuesi i tij, kur ky është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar.*
Grupi i auditimit ka komunikuar me Kryeinspektorin e IMTV-së, i cili ka njoftuar inspektorët që janë marrë me trajtimin e rastit dhe ka zhvilluar intervistë me z. A.G në datën 23.01.2025, ku ky i fundit ka informuar grupin e auditimit se, pasi janë njohur me ankesën *nuk kanë mbajtur akt verifikimi dhe nuk kanë dokumentacion mbështetës për trajtimin e kësaj ankese, por kanë bërë vetëm relacion për Kryeinspektorin.*

**II - Ankesë me nr. 658/1 prot., datë 11.10.2024,** ku shtetasi K.K, parashtron ankesën me pretendimet lidhur me moszbatimin e vendimit të gjykatës për... *"rikthim në detyrën e mëparshme"* pranë Bashkisë Durrës.
Pasi mori në shqyrtim ankesën, grupi i auditimit kërkoi informacion, me "e-mailin" e datës 17.01.2025, drejtuar: Drejtorisë Ligjore, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së Buxhetit, struktura në varësi të Bashkisë Durrës.
Me "e-mailin" e datës 20.01.2025, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, "Kthim-përgjigje KLSH-së...", rezulton se rekrutimet e bëra në Vitin 2023 pranë Bashkisë Durrës, janë si më poshtë:

- **Me konkurim sipas Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin Civil".**

- Specialist, Sektori Politikave të Turizmit, Drejtoria e Turizmit;
- Inspektor, Njësia Administrative nr.3;
- Specialist Sektori Menaxhimit të Gjeoinformacionit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;
- ***Specialist Sektori i Menaxhimit te Borxhit dhe Apelimit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore;***
- Inspektor, Njësia Administrative nr.2;
- Specialist Sektori Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;
- Drejtor, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike-Inspektor, Njësia Administrative nr.6;

- Administrator Shoqërore, Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë, Drejtoria e Shërbimit -- Social, Njësia Administrative nr.4;
- Specialist, Sektori Kontrollit të Plotë, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm;
- Specialist, Sektori Kontrollit Tematik, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm;
- Specialist, Sektori Kontrollit Tematik, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm;
- Specialist, Sektori i Bujqësisë, Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- Specialist, Sektori i Bujqësisë, Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- Specialist, Sektori i Planeve të Detajuara Vendore, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të -- Zhvillimit të Territorit;
- Specialist, Sektori i Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Marrëdhniet me Publikun, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;
- Inspektor VeterI.r, Sektori i Shërbimeve VeterI.re dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Shërbimeve Publike;

➢ **Me konkurim sipas ligjit nr. 89/2022 "Për Policinë Bashkiake"**

- Policë pranë Policisë Bashkiake: (**7 pozicione);**

➢ **Rekrutime pa konkurim:**

- Shofer pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore;
- Specialist, Gjendja Civile nr. 4;
- Specialist, Gjendja Civile nr. 6;

Bazuar në informacionin e kërkuar pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Bashkia Durrës, vënë në dispozicion grupit të auditimit me "e-mailin" e datës 03.02.2025, rezulton se në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore/Sektori i Menaxhimit të Borxhit dhe Apelimit Tatimor organiG. e miratuar bazuar në strukturë është (1+5). Në muajin Prill 2022, rezulton se Zj. B. D. është dorëhequr si spec. pranë Sektorit të Menaxhimit të Borxhit dhe Apelimit Tatimor, kurse në muajin Qershor 2022, Z. A. Xh. (Sektori i Menaxhimit te Borxhit dhe Apelimit Tatimor) ka ndërruar jetë. Për periudhën qershor - dhjetor të Vitit 2022, pozicioni ka qenë vakant, njëkohësisht janë nisur edhe procedurat e rekrutimit "Për pranimin në shërbimin civil" nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Durrës, për plotësimin e vendit vakant, *"Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Borxhit dhe Apelimit",* pranë Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore. Referuar akt-emërimit në detyrë, me nr. 750 prot., datë 20.01.2023, pika 1, rezulton: "Emërimin e Zj. M.K, në detyrën Specialistit pranë Sektorit të Menaxhimit të Borxhit dhe Apelimit Tatimor, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Me "e-mailin" e datës 22.01.2025, në përgjigje të "e-mailit", nga Drejtoria Ligjore pranë Bashkisë Durrës, na vihet në dispozicion informacion mbi trajtimin e problematikës, ku rezulton edhe se nga Rekomandimi i lënë nga KLSH, në Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi Auditimin FI.nciar dhe të Përputhshmërisë" në Bashkinë Durrës për Vitin 2023.....*(39.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa për ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për* ***shtetasit K.K.*** *dhe G.K. dhe të shmangin në të ardhmen ndjekjen e procedurave të gabuara për çështjet e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative fI.nciare në buxhet. Menjëherë dhe në vijimësi).*

Bashkia Durrës në zbatim të akteve të sipërcituara dhe vendimeve gjyqësore, bazuar në raportin e auditimit të KLSH-së, *mbi "Auditimin FI.nciar dhe të Përputhshmërisë, Bashkia Durrës për periudhën 01.01.2022.31.12.2022"* dhe rekomandimin sa më sipër, në bazë edhe të kërkesave të Zyrës Përmbarimore "H. B. S.", ka kryer **2 pagesa** në favor të Zyrës Përmbarimore "H.B.S.", me kreditor K.K. Pagesat janë kryer respektivisht **në shumën 7,362,412 lekë** bazuar në Urdhër Shpenzimin me nr. 551 dt. 14.06.2024, (në bazë të shkresës dt. 07.09.2023 së Zyrës Përmbarimore "H. B. S.") dhe në shumën **242,960 lekë** me Urdhër Shpenzimin nr. 859 dt. 05.08.2024 (në bazë te shkresës nr. 29.07.2024). *Në total shuma e paguar në favor të kreditorit është* ***7,605,372 Lekë.***

Bëjmë me dije se z. K.K, është rikthyer në detyrë pranë Bashkisë Durrës, bazuar në **aktin e emërimit në detyrë, me nr. prot. 420/2, datë 17.01.2025,** (rikthimin në detyrën e mëparshme), specialist pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.
Nga grupi i auditimit, i cili ka marrë në shqyrtim ankesën, në bazë të informacionit të kërkuar dhe praktikave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria Ligjore pranë Bashkisë Durrës, u njoh edhe me **aktin e emërimit në detyrë të Z. K.K, sipas shkresës me nr. 420/2 prot., datë 16.01.2025**. **Për sa trajtuar më sipër, në lidhje me pretendimin e ankuesit, grupi i auditimit konstaton se rekomandimi është realizuar tërësisht, duke marrë zgjidhje edhe kërkesa e ankuesit, K.K.**

***(Gjerësisht problemet mbi shkeljet janë trajtuar në aktverifikimin Nr.1-2, datë 18.07.2025, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Durrës).***

**III- Mbi shqyrtimin e ankesës së z.V.K,** e pasqyruara si më poshtë:
Me anë të shkresës pa numër protokolli, me datë 16.08.2024, drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Kryeministrit, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Avokatit të Popullit, Avokatit të Shtetit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, të administruar në KLSh me shkresën nr.1032 prot., datë 19.08.2024, z. V.K, denoncon Kryetaren e Bashkisë dhe Kryeinspektorin e IVMT-së Durrës për cënimin/ përvetësimin e një sipërfaqe prone në fshatin Rromanat të Durrësit, për të cilën prentendon që është pronar z. M.K (babai i ankuesit). Ankuesi shprehet se, në sipërfaqen e pretenduar të pronësisë po zhvillohet investimi për një rrugë të re, rrugë e cila ka qenë eksistuese që në vitet 90, por pa pasur një Plan të miratuar Zhvillimor. Gjithashtu edhe shkolla "Shefqet Ndroqi" është ndërtuar në një pjesë të pronësisë të z. K. pronë për të cilën, ky i fundit shprehet se ende nuk është dëmshpërblyer nga Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave. Sipas z. K. ndonëse këto investime "thuhet" se janë zhvilluar në kuadër të interesit publik, pas tyre janë interesa private. Për këtë çështje është bërë kallzim pranë Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Grupi i auditimit, i cili ka marrë në shqyrtim ankesën, ka kërkuar informacion në Bashkinë Durrës lidhur me pasurinë e sipërpërmendur dhe verifikim në terren nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Durrës.
Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, rezulton se, në Bashkinë Durrës është paraqitur një ankesë nga banorët e fshatit Rromanat, të Njësisë Administrative Rrashbull, me nr.1325 prot., datë 05.06.2024. Në këtë ankesë, banorët ngrenë shqetësimin për bllokimin e rrugës dhe zënien e hapësirës publike me punime të kryera në mënyrë të paligjshme nga z. V.K dhe z. K.K. Bashkia Durrës i është drejtuar ASHK-së Durrës me anë të një shkrese për të kërkuar statusin juridik të truallit/pronës. Në kthimin e përgjigjes së ASHK-së dhe në bazë të kopjes së kartelës dhe hartës treguese, ka rezultuar se kjo pasuri është në pronë shtet.
Nga IVMT-ja e Bashkisë Durrës, në zbatim të detyrave funksionale të ngarkuara nga Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar, pasi ka kryer verifikimet/ inspektimet në terren, ka konstatuar kundravajtje dhe ka mbajtur procesverbalet dhe vendimet përkatëse (Procesverbal për Konstatimin e Kundërvajtjes/ Vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm/ Urdhër ekzekutimi), të pasqyruara si më poshtë:

- *Procesverbal për Konstatimin e Kundërvajtjes nr.14, datë 25.06.2024, seria 0002894;*
- *Procesverbal për Konstatimin e Kundërvajtjes nr.15, datë 25.06.2024, seria 0002895;*
- *Vendim per prishjen e objektit të kundërligjshëm nr.70, datë 28.06.2024, seria 0001310;*
- *Vendim per prishjen e objektit të kundërligjshëm nr.69, datë 28.06.2024, seria 0001309.*

Për të bërë të mundur ekzekutimin e Vendimit për Prishjen e Objektit Kundërligjshëm u planifikua për të ndërhyrë për ekzekutim me datë 03.07.2024. Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional është bërë njoftim për lirimin e hapësirës publike drejtuar R.K dhe K.K me shkresën nr. 1746 prot., datë 16.07.2024. Mbështetur Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar, neni 128, pika 6, dhe VKM nr. 867, datë 10.12.2014 "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e

administratës shteterore", janë kryer njoftimet përkatëse bashkëpunimi institucional, me shkresat si më poshtë:

- Policisë Bashkiake Durrës, me shkresën nr. 1746/1 prot., datë 16.07.2024;
- Ndërmarjes së Shërbimeve Komunale Durrës, me shkresën nr.1746/2 prot., datë 16.07.2024;
- Komisariati i Policisë Durrës, me shkresën nr.1746/3 prot., datë 16.07.2024;
- Njësisë Administrative Rrashbull Bashkia Durrës, me shkresën nr.1746/4 prot., datë 16.07.2024.

Në vazhdim të procedurave ligjore të IVMT-së është nxjerrë:

- Urdhër ekzekutimi nr. 1611 prot., datë 03.07.2024, ku është shkuar në objektin në fjalë dhe ashtu sikundër pasqyrohet në procesverbalin e ekzekutimit nr.1611/1prot., datë 03.07.2024, u ekzekutua.
- Urdhër ekzekutimi nr.1612 prot., datë 03.07.24 për ekzekutimin e vendimeve nr. 69 dhe nr.70. Në datën 28.06.2024 këto vendime u ekzekutuan. Pas lirimit të hapësirës publike, nga shtetasi V.K është bllokuar sërisht rruga nga vendosja e një objekti të kundraligjshëm. Me datë 06.01.2025, IVMT-ja planifikoi sërisht prishjen e objektit të kundërligjshëm dhe lirimin e rrugës (pronë shtet), për aksesin e lirë të banorëve të fshatit Rromanat. Nga ana e shtetasit V.K është bërë Kallëzim Penal ndaj Kryeinspektorit të IMT-së të Bashkisë Durrës, z. D.M dhe çeshtja është në hetim. Pas njoftimit të Policisë së Rendit dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, IVMT-ja ka realizuar ekzekutimin e urdhërave për lirimin e rrugës. Pavarësisht për sa trajtuar më sipër, në kushtet kur, për konfliktin mbi pronësinë, palët kanë angazhuar gjykatën për zgjidhjen e problematikës, për analogji procedurjale, referuar nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, ndër të tjera, përcaktohet se: "*Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata*", zgjidhja e problematikës në fjalë do të jetë e mundur pas vendimit të gjykatës që ka në proces shqyrtimin e kësaj çështjeje.

***(Gjerësisht problemet mbi shkeljet janë trajtuar në aktverifikimin Nr. 3, datë 18.07.2025, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Durrës).***

Lidhur trajtimin e ankesës së z. V.K, me shkresën e administruar në KLSH me Nr.1347/48 Prot., datë 09.02.2026 dhe me shkresën Nr.668/66, datë 06.02.2026, është observuar nga Znj.P.G, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** Në lidhje me trajtimin e ankesës, përfaqësuesja e Bashkisë Durrës shprehet se: "*Pasi u njoha me Akt Konstatimin, z. V.K, denoncon Kryetaren e Bashkisë dhe Kryeinspektorin e IVMT-së Durrës për cënimin/ përvetësimin e një sipërfaqe prone në fshatin Rromanat të Durrësit, për të cilën prentendon që është pronar z.M.K (babai i ankuesit). Ankuesi shprehet se, në siperfaqen e pretenduar të pronësise po zhvillohet investimi për një rrugë të re, rrugë e cila ka qenë eksistuese që në vitet 90, por pa pasur një Plan të miratuar Zhvillimor. Gjithashtu edhe shkolla "Shefget Ndroqi" është ndërtuar në një pjesë të pronesisë te z. K., pronë për të cilën, ky i fundit shprehet se ende nuk është demshpërblyer nga Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit te Pronave. Sipas z.K., ndonëse keto investime "thuhet" se janë zhvilluar në kuadër të interesit publik, pas tyre janë interesa private. Për këte cështje ishte bëre kallzim pranë Struktures së Posaçme Kunder Korrupsionit dhe Krimit te Organizuar (SPAK). Grupi i auditimit, i cili ka marre në shqyrtim ankesën, ka kerkuar informacion në Bashkinë Durrês lidhur me pasurinë e sipërpërmendur dhe verifikim në terren nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit tëë Bashkisë Durrës. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, rezulton se, ne Bashkinë Durrës është paraqitur një ankesë nga banorët e fshatit Romanat, të Njesisë Administrative Rrashbull, me nr. 1325 prot., date 05.06.2024. Në këtë ankesë, banorët ngrenë shqetësimin për bllokimin e rrugës dhe zënien e hapësirës publike me punime të kryera në mënyrë të paligishme nga z. V.K dhe z.K.K. Bashkia Durres i është drejtuar ASHK-së Durrës me anë të një shkrese për kërkuar statusin juridik të truallit/ pronës. Në kthimin e përgjigjes së ASHK-së dhe në bazë të kopjes së kartelës dhe hartës treguese, ka rezultuar se kjo pasuri është në pronë*

*shtet. Ju bëj me dije që nga ana e Sektorit të Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve ku unë kam qenë pergjegjëse në atë periudhë kur është paraqitur kërkesa është bërë e gjithe procedura e zakonshme në lidhje me identifikimin e gjendjes juridik të pronave që banorët kërkonin informacion. Meqenëse banorët nuk kishin lënë një adresë në kerkesë dhe as numër kontakti, pE.igja e ardhur nga ASHK i është përcjellë Njësisë Administrative Rrashbull (njesia ku banojnë banorët qe kanë bërë kërkesën).*

***Edhe pse nga ana juaj nuk është lënë asnjë vërejtje për këtë procedurë po ju ve dhe një herë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e administruar për rastin.***

*-Kërkeësën e banorëve nr.4443 Prot datë 05.04.2024*

*-Shkresën e Sektorit të Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve nr.4443/1 prot., datë 08.04.2024 drejtuar DVASHK-së ( dokument që ngarkohet ne sistem në momentin e aplikimit)*

*-Aplikimin Elektronik nr.14722 datë 08.04.2024 për statusin juridik te dy pasurive të kërkuara*

*-Urdhër shpenzimin me nr.291 datë 12.04.2024*

*-Kthim përgjigjen e DVASHK-së dt.20.04.2024*

*-Shkresën përcjellëse nr.4443/4 dërguar Njësisë Administrative Rrashbull bazuar në kerkesën e banorëve të fshatit Romanat.".*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Observacioni i paraqitur nga subjekti nuk ka të bëjë me kundërshtime mbi trajtimin e ankesës nga grupi i auditimit, por pasqyron edhe njëherë të gjithë informacionin në mënyrë të përmbledhur dhe vë në dispozicion të gjithë dokumentacionin që disponon bashkëngjitur observacionit. Por në kushtet kur, për konfliktin mbi pronësinë, palët kanë angazhuar gjykatën për zgjidhjen e problematikës, për analogji procedurjale, referuar nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, ndër të tjera, përcaktohet se: "*Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata*", zgjidhja e problematikës në fjalë do të jetë e mundur pas vendimit të gjykatës që ka në proces shqyrtimin e kësaj çështjeje.

## IV. REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e të ardhurave në Bashkinë Durrës, u konstatua se për kategorinë ***"Të ardhurat e trashëguara"*** nuk mbahet një evidencë analitike sipas llojeve dhe burimeve të krijimit të tyre, por në regjistrat kontabël pasqyrohet vetëm vlera e përgjithshme. Mungesa e kësaj evidence nuk mundëson identifikimin e origjinës së këtyre të ardhurave dhe, për rrjedhojë, kufizon mundësinë e auditimit të ligjshmërisë dhe mënyrës së përdorimit të tyre.

Për vitin 2023-2024, nuk ka evidenca të sakta për llojin e të ardhurave (të trashëguara), të cilat do të shërbejnë si bazë për destinimin e tyre në shpenzime (procesin e buxhetimit). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"*Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligjin Nr. 68/2017, datë 18.05.2017, "Për fI.ncat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 3 pikat 2, 3, 10, 11, neni 5 germa "e", neni 12 pika 4, neni 13 pikat 1, 8, nenet 14-20, nenet 33-36; Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 11, neni 63 pika ç, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 22/5, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 16-45 të Raportit të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Durrës**,** nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe strukturave përgjegjëse, të marrë masa për krijimin dhe administrimin e një evidence analitike për kategorinë *"Të ardhurat e trashëguara",* duke evidentuar për secilën të ardhur burimin e krijimit, vlerën, periudhën e krijimit dhe çdo informacion tjetër mbështetës, me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë, transparencës dhe audituesmërisë së tyre.

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i organizimit dhe funksionimit të sistemit të administrimit dhe mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV), u konstatua se administrimi i sistemit të menaxhimit të të dhënave nuk mbështetet në një kuadër të plotë të kontrollit të brendshëm, në përputhje me komponentët e Sistemit të Menaxhimit FI.nciar dhe Kontrollit. Institucioni nuk disponon një rregullore të veçantë për administrimin dhe funksionimin e sistemit, nuk ka procedura të dokumentuara për administrimin e përdoruesve, monitorimin e të dhënave, kontrollin e ndryshimeve në sistem apo përshkrime të proceseve të punës për personelin që e përdor atë.
Për rrjedhojë, përdoruesit operojnë vetëm mbi bazën e detyrave funksionale të përcaktuara në strukturën organizative dhe rregulloren e përgjithshme të institucionit, pa procedura specifike që garantojnë integritetin, gjurmueshmërinë dhe kontrollin e informacionit të përpunuar në sistem.
Në mungesë të këtyre procedurave, drejtoritë përgjegjëse nuk kryejnë monitorim të dokumentuar mbi procesin e popullimit të bazës së të dhënave, përpunimin e informacionit dhe besueshmërinë e raporteve të gjeneruara nga sistemi. Nga auditimi nuk u administruan evidenca që të provojnë kontrolle periodike mbi saktësinë e të dhënave apo rakordimin e tyre me evidencat zyrtare të administruara nga DTTV.
Si pasojë e mungesës së këtyre kontrolleve, u evidentuan mospërputhje ndërmjet informacionit të gjeneruar nga sistemi elektronik dhe evidencave zyrtare të përdorura nga DTTV për planifikimin, monitorimin dhe raportimin e të ardhurave.
Gjithashtu, u konstatua se administrimi i përdoruesve të sistemit nuk është i rregulluar me procedura të dokumentuara. Nuk ka evidenca mbi mënyrën e krijimit, ndryshimit apo çaktivizimit të llogarive të përdoruesve në bashkëpunim me strukturën e burimeve njerëzore, si dhe nuk dokumentohen veprimet që ndërmerren për përdoruesit që largohen nga detyra ose ndryshojnë pozicion pune. Referuar intervistave dhe dokumentacionit të administruar gjatë auditimit, administratori i sistemit është kompania private që ka zhvilluar dhe mirëmban aplikacionin, e cila, sipas kontratës, disponon akses të plotë në sistem. Në mungesë të kontrolleve kompensuese dhe procedurave të dokumentuara të administrimit të aksesit, kjo situatë rrit riskun e aksesit të pakontrolluar, ndryshimit të paautorizuar të të dhënave dhe cenimit të integritetit, konfidencialitetit dhe gjurmueshmërisë së informacionit.
Mospërputhjet e konstatuara dhe mungesa e monitorimit sistematik të funksionimit të sistemit ndikojnë drejtpërdrejt në besueshmërinë e informacionit fI.nciar dhe administrativ të përdorur nga Bashkia, duke krijuar risk që planifikimi i të ardhurave, ndjekja e debitorëve, analizat e performancës dhe vendimmarrja menaxheriale të mbështeten në të dhëna jo të plota ose jo të sakta. Gjithashtu, kjo situatë kufizon mundësinë e institucionit për të ushtruar kontroll efektiv mbi administrimin e të ardhurave vendore dhe cenon parimet e kontrollit të brendshëm dhe të menaxhimit fI.nciar.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"*Për Menaxhimin FI.nciar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni 5, neni 11; Udhëzimi e MFE nr. 8, datë 9.3.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave fI.nciare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika ç ; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, "Për miratimin e rregullores për Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore", i ndryshuar, Manuali për MFK i miratuar me urdhër të Ministrit të FI.ncave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III. Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Durrës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 16-45 të Raportit të Auditimit).*
**2.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë në bashkëveprim me Drejtorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e procedurave për administrimin dhe monitorimin e sistemit të menaxhimit të të dhënave, të sigurojë rakordimin periodik të të dhënave ndërmjet sistemit dhe evidencave zyrtare, të identifikojë dhe eliminojë shkaqet e

mospërputhjeve, duke përcaktuar burimin zyrtar të të dhënave për planifikimin dhe raportimin e të ardhurave, si dhe të forcojë kontrollet mbi administrimin e përdoruesve dhe aksesin në sistem.

***Brenda 6 muajve***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i sistemit të DTTV, Bashkia Durrës u konstatua se:
- Nuk realizohet në kohë njoftimi i subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore pasi përllogaritja dhe azhornimi i detyrimeve vjetore në sistem bëhet manualisht.

Gjatë vitit 2023 është kryer kalimi i të dhënave nga sistemi O.E-B.S11 në sistemin O.E-B.S.R12. Referuar specifikimeve teknike në pikën 13.2 "*Migrimi i të dhënave"* është përcaktuar së operatori ekonomik do të duhet të realizojë migrimin e balancave e të gjithë të dhënave historike të sistemit informatik. Sipas evidencave të vëna në dispozicion nga DTTV, numri total i subjekteve që zhvillojnë aktivitet për vitin 2023 është 13,535 subjekte. Referuar të dhënave për vitin 2023 për taksën e ndërtesës nga 13,535 subjekte të regjistruara, vetëm për 3213 subjekte u është përllogaritur dhe regjistruar ne sistem detyrimi. Po kështu dhe për tarifat e tjera me poshtë. Pa ngarkesë për taksë e ndërtesës janë 10,322 subjekte*".*

-Për tarifën e pastrimit referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nuk janë ngarkuar për këtë tarifë 2,213 subjekte në Bashkinë Durrës.

-Për tarifën e ndriçimit referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nuk janë ngarkuar për këtë tarifë 9,679 subjekte në Bashkinë Durrës.

-Për tarifën e Gj.t referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nuk janë ngarkuar për këtë tarifë 9,753 subjekte në Bashkinë Durrës.

Sipas evidencave të vëna në dispozicion nga DTTV numri total i subjekteve që zhvillojnë aktivitet për vitin 2024 është 13,748 subjekte.

Referuar të dhënave të mësipërme për vitin 2024 për taksën e ndërtesës nga 13,748 subjekte të regjistruara vetëm për 9,385 subjekte është kryer ngarkesa për këtë taksë. Pa ngarkesë për taksë e ndërtesës janë 4,363 subjekte

-Për tarifën e pastrimit referuar të dhënave në tabelën e mësipërme nuk janë ngarkuar për këtë tarifë 2,213 subjekte në Bashkinë Durrës.

-Për tarifën e ndriçimit referuar të dhënave në tabelën e mësipërme nuk janë ngarkuar për këtë tarifë 2,278 subjekte në Bashkinë Durrës.

-Për tarifën e Gj.t referuar të dhënave në tabelën e mësipërme nuk janë ngarkuar për këtë tarifë 2,351 subjekte në Bashkinë Durrës.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 23, 27, 28, 30, 32, 36, 38, neni 64 pika 3; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, në nenin 7, Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligjin nr. 13/2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportele", Ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", VKB nr.194, datë 22.12.2023 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2024".

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 16-45 të Raportit të Auditimit).*

**<u>3.1. Rekomandimi</u>:** Kryetari i Bashkisë në bashkëveprim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtorinë e Informatikës dhe Dixhitalizimit, të marrin masa për të krijuar arkitekturën e sistemit lidhur me përditësimin e detyrimeve vjetore në mënyrë që njoftimi i subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore të bëhet në kohë, me qëllim ndjekjen e të gjitha etapave administrative dhe procedurale.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i përputhshmërisë të "*Sistemit të Menaxhimit të të Dhënave për të Ardhurat*" në Bashkinë Durrës u konstatua se Bashkia Durrës ka krijuar dhe administron " Bazë të dhënash shtetërore" e cila nuk është krijuar dhe nuk e kryen funksionin bazuar në kuadrin rregullator në fuqi. Ky institucion nuk ka paraqitur kërkesë për regjistrimin në

"Regjistrin Kombëtar të Bazave të të Dhënave Shtetërore" pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në vijim (AKSHI), i cili është autoriteti rregullator koordinues, përgjegjës i bazave të të dhënave shtetërore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore" nenin 3, Ligjin nr. 2/2017, datë 26.01.2017, "Për sigurinë kibernetike" neni 4; Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar" nenet 2, 3,.5, 6....20...27,28.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 16-45 të Raportit të Auditimit).*
**4.1 Rekomandimi:** Bashkia Durrës të marrë masa për regjistrimin në "Regjistrin Kombëtar të Bazave të të Dhënave Shtetërore" pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit duke siguruar përputhshmëri të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet e sigurisë së informacionit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për të gjithë periudhën e audituar taksa mbi tokën bujqësore nuk është administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në kundërshtim me përcaktimet e bërë në paketën fiskale.
Për këtë taksë nuk ka regjistër të taksapaguesve. Për kategorinë "familjar" edhe pse është parashikuar në paketë fiskale që të arkëtohet nga UKD, kjo nuk është realizuar as nga UKD dhe as nga vetë bashkia, pasi vetë struktura e taksave të bashkisë për mungesë të dhënash si të familjarëve edhe të sipërfaqes për secilën familje, nuk ka bërë llogaritje të detyrimeve për këtë taksë dhe si rrjedhim, nuk është pasqyruar detyrimi ne faturën e ujit.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë. 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar ,neni 4 , neni 23; Paketa fiskale e miratuar nga Këshilli Bashkiak Durrës; VKB nr. 160, datë 23.12.2021, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit", pika A.1.1.2 "Taksa e tokës bujqësore". kontrata nr. 641 prot., datë 03.02.2014.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 16-45 të Raportit të Auditimit).*
**5.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për hartimin e regjistrit të taksapaguesve privat dhe familjar për taksën e tokës bujqësore, duke evidentuar qytetarët të cilët kanë marrë tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saj në hektar për secilin dhe mbi bazën e këtij regjistri të llogariten dhe të arkëtohen detyrimet për taksën e tokës bujqësore.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i DTTV Durrës u konstatua se në këtë subjekt nuk ka një strategji afatshkurtër apo afatmesme, për të evidentuar familjet e paregjistruara te agjenti tatimor UKD, në mënyrë që të ndiqet arkëtimi i tyre jashtë agjentit tatimor, pra nga vetë administrata e taksave dhe tarifave vendore Durrës. DTTV nuk ka hartuar regjistër të taksapaguesve familjarë, duke mos evidentuar taksapaguesit familjarë, të cilët nuk kanë marrëdhënie me agjentin tatimorë. Edhe pse numri i taksapaguesve familjar në vitin 2023-2024 në krahasim me periudhat paraardhëse është rritur, nuk ka evidentime konkrete për pjesën që nuk përfshihet në UK Durrës. Për vitin 2023 rezultoi se DTTV ka ngarkuar me taksa dhe tarifa vendore vetëm 60,783 abonentë nga 70,783 të regjistruar në UKD, duke përjashtuar nga detyrimet 10,000 abonentë.
Për vitin 2024, numri i abonentëve familjarë të identifikuar me kontratë me UKD është 83,355 abonentë përfshirë qytetin e Durrësit dhe Njësitë Administrative. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon informacion të azhornuar nga gjendja civile për numrin e familjeve të regjistruara në këtë Bashki.
Rakordimet për të ardhurat nga taksat e familjarëve bëhen për të rakorduar shumën totale që UKD ka për detyrë të transferojë te Bashkia, por nuk ka rakordime mbi bazën e detyrimeve që duhet të paguajnë familjarët për llogari të muajit të caktuar të vitit buxhetor, pra sa ishte detyrimi i muajit sipas paketës fiskale, sa është paguar dhe sa ngelen debitor, në numër abonentësh dhe në vlerë. Nuk njihet situata e debitorëve familjar pasi për të gjithë periudhën e audituar nuk janë hartuar evidenca për këtë qëllim dhe nuk i është kërkuar UKD të jap raporte të tilla, në cilësinë e agjentit tatimor.

Sa më sipër nuk është zbatuar kontrata nr. 641 prot. datë 03.02.2014, neni 5 pika 4,5,6 dhe neni 7 pika 1, pika c.
Nga Bashkia Durrës nuk janë zbatuar penalitete bazuar në nenin 7, pika 2 të marrëveshjes, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin fI.nciar dhe kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 4, pika 7; Kontrata nr. 641 prot. datë 03.02.2014, neni 5 pika 4,5,6, neni 7 pika 1 dhe 2; Rregullore brendshme e institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 16-45 të Raportit të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për:
Hartimin dhe zbatimin e një programi pune për evidentimin e plotë të të gjithë taksapaguesve familjarë, duke identifikuar edhe familjet e paregjistruara nga agjenti tatimor UKD, si dhe të kryejë rakordime periodike me këtë agjent, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në kontratë. Kërkimin periodik nga UKD të raporteve të detajuara mbi detyrimet mujore, pagesat dhe debitorët familjarë, duke siguruar kryerjen e rakordimeve të plota jo vetëm për shumën totale të të ardhurave të transferuara, por edhe për saktësinë e detyrimeve të llogaritura sipas paketës fiskale në fuqi.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i masave të marra nga sektori i borxhit për periudhën 2023-2024 janë marrë masat e njoftimit të pagesës gjatë vitit 2023 për 11,087 abonentë privatë dhe për vitin 2024 për 12,036 abonentë privatë. Janë nxjerre urdhra bllokimi të llogarive për pë 2,852 abonentë privatë për vitin 2023 dhe për 12,943 abonentë privatë vitin 2024. Nuk disponohet informacion në numër dhe vlerë për arkëtimet gjatë kësaj periudhë për ekzekutimin e fondeve nga llogaritë bankarë të bllokuara nga sektori i të ardhurave dhe nga sektori i borxhit. Nuk është vendosur barra e sigurisë për asetet në pronësi të debitorëve.
Gjatë vitit 2023 janë lidhur 50 aktmarrëveshje, nga të cilat në 5 raste është konstatuar mosrespektimi e kërkesave të nenit 109 të Ligjit nr. 9920/2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", si dhe i dispozitave të neneve 90–102 të këtij ligji dhe të Kreut III të Udhëzimit nr. 17, datë 20.06.2022, "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore", që rregullojnë procedurën e mbledhjes me masa shtrënguese të detyrimeve tatimore. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 16-45 Raportit të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për:
- Evidentimin, regjistrimin dhe raportimin periodik në numër dhe në vlerë të arkëtimeve të realizuara nga ekzekutimi i fondeve në llogaritë bankare të bllokuara, si dhe të krijohet një regjistër i posaçëm për ndjekjen e rezultateve të çdo mase shtrënguese të aplikuar.
- Arkëtimin e detyrimeve nga debitorët duke dokumentuar dhe administruar në mënyrë të plotë çdo veprim në dosjen individuale të debitorit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje me pakicë të karburantit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, konstatohet se përgjatë periudhës 2023-2024 në territorin e Bashkisë Durrës dhe njësive administrative është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 130 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Në fund të vitit 2024, gjithsej rezultojnë 4 subjekte të pajisura me autorizim me afat 5 vjeçar, të cilët e kanë paguar të plotë vlerën e autorizimit sipas rastit. Ndërkohë që 126 subjektet e tjera operojnë të pa pajisur me autorizimin përkatës dhe nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe

nënprodukteve të tyre", VKM nr. 170, datë 25.04.2002, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre" i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, germa b), dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, germa "b" dhe pika 9 dhe 15. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 16-45 Raportit të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Bashkia Durrës dhe Drejtoria e Shërbimeve në bashkëveprim me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrin masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/licencë.

***Menjëherë***

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e 27 procedurave të prokurimit të audituara, me fond limit mbi kufirin e blerjes me vlerë të vogël, rezultoi se në 5 procedura prokurimi, kryesisht me objekt investime publike, në momentin e lidhjes së kontratës nuk ishte administruar dokumentacioni përkatës që provonte pajisjen me *leje ndërtimi/infrastrukture*, përfshirë, sipas rastit, dokumentacionin e *oponencës teknike*, konkretisht: procedura me objekt **"***Rikonstruksion rruge në NJA Katund i Ri***"**, viti 2023, me fond limit 16,666,285 lekë; Procedura me objekt *"Rikonstruksion rruge në NJA Ishëm"*, viti 2023, me fond limit 16,666,597 lekë; Procedura me objekt *"Rikonstruksion i Qendrës së Fëmijëve"*, viti 2023, me fond limit 41,567,027 lekë; Procedura me objekt *"Rikonstruksion i rrugëve në qytet"*, viti 2023, me fond limit 32,463,952 lekë dhe vlerë kontrate ***31,486,400 lekë***, për të cilën nuk rezultoi e administruar leja e ndërtimit/infrastrukturës dhe dokumentacioni i oponencës teknike; Procedura me objekt *"Riaftësim Strukturor i Pallatit 'Big Kristi', Durrës, Rruga 'Neki Libohova', Durrës nr. 62, Kod GIS 5058"*, viti 2024, me fond limit 156,383,025 lekë, për të cilën nuk rezultoi e administruar leja e ndërtimit/infrastrukturës dhe dokumentacioni i oponencës teknike.

Mungesa e lejeve përkatëse në momentin e lidhjes së kontratës krijon risk që procedurat e prokurimit dhe zbatimi i kontratave të investimeve publike të vijojnë pa u përmbushur paraprakisht kërkesat ligjore dhe teknike për realizimin e objektit. Kjo cenon parimin e ligjshmërisë dhe krijon risk për fillimin ose vijimin e punimeve pa dokumentacionin e plotë autorizues, si dhe për ekspozimin e Autoritetit Kontraktor ndaj përgjegjësive administrative e ligjore.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 39, pika 3, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, *sipas të cilit punimet e ndërtimit dhe ndërhyrjet infrastrukturore duhet të kryhen në përputhje me kërkesat ligjore për pajisjen me lejet/autorizimet përkatëse. (Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 45-142, Raportit të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të AK**,** në vijimësi, të marrë masa për të siguruar që për procedurat e prokurimit që kanë për objekt realizimin e punimeve të ndërtimit dhe ndërhyrjeve infrastrukturore, përpara lidhjes së kontratës dhe, në çdo rast, përpara fillimit të zbatimit të punimeve, të jetë administruar dhe verifikuar dokumentacioni i plotë ligjor dhe teknik, përfshirë lejen e ndërtimit/infrastrukturës dhe, kur kërkohet nga kuadri ligjor e teknik në fuqi, dokumentacionin e oponencës teknike. Për këtë qëllim, strukturat përgjegjëse të Bashkisë të kryejnë verifikimet përkatëse dhe të dokumentojnë përmbushjen e këtyre kërkesave në dosjen e procedurës dhe të kontratës.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**10. Gjetje nga auditimi:** Në 2 (dy) nga 27 (njëzeteshtatë) procedurat e prokurimit të audituara në Bashkinë Durrës (aparati), me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël" ("*Rikonstruksion Shkolla Besnik Hidri*" me fond limit 46,629,688 lekë, viti 2023 dhe "*Rikonstruksion i rrugëve në qytet*" me fond limit 41,567,027 lekë, viti 2023), është konstatuar

se nga punonjësit e Drejtorisë së Planifikim, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Durrës, janë hartuar projekt-preventiva për investime publike nga grupe pune ku jo të gjithë anëtarët kanë qenë të pajisur me licencat përkatëse. Kjo situatë ka ndodhur pasi Bashkia Durrës, me qëllim shmangien e shpenzimeve, ka angazhuar punonjësit e saj për hartimin e projekt-preventivave, duke mos kryer një procedurë prokurimi të mirëfilltë për përfitimin e objektit. Hartimi i projekteve të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 5, të VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 45-142, Raportit të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Durrës, në lidhje me investimet që do të kryhen në të ardhmen, për të cilat është i nevojshëm hartimi paraprak i një projekt-preventivi, të marrë masa që ky i fundit të hartohet nga specialistë të pajisur me licencë profesionale për kategorinë përkatëse, në mënyrë që të kemi projekte sa më cilësore dhe që paraqesin gjendjen reale të objektit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**11. Gjetje nga auditimi:** Në 7 (shtatë) nga 27 (njëzeteshtatë) procedurat e prokurimit të audituara në Bashkinë Durrës, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", të specifikuara në aneksin nr. 2.4.1 "për prokurimet" pjesë e raportit të auditimit, është konstatuar se, disa prej kritereve për kualifikim rezultojnë të paqartë apo të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht. Në lidhje me këto kritere, njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos marrë parasysh natyrën dhe vlerën e kontratës. Mungesa e një argumentimi teknik, i cili do të justifikonte dhe ligjëronte vendosjen e secilit kriter të kërkuar, vjen si rezultat i moszbatimit të plotë të kuadrit ligjor, në fazën e hartimit dhe argumentimit të kritereve nga personat përgjegjës, ku mund të përmendim: *vendosja në stafin mbështetës të një eksperti zjarrfikës dhe një auditues energjetik i certifikuar për ndërtesat; të 2 (dy) punonjës të kualifikuar përpunues druri, të një ing. Arkitekt ; "Auditues energjie", i cili duhet të jetë i pajisur me "Certifikatë për Auditim Energjie në ndërtesa"; punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë "Ekspert zjarrfikës" ; inxhinier të pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.; inxhinier Ndërtimi Profili Strukturist, inxhinier Elektrik, Licence nga QKB Kodi III.2. B "Transportim i ujerave të ndotura urbane, llumrave septike dhe ujerave të zeza", etj.,* në kundërshtim me nenin 36 dhe 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenet 2, 40, 39 dhe 78 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 45-142 Raportit të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi**: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Durrës (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave, specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, duhet të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur, duke përdorur vetëm ato kritere të cilat janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe duke i dokumentuar ato në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre**.**

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**12. Gjetje nga auditimi**: Në 11 (njëmbëdhjetë) nga 27 (njëzeteshtatë) procedurat e prokurimit të audituara në Bashkinë Durrës, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", të specifikuara në aneksin nr. 2.4.1 "për prokurimet" pjesë e raportit të auditimit, është konstatuar se anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), nuk kanë vlerësuar drejt shoqëritë e shpallura fituese, duke kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë në kushtet kur këta

të fundit, nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", neni 92, pika 3 dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 82, pika 2. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 45-142, Raportit të Auditimit).*

**12.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Durrës, të marrë masa që Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të kryejnë vlerësimin e ofertave në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi, duke mos kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë që nuk përmbushin të gjitha kriteret e kualifikimit, si dhe të forcojë kontrollet e brendshme dhe përgjegjshmërinë e anëtarëve të KVO-ve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 6 (gjashtë) procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, u konstatuan parregullsi në 3 (tre) procedura, me një vlerë totale të fondit limit prej 1,234,667 lekësh, pa TVSH, si më poshtë:

- Në 2 (dy) procedura prokurimi, me objekt "Riparime printera, fotokopje" dhe "Blerje materiale për MZSH (radio dore + bateri)", përcaktimi i fondit limit nuk është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Nga dokumentacioni i administruar nuk evidentohet marrja dhe dokumentimi i ofertave nga operatorët ekonomikë/subjektet private, si një nga burimet e informacionit për përcaktimin e fondit limit.
- Në 1 (një) procedurë prokurimi me objekt "Krijimi dhe Dizenjimi i Aplikacionit 'Visit Durrës'", procesverbali i marrjes në dorëzim nuk është pajisur me numër protokolli. Gjithashtu, grupi i ngarkuar me marrjen në dorëzim të shërbimit ka qenë i njëjtë me grupin që ka marrë pjesë në hartimin e specifikimeve teknike dhe në përllogaritjen e fondit limit. Për më tepër, në përbërjen e grupit të marrjes në dorëzim nuk rezultojnë të jenë përfshirë specialistë me ekspertizën e nevojshme në fushën objekt të shërbimit, në kundërshtim me kërkesat e pikës 43 të Udhëzimit të Ministrisë së FI.ncave nr. 30, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Këto mangësi lidhen me mosrespektimin e plotë të kërkesave procedurale për dokumentimin dhe përcaktimin e fondit limit, si dhe me mungesën e ndarjes së përshtatshme të funksioneve ndërmjet strukturave/personave të përfshirë në specifikimin, prokurimin dhe marrjen në dorëzim të objektit të kontratës. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 42-142, Raportit të Auditimit).*

**13.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Durrës dhe strukturat përgjegjëse, të marrin për:

- Përcaktimin e fondit limit, duke siguruar marrjen, administrimin dhe dokumentimin e burimeve të informacionit të përdorura për përcaktimin e vlerës së fondit limit, përfshirë ofertat dhe të dhënat e marra nga operatorët ekonomikë, kur përdoren si burim informacioni.
- Procedurat e marrjes në dorëzim, të sigurojnë që procesverbalet dhe dokumentacioni përkatës të jenë të protokolluara dhe të administruara në përputhje me rregullat e dokumentacionit zyrtar.
-Në përbërjen e komisioneve/grupeve të marrjes në dorëzim të përfshihen persona me njohuritë dhe kompetencat profesionale të përshtatshme për natyrën e objektit të kontratës, veçanërisht për shërbime me karakter teknik ose teknologjik.
- Të sigurohet ndarja e përshtatshme e detyrave dhe përgjegjësive ndërmjet strukturave/personave që hartojnë specifikimet teknike dhe përllogarisin fondin limit, nga ata që kryejnë verifikimin dhe marrjen në dorëzim të objektit të kontratës, me qëllim forcimin e kontrollit të brendshëm dhe shmangien e konfliktit të roleve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit, sa i përket funksionimit të Strukturës së IMTV-së në Bashkinë Durrës, u konstatua se nga niveli drejtues i Bashkisë Durrës, nuk janë marrë masa për plotësimin e kësaj strukture dhe ushtrimin e funksionit të inspektimit në përputhje me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës. IMTV nuk ka punonjës me formimin

profesional, si: Inxhinier ndërtimi, arkitekturë, urbanistikë, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë dhe hidrogjeologjisë, në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 9780, datë 16/07/2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme".
*(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6, faqe 203-235, Raportit të Auditimit).*
**14.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për rekrutimin dhe plotësimin e strukturës së IMTV-së me punonjës me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 23 procedurave të administruara nga IMTV, Bashkia Durrës, rezultoi se, ndonëse këto raste përmbajnë elementë që, sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal, mund të përbëjnë vepër penale, IMTV nuk ka referuar pranë organeve ligjzbatuese indiciet përkatëse për ndjekje të mëtejshme, në përputhje me detyrimet ligjore.
Gjithashtu, nga shqyrtimi i praktikave të ngjashme rezultoi se për raste me karakteristika të njëjta ose të ngjashme janë ndjekur praktika të ndryshme administrative, pasi në disa raste indiciet për vepër penale janë referuar pranë organeve ligjzbatuese, ndërsa në 23 rastet e audituara një veprim i tillë nuk është kryer. Kjo tregon mungesë të një praktike të unifikuar dhe të një procesi të dokumentuar për vlerësimin dhe referimin e rasteve që përmbajnë indicie për vepër penale.
Kjo praktikë krijon risk për mosreferimin e rasteve me indicie për vepër penale, trajtimin e pabarabartë të rasteve të ngjashme dhe mosndjekjen e mëtejshme të përgjegjësive ligjore**.**
Mosreferimi i rasteve me indicie për vepër penale mund të sjellë mosndjekjen e përgjegjësive penale sipas ligjit dhe krijon risk për trajtim të ndryshëm të rasteve të ngjashme, cenim të parimit të barazisë në zbatimin e ligjit dhe dobësim të efektivitetit të kontrollit mbi ndërtimet e kundërligjshme.
Veprime në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", pika a); nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika e). pika 6. nenit 199/a të Kodit Penal.
*(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6, faqe 203-235, Raportit të Auditimit).*
**15.1. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMTV-së, Bashkia Durrës, të marrë masa për:

- Rishikimin e 23 praktikave të identifikuara dhe, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, të vlerësojë dhe të referojë pranë organeve kompetente rastet që përmbajnë indicie për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, duke dokumentuar veprimet e ndërmarra.
- Hartimin dhe miratimin e një procedure të unifikuar të brendshme, e cila të përcaktojë qartë: kriteret për identifikimin e rasteve që mund të përmbajnë indicie për vepër penale; përgjegjësitë e strukturave dhe personave që bëjnë vlerësimin; mënyrën dhe afatet për referimin pranë organeve ligjzbatuese;

dokumentimin e vendimmarrjes dhe të veprimeve të kryera.
- Forcimin e mbikëqyrjes nga Kryeinspektori, me qëllim garantimin e zbatimit të njëjtë të procedurave për raste të njëjta ose të ngjashme dhe shmangien e praktikave të ndryshme në trajtimin e rasteve me të njëjtat karakteristika.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit/zhvillimit u konstatuan 9 praktika për periudhën objekt auditimi (2023-2024), në të cilat pasqyrohet situata në lidhje me mosrespektimin e të gjitha kondicioneve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe në lejen e zhvillimit, të tilla si: mosparaqitjen e saktë të planvendosjes së miratuar, mos pasqyrimi i të dhënave të sakta të treguesve të zhvillimit, mosrespektimi i të gjitha distancave të përcaktuara, lartësia e ndërtimit, intensiteti, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi. Përkatësisht në 3 praktika, në lejet e ndërtimit të miratuara në bazë të dokumentit të rregullores së veçantë nga KKT-ja, me objekt: **1.**"*Godinë banimi dhe shërbimi 10 kat mbi tokë me 2 kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 1071/1, datë 31/08/2023,

me zhvillues shoqëria "X" sh.p.k, në adresën rruga shëtitorja “Taulantia”, Durrës; **2.**“*GodI. banimi 1-2 kate dhe shërbimi me mur rrethues*”, miratuar me vendimin Nr.1444-22, datë 12/09/2023, me zhvillues shoqëria "D" sh.p.k, në adresën C.la, Bashkia Durrës; **3.**“Strukturë hotelerie 8 kate dhe 1 kat nëntokë”, miratuar me vendimin Nr. 1623-23/4, datë 22/01/2024, me zhvillues shoqëria "D" sh.p.k, në adresën rruga “Pavarësia”, plazh, lagjja 13, Bashkia Durrës. Përkatësisht në 6 praktika, në lejet e zhvillimit/ ndërtimit të miratuara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës, me objekt: **1.**“*Godinë banimi dhe shërbimi 1, 5 dhe 6 kate me 1 kat parkimi nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr. 930-22/5, datë 03/02/2023, me zhvillues shoqëria "Ç" sh.p.k, në adresën rruga “H.M”, lagjja 17, Durrës; **2.**“*Godinë banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë*”, miratuar me vendimi Nr. 1036/6, datë 22/06/2023, me zhvillues shoqëria “"A" ” sh.p.k, në adresën rruga “Doktor Remzi Fico”, Durrës; **3.** “*Objekte industriale 1 dhe 2 kat, vend-roje, kabinë elektrike dhe mur rrethues*”, miratuar me vendimin Nr.1497-22/5, datë 06/02/2023, me zhvillues shoqëria "I" sh.p.k, në adresën fshati Bisht Kamëz, Njësia Administrative Katund i Ri, Bashkia Durrës; **4.**“*2 kapanone industriale 1 kat dhe 2 kat+ mur rrethues + kabinë elektrike dhe vendroje*”, miratuar me vendimin Nr. 55/1-23, datë 15/03/2023, me zhvillues B.D, në Spitallë, Bashkia Durrës; **5.**“ *Godinë banimi dhe shërbimi 3, 5 dhe 7 kat me 1 kat parkim nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr. 783/5, datë 11.11.2024, me zhvillues shoqëria "K" sh.p.k, në adresën rruga “Aleksandër Goga”, lagjja 18, rajoni 4, Bashkia Durrës; **6.**“*Godinë banimi 4 kat me 1 kat nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr. 1282-23/5, datë 28/03/2024, me zhvillues I.S dhe M.S, në adresën rruga “S.D”, lagjja 8, njësia administrative nr. 4, Bashkia Durrës. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr.107/2014, datë 31.07.2014, “*Për* Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 4, datë 27.07.2022; Planin e Përgjithshëm Vendor ekzistues të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendimin Nr. 27, datë 10.05.2013 “Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës”; VKM-së 502, datë 13.07.2011,”Për miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 165-203 të Raportit të Auditimit).*

**16.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës, përpara miratimit të lejeve të ndërtimit/zhvillimit të verifikojë nëse dokumentacioni teknik i ngarkuar në sistemin e-Leje është i plotë, në përputhshmëri dhe i paraqitur saktë. Gjithashtu, të verifikohet nëse aplikimi i kryer është në përputhje me të gjitha kriteret dhe kondicionet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe lejen e zhvillimit, të tilla si: planvendosja e miratuar, treguesit e zhvillimit, intensiteti i ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, lartësia e ndërtimit, respektimi i distancave dhe tipologjisë së ndërtimit, në bazë të njësisë strukturore përkatëse, sipas përcaktimit të tyre, në aktet përkatëse, në kohë dhe hapësirë.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatuan 6 praktika për periudhën objekt auditimi (2023-2024), në të cilat u evidentuan mangësi në lidhje me përcaktimin e të gjitha kushteve në dokumentin e lejes së ndërtimit, specifikisht mungesa e lejes për prishjen e objekteve ekzistuese. Përkatësisht në lejet me objekt: **1.**“ *Godinë banimi dhe shërbimi 10 kat mbi tokë me 2 kat nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr. 1071/1, datë 31/08/2023, me zhvillues shoqëria "X" sh.p.k, në adresën rruga shëtitorja “Taulantia”, Durrës; **2.**“*Godinë banimi dhe shërbimi 1, 5 dhe 6 kate me 1 kat parkimi nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr. 930-22/5, datë 03/02/2023, me zhvillues shoqëria "Ç" sh.p.k, në adresën rruga “H.M”, lagjja 17, Durrës; **3.**“*Godinë banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr. Nr. 1036/6, datë 22/06/2023, me zhvillues shoqëria “"A" ” sh.p.k, në adresën rruga “Doktor Remzi Fico”, Durrës; **4.**“*Hotel me 1 dhe 7 kate, me 1 kat nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr. 1654-22/5, datë 31/01/2023, me zhvillues E.K, në adresën rruga “Val Deti”, lagjja 13, Bashkia Durrës; **5.**“Strukturë hotelerie 8 kate dhe 1 kat nëntokë”, miratuar me vendimin Nr.

1623-23/4, datë 22/01/2024, me zhvillues shoqëria "D" sh.p.k, në adresën rruga "Pavarësia", plazh, lagjja 13, Bashkia Durrës; **6.**" *Godinë banimi 4 kat me 1 kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 1282-23/5, datë 28/03/2024, me zhvillues I.S dhe M.S, në adresën rruga "S.D", lagjja 8, njësia administrative nr. 4, Bashkia Durrës. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar, neni 11, pika ç. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 165-203 të Raportit të Auditimit).*

**17.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Durrës, të marrë masa që në përcaktimin e kushteve të lejes së ndërtimit, të përfshihet edhe leja për prishjen e objekteve, në rastet kur në pasuritë që marrin pjesë në zhvillim ka objekte ekzistuese.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatuan 5 praktika në të cilat në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, kartelat e pasurive që marrin pjesë në zhvillim dhe hartat treguese nuk janë të përditësuara, si dhe mendimi i institucionit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës kufizohet vetëm me dhënien e dakordësisë, por nuk përmban statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, sipas legjislacionin sektorial për kadastrën, përpara miratimit të lejes së ndërtimit. Përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt: **1.**"*Godinë banimi dhe shërbimi 1, 5 dhe 6 kate me 1 kat parkimi nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 930-22/5, datë 03/02/2023, me zhvillues shoqëria "Ç" sh.p.k, në adresën rruga "H.M", lagjja 17, Durrës; **2.**"*Godinë banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 1036/6, datë 22/06/2023, me zhvillues shoqëria ""A" " sh.p.k, në adresën rruga "Doktor Remzi Fico", Durrës; **3.**" *GodI. banimi 1-2 kate dhe shërbimi me mur rrethues*", miratuar me vendimin Nr.1444-22, datë 12/09/2023, me zhvillues shoqëria "D" sh.p.k, në adresën C.la, Bashkia Durrës; **4.**"*2 kapanone industriale 1 kat dhe 2 kat+ mur rrethues + kabinë elektrike dhe vendroje*", miratuar me vendimin Nr. 55/1-23, datë 15/03/2023, me zhvillues B.D, në Spitallë, Bashkia Durrës; **5.**" *Godinë banimi dhe shërbimi 3, 5 dhe 7 kat me 1 kat parkim nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 783/5, datë 11.11.2024, me zhvillues shoqëria "K" sh.p.k, në adresën rruga "Aleksandër Goga", lagjja 18, rajoni 4, Bashkia Durrës. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, nenin 15, pika 1/b dhe nenin 21, pika 6; me Ligjin 111/2018, për "Kadastrën", datë 7.2.2019, neni 17, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 165-203 të Raportit të Auditimit).*

**18.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Durrës të marrë masa që përpara miratimit të lejeve të ndërtimit, të verifikojë paraprakisht të gjithë dokumentacion e nevojshëm që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, të pasqyrojë gjendjen ligjore të përditësuar, si dhe të këtë të realizuar marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat dokumentacioni i paraqitur në sistemin e-leje nuk është i plotë, pasi ndonëse dispozohej nga autoriteti vendor gjatë shqyrtimit të aplikimit për leje ndërtimi, nuk ishte bërë pjesë e dosjes elektronike në sistemin e-leje. Përkatësisht në lejet me objekt: **1.**"*2 kapanone industriale 1 kat dhe 2 kat+ mur rrethues + kabinë elektrike dhe vendroje*", miratuar me vendimin Nr. 55/1-23, datë 15/03/2023, me zhvillues B.D, në Spitallë, Bashkia Durrës; **2.**"*Strukturë hotelerie 8 kate dhe 1 kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 1623-23/4, datë 22/01/2024, me zhvillues shoqëria "D" sh.p.k, në adresën rruga "Pavarësia", plazh, lagjja 13, Bashkia Durrës. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, nenin 4/1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 165-203 të Raportit të Auditimit).*

**19.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Durrës, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, të verifikojë që i gjithë dokumentacioni që ka qenë pjesë e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për leje ndërtimi, të jetë pjesë e dosjes në sistemin elektronik e-leje, duke përfshirë edhe kontratat, marrëveshjet, ose korrespondencat shkresore të realizuara ndërmjet institucioneve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën nuk rezulton të jetë kryer oponenca teknike, për objektin me akses publik dhe për projektin me vlerë të preventivuar më të lartë se 100 milionë lekë. Përkatësisht në lejen me objekt: "*Strukturë hotelerie 8 kate dhe 1 kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 1623-23/4, datë 22/01/2024, me zhvillues shoqëria "D" sh.p.k, në adresën rruga "Pavarësia", plazh, lagjja 13, Bashkia Durrës. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me pikën 1, të nenit 6, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, dhe me nenin 52 të ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 165-203 të Raportit të Auditimit).*

**20.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Durrës, përpara dhënies së dakordësisë për miratimin e lejes së ndërtimit, të sigurohet që projektet e ndërtimit të objekteve me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, si dhe ato me akses publik, t'i jenë nënshtruar një oponence teknike. Gjithashtu, pas nënshtrimit të oponencës teknike, nga Autoriteti Përgjegjës, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, të verifikohet nëse janë reflektuar të gjitha rekomandimet eventuale të oponencës në projektin e paraqitur për zbatim.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë tek e cila nuk janë marrë të gjitha mendimet dhe nuk është dhënë konformiteti nga autoritetet e tjera publike, të cilat duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: "*Godinë industriale 1 kat, vendroje, kabinë elektrike dhe mur rrethues*", miratuar me vendimin Nr. 1562-23/4, datë 15/01/2024, me zhvillues shoqëria "T" sh.p.k, në adresën rruga "Kuvendi Françeskan", Spitall, Bashkia Durrës. Sa më sipër, veprime në kundërshtim VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, neni 21, "*Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor*", pika 6, autoriteti vendor duhet të marrë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 165-203 të Raportit të Auditimit).*

**21.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Durrës, të marrë masa që përpara miratimit të lejeve të zhvillimit dhe lejeve të ndërtimit, të marrë mendimet dhe konformitetet nga të gjithë autoritetet e tjera publike të cilat duhen të shprehen për zhvillimin e propozuar, me qëllim respektimin e procedurave ligjore, rritjen e transparencës dhe shmangien e vendimmarrjes në mungesë të vlerësimeve të domosdoshme ndërinstitucionale.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i praktikave të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 raste në të cilat taksa e ndikimit në infrastrukturë duhej të rivlerësohej nga autoriteti përgjegjës, për shkak të ndryshimit të destI.cionit të strukturave të objektit dhe aplikimit të niveleve të ndryshme të taksës, si dhe për shkak të ndryshimit të projektit gjatë fazës së ndërtimit, me pasojë rishikimin e sipërfaqeve të ndërtimit.

Konkretisht:

Në 1 praktikë, taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk ishte llogaritur në nivelin e duhur për strukturat me destI.cione të ndryshme. Pjesa e objektit e destinuar për njësi shërbimi duhej t'i nënshtrohej taksës në masën 8% të çmimit të shitjes për metër katror, ndërsa pjesa e destinuar për funksion industrial dhe prodhues duhej të taksohej në masën 3% të vlerës së investimit, bazuar në preventivin

e rishikuar për ndërtimin me destI.cion prodhimi. Rasti i referohet lejes së ndërtimit me objekt: "2 kapanone industriale 1 kat dhe 2 kat + mur rrethues + kabinë elektrike dhe vendroje", miratuar me vendimin nr. 55/1-23, datë 15.03.2023, me zhvillues z. B.D, në Spitall, Bashkia Durrës.

Në 1 praktikë tjetër, leja e ndërtimit ishte në proces shqyrtimi për ndryshim projekti gjatë ndërtimit, ndërkohë që sipërfaqet e ndërtimit ishin rishikuar si pasojë e ndryshimit të projektit. Për rrjedhojë, llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhej të rivlerësohej mbi bazën e sipërfaqeve aktuale të ndërtimit. Rasti i referohet lejes së ndërtimit me objekt: "Godinë banimi 1-2 kate dhe shërbimi me mur rrethues", miratuar me vendimin nr. 1444-22, datë 12.09.2023, me zhvillues shoqërinë "D" sh.p.k, në C.la, Bashkia Durrës.

Sa më sipër, veprime në kundërshtim me Nenin 46 të Ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar ; me Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar; me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës me nr.194, datë 22.12.2023, *Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës", pika 1.3*; me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës me nr.149, datë 22.12.2022, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës", pika 1.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 165-203 të Raportit të Auditimit).*

**22.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Durrës të marrë masa për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë në bazë të destI.cionit të objektit dhe referuar ndryshimeve të sipërfaqeve në aplikimin për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, përkatësisht për lejet e mëposhtme me objekt:

-"2 kapanone industriale 1 kat dhe 2 kat+ mur rrethues + kabinë elektrike dhe vendroje", miratuar me vendimin Nr.55/1-23, datë 15/03/2023, me zhvillues B.D, në Spitall, Bashkia Durrës, në bazë të destI.cionit të tij dhe nivelit të duhur të taksës.

-"*GodI. banimi 1-2 kate dhe shërbimi me mur rrethues*", miratuar me vendimin Nr.1444-22, datë 12/09/2023, me zhvillues shoqëria "D" sh.p.k, në adresën C.la, Bashkia Durrës, duke qenë që është aktualisht në shqyrtim nga autoriteti vendor në apikimin me nr. AN150120250068, datë 15.01.2025, për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, të llogaritet diferenca e taksës së ndikimit në infrastrukturë në bazë të sipërfaqeve të ndërtimit të ndryshuara, sipas projektit të fundit të miratuar.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**23. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, në krahasim me kushtet dhe parametrat e përcaktuar në lejen e ndërtimit të miratuar, u konstatua 1 rast i zhvillimit të punimeve në mospërputhje me lejen e ndërtimit. Konkretisht, për lejen e ndërtimit me objekt: "Hotel me 1 dhe 7 kate, me 1 kat nëntokë", miratuar me Vendimin nr. 1654-22/5, datë 31.01.2023, me zhvillues z. E.K, në adresën Rruga "Val Deti", Lagjja 13, Bashkia Durrës, u evidentua se punimet e realizuara nuk ishin në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar konkretisht: numri i kateve, sipërfaqja e ndërtimit, gjurma e objektit, lartësia, konfigurimi i volumit, përdorimi i ambienteve, etj. Kjo situatë është në kundërshtim me kërkesat e neneve 51 dhe 52 të Ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", si dhe me nenet 5 dhe 12 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 165-203 të Raportit të Auditimit).*

**23.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Durrës të marrë masa për të shqyrtuar dhe verifikuar në sistemin e-Leje të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet të paraqitet, vërtetësinë/saktësinë e tij, si dhe të kryej verifikimet në terren për realizimin e punimeve të zbatimit dhe të japë konformitetin për aktkontrollet e detyrueshme (*përfundimi i karabI.së, i fasadave dhe sistemimit të jashtëm*), që të jenë në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.

**23.2. Rekomandimi:** Në bashkëpunim me strukturat e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të vijojnë me kontrolle të vazhdueshme në terren përgjatë gjithë periudhës së zbatimit deri në përfundim të punimeve të ndërtimit dhe pas saj, në mënyrë që objekti i realizuar të mos pësoj

ndryshime/ devijime nga leja e ndërtimit e miratuar dhe të ruaj të njëjtin destI.cion sipas së cilit është miratuar.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**24. Gjetje nga auditimi:** Gjatë trajtimit të ankesës nr. 118 prot., datë 18.10.2024, administruar në KLSH me nr. 1258 prot., datë 21.10.2024, të paraqitur nga studio ligjore "T.& H.", në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shtetasit J.M, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar lidhur me ankesën e depozituar në Bashkinë Durrës me nr. 8728 prot., datë 17.07.2024, u konstatua se grupi i inspektorëve të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), i ngarkuar për verifikimin e kësaj ankese, nuk ka hartuar akt-verifikimin mbi gjendjen faktike të konstatuar në terren.
Mos hartimi i akt-verifikimit përbën mosrespektim të pikës 5 të nenit 12 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikë 2.7 faqe 235-240, të Projekt Raport Auditimit)*
**24.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Durrës, nëpërmjet Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), të ngrejë një grup pune me qëllim verifikimin në terren të pretendimeve të ngritura në ankesën e z. J.M, depozituar në Bashkinë Durrës me nr. 8728 prot., datë 17.07.2024. Në përfundim të procesit të verifikimit, të dokumentohen rezultatet me aktet përkatëse, të merren vendimmarrjet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pala ankuese të njoftohet zyrtarisht për rezultatet e verifikimit dhe masat e marra.

***Menjëherë***

## B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15, germat b) dhe c) "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*" dhe mbështetur në nenet 98-102 të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, nga ana e **Titullarit të Bashkisë Durrës**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësish, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **30,353,166 lekë pa TVSH** si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimit:** Nga auditimi i kontratës *"Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore të Fëmijëve", Bashkia Durrës,* me Shoqërinë "G" sh.p.k, nënshkruar 52/5 prot., datë 24.03.2023 dhe me vlerë 124,787,056.4 lekë me TVSH, u konstatuan mangësi në lidhje me raportimin e volumeve të rrjetës metalike Ø 10 mm, FV dektor tymi + Fv bazë detektori. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën **497,280 lekë pa TVSH.** Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve OE "T" sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.
*(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4, faqe 142-165 Raportit të Auditimit).*
**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*Sektori i Menaxhimit të Kontratave të Punëve Publike*) në Bashkinë Durrës, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme

administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **497,280 lekë pa TVSH**, nga shoqëria "G" sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

***Brenda datës 31.12.2026***

**2. Gjetje nga auditimit:** Nga auditimi i kontratës *"Riforcim i pallateve me kod gis 24, 5703,5414, 6169, 94, 80, 99"*, me shoqërinë "I" sh.p.k, nënshkruar me nr. 4992/16 prot, datë 13.09.2022 dhe me vlerë 501,887,927 lekë me TVSH, u konstatuan mangësi në lidhje me raportimin e volumeve të transportit të materialeve të ndërtimit, plintuesve gres, mureve të tullës, suvatimeve muri tulle + lyerje, shtresave me pllaka gres, shtresë llustër çimento, suvatime solete, përmasat e koloncI.ve dhe shtrimi me veshje shkalle. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën **4,943,001 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve bashkimi i operatorëve ekonomik BOE "M" PF & "D" sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve dhe nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4, faqe 142-165 Raportit të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*Sektori i Menaxhimit të Kontratave të Punëve Publike*) në Bashkinë Durrës, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **4,943,001 lekë pa TVSH**, nga shoqëria "I" sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

***Brenda datës 31.12.2026***

**3. Gjetje nga auditimit:** Nga auditimi i kontratës *"Rikonstruksioni godine 12-13 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, rruga "Jahja Ballhysa" nr. 6, GIS 3092"*, me BOE "E" sh.p.k & "L" sh.p.k & "E" sh.p.k, nënshkruar me nr. 3638/63 prot., datë 09.06.2021 dhe me vlerë 247,158,153 lekë me TVSH, u konstatuan mangësi në lidhje me llogaritjen e volumeve të prishjeve të suvasë ekzistuese të murit dhe transport materiale ndërtimi. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën **4,696,842 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve operatori ekonomik "N" sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.
*(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4, faqe 142-165 Raportit të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*Sektori i Menaxhimit të Kontratave të Punëve Publike*) në Bashkinë Durrës, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **4,696,842 lekë pa TVSH**, nga B/OE "E" sh.p.k & "L" sh.p.k & "E" sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

***Brenda datës 31.12.2026***

**4. Gjetje nga auditimit:** Nga auditimi i kontratës *"Rikonstruksioni dhe riparimi i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Durrës, Njësitë administrative nr. 1,2,3,4,5, Sukth, Manëz"*, me shoqërinë "E" sh.p.k, nënshkruar me nr. 588/17 prot., datë 05.04.2022 dhe me vlerë 176,327,975 lekë me TVSH, u konstatuan mangësi në lidhje me llogaritjen e volumeve të transportit të materialeve të ndërtimit dhe lyerje me bojë plastike

jashtë. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën **483,178 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve operatorit ekonomik "G" sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4, faqe 142-165 Raportit të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*Sektori i Menaxhimit të Kontratave të Punëve Publike*) në Bashkinë Durrës, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **483,178 lekë pa TVSH**, nga shoqëria "E" sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

***Brenda datës 31.12.2026***

**5. Gjetje nga auditimit:** Nga auditimi i kontratës *"Rikonstruksioni dhe riparimi i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Durrës, Njësitë administrative nr. 5 dhe Sukth, Rrashbull"*, me BOE "R" sh.p.k & "G" sh.p.k, nënshkruar me nr. 588/19 prot., datë 01.04.2022 dhe me vlerë 206,840,255 lekë me TVSH, u konstatuan mangësi në lidhje me llogaritjen e volumeve të suvatimeve të jashtme dhe rrjetë plastike për suvatimet. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën **2,397,919 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve operatorit ekonomik "H" sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4, faqe 142-165 Raportit të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*Sektori i Menaxhimit të Kontratave të Punëve Publike*) në Bashkinë Durrës, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **2,397,919 lekë pa TVSH**, nga B/OE "R" sh.p.k & "G" sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

***Brenda datës 31.12.2026***

**6. Gjetje nga auditimit:** Nga auditimi i kontratës *"Riforcim i pallateve me kod gis 25759, 25583, 22842, 22243, 22248, 22866, 24812, 22707,25248, 22721, 24821, 22245, 22299"*, me BOE "L" sh.p.k & "U" & "S" & "S" sh.p.k, nënshkruar me nr. 4990/16 prot, datë 15.08.2022 dhe me vlerë 428,529,309 lekë me TVSH, u konstatuan mangësi në lidhje me llogaritjen e volumeve të transportit të materialeve të ndërtimit, plintuesve grez, prishje mur tulle pa pastrim, shtresë llustër çimento, veshje e shkallëve të brendshme me pllakë mermeri, suva brenda mur tulle, suva zakonshme fasade, prishje suva tavani, suva tavani, lyerje tavani, suva strukturore me rrjet teli, shtresë me pllaka gres, mure b/a, parapet shkalle dhe përforcim mure. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën 6,945,267 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve B/OE "H" & "I" sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e*

*Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4, faqe 142-165 Raportit të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*Sektori i Menaxhimit të Kontratave të Punëve Publike*) në Bashkinë Durrës, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **6,945,267 lekë pa TVSH**, nga B/OE "L" & "U" & "S" sh.p.k & "S" sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

***Brenda datës 31.12.2026***

**7. Gjetje nga auditimit:** Nga auditimi i kontratës *"Rikonstruksioni i hapësirave publike në bllokun e banimit në Lagjen nr. 17 dhe tek Muzeu i dëshmorëve"*, me B/OE "L" sh.p.k & "N" sh.p.k, nënshkruar me nr. 4002/19 prot., datë 02.09.2022 dhe me vlerë 66,276,473 lekë me TVSH, u konstatuan mangësi në lidhje me llogaritjen e volumeve të prerje të bimëve të vogla, shtresë çakulli 15 cm + stabilizant 10 cm, pllaka guri trani dhe rrjetë metalike deri 2.5m. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën **2,187,119 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve operatori ekonomik "H" sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4, faqe 142-165 Raportit të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*Sektori i Menaxhimit të Kontratave të Punëve Publike*) në Bashkinë Durrës, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **2,187,119 lekë pa TVSH**, nga B/OE "L" sh.p.k & "N" sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

***Brenda datës 31.12.2026***

**8. Gjetje nga auditimit:** Nga auditimi i kontratës *"Riforcimi i pallateve me kod GIS 20590, 22363, 20402, 19065, 19659, 21258, 21167, 47053, 38776, 19068, 21281, 22369, riforcimi i banesës individuale në NjA Manëz të X.S"*, me shoqërinë "G" sh.p.k, nënshkruar me nr. 4981/14 prot., datë 15.08.2022 dhe me vlerë 409,898,699 lekë me TVSH, u konstatuan mangësi në lidhje me llogaritjen e volumeve të transportit të materialeve të ndërtimit, të plintuesve pllake grez, dyerve të blinduara, hekur betoni d>10 mm, veshjeve shkallë të brendshme me pllakë mermeri, kolonat lidhëse, suva mur tulle, suva e zakonshme, suva fasade dhe hekur betoni me d=5mm. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën **7,170,620 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve B/OE "H" & "I" sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4, faqe 142-165 Raportit të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*Sektori i Menaxhimit të Kontratave të Punëve Publike*) në Bashkinë Durrës, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme

administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **7,170,620 lekë pa TVSH**, nga shoqëria "G" sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

***Brenda datës 31.12.2026***

**9. Gjetje nga auditimit:** Nga auditimi i kontratës *"Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Sukth"*, me shoqërinë "K" sh.p.k, nënshkruar me nr. 1865/54 prot., datë 01.06.2023 dhe me vlerë 12,492,900 lekë me TVSH, u konstatuan mangësi në lidhje me llogaritjen e volumit të mbushjes me çakëll, përhapur e ngjeshur me makineri (t=10cm). Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën **127,000 lekë pa TVSH.**
Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve operatori ekonomik "A" sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.
*(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4, faqe 142-165 Raportit të Auditimit).*
**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*Sektori i Menaxhimit të Kontratave të Punëve Publike*) në Bashkinë Durrës, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **127,000 lekë pa TVSH**, nga shoqëria "K" sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

***Brenda datës 31.12.2026***

**10. Gjetje nga auditimit:** Nga auditimi i kontratës *"Rikonstruksion në rruge në Njësinë Administrative Rrashbull"*, me shoqërinë "K" sh.p.k, nënshkruar me nr. 2626/9 prot., datë 28.01.2024 dhe me vlerë 5,661,000 lekë me TVSH, u konstatuan mangësi në lidhje me llogaritjen e volumit e shtresës asfaltobetoni me zall lavatrice dhe shtresë binderi me zall lavatrice. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Durrës në vlerën **102,400 lekë pa TVSH.**
Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve operatori ekonomik "P" sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.
*(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4, faqe 142-165 Raportit të Auditimit).*
**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*Sektori i Menaxhimit të Kontratave të Punëve Publike*) në Bashkinë Durrës, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **102,400 lekë pa TVSH**, nga shoqëria "K" sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

***Brenda datës 31.12.2026***

**11. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e kontratës nr. 1859/55 prot., datë 08.05.2023, me objekt "Blerje dru zjarri dhe pellet për QEA, Durrës", të lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe operatorit ekonomik "G" (PF), u konstatua se operatori ekonomik nuk ka respektuar afatin kontraktor të lëvrimit të mallit, sipas pikës 7.5 të Kushteve të Veçanta të Kontratës, afati i zbatimit ishte 150 ditë, nga data 01.11.2023 deri më 31.03.2024. Megjithatë,

një pjesë e mallit, në vlerën 25,079,400 lekë, është dorëzuar më datë 02.05.2024, sipas faturës nr. 1 dhe Fletë-Hyrjes nr. 18, datë 02.05.2024, pra me 32 ditë vonesë ndaj afatit kontraktor.
Pavarësisht mosrespektimit të afatit të kontratës nga operatori ekonomik, autoriteti kontraktor, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të Bashkisë Durrës, nuk ka llogaritur dhe aplikuar penalitetet (kamatëvonesat) e parashikuara në pikën 10.1/a të kontratës. Si pasojë, nuk është arkëtuar penaliteti kontraktor i llogaritur në vlerën 802,540.8 lekë, duke shkaktuar një efekt me dëm në buxhetin e Bashkisë Durrës**.** *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 45-142, Raportit të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës pranë Qendrës Ekonomike të Arsimit Durrës, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të autoritetit kontraktor, të marrë masa për aplikimin dhe arkëtimin e penaliteteve kontraktore në shumën 802,540 lekë ndaj operatorit ekonomik "G" (PF), duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për realizimin e kësaj kërkese.

***Brenda datës 31.12.2026***

## C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatuan **3 praktika** me llogaritje jo të saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi. Diferenca e taksës së ndikimit në infrastrukturë është konstatuar si pasojë e diferencave të sipërfaqeve të ndërtimit të konstatuara nga verifikimi i projektit i teknik në dëg. Përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt: 1.“*Godinë banimi dhe shërbimi 1, 5 dhe 6 kate me 1 kat parkimi nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr. 930-22/5, datë 03/02/2023, me zhvillues shoqëria "Ç" sh.p.k, në adresën rruga “H.M”, lagjja 17, Durrës, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **4,318,434 lekë**; 2.“*Godinë banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr. Nr. 1036/6, datë 22/06/2023, me zhvillues shoqëria "A" sh.p.k, në adresën rruga “Doktor Remzi Fico”, Durrës, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **237,492 lekë**; 3.“*Godinë banimi 4 kat me 1 kat nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr. 1282-23/5, datë 28/03/2024, me zhvillues I.S dhe M.S, në adresën rruga “S.D”, lagjja 8, njësia administrative nr. 4, Bashkia Durrës, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **3,950,155 lekë,** veprime në kundërshtim me Nenin 46 të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar ; me Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar; me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës me nr.194, datë 22.12.2023, Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës”, pika 1.3; me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës me nr.149, datë 22.12.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës”, pika 1.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 165-203 të Raportit të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Durrës (strukturat përgjegjëse), të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej **8,506,081 lekë**, si pasojë e përllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga verifikimi i sipërfaqes së ndërtimit.

***Brenda datës 31.12.2026***

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua **2 praktika** me llogaritje jo të saktë të sipërfaqes që duhet të kaloj në favor të fondit të banesave sociale, sipas rregullores

dhe legjislacionit në fuqi. Përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt: **1.**"*Godinë banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 1036/6, datë 22/06/2023, me zhvillues shoqëria "A" sh.p.k, në adresën rruga "Doktor Remzi Fico", Durrës, me diferencë të sipërfaqes që duhet t'i kalojë bashkisë pa shpërblim prej **9.8 m²**, ose e shprehur në vlerë monetare **664,200 lekë; 2.**"*Godinë banimi dhe shërbimi 3, 5 dhe 7 kat me 1 kat parkim nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 783/5, datë 11.11.2024, me zhvillues shoqëria "K" sh.p.k, në adresën rruga "Aleksandër Goga", lagjja 18, rajoni 4, Bashkia Durrës, me diferencë të shprehur në vlerë monetare në raport me vlerën e likuiduar prej **133,650 lekë,** veprime në kundërshtim me Ligjin Nr.22/2018, "*Për strehimin social*", datë 3.5.2018, Neni 19, pika 1.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 165-203 të Raportit të Auditimit).*
**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Durrës (strukturat përgjegjëse), të marrin masa për kalimin e sipërfaqes prej **9.8 m²** në favor të fondit publik të banesave sociale, ose në pamundësi të sipërfaqes ndërtimore, të arkëtojë vlerën prej **797,850 lekë**, që përbën të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e mosrealizimit të marrëveshjes ndërmjet palëve.

***Brenda datës 31.12.2026***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatuan **2 praktika** të cilat lejet e zhvillimit janë të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe lejet e ndërtimit janë të miratuara nga Bashkia Durrës, sipas marrëveshjes për delegimin e kompetencave, në të cilat taksa e ndikimit në infrastrukturë është llogaritur në bazë të të dhënave të treguesve të zhvillimit dhe sipërfaqeve të miratuara nga KKT-ja dhe jo nga verifikimi i projektit të ndërtimit në dëg. Përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt: **1.**"*Godinë banimi dhe shërbimi 10 kat mbi tokë me 2 kate nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 1071/1, datë 31/08/2023, me zhvillues shoqëria "X" sh.p.k, në adresën rruga shëtitorja "Taulantia", Durrës, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas verifikimit të projektit në dëg prej **10,131,056 lekë**; **2.**"Strukturë hotelerie 8 kate dhe 1 kat nëntokë", miratuar me vendimin Nr. 1623-23/4, datë 22/01/2024, me zhvillues shoqëria "D" sh.p.k, në adresën rruga "Pavarësia", plazh, lagjja 13, Bashkia Durrës, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **100,222 lekë**.
Sa më lart, diferenca e vlerës prej **10,231,278 lekë** konsiderohet mungesë të ardhurash, veprime në kundërshtim me Nenin 46 të Ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar ; me Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për "Sistemin e taksave dhe tarifave vendore", i ndryshuar; me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës me nr.194, datë 22.12.2023, Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës", pika 1.3; me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës me nr.149, datë 22.12.2022, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës", pika 1.3.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 165-203 të Raportit të Auditimit).*
**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Durrës, të marrë masa që të verifikojë dhe të kryej llogaritjen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën **10,231,278 lekë**, bazuar në sipërfaqet e ndërtimit sipas projektit teknik (në pdf/dëg) të miratuar, duke respektuar pikat e marrëveshjes së deleguar nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

***Brenda datës 31.12.2026***

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua **1 praktikë** në të cilën leja e zhvillimit është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe leja e ndërtimit është miratuar nga Bashkia Durrës, sipas marrëveshjes për delegimin e kompetencave, në të cilën sipërfaqja që duhet të kaloj në favor të fondit të banesave sociale është llogaritur në bazë të sipërfaqeve të miratuara nga KKT-ja në lejen e zhvillimit dhe jo nga verifikimi i projektit të ndërtimit në dëg të miratuar në lejen e ndërtimit, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi. Përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: "*Godinë banimi dhe shërbimi 10 kat mbi tokë me 2 kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 1071/1, datë 31/08/2023, me zhvillues shoqëria "X" sh.p.k, në adresën rruga

shëtitorja “Taulantia”, Durrës, me diferencë të sipërfaqes që duhet t’i kalojë bashkisë pa shpërblim prej **7.7 m$^2$**, ose e shprehur në vlerë monetare **519,750 lekë,** e cila konsiderohet mungesë të ardhurash, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr.22/2018, “*Për strehimin social*”, datë 3.5.2018, Neni 19, pika 1.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 165-203 të Raportit të Auditimit).*
**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Durrës të marrë masa që të verifikojë dhe të kryej llogaritjen e saktë të sipërfaqes së banimit për kontributin e banesave sociale në bazë të projektit teknik të miratuar, duke respektuar pikat e marrëveshjes së deleguar nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

***Në vijimësi***

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që kanë zënë hapësirën publike rezulton se, gjatë vitit 2023, janë lidhur 157 kontrata për zënien e hapësirës publike, me afat 1-vjeçar, si dhe kanë qenë aktive 47 kontrata me afat 3- dhe 5-vjeçar.
Në datën 31.12.2023 rezultonin 6 kontrata debitore, me një vlerë totale detyrimi prej 2,916,705 lekësh. Gjatë vitit 2024, 3 prej këtyre kontratave kanë likuiduar detyrimet, në vlerën totale prej 2,065,000 lekësh, ndërsa 3 kontrata kanë vijuar të rezultojnë debitore, me një vlerë detyrimi prej 851,705 lekësh.
Gjatë vitit 2024 janë lidhur 193 kontrata për zënien e hapësirës publike, me afat 1-vjeçar, ndërkohë që kanë qenë aktive 35 kontrata me afat 3- dhe 5-vjeçar.
Në datën 31.12.2024 rezultojnë 5 kontrata debitore, me një vlerë totale detyrimi prej 1,989,500 lekësh.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKB nr. 149, datë 22.12.2022 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2023” VKB nr. 194, datë 22.12.2023 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2024”. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 16-45 Raportit të Auditimit).*
**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga kontratat e plazhit për vlerën **2,841,205 lekë**.

***Brenda datës 31.12.2026***

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se deri më datë 31.12.2023, për mos pagesën e detyrimeve tatimore për abonentët privatë debitorët janë në vlerën **1,718,399,005 lekë**. Përgjatë vitit 2024 detyrimet janë rritur me vlerën **140,927,992 lekë**. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2024, për abonentët privatë janë në vlerën **1,859,326,997 lekë.**
Për debitorët abonentët biznes nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponohet shkresë përcjellëse në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e këtyre debitorëve. Nga sistemi nuk mund të gjenerohet një liste e debitorëve me datë detyrimi deri në datë 31.12.2024.
Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara në sistem në datën 11.04.2025 i është kërkuar sektorit të borxhit gjenerimi i një raporti përmbledhës me detyrimin total për abonentët privat deri në datën 31.12.2024.
Në datën 11.04.2025 sipas informacionit të përcjellë me e-mail nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, detyrimi për abonentë privatë deri në datën 31.12.2024 është në vlerën **1,951,318,745 lekë**.
*Sa më sipër për të njëjtën periudhë janë gjeneruar 2 raporte me vlerë të ndryshme debie për të njëjtën datë raporti.* Problematika kryesore e sistemit është sepse në sistem detyrimi nuk gjenerohet sipas datës që kërkohen të dhënat por në informacionin e periudhës që kërkojmë në sistem përfshihen edhe kamatëvonesa dhe rivlerësime pas periudhës për të cilën po kërkojmë informacionin në sistem por që kanë ndikuar në rezultatin e kësaj periudhë.
Sa më sipër grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion të saktë dhe të qenësishëm për situatën e menaxhimit, identifikimit, regjistrimit dhe vjeljes së të ardhurave në DTTV Durrës për debinë totale pasi ka pasaktësi në detyrimin total për sa më sipër.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, nenet 54, 55, Ligji nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 4, 22, 23, Ligji nr.10296/2010 "Për menaxhimin fI.nciar dhe kontrollin", nenet 8, 9, 12, dhe Ligji nr. 9920 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" nenet 5,70,89.
*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 16-45 Raportit të Auditimit).*
**6.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, ku të përfshihen përfaqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Financës dhe specialistë të IT-së, me qëllim:
- Rakordimin dhe saktësimin përfundimtar të vlerës së detyrimeve tatimore për abonentët biznes deri më datë 31.12.2024;
- Verifikimin e funksionalitetit të sistemit informatik, në mënyrë që gjenerimi i detyrimeve të realizohet sipas datës faktike të kërkuar, pa përfshirë kamatëvonesa dhe rivlerësime të krijuara pas periudhës raportuese;
- Dokumentimin zyrtar të çdo diference të konstatuar ndërmjet të dhënave të sistemit dhe evidencave kontabël.
Në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca në vlerën e detyrimit total, të përcaktohen përgjegjësitë administrative dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore përkatëse për sistemimin e pasaktësive.
- Arkëtimin e detyrimeve nga debitorët për vlerën **1,859,326,997 lekë,** duke marrë të gjitha hapat ligjorë deri në kallëzim penal, dhe dokumentuar dhe administruar në mënyrë të plotë çdo veprim në dosjen individuale të debitorit.

***Brenda datës 31.12.2026***

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi përllogaritjen e fondit limit në procedurën me objekt "*Rikonstruksion i shkollës Besnik Hidri*", me fond limit 46,629,688 lekë, nga verifikimi i preventivit të administruar në dosje u konstatua se për zërin e punës "FV Dritare plastike me dopio xham (*me mek antiribalt hapje*), i cili është marrë me nr. analize "An" dhe çmim 16,716 lekë /$m^2$, në dosjen e prokurimit nuk administrohet analizë e veçantë. Ky zë pune në manualin e çmimeve rezultoi me nr. Analize 2.375/1 dhe me çmim 14,993 lekë/$m^2$, ose 1723 lekë/$m^2$ më pak se në preventivin e fondit limit. Pra, si rezultat i diferencës së çmimit në vlerën 1,723 lekë/$m^2$ të llogaritur në preventiv vlera e fondit limit është rritur në shumën **646,125 lekë** *(375 $m^2$ x 1,723 lekë/$m^2$),* veprime në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", i ndryshuar.
*(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 45-142, Raportit të Auditimit).*
**7.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të AK të marrë masat e nevojshme që zyrtarët e përfshirë në procedurat e prokurimit të kryejnë përllogaritje të saktë të fondit limit, me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**8. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e **2 procedurave** të prokurimit, rezultoi se në hartimin e fondit limit për makineritë dhe pajisjet është ngarkuar edhe TVSH-ja, në kundërshtim me Udhëzimin e KM Nr. 1, datë 16.6.2011, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar. E konkretisht:
- Procedura me objekt "*Rikonstruksion i Qendrës së Fëmijëve***"** me fond limit 106,262,235 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 103,989,214 lekë me shoqërinë "G" sh.p.k, rezultoi se referuar të dhënave të procesverbalit 14387/1 prot, datë 09.10.2023 të mbajtur nga grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit të kontratës, ky grup është bazuar ne projekt preventivin e hartuar nga studio projektimi private.

Kapitullit "*Makineri pajisje (Sistemi i ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit*", me vlerë totale 11,122,901 lekë, gjatë hartimit të preventivit nga projektuesi "D" sh.p.k, i në të cilin jepet struktura e preventivave. Ky veprim, ka rritur fiktivisht fondin limit në vlerën **2,224,580 lekë**, e cila bie ndesh me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficensës së fondeve publike të Bashkisë Durrës.

**-** Procedura me objekt: "*Rikonstruksion i Pallatit të Kulturës*", Bashkia Durrës, me fond limit 496,274,322 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 488,709,669 lekë me B/OE "G" & "G" & "S" sh.p.k, rezultoi se në strukturën e preventivit të fondit limit (*del që është e njëjtë edhe në ofertën fituese*), pajisjet janë ngarkuar me TVSH, duke rritur fiktivisht fondin limit në vlerën **12,006,339 lekë**, vlerë që përbën përdorim pa ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Durrës. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 45-142, Raportit të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Durrës të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialist të fushës për të evidentuar shkaqet që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit në vlerën **14,230,919 lekë,** si rezultat i hartimit të gabuar të fondit limit, duke rënduar TVSH e makinerive e pajisjeve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi arkëtimin e gjobave të aplikuara nga IMT, rezultoi se, nga 277 masa administrative "Vendim me gjobë", me vlerë totale 79,491,000 lekë, është arkëtuar nëpërmjet shlyerjes vullnetare të detyrimit vlera 9,600,000 lekë, ndërsa vlera **69,891,000 lekë** rezulton e paarkëtuar. Gjithashtu, në 252 raste nuk rezulton të jetë dokumentuar konfirmimi i njoftimit të kundërvajtësve, në kundërshtim me kërkesat e nenit 160 të Kodit të Procedurës Administrative

Nga IMT Durrës nuk është ndjekur procedura e njoftimit të subjekteve kundërvajtëse në përputhje me kërkesat e nenit 160 të Kodit të Procedurave Administrative, përfshirë njoftimin nëpërmjet të tretit, si dhe nuk rezulton të jenë dokumentuar përpjekjet e nevojshme për njoftimin e tyre. Për rrjedhojë, nuk është ndjekur në mënyrë të plotë procedura ligjore për njoftimin e subjekteve kundërvajtëse dhe vijimin e procedurave për arkëtimin e detyrimeve.

- Vlera e gjobave të paarkëtuara në mënyrë vullnetare apo të detyrueshme, paraqitet në vlerën prej **69,491,000 lekë**. Gjithashtu, në të gjitha rastet nga IMTV-ja, arkëtimi i shumave të detyrimeve, nuk është shoqëruar me kamatë vonesë bazuar në masën e gjobës, në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar. *(Më hollësisht, gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6, faqet 203–235, të Raportit të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Mjedisit (IMT/IMTV) Durrës**:**

- Të marrë masa për evidentimin dhe dokumentimin e plotë të të gjitha detyrimeve të krijuara nga masat administrative "Vendim me gjobë", duke ndjekur procedurat ligjore për njoftimin e subjekteve kundërvajtëse, përfshirë dokumentimin e konfirmimit të njoftimit dhe, kur është e nevojshme, të gjitha përpjekjet e kryera për njoftimin nëpërmjet të tretit apo mënyrave të tjera të parashikuara nga neni 160 i Kodit të Procedurave Administrative.
- Të ndjekë, për të gjitha gjobat e papaguara, procedurat ligjore për arkëtimin vullnetar dhe, në rast mospagese, procedurat e arkëtimit të detyrueshëm, duke dokumentuar në çdo rast veprimet administrative të ndërmarra dhe rezultatet e tyre.
- Të verifikojë dhe të llogarisë kamatëvonesat për detyrimet e papaguara, në përputhje me nenin 30 të Ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar, dhe të marrë masa për arkëtimin e tyre së bashku me shumën e gjobës.
- Të hartojë një plan masash me afate dhe përgjegjësi konkrete për ndjekjen e detyrimeve të paarkëtuara, duke synuar arkëtimin e shumës prej **139,382,000 lekë** të evidentuar si e paarkëtuar, si dhe të raportojë periodikisht mbi ecurinë e arkëtimit dhe zbatimin e procedurave ligjore.

***Menjëherë dhe në vijimësi***.

**D. MASA DISIPLINORE**

**D.1. Për punonjësit në marrëdhënie pune**

**D.1.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e shërbimit civil dhe kodit të punës apo me statuse të parashikuar në ligje të veçanta**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja "c", Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013, *"Për nëpunësin civil"* i ndryshuar nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"*, gërma "a" dhe VKM-në nr. 115, datë 05.3.2014, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil"*, dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996, *"Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 37 *"Masa disiplinore"* dhe kontratës individuale të punës neni 13, gërma "a", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Durrës, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga "***Vërejte deri në largim nga puna"*** për punonjësin e mëposhtëm:

**1- Z. J.K.,** me detyrë Specialist Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit publik.
**2. Zj. A.K.,** me detyrë Specialist Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit publik;
**3. Z. E.X,** me detyrë Specialist Sektori Marrëdhënieve me Publikun.
**4. Zj. E.Ç.,** me detyrë Inspektor i Sportit dhe Rinise, Sektori i Kulturës, Rinisë, Sporteve.
**5. Zj. D.E.,** me detyrë Specialist Sektori i Planifikimit Urban.
**6. Zj. B.M.,** me detyrë Përgjegjës Sektori të Projekteve Publike.
*Në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, për shkeljet si më poshtë vijon:*
Në 7 (shtatë) nga 27 procedurat e prokurimit të audituara rezultoi se, në përcaktimin dhe/ose aplikimin e kritereve kualifikuese, nuk është respektuar në mënyrë të plotë kuadri ligjor dhe rregullator që disiplinon procedurat e prokurimit publik. Konkretisht, problematika juridike konsiston në:
- mospërputhjen e kritereve kualifikuese me objektin dhe tipologjinë e procedurës;
- vendosjen dhe/ose aplikimin e kërkesave që nuk rezultojnë të nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës;
- cenimin potencial të konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë;
- mungesën ose pamjaftueshmërinë e arsyetimit dhe dokumentimit të kritereve;
aplikimin jo të njëtrajtshëm të kërkesave kualifikuese;
Mos respektimin e dispozitave të LPP-së dhe akteve nënligjore zbatuese, si: Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar – neni 77; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar – neni 40, neni 41**.**
Mangësitë e mësipërme janë evidentuar në procedurat, si vijon:
- *Procedura me objekt: "Rikonstruksion shkolla 9- vjeçare Demokracia", viti 2023 me fond limit 47,500,000 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Blerje dru zjarri e pellet për QEA, Durrës", viti 2023 me fond limit 39,996,000 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Rikonstruksion i Qendrës së Fëmijëve", viti 2023 me fond limit 106,262,235 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Ndërtim i shkollës 9-vjecare Vadardh Sukth viti 2024 me fond limit 268,788,521 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Ndërtim i ri Gjimnazi Manëz, NjA Manëz", Bashkia Durrës me fond limit 315,848,761 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Rikonstruksion i Pallatit të Kulturës", Bashkia Durrës viti 2024 me fond limit 496,274,322 lekë;*

- *Procedura me objekt: "Ndërtim shkolla 9 vjeçare "Met Hasa", Bashkia Durrës viti 2024 me fond limit 241,896,945 lekë.*

**7- Zj. K.B.,** me detyrë Specialist (Jurist), Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile.
**8- Z. G.K.,** me detyrë Zv/Kryetar Bashkia Durrës.
**9- Z. L.S,** me detyrë Drejtor Drejtoria e Turizmit.
**10- Z. K.Dh.,** me detyrë Specialist Sektori i Procedurave Ligjore dhe Prokurimeve Publike
**11- Z. M.J.,** me detyrë Specialist Sektori i Projekteve Publike.

*Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), për shkeljet si më poshtë vijon;*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në 10 (dhjetë) nga 27 procedura prokurimi të audituara të ofertës së OE të shpallur fitues rezulton se nuk ka provuar përmbushjen e plotë të kritereve të kualifikimit të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit. Pavarësisht kësaj, KVO-ja e ka konsideruar ofertën të kualifikuar, pa evidentuar në mënyrë të qartë bazën dokumentare dhe faktike mbi të cilën ka arritur në këtë përfundim.

Në këto kushte, vlerësimi i KVO-së rezulton në kundërshtim me kërkesat e LPP-së lidhur me verifikimin e aftësisë dhe përmbushjen e kritereve të kualifikimit, si dhe me parimet e transparencës, barazisë dhe trajtimit të njëjtë të operatorëve ekonomikë. Mosplotësimi i një kriteri kualifikues të përcaktuar si i detyrueshëm nuk mund të anashkalohet apo të konsiderohet i përmbushur në mungesë të provave përkatëse.

Për rrjedhojë, KVO-ja, duke pranuar dhe kualifikuar ofertën e një OE-je që nuk përmbush kriteret e përcaktuara në DST, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LPP-së dhe me kërkesat e dokumenteve të tenderit, duke cenuar njëkohësisht parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Konkretisht të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 3, neni77, neni 92, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Neni 8;

Dokumentet Standarde të Tenderit – kriteret e kualifikimit dhe Kapitulli "Vlerësimi i ofertave".

Mangësitë e mësipërme janë evidentuar në procedurat, si vijon:

- *Procedura me objekt: "Rehabilitim i shëtitores Taulantia (Loti III) viti 2023 me fond limit 16,953,401 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Rikualifikim i hapësirave publike lagjja 13 dhe 6, bashkia Durrës viti 2023 me fond limit 21,144,868 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Rehabilitim i ndriçimit të akseve rrugore viti 2023 me fond limit 41,611,645 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Rehabilitim rruga e dëshmorëve, segmenti nga kryqëzimi me rrugën Mujo UlqI.ku tek Stacioni i Trenit", viti 2023 me fond limit 50,401,601 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Riaftësim strukturore i pallatit Big Kristi, Durrës, rruga Neki Libohova nr. 62, Kod Gis 5058", viti 2024, me fond limit 156,383,025 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Riaftësim strukturor i pallatit nr. 8 dhe nr. 10, rruga Pelikan me kod gis 5709-5711", viti 2024, me fond limit 291,310,068 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Ndërtim i shkollës 9-vjecare Vadardh Sukth viti 2024, me fond limit 268,788,521 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Riaftësim i strukturorë i pallatit R. sh.p.k, rruga Iljaz Reka, Kod Gis 26380", viti 2024, me fond limit 118,997,888 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Riaftësim strukturore i pallatit nr. 15, rruga Abaz Elkupa 15, Rajoni 3, Kod Gis 24795", viti 2024, me fond limit 81,831,881 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Ndërtim shkolla 9 vjeçare "Met Hasa", Bashkia Durrës viti 2024, me fond limit 241,896,945 lekë.*

**12- Zj. M.J.,** me detyrë Specialist Sektori i Projekteve Publike.

*Në cilësinë e anëtarit të NJP, për shkeljet si më poshtë vijon;*

Në përcaktimin dhe/ose aplikimin e kritereve kualifikuese, nuk është respektuar në mënyrë të plotë kuadri ligjor dhe rregullator që disiplinon procedurat e prokurimit publik.
Konkretisht, problematika juridike konsiston në:
- mospërputhjen e kritereve kualifikuese me objektin dhe tipologjinë e procedurës;
- vendosjen dhe/ose aplikimin e kërkesave që nuk rezultojnë të nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës;
- cenimin potencial të konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë;
- mungesën ose pamjaftueshmërinë e arsyetimit dhe dokumentimit të kritereve;
aplikimin jo të njëtrajtshëm të kërkesave kualifikuese;
Mos respektimin e dispozitave të LPP-së dhe akteve nënligjore zbatuese, si: Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar – neni 77; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar – neni 40, neni 41**.**
Mangësitë e mësipërme janë evidentuar në procedurat, si vijon:
- *Procedura me objekt: "Rikonstruksion shkolla 9- vjeçare Demokracia", viti 2023 me fond limit 47,500,000 lekë;* dhe,

*Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), për shkeljet si më poshtë vijon:*
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së OE të shpallur fitues rezulton se nuk ka provuar përmbushjen e plotë të kritereve të kualifikimit të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit. Pavarësisht kësaj, KVO-ja e ka konsideruar ofertën të kualifikuar, pa evidentuar në mënyrë të qartë bazën dokumentare dhe faktike mbi të cilën ka arritur në këtë përfundim.
Mangësitë e mësipërme janë evidentuar në procedurat, si vijon:
- *Procedura me objekt: "Ndërtim i shkollës 9-vjecare Vadardh Sukth viti 2024, me fond limit 268,788,521 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Riaftësim strukturore i pallatit nr. 15, rruga Abaz Elkupa 15, Rajoni 3, Kod Gis 24795", viti 2024, me fond limit 81,831,881 lekë;*
- *Procedura me objekt: "Ndërtim shkolla 9 vjeçare "Met Hasa", Bashkia Durrës viti 2024, me fond limit 241,896,945 lekë.*

**13- Z. R.S,** në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për mangësitë e mëposhtme:
Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, kreu XI.
**14- Znj. A.H**, në cilësinë e specialistes në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, për parregullsitë e konstatuara në **10 raste**, në lejet e ndërtimit të miratuara me objekt:1."*Godinë banimi dhe shërbimi 10 kat mbi tokë me 2 kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 1071/1, datë 31/08/2023, me zhvillues shoqëria "X" sh.p.k, në adresën rruga shëtitorja "Taulantia", Durrës; 2."*Godinë banimi dhe shërbimi 1, 5 dhe 6 kate me 1 kat parkimi nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 930-22/5, datë 03/02/2023, me zhvillues shoqëria "Ç" sh.p.k, në adresën rruga "H.M", lagjja 17, Durrës; 3."*Godinë banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. Nr. 1036/6, datë 22/06/2023, me zhvillues shoqëria ""A" " sh.p.k, në adresën rruga "Doktor Remzi Fico", Durrës; 4." *GodI. banimi 1-2 kate dhe shërbimi me mur rrethues*", miratuar me vendimin Nr.1444-22, datë 12/09/2023, me zhvillues shoqëria "D" sh.p.k, në adresën C.la, Bashkia Durrës; 5."*Hotel me 1 dhe 7 kate, me 1 kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 1654-22/5, datë 31/01/2023, me zhvillues zhvillues E.K, në adresën rruga "Val Deti", lagjja 13, Bashkia Durrës; 6." *Objekte industriale 1 dhe 2 kat, vend-roje, kabinë elektrike dhe mur rrethues*", miratuar me vendimin Nr.1497-22/5, datë 06/02/2023, me zhvillues shoqëria "I" sh.p.k, në adresën fshati Bisht Kamëz, Njësia Administrative Katund i Ri, Bashkia Durrës; 7."*Strukturë hotelerie 8 kate dhe 1 kat nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 1623-23/4, datë 22/01/2024, me zhvillues shoqëria "D" sh.p.k, në adresën rruga "Pavarësia", plazh, lagjja 13, Bashkia Durrës; 8." *Godinë banimi dhe shërbimi 3, 5 dhe 7 kat me 1 kat parkim nëntokë*", miratuar me vendimin Nr. 783/5, datë 11.11.2024, me zhvillues shoqëria "K" sh.p.k, në adresën

rruga “ALeksandër Goga”, lagjja 18, rajoni 4, Bashkia Durrës; 9.“ *Godinë industriale 1 kat, vendroje, kabinë elektrike dhe mur rrethues*”, miratuar me vendimin Nr. 1562-23/4, datë 15/01/2024, me zhvillues shoqëria "T" sh.p.k, në adresën rruga “Kuvendi Françeskan”, Spitallë, Bashkia Durrës; 10. “*Godinë banimi 4 kat me 1 kat nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr. 1282-23/5, datë 28/03/2024, me zhvillues I.S dhe M.S, në adresën rruga “S.D”, lagjja 8, njësia administrative nr. 4, Bashkia Durrës.

**15**. **Znj. D. Gji.**, në cilësinë e specialistes në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të lejeve, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, për parregullsitë e konstatuara në **2 raste**, në lejen e ndërtimit dhe në certifikën e përdorimit të miratuar me objekt:1.“*GodI. banimi 1-2 kate dhe shërbimi me mur rrethues*”, miratuar me vendimin Nr.1444-22, datë 12/09/2023, me zhvillues shoqëria "D" sh.p.k, në adresën C.la, Bashkia Durrës; 2.“ *Godinë banimi dhe shërbimi 1-6-8 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr. 1051/3, datë 19/09/2023, me zhvilluesi” "K"” sh.p.k, në adresën lagjja 13, Plazh Durrës.

### D.1.2. Për punonjësit e larguar

Për **17 (shtatëmbëdhjetë)** ish-punonjësit: E.P, L.F., R.D., në cilësinë e anëtarit të NJP; B.M, M.B, A.T, R.M., N.Z, në cilësinë e anëtarit të KVO; L.D, në cilësinë e ish-Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore; A.I., në cilësinë e ish- Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve, dhe në cilësinë e anëtarit të KVO; L.B, në cilësinë e ish- përgjegjësit të sektorit të kontrollit të taksave dhe tarifave vendore, dhe në cilësinë e anëtarit të NJP; R.D., në cilësinë e ish- Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, dhe në cilësinë e anëtarit të NJP; E.L, në cilësinë e përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; K.A, në cilësinë e specialistes në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të Lejeve, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit; E.K, në cilësinë e specialistes në Sektorin e Kontrollit të Territorit dhe marrëdhënieve me Publikun, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; V.S, në cilësinë e specialistit në Sektorin e Planifikimit dhe Zbatimit të lejeve, Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; D.M, në cilësinë e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “***Vërejte deri në largim nga puna”.***

## G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Durrës, *të ndërmarrë veprimet si më poshtë*:

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013, *“Për Nëpunësin Civil”* i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013, *“Për Nëpunësin Civil”* i ndryshuar.

## F. MASA ADMINISTRATIVE

**F.1 INSPEKTORATIT TË MBROJTJES SË TERRITORIT, BASHKIA DURRËS**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12, kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, kreu II, Pika 3, të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014, datë 01.04.2013 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", **i rekomandojë**, Titullarit të Bashkisë Durrës, t'i kërkojë **Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Durrës,** sipas kontratave respektive, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të nxjerrë vendime për marrjen e masave dhe sanksioneve administrative për:

**1.** Subjekti OE **"T" sh.p.k**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën nr. 52/5 prot., datë 24.03.2023 me objekt: *"Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore të Fëmijëve", Bashkia Durrës*, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën 497,280 lekë pa TVSH.

**2.** Subjekti BOE **"M" PF & "D" sh.p.k**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën nr. 4992/16 prot, datë 13.09.2022 me objekt: *"Riforcim i pallateve me kod gis 24, 5703,5414, 6169, 94, 80, 99"*, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën 4,943,001 lekë pa TVSH.

**3.** Subjekti OE **"N" sh.p.k**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën nr. 3638/63 prot., datë 09.06.2021 me objekt: *"Rikonstruksioni godine 12-13 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, rruga "Jahja Ballhysa" nr. 6, GIS 3092"*, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën 4,696,842 lekë pa TVSH.

**4.** Subjekti OE **"G" sh.p.k**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën nr. 588/17 prot., datë 05.04.2022 me objekt: *"Rikonstruksioni dhe riparimi i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Durrës, Njësitë administrative nr. 1,2,3,4,5, Sukth, Manëz"*, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën 483,178 lekë pa TVSH.

**5.** Subjekti OE **"H" sh.p.k**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën nr. 588/19 prot., datë 01.04.2022 me objekt: *"Rikonstruksioni dhe riparimi i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Durrës, Njësitë administrative nr. 5 dhe Sukth, Rrashbull"*, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën 2,397,919 lekë pa TVSH.

**6.** Subjekti BOE **"H" & "I" sh.p.k**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën nr. 4990/16 prot, datë 15.08.2022 me objekt: *"Riforcim i pallateve me kod gis 25759, 25583, 22842, 22243, 22248, 22866, 24812, 22707,25248, 22721, 24821, 22245, 22299"*, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën 6,945,267 lekë pa TVSH.
- Në kontratën nr. 4002/19 prot., datë 02.09.2022 me objekt: *"Rikonstruksioni i hapësirave publike në bllokun e banimit në Lagjen nr. 17 dhe tek Muzeu i dëshmorëve"*, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën 2,187,119 lekë pa TVSH.

- Në kontratën nr. 4981/14 prot., datë 15.08.2022 me objekt: *"Riforcimi i pallateve me kod GIS 20590, 22363, 20402, 19065, 19659, 21258, 21167, 47053, 38776, 19068, 21281, 22369, riforcimi i banesës individuale në NjA Manëz të X.S"*, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën 7,170,620 lekë pa TVSH.

**7.** Subjekti OE **"A" sh.p.k**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën nr. 1865/54 prot., datë 01.06.2023 me objekt: "*Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Sukth"*, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën 127,000 lekë pa TVSH.

**8.** Subjekti OE **"P" sh.p.k**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën nr. 2626/9 prot., datë 28.01.2024 me objekt: *"Rikonstruksion në rruge në Njësinë Administrative Rrashbull"*, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën 102,400 lekë pa TVSH.

**9.** Për shoqërinë **"A" sh.p.k,** në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve.

Sipërmarrësi OE "A" sh.p.k ka filluar punimet e zbatimit të kontratës "*Rikonstruksion rruge në NJA Ishëm*" viti 2023, pa disponimin e lejes së ndërtimit në kundërshtim me nenin 39, të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, sipas të cilit leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim.

**10.** Për bashkimin e OE **"R" + "G" sh.p.k,** në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve.

Sipërmarrësi bashkimi OE "R" + "G" sh.p.k ka filluar punimet e zbatimit të kontratës "*Riaftësim strukturore i pallatit Big Kristi, Durrës, rruga Neki Libohova nr. 62, Kod Gis 5058"*, viti 2024, pa disponimin e lejes së ndërtimit në kundërshtim me nenin 39, të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, sipas të cilit leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim.

**11.** Për shoqërinë **"M" sh.p.k,** në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve.

Sipërmarrësi OE "R" + "G" sh.p.k ka filluar punimet e zbatimit të kontratës "*Rikonstruksion Shkolla "Besnik Hidri",* Bashkia Durrës, viti 2023, pa disponimin e lejes së ndërtimit në kundërshtim me nenin 39, të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, sipas të cilit leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim.

**12.** Për shoqërinë **"V" sh.p.k,** në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve.

Sipërmarrësi OE "V" sh.p.k ka filluar punimet e zbatimit të kontratës "*Rikonstruksion i rrugëve në qytet", Bashkia Durrës, viti 2023*, pa disponimin e lejes së ndërtimit në kundërshtim me nenin 39, të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, sipas të cilit leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim.

## F.2 AGJENCICË SË PROKURIMIT PUBLIK

Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, "Për Organizim in dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; nenin 23 pika "e" dhe neni 132 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar **i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik**, që referuar shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimit të zhvilluara në **Bashkinë Durrës** të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit *(pika 5 e Raportit Përfundimtar të Auditimit faqe 45-142)* të marrë masa disiplinore e administrative për anëtarët e Njësisë së Prokurimit, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, sipas përcaktimeve të Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar neni 129, "Procedura e hetimit administrativ" pika 1, germa "a", për procedurat e prokurimit me objekt si më poshtë:

**1- Procedura me objekt**: "*Rikonstruksion shkolla 9- vjeçare Demokracia",* viti 2023 me fond limit 47,500,000 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria "A" sh.p.k, për vlerën 34,954,350 lekë;

**2- Procedura me objekt**: "*Rehabilitim i zonës që preket nga zgjerimi territorit të varrezave të qytetit të Durrësit",* viti 2023 me fond limit 240,000,000 lekë, ku fitues është shpallur B/OE "B" + "A" sh.p.k, për vlerën 231,059,829 lekë

**3- Procedura me objekt**: "*Rehabilitim i shëtitores Taulantia (Loti III)",* viti 2023 me fond limit 16,953,401 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria "M" sh.p.k, për vlerën 12,692,156 lekë

**4- Procedura me objekt**: "*Rikualifikim i hapësirave publike lagjja 13 dhe 6, bashkia Durrës",* viti 2023 me fond limit 21,144,868 lekë, ku fitues është shpallur B/OE ""K" + "C" " sh.p.k, për vlerën 15,633,895 lekë

**5- Procedura me objekt**: "*Rehabilitim i ndriçimit të akseve rrugore",* viti 2023 me fond limit 41,611,645 lekë, ku fitues është shpallur B/OE "B" + "B" + "B" sh.p.k, për vlerën 34,282,500 lekë

**6- Procedura me objekt**: "*Blerje dru zjarri e pellet për QEA, Durrës",* viti 2023 me fond limit 39,996,000 lekë, ku fitues është shpallur subjekti "G" PF, për vlerën 39,889,800 lekë

**7- Procedura me objekt**: "*Riaftësim strukturore i pallatit Big Kristi, Durrës, rruga Neki Libohova nr. 62, Kod Gis 5058"*, viti 2024 me fond limit 156,383,025 lekë, ku fitues është shpallur BOE "R" + "G" sh.p.k, për vlerën 156,015,648 lekë.

**8- Procedura me objekt**: "*Riaftësim strukturor i pallatit nr. 8 dhe nr. 10, rruga Pelikan me kod gis 5709-5711", viti 2024* me fond limit 291,310,068 lekë, ku fitues është shpallur BOE "R" + "G" sh.p.k, për vlerën 290,577,196 lekë

**9- Procedura me objekt**: "*Ndërtim i shkollës 9-vjecare Vadardh Sukth", viti 2024* me fond limit 268,788,521 lekë, ku fitues është shpallur BOE "P" + "U" sh.p.k, për vlerën 260,524,684 lekë

**10- Procedura me objekt**: "*Riaftësim i strukturorë i pallatit R.sh.p.k, rruga Iljaz Reka, Kod Gis 26380", viti 2024* me fond limit 118,997,888 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria "I" sh.p.k, për vlerën 118,983,262 lekë.

**11- Procedura me objekt**: "*Riaftësim strukturore i pallatit nr. 15, rruga Abaz Elkupa 15, Rajoni 3, Kod Gis 24795", viti 2024* me fond limit 81,831,881 lekë, ku fitues është shpallur BOE "E" + "E" + "S" sh.p.k, për vlerën 81,820,638 lekë.

**12- Procedura me objekt**: "*Rehabilitim rruga e dëshmorëve, segmenti nga kryqëzimi me rrugën Mujo UlqI.ku tek Stacioni i Trenit", viti 2023* me fond limit 50,401,601 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria "E" sh.p.k, për vlerën 40,034,812 lekë.

**13- Procedura me objekt**: "*Rikonstruksion i Pallatit të Kulturës", viti 2024* me fond limit 496,274,322 lekë, ku fitues është shpallur BOE "D" sh.p.k & "E" sh.p.k, për vlerën 315,162,521 lekë.

**14- Procedura me objekt**: "*Ndërtim shkolla 9 vjeçare "Met Hasa", viti 2024* me fond limit 241,896,945 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria "A" sh.p.k, për vlerën 193,847,553 lekë.

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT